

U L M A R K V I K U

MË SHUMË HEROIZMA SE SA GRURË

Një përshkrim dokumentar i historisë dhe jetës
shoqërore të shqiptarëve gjatë shekullit të XX

[U përkthye në shqip prej origjinalit në gjuhën suedeze: "Mera hjältemod än vete"
(Revista "Drita" në Treleborg, Suedi, viti 2004, 399 faqe. ISBN-91-631-5616-4)
por me disa shtesa dhe ndryshime të vogëla]

Përktheu: Hajdin Abazi

Korrektorë:
Shefki Oseku, Ulmar Kvik

Përpunimi kompjuterik: Frashër Oseku

Libri u financua nga ABF-i në Treleborg-Suedi

**I jam shumë mirënjohës kryeredaktorit të "Dritës", Shefki Osekut, pa ndihmën e
të cilit ky libër nuk do ta shihte dritën.**

Autori

U dorëzua në shtyp në qershor të vitit 2006

Tirazhi 1.000 kopje

BOTIM I REVISTËS "DRITA" NË TRELEBORG-SUEDI

Dy fjalë nga përkthyesi

Ulmar Kviku, me qetësinë tipike suedeze dhe me vendosmëri të palëkundshme, për një gjysmë shekulli ka qenë i lidhur shpirtërisht me popullin shqiptar. Me punën dhe angazhimin e tij që ka bërë për kulturën dhe letërsinë, për poezinë dhe afirmimin e shqiptarëve si një komb evropian, me zërin që ka ngritur kundër shtypjes së shqiptarëve nga shovenizmi serb - Ulmar Kviku është figura suedeze më markante që na bën të ushqejmë respekt të përhershëm ndaj tij, ndaj përkushtimit të tij për gjithë atë që është shqiptare, veçmas për përkrahjen me gjithë zemër që u ka bërë prirjeve tona për të flakur të kaluarën e errët dhe për t'u rilidhur me kombet e kontinentit, pra me Perëndimin.

Ulmar Kviku është angazhuar në shumë manifestime kulturore, nëpër shumë qytete suedeze, ku organizohen “Ditët e Kulturës Shqiptare”. Kjo është një ndërmarrje, përmes së cilës ngrihen ura lidhëse midis dy kulturave tona, asaj suedeze dhe asaj shqiptare dhe anasjelltas; përmes të cilave njihemi nga afër mesvete, përmes artit, traditave, ushqimeve, valleve etj. Ai nuk ka hezituar as të kalojë në formë tjetër të veprimtarisë, kur duhej shfaqur edhe publikisht: ka organizuar dhe ka marrë pjesë nëpër manifestime të ndryshme protestash, nëpër manifestime të ndryshme përkrahëse ndaj kërkesës për pavarësi të Kosovës, për të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni etj.

Në vazhden e kontributeve të tija për afirmimin e shqiptarëve, Ulmar Kviku shkroi dhe kryeveprën e tij “Më shumë heroizma se sa grurë”, më 2004, në kohën kur pas ngjarjeve të marsit të vitit 2004 në Kosovë sikur u rishfaq antipatia ndaj shqiptarëve. Në këtë kryevepër, Ulmar Kviku ka shkruar për shqiptarët ashtu sikurse mund të shkruajë një skandinav, një njeri që nga larg e sheh një vend e një popull tjetër, domethënë ai ka shkruar paanshëm, duke vënë në pah si anët pozitive ashtue dhe ato negative, si përparësitë edhe të metat, të mirat e të këqiat, prapambetjen dhe përparimin. Ai e shikon çështjen shqiptare në totalitetin e saj, si interes jetik i popullit dhe kjo është busulla përmes së cilës ai përpiket të orientohet në labirintet politike nga koha e pavarësisë më 1912 deri në ditët tona.

Vepra “Më shumë heroizma se sa grurë” e Ulmar Kvikut është e shkruar me një gjuhë shumë të rrjedhshme, me një stil të lehtë dhe atraktiv, gërshetohet thjeshtësia e të shprehurit dhe mendimi i kondenzuar, përrshkrimi dhe rrallëherë edhe qëndrimi, ai ecën herë para e herë pas në kohë, gjithnjë në funksion të përmbajtjes, i prek të gjitha ngjarjet, të gjitha personalitetet, shpreh mendime të ndryshme rreth tyre, varësisht nga konteksti dhe tema që trajtohet. Në këtë kuptim, konsideroj se libri mund të karakterizohet si postmodernist – nga se nuk mëton të zgjidhë problemet në mënyrë definitive, por t'i shtrojë ato, t'i trajtojë, të ofrojë mendime e pikëpamje pa i sforcuar ato, për ta bërë kështu lexuesin të reflektojë rreth tyre. Lexuesi suedez dhe ai perëndimor do të ndjehej komod duke e lexuar librin e Ulmar Kvikut, sidomos nuk do të ndjente monotoni dhe nuk do të ballafaqohej me moralizime të bezdisshme, dhe ta lexonte deri në fund e të kuptonte më thellë çështjen shqiptare.

Por – mjaft. Nuk kam për qëllim të jap vlerësime këtu; vlerësimet le t'i mbeten lexuesit.

Si përkthyes ndjej të nevojshme që të jap edhe disa shpjegime, lidhur disa vështirësi që ikam hasur. I pari problem me të cilin jam ndeshur ka qenë ai me emrat suedeze, qofshin të njerëzve apo të vendbanimeve – se si t'i shkruaja ata: në origjinal apo sipas shqiptimit? Duke qenë se libri nuk u dedikohet vetëm shqiptarëve në Suedi, e ndoshta më së pakut këtyre, nga se këta mund ta lexojnë edhe në suedisht, jam përcaktuar që si

model ta përdor shqiptimin. Meqenëse gjuha suedeze nuk është e njohur te shqiptarët si, fjala vjen, anglishtja, dhe për t'u dhënë mundësi të interesuarve që t'i njohin në origjinal emrat suedeze, në fund të librit kam përmbledhur të gjitha emrat, ku kam paraqitur emrin sipas shqiptimit (domethënë ashtu sikurse është në këtë libër) dhe përkrah duke e vënë emrin ashtu sikurse shkruhet. Problemi i dytë me të cilin jam ballafaquar ka qenë ai se si t'ia bëj me citimet nga shqipja, të cilat Ulmari i ka përkthyer në suedisht? Sidomos kur është fjala për autorë të vjetër shqiptarë dhe ata që nuk kanë shkruar në gjuhën e njësuar shqipe, dilema ishte edhe më e madhe: si t'ia bëja? Jam përcaktuar, natyrisht në bashkëpunim edhe me autorin, që ato tekste, të cilat mund të gjendeshin, t'i merrja në origjinal dhe t'i paraqisja ashtu, me qëllim që të mos humbet asgjë nga origjinaliteti i tyre. Ato pjesë tekstesh apo citate që janë futur nën thonjëza janë marrë nga tekstet origjinale; kurse të tjerat janë të përshtatura nga suedishtja. Dhe një problem i tretë, nëse mund të quhet kështu, ka qenë ai, fjala vjen, a duhet ta përfshihen edhe në shqip të gjithë nënkapitujt e kapitullit "A mund të mësohet shqipja?", pasi që shumë gjëra janë të njohura për lexuesin shqiptar. Po e kësaj natyre është edhe kapitulli që lidhet me fjalët e urta popullore, ku unë kam ndjekur autorin duke dhënë versionet në të dyja gjuhët, shqip e suedisht. Unë kam këmbëngulur që të dy kapitujt të përfshihen ashtu sikurse janë në këtë libër, nga se kam bindjen se do të paraqesë një burim interesi për gjuhëtarët, të paktën sa i përket relacionit gjuhë shqipe – gjuhë suedeze.

Për hir të singëritetit, më duhet të pranoj se ky libër është vonuar për shkak të llogarive që unë i kam bërë gabim. Mendoja se që në mars, shumë-shumë në maj të vitit 2005 do të ishte i gatshëm për botim. Mirëpo, përgatitja e temës së magistraturës, të cilën e mbrojta në shkurt 2005, më mori më shumë kohë se sa mendoja, aq më tepër që m'u dasht t'i bëja disa plotësime për shkak se ai do të botohej në ueb-sajtin e Institutit të Filozofisë në Lund. Një gabim tjetër kisha bërë se punën e nisa duke përkthyer me dorë në një fletore, dhe kur fillova ta shkruaja në kompjuter, vëreja herë pas here jokorrektësi në përkthim, prandaj i kthehesha sërish tekstit në suedisht për të bërë krahasime. Ky gabim i fundit më ka kushtuar kohë dhe mund, sepse asnjëherë nuk kam mundur të jem i lirë për ta hequr qafesh tekstin në dorëshkrim dhe për të përkthyer direkt në kompjuter, ngase ndodhte që shihja përkthime më të bukura në fletore se sa ajo që e bëja drejtpërsëdrejti në kompjuter. Ky gabim për mua ka qenë një mësim i madh, meqë më bëri ta kuptoj në thelb artin apo teknikën e përkthimit: secili përkthyes i ka nuancat e veta gjuhësore, specifikat e veta dhe momentet që pashmangshëm ndikojnë në kualitetin e përkthimit. Më ka rastisur të shoh, fjala vjen, një poezi të njëjtë të përkthyer nga dy autorë: leksiku dhe nuancat ishin aq të ndryshme, sa që mund të krijohet përshtypja se autorët nuk e kanë përkthyer të njëjtën poezi.

Pavarësisht këtij aspekti teknik, e pranoj se nuk e kam pasur të lehtë të merrem me shqipërimin e këtij libri të Ulmar Kvikut. Stili i tij i të shprehurit që është aq i rrjedhshëm, i thjeshtë, por njëherit edhe i kondenzuar dhe i fuqishëm është i vështirë, shumë i vështirë për t'u shqipëruar në mënyrë adekuate. Kam përkthyer poezi nga shqipja në suedisht e nga suedishtja në shqip, por ky është projekti im i parë kaq voluminoz. Jam i vetëdijsëm se mund të ketë lëshime, prandaj pres me kënaqësi çdo sygjerim, vërejtje, propozim.

Në fund, dua ta fëlenderoj autorin, Ulmar Kvikun, sa për konsultimet, e edhe më tepër për përkujdesjen dhe gjetjen e pjesës dërrmuese të teksteve në origjinal, të cialt i ka fotokopjuar dhe m'i ka dërguar. Dua ta falënderoj mikun tim të fëmijërisë Avni Sadikun, punëtor në bibliotekën komunale "Anton Çetta" të Ferizajt, që më ka siguruar Bajronin dhe Kutelin. Në mënyrë të veçantë, dua ta theksoj se ka qenë një kënaqësi të bashkëpunoj me editorin, Shefki Osekun, i cili shquhet për korrektësi dhe për

përpikmëri të jashtëzakonshme, pa folur për kontributin e tij kulturor, që një shoqatë të vogël shqiptare e ka shndërruar në qendrën më të madhe të botimit shqip-suedisht e suedisht-shqip në Suedi. Për inkurajimin dhe frymëzimin që më ka dhënë për të vazhduar punën me këmbëngulje dua ta falënderoj edhe bashkështoren time, Salihen.

HAJDIN ABAZI

HYRJE

Nga ilirët e lashtësisë, thuaja mitologjik, pas luftërave të shumta me romakë e pastaj edhe me fise gjermane të kohës së dyndjeve të mëdha, në fillimet e mesjetës, u lind populli shqiptar. Natyrisht se invadimet e shumta dhe dyndjet e kishin bërë të veten – këta shqiptarë ishin me siguri pasardhës të ilirëve, por nuk mund të thuhet se ishin i njëjti popull. Si gjatë kohës ilire, edhe tash ata ishin dhe janë një shoqëri fisnore; pas ndarjes së Perandorisë Romake ata i takonin Perandorisë Bizantine. Nga veriu vërshuan sllavët, para së gjithash serbët, të cilët në fund të shekullit të XII arritën të krijojnë Serbinë e Madhe, që zgjati rreth dyqind vjet dhe u shtri mbi gjithë Shqipërinë e tashme deri në Greqi e Bullgari. Ky dominim serb u ndërpre nga ekspansioni i Perandorisë Osmane në drejtim të Evropës Qendrore. Në luftën kundër këtij ekspansioni shqiptarët, nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit të njohur më tepër si Skënderbe, kanë luajtur një rol vendimtar. Ndërsa shqiptarët e tij, pa u shkuar fare në ndihmë shtetet tjera, përgjakeshin gjatë tërë kohës në luftërat kundër turqve, për ç'gjë vendi shkretohej dhe shumë shqiptarë detyroheshin të mërgonin, fuqive evropiane tek më vonë u shkoi përdore të bashkoheshin në qëndresë për ta ndaluar ekspansionin osman në dyer të Vjenës.

Shqiptarët u lanë në fatin e tyre. Nën perandorinë osmane do të mbeten për më tepër se 450 vite dhe vetëm më 1912 e arritën pavarësinë e tyre – por që përfshiu vetëm gjysmën e kombit. Shqiptarët në Kosovë, Maqedoni e në treva të tjera mbeten jashtë kufijve. Është vështirë të thuhet se shqiptarët, në aspektin etnik dhe social, kanë arritur një pozitë më të mirë sot se sa në kohën osmane, po qe se në vija të trasha e krahasojmë me Evropën.

Ky libër do të bëjë fjalë për një popull që gjatë tërë kohës është tradhëtuar nga të fuqishmit. Ata shpesh janë tradhëtuar edhe nga liderët e tyre despotë ose nga mungesa e një udhëheqjeje të mirëfilltë. Krimi i tyre i vetëm ka qenë dobësia e tyre sociale dhe ekonomike si dhe prapambetja. Tradhëtia ka vazhduar deri në kohën tonë.

Unë jam përcaktuar të kombinoj përshkrimin dokumentar me elemente fiktive, të bazuar në dokumente. Lexuesi nuk do të mbetet i panjohtuar lidhur me këtë meqë në hyrje të çdo pjese shpjegohet se a është fjala për fakte apo fikcion. Kjo që unë kam hartuar nuk është ndonjë lloj kursi në historinë shqiptare. Qëllimi im ka qenë që, mbi të gjitha, të prezantoj atë që është e pamundur të gjendet në enciklopedi e vepra të tjera. Për një informacion të përgjithshëm mbi historinë dhe shoqërinë shqiptare do t'u rekomandoja librin "*Örnarnas land*" - "Vendi i shqiponjave"- të Shtëpisë Botuese Studiekamraten 1995, të autorit Peter Dalhof-Nilsen. Në përshkrimin tim do të kufizohem kryesisht në vitet 1912-2001. Dua poashtu të theksoj se temat e ndryshme të librit janë të lira nga njëra tjetra, gjë që nuk e bën të domosdoshëm leximin në kontinuitet.

Problemet e veçanta që lidhen me gjendjen e shqiptarëve në Jugosllavi dhe në Kosovën aktuale, Maqedoni dhe Mal të Zi janë trajtuar hollësisht në librin e mësipërm të Dalhof-Nilsenit, në "*Kosova utan stjärna*" - Kosova pa yll – Shtëpia Botuese Karlsons 1993 të Soren Someliusit, dhe në "*Den albanska frågan*" - "*Çështja shqiptare*" - botuar nga Institutit i Politikës së Jashtme në serinë "*Världspolitikens Dagsfrågor*" - "*Çështjet aktuale në politikën botërore*" - 8-9 viti 1997 me autorë Orjan Styreshë e Sebastian Sheiman. Gjithashtu unë kam shkruar tre broshura kushtuar çështjes së Kosovës në kuadër të serisë së botimeve të Shoqatës Suedeze-Shqiptare. Prandaj, në këtë libër, jam kufizuar vetëm në një paraqitje përmbledhëse të shkaqeve të problemit të Kosovës,

meqë më është dukur më e rëndësishme të trajtoj zhvillimet në shtetin e Shqipërisë, shoqëria dhe kultura e të cilit janë ndriçuar në mënyrë shumë të përciptë në mediat suedeze. Punimet e vjetra mbi Shqipërinë nga Bengt Fyledal dhe Gyn Kesle - Jan Myrdal, parë në dritën e asaj që sot dimë mbi regjimin e Enver Hoxhës, duhet të trajtohen si të vjetëruara. Ndërsa lidhur me Kosovën ka sot mjaft material – kurse jo më larg se para 25 vjetësh nuk kishte thuaja asgjë! Problemi i Maqedonisë preket në rrëfimin që ka të bëjë me udhëtimin tim atje më 1994, por vetëm nga horizonti i një fshati të vogël. Në gjendjen aktuale, ardhmëria e shqiptarëve në Maqedoni është një faktor ndër më të pasigurtët në politikën botërore, dhe në mungesë të një vizioni të kristaltë kam abstenuar të merren me profeci. Këtë e kam bërë për shkak se shumë nga zhvillimet janë të mbuluara me mjegull të madhe.

Edhe diç: libri përmban shumë kundërthënie. Kam zgjedhur që të rrëfej pikëpamjet mbi shqiptarët, të cilat janë në kontrast të ashpër me njëra-tjetrën. Ndoshta edhe shqiptarët e edhe suedezët, që i çmojnë shqiptarët, mund të pyesin se përse bëj kështu. E vërteta është se një krahasim nga e kaluara dhe e tashmja pjesërisht e konfirmon një pjesë të pikëpamjeve negative, sikurse që edhe e përforcon një pjesë të pikëpamjeve pozitive; por qenësore është përpjekja për të kuptuar se përse ky popull dhe ky vend janë të tillë siç janë, dhe lidhur me këtë historia mundet të na japë njohuri të rëndësishme.

Për suedezët nuk është kurrfarë turpi po qe se konstatohet se stërgjyshërit e tyre ishin të ashpër dhe barbarë, se ata, me ndërmarrjet luftarake, i pllakosën shumë popuj dhe ishin tmerr për popujt paqedashës. Ndërsa të tërheqësh vëmendjen te faktet negative për popujt në Ballkan është shumë më e ndieshme, për shkak se përmes shtrembërimit të së vërtetës dhe shpifjeve ndaj popujve fqinjë, sidomos pushtetarët në Serbi dhe Greqi, kanë krijuar një atmosferë helmuese, me çka është goditur pikërisht e vërteta dhe objektiviteti. Mitet, gënjeshttrat, shtrembërimet dhe kundërthëniet e shprehura religjioze kanë qenë mjete të qarqeve drejtuese për arritjen e qëllimeve të tyre nacionaliste dhe shoveniste, dhe infektimin që e kanë përhapur në popull do të mbetet për një kohë të gjatë. Asgjë nuk duhet të na pengojë neve që ta zbatojmë maksimën e Erik Gustaf Gejerit, maksimë që vlen për çdo lloj hulumtimi: Ne duhet të shohim se çka fshihet pas asaj që është e dukshme.

Ky libër është një përpjekje e tillë. Një përpjekje modeste, pa pretendime të mëdha letrare ose artistike. Një fakt krejt i pazakonshëm duhet përmendur: Unë jam i vetmi në Suedi që e kam tërë atë fond materialesh në shqip dhe që mundem ta shfrytëzoj, sepse mundem ta interpretoj nga shqipja. Këtë fakt e kam përjetuar si një detyrë, që këto njohuri t'i përcjellë më tutje te një rreth lexuesish suedezë, e të mos i marr ato me vete në varr. Në vend që të jap një përshkrim të plotë lidhur me popullin shqiptar jam përqëndruar në çështje të caktuara, si, fjala vjen, mbi mentalitetin, traditat, kulturën dhe disa rrjedha të rëndësishme historiko-politike. Në këtë kontekst nuk u jam shmangur as miteve, patetizmit dhe melodramatizmit, meqë ato janë shprehje e mentalitetit shqiptar.

Pa e njohur këtë pasuri opinionesh nga e kaluara e që edhe sot e kësaj dite gjenden si komponente të rëndësishme në përfytyrimet e shqiptarëve mbi botën, është absolutisht e pamundur të kuptohet botëkuptimi shqiptar. Gjenerata ime e viteve të 30-ta e të 40-ta u formua në aspektin social nga libri i leximit "*Far rar. Mor är rar*" - "Babai merret me lundrim. Nëna është e dashur"- nga psalmet dhe lutjet e mëngjesit. Ne, kështu, u futëm në një botë të qetë e statike, ku sundonin pikëpamje të qarta morale, kurse bota mendore e fëmijëve tanë u karakterizua shumë më tepër nga ndryshime dhe nga ndikimi i përhershëm i mediave.

Të gjithë janë fëmijë të kohës që i përkasin, dhe kjo vlen gjithsesi edhe për shqiptarët. Një pjesë e mirë e elementeve të botkuptimit të shqiptarëve në kohën tonë do të kuptoheshin si krejt normale prej intelektualëve suedezë të para 150-200 vjetësh. Patriotizmi patetik dhe romantik i Suedisë së asaj kohe ka ngjashmëri të mëdha me atë të shqiptarëve bashkëkohorë. Pjesa dërrmuese e asaj që kam dashur ta pasqyroj i përket, pra, asaj që është keqkuptuar ose është refuzuar nga shumë observatorë të jashtëm bashkëkohorë. Lexuesi është i vetmi i cili mund të gjykojë, nëse ia kam arritur ta shpie atë në ambientin kulturor e tradicional shqiptar.

FISET SHQIPTARE

Një gjimnazist suedez, që unë do ta quaj Anders Vestin, njihet me çështjen shqiptare. Ai përcjellë shtypin, lexon libra dhe i shtohet interesimi. Ato tekste të cilat ai i gjen shpesh thonë më tepër për autorin se sa për shqiptarët. Ne do ta shohim çështjen përmes syve të Andersit dhe do të ndeshemi me reagimet e tij. Materialet faktike – të dhënat e ndryshme biografike dhe tekstet nga burime të ndryshme – paraqiten pa shtrembërime, kurse mendimet dhe konkluzionet e Andersit siç kuptohet janë fiktive.

Duka i Sodermanlandit – princ i Shqipërisë?

E ëma, si zakonisht, e la gazetën e mëngjesit në tryezën e Andersit, pasi që ai hëngri mëngjesin. Edhe babai flinte, si rëndom. Redaktorët e gazetës, që punojnë deri në orën dy të pasmesnatës, më me qejf do të flenin tërë paraditen. Ata, si një pjesë e profesionit, merren edhe me gazeta të tjera. Andersi e shikoi orën; nuk do të kishte më tepër kohë se sa t’ia hidhte një sy gazetës *Dagens Nyheter* (Lajmet Ditore) në atë ditë të ftohët vjeshte, më 30 tetor 1912, për të parë nëse kishte ndonjë tension diku në botë. Në orën 08.30 duhet të jetë në shkollën “Sodra Latin” (Latini i jugut), për të marrë pjesë në lutjen e mëngjesit dhe leksionet e ditës. Dyshonte se ajo që e kishte kujdestarinë atë mëngjes do të ishte mësuesja Lundgren - tmerri i shkollës. Prej saj, nuk kishte mundësi të shpëtohej pa vërejtje, po qe se shkohej me vonësë.

Anders Vestini, një gjimnazist shtatëmbëdhjetë vjeçar, në mënyrë të pasionuar ishte i interesuar se çka ndodhte jashtë kufijve të Suedisë. Në mënyrë po aq të pasionuar, babai i tij ishte i interesuar për politikën suedeze, gjë që i përkiste profesionit të tij si redaktor në gazetën *Socialdemokraten* (Socialdemokrati). Familja banonte mjaft këndshëm në një banesë katërdhomëshe në Folkungagatan në Soder (Jug), një lagje pas Sheshit të Nënshtetasit, në fqinjësi me Bjornpark. Andersi ishte i vetmi fëmijë, prandaj e kishte një dhomë të veten. Kjo, dhe dhoma e punës e babait, dhoma e fjetjes e prindërve dhe dhoma e ndejës e përmbyllte kuartetin.

Në faqen 8 Andersi gjeti atë që kërkonte: një artikull të theksuar kozerik me titullin “Shteti ynë ballkanik”. Në Ballkanin e trazuar ndodhnin vazhdimisht gjëra të tilla, që e bënin të rritej interesimi i gjimnazistit tonë. Lufta ballkanike, e cila kishte një muaj që kur ia kishte filluar, qe një shok për Evropën, e cila kishte imagjinuar se qe nisur epoka e paqës së përhershme. Mirë, malazetët dhe turqit, mund edhe të grinden; por fuqitë civilizuese kurrë më nuk do të hidheshin kundër njëra-tjetrës - kjo ishte melodia e asaj kohe.

Shikimi i Andersit endej midis orës dhe gazetës. Një rubrikë arrij ta lexoj, mendoj ai.

”Meqë në Këshillin e Fuqive të Mëdha ka gjasa se do të vendoset që nga trazirat e Ballkanit, ndër të tjera, të krijohet një Shqipëri e pavarur me princ Karl Vilhelm Ludvigun (Princ Vidin), nga dera e Bernadotit¹ të Francës, ndaj ne kemi një shkak më tepër për të hedhur një shikim në këndin e Evropës juglindore. Po qe se i shikojmë hartat e luftës do t’i gjejmë me lehtësi qytetet bregdetare Durrës dhe Vlorë në detin Adriatik, që supozohet se këto qytete do të ishin brenda Shqipërisë, si kufinj të veriorë dhe jugorë të saj. E kur tash Shqipëria jonë e Bernadotit do të jetë e madhe afërsisht sa shteti aktual i mbretit Nikita, nevojitet vetëm të futemi brenda ndonjë kilometër nga vija bregdetare që të arrijmë në atë trevë, e cila përnjëherësh u bë me interes të veçantë

¹ Familje nga kryeqyteti Pau i Béarn, krahinë jugore franceze, prej të cilës familje rrjedhë familja mbretërore suedeze.

për neve. Nëse do të na lejohej të futeshim më në thellësi do të arrinim te liqeni i Ohrit, që është i dobishëm për peshkim dhe lundrim. Ky liqe në madhësi i afrohet Jelmarit dhe prandaj nuk është për t'u nënçmuar."

Autori vazhdon më tej ta teleisë, në mënyrë komike, shkrimin e tij, duke thënë se duka nga Sormland, princi Vilhelm, është menduar të jetë sundues i Shqipërisë ekzotike dhe të prapambetur, gjë që autori e konsideron poaq të parëndësishëm sa edhe shtetin e vogël malor, Mali i Zi, të Nikitës. Kozeristi, që e quan veten Zhan q. P, konstaton më tej se princi Vilhelm do të sundojë mbi 240 000 shpirtëra, që është sa Stokholmi pa lagjen Soder. Elbasanin, kryeqytetin e menduar, e krahason kozeristi me Eskilstunën, "ku banorët merren me përpunimin e metaleve të dobishme, si hekur dhe bakër".

Zhan q. P. vazhdon me ironizimin duke u zgjeruar edhe lidhur me mundësitë e princ Vilhelmit që, me ndihmën e armëve, ta rrisë shtetin e vogël shqiptar. Kjo nuk do të duhej të ishte aspak e pamundur, mendon ai, pasi që "populli shqiptar është mirë i stërvitur në armë dhe kështu edhe shumë i përshtatshëm për të ndërmarrë një ofensivë ekspansioniste. Një çun i moshës shtatëvjeçare mundet që, në largësi prej dhjetë metrash, nga gjuajtje me thikë, të godasë një mizë; ndërsa burrat marrin njohuri të shkëlqyeshme luftarake përmes shërbimit një apo disavjeçar në ndonjë nga bandat plaçkitëse, një kurs i detyrueshëm e me vlerë të madhe".

Kur Andersi arriti deri këtu me leximin konstatoi se i kishin mbetur vetëm edhe shtatë minuta për të arritur në shkollë. Shkolla ishte vetëm tri lagje larg, por mësuesja Lundgren... Ai i gëlltiti rreshtat e fundit para se të shpejtonte për në shkollë:

"Nuk duhet harruar se shqiptarët janë krejt të paqëndrueshëm në ndjenjat e tyre, për çka është e këshillueshme për princin e tyre të ardhshëm që vazhdimisht ta mbajë të ndezur një anije me avull në skelen e Durrësit. Rruga prej aty deri në Brindis është shumë e shkurtër".

Anders Vestini vazhdon leximin

- Në mbrëmje do të shkojmë ta shohim *Të vejen e Gëzuar* të Leharit, tha babai i Andersit duke tundur tre bileta. – Biletat veç janë shitur, por unë ia mora një bashkëpunëtori të gazetës, që kishte tjetër gjë për të bërë sonte.

Në fillim Andersi ishte mjaft i ngazëllyer, por më pas filloi të mendojë se mund të ishte interesante për të dëgjuar se si paraqitej Ballkani dhe ngjarjet e atjeshme në formë të operetës.

Kur atë mbrëmje bashkë me prindërit u kthye në shtëpi, Andersi e kishte me vete këngën e princit Danilo "Atëherë shkoj te Maksimi...". Pamja e një princi ballkanas, që argëtohej me zonja sharmante në Paris për të harruar mallin për Malin e Zi, i përzihet me tekstin e gazetës:

"Në ndërkohë vazhdonte princi Danilo marshin e vet fitimtar kundrejt Shkodrës, qyteti që josh nga largësia popullin e Maleve të Zeza dhe që ndër shkekuj ka zgjuar lakmitë për plaçkitje. Shkodra është një ndër vendet më të bukura natyrore të Shqipërisë, një qytet pitoresk me 4-5 000 shtëpi të vogla me kulme të rrëpirët. Në drejtimin veriperëndimor shtrihet liqeni vezullues, i cili rrethohet nga një mori kodrash të larta, kurse në drejtimin tjetër - zgjerohen si buzëqeshja fushat pjellore, arat me misër, që shtrihen deri atje ku syri mund të shikojë".

- Përse, e vriste mendjen Andersi në shtrat para se ta zinte gjumi atë natë, njerëzit atje në Ballkan – dhe në përgjithësi në ato pjesë të botës që janë larg nesh dhe që nuk kanë popullatë me origjinë evropërendimore – janë aq pitoreskë ose qesharakë ose të papjekur ose të marrë ose mashtrues në pjesën dërrmuese të përshkrimeve që po lexoj? Përse stërgjyshërit tanë, vikingët, nuk janë në mënyrë të ngjashme pitoreskë, qesharakë,

të papjekur, të marrë ose mashtrues si shqiptarët, arabët e afrikanët, megjithëse shkencëtarë të sinqertë e kanë dëshmuar se ata kanë qenë jashtëzakonisht të papastër, të tmerrshëm, mashtrues dhe plaçkitës? Se, këtu vlerat letrare më me kënaqësi paraqesin pamjen e një luftëtari krenar, që hedhë shikimin në drejtim të hapësirës së detrave dhe që trimërisht shkon në luftime edhe kundër armiqve më të fuqishëm. Këtu patjetër duhet të ekzistojë një nevojë për ta fshehur të vërtetën. Civilizimi ynë i jashtëzakonshëm evropian dëshiron të drejtojë dhe të rregullojë sipas shijes së vet tërë botën, dhe puna është që Fuqitë e Mëdha duhet vetëm të gjejnë pretekste për politikën e tyre mizore dhe shfrytëzimin e vendeve të largëta...

Me gjithë moshën e vet të re Andersi arriti të fitojë një aftësi për të analizuar, ose për t'u shprehur me fjalët e historianit të madh Erik Gustaf Gejer: për të parë se çka fshihet mbrapa të dukshmes. Kohëve të fundit, shpesh kishte shkuar me tramvaj deri tutje në bibliotekën e qytetit të Stokholmit dhe kishte studiuar vepra të vjetra e të reja lidhur me Ballkanin. Donte të mësonte më shumë për këta shqiptarë enigmatikë. Mirëpo, ajo që kishte lexuar më tepër shprehnin mëdyshje dhe kundërthënie se sa njohuri të vërteta e të besueshme. Një bibliotekare e sjellshme, që kënaqej me interesimin e pazakonshëm të këtij gjimnazisti të ri, e kishte ndihmuar atë për të gjetur fakte dhe enciklopedi të ndryshme.

- Shiko, thoshte bibliotekarja me zell, këtu e ke *Pelegrinin e Child Haroldit* nga Lord Bajroni, në përkthimin suedisht, pelegrinin e Haroldit të ri. Bajroni ka udhëtuar nëpër Shqipëri në fillim të shekullit të kaluar dhe kështu shkruan ai: "Të rreptë bijt' e Shqipes! Por virtyte:

Nuk u mungojnë; veç t'ishin më t'arrira:
Armiku ua pa kurrizin ndonjë herë?
Kush e duron si ata mundimin' e luftës?
Shkëmbinjt' e tyre s'jan' më të patundur
Nga ata në çast rreziku dhe nevoje:
Ç'armiq për vdekje, po aq miq besnikë!?"²

Bajroni është krejt i kundërt me kozeristin e Dagens Nyheter, mendoi Andersi – ai thoshte se shqiptarët ishin të pandryshueshëm dhe jobesnikë, kurse Bajroni, që i kishte parë nga afër mendonte se ata ishin jashtëzakonisht besnikë. Unë mund të vëj bast një metelik, se Bajroni ka të drejtë, e përfundoi Andersi rrjedhën e mendimit. E bibliotekares i dha këtë koment:

- Po, është interesante se Lord Bajroni ka shkruar nga përvoja e tij personale. Por, a nuk ka ndonjë përshkrim a vlerësim më të ri mbi shqiptarët?

- Kam gjetur diçka, qyshkur ti më tregove për interesimin tënd, por jo dhe aq shumë, i tha bibliotekarja. – Një francez, që quhet Guillaume Lejean ka shkruar mbi një udhëtim në Bullgari, që më pas vazhdoi nëpër Shqipëri. Ja *Övfer land och haf* - Nëpër tokë e det- një përmbledhje me udhëpërshkrime, ku është edhe rrëfimi i Lejeanit. Udhëtimi i tij u bë më 1857, kurse përkthimi suedez u botua më 1878, shtoi ajo.

Andersi i gjeti shpejt ata kapituj që bënin fjalë për udhëtimin e francezit në mesin e shqiptarëve. Kur Lejeani erdhi te qyteti Ipek i Kosovës, një qytet që sllavët e quajnë Peç e shqiptarët Peja, një qytet i vogël, por i bukur, do të kërkonte aty një njeri bese, që do të mund të garantonte sigurinë e tij për vazhdimin e udhëtimit të tij nëpër vendin e shqiptarëve. Por ai e kishte gjetur qytetin në rrëmujë. Një musliman i ri, që ishte dashuruar në një muslimane prej një familjeje të mirë dhe dorën e së cilës ai do ta kishte marrë pa vështirësi, sikur ta kishte kërkuar atë, e kishte konsideruar më

² Xh. G. Bajron: Çajld Harold, f.55. Shqipëruar nga Skënder Luarasi. Shtëpia Botuese Onufri, 1999. Tiranë.

tërheqëse që ta rrëmbejë atë me armë në duar. I tërë qyteti ishte ndarë në dy taborre, për dhe kundër; tërë natën kishin shtënë në njëri-tjetrin dhe disa ende kishin mbetur në pozicione. Por kur francezi kishte mbërritur, qytetit i ishte kthyer sërish e tërë qetësia.

Pas një sërë aventurash nëpër malet e Shqipërisë veriore mbërrin Lejean në liqenin e Shkodrës dhe vendin e quajtur Koplik. Atje ai kishte dëgjuar të flitej për një rast të çuditshëm të drejtësisë turke dhe i kishte parë vetë pasojat: rrënojat e freskëta të një shtëpie të bukur. Guvernatori gjeneral i Shkodrës, Esad Pasha, donte t'i jepte fund gjakmarrjes, që po e shkatërronte krahinën, dhe kishte urdhëruar që familjet e dorasit të shpalleshin drejtpërsëdrejti përgjegjës. Ata do të burgoseshin dhe të dëboheshin nga vendi, shtëpitë e tyre do të rrafshoheshin me tokë dhe pasuria e tyre do të konfiskohej. Qarqet drejtuese në Shkodër e kishin pëlqyer këtë dekret, ata në periferi nuk kishin bërë zë e sa i përket parive të maleve - ishin kujdesur të mos u thoshin asnjë fjalë atyre.

Një kohë më pas ndodhën dy vrasje në trevë – njëra në Dajç nga një katolik dhe tjetra në Koplik nga një musliman. Të dy vrasësit ia arritën të shmangen dhe nuk mund të gjendeshin – e për këtë do të mund të befasohej vetëm se kush që nuk e njuh policinë turke. Dekreti i pashait zbatohet ashpër kundër familjes së vrasësit të parë: nëna e tij, gruaja dhe motrat u hodhën në burg, shtëpitë e tyre u rrënuan dhe pasuria e tyre u shit shumë lirë; ato pastaj, duke hequr vetë shpenzimet, u dëbuan larg për në Bullgari. Por, kur u bë përpjekje e njëjtë në Koplik, ku ishte fjala për një fajtor musliman, u ngrit i tërë fshati dhe i largoi policinë. U dasht të dërgohen dy kompani kombësorie, të cilët me siguri e shkatërruan shtëpinë e fajtorit, por nuk guxuan të preknin gratë, të cilat për shkaqe fetare gëzonin një mbrojtje të fuqishme. Lejeani e përjetoi këtë si padrejtësi, pasi që gratë katolike do të duhej të gëzonin të njëjtën mbrojtje si gratë muslimane..

Në Shkodër Lejeani arriti të njihet me nënën e kryeplakut të Mirditës, Bib Dodën. Mirdita është një malësi e djerrë në veri të Shqipërisë, në mes të Shkodrës dhe Tiranës, popullsia e së cilës përbën një ishull katolik në një territor musliman. Kjo, mbase, edhe ishte treva më e çuditshme shqiptare që e kishte vizituar studiuesi francez, i cili poashtu shkruan se burrat i marrin gratë duke rrëmbyer ndonjë vajzë nga treva e afërt muslimane. – Në Suedi përrallat tregojnë për rrëmbime nusesh në mesjetë, por jo edhe më vonë, kujtoi Andersi. - Lejeani i përshkruan banorët e Mirditës njëmend si antikë, në kuptimin shkencor të fjalës. Besimi i tyre katolik është vetëm lustër – përveç kryqit të krishterë në kishë dhe armët që secili burrë, në moshën dymbëdhjetë vjetë e sipër i mbanë mbi supe, kurrfarë shenjash nuk ka se këta njerëz jetojnë disi më ndryshe sesa në lashtësi - në antikë. Edhe vënia e emrave poashtu nuk është në mënyrë të krishterë, shkruan Lejeani. Luftëtarët krenarë mund të quhen Bib (gjel deti), ose Lepur, kurse gratë kanë emra si Kuqe, Bjeshka, Sul ose Preu. Misionarët kanë gjetur mënyrat se si ta përmirësojnë lustrën: Nëse babai i thotë priftit që vajza do të quhet Bjeshka, prifti e regjistron në librin e pagëzimit me emrin Sylvia. Në mënyrë të ngjashme emri Sul bëhet Flora ose Florina, kurse Preu, që është emër i së premtës, përkthehet si Veneranda. Dhe Lejeani komenton: "Shih se si shqiptarët bëhen katolikë, pa dyshuar fare!"

Lejeani, në fund, e ngrit çështjen e problemit më të madh të shoqërisë shqiptare: gjakmarrjen, që ai e cilëson si "kancer i çështjes së nderit", dhe me siguri ka shumë shqiptarë që këtë të keqe e kanë përjetuar si kancer në trupin e shoqërisë. Ai përmend shifrën prej 3000 viktimave në vit në Shqipërinë e veriut. Lejeani mendon se shqiptarët e konsiderojnë jetën e tyre si jashtëzakonisht të vlefshme, kurse jetën e të tjerëve si krejt të pavlefshme. Në orient, shkruan Lejeani, nuk njoh askend tjetër përveç malazezve, që poashtu nuk e çmojnë shumë jetën, mirëpo ka një dallim të dukshëm mes tyre. Malazezi e di se përse vdes: për besimin e vet, për atdheun, për lirinë. Shqiptari lufton për asgjë, vetëm për qejf të luftës. Dhe, edhe një çështje tjetër: kur shqiptari nis të hyjë në flakë të luftës, vishet me krejt çka ka më të bukur, flori të pastër dhe me qëndisje të hijshme.

Kurse kur malazezi do të shkojë për të luftuar merr me vete veshjen më të keqe, sepse ai nuk don që panevojshëm të shkatërrojë pasurinë e bukur, po qe se do të flijonte jetën...

Një libër tjetër, që Anders Vestini e huazoi nga biblioteka, i ofroi të dhëna të kundërta mbi shqiptarët. Libri *Orienten - Orienti* nga A. fon Shveiger-Lershenfeld, në suedisht u publikua më 1883. Ishte një vepër voluminoze që fillonte me Shqipërinë dhe Greqinë dhe përfundonte me Tunizinë. Andersi e kuptoi shpejt se ky libër i trashë, njëloj si përshkrimi i Lejeanit, përmbante një përzierje të të dhënave interesante me gjykime të pamenduara dhe paragjykime. Fakti që shkrimtari është munduar të përmbledhë shkrimet për tërë Orientin në 1000 faqe, ku shumëçka dëshmon se shkrimtari ka bërë udhëtime dhe studime vëllimore edhe të literaturës, është tregues për përpikërinë dhe zellin e pabesueshëm gjerman. Mirëpo, për fat të keq, edhe ky libër nuk ishte me më pak gjykime arbitrare dhe paragjykime.

Autori pohon se shqiptarët me siguri rrjedhin nga ilirët, por jo nga pellazgët. Andersi, shumë kohë më pas, do ta vërtetonte këtë përmes studiuesve albanologë, kështu që duket se mendimi i autorit është i saktë. Poashtu, ai thotë diçka të qëndrueshme kur shkruan se invadimet, që ndodhën njëri pas tjetrit, e boshatisën bregdetin shqiptar të Adriatikut dhe të detit Jon, mirëpo shpirti i vjetër shqiptar mbijetoi nëpër viset malore.

E çka ka, pra, fon Shveiger-Lershenfeld për të thënë mbi këtë shpirt shqiptar? Pas leximit të kapitullit mbi Shqipërinë, Andersi arriti në këto përfundime:

- Shqiptarët janë kokëfortë dhe u shquhet ndjenja e fuqishme për liri.
- Janë mjaft indiferentë ndaj fesë.
- Shquhen për karakteristikat kombëtare dhe kanë doke e zakone origjinale.
- Nuk kanë gjuhë të shkruar. (Kjo vlente deri më 1908, kishte mësuar më parë Andersi).
- Ushtarët shqiptarë ishin trupa e zgjedhur dhe më e mira e shtetit Osman.
- Me gjithë shkathtësitë e tyre luftarake, shqiptarët e kanë të vështirë të përshtaten me shtrëngime dhe disiplinë.
- Janë të pa ndjenja, karakterizohen nga lakmia për para dhe etja për vrasje. (Gjakmarrja).
- Respektojnë traditat, por nuk çajnë kokën për ligjet dhe institucionet shtetërore.
- Me gjithë këto, ata janë patriotë dhe janë të gatshëm të flijojnë jetën për atdheun.
- Një pjesë e shqiptarëve merren me blegtori, më pak me bujqësi dhe thuaja fare me industri.
- Gjakmarrja është një murtagjë për shqiptarët. Çështjet që kanë të bëjnë me mysafirët, me rrëmbimin e femrave, plaçkitja dhe sulmet kërkojnë gjak. Familja e nëpërkëmbur është e detyruar të hakmerret me gjakmarrje. Shumë jetojnë si banditë lart në male për t'i shpëtuar hakmarrjes. Ata që jetojnë kështu, nuk mund të sigurojnë ekzistencën ndryshe përveçse si plaçkitës. Konsiderohet se për çdo vit rreth 3000 njerëz mund të bien viktima të gjakmarrjes.

- Shqiptarët janë të ndarë në fise, ku kryeplaku ka një pushtet patriarkal. Gratë kanë vlerë të paktë, kurse gruaja më e moshuar në familje i ka po ato të drejta ndaj anëtarëve të familjes sikurse kryefamiljari ndaj burrave.

Autori ia kushton rreth 40 faqe shqiptarëve, historisë dhe vendabimit të tyre. Pamja ishte mjaft e errët: prapambetje, analfabetizëm, rrënim dhe ethe malarike. E vetmja figurë e ndritshme që gjen autori gjerman është luftëtari shqiptar i lirisë Skënderbeu, emri i vërtetë i të cilit ishte Gjergj Kastrioti, dhe që luftoi për popullin shqiptar kundër osmanëve në shekullin e pesëmbëdhjetë. Ai përshkruhet si një hero i vërtetë, mbase për shkak se autori e sheh atë si "ushtar të Jezu Krishtit dhe princ të epirotëve", titull që ai e kishte hasur te biografishkruesi i Skënderbeut, murgu Barlet, edhe ai shqiptar, nga Shkodra.

Megjithëse ishte i vetëdijshëm për mangësinë e opinionit evropian lidhur me popujt jashtë qarqeve të veta kulturore, Anders Vestini filloi të ndjehet paksa i hutuar. Çka do të duhej të besonte ai për këta njerëz të paqëndrueshëm e besnikë, të paligjë e patriotë, mikpritës dhe plaçkitës vrasarë, që e përbënin popullin shqiptar? Nuk ishte asgjë më lehtë, kur ai lexoi veprën e fon Shveiger-Lershenfeld, kapitullin mbi Greqinë dhe, për çudinë e tij, aty përshkruheshin grekët si "të pakujdesshëm dhe të ndyrë, jomikpritës, me priftër të paditur dhe ortodoksë vulgarë". Kjo vlente kryesisht për fshatrat, por megjithatë... Dhe në përgjithësi, si tipar për karakterin popullor grek konsiderohej se ai është "i kotë, mburravec dhe lakmitar për fitim". Me sa duket ishte zhdukur fare në rrjedhën e kohës heleni klasik e fisnik, ose të paktën kështu mendonte eksperti gjerman.

Por kishte diç edhe më sensacionale. Fon Shveiger-Lershenfeld konsideronte se grekët me siguri kishin një çikë forcë dhe ashpërsi, por kjo varej nga fakti se ata ishin përzier me shqiptarët! Pa pjestarët e popullatës shqiptare në Greqi, grekët nuk do ta fitonin kurrë luftën e lirisë kundër turqëve:

"Thuaja se të gjithë prijësit e shquar të palikarëve ishin shqiptarë; burrat e flotës, që u shquan aq shumë në të njëjtën kohë, ishin të rekrutuar nga banorët shqiptarë në ishujt Speza, Hydra dhe Porosi, si dhe nga popullata e përzier shqiptaro-greke e Salamisit, Euboeas dhe Aginas".

Andersi krijoi bindjen se kjo vepër nuk do të mund të ndodhte kurrë që të përkthehej në greqisht, se ai tashmë kishte mësuar diçka mbi qëndrimin e grekëve ndaj popujve fqinj, qëndrim ky që ishte jashtëzakonisht i ligë, sidomos kundrejt shqiptarëve. Me siguri se në këtë vepër përshkruheshin shqiptarët kryekreje negativisht, por opinionin mbi grekët ishte edhe më kritik. Mendimi se grekët ishin degjeneruar totalisht që nga antika dhe se ata e kishin fituar lirinë e tyre vetëm sepse ishin përzier me shqiptarët e fortë e të guximshëm do t'i kishte bërë lexuesit grekë t'i shkoqnin me dhëmbë faqet e librit dhe t'i flaknin!

Të çrrënjoset e tërë fara shqiptare!

Në shtypin ditor rrëfenin korrespondentët gjermanë, francezë dhe austriakë për mikpritjen shqiptare. Lidhur me rrethimin e Shkodrës nga malazetët nuk kishte se çka të raportohet, e aq më tepër lidhur me luftimet në rrethinën e Shkupit, që asokohe ishte kryeqytet i Kosovës, që ishte vilajet osman. Serbët dhe malazetët kishin përparuar dhe nga të gjitha anët i kishin bërë të tërhiqeshin turqit, duke vazhduar më tej drejt Shkupit, i cili në lashtësi quhej Skupi e turqit e quanin Yskub. Serbët prireshin nga ëndërra për Serbi të Madhe: Një herë kishte qenë Shkupi kryeqytet i Serbisë së Madhe gjatë sundimit të Stefan Dushanit. Ai qe kurorëzuar si car i serbëve, bullgarëve dhe grekëve ditën e pashkëve të vitit 1346. Por plot katërdhjetë vjetë më pas, më 1389 u mposht ky shtet i Serbisë së Madhe në betejën e njohur të Fushë Kosovës; këtu qenë mposhtur forcat e bashkuara serbe, shqiptare dhe hungareze nga turqit osmanllinj dhe këta do të qëndronin në këto treva për pesëqind vjetë.

Andersi po mendonte për ëndërrën e Serbisë së Madhe. Suedia kishte qenë superfuqi në shekullin XVI-XVII. Kur kjo perandori, më në fund, u shpërbë dhe, më pas, Suedia pa luftë e lejoi Norvegjinë të bëhet më vete, gjë të cilën Andersi e kishte përjetuar si nxënës i klasës së katërtë fillore, Suedia kishte mbetur një shtet thuaja vetëm me suedezë. Trevat jugore³, të cilat u ishin rrëmbyer danezëve, ishin suedizuar me mjaft efektivitet, sa që skonezët ishin kryesorët në administratë, në industri e tregti jo vetëm në Skone por edhe shumë përtej kufijve të saj. Ne e kishim, natyrisht, edhe Fushën e Tornes me popullatë finlandeze, por këta nuk kishin shprehur ndonjë interesim që të

³ që sot quhen Skåne (shqip: Skone)

mbrojnë përkatësinë e tyre finlandeze, madje përkundrazi. Kishin mbetur vetëm lapët me kaprojtë e tyre; këta ishin vazhdimisht të pakënaqur me sundimin suedez, që i pengonte ata të bënin jetën sipas traditave të tyre. Por, vallë, a do të duhej Suedia të pretendonte sërish Finlandën, Estoninë dhe Letoninë, si dhe të kërkonte një pjesë të Gjermanisë veriore? Kjo është krejt e paimagjinueshme. Kurse serbët kishin paturpësinë që të kërkonin atë që e kishin pasur për një kohë të shkurtër dhe atë thuaja para gjashtëqind vjetëve! Ata kishin luftuar për lirinë e tyre kundër turqve, e ndërkohë nuk dëshironin që shqiptarët dhe popujt e tjerë të Ballkanit të fitonin pavarësitë e tyre. Kjo provonte se mentaliteti i tyre ende ishte i ulët, po në atë nivel që e kishte Suedia para dyqind vjetëve, në kohën e mbretit Karl XII.

Lufta serbe në Ballkan, veçanërisht në tetor-nëntor 1912, sipas burimeve nga Evropa qendrore, kështu përshkruhej në shtypin suedez:

”Gjeneral Stepanoviç, në Kratovë i ka rreshtuar në dy rreshta 100 shqiptarë të zënë robër dhe i ka qëlluar me mitraloza. Me atë rast, gjenerali ka deklaruar se do të çrrënjoste të tërën farën shqiptare, megjithëse kishin protestuar austriakët. Në mes të Kumanovës dhe Shkupit ishin ekzekutuar 2000 dhe afër Prishtinës 5000 shqiptarë. Pasi ishte pushtuar Shkupi, ishin dërguar patrulla të forta për t’i djegur fshatrat dhe për t’i vrarë të arratisurit. Thuhet se lumenjtë ishin përplot me kufoma. Filluan kontrollimet shtëpi më shtëpi dhe aty ku gjendeshin armë, vriteshin pamëshirshëm pronarët. Ky nuk ishte dënim, po luftë për shfarsoje, po qe se informacionet janë të vërteta”. Dhunë nuk ushtrohej vetëm ndaj shqiptarëve. Prosjaska, konsuli austriak në Mitrovicë, mbahej në arrest dhe i ishte nënshtruar dhunës. Ai, megjithatë, kishte arritur të arratisëj. Kjo ngjarje e rrezikonte Serbinë me reprezalie nga ana e Austrisë. Korrespondenti i gazetës “Rajhposten” rrëfen për pushtimin e qytetit të Prizrenit në Kosovë:

”Ishte sikur sulje e një ushtrieje të egër e të xhindosur djajsh në qytetin e pafat. Pa asfarë shkakut të dukshëm vërsuleshin ushtarët serbë kundër popullatës shqiptare dhe qëllonin me armë të gjithë ata që ndodheshin para tyre. Për më pak se dy orë u vranë 111 burra, 33 gra dhe 8 fëmijë nën moshën 12 vjeçare, ndër të cilët gjashtë fëmijë që ende nuk i kishin mbushur gjashtë vjet. Serbët qëllonin me mitralozë qytetarët nëpër rrugë. Se banorët e qytetit kishin qëlluar me armë kundër depërtimit të ushtrisë serbe është e pavërtetë, por edhe sikur të ishte kështu – kjo nuk do të arsyetonte vrasjen e grave dhe të fëmijëve”.

Nga leximi mbi mizori të tilla Anders Vestini u ndje keq. Por ai kishte dëgjuar se trupat suedeze, para dyqind e pesëdhjetë vjetëve, kishin bërë masakra me rastin e ”pacifikimit” të blekingasve⁴ dhe skonezëve. Në këtë krahasim kishte një dallim të rëndësishëm: asokohe luftohej kundër guerilëve⁵ dhe përkrahësve të tyre, por për aq sa dihet kurrë suedezët nuk kishin ndërmarrë ndonjë luftë shfarosëse. Kurse në rastin serb, gjithçka provonte për një strategji shfarosëse ndaj shqiptarëve. Një gazetë gjermane në Beograd, “Südslavische Korrespondenz”, i kishte konfirmuar mizoritë:

”Sipas burimeve të mirinformuara tashmë janë siguruar të dhëna të besueshme lidhur me harbimin që armata e gjeneral Jankoviçit bashkë me disa vullnetarë janë fajtorë. Nga këto burime konstatohet se brendia e Shqipërisë është tërësisht e shpopulluar. Një numër i madh fshatrash janë rrafshuar me tokë, kurse të gjithë fshatarët janë vrarë. Në shumë raste janë varrosur ata të gjallë, dhe akte të përgjakshme të dhunës janë bërë edhe kundër grave dhe fëmijëve. – Nga ana serbe, poashtu, kërkohet që fajtorët të dënohen”.

⁴ Banor i krahinës së Blekinges (Suedi).

⁵ Që luftonin në anën daneze kundër pushtimit suedez të Skones.

Lëvizja për pavarësi të shqiptarët

Lëvizja kombëtare shqiptare kishte filluar afërsisht në kohën e Kongresit të Berlinit më 1878, atëherë kur shihej qartë se Perandoria Osmane ishte në rënie e sipër dhe se shtetet fqinje kishin një qëllim të përbashkët: të ndanin ndërmjet vete trojet shqiptare. Para fillimit të Kongresit u mblodhën përfaqësuesit e të gjitha trevave shqiptare në qytetin e Prizrenit, në Kosovë, dhe krijuan një bashkim për shpëtimin e atdheut, të quajtur Lidhja e Prizrenit. Në udhëheqje të Lidhjes ishte Abdyl Frashëri, që i përkiste një familjeje të njohur atdhetare nga jugu i Shqipërisë. Qëllimi ishte bashkimi i të gjitha pjesëve të kombit shqiptar. Lidhja që jetëshkurtër, por do të kishte një rëndësi vendimtare për vetëdijësimin e përkatësisë së shqiptarëve.

E veçanta e kësaj lëvizjeje shqiptare ishte se ajo qëndronte mbi interesat fetare. Shqiptarët ishin të ndarë në tre fe: në veri katolikët romakë, në jug ortodoksët dhe në tërë vendin, por të përqëndruar në Shqipërinë e mesme, ishin muslimanët. Që në kohën e Kongresit të Berlinit, Vaso Pasha, një guvernator i besueshëm osman dhe njëkohësisht patriot shqiptar, e kishte formuluar mendimin bazë në poemën “Moj Shqipëri, e mjera Shqipëri!”: ”Dhe mos shikoni kisha e xhamia, se feja e shqiptarit është shqiptaria”. Me fjalë të tjera: në radhë të parë ti je shqiptar, e më pas i krishterë apo musliman.

Aleanca Ballkanike kishte vendosur të shpërbënte Shqipërinë. Armatat e tyre kishin pushtuar pjesët më të mëdha të vendit – të cilat përmenden edhe me qëllimet shfarosëse të popullatës – dhe gjendja ishte tepër e pashpresë. Më 28 nëntor 1912, delegatët nga e tërë Shqipëria – për aq sa ata mund të arrinin, u bashkuan në qytetin e Vlorës, në bregdetin shqiptar të jugut, në një Kuvend Nacional, dhe po atë ditë, e shpallën Shqipërinë shtet të lirë, sovran dhe të pavarur. Burrë shteti i vjetër Ismail Qemal beu, në ballkonin e shtëpisë së bashkisë e kishte ngritur flamurin shqiptar, që ishte qëndisur nga një vlonjate, Marigona. Ishte shqipja e heroit kombëtar Skënderbeu: një shqiponjë e dykrenare me ngjyrë të zezë në sfond të kuq.

Përkrahja për krijimin e këtij shteti të ri mungoi nga ana e Fuqive të Mëdha. Më së largti që arriti të depërtojë kjo krijesë e re, ishte përmendja e saj si çështje kurioze në shtypin evropian. E në ndërkohë, ushtritë e shteteve fqinje vazhdonin vërshimin në trevat shqiptare.

Jalmar Branting dhe fiset shqiptare

Anders Vestini e kishte ndjekur Jalmar Brantingun, që ishte kryeredaktor i të përditshmes Socialdemokraten, dhe poashtu atë çka kishte raportuar ai nga Kongresi i IX i Internacionales së Dytë Socialiste mbajtur në Bazel (Zvicër). Për këtë kishte shkruar ai në gazetën e tij më 29 nëntor, ku shprehej qartë se socialistët konsideronin se një luftë botërore do të ndodhte, një luftë me të cilën Fuqitë e Mëdha do të përpiqeshin ta rishpërndajnë sundimin mbi pasuritë botërore dhe të plaçkisnin sa më shumë në kurriz të popujve dhe të shteteve më të dobëta. Socialistët ishin unik në atë se ata kurrë nuk do të merrnin pjesë në një luftë të tillë kundër interesave të vërteta të popujve. Kjo shprehej qartë nga manifesti i Kongresit në Bazel.

Më 4 dhjetor u botua një artikull i ri e i rëndësishëm, një analizë nga Jalmar Brantingu. Anders Vestini e lexoi, mendoi rreth tij dhe u bë gjithnjë e më dyshues. Edhe babai i tij kishte theksuar se po që se kapitalistët do të donin t’i zgjidhnin kundërthëniet e tyre me ndihmën e luftës, atëherë ishte e rëndësishme që socialistët të bashkoheshin me masat proletare në një qëndresë aktive kundër një lufteje të tillë. Bie fjala, nuk do të mundte askush t’i mashtronte punëtorët francezë se gjoja gjermanët ishin armiq të tyre, kundër të cilëve ata do të duhej të luftonin e vice versa. Ndërkaq, këtu shkruante

Jalmar Brantingu diçka që ishte krejt kundër interesave të popujve të Ballkanit, pasi që fjalët e tij i ngatërronin kartat:

”Se konfliktet lokale në Ballkan, edhe kur ato ishin të llojit më të ulët, do të mundnin në mënyrën më të mprehtë ta sillnin gjendjen deri aty sa popujt më të fuqishëm të Evropës do të mund të dërgonin ushtritë milionëshe dhe flotat-luftanija të tyre kundër njëri-tjetrit, se fuqitë më të mira të vendeve me civilizimin më të lartë do të shkretëroheshin për shkak të kundërthënive të ndryshme që kishin ata rreth daljes serbe në bregdet, ose mbi masën e pavarësisë së fiseve shqiptare!”

Andersi arriti në përfundimin se teksti i Jalmar Brantingut nuk ishte ndonjë rasti fatkeqësie në punë, por se ai faktikisht nuk iu qe përmbajtur vlerave socialiste, të cilat i kishte ngritur në qiell pas Kongresit të Bazelit. Mbase babai i Andersit, i cili përmes punës në gazetë e njihte mirë Jalmar Brantingun, do të mund të sqaronte diç? Kur u kthye të njëjtën pasdite nga shkolla në shtëpi, Andersi e pyeti babain, nëse kishte kohë të diskutonte artikullin e botuar në Socialdemokraten. Paksa i befasuar i pranoi Gustav Vestin shfrimet politike të të birit.

- Baba, a mund të besohet se Jalmar Brantingu është socialist?
- Absolutisht, e tërë vepra e tij dëshmon se ai jo vetëm që është socialist, por është socialisti më i dalluar në Suedi dhe një ndër më të shquarit në Evropë.
- Më fal, im at, nuk më pëlqen të të kundërshtoj, por unë kam dyshime të mëdha në të, pasi lexova atë që ai kishte shkruar sot në gazetë. A e ke lexuar artikullin?
- Posi, por nuk kam pasur kohë që ta analizoj. Çka ke kundër, apo çka po mendon?
- E po, kohëve të fundit unë kam lexuar krejt çka kam mundur për shqiptarët dhe problemin e tyre kombëtar. Është e qartë se ata i kanë shumicën kundër tyre. Ata janë të ndarë në fise, secili me fushat e tyre dhe me malet e larta në mes, turqit i kanë shtypur egërsisht si hakmarrje për kundërvënien e tyre në shekullin XV, për çka ata kanë ngelur pas krahasuar me popujt tjerë të Ballkanit. Por nuk ka asfarë dyshimi se ata duan të kenë lirinë e tyre, ata kanë të drejtë në pavarësinë e vendit të tyre, në zhvillimin e kulturës së tyre. Gjuha e kultura e tyre janë krejt të ndryshme prej atyre të popujve fqinjë. Dhe poashtu nuk ka asfarë dyshimi se serbët po marshojnë si vrasës brutalë në trevat shqiptare për t'i nënshtruar ata njëherë e përgjithmonë. Shqiptarët kërcënohen poashtu nga malazetët dhe grekët. Kjo është një çështje që socialistët do të duhej ta mbështesnin, se është çështje e ekzistencës së një populli të tërë. Apo jo, im at?
- Sigurisht, unë nuk di shumë për shqiptarët, por ajo që ti thua me siguri se është e drejtë.
- Pikërisht për këtë dëshpërohem në Jalmar Brantingun. Ja, shihe se çka shkruan këtu! Ai sikur e ndanë popullin e Evropës në shumë të mirë, në vende me civilizimin më të lartë, dhe të tjerët si të tillë që kanë më pak vlerë. Kuptimi i asaj që ai shkruan është se edhe nëse shqiptarët e fitojnë vetëqeverisjen, kjo është një çështje tejet e parëndësishme dhe e dorës së dytë. Ai mendon se duhet pranuar se serbët mund të shkretërojnë ashtu sikurse ata duan dhe të pushtojnë limanet shqiptare, sepse pikërisht limanet në Shqipëri janë ato që serbët duan t'i kenë. Ai, poashtu, vë shenjën e barazimit midis Fuqive të Mëdha të Evropës dhe interesave të popujve përkatës, dhe ai mendon se popujt e më të fuqishmëve do të duhej të kishin kujdes e të mos shkretëroheshin mesvete për këto çështje krejt të parëndësishme në Ballkan.
- Jo, ndal, këtu nuk mund të pajtohem me ty, sepse tash po e tepron, thirri me zë të lartë babai i Andersit. Ti po e lexon Brantingun gati siç e lexon Dreqi Biblen. Ai mendon se vetëm popujt më të civilizuar, përmes nivelit të tyre të zhvillimit, kanë një përgjegjësi të veçantë dhe se ne duhet t'i dallojmë çështjet kryesore prej konflikteve lokale.

- Po, baba, por ai i vë shenjën e barazisë mes interesave të pushtetarëve dhe të popujve?

- Mbase duket kështu, por mos kërko ti tash që në çdo rast kur ai do të dërgojë tekstet për botim, që ato të kenë të bëjnë me çështjet klasore apo çështjet nacionale e kështu me radhë! Ai donte të theksonte nevojën për mbrojtjen e paqes!

- Ndoshta, por unë, fatkeqësisht, më duhet të qëndroj në mendimin se Brantingu i flakë shqiptarët sepse ata nuk janë aq të civilizuar dhe unë, poashtu, e shoh në ato që ai shkruan mendimin e tij se çështjet mbi Ballkanin janë më me pak vlerë se sa, për shembull, të tilla që i përkasin vendeve nordike, ose Gjermanisë ose Francës.

- Nuk mendoj se ti ke të drejtë, megjithëse ka diçka në atë që thua ti. Që nesër në mëngjes do ta ngris këtë çështje me Jalmarin. Atë që paska shkruar ai nuk paska qenë e suksesshme.

Andersi e përjetoi si një gjysmë fitore faktin që i ati u dakordua se teksti i Brantingut ishte i dyshimtë. Por pas ca ditësh, meqë babai nuk e zuri fare në gojë më bashkëbisedimin e tyre, e kuptoi se ajo bisedë që ai duhej ta bënte me Brantingun nuk kishte ndodhur ose edhe se nuk kishte dhënë asfarë rezultati, në mënyrë që i ati do të donte t'ia përcillte atij. Dhe Andersi nuk e shihte të udhës që ta bezdiste të atin me pyetje të tjera. Me nënën Andersi ishte mjaft joformal, por me babain ishte ndryshe: origjina e tij borgjeze dhe raporti me socializmin ishin fakte që mund ta bënin të ndjeshme bisedën e lirë të Andersit. Ai e vërente se kishte kundërthënie në udhëheqjen socialiste dhe se babai, për shkaqe taktike, duhej të ndiqte një disiplinë që as vetë nuk e pëlqente.

Kaq sa i përket kësaj, porse mendimi i Andersit për Jalmar Brantingun si një socialist i mirë kishte marrë një goditje të fuqishme. Ai artikull dhe vlerësimi mbi "fisët shqiptare" do të kishte rëndësi për qëndrimin e Andersit në të ardhmen.

Një libër shumë i çmuar

Një vit më pas, kur kishte mbaruar lufta ballkanike, përmes mikeshës së vet bibliotekare, Anders Vestini mori vesh për një libër të sapobotuar, që dukej të ishte një minierë ari për të kuptuar lojërat mbi popujt dhe trevat e Ballkanit. Libri quhej *Kriget om Balkan* (Lufta për Ballkanin), shkruar nga Valdemar Langlet dhe Ivan T. Aminof. Veçanërisht interesante ishte ajo që autorët thoshin për çështjen shqiptare. Këtu shqiptarët përshkruheshin si të shkapërderdhur dhe pa unitet, me tre fe, me prapambetje sociale dhe kulturore. Mirëpo si individë, sipas autorëve, ata janë të ndershëm dhe modestë, dhe mbi të gjitha sidomos mikpritës. Mikpritja e tyre jeton edhe në ditët tona më fuqishëm se në asnjë vend tjetër. Gjakmarrja është një doke tjetër karakteristike e shqiptarëve, si te malazetët dhe korzikanët; mirëpo te shqiptarët gjakmarrja kishte një kufizim të hekurt: po qe se armiku kërkon mbrojtje në emër të mikpritjes, ai mundet në mënyrë krejt të sigurt të flejë në shtëpinë e armikut. Ligjet e mikpritjes qëndronin faktikisht mbi ato të gjakmarrjes, dhe ai që i shkel ato konsiderohet si kriminel dhe mund të vritej nga kushdo!

Këto të dhëna korrespondojnë me të tjera përshkrime serioze dhe Andersi e kuptoi se ato ishin mjaft të besueshme. Më interesantja, ndërkaq, ishte të shihej se çka *Lufta për Ballkanin* kishte për të thënë mbi pikëpamjet e fuqive lidhur me çështjen shqiptare.

Shkrimtarët paraqisnin në mënyrë elementare dhe në hollësi gjendjen e gjërave. Ata theksonin se, edhe pse ndjenja kombëtare e shqiptarëve është e zhvilluar dobët, megjithatë, shqiptarët pa fije dyshimi, janë një popull dhe një komb. Po qe se serbët, bullgarët dhe grekët donin të vinin kufijtë e vendeve sipas kufijve të shtrirjes së popujve, atëherë shqiptarët nuk do të mund të ndaheshin, për hir të mirësisë, midis fqinjve të uritur, po do të duhej që edhe ata të shprehnin kërkesat e tyre për kufijtë e vet

nacional. Pikëpamje të tilla ishin paraqitur nga lideri shqiptar Ismail Qemal Beu, si edhe në dokumentet e Fuqive të Mëdha.

Por kjo nuk ishte më qenësorja, theksonte Langlet-Aminof. Faktori vendimtar ishte në politikën e Fuqive të Mëdha. Ishin dy shtete, të cilat i kundërviheshin kërkesës që Shqipëria t'u ndahej fqinjve. Njëra ishte Italia, e cila absolutisht nuk mund të toleronte që limani i rëndësishëm i Vlorës të binte në duart e Greqisë ose të ndonjë fuqie tjetër të huaj. Shteti tjetër që ishte kundër ndarjes së Shqipërisë ishte Austro-Hungaria, kundërshtimi i të cilës drejtohej, para se gjithash, kundër Serbisë. Ishte fjala për ta ndalë Serbinë që të merrte një liman në detin Adriatik, që do të ishte një dritare e Serbisë ndaj Evropës. Limani që serbët e synonin ishte Durazzo (serbisht: Draç, shqip: Durrës). Më 29 nëntor 1912, gjeneral Jankoviçi e mori vërtetë këtë qytet, që solli komplikime të fuqishme politike. Por, ky fakt, mu si për Brantingun në Suedi, edhe për liderët e Evropës konsiderohej se nuk ishte diçka që ia vlente shumë për t'u ngacmuar, sa kjo të rrezikonte paqën e tërë botës. Kështu, bie fjala, shkruante gazeta angleze Times, se do të ishte krejt qesharake po qe se lufta botërore do të shpërthente për shkak të një limani të varfër shqiptar.

Në të vërtetë puna ishte më e komplikuar se sa dukej: zemërimi midis Austrisë dhe Serbisë ishte një fakt i mprehtë. Dhe pas Serbisë qëndronte Rusia. Tensioni rritej tërë kohën, pasuar nga mobilizimet, por pas konferencave të shpeshta ishte e qartë se aleanca tripalëshe Gjermani-Austri-Itali nuk do të lëshonte pe dhe se Serbisë kurrë nuk do t'i njihej limani i lakmuar. Dhe meqë Franca dhe Anglia nuk ishin të gatshme të flijonin asgjë për shkak të përkrahjes ndaj Serbisë, çështja u vendos. Është fakt se gjendja ishte në prag të shpërthimit të një lufte botërore.

Kështu, çështja e shtetit të saposhpallur u vu në rend të ditës lidhur me kufijtë e Shqipërisë dhe mënyrën e qeverisjes në të ardhmen. Kur libri u shkrua nuk diheshin ende hollësitë nga autorët. Ata shkruajnë edhe lidhur me negociatat në kuadër të Konferencës së Ambasadorëve në Londër më 1913 dhe në Konferencën pasuese të Paqes.

Shqiptarët kërkonin të mos ndryshoheshin kufijtë në drejtim të Malit të Zi dhe të Greqisë, kurse serbët donin ta kishin Manastirin, Shkupin dhe Prishtinën.

Malazezët kërkonin Shkodrën, Pejën dhe Prizrenin dhe tërë pjesën veriore.

Serbët i mbështesnin kërkesat e malazezve, përveç asaj se ata vetë donin ta kishin Gjakovën dhe Prizrenin.

E tëra, megjithatë, u vendos në lojën midis Austrisë dhe Rusisë: Rusia ishte e gatshme të lejonte Shqipërinë të merrte Shkodrën, me kusht që Austria të lëshonte Pejën dhe Prizrenin. Pas kompromisit, mbeti çështja e Gjakovës, dhe paqja botërore u var për disa ditë nga fakti nëse ky qytet i vogël malor do t'i takonte Shqipërisë apo Serbisë. Më në fund, Rusia fitoi Gjakovën në llogari të Serbisë me garancionet se Malit të Zi në kurrfarë shtate nuk do t'i lejohej Shkodra.

Ajo çka Andersi nuk mund ta dinte ishte se vendimi i marsit të vitit 1913 do të vlente deri në kohën sa ky libër do të botohej (qershor 2004), me përjashtim të disa viteve gjatë luftës, një parantezë kur Shqipëria etnike u krijua nga Fuqitë e Boshtit. Ai vendim i para 85 vjetëve hedh hijet e veta në konfliktin e viteve 1998-1999 në Kosovë. Një gjë tashmë dihet: një shtëpi që ngrihet mbi një themel të brishtë nuk mundet kurrë të bëhet një ndërtesë e mirë! Por këtë fakt nuk duan ta pranojnë as politikanët e tashëm evropianë...

VUAJTJET E SHQIPTARËVE

Himnizonin poetët zanat dhe shtojzovallet,
Por ato qëronin morra ndanë ujërave,
Zanave, shtojzovalleve u dilnin kokallat,
Shtriheshin për lekë prapa shkurreve.

Kështu e përshkruan Ismail Kadareja në poemën e tij “*Përse mendohen këto male?*” mjerimin moral, ekonomik e social që mbretëronte në hapësirën malore të Shqipërisë veriore në kohën e mbretit Zog. Prostitucioni ishte bërë realitet, për shkak të numrit të madh të popullatës dhe kushteve mjeruese të ekzistencës lart në male; gratë, të cilat në të vërtetë do të duhej të merreshin me shitjen e prodhimeve të fshatrave, u shtrënguan të zgjedhin midis vdekjes nga uria ose poshtërimin të tyre. Ato duheshin me çdo kusht të ktheheshin në shtëpi me para pas udhëtimeve të tyre deri në qytete – dhe ç’mund të bënin ato? Edhe një shkrimtar i hershëm shqiptar, Migjeni (emri letrar i Millosh Gjergj Nikollës) e ka prekur këtë problematikë në tregimin e tij “*A do qymyr zotni?*”.

Me këtë tematikë kam shkruar një skicë, ku një vajzë nga një fshat malor takon një ushtar austriak. Lexuesi mundet ta hetojë se tregimi ka si pikënisje problemin e lartpërmendur, ndërsa përfundon në diçka tjetër.

Vuajtja mund të përbëhet nga një luftë të jetesës me privime dhe vështirësi që, me gjithë përpjekjet e jashtëzakonshme të personave, përfundon me asgjësim personal.

Kjo pasqyrohet në jetën e Isa Boletinit dhe në luftën e tij të fundit.

Kënga “Përtej urës së Qabesë” (“Mbeçë, more shokë, mbeçë!”) është një baladë e vjetër nga Shqipëria e Jugut. Rrethanat rreth krijimit të kësaj kënge bazohen në realitetin e hidhur, kur shqiptarët gjatë shekujve XVIII-XIX rekrutoheshin me dhunë në armatën osmane. Por atë kornizë që unë ia kam dhënë këngës, natyrisht, është vetëm fiktive. Dhe së fundi Kënga e Rexhës, që përshkruan fatkeqësinë absolute: mbytjen me shqelm nga kali i vet në ditën e martesës, kjo në rrethanat suedeze do të mund të ishte një këngë e thjeshtë popullore. Por tematika melodramatike interpretohet në këngë me dinjitet, me një melodi pikëlluese. Dhe, ashtu sikurse një shkrimtar nga Shqipëria ishte shprehur: Kjo këngë e shprehë atë fat që i ka goditur dhe vazhdon t’i godasë shqiptarët e Kosovës – sapo shpresa për liri të jetë rritur, në çastin kur agu i ditës nis, gjithçka përfundon në tragjedi.

Fytyra e vuajtjes karakterizohet nga diçka që duket si fat i verbër. Por çdo njëri e kupton se sikur të ishin kushte dhe rrethana të tjera edhe fati do të ishte më ndryshe. Tregimet dhe këngët që do të prezantohen në këtë kapitull përfundojnë me vdekje të shpejta e të këqija. E si gjithmonë, kur është fjala për përshkrimet e vjetra shqiptare, fati i individit është vetëm një pasqyrim i fatit të përgjithshëm. Kjo tragjikë rrëfëhet në mënyrë patetike, porse ajo që ndodh është në lidhje direkte me realitetin shoqëror.

Luftë e ashpër dhe fund i ashpër: Isa Boletini

Gjendja në Podgoricë, ky qytet i vogël në Mal të Zi, ishte shumë e tmerrshme në ditët e dimrit të 1916. Buzë qytetit, në fushim, ndodhej ushtria serbe e cila e detyronte popullatën në qytet të dorëzonin gjithë ushqimin që e kishin për ushtarët që vdisnin urie. Çdo ditë vdisnin njerëz nga uria dhe kolera, dhe aq i shumtë u bë ky numër i të vdekurve, sa më askush nuk mund të kujdesej për ata që kishin ngelur nëpër rrugë.

Në këtë gjendje, austriakët arritën të depërtojnë, ndërsa serbët u tërhoqën në drejtim të Shkodrës. Gjithkrah plaçkitje dhe një humbje totale e disiplinës. Oficerët serbë, që u përpoqën të ruajnë komandën mbi ushtarët, u mbytën. Edhe ushtarët malazezë ishin të

demoralizuar dhe rrëmbenin gjithçka që mund të përdorej e të merrej me vete. Më së shumti e pësoi pjesa muslimane e popullatës, domethënë turqit dhe shqiptarët.

Kur erdhën lajmet se austriakët ishin rrugës duke hyrë në Podgoricë, luftëtari i lirisë Isa Boletini e dërgoi djalin e tij dhe djalin e vëllait të tij si ndërmjetësues te komandanti austriak që të vihej nën mbrojtjen e tij. Isai, së bashku me djemtë Halilin dhe Zahidin dhe me djemtë e vëllait Jonuzin dhe Halitin, ndodhej në Podgoricë me lejen e mbretit malazez Nikita. Isai u frikësohej grupeve ushtarake malazeze që kishin braktisur disiplinën po në atë masë sa respektonte austriakët, që, përveç tjerash, ishin miq të shqiptarëve.

Befas dëgjon Isa Boletini një zhurmë përjashta shtëpisë dhe kupton sakaq se të afërmit e tij ishin në rrezik, e merr revolverin dhe hidhet për t'i mbrojtur ata.

Ushtarët malazezë, që kishin kërkuar që shqiptarët t'ua dorëzonin armët, hidhen në grup ndaj Isait dhe të afërmeve të tij. Shqiptarët të tjerë i vijnë Isait në ndihmë. Të gjithë janë të armatosur. Ushtarët malazezë synojnë së pari ta godasin Isain. Një plumb revoleje e godet atë dhe ia shqyen barkun. Ai bie në gjunjë, por nuk e lëshon armën. Krejt i qetë në dukje e zbrazë tytën e revolverit mbi turmën e ushtarëve. Edhe plumba të tjerë e godasin Isain, por rretheqark tij ndodhen të afërmit dhe miqtë, që të gjithë duke luftuar për jetë a vdekje. Përskaj Isait bie së pari njëri djalë i tij, pastaj njëri djalë i vëllait, edhe pesë shqiptarë të tjerë. Vetë Isai goditet edhe nga një plumb në ballë dhe plandoset i vdekur.

Në vendin e ngjarjes, skaj një ure në Podgoricë, qëndrojnë katërmbëdhjetë të vdekur – gjashtë malazezë dhe tetë shqiptarë.

Pikërisht në çastin kur kjo luftë përfundon, ia behin austriakët, që pengojnë një masakër të përgjithshme ndaj shqiptarëve dhe muslimanëve të tjerë në qytet.

Fjalët e thëna në varrin e Isa Boletinit

Së bashku me një hoxhë, klerik musliman, dhe disa shqiptarë të tjerë, korrespondenti suedez i luftës Nils Lago – Lengkvist e viziton atë varrezë muslimane disa javë pas ngjarjes. Aty sheh tetë varret e freskëta dhe dëgjon rrëfimet e bashkëvendësve të Isa Boletinit, rrëfimet mbi luftëtarin e madh të lirisë.

Isai arriti moshën 52-vjeçare, por u bë legjendë në popullin e tij. Ishte lindur në një fshat të vogël në periferi të qytetit kosovar Mitrovica, dhe tërë jeta e tij do të mbushet përplot me luftëra dhe përpjekje të tjera për të siguruar ardhmërinë e shqiptarëve.

Që në moshën 17-vjeçare mori pjesë në luftimet kundër turqve, si pjesëmarrës i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, e cila luftonte për lirinë e shqiptarëve. Në prag të ndërrimit të shekujve ishte në krye të qëndresës së Kosovës kundër intrigave dhe përpjekjeve për aneksimin e Shqipërisë nga ana e Serbisë, Malit të Zi dhe e Rusisë. Isa Boletini vazhdoi të ishte prijës i kryengritjes gjatë viteve 1908-1912. Ishte në Vlorë më 1912, së bashku me Ismail Bej Vlorën, kur u proklamua pavarësia e Shqipërisë. Bashkë me Ismail Qemalin ai udhëtoi në Londër më 1913 për të protestuar kundër vendimit të Fuqive të Mëdha për ndarjen e trojeve shqiptare. Pastaj kthehet në Kosovë dhe organizon qëndresën kundër sulmeve të reja serbo-malazeze. Tërë jetën e pati të mbushur me luftime dhe motoja e tij ishte: “Unë jam mirë kur Shqipëria është mirë”.

Kur mysafiri suedez po dëgjonte rrëfimet mbi Isa Boletinin të gjithë heshtnin. Pastaj hoxha kishte pëshpëritur nëpër dhëmbë disa fjalë, të cilat gazetarit ia kishte përkthyer komandanti turk: “Fati i njerëzve është si thërmiat fluturuese të pluhurit. Mbi jetën e vdekjen sundon zoti i plotfuqishëm. Atij i qoftë lavdi i përjetshëm!...”

Dashuria e pamundshme: Lule Pal Marku

Lulja, si përherë, kishte shkuar te pusi në mes të fshatit për të marrë ujë. Ky ishte angazhimi i saj i përditshëm, me përjashtim të rasteve kur ajo shkonte në Shkodër për të shitur mallra në treg ose nëpër rrugë. Lulja i kishte pesë vëllezër, të gjithë më të rinjë se ajo, por nuk kishte asnjë motër. Së bashku me të ëmën, dërrmohej për t'ia dalë në krye krejt asaj pune që kërkonte familja, në fushë ose në shitje të prodhimeve të pakta që bujqësia e tyre jepte. Më së shpeshti ky mall ishte duhan ose dru që ajo shpinte në qytet, i cili shtrihej rreth pesëmbëdhjetë kilometra nga fshati Mazrekë. Kjo ishte një rrugë e rëndë dhe e mundimshme, sa nëpër dhiaret gjarpërore të maleve, sa nëpër tokën moçalore përgjatë Drinit.

Vajzat rrinin në një rreth afër pusit dhe bisedonin lidhur me shqetësimet që sillte shitja në Shkodër. Disa prej tyre dukeshin sikur nuk pajtoheshim me diçka që ato e dinin, porse të gjithat ishin të një mendjeje se tash ishte më vështirë për shitjen e mallrave krahasuar me gjendjen e paraluftës, kur banorët e qytetit ishin në gjendje të mirë dhe kishin mjaft para. Shumë nga ta kishin vuajtur tej mase dhe kishin humbur kushtet e mira të jetesës si pasojë e zhvillimeve të luftës. Tash e vetmja mundësi i kishte ngelur shitja e mallrave të ushtarët austriakë, të cilët ishin më të interesuar për duhan dhe duhani ishte pikërisht ajo që më së shumti kultivohej në fshatin Mazrekë. Lulja e kishte një xhaxha, i cili kishte hapur një punëtori lëkurësh në Shkodër dhe blente të gjitha lëkurat me të cilat fshati mund ta furnizonte.

Kur Lulja me shtambën e vet kishte ecur disa hapa drejt rrugës për në shtëpi atë e arriti njëra nga vajzat tjera. Shkurte quhej ajo, dhe ishte e njohur si dinake dhe llafazane, prandaj Lules nuk i pëlqente.

Shkurtja ia vuri dorën miqësisht në belin e Lules dhe i tha me gjysmë zëri: - Ka mundësi të mira për të fituar para, vetëm se duhet ditur vepruar. Shko te Mara, te ajo magjupja e vjetër, dhe ajo të tregon se si duhet vepruar.

Lulja nuk arriti as të pyeste gjë e as të kundërshtonte, sepse sa çil e mbyll sytë Shkurtja iku. E çka donte të thoshte ajo? Lules iu kujtua se vazhdimisht merrte flakaresha nga i ati, sa herë që kthehej në shtëpi pa shitur gjë. Në një farë mënyre ajo e kuptonte të atin, sepse, pa para, uria trokiste në derë. Misri dhe gruri nuk bëheshin aq mirë në arat e babait, e ai, ndërkaq, ishte i orientuar në kultivimin e duhanit njëllor sikurse kishte bërë i ati dhe gjyshi para tij. Ata duhej të siguronin edhe ushqim, edhe krip e edhe gjëra të tjera të domosdoshme e këto mund të bleheshin vetëm me para.

Do të shkoj një ditë e të flasë me Marën, mendoi Lulja, dhe rasti i erdhi shpejt, sepse ditën e nesërme mbeti e vetme, nga që babai dhe vëllezërit shkuan për gjah e nëna shkoi në vizitë te e motra në fshatin fqinj, dhe kështu mund ta shfrytëzonte kohën si të donte.

Mara ishte një plakë e vogël dhe e zezë, me sy të zjarrtë. E qerasi Lulen me një pije freskuese dhe e pyeti më pas se ç'hall kishte.

Kur Mara dëgjoi se çka ishte folur tek pusi u nënqesh paksa dhe filloi më pas një monolog, të cilin Lulja në fillim e kishte të vështirë për ta kuptuar, por nuk vonoi e gjithçka iu bë tërësisht e qartë.

- Flitet për gra, për nder e turp, filloi Mara. – Gruaja e ka nderin e vet nën rrobe, në flokë dhe në sy. Burri e ka nderin e vet në fjalën e tij dhe në dyfek. Po cili burrë, vallë, mundet ta ruajë nderin e vet po qe se mashtrohet ose e humb armën e vet? Dhe cila grua mund ta ruajë nderin e vet, po qe se kërkohet prej saj që ajo të fitojë para nga qyteti, ndërkohë që askush nuk dëshiron t'i blejë mallrat e saj? Atëherë asaj i mbetet vetëm një mall që mundet t'i sigurojë të ardhura: trupi i vet. Ti ke një trup të bukur dhe një fytyrë të hijshme, Lule. Kur një burrë nuk dëshiron t'i blejë mallrat tua, ai do të donte ta kishte trupin tënd. Ky është turp, thuhet. Kurse unë them të kundërtën, se turp më i

madh është të jesh e uritur, përderisa të tjerët i kanë të gjitha të mirat. Sepse të pasurit nuk turpërohen pse janë të pasur, ani se të tjerët vdesin urie.

- Kuptohet se duhet të jesh shumë e kujdesshme. Më e mira do të ishte po të gjeje ndonjë ushtar, i cili do të të pëlqente dhe tek i cili do të mund të shkoje sa herë që të kishe nevojë. Ai mbase nuk ka aq shumë para, por janë para të sigurta. Ti, mbaje mend, ti duhet të kesh kujdes, shumë kujdes: të mos shkojë puna asisoj sa të fillojë të të rritet barku. Që të mos ngjajë kjo duhet të veprosh kështu: kur t'i kesh të përmuajshmet do të numërosh shtatë ditë pas përfundimit të tyre, dhe vetëm atëherë mund të biesh në shtrat me ndonjë burrë. Pastaj nuk duhet të lësh asnjë burrë të të prekë para se të kenë kaluar më së pakut edhe dymbëdhjetë ditë, kur sërish mund t'i pranosh burrat deri te periudha tjetër e përmuajshme. Po qe se ata pajtohen mund të të marrin ty edhe në ditët e kuqe, por shumica syresh nuk duan.

Lulja mori një frymëmarrje të thellë. Diçka të tillë ajo nuk kishte menduar kurrë ndonjëherë. Ishte skuqur e tëra tek sa po dëgjonte Marën.

- Mbase mendon se kjo që po them unë është e turpshme, kurse ajo që është e turpshme në të vërtetë është ajo se dikush ka aq shumë para e pasuri, e të tjerët asgjë fare. Duhet të harrosh turpin. Ke lindur lakuriq, dhe po qe se do të ishim si kafshët, do të ishim tërë kohën lakuriq. Që ta joshësh një burrë, me të cilin nuk mund të flasësh, duhet t'ia bësh të qartë se çfarë do ti. Do ta lejosh të shoh krejt çka ai dëshiron të shohë, do t'ia tregosh organin tënd femëror, aq sa atij t'i shkoqën sytë duke shikuar. Çdo burrë normal bëhet si i marrë kur të shoh tërë atë bukuri që ndodhet nën rrobat e një gruaje të re. Vetëm tregoji atij se çka ke, dhe ai pastaj është i yti për një çast. Por kujdesu t'i marrësh paratë para se ai të fillojë me ty.

Lulja kurrë ndonjëherë nuk kishte dëgjuar të flitej për diçka të ngjashme, për të cilën gjë i kishte folur Mara. Ajo e dinte se kishte të tilla, që populli i quante "gra të përdala", dhe të tilla quheshin ato, për të cilat burrat ishin vrarë, ngase e kishin prishur nderin e familjes. E ndjente se kishte diçka të sëmurë dhe krejt të gabuar në atë që Mara i kishte thënë, ani se ajo fliste aq bindshëm; e prapë se prapë Lulja ndjehej çuditërisht e joshur nga fjalët e saj. Ishte e re dhe asnjë burrë as që e kishte prekur ndonjëherë. Kishte filluar të ndjente një mall të paqartë pas diçkaje, që ajo s'e kuptonte. Në këtë gjendje në të cilën ishte, Lulja u ngacmua çuditërisht nga fjala e Marës. Si e paralizuar, por me shqisa krejt të tendosura, dëgjonte ato mësimë lidhur me marrëdhëniet intime me burrin, që Mara ia kishte dhënë asaj pasdite.

Lulja takon Aloisin

Ishte rrugë e gjatë shkuarja nga tregu i Shkodrës deri në kampin austriak skaj malit Tarabosh. Aloisi kishte filluar të lodhej, dita ishte nxehtë, dhe ai kishte pirë bukur mirë verë në një han.

Kur po kalonte një shkurnajë pas rrugës gjarpërore befas u shfaq para tij një vajzë shqiptare. Ishte mjaft e gjatë, zeshkane, e veshur me një petk katolik fshataresh me çorapa të zeza leshi, fund të zi e jelek dhe me këmishë të bardhë. Flokët e saj ishin të prera sipas traditës aty diku nën veshë. Ishte një vajzë jashtëzakonisht e bukur, e cila vështronte pa e lakuar shikimin kah Aloisi.

Aloisit iu duk se diçka ishte e pazakontë. Deri në këtë çast asgjë nuk ia kishte ndryshuar atë pasqyrë që ia kishin dhënë lidhur me vajzat e vendit: ato ishin të paarritshme, mohuese dhe të vrazhda. Por kjo çupëz ishte ndryshe. Ajo e kapi Aloisin për krahu dhe e tërhoqi pakëz. I dha shenjë drejt shkurnajës dhe eci e para duke e kthyer kokën vazhdimisht pas për të parë nëse Aloisi po e përcillte; natyrisht, ai e ndiqte, por me ngurrim.

Në anën tjetër të zabelit kishte ca gurë të mëdhenj deri te një arë. Asnjë njeri nuk të zinte syri. Vajza u ul në një guri dhe i dha shenjë Aloisit të ulej në afërsi. Ai e çiku veten e vet dhe thirri: “Alois”. Pastaj ai e preku vajzën dhe e pyeti: Wie heisst du? Vajza e kuptoi dhe u përgjigj: “Lule”. Aloisi tundi kokën dhe tha: “Lule, das klingt recht schön”.

Vajza nxori nga thesi ca duhan. Provoi të komunikonte me shenja ashtu që ta bënte Aloisin të blente. Ai tundi kokën dhe me shenja e sqaroi se nuk e pinte duhanin.

Atëherë Lulja u ngrit. Aloisi ia nguli sytë, sepse ai e kuptoi se diçka e pazakontë do të ngjante. Vajza ngadalë filloi ta ngrinte fundin e saj dhe ajo nuk u ndal derisa e ngriti fundin mbi bel. Sipër çorapeve të zeza prej leshi, ishte lakuriqe, përveç shiritit të çorapeve që ishin të lidhura në një farë brezi rreth belit.

Kjo që po shihte Aloisi e bëri të gulçonte dhe të besonte se ishte diku në parajsë. Aq e bukur ishte Lulja, aq e pastër dhe po aq e hijshme. Me sa duket banonte në ndonjë fshat që kishte ujë të bollshëm, dhe prandaj edhe ishte lehtë të kujdesej për higjienën personale.

Krejt i hutuar nisi Aloisi të çikte trupin e Lules, dhe kur ndjeu reagimin e saj i humbi çdo fije dyshimi. Buzët e tij hapën buzët e saj dhe ai ia futi brenda gjuhën në gojë, ashtu sikurse kishte mësuar nga vajzat me përvojë në Vjenë. Lulja merrte frymë gjithnjë më shpesh, dhe sakaq filloi ta puthte Aloisin në mënyrë të njëjtë.

Me gjithë çudinë e rastit Aloisi nuk e kishte kuptuar se kjo ishte çështje e ndytë e blerjes seksuale, pasi që vajza qartë e shprehte se i pëlqente ajo që po ndodhte. Në atdhe Aloisi kishte vizituar disa herë bordelet dhe vajzat aty ishin sjellë në mënyrë aq mekanike, pa ndjenja të vërteta, sa që hetohej qartë se gjithçka kishte të bënte vetëm me shitjen e trupit për para.

Ajo që pasoi më pas qe diçka aq joreale dhe njëkohësisht reale për të dytë. Çasti i tyre i përbashkët përfundoi në një klimaks të ëmbël, që i dehu për një kohë të gjatë. U shtrinë skaj njëri-tjetrit në tokë. Aloisi i shikoi sytë e Lules tash gjysmë të mbyllur, sytë e zinj, dhe përjetoi një dashuri të ngrohtë për këtë vajzë, e cila kishte bërë diçka të padëgjuar, që në raste të zakonshme do të ishte përjetuar si amorale, por që për Aloisin ajo dhe sjellja e saj ishin si një fuqi e shëndoshë natyrore.

Kur Lulja e mori një çikë veten, iu kujtua se nuk e kishte pasur as mendimin te shkaku, që e shtynte ta bënte atë që bëri. Si t’ia bënte tash? Përmes gjuhës së shenjave u mundua t’ia sqaronte se duhej të paguhej. Duhanin mund ta merrte Aloisi dhe të bënte çfarë të donte me të. Aloisi e kuptoi. E nxori qesen dhe i dha vajzës gjithë paratë që nuk i duheshin. Vetë e pa se nuk kishte shumë para. Për Lulen ishte diçka e tmerrshme që tash duhej të kërkonte kompensim nga ai. Me lot në sy iu hodh sipër dhe nisi ta puthte me aq afsh, që të kuptonte se ajo vërtetë e pëlqente Aloisin. Fjalët e Marës ndereshin si rreckë e ndotur mbi gjithçka, dhe Lulja mudohej të çlirohej nga ndotja.

Se çka ishte dashuria, ajo në të vërtetë nuk e dinte, meqë nuk ishte pjesë përbërëse e jetës në ato fshatra shqiptare. Dashuria ishte diçka e dyshimtë, diçka e rrezikshme për njerëzit. Sigurisht se vajzat i pëshpëritnin njëra-tjetrës aty tek pushi në fshat, që ishte vendtakimi i tyre, sapo të ndodhte të kalonte andejpari ndonjë çun i pashëm. Ato ishin vetëm fantazi të vajzave të reja – realiteti ishte se babai merrej vesh me një familje tjetër për martesën e vajzës, thuaja gjithnjë përmes një mblesi, dhe meqë vajzat nuk martoheshin në fshat ato thuaja se kurrë nuk e kishin parë paraprakisht dhëndrin. Kërkesa për ruajtjen e pastërtisë së gjakut donte të thoshte se vajzat nuk mund të kërkonin bashkëshortësi brenda të njëjtit fshat. Po qe se ndonjë simpati e vërtetë dhe dashuri krijohet, kjo më tepër i ngjante një lotarie. Zakonisht burrat shqiptar i konsideronin femrat më tepër si pronë dhe gjësede të dobishme, se sa si njerëz. Vetëm kujdesi ndaj nderit të femrës mundte nganjëherë t’i bënte shqiptarët të sillëshin

njerëzishëm kundrejt grave të panjohura, ndërsa rëndom ata nuk tregonin asfare respekt ndaj tyre.

Aloisi provoi të bindte Lulen që të mbante duhanin, por ajo ia bëri të qartë se ajo nuk mund të shkonte në shtëpi me duhanin dhe me paratë. Kjo do të ngjallte dyshime ogurzeza. Më në fund Aloisi vendosi të kujdesej për duhanin, të cilin mund t'ua shiste shokëve të tij duhanxhinj – me siguri me çmim më të lirë, po kjo s'kishte rëndësi; vetëm të kishte para sa për t'ia dalë. Shqetësimi kryesor i Aloisit ishte se si do të mund të takoheshin përsëri. Ata këtë nuk mund ta bënin haptazi para të tjerëve, mirëpo një gjë ishte e qartë: Ata do të takoheshin në të njëjtin vend. Lulja mendohej me gishtërinj t'i tregonte se ajo shkonte në qytet vetëm një herë në javë. Aloisi mendonte se e kuptoi, por ai, për t'u siguruar, do të kalonte kah i njëjti vend çdo ditë kur të kishte mundësi.

Lules i dukej sikur gjithçka ishte vetëm një ëndërr. Sikur që hedhur nga një shkëmb në humnerë, por kishte rënë e pa gërvishtur në tokë. Atë njeri që e kishte takuar dukej se ishte njeri i mirë, dhe për këtë ishte krejt e sigurt. Aloisi ishte çubardhok, me sy të kaltër e paksa të lagësht. Dukej sikur jetonte në fantazinë e dikujt. Dhe kishte arsye për këtë – ajo çka kishte ndodhur ishte vërtet me tipare fantazie... Takimi me këtë njeri të huaj, atë ëndje që ai ia ngjalli, mënyra se si e trajtoi si të qe e barabartë me të – të gjitha këto e turbulluan Lulen. E vetmja gjë që ajo e dinte me siguri ishte se do ta takonte sërish. Sa më parë, sa më parë.

Herën tjetër kur Lulja shkoi në qytet, diku pas një jave, vajti menjëherë te shkurnaja, në anën tjetër të qytetit, rrugës për në Tarabosh. Priti derisa erdhi Aloisi. Sapo mbërrinë te vendi i tyre i sigurtë, Lulja iu hodh sipër dhe nisi ta puthte ashtu sikurse ai e kishte mësuar atë. Tash e dinte se ditët e rrezikshme kishin ardhur, atëherë kur mund të mbetej shtatzënë, por si ta sqaronte për këtë Aloisin? Kësaj here ia arriti edhe ta evitojë rrezikun e edhe t'ia bëjë qejfin Aloisit, sipas mësimëve të Marës për mundësinë që, përmes buzëve, gjuhës dhe duarve, të kënaqeshin që të dy. Aloisi habitej se si një vajzë, që dukej aq e re dhe e virgjër, kishte njohuri të tilla.

Kështu kaluan javë e muaj, verën e ndërroi vjeshta e vjeshtën dimri. Gjatë atyre ditëve të acarta Lulja dhe Aloisi nuk kishin mundësi të takoheshin, meqë nuk kishin ndonjë vendtakim të mbrojtur e pa u vërejtur nga të tjerët. Përveç kësaj edhe ishte e vështirë të endeshe nga fshati në qytet gjatë dimrit. Gjatë kësaj kohe Lulja rrinte kryesisht brenda dhe u qe përkushtuar punëve të shtëpisë. Aloisi ishte bërë mik me një të ri shqiptar, i cili donte të mësonte gjermanishten, dhe ata i jepnin mësimë njëri-tjetrit në gjuhët e veta amtare. Kështu që kur Aloisi e takoi sërish Lulen në pranverë, ai tashmë kishte mësuar mjaft fjalë që t'ia thoshte asaj në shqip.

Të dy e dinin se dashuria e tyre nuk kishte ndonjë të ardhme. Aloisi kishte marrë lajmin se në vjeshtë do të transferohej për një kohë në atdhe, natyrisht po qe se lufta nuk do të ndodhte që ai të binte në ferrin e vijës frontale. Edhe Lulja e kishte të qartë se një ushtar nuk rri gjatë në një vend, si dhe faktin se familja e saj kurrë nuk do ta lejonte atë të bashkohej me të. Ata kishin fe të njëjtë, mirëpo vetëm mendimi se një vajzë shqiptare e fshatit mund të bëhej nuse e një burri të huaj ishte jo natyrore, ishte marrëzi. Diçka e këtillë thjesht nuk mund të ngjante. Dy botë kaq të ndryshme nuk mund të bashkoheshin në një dyzim të tillë.

Të dy donin që jetës t'ia nxirrnin tërë ëmbëlsinë dhe ëndjen, thua se secili takim i tyre do të ishte veprimi i fundit i jetës. Kështu shkoi ajo verë e nxehtë, duke çuar gllënjka me pijen e rinisë dhe të dashurisë sa herë që ata bashkoheshin.

Ditën kur Aloisi iku nga Shkodra, për të mos u kthyer kurrë më, Lulja nuk pati mundësi t'i afrohej më. Ai ishte përshëndetur me të me fjalët: Lule, je me mua për jetë, në shpirtin tim. Sytë e Lules, të mbushur me lot, ishin si sy të një të dënuari me vdekje. Ajo kishte pasur kohën e vet të lulëzimit, tash kishte ardhur vjeshta dhe ajo do të fishkej

e nuk do të mugullonte kurrë më. Pas fishkjes, lulja që po vdiste do ta priste dimrin nën tokën e ftohtë, të zezë.

Lulja do ta bënte udhëtimin e parë gjatë këtij viti për në Shkodër. Kur mbërriti deri te vendi ku rruga malore shkonte poshtë deri te Drini, ndjeu se nuk mundte më. Shikimin e hodhi tutje tek ujët që vërsulej, ku copa akujsh vallëzonin rretheqark, shtyheshin me njëra-tjetrën dhe iknin me nxitim tutje. Iu duk vetja si një cipë e tillë akulli, e kapur nga një vërshim i keq dhe i egër që e detyronte të ikte tutje, pa pasur mundësi të ndryshonte ndonjë gjë. I mbylli sytë dhe u hodh, duke e mbajtur thesin e duhanit në përqaftim.

Një kalimtar rasti e kishte nxjerrë nga uji. Ajo jetonte ende, prandaj në shpinë mushku e kishin shpënë në shtëpi. Babai kishte menduar një herë ta dënonte, por kishte hequr dorë kur e kishte parë shikimin e saj çmendurak. E kuptoi se në të kishte ndikuar diçka shumë më e fuqishme se ai dhe fisi i tij. Kishte kërkuar një plakë të mençme, e cila kishte provuar të fliste me Lulen, por më kot. I dhanë të pinte lëng barishtesh, por ishte e pamundur të ndalej kallja e mushkërive, e as çmenduria që kishte pushtuar mendjen e vajzës.

Disa këmbëngulnin se çmenduria është dhuratë e Zotit për atë njeri, vuajtja e të cilit e bën kujtesën të padurueshme. Të tjerë mendonin se kjo është një ndodhi: çmenduria ndodh kur Djalli me gishtërinj të ndytë prekë shpirtin e njeriut. Para se Lulja të vdiste një ditë të acartë dimri, u bë krejt e qetë dhe e kthjellët. I kujtoheshin disa fjalë të një kënge, që lokja e kishte zakon t'ia këndonte: Pa fat e pa ushqim, më mirë vdekur shqim. Me këto fjalë, qetësisht e zuri gjumi për mos t'u zgjuar më.

Askush nuk do ta dinte se çka në të vërtetë kishte ngjarë, që e nxiti Lulen ta braktiste këtë jetë. Aloisi e mbijetoi luftën dhe stërmundimet e saj, dhe kaloi në jetën e zakonshme qytetare të Vjenës së pasluftës. Më vonë ai u martua, por mendimet e tij kurrë nuk e braktisën vajzën nga malet shqiptare. Fëmijët e kishin dëgjuar babain e tyre duke pëshpëritur “O Lule, o shpirt”, por kur ata e pyesnin se ç’thoshte, ai u përgjigjej se kjo ishte një fjalë e urtë popullore që e kishte mësuar në një vend të huaj gjatë luftës. Ai ishte i sigurt se po qe se do të shkonte ndonjë herë në qiell, atje do ta gjente Lulen duke e pritur. Sepse shpirti i saj ishte aq i çiltër, si dhe ujët e atij vendi malor, gjë të cilën ai e dinte fare mirë, sepse ashtu kishte qenë në realitet. Dhe në një farë mënyre e dinte Aloisi në vetvete, se Lulja tashmë ishte atje ku ai do të kishte mundësi ta takonte edhe një herë.

Mbeçë, more shokë, mbeçë!

Me vite kishte luftuar së bashku me jeniçerët gjatë marshimeve fushore dhe në aksionet spastruese në malet kurde, në Sanxhak, në shkretëtirat e Libisë. Tash ishte urdhëruar të marshonte kundër fiseve kryengritëse në Oman. Kjo ishte një mundësi që të kthehej atje, në Tepelenën e Shqipërisë së jugut, në atë vend të tij, ndaj të cilit kurrë nuk i shqitej mendja. Dhe në qiellin e vendit të tij, ishte ngritur një yll i kthjellët: Ali Pasha, ky lider i rebeluar i shqiptarëve, e kishte sfiduar sulltanin dhe e kishte marrë pushtetin në tërë regjionin e tij. Ky ishte si një kushtrim për të gjithë shqiptarët që i shërbenin sulltanit, një kushtrim për kthim dhe bashkim me Ali Pashën.

Selmani e kishte përgatitur mjaft me kujdes ikjen e tij nga jeniçerët, të cilët i kishte urryer gjatë tërë kohës. Si i rekrutuar me dhunë nuk kishte pasur ndonjë alternativë tjetër përpos të luftonte për të mirën e perandorisë osmane, e pra asnjë nga ato veprime nuk i kishte bërë me zemër.

Me armën në dorë Selmani u zvarris vjedhurazi nga ai vend, ku ishte paraparë të bënte roje gjatë natës. Zëri i një çakalli dëgjohej në largësi, përndryshe gjithçka ishte e qetë. Selmani nisi të merrte frymë më lehtë sa më tepër që largohej nga kampi. Plani

ishite ky: të shkonte deri në Mekë, ku kishte shqiptarë të cilët mund ta ndihmonin të kthehej në atdhe.

Kur agu po afrohej, Selmani e kuptoi se kishte marrë drejtim të gabuar gjatë arratisë. Ende nuk ishte ngjitur në ato male, ku do të mund të gjente ushqim dhe strehim në vazhdim të arratisë së tij. Ndodhej edhe më në shkretëtirë, dhe mund të shihej mirë edhe nga postrojet që ishin në brigjet e maleve. Pa pasur mundësi të bënte ndonjë gjë tjetër përveç se të priste, pa një turmë kalorësish jeniçerë që po afroheshin. E nuk kishte se ku të fshihej.

Ishte një gjë e lehtë për jeniçerët konstatimi se Selmani ishte një tradhtar në arratisje e sipër. Njëri nga ta e nxori një pistoletë dhe ia zbrazi tre plumba Selmanit. E lanë në shkretëtirë, ashtu të plagosur për vdekje.

Para se të vdiste Selmani e këndoi një këngë elegjike. Se si ajo kishte mbërritur deri te vendi i tij në Tepelenë, është e zorshme të dihet. Sekush thoshte se një sorrë, që ia kishte ngrënë zemrën, fluturoi deri te malet shqiptare dhe atje një njeri i ditur, i cili kuptonte gjuhën e shpezëve, e kishte dëgjuar këngën, të cilën e kishte gëlltitur sorra së bashku me zemrën. Kënga është kjo:

Mbeçë, more shokë, mbeçë!

Përtej Urës së Qabesë

Falem me shëndet nënesë;

të dy qet' e zez' t'i shesë,

t'i japë nigjan⁶ së resë.

Të më shesë kalën,

të më rrisë djalën:

të më shesë mushkën,

të më rrisë çupën.

Në pyet' nënia për mua,

i thoni që "t'u martua";

në pyet' se "ç'nuse mori",

"tre plumba prej krahërori";

në thëntë se "ç'kalë hipi",

"në dy-tri dhoga⁷ meiti⁸";

në thëntë se "ç'krushq i vanë",

"zhgabat e sorrat e hanë"!

Kënga e Rexhës

E fundit nga fytyrat e vuajtjes shqiptare që lexuesi do ta shoh i përket Rexhës së ri. Balada për Rexhën është e njohur për çdo shqiptar, ajo është kënduar në Shqipërinë e Veriut, në rrethin e Shkodrës, po sidomos në Kosovë. Kjo elegji shpreh fatin shqiptar: Pikërisht atëherë kur dëshirimi i tij është më i madh se asnjëherë më parë, shqiptari goditet nga fati i pamëshirshëm. Ajo që në fakt ka ndodhur me Rexhën është se ai në ditën e martesës shqelmohet nga kali i vet, prej së cilës goditje ai vdes, ndërkohë që krushqit i afroheshin shtëpisë së tij. Në këngë ndeshim dëshpërimin e nënës, kundërshtimin e saj për të pranuar atë ngjarje të hidhur që ka ndodhur:

- Çou Rexh' se ka dal' drita,

⁶ Shuma që caktohej në kontratën e martesës, të cilën burri detyrohej t'ia kthente gruas në rast lëshese.

⁷ Dërrasa.

⁸ Të vdekuri, për të vdekurin.

vesh jelekun me shirita.
Çou Rexh-o, çou, bir-o,
çou, delia i nanës-o!

Çou Rexh', e dil te trina,
Se po vin' t'zezat kushrina.
Çou Rexh-o, çou, bir-o,
çou, delia i nanës-o!

Çou Rexh', e dil te vija,
se po vin' t'zezat bija.
Çou Rexh-o, çou, bir-o,
çou, delia i nanës-o!

Çou Rexh', e dil te boka,
se po vin' t'zezat motra.
Çou Rexh-o, çou, bir-o,
çou, delia i nanës-o!

Çou Rexh', qit nji pushkë,
se po vjen e zezat krushkë.
Çou Rexh-o, çou, bir-o,
çou, delia i nanës-o!

Çou Rexh', e qitna kafe!
- Jam i lig e s'mund t'baj llafe.
- Çou Rexh-o, çou, bir-o,
çou, delia i nanës-o!

Çou Rexh', e qit raki-e!
- Jam i lig e s'mund ta pi-e.
- Çou Rexh-o, çou, bir-o,
çou, delia i nanës-o!

Nusezeza nën duvak,
Rexha i dekun në çardak.
- Çou Rexh-o, çou, bir-o,
çou, delia i nanës-o!

Nusezeza duel në shkallë,
Rexhën e mbyti kali i bardhë.
- Çou Rexh-o, çou, bir-o,
çou, delia i nanës-o!

More gjok, të raftë jela,
Qysh ma mbyte djalin n'shqelma!
Çou Rexh-o, çou, bir-o,
çou, delia i nanës-o!

Çou, Rexh', e dil te sana,
darsëm e mort t'i bani nana.
- Çou Rexh-o, çou, bir-o,
çou, delia i nanës-o!

Pas një vizite në Kosovë në vitet e 1980-ta një këngëtare nga Shqipëria ka shkruar: Në baladën e Rexhës mishërohet fakti se pikërisht kur fati dhe liria ndodheshin në afërsi të arritshme, atëherë ëndrrat dhe shpresat bëhen copë e grimë... dhe kështu gjithëherë. Pikërisht për këtë Kënga e Rexhës është shumë më tepër se sa vetëm një këngë – ajo shpreh fatin e dhembshëm e tragjik të një populli të tërë

MID'HAT FRASHËRI – ALIAS LUMO SKËNDO

Gjatë katërdhjetepesë viteve ishte e paimagjinueshme të flitej për Mid'hat Frashërin (1880-1949) në Shqipërinë e Enver Hoxhës. E vetmja gjë që mund të thuhej ishin fjalët: “tradhtar” , “fashist” ose “reaksonar”. Çdo mundësi për vlerësim objektiv bllokohej nga tabuja politike.

Qoftë edhe vetëm ky fakt e bën Mid'hat Frashërin interesant. Dy rolet e tij, si shkrimtar i orëve të para dhe lider i qëndresës antikomuniste, e bëri atë edhe pas vdekjes një armik të rrezikshëm për regjimin shqiptar.

Për lexuesin suedez dua ta prezantoj këtë Mid'hat Frashër – si shkrimtar të njohur me emrin Lumo Skëndo. Do t'i kem për bazë tre kapituj krejt të ndryshëm biografik: do t'i vë ballë për ballë faktet objektive të albanologut Robert Elsie, anatemën tradicionale komuniste dhe një portret prej idoli thuaja njëlloj i njëanshëm, pra prej një përkrahësi të tij politik.

Duhet thënë disa fjalë lidhur me përshkrimin komunist që i dedikohet Mid'hat Frashërit. Ato janë të shkruara sipas nevojave politike dhe nuk kanë asfare lidhje me logjikën, të vërtetën, analizën dhe shkencën. Përveç internimit të familjeve të tëra, si dhe poshtërimit dhe dënimit me punë të detyrueshme në rrethana të tmerrshme, ligësia e këtij sistemi u tregua para se gjithash në përpjekjet për të zhdukur kujtimin për njerëzit, mendimet dhe veprimet e të cilëve ishin të kundërta me synimet komuniste. Është mjaft groteske fakti se biografia e Mid'hat Frashërit në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar të vitit 1985 është shkruar nga Dr. Xhemil Frashëri, i cili qe detyruar të pështynte në të afërmin e tij. Një historian tjetër edhe më i njohur me mbiemrin Frashëri, Kristo Frashëri, në librin e tij ”Historia e Shqipërisë” (Një vështrim i shkurtër), botuar në Tiranë më 1964, e ka dënuar Ballin Kombëtar si lëvizje dhe ka shkruar se një pjesë e udhëheqësve të Ballit ishin politikisht dhe moralisht të dyshimtë; ndërsa për Mid'hat Frashërin ai shkruante:

- Persona të ndryshëm në këto qarqe – kryesisht qytetarë intelektualë dhe antizogistë – krijuan në fund të vitit 1942 një organizatë të fshehtë me emrin Balli Kombëtar. Në udhëheqjen e kësaj organizate, e cila ishte deklaruar të jetë patriotike dhe antizogiste, si figurë më e shquar ishte Mid'hat Frashëri, alias Lumo Skëndo, sikurse quhej ai zakonisht, një njeri me kulturë, i njohur si kundërshtar i regjimit të Zogut dhe si antifashist.

Kristo Frashëri i shmanget veprimit të Xhemil Frashërit, i cili disa dekada më vonë do ta poshtërojë veten, atëherë kur klima politike në Shqipëri ishte ashpërsuar edhe më dhe, e detyron këtë të fundit të hedh baltë në farefisën e tij.

Akuza se Mid'hat Frashëri e ka tradhtuar çështjen shqiptare duke e mbështetur lëvizjen e xhonturqve (turqve të rinj) bie përdhe. Për një kohë të gjatë kishin menduar patriotët shqiptarë se Shqipëria do të duhej të rrinte edhe më tej brenda shtetit osman, por me një autonomi të zgjeruar. Ky qëndrim shpjegohet me faktin se kanosej rreziku nga qarqet shoveniste të vendeve fqinje, si Serbia, Mali i Zi, Greqia dhe Italia, që donin ta mbanin pjesërisht apo tërësisht nën pushtim Shqipërinë. Në rrethana të tilla do të ishte më e mençme mbetja nën Portën e Lartë. Atë që ai ka shkruar më pas në përmbledhjen e tij eseistike më 1924 paraqet me fakte të qarta urrejtjen që Mid'hat Frashëri e kishte ndaj shtetit osman, shtet ky i cili moralisht dhe në aspektin social i ka dëmtuar shqiptarët më shumë se cilido qoftë shtet tjetër. Fjalët e tij mbi të metat dhe mungesat e shqiptarëve do të vërtetohen thuaja në mënyrë profetike: ngjarjet e egra të viteve të fundit në zhvillimet e Shqipërisë postkomuniste sikurse janë kaosi, anarkia, shkatërrimet e pakuptimta dhe rastet e reja të gjakmarrjes.

Akuza tjetër ka të bëjë me Ballin Kombëtar, që drejtohej nga Mid'hat Frashëri. Këtu kemi të bëjmë me një problem i cili është i ngjashëm me atë që ka ndodhur në vendin tonë fqinj Finlandën gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në njërën anë ishte i dënueshëm bashkëpunimi me gjermanët kundër Bashkimit Sovjetik e në anën tjetër ishte bindja se Stalini donte ta gëlltiste Finlandën. E ku do të duhej kërkuar mbështetje, kur rusët ishin aleatë të amerikanëve dhe britanikëve? Qarqet borgjeze në Shqipëri, si edhe shumë intelektualë u ndodhën si Odiseu në mes të Skilës dhe Karibdës – ku nuk ka ndonjë zgjidhje të mirë lidhur me problemet e vendit, përveç disa formave të humbjeve dhe viktimave...

Sa për krahasim do të mund të pyetesh se ku mund të mbështetej Balli Kombëtar, kur partizanët komunistë kishin filluar një luftë të vërtetë qytetare për t'i zhdukur ata? A mund të luftonin kundër gjermanëve, e njëkohësisht të goditeshin pas shpine nga partizanët? Gjendja po bëhej gjithnjë e më shumë e pashpresë për ballistët. Aleanca i mbështeste partizanët përmes ndihmave materiale që u dërgonte nga ajri, dhe ishte e vërtetë se partizanët luftonin kundër gjermanëve. Për kërkesat e tyre për një Shqipëri etnike me kufij të drejtë Balli nuk mund të merrte gjetiu mbështetje përveçse te forcat e Boshtit, për të cilat një Shqipëri e fortë ishte një frenim i ekspansionit sllav. Fakti se okupacioni fashist, gjatë viteve të luftës, i kishte krijuar kushtet dhe rrethanat për realizimin e kufijve etnik të Shqipërisë, u bë më pas argumenti kryesor për të penguar vënien e kufijve të drejtë. Ata që flisnin për “Shqipëri etnike” ose thjesht për “Shqipëri të Madhe” automatikisht klasifikoheshin si fashistë. Në fund të luftës, Shqipëria sërish u kthye në kufijtë e paraluftës. Partizanët shqiptarë mbaheshin të lidhur pas ideologjisë jugosllave dhe realpolitikës së tyre.

Sigurisht se nuk ishte gjithçka e keqe në Shqipërinë e Enver Hoxhës. Nuk duhet mohuar ose fshehur të arriturat në udhëheqjen e Enver Hoxhës e më pas edhe të Ramiz Alisë në arsimimin e popullit, në kulturë, në ekonomi dhe në kujdesin social. Enver Hoxha e kishte me siguri një vullnet që ta udhëhiqte popullin drejt një jete më të mirë, porse përmes mekanizmave të pushtetit në një shoqëri moniste nuk kishte mundësi për korrigjime, që do të ishin aq të nevojshme. Në anën tjetër, dhuna ndaj individit dhe inteligjencës që është ushtruar nga kjo diktaturë është e pafalshme. Është e pafalshme edhe tradhtia ndaj shqiptarëve të Kosovës, që u lanë në anën tjetër të kufirit, edhe pse nuk ishte e lehtë për regjimin shqiptar për të vepruar në interesin e tyre. Në fund, unë i lutem Zotit të na e falë mëkatin gjithë neve që dikur kemi besuar vetëm gjëra të mira për këtë regjim...

Në formë episodike parashtrova disa çaste nga jeta e Mid'hat Frashërit, të cilit poashtu do t'ia japë fjalën që të flasë edhe vetë drejtpërsëdrejti, pjesërisht përmes një tregimi, pjesërisht përmes disa teksteve ku tregohet qëndrimi i tij politiko-social. Kjo mbase do të mjaftonte për lexuesin që të mund të vrasë mendjen se çka do të ndodhte sikur në vend të Enver Hoxhës të bëhej ky njeri udhëheqës i Shqipërisë pas luftës. Fakti se pushteti u mor nga Partia Komuniste në një vend si Shqipëria kishte vetëm një domethënie: kundërshtarët e kësaj partie nuk ishin njëlloj mizor, nuk ishin njëlloj të shkathët faktikisht, jo aq pragmatik si ajo parti, ku Hoxha dhe në fillim këshilltarët e tij jugosllavë i dhanë ritëm dhe karakter. Në Shqipërinë me një minimum të traditave demokratike, me një zhvillim tjetërfare të jetës politike, nuk do të kishte as shansin më të vogël një parti e tipit komunist, sikurse ishte Partia Komuniste e Shqipërisë. Vetëm dobësia e kundërshtarëve dhe një konjunkturë e favorshme e shkrirë në një mizori fanatike u sollli komunistëve shqiptarë fitoren në një vend të varfër e gjysmëfeudal.

Sistemi që filloi të instalohet më 1944 ishte aq pak i përshtatshëm për shqiptarët sa një vidhe druri që vihet në një pjesë metalike. Një shoqëri e tipit stalinist në një vend si Shqipëria nuk mund të kishte ndonjë kuptim tjetër pos atë se një popull i dobët e i

vuajtur ishte vënë në shtratin e Prokrustit e shtrihej dhunshëm për t'u përshtatur në të. Ditën kur ky shtrat u shemb u pa se ai që kishte qenë i shtrirë në të ishte deformuar, se ai nuk mund të orientohej në botën e vërtetë që ekzistonte përtej asaj bujtine, që i kishte dritaret me grila, aty ku ai ishte futur në vitin 1945. Vetëm tepricat e të shkuarës së ligë kishin mbijetuar të gjitha tendosjet dhe amputimet që Prokrusti – Hoxha i kishte bërë trupit të shoqërisë shqiptare. Rezultati i këtij deformimi psikik, në kombinim me faktorë të tjerë, e ka shndërruar Shqipërinë postkomuniste në një vend ku tmerrri dhe shqetësimi kanë qenë ndonjëherë shumë më të mëdha se sa në fushatat komuniste që bëheshin në emër të luftës së klasave.

E sikur Balli Kombëtar të kishte udhëhequr vendin me qëllim që t'i realizonte idealet e veta – ç' do të kishte ngjarë atëherë? Një gjë është e sigurt: as atëherë një Shqipëri nën udhëheqje konservatore nuk do të kishte mundur t'i shmangë tensionet dhe konfliktet e brendshme. Pa fije dyshimi se konflikti midis pronarëve të tokave dhe të fshatarëve të pa pronë mbi tokën në atë vend të varfër do të kishte çuar detyrimisht në një zgjidhje. E përvoja tregon se në atë rast një regjim konservator ka vetëm një metodë: diktaturë civile ose ushtarake. Për fat të keq, bota nuk ka aq mirëkuptim ndaj popujve të varfër, që padrejtësisht janë ndaluar në rrugëtim e sipër e që pastaj duan të vrapojnë për të zënë hapin e historisë.

Të dhëna: Kush është Mid'hat Frashëri?

Robert Elsie: History of Albanian Literature. New York 1995:

Një figurë tjetër e shquar, tek e cila veprimtaria publicistike dhe angazhimi politik për përmbushjen e qëllimeve të lëvizjes kombëtare lë në hije talentin letrar, ishte publicisti, politikani dhe prozatori Mid'hat bej Frashëri (1880-1949), i shfaqur shpesh me pseudonimet Lumo Skëndo dhe Mali Kokojka. Mid'hat bej Frashëri që i biri i politikantit dhe ideologut të Rilindjes Abdyl Frashëri (1839-1892) dhe nip i figurave po aq të shquara Naim dhe Sami Frashëri. Mendohet se ka lindur në Janinë dhe është rritur në Stamboll, ku familja e tij u bë qendër e lëvizjes kombëtare. Në moshën shtatëmbëdhjetë vjeç ndihmoi Kristo Luarasin (1875-1934) dhe Kosta Jani Trebickën për botimin e almanakut kulturor të njohur me emrin *Kalendari kombiar*, që shtypej në shtypshkronjën Luarasi në Sofje. Një vit pas vdekjes së të ungjit, Naim Frashërit, botoi një biografi të shkurtër me titull *Naim be Frashëri*, Sofje 1901, me pseudonimin Mali Kokojka. Nga 1905 deri 1910 punoi në administratën osmane në vilajetin e Selanikut si drejtor për çështje politike. Në korrik 1908, kësaj radhe me pseudonimin Lumo Skëndo, nisi botimin e gazetës së përjavshme *Lirija* në Selanik, që zgjati deri më 1910. Ai ishte në krye të Kongresit të Manastirit më 14-22 nëntor 1908 (ku u vendos çështja e alfabetit shqip – shënim i Ulmar Kvikut), kurse në janar të vitit tjetër nisi të botojë një revistë mujore me emrin *Diturija*, organ periodik i ilustruar me interes kulturor, letrar e shkencor që doli më 1909 në Selanik, më 1916 në Bukuresht dhe nga 1926 deri 1929 në Tiranë. Mid'hat Frashëri luajti rol të madh në klubin patriotik të Selanikut, i cili u shqua për qëndrimin relativisht pajtues ndaj xhonturqve e që më pas pati kundërshtimin e figurave kombëtare më radikale.

Veprimtaria politike e Mid'hat Frashërit mori një karakter më kombëtar gjatë Luftës Ballkanike dhe shembjes përfundimtare të Perandorisë Osmane, kur Shqipëria ndodhej para rrezikut që të gllabërohej nga fqinjët e saj ballkanikë. Pas pavarësisë në nëntor 1912, u bë i pari ministër i vendit për punët botërore, kurse më pas konsull i përgjithshëm i Shqipërisë në Beograd dhe drejtor i përgjithshëm i postave. Me shpërthimin e Luftës së Parë Botërore u internua në Rumani për një farë kohe, por pasi u lirua, iu kthye përsëri botimeve. Nga 5 maji 1916 drejtoi të përdyjavshmen e Bukureshtit *L'indépendance albanaise*, një nga organet e shumta jetëshkurtëra të

lëvizjes kombëtare shqiptare gjatë Luftës së Parë Botërore. Më pas e shohim në Lozanë, ku banoi me kushëririn Mehdi Frashërin (1874-1953) e ku shkroi një numër artikujsh publicistikë e studimorë. Më 25 nëntor 1920 u emërua kryetar i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris, ku jetoi deri më 1922. Në Paris vazhdoi veprimtarinë publicistike në shtypin francez për të propaganduar qëndrimin e Shqipërisë në ristrukturimin e Evropës së pasluftës. Artikujt e tij të kthjellët e racionalë dolën në organe si *France-Orient*, *L'Europe nouvelle*, *Mercure de Franca*, *Revue de Genève* dhe *Les peuples libres*. Më pas mbajti disa poste ministrore dhe ishte ambasador i Shqipërisë në Greqi nga 1923 deri në 1926.

Në periudhën e diktaturës së mbretit Zog, ai për një kohë e la politikën dhe hapi një librari në Tiranë. Vetë e kishte një bibliotekë private jashtëzakonisht të pasur, me rreth 20 000 vëllime, më e madhja në Shqipëri në atë kohë, të cilën në shkurt 1938 e dhuroi për krijimin e një Instituti Studimesh Shqiptare. Për fat të keq ky projekt nuk u realizua në vitet më pas. Në fund të vitit 1942 rihyri në arenën politike për të luftuar kundër pushtimit të vendit nga Boshti, dhe u caktua udhëheqës i *Ballit Kombëtar*, lëvizje antikomuniste e qëndresës, që rivalizonte për pushtet me partizanët komunistë. Në vjeshtë 1944, kur pa se në Shqipëri po fitonin komunistët, iku në Italinë e jugut. Biblioteka e tij në Tiranë u konfiskua dhe përfundoi në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë. Vitet e para të luftës së ftohët e gjetën Mid'hat Frashërin në Perëndim në përpjekje për të formuar një koalicion të forcave opozitare antikomuniste në Angli dhe në Shtete të Bashkuara. Vdiq nga një krizë zemre në hotelin Lexington në avenynë Lexington në Nju Jork më 3 tetor 1949 (Disa përkrahës të tij kanë spekuluar lidhur me mundësinë e helmimit të tij nga agjentët komunistë...).

Mid'hat bej Frashëri është autor i një game të gjerë veprash edukative: tekste shkollore, përkthime, artikuj gazetash, broshura politike dhe rrëfenja didaktike. Deri më 1926 kishte botuar rreth njëzet vepra në shqip. Nga botimet joletrare, në mund t'i quajmë kështu, në veçanti mund të përmenden: *Istori e shkrimit shqip*, botuar më 1901 në revistën *Diturija*, një nga historitë më të para të letërsisë shqiptare; *Këndime për shkollat e para*, Selanik 1910; *Istori e mbretëris Otomane*, Konstantinopojë 1911; *Letra mi një udhëtim në Zvicrë*, Sofje 1915; dhe *Plagët tona. Çë na mungon? Çë duhet të kemi?*, Tiranë 1924, një traktat 61 faqesh për gjendjen morale, materiale dhe psikologjike të Shqipërisë. Më tej, ai e ka përkthyer *Gjyjom Tellit* (Guillaume Tell), Sofje 1898, të poetit dhe shtetarit frëng Alfons de Lamartinit (1790-1869); pjesë nga romani "Robinson Kruso" i Daniel Defosë (1660-1731), veprën e shkencëtarit të shekullit XVIII Johan Tunman - *Mbi historinë dhe gjuhën e shqiptarëve dhe vllahëve*, si dhe *Psikologji e edukatës* e psikologut francez Gustave Le Bon.

Në fushën e letërsisë origjinale Mid'hat Frashëri ishte një nga shqiptarët e rrallë të kohës që nuk botoi ndonjë vjershë, gjë që sjellë një farë lehtësimi kur sheh shpërthimet nga të gjitha anët të vrullit kombëtar dhe thirrjeve poetike nga moria e poetëve rilindës me talent të kufizuar. Sidoqoftë, ai botoi një përmbledhje me poezi në prozë, tregime të shkurtra dhe persiatje me titullin *Hî dhe shpuzë*, Sofje 1915. Këto tregime për vuajtjet nën zgjedhën turke, për gjakmarrjen mes shqiptarëve dhe për luftërat në Ballkan janë interesante, megjithëse përshkohen nga një notë pakëz e tepruar didaktike.

Fjalori Enciklopedik Shqiptar. Tiranë 1985. Botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Kryeredaktor: Prof. Aleks Buda.

FRASHËRI, Mithat (1880-1949). Një nga përfaqësuesit kryesor të reaksionit në Shqipëri, intelektual liberal, pseudopatriot dhe tradhtar. Në vitet 1908-1912 ndoqi vijën e bashkëpunimit me xhonturqit dhe iu kundërvu lëvizjes kryengritëse të popullit shqiptar, që luftonte për shpalljen e Pavarësisë kombëtare. Në vitet e luftës ANÇ të

popullit shqiptar, u vu në krye të organizatës tradhtare të *Ballit Kombëtar* dhe ishte përgjegjësi kryesor për veprimtarinë që zhvilloi ajo për sabotimin e luftës çlirimtare, si dhe për bashkëpunimin me forcat pushtuese fashiste italiane dhe gjermane. Drejtoi një varg organesh shtypi dhe botoi shkrime me pseudonimin Lumo Skëndo.

(Xh.F. – Xhemil Frashëri).

Halim Zeqiraj: Mid'hat Frashëri si njeri dhe patriot. Nga gazeta Flamuri, organ i Ballit Kombëtar, më 28 Nëntor 1978.

Balli Kombëtar ishte një Organizatë Shqiptare dhe kryesohej nga Midhat Frashëri; përfshinte të gjithë Patriotët e çquar me idera thjesht nacionaliste që u dhimbsej Atdheu dhe e shifnin rrezikun që i kërcënohej; qëllimi i Ballit Kombëtar ishte ky: Çlirimi i Shqipëris nga sundimi i huaj, bashkimi i të gjitha tokavet shqiptare në një Atdhe të vetëm dhe vendosja e një regjimi të zgjedhur lirisht e demokratikisht që të shëronte plagët e luftës dhe të siguronte liri, drejtësi e mirëqenie për të gjithë. Këto parime ishin shprehur qysh në fillim në dhjetë pikat e Dekallogut dhe ishin aq të thjeshta, të kuptueshme e patriotike sa me të shpejtë u mishëruan me shpirtin e trupin e një pjese të madhe të Popullit Shqiptar. Këto suksese të Ballit sigurisht shtuan qëndrimin armiqësor të komunistëve, të cilët filluan me një herë nga terrori duke vrrarë, duke djegur e duke rrëmbyer njerëz të pafajshëm nga shtëpirat e tyre; duke i ngjitur akuzat më të pavend që fabrikonte propaganda e kuqe.

Përpara këtyre ngjarjeve të shëmtuara e tragjike, Midhat Frashëri mbeti i habitur, sepse as nuk e kishte përgatitur Ballin Kombëtar për akte të tilla, as nuk këshillonte një luftë civile; përkundrazi Midhat Frashëri u përpoq ta shmangte vllavrasjen, dhe flamurin komunist të dhunës, të terrorit e të tradhtis, ta zëvendësonte me flamurin e mirësis, t'urtësis e të dashurisë; me fjalë të tjera pranoi më mirë të pësojë të gjitha rrjedhimet e hidhura e tragjike që dihen, sesa të zhytet në gjak e tradhti, sepse e dinte shumë mirë që një kundërveprim, duke iu përgjigjur gjakut me gjak, zjarrit me zjarr e atentatit me atentat, nuk ishte për të mirën e Atdheut e të Popullit Shqiptar; ai thosh shpesh herë: "Po të vrasim prapa krahëve, po të djegim edhe na siç bëjnë komunistët, atëherë po ndihmojmë edhe na për t'i hapur varrin Shqipëris e Popullit, ahëre po bëhemi edhe na komunistë".

(...)

Në dhomën e vogël të barakës së kampit n'Itali, ku qëndori për një kohë të gjatë, Midhat Frashëri filloi me një herë punën për të çuar në vend premtimin që i bëri popullit në minutën që u largua nga Shqipëria. Meqense propaganda komuniste kishte bërë çmos që ta demaskonte Ballin me akuza të pavënd, Midhat Frashërit iu desh më parë të sqarojë me hollësi se Balli Kombëtar nuk ishte një grup fashistësh, ose nazistësh, ose merçenarësh, siç e kishin paraqitur të kuqtë, por një Organizatë Shqiptare nacionaliste, e përbërë nga patriotë të çquar e të ndershëm, që luftonin për çlirimin e Atdheut nga okupatorët e huaj. Pastaj duke dërguar memorandume e protesta fuqivet e organizatave të Botës së Lirë, Midhat Frashëri vuri në dukje krimet e shëmtuar të të kuqvet në Shqipëri, dhe mund të themi me siguri se qe i pari që dha alarmin për rrezikun komunist në botë.

Me punën e pareshtur pranë fuqivet Aleate, më në fund formoi Komitetin Kombëtar "Shqipëria e Lirë" më 26 gusht 1949 në Paris. Ky Komitet u njojt nga Aleatët si i vetmi autoritet shqiptar në mërgim. Formimi i këtij Komiteti qe vepra patriotike e fundit, që i bëri popullit shqiptar Midhat Frashëri, sepse për fat të keq nuk shkoi shumë kohë që i vetmi trashëgimtar i Familjes Famëmadhe Frashërlli mbylli sytë për gjithmonë më 3 tetor 1949, pa realizuar atë ëndërr, për të cilën punoi e luftoi për gjithë jetën e tij:

FORMIMIN E NJË SHQIPËRIJE TË LIRË ETNIKE E DEMOKRATIKE MBI BAZAT SHOQËRORE MODERNE.

Episode nga jeta e Mid'hat Frashërit

Një ditë në librarinë e Lumo Skendos

1. Halim Zeqiraj rrëfen në gazetën Flamuri më 28 Nëntor 1978

Ishte viti 1930 dhe gjindem në Tiranë me rastin e pushimevet shkollore. Neve të rijvet, që sapo kishim lënë bankat e shkollës, na kishin rrëmbyer si me magji shkrimet e Lumos, jo vetëm nga stili i ëmbël e tërheqës që përdorte, por edhe nga problemet që rrifte. Kështu, pra, më lindi dëshira të shkoj dhe të shifem sy në sy me atë që kishim kaqë admirim. Shkova në Librarin e tij me pretekst që të blej një libër dhe e gjeta në tyrezen e punës duke shkruar. Me një ton të butë e atëror më pyeti se ç'dëshiroja; ja msheha qëllimin, për të cilin kishja shkruar dhe i them se dëshiroja të blej një libër. Ndërkohë që djali kërkonte librin nëpër raftet, Lumua (ky ishte emri që e shifshim shpesh nëpër shkrimet e tij) më pyet se nga ishja dhe ç'punë bëja. I them se jam nga Vlora dhe shërbej si arsimtar. Atëhere më shikoi drejt në sye më me vretjtje; m'u duk sikur donte të studjonte e të zbulonte dishka prej meje; pastaj me një nënqeshje të hollë këndoi me zë t'ultë dy vargje të një vjershe, që ishte e ndaluar nga qeverrija e atëhershme të këndohej nëpër shkolla:

*Vlora, Vlora, Vlora, Vlora,
Bjeri, moj, të lumtë dora...*

Pa më dhënë kohë t'i them ndonjë fjalë, më pyet përsëri: "A e bën detyrën si duhet, biri im?" I them se po; programin që na ka caktuar Ministrija e Arsimit e plotsoj siç duhet. "Biri im, më tha, plotsimi i pikavet të programit është puna për të cilën paguhesh; unë desha të di nëse bën dishka tjetër përtej vijave të programit". Vonesa e përgjigjes s'ime e shtyjtë Lumon ta vazhdojë prapë bisedimin me këto fjalë: "Kam ndëgjuar se Vlora ka shumë ullij dhe se mbjellja e tyre ka filluar qysh në kohën e Venecianëve; këta e nxitnin popullin që të mbillte sa më shumë ullij e pemë të tjera kundrejt një shpërblimi të mirë në të holla. Populli Shqiptar trashëgon nga e kaluara disa të meta, që nuk e kanë lënë të forcohet fizikisht, të përmirësohet ekonomikërisht e të ngrihet mëndërisht; nga apathija e padurueshmënia kërkon vjeljen e frutës para se të mbillet e të rritet pema. Për këto arsye pra është detyra e një arsimtari, dhe e cilitdo njeriut tjetër që dëshiron mirëqenien e kombit të vet, që të përpiqet t'i shërojë këto të meta ashtu si shëron një doktor i mirë sëmundjet kronike të trupit. Ky është misioni i një arsimtari. Kështu plotsohet detyra".

Nga ky bisedim, që zgjati vetëm disa minuta, fitova një mësim të vlefshëm prej një Edukatori të Madh; kuptova se Populli Shqiptar kishte nevojë për misionarë e përçues të mirë që ta nxirrnin nga mizerja shekullore, në një jetë më të begatshme; nga errësira mendore, në dritën e diturisë; nga shtypja e përhershme, në lirin e demokracin e vërtetë.

2. Ma shkatërruan murin

*Në mënyrë të lirë sipas udhëpërshkrimit "Europeisk Orient" (Orienti evropian) 1936 të
Sven Aurénit*

Vapa ende nuk kishte mbërritur në pluhurin e verës në Tiranë. Mid'hat Frashëri sapo i ka hequr kapakët e dritarëve të librarisë së tij dhe po shfletonte një roman në gjuhën frënge, që i kishte ardhur me postë. Libri bënte fjalë për mundimet jetësore, dhe

Mid'hati filloi të mendojë për vuajtjet e tij. Politikën ai tashmë e ka lënë anash, pasi që Ahmet Zogu ishte vendosur në fron, por ai kishte lënë tashmë edhe shkrimet e tij didaktike-patriotike. Nuk ka ndonjë vend në jetën politike të mbretit Zog për një njeri si Mid'hat Frashëri. Tash ai i është përkushtuar tërësisht librarisë dhe librave të tij, që kërkojnë shumë kohë. Biblioteka private e Mid'hat Frashërit është më e madhja në Shqipëri, me 20 000 vëllime.

Befas hyn me furi një njeri, që rrallë mund të shihet të hyj në një librari shqiptare, me një revolver në duar. Përjashtë librarisë dëgjohej një krismë, dera hapet përsëri, dhe një njeri që Mid'hati e njeh si njëri prej krerëve të klaneve nga malësia në veri, tenton të hyjë brenda. Por pas Mid'hatit qëndron njeriu që sapo që futur brenda dhe ia drejton armën kreut të klanit. Ky kthehet pas dhe në pragun e librarisë ku i bashkangjiten edhe pesë të tjerë të armatosur, të gjithë me armë të gatshme në duar. Situata është e pashpresë, dëgjohej disa krisma plumbash dhe pluhuri i gëlqeres së murit ngrihet si re në vendin e ngjarjes. Gjithë veprimtaria rreth e qark aty ndalet, të gjithë drejtojnë shikimet kah ajo shtëpi në murin e të cilës mund të lexohet Lumo Skendo – Librari. Kur megjulla e pluhurit të gëlqeres dhe suvatimit përhumbet mund të shiheshin vrima të mëdha në mur; e përjashtë, atje tej në rrugë, shtrihen dy figura të palëvizshme: një grua dhe një fëmijë.

Njerëzit që erdhën me nxitim aty i mposhtën sulmuesit dhe u pa ajo që më së pakut mund të besohej: kreu i klanit nga malësia as nuk ishte lënduar. Ata dy të vdekurit në rrugë ishin dy kalimtarë që nuk kishin pasur asgjë të bënin me ta. Ata kishin pasur pafatësinë të ndodheshin aty mu në kohën kur kishin vërshuar plumbat, konstaton Sven Aurëni.

Kuptohet se është fjala për gjakmarrje, dhe si zakonisht ajo shpesh ka goditur të pafajshmit, kurse viktimat e menduar ia ka dalë të shpëtojë. Është ironi e fatit, ajo që kjo ngjarje u zhvillua mu në librarin e Lumo Skendos. Kanë kaluar njëzet vite qyshkur u shkrua tregimi Lotët, dhe një pjesë ka ngjarë edhe më pas. Numri i rasteve të gjakmarrjes është zvogëluar në Shqipëri, por zakoni është vështirë të çrrënjoset. Lumo Skendo ndoshta ka ndryshuar – ai nuk derdhë lot për viktimat e gjora. Ai vlerëson madhësinë e dëmit; e kur një gazetar i huaj e lut për një koment, ai thotë vetëm këtë:

- Kopukë të mallëkuar! Ma shkatërroan murin!

3. Pas shkollës shkova te libraria e Lumo Skendos

Nexhmije Hoxha rrëfen në librin e saj “Jeta ime me Enverin”, Tiranë 1998

Një herë më tha (Enver Hoxha): “Paske stilograf të bukur, shkruaka mirë. A ma fal mua?”. “Merre, po ta duash – ia ktheva me të qeshur – por ti e sheh që ai humbet në atë dorën tënde, ai është për “zonjusha”.

Se, vërtetë, stilografi ishte për vajza, sa një gisht dore dhe kishte një xhufkë të kuqe prej fijesh mëndafshi të dredhur. Në atë stilograf, kuq e zi, kisha shtënë sevda dhe ia kisha vënë syrin me kohë, sa herë që e shihja në vitrinën e librarisë së Lumo Skendos (Mit-hat Frashëri). Kjo librari ishte në rrugën “Mbretërore”, që pas Çlirimit u quajt rruga e Barrikadave. Te kjo librari unë, ashtu si shumë shoqe e shokë të rinj, kthehesha shpesh kur dilja nga shkolla, për ndonjë libër që më interesonte. Shkonim aty gati çdo ditë dhe shikonim me respekt, kur ai, i biri i Rilindasit të madh Abdyl Frashëri, Mit-hati, i ngrirë në veshjen e tij elegante, me redingotë dhe me jakën e kollarisur që zbardhte më shumë në kontrast me papijonin e zi dhe, duke mbajtur kokën lart nga jaka e ngrirë dhe nga syzet që mbante “pinsë” në hundë, na shërbente vetë për çfarë kërkonim.

(...)

Një përshkrim dashamirës për një intelektual klasik, librarin Mid'hat Frashëri. Ka kaluar një dekadë që kur enciklopedia shqiptare ka shkruar për të si “pseudopatriot dhe tradhëtar”. Tash janë kohë të tjera, dhe është bukur e vetëdijshme për këtë kur shkruan gruaja e Enver Hoxhës. Mid'hat Frashëri është bërë një figurë e respektueshme – madje edhe nga një grua që ishte mu në qendrën e pushtetit të shkuar.

Nga proza e Mid'hat Frashërit: - ”Lotët” nga Hi e Shpuzë, 1915

Tetë vite pa dalur jashtë...Vesa e natës ende nuk ishte shndërruar në avuj dhe shkëlqim në gjethe e bar, si pjesë të diamantit në një smerald; frynte një erë e lehtë, por shumë e ftohët.

Meço heshti një çast; e lëshoi poshtë dyfekun dhe u mbështet për një guri në kënd. Gjithë ç'pa iu duk krejt e re. Dielli, që sapo qe ngritur lart, bëri që një pamje e kaltëreme të depërtojë nëpër atë rreth të egër; në perëndim majat e malit ngriheshin në mënyrë madhështore deri në kup të qiellit. Kurora e maleve ishte e mbuluar në mjegull. Është vjeshtë.

Meço mori frymë thellë. Filloi të mendonte për atë jetë që po bënte. I vetëm në këtë kodër mes drunjsh e shkëmbinjsh dëshironte të rrinte e të mendonte i brengosur.

Kush ishte ky njeri trupgjatë, i hijshëm por i zbehët dhe me flokët që i zgjteshin deri poshtë shpinës? Mustaqet e tij të mëdha jepnin përshtypjen e një heroi; ato rriteshin si dy hije të zeza në këtë fytyrë të zbehtë. Kur të shihej shikimi i tij i ashpër dhe i shqetësuar, dyfeku që ai mbante në duar, pistoletat në brez dhe kamën në kallëf, nuk mund të besohej ndonjë gjë tjetër përveçse se ky ishte njëri nga ata fatkeqët, që jeton i izoluar nga njerëzimi, që nuk di se ç'është jeta familjare dhe që jeton duke plaçkitur mallra të të tjerëve. Mirëpo, kur përsëri të vështrohet ai, që duket të jetë rreth të dyzetepestave, zbulohet diçka tjetër përveç egërsisë, që u fitua nga përshtypja e parë. Këta sy, që kanë ngjyrë të kaltër si çelik, e që dukeshin të egër në shikim të parë, por më pas dallohet një butësi, një brishtësi, dhe në ta pasqyrohet trishtimi nëpër të cilin ai kalon dhe e bartë në vete.

Eh! Tetë vite pa dalur jashtë! – mermëriti Meço. Tetë vite pa dalë nga shtëpia, thuajse pata harruar se si dukej mali dhe se sa i bukur është lindja e diellit këtu mes malesh. A kjo të quhet jetë, kështu si jetojmë ne! Më kujtohet si të ishte dje: ishin në shëtitje, vëllai im, kushëriri dhe njerëz të familjes Sheli. U zumë, dhe ata të Shelit filluan të gjuajnë dhe aty u shtri i vrrarë vëllai im... Që atëherë trembëdhjetë njerëz, nga ne e nga ata të Shelit, kanë humbur jetën. Trembëdhjetë njerëz, pa ndonjë arsye... Që atëherë unë jam mbyllur dhe nuk kam dalur jashtë, se unë e kam radhën për të larë gjakmarrjen.

Me hapa të ngadalshëm filloi sërish ecejaket. U ngjit shpatit përpjetë. Rruga gjarpëronte nëpër lisa e bredha. Dielli u ngrit edhe ca. Sapo e kaloi kthesën pa një pamje magjepsëse: mbi fushëzat e vogla atje poshtë kishte ende mjegull, një mjegull e bardhë, dhe dukej sikur Meço ishte një shqiponjë që po fluturonte sipër një reje që kishte rënë në tokë.

Pa u ndalur vazhdoi rrugën. Ajri po bëhej më i nxehtë, mjegulla u rrallua dhe fusha e vogël tashmë shihej qartë me lumin e saj të argjendtë në mes: ishte Drini i Zi, që po rridhte qetë e qetë.

- Tetë vite pa dalë nga shtëpia, tha Meço vetë më vete. Sot është hera e parë. Motra ime ka lindur një djalë dhe ajo ka shprehur dëshirën që të shkoj e ta shoh atë. Ajo e mjera don që unë të dal nga ky burg ku kam rënë me vullnetin tim; a thua vallë, a mos do të jetë kjo dita ime e fundit. Nuk e di, mundet që mbase pikërisht sot të vritem nga njerëzit e Shelit dhe ata pastaj të ma çojnë kufomën te motra! Motra ime e shkretë, nuk

i ka mbetur askush nga farefisi përveçse meje, e unë jam i vdekur për botën. E sa do të gëzohet kur të më shoh!

Një lot rrëshqiti faqeve të Meços. Ai po mendonte në jetën që kishte bërë, sa kishte vuajtur, se si ai tashmë po jetonte si një i vdekur dhe se ai nuk ishte i sigurt në jetë. Vdekja i rrinte mbi kokë si sopata e lidhur në spango të kalbura. Jetonte si një hije, pa gëzim në jetë. Hareja, të qeshurit, dëshirat, puna dhe përkujdesja të cilat na lidhin me jetën dhe që na bëjnë ta duam ekzistencën ishin të pa njohura për këtë njeri, të cilin zakonet e vendit dhe prapambetja e njerëzve e kishin katandisur në fatkeqësi. I mbyllur në shtëpi, pa i takuar të afërmit për një kohë aq të gjatë, ishte bërë një hije e errët. Tash po e shihte bukurinë e kësaj treve që e rrethonte atë, dëgjonte fëshfërimat e gjetheve që viheshin në lëvizje nga era, e shihte shkëlqimin e Drinit, majet e maleve, trungjet... Ah, i mjeri unë, që sa kohë s'e kam parë gjithë këtë bukuri, që sa kohë s'e kam dëgjuar zërin e erës së veriut që shqet nëpër degët e lisave, i ankohej vetes së vet. I mjeri, mu sot kur po e ndjente ëmbëlsinë e jetës, sa e bukur i dukej gjithçka! Të gjitha këto mendime ia rritën pikëllimin, kur ai mendoi për vetitë e këqia të njeriut, që e dallojnë një njeri nga shokët e tij. Njeriu do të jetonte si i konsumuar, nëse ai nuk guxon të dalë jashtë dhe të takojë të afërmit e vet, si dhe të marrë pjesë në gëzime, që i madhi Zot i shpërndanë në tërë botën. Ah, sa e bukur është bota! Është njeriu ai që shkakton gjithçka të ligë! Sepse bash për asgjë, pa kurrfarë arsyeje, njerëzit luftojnë, vrasin... A thua na e dhuron dielli rrezen, bimët kallinj të artë, lulet aromën, e shpezët këngën vetëm që ne të bëhemi pikë e pesë e të shkatërrohem mes vete?

Ecte duke menduar, me shikimin përdhe, kur befas në anën e djathtë të rrugës malore dëgjoi një zë: gjethet e pemëve u dridhën. Meço e hoqi dyfekun nga supet dhe u bë gati. Pastaj nisi të qeshte, kur e kuptoi se prej nga erdhi zëri: disa pëllumba që ishin trembur nga ecja e tij kishin fluturuar me rrëmbim! Meço iu afrua vendit ku kishin qenë pëllumbat. Aty që një krua me ujë të freskët dhe rretheqark bari i gjelbër. Ishte etur nga moti i nxehtë, ishte lodhur nga udhëtimi katër orësh. U përkul, piu ujë të ftohët dhe u ul të pushonte. Ndjeu se që uritur dhe nxori bukë e djathë nga valixhja.

Pasi që ulur, piu sërish ujë dhe e ndjeku freskinë. Vazhdoi ecjen, rruga që e ngushtë e përplot me gur. Nga ana e djathtë ishte mali dhe shkurrat, aty këtu kishte gurë të mëdhenj; në anën e majtë zgjerohej fusha me disa fshatra atje poshtë, që dukeshin nga larg, dhe majat e maleve dukeshin si mure të kësaj skene. Dielli kishte mbërritur në gjysmë të rrugës, të cilën ai e kalon në udhëtimin e tij ditë. Meço arriti deri në një vend, ku rruga ishte e hapur dhe asgjë nuk e pengonte pamjen që nga larg. Dhe ai pa dy njerëz që po ecnin në drejtim të tij. Që nga largimi prej shtëpisë nuk kishte takuar asnjëri, prandaj ndjeu një të rrëqethur në tërë trupin. Tetë vite kishin kaluar pa e hedhë një hap të vetëm jashtë shtëpisë dhe pa e parë asnjë njeri të panjohur, gjë që e bëri të dyshonte dhe të kishte frikë edhe nga hija. Për fat, aty kishte disa shkurre midis tij dhe atyre që po vinin kah ai, ashtu që ata mbase nuk do ta kishin parë atë.

Meço konsideroi se më e mira ishte që të tërhiqej tutje, nga njëra anë e rrugës, të fshihej pas një shkëmbi dhe të priste derisa dy udhëtarët të kalonin.

U fsheh pas shkëmbit dhe nisi të mendonte, sa ai thuajse i kishte harruar ata dy kalimtarët; ata ishin ofruar rreth njëqind hapa. Përnjëherësh e mbërthyen mornica dhe u bë dyll. Ai e tundi kokën që të mund të shihte më mirë.

- Është ai, ai qenka! – tha ai për veten e vet. Vetë Taf Sheli, sulmuesi që ma ka vlarë vëllain... ai tjetri qenka Gjoka, një burrë nga fshati.

Po i dilnin para sysh, njëra pas tjetër, të gjitha ngjarjet e tetë viteve që kishin shkuar, se si Taf Sheli shtiu mbi vëllain e tij, se si një rrëke e gjakut të zi i doli nga goja dhe se si ai u rrëzua për tokë. Të gjitha krimet që më pas u bënë midis farefisit të tij dhe të Shelit i erdhën ndër mend një për një, dhe jeta e tij mizore që ai po bënte për shkak të këtyre

krimeve sot i dukej më e trishtueshme dhe më e mjerë se kurdoherë. Dhe e tërë e keqja ishte shkaktuar nga ky njeri që po shkonte drejt tij!

Ç' duhej të bënte Meço? Si duhej të vepronte? Meço nuk hezitoi as për një çast: në çastin e vdekjes i vëllai i kishte thënë: "Meço, mos më lër pa ma marrë hakun!". Fytyra e vëllait i doli përpara, dhe kjo e shtyu atë të kërkonte gjakmarrjen. Së pari ai duhej të shtinte mbi vrasësin e të vëllait, e pastaj, nëse do të ishte e domosdoshme, do të shtinte edhe mbi Gjokën, dhe atëherë do të merrej gjaku.

E ngriti dyfekun në sup dhe e vendosi tytën në shkëmb dhe pastaj provoi t'i dëgjonte se ç'po flisnin ata. Gjoka i thoshte Taf Shelit:

- Ka kaluar shumë kohë qyshkur ti e ke parë shtëpinë tënde?

- Tetë vite, ah, tetë vite – qysh kur ndodhi vrasja pa paramendim, e cila u fut në mes nesh dhe familjes së Muço Gurit. Me atë rast, që ndodhi si të thuash pa asfarë shkakut, u vra vëllai i Muços dhe ai vetë mori plagë. Që atëherë e deri tash kam qenë larg nga Shqipëria, por ah sa më paska marrë malli! Kisha humbur shpresat se do të mund të shihja ndonjëherë më këto treva të bukura, këto male të larta, ku kam kaluar rininë...

Meço hezitoi, dora e tij filloi të dridhej. Qe zverdhur si të ishte ngritur nga varri, ai nuk mund të shihte më qartë. Një lot i rrodhi faqes përposhtë.

Ç'po ngjante me Meçon, ç'frikë kishte ai? Ai që ishte aq trim dhe një shenjtar aq i shkathët. Një herë – para katërbëdhjetë vjetësh – kishte marrë pjesë në një garë shenjëtari në një dasmë dhe ishte treguar më i miri. Kishte fituar një dem të hijshëm!

- Tetë vite pa i parë këto anë! Tetë vite pa pasur mundësi që t'i takoja të afërmit e mi! Para se të nisesha për këtë rrugë mora një letër nga im at, nga babai im i mjerë, në të cilën ai më shkruante se e tërë familja, nëna, gruaja, motrat dhe fëmijët që ishin të vegjël kur unë isha larguar, të gjithë donin të më shihnin. Oh, ç'ka bërë marrëzia jonë, sa dhembje i shkaktojme njëri-tjetrit...

Ai nuk arriti kurrë të përfundonte fjalën e tij; një zë u dëgjua nga ana tjetër e rrugës. Të dy udhëtarët u stepën. Meço kishte hedhur dyfekun e tij, po vraponte rrugës drejt tyre dhe thirrte me krahë të hapur:

- Taf Sheli! Unë jam Meço. Deri më tash kanë vdekur trembëdhjetë njerëz nga familja ime dhe e jotja. Lotët që familjet tona kanë derdhur do të mund të mbushnin një liqe. E tërë kjo fatkeqësi, sikurse the ti, vjen për shkak të marrëzisë sonë. Unë ta fal gjakmarrjen, a mund ta bësh dhe ti këtë? Eja, le të pajtohemi!

Tash jo vetëm Muço kishte lotë në sy; të tre burrat po qanin si gra dhe e puthnin njëri-tjetrin si fëmijë.

Me lot të gëzimit tha Gjoka: - Rroftë dashuria! Rroftë shpirtmadhësia!

(...)

Nga koha kur është shkruar ky tregim kanë kaluar nëntëdhjetë vite. Për mua është shumë tragjike fakti se ky tregim ende është aktual, sot si atëherë. Edhe në këtë milenium të ri ngujohen shqiptarët sërish për shkak të mallkimit të gjakmarrjes. Çfarë do të thoshte Mid'hat Frashëri, sikur ai të mund të kthehej sërish në jetë dhe ta shihte këtë? Të shihte se shpresat e tij për përparim dhe demokraci në jetën e Shqipërisë ende nuk janë përmbushur...

TAKIME ME ALBANOLOGË DHE DISA TË TJERË

Miku ynë Anders Vestin vazhdon të zemërohet nga përshkrimet tendencioze mbi shqiptarët, të bëra nga persona të cilët bazohen vetëm në njohuri joburimore. Një bursë udhëtimit i krijoi atij një rast të mirë që të studiojë arkivat në Evropë dhe të njihet me disa albanologë të njohur. Dhe shumë kohë përpara Enver Hoxhës e socialistëve të tjerë shqiptarë që filluan të vepronë në vitet e '30-ta, ndodhi diçka fantastike: një socialist shqiptar erdhi në Suedi në vitin 1918! Ky rast i jep Andersit mundësi që, për herë të parë, të takojë një shqiptar. Ndoshta edhe Jalmar Brantingu do të ketë shkas për të menduar për fjalët e tij lidhur me çështjet “e llojit krejt të dorës së dytë”, të cilat mysafiri nga Ballkani do t'i shtrojë, çështje të cilat për të dhe popullin e tij janë absolutisht të dorës së parë: Çështja e mbijetesës së një populli dhe të një kombi.

“Më thuaj me kënd rri, të të them se cili je!”

Anders Vestini mori frymë thellë. Ja, edhe një leshko që beson në pohimet mbi shqiptarët nga rrëfimet që dëgjon prej armiqve të tyre...

E largoi mënjandë librin “Popujt e vendeve ballkanike” të J. L. Sakson, që sapo ishte botuar. Ishte koha për t'i bërë detyrat në frëngjisht dhe gjermanisht, por ajo që kishte lexuar nuk i jepte farë frymëzimi të merrej me diçka më serioze.

Ai farë Saksoni do të duhej të merrej vetëm me botimin e gazetës së tij “Såningsmannen” (Mbjellësi) në vend që të merrej me botimin e librave që, mbi marrëdhëniet në Ballkan, mbjellin farën e paragjykimeve në mendjen e lexuesve të paditur, mendoi Andersi.

Andersi tashmë ishte në semestrin e tretë të fakultetit në Stokholm, por interesimi për Ballkanin në përgjithësi, e për shqiptarët në veçanti, nuk i ishte zbehur aspak. Pasi kishte siguruar disa vepra nga jashtë, vetëm sa i ishte rritur pasioni për shqiptarët. Ishte një popull me kontradikta të mëdha, dhe megjithëse shumë gjëra negative mund të thuheshin për të, prapëseprapë mendimet pozitive ishin aq habitëse, sa kishte vendosur që t'i vazhdonte hulumtimet mbi shqiptarët. Më së shumti u ndikua nga veprat e Edith Durhamit, meqë ajo kishte jetuar disa vite me malësorët e Shqipërisë veriore dhe shkruante me autoritetin e dëshmitares që kishte njohuri të mirëfillta. Kishte siguruar tre nga veprat e saja, të cilat ishin krejt magjepsëse. Fakti se një zonjë nga Anglia imperialiste mund të kishte një simpati dhe një interesim kaq të zjarrtë për njerëzit e varfër të malësisë së Shqipërisë, ishte diçka shumë e rëndësishme. Njohuritë e saja etnografike dhe aftësia e saj për t'u familjarizuar me kulturën popullore të shqiptarëve ishin mbase një nxitje për angazhim aq të fuqishëm. Neveria që ajo ndjente ndaj përpjekjeve sllave, sidomos ndaj sulmeve të egra malazeze e serbe, për t'i pushtuar trevat në fshatrat malore shqiptare, u jep përshkrimeve të saja një patos të fuqishëm dhe shpreh angazhimin e saj, sado që përpiqet t'i përmbahet tërë kohës kufijve të maturisë anglosaksone.

Krahasuar me përshkrimet e Durhamit, ato të Saksonit ishin krejt katastrofale. Me mburrje dhe vetësiguri ky farë “mbjellësi” përhapte mendime shoveniste greke mbi shqiptarët. Në anijen prej brigjeve italiane Brindisi drejt Greqisë, Saksoni kalon bregdetin shqiptar në prill të vitit 1914. Në udhëtim e sipër, hyn në bisedë me një zotëri të veshur në mënyrë evropiane me qëllim që të marrë të dhëna lidhur me disa njerëz të tjerë me veshje popullore, që ishin në të njëjtën anije.

- Janë epirotë, që dikur jetonin në Greqi e tash po kthehen në shtëpi për të përkrahur përpjekjet e vendit për ta hequr zgjedhën që ua kanë vënë Fuqitë e Mëdha, e informoi ai.

- A janë këto veshje tipike të popullatës së Epirit? – pyeti Saksoni.
- Mund të thuhet. Epirotët janë inteligjentë dhe të zotë, e janë të njohur sidomos si ndërtues të shkathët anijesh dhe tregtarë, u përgjigj ai.
- A do të mund t’ia dalin të mos bëhen shqiptarë?
- S’ka fije dyshimi. Se atëherë Fuqitë e Mëdha do ta bënin një marrëzi: për ta përmbush dëshirën e Austrisë që ta bllokojë daljen e Serbisë në det, do ta krijonin këtu një mbretëri; bashkimi i Epirit me Shqipërinë do të ishte gabimi më i madh. Shqiptarët janë në një nivel më të ultë kulturor se sa cilido qoftë popull tjetër në Evropë, kurse epirotët kanë një arsimim mjaft të mirë. Që këta të fundit të udhëhiqen nga të parët është e paimagjinueshme.

Në vazhdim të bisedës pranohet fakti se “patriotët grekë” i shkojnë në ndihmë Epirit, se qeveria greke qëndron në prapaskenë dhe i nxit përpjekjet epirotase që të bashkohen me Greqinë.

Saksoni e përfundon kapitullin me një frazë të gjatë, e cila e sforcoi atë neveri që Anders Vestini e kishte ndjerë para se ta largonte librin:

“Epirotët duan të bëhen grekë, gjë që unë e shoh si diçka krejt të natyrshme. Serbisë nuk do të mund t’i mohohet përgjithmonë e drejta e daljes në det dhe prandaj krejt natyrshëm ajo duhet ta marrë Shqipërinë, edhe nëse feudalët e mëdhenj muhamedanë të Shqipërisë së Mesme hidhen në kryengritje. Ata frikësohen nga fakti se nuk do të mund t’i trajtojnë vartësit sipas nevojave të tyre po qe se fshatarët serbë bëhen padronë këtu”.

Saksoni e kishte gëlltitur mesazhin nga ata që donin ta shkatërronin kombin shqiptar. Andersit i erdhi një e qeshur e hidhur, kur ai e ndryshoi thënien e urtë: “Më thuaj se me kënd rri, të të them se cili je”; duke e pasur parasysh qëllimin e “mbjellësit” të Saksonit, kjo thënie merrte një kuptim të ri: Më thuaj me kënd rri të të them se çka beson... Kjo, për fat të keq, duket më se e zakonshme për ata që kanë ndejtur te popuj të ndryshëm të Ballkanit.

Futja e Andersit në vorbullën politike

Më 1914 Andersi futet në Lidhjen e Rinisë Socialdemokrate. Që në fillim ishte ndierë skeptik ndaj udhëheqësit të kësaj lidhjeje, Per Albin Hanson, kjo nuk varej vetëm nga antipatia e një djaloshi të Stokholmit ndaj një të jugut të Suedisë, ose sikurse thuhej – ndaj skonezëve mendjemëdhenj... Ndërkaq, ndjente një afërsi me grupin rreth Set “Zeta” Høglund dhe gazetën “Stormklockan” (Kambana e stuhisë). Kundërthëniet ndërmjet të majtëve dhe të djathtëve në kuadër të Lidhjes së Rinisë bëri që Per Albin Hansoni shpejt të eliminohej me pretekstin se udhëheqja e rinisë bartej në Stokholm. Në vend të “Fram” (Përpara) që drejtohej nga P. A. Hansoni, “Stormklockan” u bë gazetë e Lidhjes.

Luftimet ndërmjet të rinjve radikalë socialistë dhe socialdemokratëve reformistë po bëheshin gjithnjë më të ashpra. Pas kongresit të Partisë socialdemokrate në shkurt të 1917 u bë e qartë se socialdemokracia suedeze ishte shkapërderdhur. Në maj të të njëjtit vit opozita e krijoi Partinë e majtë socialdemokrate, të cilës Anders Vestini, si anëtar i klubit të të rinjve “Revolta”, iu bashkangjiti që nga fillimi.

Për Andersin rruga që ai kishte zgjedhur ishte me rëndësi të madhe. I ati nuk ishte farë njeriu intolerant, por fakti se i biri mbante qëndrim kundër asaj partie ku ai bënte pjesë – nën udhëheqjen e Jalmar Brantingut – për disa dekada, ishte një goditje e fortë kundër tij. I biri që pozicionuar kundër qëndrimit të reformistëve socialdemokratë në çështjen e mbrojtjes, në çështjen e monarkisë dhe në problemet e përpjekjeve jashtëparlamentare. I ati, natyrisht, se e kishte kuptuar se udhëheqja partiake në krye me Brantingun paraqitej ndonjëherë në mënyrë oportuniste, mirëpo mendonte se fuqia

jashtëzakonisht e madhe e kundërshtarëve, e kapitalit, brenda dhe jashtë Suedisë, impononte kujdesin në paraqitje.

Pas disa grindjeve të ashpra me të atin, Andersi vendosi në dimrin e vitit 1917 të largohej nga shtëpia dhe të bashkëjetonte ekonomikisht me tre kolegë studimesh, të cilët po ashtu ishin socialistë të majtë. Ia dolën të gjenin një banesë të mirë në Hagalund, në pjesën e qytetit ku jetonin shumë punëtorë, e ku do të ambientohen shumë shpejt. Gjendja e tyre ekonomike ishte mjaft e keqe, mirëpo ia arritën që, gjatë vikendeve, të gjenin punë për të cilat nuk kërkohej farë kualifikimi; kjo punë, si dhe disa huazime të vogla bënë që grupi t'ia dilte ekonomikisht.

Andersi e takon një shqiptar

Në kongresin që Internacionalja e Dytë e mbajti në Stokholm në qershor 1917 Anders Vestini dhe shokët e tij nuk morën pjesë. Në këtë kongres u krijua një Komitet ruso-holandezo-skandinav, që kishte për detyrë të merrej me çështjen e paqes mu në kohën kur tashmë ishte duke u zhvilluar lufta. Në udhëheqjen e këtij komiteti ishte Jalmar Branting.

Njeriu që pesë vjet më parë kishte deklaruar se çështjet mbi “vetëqeverisjen e fiseve shqiptare” u përkisnin “çështjeve lokale të Ballkanit, pra se këto çështje ishin krejtësisht të dorës së dytë”, tani, pikërisht ky njeri, në mars të vitit 1918, do të kërkohet nga delegati i komitetit socialist shqiptar. Ky shqiptar që e kërkonte quhej Dhimitër Trajani, i cili Brantingut ia dorëzoi një apel në gjuhën frënge nga socialistët shqiptarë, e që i adresohet Komitetit ruso-holandezo-skandinav.

Përmes të atit Andersi mësoi për vizitën e mysafirit shqiptar në Stokholm. Qe shumë e lehtë të merrej kontakti me këtë shqiptar. Në një kafene në Stokholm Andersi u takua me Dhimitër Trajanin. Ishte një zotëri nga Shqipëria e jugut, i arsimuar dhe njohës i mirë gjuhësh, i arsimuar në Francë. Bashkërisht e lexuan tekstin e apelit që Trajani e kishte dorëzuar.

Apeli trajtonte sidomos gjendjen dëshpëruese në Shqipëri:

“Fati i Shqipërisë meriton nga kjo pikëpamje (nevoja për ndihmë – shënim i autorit) një vëmendje krejt të posaçme, dhe nisur nga kjo përfaqësuesit e Partisë Socialiste Shqiptare e marrin iniciativën që, në të mirë të lëvizjes, t’i drejtohen zyrtarisht Komitetit Socialist Ruso-Holandezo-Skandinav.

Historia e para luftës e Shqipërisë meriton që, në vija të trasha, të ngulitet në vetëdijen tonë.

Së pari është sundimi i pakufizuar më shumë se pesëqindvjeçar i turqve, kohë kjo e shtypjes së plotë të lirisë dhe vuajtjeve më të rënda morale. Më pas, bashkë me rënien e sulltan Abdul-Hamidit shfaqen ca rreze shprese. Xhonturqit, këta të magjepsur në dukje pas lirisë, a do të kuptonin se liria është e njëjtë për të gjithë, dhe a do të mendojnë për ta ndarë fitoren e tyre bashkë me kombet e vogla, të cilat kanë vuajtur nën regjimin e vjetër? Kështu besohej në fillim, porse kjo ishte një shpresë e rreme. Imperializmi i ri i Turqisë qe vetëm një vazhdim i atij të më hershmit. Kufiri i nënshtrimit pasiv kishte arritur fundin: tash i erdhi radha revolucionit shqiptar, menjëherë para Luftës ballkanike, dhe bashkë me të edhe arritja për herë të parë e pavarësisë.

Mirëpo kjo nuk ishte fundi i vuajtjeve. Gjatë Luftës së fundit ballkanike u zhvilluan luftime në territoret shqiptare, dhe janë të njohura sulmet e të gjitha llojeve që u bënë ndaj popullatës nga të dyja palët ndërluftuese. Më shumë se 35 fshatra u rrënuan dhe më shumë se 100 mijë njerëz, burra, gra e fëmijë, mbetën të gjymtuar. Në përfundimin e luftës iu pushtua Shqipërisë një e treta e trevave të saja nga fqinjët e pangopur.

Kështu erdhëm te koha e luftës evropiane. Megjithëse Shqipëria ishte njohur si shtet i pavarur nga Fuqitë Evropiane në Konferencën e Londrës dhe në Florencë në vitin 1913, prapëseprapë Shqipërisë iu cenuan territoret nga disa prej këtyre fuqive, një cenim që përcillej me shfrytëzim të të gjitha llojeve dhe që kishte pasoja katastrofale: përhapja e tifosë etj.

Këto janë faktet. Shqipëria e pavarur në praktikë ende është në zgjedhën e shtypjes. Liria e premtuar dhe e njohur ceremonialisht ishte vetëm një palaçllëk: liria nuk ekziston. Shqipëria nuk është e lirë.

Pasi që fuqitë shtypëse e kanë asgjësuar çdo mundësi për veprime të drejtpërdrejta, përpjekjet e Shqipërisë janë të shprehura në apelin urgjent drejtuar Mbrojtësve të Drejtësisë.

Përmes këtij manifesti Komiteti Shqiptar Socialist i lutet Komitetit Ruso-Holandezo-Skandinav që në mënyrë të posaçme t'i përkushtohet fatit të Shqipërisë dhe që nga tash të veprojë me pikësynim të realizimit të kërkesës së drejtë të kombit shqiptar: të rivendosen kufijtë si dhe pavarësia absolute pa asnjë formë të cenimit.

Komiteti shqiptar socialist vërteton pajtimin me parimin bazë të Internacionales socialiste: paqe e shpejtë e bazuar në të drejtën e popullit që të qeverisë veten e vet.

Delegati i Komitetit shqiptar socialist

Dimitri Trajani

Stokholm, 26 mars 1918".

Trajani u befasua nga njohuritë solide të këtij të riu suedez mbi vendin e tij. Andersi premtoi që në kuadër të Partisë së majtë socialdemokratike ta ngritë çështjen e përkrahjes së kërkesave të shqiptarëve, meqë apeli në fjalë jepte shkas të veçantë për këtë. Andersi nuk donte t'i bënte presion lidhur me bisedimet që kishte pasur me Brantingun. Do të jetë pranuar mirë, Brantingu do ta ketë dëgjuar dhe do të ketë mbajtur shënime. Deri këtu gjithçka ishte në rregull. Dhimitër Trajani i premtoi Andersit se do t'ia lente një kopje të manifestit, para se ai të vazhdonte udhëtimin e tij për në jug. Në takimin e ndarjes në stacionin e trenit në Stokholm Andersi e mori kopjen në duar, dhe me një ndjenjë të çuditshme të irealitetit e mori ngryk shokun shqiptar, kur ky po përgatitej të hipte në tren. "Mirë se vjen në Shqipërinë e lirë e të pavarur" ishin fjalët e fundit që Andersi i dëgjoi nga mysafiri shqiptar.

Afërsisht në të njëjtën kohë përmes shtypit u përhap një mesazh, që hidhte dritë të pamëshirshme ndaj asaj se ç'trajtim i kishin bërë Fuqitë e Mëdha popullit shqiptar. Pas revolucionit të tetorit, Lenini e nxori në shesh traktatin e fshehtë të 26 prillit 1915 që ishte bërë midis Italisë dhe Fuqive të Antantës – Anglisë, Francës dhe Rusisë. Italia kishte pranuar të dilte në anën e Antantës me kusht që anëtarët e saj t'i pranonin pretendimet italiane ndaj detit Adriatik dhe detit të Mesdheut.

Në traktat thuhej se pjesa veriore dhe lindore e Shqipërisë do t'i jepej Malit të Zi dhe Serbisë, Shqipëria e jugut Greqisë dhe një trekëndësh me qytetin e Vlorës si epiqendër do t'i jepej Italisë. Shqipëria e gjymtuar që mbetej në mes do të vihej nën protektoratin italian.

Implementimi i këtij traktati do të ishte goditje vdekjeprurëse për përpjekjet për Shqipërinë e pavarur. Një valë indinjate e kaploi Shqipërinë dhe vendbanimet shqiptare në mërgim. Në fakt, vetë bërja publike e kësaj pjese të ndyrë të veprimtimit donte të thoshte në aspektin strategjik një mbështetje e fuqishme për luftën e rivendosjes së kufijve shqiptarë. Me këtë nuk do të arrihej drejtësia e plotë, porse edhe shtetet fqinje të uritura për territore kishin marrë një qortim të ashpër moral.

Një bursë udhëtimi dhe pasojat e saj

Në vitin 1920, kur Evropa ende i mëkonte plagët e veta dhe përpiquej ta merrte veten pas tmerreve dhe rrënimeve të luftës, Anders Vestini, për çudinë e tij, e fitoi një bursë udhëtimi për studime në gjermanisht të lidhur me hulumtime në arkivat austriakë e gjermanë në kuadër të një lënde, të cilën kandidati mund ta zgjidhte vetë. Bë e gjetë për Andersin, me që kishte për qëllim që trajnimin e gjermanishtes në vende konkrete ta kombinonte me studimet ballkanike, për çka i ofronin mundësi sidomos arkivat austriake.

Në veprat shkencore mbi Shqipërinë dhe shqiptarët kishte hasur emrin e Holger Pedersenit, i cili i kishte kushtuar shumë vite studimit të gjuhës shqipe dhe parahistorisë së tyre. Holger Pedersen i qëmoti ishte profesor në universitetin e Kopenhagës me historinë e gjuhëve indoevropiane si specialitet.

Para se Andersi ta përgatiste planin e tij për studime, që ishte kusht për bursën, i shkroi një letër të gjatë profesor Pedersenit, ku i shprehte interesimin e tij për shqiptarët dhe nevojën e tij për kontakte me albanologë, para se gjithash në Gjermani dhe Austri, që lidheshin me udhëtimin e tij të ardhshëm. Përgjigja nuk u vonua. Profesori i dha një varg propozimesh të vlefshme lidhur me specialistët e gjuhës shqipe, që Andersi do të duhej t'i kërkonte gjatë udhëtimit të tij, si dhe i kishte dhënë informacione lidhur me arkivat dhe bibliotekat që mund të ishin të vlefshme për Andersin.

Profesor Pedersen i kishte dhënë edhe disa informacione interesante lidhur me udhëtimin që kishte bërë në Shqipërinë e jugut më 1893, ku, ndër të tjera, kishte mbledhur tregime popullore shqiptare e të cilat, më pas, i kishte botuar, së pari në shqip më 1895, e më pas në gjermanisht më 1898. Ishte treguar aq i dashur sa i kishte futur edhe një artikull, të cilin e kishte shkruar tre vjet më parë:

Mbi gjuhën shqipe

Shqipja është një gjuhë e llojit të veçantë, që nuk ka asgjë të ngjashme as me gjuhët sllave, greke, daneze e as me atë perse. Gjuha shqipe ka mundur të mbijetojë ndër shekuj vetëm falë forcës morale dhe vetëdijes së shqiptarëve. Shi për këtë, çdo mbështetje e depërtimit të shkollave të huaja dhe bashkësive të huaja kishtare në Shqipëri është njëlloj dacke në fytyrë ndaj këtij populli fisnik e të zgjuar.

Asnjë nga kundërshtimet që i bëhen gjuhës shqipe nuk janë të argumentuara mirë. Persona të ndryshëm shpesh kanë këmbëngulur se nuk do të mund të bëhet ndonjë bashkim gjuhësor në Shqipëri, dhe se dialektet veriore do të dalloheshin në mënyrë radikale prej atyre jugore, dhe mu për këtë do të ishte e pamundur njësimi i tyre. Por ky përfundim është krejt i gabuar. Dallimet midis dialekteve të gjuhës shqipe janë shumë më të vogla se sa dallimet ekuivalente në shumë gjuhë të tjera, dhe nga aspekti praktik këto dallime janë, në të vërtetë, pa ndonjë vlerë. Një i huaj, i cili e zotëron njërin nga këto dialekte shqiptare, nuk ka asfarë vështirësie për t'i kuptuar dialektet e tjera. Ato dallime, në disa raste më të theksuara, janë pasojë e mungesës së lidhjeve dhe komunikimeve. Rrënjët e dialekteve ndodhen në një tokë të përbashkët. Natyrisht se shqiptarët në gjendjen e tanishme janë të detyruar të përdorin dhe të shkruajnë në të dyja dialektet kryesore, mirëpo kjo nuk u nxjerr telashe të mëdha, sidomos jo po qe se shqiptarët do të kujdesen që gjeneratat e reja t'i përvetësojnë të dyja grupet gjuhësore dhe po qe se librat shkollorë hartohen duke e pasur këtë parasysh.

Ka disa që, ndër të tjera, pohojnë se shqipja nuk ka ndonjë ortografi të mirëfilltë. Kjo ishte e vërtetë para një dekade, por pas Kongresit të Manastirit më 1908 ortografia shqiptare ka qenë aq e pranuar sa edhe ekuivalentet në secilin vend tjetër.

Le të na lejohet tash të ngremë edhe një problem tjetër, që ka të bëjë me vërejtjet e disa personave gjoja me karakterin “e përzier” të gjuhës shqipe. Për fat të keq, më duhet ta them se gjuhëtari gjerman Gustav Majer ka pasur ndikim të madh në përhapjen e kësaj ideje. Në parathënien e fjalorit të tij etimologjik mbi gjuhën shqipe (1891), i paraqet disa të dhëna të gabuara mbi gjenezën e gjuhës shqipe. Meqë këto të dhëna janë përsëritur shpesh, janë të njohura nga një numër i madh i njerëzve, të cilët në rastet më të shumta nuk dinë gjë për gjuhën shqipe. Këta njerëz natyrisht nuk kanë ndonjë mundësi të shohin marrëdhëniet më interesante: se fjalët e huaja që ndodhen në fjalorin e Majerit janë shumë më të tepërta në numër se sa në realitet janë fjalët e huazuara që hasen në ndonjërin nga dialektet shqiptare. Vetëm në disa dialekte shqiptare janë hasur huazime fjalësh nga gjuhët e vendeve fqinje. Prandaj, fjalët e huazuara nga italishtja prej shqiptarëve që banojnë në Itali dhe ato të huazuara nga greqishtja prej shqiptarëve që banojnë në Greqi nuk kanë asgjë të përbashkët me fjalorin e përbashkët të shqipes. Të këtilla janë edhe fjalët e përfshira në fjalorin e Majerit dhe që janë llogaritur në statistikën e tij. Po ashtu kjo statistikë nuk shpreh asgjë lidhur me rëndësinë relative të këtyre fjalëve të huazuara.

Është e vërtetë se një pjesë e mirë e atyre fjalëve që kanë qenë në përdorim që nga periudhat e mëhershme janë me gjenezë romake, që vlen edhe për ca fjalë me gjenezë sllave ose greke, kurse ndikimi i elementit turk nuk është aq i rëndësishëm; porse të kundërtën pretendon fjalori i Majerit. Pjesa dërrmuese e fjalëve turke nuk kanë rrënjë të thella në gjuhën shqipe. Nuk ka kurrfarë arsye që të përdoren fjalët turke, të cilat mund të zëvendësohen, ose thjesht të hiqen fare nga gjuha shqipe. Pa fije dyshimi Majeri e ka gabim kur e jep atë numër fjalësh, që i përket gjenezës së bërthamës së gjuhës shqipe. Një studim i bërë lidhur me gjenezën e fjalëve tregon se ky numër i fjalëve do të duhej të ishte shumë më i madh. Fjalët që Majeri i trajton si fjalë të huazuara, fjalët të cilat sipas Majerit janë etimologjikisht të paqarta dhe fjalët të cilat Majeri i vë në dyshim është dëshmuar se janë fjalë autoktone, që i përkasin thesarit të fjalëve burimore të gjuhës shqipe. Për të ilustruar se si njohuritë tona zgjerohen mund të përmend se hulumtuesi i ri në albanologji, Dr. Norbert Jokl, në një nga artikujt e tij të shumtë (Studium zur albanischen Etymologi, Vjenë 1911) ka prezantuar më tepër se 100 fjalë rrënjësore, që bazohen në fjalët burimore të shqipes. Një revidim i të dhënave të Majerit, duke u nisur nga tërësia e fjalorit të shqipes, do të çonte në të njëjtin rezultat.

Secili njeri që ka njohuri nga përdorimi i gjallë i gjuhës shqipe dhe që ka njohuri shkencore për përbërjen e tyre nuk mund ta pranojë karakterizimin e saj si një “gjuhë e përzier”, si një konglomerat. Si të gjitha gjuhët e tjera në tokë edhe gjuha shqipe ka huazuar pak fjalë të huaja, të cilat kanë qenë objekt shndërrimesh të brendshme, në përputhje me strukturën e veçantë të gjuhës shqipe.

Dhe pikërisht për këtë gjuha shqipe vazhdon të jetë e bukur dhe e fuqishme. Një gjuhë që është krenari e shqiptarëve dhe një armë e pamposhtur për zhvillimin intelektual dhe kulturor të kombit të vjetër shqiptar.

Holger Pedersen, tetor 1917”.

Baroni Franz Nopça dhe disa albanologë të tjerë

Kishte tre ditë që kur Anders Vestini kishte mbërritur në Vjenë. Ishte verë, por me gjithë stinën e hareshme hetohej një tipar i errët në jetën shoqërore, nga që rënia e fuqisë së madhe të Habsburgëve të Austrisë e kishte reduktuar Vjenën në një qytet të madh të një shteti mjaft të parëndësishëm. Të papunët endeshin rrugëve dhe një plogështi e përgjithshme binte në sy. E Andersi duhej të kërkonte dhe të njihej me institucionet shkencore, që do të mund ta ndihmonin atë në studimet e tij, gjë të cilën e

arriti me lehtësi, sado që shpesh e çonin këmbët në pijetore birrash e verërash kur pluhuri i arkivit e bënte të ndjehej shumë i etur.

Kësaj here befaz e ndaluan në recepcion me fjalët: “Është një zotëri që dëshiron të flasë me dr. Vestin”. Sikur Andersi të mos ishte mësuar me inflacionin e titujve do të skuqej kur të ishte quajtur doktor, apo profesor, siç ishte titulluar disa herë më parë, ndonëse i kishte vetëm 25 vite dhe dukej shumë i ri dhe i padjallëzuar.

Ishte baroni hungarez Franz Nopça që kishte marrë mundin të merrte trenin prej Budapestit për të takuar këtë suedez të ri. Një letër të shkurtër, por me respekt të theksuar e kishte marrë Andersi nga ai pak para nisjes, dhe atëherë e kishte njohtuar hulumtuesin hungarez me të dhënat për kohën dhe vendin e takimit.

Baron Nopça ishte rreth njëzet vjet më i vjetër se sa Andersi, por dukej i fortë dhe i shëndetshëm. Teni i fytyrës së tij tregonte se shumë nga hulumtimet e tij ishin zhvilluar jashtë shtëpisë. E ai në radhë të parë ishte gjeolog, dhe në endjet e tij, më këmbë ose në shpinë kali, kishte arritur në Shqipëri që në moshën 20-vjeçare e ku do të qëndronte herë më gjatë e herë më shkurtë gjatë vizitave të shumta. Vetëm ato vitet e gjendjes kaotike gjatë luftës e kishin penguar atë në punën e tij hulumtuese, punë kjo që përfshinte si etnografinë poashtu edhe edhe kulturën gjeografike.

Baroni ishte një mik i zjarrtë i popullit shqiptar, njëlloj si edhe profesori Pedersen, dhe në të dyja rastet kjo miqësi kishte bazën në miqësinë me shqiptarët nga vizitat e bëra në vendin e tyre. Ishte mjaft interesante fakti se të dy hulumtuesit kishin përvoja, secili nisur prej qëllimeve të tyre, me vendbanimet shqiptare. Pikërisht banorët e malësisë së Shqipërisë veriore i përkisnin me siguri popullatës së lashtë që njeriu mund të gjente në Evropë, që kishte ngelur i pandikuar nga bota e jashtme për shkak të izolimit gjeografik dhe social. Sundimi otoman nuk ia kishte arritur asnjëherë t'i nënshtronte këta malësorë dhe, për shkak të varfërisë së tyre dhe paarritshmërisë ishin jointeressantë si objekt tatimi, prandaj Porta e Lartë në pjesën më të madhe i kishte lënë të qetë.

Lidhur me këtë baron Nopça tregoi gjatë dhe bukur, dhe kur ai e pa se studenti suedez kishte një interesim serioz për studime shqiptare i rekomandoi atij që të njihej me një dorëshkrim që ai e kishte shkruar dhe që ruhej në Bibliotekën Nacionale të Vjenës. Ishte një përshkrim i Shqipërisë dhe i shqiptarëve që Nopça e kishte shkruar më 1913, por që nuk ishte publikuar. Kishte qenë aq xhentil sa t'i shkruante një rekomandim bibliotekës që t'ia lente dorëshkrimin në dispozicion studentit suedez.

Gjatë qëndrimit të tij në Vjenë Andersi u takua edhe me dy albanologë të tjerë: Maksimilian Lamperc dhe Norbert Jokl. I pari kishte derdhur shumë mund në krahasimin e dialekteve të ndryshme shqiptare dhe kishte njohuri të mëdha në shqipen e vjetër e cila flitej te të ashtuquajturit arbëreshë në jug të Italisë dhe në Sicili. Ky kishte bërë udhëtime të shpeshta edhe gjatë viteve të luftës, dhe kishte marrë pjesë në punën e Komisionit letrar shqiptar që kishte vepruar në Shkodër gjatë okupacionit austriak më 1916. Ky komision e kishte për detyrë që t'i përcaktonte orientimet për një gjuhë të njësuar shqipe dhe të përcaktonte terminologjinë shqiptare në kuadër të fushave të ndryshme të civilizimit modern. Lamperci ka mbledhur edhe poezi popullore dhe përralla popullore, të cilat pjesërisht kishte arritur t'i botonte. Ndërsa Jokli, një bibliotekar në bibliotekën universitare të Vjenës, për dallim nga Nopça dhe Lamperci, ishte me kulturë sallonesh. Interesimi i tij i veçantë ishte etimologjia shqiptare dhe fjalëformimi, lidhja e gjuhës shqipe me gjuhët tjera si dhe fonetika dhe morfologjia shqiptare.

Andersi nuk ishte i përgatitur të thellohej në studimet e gjuhës shqipe, meqë ishte i angazhuar me frëngjishten dhe gjermanishten, e kohëve të fundit kishte filluar të mësonte edhe rusisht duke pasur parasysh kontaktet me Rusinë socialiste, që dëshironte

t'i zhvillonte edhe më. Porse ishin shumë çështje interesante dhe tërheqëse lidhur me gjuhën shqipe që nxori në dritë, para se gjithash Lamberci, që kishte përvojën më të gjithanshme me shqiptarët dhe që i dha atij impulset më të mira për të vazhduar studimet dhe përshkrimet më të gjalla të jetës shqiptare. Jokli ishte një natyrë më e mbyllur, me prejardhje hebreje, dhe ishte më i dhënë pas diskutimeve lidhur me problemet më të mprehta dhe kritike linguistike. Lamberci ishte një mbledhës tipik i diturisë prej të gjitha anëve sa i përket shqipes, por si klasifikues ishte mjaft i varfër. As ndonjë farë pedagogu nuk ishte, dhe mund të bëhej mjaft i mërzitshëm për ta dëgjuar, pasi që me entuziazmin e tij zgjerohej dhe bluante deri në pafundësi, dhe krejt befas hidhej në një çështje të re, ku po ashtu ishte fjalëshumë dhe i stërzgjatur. Por për ndokend që mund ta dëgjonte dhe kishte aftësi ta ndiqte, mund të mësonte shumë nga ai.

Ditët e fundit në Vjenë Andersi i shfrytëzoi për ta përpunuar manuskriptin e Nopças. Rrinte me ditë të tëra në Bibliotekën Nacionale dhe mbante shënime ato që i dukeshin më së shumti interesante. Kur u kthye në shtëpi këto shënime i përdori në serinë e ligjëratave me temën "Popujt e panjohur të botës", të organizuar nga Shoqata për mbajtjen e ligjëratave në Stokholm.

Anders Vestini nuk do të mund të merrej në vazhdim aktivisht me çështjet e shqiptarëve dhe kulturën e tyre, sepse krijoi familje, dhe duhej t'u jepte përparësi çështjeve ekzistenciale. Kjo vlente sidomos në vitet e vështira të depresionit në fillim të viteve të 30-ta. Mirëpo në ditët e pleqërisë, kur vajza e djalit të tij Sara kishte filluar të shfaqte interesim për kulturën shqiptare, Andersi do të shfletonte dosjen me dokumente të vjetra nga angazhimi i tij i hershëm për shqiptarët dhe e gjeti edhe punimin e Nopças. Habitej se si ende kaq shumë ato përputheshin me vëzhgimet e tij personale, ani se kishin kaluar më se gjashtëdhjetë vjet që kur Nopça kishte jetuar në mesin e shqiptarëve dhe atëherë, për më tepër, Andersi nuk kishte pasur thuaja rastin fare të njihej me malësorët e vërtetë në Shqipërinë e veriut, që kishin ruajtur më shumë tipare të lashta krahasur me banorët e fushave. Por ende tiparet themelore ishin ruajtur në karakter për të mirë e për të keq, mendoi Andersi.

MË SHUMË HEROIZMA SE SA GRURË

Netët e gjata e të ashpra dimërore në malësinë e Shqipërisë veriore i mblidhnin njerëzit e shtëpisë dhe mysafirët, që vinin nga rrethi ose nga rrugë të gjata, në konakun e shtruar me shilte dhe jastëk. Njeriu mund të ulej në to ose në trapazan, lloj bankash të kapura për muri. Gratë, si rregull, nuk rrinin bashkë me burrat, kurse fëmijët dëgjonin syhapur tregimet e të vjetërve. Rast i paharrueshëm ishte kur ndodhte që ndonjë rapsod, një lloj këngëtar shëtitës, të vinte për vizitë në shtëpi. Një rapsod i shkathët dinte me mijëra vargje, ku këndoheshin aktet heroike të trimave shqiptarë. Kështu kalonte mbrëmja në kullë – një shtëpi, e cila njëherësh ishte edhe një fortesë mbrojtëse me frëngji të vogla; e fëmijët do të shënonin mirë në kujtesë gjithë ç’dëgjonin. Këngë pas kënge kushtuar trimërisë, dhe kështu krijohet një klimë shpirtërore, ku virtytet tradicionale si besa, nderi, burrëria do të forcoheshin edhe më dhe do të përcilleshin nga brezi në brez.

Pra, pikërisht ashtu sikurse Ismail Kadare e ka theksuar në poemën e tij “*Përse mendohen këto male*”, toka shqiptare ka dhënë më shumë heroizma se sa grurë.

Në vazhdim do të njihemi me këngët më të rëndësishme të trimërisë, legjenda këto të kthyer në prozë. Mitrush Kuteli, alias Dhimitër Pashko, është autori i teksteve, të cilat përbëjnë bazën e përshkrimeve që do të prezantohen këtu. Për nevojat e shkollës së të rinjve shqiptarë ai e ka hartuar librin “*Tregime të moçme shqiptare*” (Tiranë 1965; 1987).

Këto këngë heronjsh janë shumë, shumë të moçme. Balada e Rozafës i ka paralelet e veta nga këngët prej Elbasani dhe Berati; këngët për gratë që murosën në themelet e urave rrëfohen në formë të njëjtë edhe në Gjakovë (Kosovë), Artë (Greqi) dhe vende të tjera të Ballkanit. – Kënga e Konstandinit dhe Doruntinës është variant që njihet prej vendbanimeve shqiptare, përkatësisht fshatrave arbëreshe në Italinë e jugut, dhe kjo mund të datohet ndokund në mesjetë. Por ka edhe një variant tjetër me elemente të fuqishme islamike, gjeneza e të cilës është shumë e lashtë: Kënga e Halil Garrisë, si dhe një këngë tjetër, Balada e Dhoqinës me motiv nga Shqipëria e jugut.

Balada e Gjergj Elez Alisë ka tipare të përbashkëta me legjendën suedeze kushtuar Shën Goranit dhe kulshedrës (Georg – Gjergj – Göran), që është një motiv i përhapur gjerësisht. Është e pamundur të thuhet me saktësi se çka është me origjinë shqiptare e çka është huazim, e ajo që dihet është se motivi vjen nga fiset perse dhe mitet armene, të cilat më pas janë përvetësuar nga kisha katolike. Tradita shqiptare mbi Gjergj Elez Alinë përfshihet si cikël i veçantë në kuadër të Këngëve Kreshnike dhe ka hulumtues që përmbajtjen e versionit shqiptar e nxjerrin nga luftërat kundër normandëve ose venedikasve në mesjetën e hershme. Gjatë kohës kur po punoja në përkthimin në suedisht të Këngës mbi Gjergj Elez Alinë, si shumë herë më parë edhe kësaj here, më ra në sy ngjashmëria me gjendjen e tashme:

Gjergj Elez Alia ka luftuar kundër shumë armiqve. Për nëntë vjet ai ka qenë i shtrirë në shtrat, si i paralizuar, nga plagët e marra në ato luftëra të shumta. Mirëpo, kur shfaqet një armik i tmerrshëm i cili po e shkatërronte vendin dhe kur Gjergji e kupton këtë që po ndodhte, atëherë ngrihet prej shtratit, i del për ballë armikut të egër dhe e mundë atë.

Në këtë kapitull prezantohet kjo këngë, në formën e legjendave në prozë. Është një përjetim i veçantë t’i dëgjosh ato të paraqitura në formën e tyre origjinale, nga një rapsod që këndon në telin e lahutës, një lloj violine e lashtë me një tel të vetëm. Bukuria e veçantë e vargjeve ceremoniale stoike është një jehonë nga mesjeta në Evropën moderne. Është një jehonë e fundit, ende e gjallë, nga një traditë në vdekje e sipër...

Nga ky mit historik t'i kthehemi kohës sonë: Për nëntë vite, 1989 – 1997, shqiptarët e Kosovës ishin si të paralizuar, meqë serbët i kishin mohuar dhe suprimuar të drejtat e tyre të mëhershme. Por kur armiku më në fund provoi që përfundimisht t'i qërojë hesapet me shqiptarët atëherë u krijua Ushtria Çlirimtare e Kosovës – UÇK, e cila luftoi kundër pushtimit. Dhe epilogun e dimë: kulshedra u mund, pasi që nëntë vite ishte munduar të shuante shqiptarët. A thua, është kjo vetëm një rastësi apo shqiptarët kanë provuar prapë ta sendërtojnë mitin e lashtë historik?...

Një gjë, sidoqoftë, është e sigurt: Këngët si ato për Konstandinin e Doruntinën dhe për Gjergj Elez Alinë i kanë mësuar shqiptarët se nuk ka ndonjë gjë që është e pamundur për vullnetin njerëzor. Se asgjë nuk mund ta pengojë mbrojtjen e nderit, sedrës dhe atdheut. Është po ai mentalitet që ne hasim në parimin holandez për lundrimin: *Navigare necesse est, vivere non* – Të lundrosh është e domosdoshme, të jetosh jo...

Pjesa dërrmuese e Këngëve të moçme përbëhen nga baladat për Mujin e Halilin, dhe këto, me pak variacione por me përmbajtje të njëjtë, janë shumë të shpërndara dhe të njohura edhe te sllavët e jugut. Ato që unë në tekste i quaj “älvor” (shtojzovalle) shqiptarët i quajnë zana – porse te varianti sllav i vullnetit është më i njohur përmes Viljasängen suedisht – Vilja është zana e sllavëve. Kjo këngë është e popullarizuar përmes një operete të Leharit. Zanat janë ca çupëza mali, me pak ngjashmëri me shtojzovallet dhe sirenat tona, por pa njollat morale të këtyre të fundit.

Kristë Maloki (1900 – 1972), që në këtë kapitull na rrëfen për Shpirtin shqiptar, ky ishte i lindur në Prizren (Kosovë); herët kishte ardhur në Austri ku mori titullin edhe doktor i filozofisë e edhe doktor i drejtësisë, kishte punuar në Grac, edhe si jurist në Akademinë e Tregtisë e në Universitet si profesor i Letërsisë Shqiptare dhe asaj të Ballkanit. Në një artikull tjetër ai rrëfen se si e ka vizituar Shqipërinë socialiste, ku kishte përjetuar shumëçka që atij nuk i kishte pëlqyer. Gënjeshtër, falsifikime dhe justifikime përbënin elemente të natyrshme në arsenalin komunist, të cilat Maloki me njohuritë e tij solide që i posedonte i kishte kuptuar dhe me një zgjuarsiri thumbuese ua kishte bërë të qartë nikoqirëve se ai nuk ishte mashtruar nga të pavërtetat e tyre.

Pas vizitës në Shqipëri, më 1962, shkroi një artikull, që u botua më vonë në gazetën e mërgimtarëve “Dielli”, që botohet në Boston. Për komunistët kishte për të thënë sa vijon:

“Kemi konstatue si në Jugosllavi ashtu në Shqipëri se ka komunistat të të gjitha llojeve: komunistat katërqind derhemësh dhe komunistat sa për sy e faqe; komunistat të rranjosur filozofikisht me Materializmin Historik të Marksit e t’ Engelsit, por edhe komunistat më fortë idealistat e spiritualistat – horrible dictu - të Platonit e të Tolstoit; ka mandej komunistat fare internacionalistat (revizionistë trozkist), por fare nacionalistat; këndej më fort individualistat apo t’ aparatit (APARATSHKI) andej më fort individualistë monoambulant e deri bohemë me tendenca t’eksistencializmit nëmos të surrealizmit. Shka lëviz mandej ndërmjet njatyne polariteteve ideologjike e botkuptimore janë turmat e popullit më fort indiferent që i pranojnë symbyllas me përvujtnin e herëshme religjioze formulat, dogmat, “kallepet” dhe litanijet e importueme nga vende të hueja dhe popuj heterogjen, të njasaj ideologjie që quhet marksiste leniniste; sa për oportunistat oriental e pehlivanat ideologjike më mirë s’po flasim sot”

Dhe Kristë Maloki shton:

“Moskoordinimi i ideologjis marksiste-leniniste me botkuptimin e vërtet të Popullit e të Kombit Shqiptar i ka shkaktue rregjimit të sotshëm sa e sa zorime të panevojshme mbrenda e jashta Shqipërisë, sa e sa interferenca, kontradikta e tensione të ndieshme për

gjithë lamijet e veprimit shtetnor: në politikën e jashtëme, në jetën shoqërore të përbrendëshme, në rregullimin e ekonomisë nacionale e deri në fushën e kulturës”.

Dhe së fundi, Maloki e shpreh kredon e vet si shqiptar dhe si kosovar:

“Gjithë jeta e jeme ka kaluar pa u përzier as në politikën e Shtetit Shqiptar e as të ndonji shteti tjetër, due me thanë s’kam marrë pjesë kurrë as ndër aventura të ndonji politikani ambicioz e as të ndonjë klike e grupi politik me interesa personale, lokale, regjionale e edhe partijake. Prandaj as kam kërkuar – a pranuar – kurrë as pozitë, as mandate e as dekorata e as “shpërblime”. Për mua – si kosovar – i gjakut shqiptar dhe si humanitar i kulturës oksidentale- ka vetëm një politikë: politikën e Kombit Shqiptar, d.m.th. të njati etni historik, kulturor e moral që i përmbledhë në veditë të gjithë Shqiptarët e vërtet, kudo qofshin në botë. Dhe ky qëndrim i em bazohet më shumë mbi një botëkuptim që më ka pushtuar qysh nga rinia e ime dhe që mund të kuptohet vetëm nëpër filozofin e Aristotelit: en gar o holon anaghaikon proteron tou meroues, shqip: Totaliteti është më tepër – është më i vlefshëm – se të gjithë pjesët e tij. Totaliteti i jem është Kombi Shqiptar dhe Shqipëria, vetëm një pjesë e tij. Për mua si Kosovari, ndoshta pjesa kryesore. Shqipëria e 1913 për mua më fort – shkodranisht – është një vend drejtë a më mirë vend haram e vend vakuf: I mallkuem nga DJALLI por i bekuem nga ZOTI: Si i mallkuem nga Djalli ka për të qenë gjithmonë objekt grindjesh, gryksinash e inatesh... personale, lokale e internacionale; i bekuem prej Zotit sepse çdo dorë grabitqare që në ‘te digjet, shkrumbohet e cunohet për të zezën e vetë”.

Në mungesë të bukës shqiptari përtypte legjendat e tij. Teksti i Kristës Malokit për shpirtin shqiptar, cili do të jepet më poshtë, mbase mund të duket një çikë si tepër i idealizuar dhe i demoduar për një lexues të kohës sonë. Jan Myrdali me të drejtë ka theksuar se nga mënyra e të shprehurit intelektual shqiptar përjetohet një jehonë e idealit të Bashkimit Gotik, dyqind vite më parë kur skandinavizmi ishte në zhvillim e sipër. Për mua ka qenë një imperativ për ta përfshirë edhe tekstin e Kristës Malokit; sepse pa i kuptuar ato ideale, që i kanë karakterizuar shqiptarët dhe që edhe tash janë aktuale, sa hapur e sa fshehurazi, nuk mund të kuptohet thuhet asgjë nga mentaliteti shqiptar. Mitet – ato që kanë mundur të jenë një realitet dhe që ndjehen aq fuqishëm dhe të vërteta si të ishin reale – janë një pjesë tipike e shpirtit ballkanas, për të mirë e për të keq. Prandaj nuk i kam evituar aspektet patetike, romantike dhe melodramatike. Çdo kulturë e çdo shoqëri duhet të vlerësohet duke pasur parasysh përmbajtjen e tyre faktike.

Fuqia në idealet shqiptare nuk mund të vihet në dyshim. Megjithatë duket groteske, gjakmarrja të shqiptarët në kohët e lashta nuk ka pasur për bazë urrejtin dhe etjen për vrasje, por ndjenjën e nderit. Ekzistenca e saj ka qenë, natyrisht, e lidhur me faktin se drejtësia shtetërore ose nuk është ushtruar fare në vend ose nuk është pranuar nga njerëzit. Kjo drejtësi administrative ndër shekuj ka qenë në duart e turqve, serbëve dhe forcave të tjera të huaja për shqiptarët. E dihet se faktikisht edhe pasi të jetë zhdukur ideologjia dhe kushtet materiale për një traditë, ajo mund të jetojë edhe më tutje, përmes bllokimit të mentalitetit individual dhe mungesës së vullnetit për t’i pranuar ndryshimet. E pa bazë reale në kërkesat morale ajo bëhet reaktive. Mund të jetë edhe një e dhënë interesante të hetohet se çfarë pikëtakimesh dhe kundërthëniesh të pakalueshme ekzistojnë midis idealeve shqiptare tradicionale, idealet e Shqipërisë socialiste dhe idealeve të shoqërisë moderne kapitaliste konsumuese. Mendimi im është se ato fuqi të cilat kanë ndikuar te shqiptarët kanë qenë kundërthënëse, sa që kanë krijuar një gjendje skizofrenike. Ky mendim më duket se vërtetohet nga kolapsi moralo-ekonomiko-social në Shqipërinë e 1990-tës. Morali tradicional i shoqërisë ekzistonte vetëm në formë të fshehur apo të bastarduar, morali socialist nuk e mbijetoi shoqërinë moniste, meqë ishte si kapak për tenxhere vetëm për atë shoqëri; ndërkohë që shoqëria

konsumatore, në mënyrë të beftë hidhet mbi njerëzit, në fillim shkakton vetëm një huti morale dhe sociale.

Le të kthehemi te fshati malor shqiptar: Traditat e tij thoshin se besnikëria, nderi dhe burrëria ishin më të rëndësishme se vetë jeta. Nëse nuk ka asgjë tjetër, atëherë njeriu mund të mbahet për virtytet e tij, meqë ashtu ai vdes vetëm si individ, kurse virtytet nuk vdesin kurrë.

Kristë Maloki: Shpirti i Shqiptarit (marrë nga gazeta Bota Shqiptare 1943)⁹

Në visarin gjuhësuer t'onin kemi tri fjalë, të cilat, sikur "Heim" i Gjermanëve, "gentleman" i Englezëve, me të vështirë përkthehen në gjuhët të tjera. Këto janë: "Besa", "Ndera" e "Burrnija"¹⁰.

"Besa" në gjuhë e në zemër të Shqiptarit përfshin fjalën e dhanun e të mbajtur, armëpushimin, besnikinë, paprekëninë, nderën e sa e sa të tjera, që s'është nevoja t'i rendojmë, mbassi mâ parë e mâ lehtas i kuptojmë se i numërojmë. Babat t'onë, kur jepshin a lidhshin besë në mjes njeni-tjetrit a me kedó të huej, mik a anmik nënkuptojshin një lidhje me të tana rrethanat, të cilën e mbajshin me të tanë fuqit'e veta e të robvet të vet; po t'ishte nevoja shkriheshin me pasuni, rob e robi për mos me e thye atë besë, kështu që ishin të zotë për "besë të dhanun" me humbë gjithshka, edhe jetën, por besën mos m'e thye.

Fuqija morale e therorisë dhe e vetmohimit që përmbledhen me fjalën "Besë" me të vështirë kuptohen prej kujdohit, e mâ me të vështirë mund të gjinden më ndonji popull, që t'i dallojë në këtë mënyrë si populli shqiptar.

"Ndera" e "ërzy" për Shqiptarin është gjithshka mund të jetë mâ e madhe e mâ e çmueshme mbi faqe të tokës. "Aj, të cilit i mirret ndera, është i dekun mbas Kanunit". Me fjalën "nderë" Shqiptari nënkupton jo vetëm largimin prej shka ka të përpjekun me flligshiti, por gjithshka i siell nderim faqe të tjerëvet dhe ja nalton çmimin dinjitetit personal të tij.

Fjala "nderë" përmbledh në shpirt të Shqiptarit një sumë ndiesish të veçanta, të cilat kanë lidhni me gjithshka e rrethon e i përket atij drejt për drejt a terthoras: person, familje, gjak e gjini, votër e vend-lindje e sidomos doket e të parevet. "Dy gisht nderë në lule të ballit na i njiti Zoti i Madh".

Shqiptari e njëj vedin për nderëhupun a të koritun, në qoftë se i thotë kush se rren faqe burravet në kuvend, në qoftë se e pështyn, i matet, e shtyn a i bie kush; në qoftë se ja prish ndërmjetësinë a ja thyen besën, ja dhunon gruen a e ban me hikun, ja marron (turpëron) armët e krahit a të brezit; në qoftë se ja dhunon buken tue ja nga mikun a puntorin; në qoftë se thyen shtëpinë, vathin, kotecin, a çarranikun n'oborr; në qoftë se ja ndalin uhan a detyrën, ja luejnë rrasen e vegshit në votër, ja marrin rendin e të lames së duervet, kur ulet me hangër më ndonji darsëm a festë, mort, etj.

Në nderë e gjëjmë rrâzën e asaj ngjitjeje të pashmangun të Shqiptarit për të rrujtë doket e të parëvet e të gjuhës. Mâ se dy mij vjet stuhí e krajata kalojnë, kamba e ushtrivet të panumërta të popujve të ndryshëm shklet e përshkohet në këtë tokë shqiptare, lufta mizore, rrenon ç'mos, zgjedha e robnija e pamëshirshëme randon mbi krye të Shqiptarit, e megjithë këtë Shqiptari gjatë këtyne njizet e mâ shekujve ruen karakter, doke e gjuhë. Çdo gjâ të huej që gjejmë në gjuhën t'onë është transformue e njëshë aqë fort me shqipen, sa vetëm ndonji hulmëtues i hollë mund t'ja gjëjë rrjedhën a burimin.

⁹ Sipas origjinalit.

¹⁰ Është me rëndësi të bëhet e ditur për lexuesin shqiptar se fjalët besa, ndera e erzi, burrnija dhe trimni Ulmar Kvikun i përdor në origjinal, domethënë në shqip në tekstin e tij në suedisht.

“Burrnija” është një fjalë së cilës i njihet rrjedha pa të vështirë: del prej fjalës b u r r ë – i. Por kjo fjalë në gjuhë t’one ka një veshtrim aqë të hapun, sa është jeta dhe të përpjekunit e tij me shka e rrethon. Vetëm tue vrojtë përshëndetjen kryesore të Shqiptarit malsuer: a je b u r r ë! Nji psikolog i hollë gjen krejt shprehjen e dinjitetit njerëzuer. Kjo përshëndetje përkthye ndër gjuhë të gjalla a të dekuna, del e paveshtim e qesharake, por Shqiptari përmbledhë në të krejt shka mund të ketë e shka mund të veprojë mashkulli: vullndesë, guxim, qindresë, bujari e çdo virtyt që e plotson shpirtnisht e njerëzisht.

Burrnija nuk kallzon vetëm sjelljen e jashtme për ball t’anmikut; për këtë kemi fjalën t r i m n í. Burrnija difton zotnimin e vetvedit, nderimin për nder të vet e të tjerëvet, qetësin’e duresën ndër të paprituna e rreziqe, papërkulninë e pathyeshminë kundrejt të mitosunash. Për Shqiptarin është burrni me mbetë në luftë, me i dalë zot atij që i bie ndorë, me mprojtë të drejtat e veta dhe të shoqit, me falë anmikun, mos me ja xanë frymën të ligshtit, kur ja rrëfen ligshтин’e vet, me pritë e me përcjellë miq, me dalë në kushtrim për çdo rasë që ka nevojë shoqi, lagja, katundi, bajraku etj.

Vetëm burrnija e shtyni Shqiptarin e vërtetë me zgjedhë për banesë të vet e me kalue jetën vorfnisht ndër shpella të malevet e curra të thepisuna mâ parë se me ja sjellë shpinën virtytevet të të parëvet e me fitue plang e pasuni, sikur i zotohej pushtuesi anadollak.

Prap, burrnija e bani Shqiptarin guximtar me ja hi e me i dalë në krye disa punëve të kapërthyeshme e gadi të pamrrijshe, si ajo e ngrehjes së dinastis së Misirit prej një tregtarit shqiptar; si punimi i një Krispi shqiptar për bashkimin e Shtetit italian; të mkambunit e Turqisë së re prej një Shqiptari; e n’Austri një Karlo Gega Shqiptar ja del me zgjidhë problemin aqë të vështirë të hekurudhës së Semeringut”.

Rrëfejza nga “Tregime të moçme shqiptare” të Mitrush Kutelit

1. Rozafati

Krenare ngrihet mbi Bunën e gjerë e mbi qytetin e Shkodrës kështjella e lashtë e Rozafatit.

Kur është hedhur guri i parë në themelet e kësaj kështjelle? S’dihet. Historia e saj humbet në mjegullën e lashtësisë ilire, banorët e moçëm të kësaj mënge.

Një gjë dihet mirë e qartë: atë e kanë pasur dikur labeatët dhe pastaj ardianët, që ishin fise të forta ilire. Në atë kohë tërë bregu i këtejshëm i Adriatikut, gjer në Tergestën e bujshme apo Triestën e ditëve tona, ishte breg ilir. Më vonë u derdhën këtej romakët, pastaj sllavët, normanët, venetikët, turqit e shumë popuj të tjerë të huaj. Gjatë shekujve ata krepat e thatë nën muret e Rozafatit, si edhe vetë muret e kështjellës, janë lagur me përrenj gjaku prej atyre që e kanë sulmuar dhe të atyre që e kanë mbrojtur. Të huajt erdhën e shkuan, kurse populli ynë mbeti ngulur në këtë tokë ilire.

Ndërtimi i kështjellës së Rozafatit ka një gojëdhënë të bukur e të hidhur që na ka ardhur nga lashtësia jonë.

Ja se ç’thotë kjo gojëdhënë:

... I ra mjegulla Bunës dhe e mbuloi të tërë. Kjo mjegull mbeti aty tri ditë e tri netë. Pas tri ditësh e pas tri netësh fryu një erë e hollë dhe e largoi mjegullën. E lartoi dhe e shpuri gjer në kodrën e Valdanuzit. Aty majë kodrës punonin tre vëllezër. Ndërtonin një kështjellë. Muri, që e bënë ditën, u prishej natën dhe kështu nuk e lartnin dot..

Na shkon aty një plak i mirë.

- Puna e mbarë, o tre vëllezër!

- Të mbarë paç, o plak i mirë! Po ku e sheh ti të mbarën tonë? Ditën punojmë, natën shembet. A di ti të na thuash ndonjë fjalë të mirë: ç'të bëjmë që t'i mbajmë muret më këmbë?

- Unë e di, - u thotë plaku, - po e kam për mëkatë t'jua them.

- Atë mëkatë hidhe mbi kryet tonë, se ne duam që ta qëndrojmë më këmbë këtë kështjellë.

Plaku i mirë mendohet e pyet:

- A jeni të martuar, o trima? A kini ju të tre vashat tuaja?

- Të martuar jemi, - i thonë ata. – Edhe të tre i kemi vashat tona. Na thuaj pra ç'të bëjmë që ta qëndrojmë këtë kështjellë.

- Nëse doni ta qëndroni, lidhuni me besa-besë: vashave mos u rrëfeni, në shtëpi mos kuvendoni për fjalët që do t'ju them unë. Atë nga të tri kunatat, që do të vijë nesër t'ju sjellë bukën, ta merrni e ta muroni të gjallë në mur të kështjellës. Atëherë kini për të parë se muri do të zërë vend e do të qëndrojë për jetë e mot.

Tha kështu plaku e shkoi: tani u pa, pastaj s'u pa.

Vaj! Vëllai i madh e shkeli besën e fjalën. Kuvendoi në shtëpi, i tregoi vashës së vet kështu e kështu, i tha të mos vinte atje të nesërmen. Edhe i mesmi e shkeli besën e fjalën: i tregoi të gjitha vashës së vet. Vetëm i vogli e mbajti besën e fjalën: nuk kuvendoi në shtëpi, nuk i tregoi vashës së vet.

Në mëngjes, ata të tre ngrihen shpejt e shkojnë në punë. Çekanët godasin, gurët copëtohen, zemrat rrahin, muret lartohen...

Në shtëpi, nëna e djemve s'di gjë. I thotë së madhes:

- Moj nuse e madhe, mjeshtrit duan bukë e ujë, duan kungullin me verë.

Nusja e madhe ia kthen:

- Besa, nënë, sot s'mund të shkoj, se jam sëmurë.

Kthehet e i thotë së mesmes:

- Moj nusja e mesme, mjeshtrit duan bukë e ujë, duan kungullin me verë.

- Besa, nënë, sot s'vete dot, se do shkoj te fisi për të bujtur.

Nëna e djemve i kthehet nuses së vogël:

- Moj nuse e vogël...

Nusja e vogël brofi në këmbë:

- Urdhëro, zonja nënë?

- Mjeshtrit duan bukë e ujë, duan kungullin me verë.

- Besa, nënë, unë vete, po e kam djalin e vogël. Druhem se do gji të pijë e qan.

- Nisu, shko, se djalin ta shikojmë ne, s' ta lëmë të qajë, - i thonë të kunatat.

Ngrihet e vogla, e mira, merr bukë e ujë, merr kungullin me verë, e puth djalin në të dy faqet, niset e bie në Kazenë; që aty ngjit kodrën e Valdanuzit, i afrohet vendit tek punojnë të tre mjeshtrit: dy kunetërit dhe i shoqi.

- Puna mbarë, o mjeshtrë!

Po ç'është kështu?

Çekanët ndalen e s'godasin, po zemrat rrahnin fort e fort. Fytyrat zbehen. Kur i vogli e pa të shoqen, hedh çekanin nga dora, mallkon gurin e murin. E shoqja i thotë:

- Ç'ke ti, o im shoq? Pse mallkon gurin e murin?

Hidhet kunati i madh:

- Ti paske lindur në ditë të zezë, moj kunata jonë: Ne e kemi bërë me fjalë të të murojmë të gjallë në mur të kështjellës.

- Shëndoshë ju, o tim kunetër. Po unë do t'ju le një porosi: kur të më muroni në mur, synë e djathtë të ma lini jashtë, dorën e djathtë të ma lini jashtë, këmbën e djathtë të ma lini jashtë, gjirin e djathtë të ma lini jashtë, se djalin e kam të vogël. Kur të nis të qajë, me njërin sy do ta shikoj, me njërin dorë do ta ledhatoj, me njërin këmbë do t'i tund

djepin e njërin gji do t'ia jap ta pijë. Gjiri im u nguroftë, kështjella qëndroftë, djali im trimëroftë!

Ata e marrin nusen e vogël dhe e murojnë në themel të kështjellës. Dhe muret ngrihen, lartohen, nuk shemben më si më parë. Po rrëzë tyre gurët janë edhe sot të lagur e të myshkët; sepse vazhdojnë të pikojnë lotët e nënës për të birin e saj...

Dhe i biri u rrit, luftoi e trimëroi.

2. Besa e Konstandinit

Ish një herë e një mot një mëmë shumë e mirë e kish dymbëdhjetë bij të hijshëm. Të trembëdhjetën kish një bijë të bukur mbi të gjitha shoqet, që i thoshin Doruntinë.

Vasha u rrit e bë për t'u martuar.

Mirëpo nga bujarët e atij vendi asnjë nuk e gëzoi.

Të gjithë e dëshironin, askush s'guxonte ta zente nuse, sepse nuk e ndjente veten të zotin ta merrte për shoqe.

Atëherë na vjen një trimi largët: i mirë, i hijshëm, i fisëm dhe nis dërgon shkesë dallëndyshen që ta kërkojë Doruntinën nuse. E ëma dhe njëmbëdhjetë vëllezërit e mëdhenj nuk donin t'ia jepnin, sepse trimi, ndonëse i mirë, ishte nga një vend i largët. Vetëm i vogli, Konstandini, donte.

- T'ia japim, zonja mëmë, - thosh ai, - se trimi është i mirë. Më ka hyrë në zemër.

- Konstandin, biri im, ç'po më thua ti kështu? – ia kthente e ëma. – Aq larg do ti që të ma shpiësh Doruntinën time? Se, në e daça për gëzim, për gëzim nuk do ta kem; se, në e daça për helm, për helm nuk do ta kem.

- Të jap besën, zonja mëmë, se kur ta duash ti Doruntinën, qoftë për gas, qoftë për helm, vete unë e ta sjell.

Mëma dhe të njëmbëdhjetët u bindën: e fejuan dhe e martuan Doruntinën me trimin e largët. Bënë dasmë nëntë ditë. Të dhjetën trimi e mori nusen e shkoi te dheu i tij i largët. Mëma dhe e vasha qanë me lot kur u ndanë...

...Shumë luftëra u luftuan atë mot te dheu ynë, se kish ardhur i huaji ta shkelte e ta pushtonte. Të dymbëdhjetë vëllezërit dualen të luftojnë për vendin e tyre dhe u vranë një pas një të gjithë.

Kur iu vra djali i parë, mëma shërëmtiu e tha:

- Biri im, unë nuk kam helm e nuk do të qaj, sepse ti re për dheun tënd e më mbeten njëmbëdhjetë bij të tjerë për luftë.

E kur iu vranë gjashtë, që të gjashtë trima e të dashur... ajo derdhi vetëm një lot për secilin bëri vetëm nga një vajtim. Po kur nisën t'i vriten edhe të tjerët, mëmës iu këput zemra dhe lëshoi një shërëmtimë të madhe sa uturoi tërë vendi:

- Mjerë unë, ç'helm i madh të mos e kem Doruntinën pranë në këtë zi, që më mbuloi shtëpinë!

Kur u vra djali i fundit, Konstandini, ra, mëma shkuli leshrat e bardha e thirri:

- Bobo, vdekje, e nëmosur vdekje! Ti më more dymbëdhjetë bij e tani kush mund ta dijë a s'ma ke marrë edhe bijën time të vetme, bijën time të dëshëruar!

Kur u gdhi e shtuna e të vdekurve, mëma vajti te varret e të bijve. Dymbëdhjetë djem kish pasur, dymbëdhjetë varre kish tani... Mbi çdo varr bëri nga një vajtim, po mbi varr të Konstandinit bëri dy vajtime, qau me ngashërim e thirri tri herë:

- O biri im! O biri im! O biri im!

Edhe tri herë të tjera:

- O, Konstandin! O, Konstandin! O, Konstandin!

Pastaj u shemb përdhe, pushtoi gurin e varrit e u trua:

- Konstandin, o biri im, ku është besa që më dhe, se do ma sillje Doruntinën, tët motër? Besa jote vdiq bashkë me ty e kalbet në varr të zi!

Kështu tha dhe e lau gurin me lotët e syve.

Në mesnatë Konstandini u ngrit nga varri. Guri i varrit u bë kalë i zi si nata. Edhe dheu i zi u bë shalë e zezë si nata. Rrotulla që mbante gurin u bë fre i argjendë. Trimi i hipi kalit, u përkul përpara, uli kryet dhe i ra me shporet. Kaptoi si frymë male e fusha, hodhi lumenj e përrenj, la prapa katunde, kodra, pyje...

Konstandini arriti te shtëpia e së motrës, kur kish dalë dielli. Ajo ditë ndodhi ditë e kremte. Në shesh para shtëpisë, gjeti bijtë e së motrës, nipërit e tij, që loznin e vraponin pas dallëndysheve. I pyeti:

- Bij të zemrës, ku është zonja mëmë e juaj?

- Konstandin, o zoti lalë, – i thanë ata, – mëma jonë po hedh valle në fshat, atje tek bëhet dasmë.

Konstandini shkoi shpejt te vallja e parë, pa një luzmë vashash të bukura tek këndonin e vallzonin dhe tha me vete: “Të bukura jini, moj vasha, po për mua nuk jini, sepse unë s’jam nga kjo botë...”

Dhe u afrua t’i pyesë:

- Gëzuash, o vasha të bardha! A është me ju Doruntina, motra ime?

- Shko përpara, trim, se do ta gjesh tek kërcen e hareshme veshur me petk të ndritur kadifeje.

Konstandini vajti tek vallja e dytë dhe u mat të pyesë përsëri, po Doruntina e pa vetë e i thirri:

- Konstandin, o im vëlla!

Dhe Doruntina iu afrua, e përqafoi.

Konstandini i tha:

- Doruntinë, motra ime! Eja të shkojmë. Të do zonja mëmë në shtëpi!

- Më thuaj, vëlla, si të vi unë atje? Po të më dojë për gas, do të vete të marr stolitë më të mira, po të më dojë (mos qoftë thënë!) për helm, do të vete të vishem me të zeza.

- Eja motër, ashtu si je!

E mori në vithe të kalit. Kali ikë si shakullimë. Ata kapërcejnë si në ëndërr male e fusha, pyje e kodra, lumenj e përrenj. Hëna e yjet kanë shtangur lart e shikojnë me të drojtur.

Gjatë udhës motra e pyet të vëllanë:

- Konstandin, vëllathi im, përse shpatullat e gjera të janë mbuluar me myk?

- Doruntinë, motra ime, shpatullat m’i ka mbuluar tymi i shkluhave në luftë, se në vendin tonë u bënë lufta të mëdha, erdhën armiq të na shkelin tokën dhe ne të gjithë dualëm të luftojmë.

- Konstandin, vëllathi im, përse flokët e dredhura i ke tërë pluhur?

- Doruntinë, motra ime, gjatë udhës kishte shumë pluhur dhe m’i pluhurosi flokët.

- Konstandin, vëllathi im, përse vëllezërit e mi të bukur si drita s’kanë dalë përpara të na presin?

- Doruntinë, motra ime, ndofta janë në lodër e s’presin që të vemi sonte.

- Konstandin, vëllathi im, përse dritaret e shtëpisë janë mbyllur sot krejt?

- Doruntinë, motra ime, i kemi mbyllur se fryn nga deti era e fortë e dimrit.

Kur arrinë pranë kishës, Konstandini i tha së motrës:

- Ti shko përpara, se unë dua të hy të përgjunjem.

Konstandini shkoi prapë në varr të zi. Kali u bë prapë gur, shala u bë dhe, freri i argjendë u bë rrotullë. Dhe përsëri rreth e qark zotëroi heshtja e vdekjes. Ndërkaq Doruntina ngjitur shkallët dhe trokiti pamend në derë.

- Mëmë, hapma derën!

- Kush je ti që trokëllin aty te dera?

- Hapma, zonja mëmë! Jam unë, bija jote Doruntina!...

- Ik tutje nga ke ardhur, o vdekje e shkretë! Ti m'i more të dymbëdhjetë djemtë e tani ke ardhur të më marrësh edhe mua që të mos e shoh më Doruntinën time!

- Ç'po thua ashtu, zonja mëmë? Nuk ma njeh zërin? Besa, zonja mëmë, jam unë vetë, Doruntina jote.

- Ngul gishtin e vogël te vrima e kryqit: që të ta shoh e të ta njoh.

Doruntina nguli gishtin e vogël te vrima e kryqit – atë gisht të hollëz e të bardhë. Mëma ia njohu sakaq e hapi derën.

- Kush të solli këtu, o zemra ime?

- Më solli Konstandini, im vëlla.

- Cili Konstandin, moj bijë? Konstandini im ka vdekur bashkë me të njëmbëdhjetë vëllezërit e tjerë. U vranë në luftë...

Dhe si rrinin të dyja, njëra te praku e tjetra te dera, plasën si qelqi me verë...

3. Gjergj Elez Alija

Trim mbi trima kish qenë gjithmonë Gjergj Elez Alia...

Vjete e vjete ai i kish dalë zot truallit të të parëve; ia kish mbrojtur nderin. Kish luftuar me topuz e shpatë kundër armiqve të derdhur këtej nga deti e nga toka për të shkelur vendin, për ta dhunuar e zhveshur. Dhe të gjithë këta armiq Gjergj Elez Alia i kish shtrirë përtokë, pa frymë.

Por në luftërat e shumta me dhunues të shumtë trimi ynë kish marrë nëntë plagë në shtat dhe tani kish nëntë vjet që dergjej në kullë. E motra i rrinte ditë e natë mbi krye, i lante plagët me ujët e gurrës nëntë vjeçe, ia shpërlante me lotët e syve të saj, i terte gjakun me flokët e ballit; shtatin ia lidhte me shamitë e nënës, ia hijeshonte me petkat e moçme të tatës; armët e brezit ia rendiste mbi krye, sepse, kur i shihte armët pranë, bacë Gjergji e ndjente zemrën ende të ngrohtë, i ngjallej një fill shprese.

Ai i duronte si burrë dhembjet e plagëve kur i ndërronte e motra shtatin. Vetëm një dhembje nuk e duronte dot Gjergji: dhembjen për motrën e dashur të varrosur së gjalli pranë tij, në kullën e lartë, që t'ia mjekonte plagët, të përkujdesej për të. Kjo dhembje e shtrinte Gjergjin si të vdekur, pa frymë. E motra e Gjergjit s'kish pasur kurrë çaste gëzimi. Ndërsa shoqet e saj gëzonin të ritë e tyre, kishin dashuruar, ishin martuar, kishin lindur fëmijë, ajo rrinte gjithnjë mbyllur në kullë pranë Gjergjit të sëmurë.

Kështu kaluan të nëntë vjetët.

Vitin e nëntë u hap e mori dhenë fjala gjëmëmadhe se kish dalë nga deti një bajloz i zi, trim i fortë e i prapë, më i lig nga të gjithë bajlozët e tjerë që kishin shkelur gjer atëherë truallin tonë. Ky bajloz i prapë i kish hedhur vendit një rreng të rëndë: çdo derë t'i jepte një dash të pjekur, çdo vatër t'i dërgonte një vashë të njomë. Bajlozi vriste ditë për ditë, digjte javë për javë nga një krahinë. Kish vrrarë kaq kreshnikë, sa tani askush s'kish zemër t'i dilte përpara e t'i priste hovin, sepse topuzi i tij ishte shumë i rëndë, shpata e tij ishte shumë e mprehtë dhe heshta e tij e përshkonte tejprtej shtatin e kreshnikut. Kështu, tërë vendi lëngonte nën thundrën e tij.

Gjergj Elez Alia s'dinte gjë: ai dergjej në shtrat si i vdekur i pakallur në varr.

Kur i erdhi radha shtëpisë së Gjergjit që t'i jepte bajlozit haraçin: dashin e pjekur dhe motrën, kjo, motra, qau me lot, u ankua dhe nëmi:

- O vëlla, po qysh na harroi neve mortja e s'na mori? Nëna e tata kalben të vdekur nën blir. Shtati i vëllait kalbet së gjalli brenda në shtëpi. Shtati i motrës do të bjerë në duart e bajlozit të zi...Pse vallë s'shembet kjo kullë e të na zërë brenda të vdekur? Pse s'bëhet gërmadhë kjo shtëpi jona? Vdekja është më e ëmbël, moj e zeza nënë, se sa jeta pander!

Atëherë Gjergji u zgjua, shikoi përreth e s'dinte ç'kish ndodhur. Kish ndierë se i qe lagur fytyra dhe kish pandehur se kulla qe rrënuar kaq shumë, sa i shtinte shiun

brenda. Zemra ju bë dy copë, shikoi motrën: dy vija lotësh ia përshkuan faqet e tretura. Dhe nga pikëllimi mallkoi kullën:

- Hej, u nxfish, moj kulla ime! Të mbuloftë fund e krye lëmashku! Paç banorë brevën e gjarprin! Si më lëshove ti kaq shpejt pikat e shiut brenda në shtrat?

Motra ia fshiu me dorë të dredhur lotët i tha:

- Jo, more vëlla, nuk bie shi jashtë e nuk pikon çatia e kullës. Ty të kanë lodhur fort plagët e shtatit, prandaj s'di se ç'flet: sytë e mi pikojnë lot, vëlla!

Atëherë Gjergji i shtrëngoi dorën me atë pëllëmbën e thatë, i lëmoi ëmbël fytyrën, e shikoi me ata sytë e mallit dhe i foli me zjarr, si nuk kishin folur kurrë:

- Përse qan, moj motër? Pse ma thyen kaq fort zemrën? Shtati im ka nëntë vjet që po kalbet së gjalli. Në këta nëntë vjet Gjergji yt s'ka pasur kurrë pushim e ka fërfëlluar gjithnjë si ai gjethi i ahut në faqe të shullërit. Vallë a s'ke pasur të hash e të pish në këta nëntë vjet? A s'të ka mbajtur ty vëllai me të veshur e të mbathur? A të ka rënduar ndonjëherë me fjalë? Apo t'u mërzi vëllai e të ka lindur dëshira të martohesh e ta braktisësh?

Atëherë motra i mori dorën, ia shpuri në ballin e saj e iu përgjegj bukur:

- Oh, vëlla! Kaq fort të paska mërziur ty vuajtja, që më flet kështu! Hyfsha gjallë në dhe, në më shkon mendja të martohem! Të ngrënë e të pirë kam pasur mjaft, vëlla. Edhe të veshur e të mbathur kam pasur mjaft. Kurrë s'më ke rënduar në fjalë si sot. Unë ty të kam atë, ty të kam vëlla. Po sot, bacë Gjergj, dua të të qaj një brengë të madhe. Si nuk t'u përkund vallë shtati në këta nëntë vjet që të dalësh gjer te praku i derës? Si nuk u tha motra jote – e thaftë vera! Po qysh të duroj unë e zeza trupin që t'i shkoj bajlozit në derë?

E kur Gjergji dëgjoi këto fjalë i harroi nëntë plagët e shtatit, i harroi nëntë varrët e veta dhe u ngrit sakaq në këmbë sikur të mos kishte pasur ndonjë lëndim fare. Ashtu shtathedhur e i gjatë, si dikur, i pari i heronjve. E i tha së motrës:

- Motra ime, merre kalin tim më të mirë e shko deri në qytet dhe kërkoje vëllamin tim nallban. T'i thuash: "Të bën të fala Gjergji dhe të lut t'ia mbathësh kalin me potkonjtë prej hekuri të farkuar dhe me thumba të fortë, se do t'i dalë në mejdan bajlozit". E nëse vëllami nuk do t'ia vërë patkonjtë kalit, kalëro më tej e shko te miku im tjetër, edhe ai nallban.

Motra iu hodh kalit në shpinë, u nis dhe mbërriti në qytet; shkoi drejt e te vëllami nallban.

- Punë e mbarë, o nallban!

- Fat e mbarësi paç, ti vajzë që vjen nga larg!

- O nallban, vëllam i vëllait tim, Gjergji të dërgon të fala dhe të lut t'ia mbathësh kalin me potkonj prej hekuri të farkuar dhe me thumba të fortë, se do t'i dalë në mejdan bajlozit.

Por nallbani, për këta nëntë vjetë që Gjergji kishte qenë i varrosur së gjalli në kullën e tij, e kishte harruar vëllazërimin të bërë përmes gjakut. Ai nisi t'i fliste fjalë të rënda motrës së Gjergjit.

- Nëse m'i falë sytë e tu të bukur, çupëz, do të ta shpëtoj Gjergjin, ashtu që kalin do ta mbath me aso potkonjsh me të cilët do të bëhet i shpejtë si era.

Motra e Gjergjit iu përgjigj me zemërim:

- Ç'po thua kështu, nallban, t'u thaftë gjuha! Mendova se kam ardhur te vëllami, por po e shoh se paskam ardhur te një horr i shkretë. E pra, unë të dy sytë ua kam falur prindërve, nënës e babait, që më treten në varr dhe Gjergjit që tretet me nëntë plagë mbi tokë!

Kështu i foli e motra nallbanit, vëllamit që e kishte harruar vëllazërimin, dhe pastaj i hipi kalit dhe shkoi te nallbani tjetër, te miku i dashur i Gjergjit.

- O nallban, mik i dashur i vëllait tim, - tha ajo. – Gjergji të bën të fala dhe të lutet që kalin t'ia mbathësh me potkonj prej hekuri të farkuar dhe me thumba të fortë, se do t'i dalë në mejdan bajlozit.

Nallbani, miku i mirë i Gjergjit, menjëherë ia mbathi kalin me potkonj, të mirë e të fortë, si ta bënte për veten e tij.

- I dërgoj të fala të përzemërta Gjergjit, me dëshirën që të jetë mirë dhe të dalë fitimtar nga lufta.

- Paç fat e mbarësi, nallban, miku i mirë i vëllait tim, ia ktheu vajza.

Kah mbrëmja mbërriti vajza në kullë dhe e gjeti Gjergjin duke pritur nën hije të blirit, i veshur e i ngjeshur në armë dhe i gatshëm.

E kishte mundur dhembjen në shtat vetëm e vetëm që të mbronte nderin e shtëpisë e të tërë vendit, për hakmarrje.

E ç'bëri Gjergj Elez Alia? I dërgoi të fala bajlozit:

- Nuk kam asnjë çupë të të japë ty. Dëshët e mi nuk i kam mbajtur në kullosa për ty. E kam vetëm një motër në shtëpi, por nuk mund të ta japë, se tërë kohën m'i lidhë plagët. Prandaj të ftoj në log burrash, në dyluftim.

Kur drita e mëngjesit të nesërm nisi të ndrijë të dy – Gjergji dhe bajlozi – u nisën për në mejdan dhe filluan ta ngacmojnë njëri-tjetrin me fjalë. Bajlozi armik ishte veshur në pancir të rëndë hekuri, kishte helmetë çeliku në kokë, një topuz të rëndë dhe një shpatë të gjatë. Edhe kali ishte i mbrojtur me hekur. Toka dridhej kah ecte.

Sapo e pa Gjergjin, ashtu shëndetlig mbi kal, qeshi me sa zë pati dhe i thirri:

- Gjergj, a nga varri je zgjuar a? Përse më ke sjellë më kot, o burrë, në mejdan? A nuk e di se unë jam i njohur si bajloz nga deti? Kam rrëzuar shumë luftëtarë nga kuajt e tyre dhe i kam dërguar në botën tjetër. E ty do të të hedh poshtë me gishtin e vogël.

Gjergji iu kundërpërgjigj:

- Po folke mirë, bajloz, sa unë e dëshiroj gjuhën tënde! Është e vërtetë se për nëntë vjet kam qenë rrugës drejt varrit, se i kam nëntë plagë në shtat. Para se të arrija atje, ti më bëre të kthehesha. Se më ke kërkuar motrën para se të më kërkosh mejdanin, se më ke kërkuar bagëtinë para se të kërkosh bariun. Kam ardhur të të tregoj se ç'thotë ligji i stërgjyshërve tanë: të mos dorëzohet asgjë para se të zgjatet arma, që kurrë motrat të mos ua japim armiqve para se të ndeshemi me shpata në mejdan. Bëhu gati, bajloz, se të paska ardhur dita e fundit! Kështu foli Gjergj Elez Alia!

Dhe kuajt nisën turravrapin në mejdan sa u ngrit pluhur i madh aty. Bajlozi i keq qe i pari që sulmoi dhe gjuajti me topuz. Kali i Gjergjit u përul dhe u shtri për tokë. Topuzi i rëndë i bajlozit fluturoi mbi kokën e Gjergjit, u përplas larg dhe u ngul dymbëdhjetë këmbë thell në tokë. Pluhuri u ngrit dymbëdhjetë këmbë në ajër

Kur i erdhi radha Gjergjit, ky qëlloi me shkathtësi me topuz dhe e goditi m'u në ball bajlozin, që ra përdhe i vdekur, dhe u dridh i gjithë vendi. Kali mori arratinë. Gjergji e nxori shpatën, ia preu kokën armikut dhe e hodhi sipër shalës, kurse trupin ia tërhoqi me kali zvarrë nëpër fushë, nëpër zabel e lluga e pastaj e flaku në një greminë. Gjaku nga trupi i bajlozit rrodhi në përroskë dhe e bëri ujin e lumit të zi. Tre vjet me radhë kundërmoi vendi aty nga kufoma e tij...

Pasi heroi e kishte mundur bajlozin u kthye fitimtar në shtëpi, i mblodhi të gjithë miqtë dhe u tha:

- Më dëgjoni, miq! E juaja është kulla, të juajat janë paratë, e juaja është pasuria ime, e tërë bagëtia! Motrën ua lë në mbrojtjen tuaj!

Heroi shkoi ta përqafonte motrën e gjorë, që e priste më gëzim. Në atë çast pushoi zemra e të dyve. Motër e vëlla ranë të dy të vdekur.

Një vdekje më të lehtë dhe më të këndshme kurrë kurrkush nuk kishte parë!

Miqtë e Gjergjit mbajtën zi një kohë të gjatë. Pastaj e hapën një varr të madh sa t'i zinte të dytë, vëlla e motër, ashtu si ishin në përqaftim. Varrin e rrethuan me një muranë të bukur që të mos harrohet kurrë se sa shumë motra e deshi të vëllanë dhe se sa shumë vëllai e deshi të motrën; që heroi i madh Gjergj Elez Alia të mos harrohet kurrë, ai që mbrojti nderin e vet e të atdheut, dhe që e shpëtoi vendin nga dhuna e bajlozit.

Në krye të varrit të të dyve, miqët mbollën një bli, ashtu që shpezët të pushonin sipër varrit të secilit.

Kur mali filloi të mbushet me gjethe, u ndal qyqja te murana e varrit, por blini qe fishkur; ajo fluturoi sipër kullave të nxira dhe e pa kulmin e rrënuar. Atëherë ajo bëri vend në dritare dhe filloi t'u këndonte udhëtarëve që kalonin rrugës:

- Dëgjo, ti kalimtar malesh! Nëse këndon, kur t'i afroresh këtij vendi, ndale këngën, e nëse qanë, atëherë rrite gjëmimin dhe vajin. Kam kërkuar nga mali në mal, nga fusha në fushë, nga shtëpia në shtëpi, por askund nuk kam parë si njai Gjergj Elez Ali!

Të gjithë erdhën e shkuan: Gjergj Elez Alia vdiq, edhe e motra, kulla iu rrënuar. Nga murana e varrit e as nga kulla nuk ka më as gjurmë. Ajo që mbeti, qe vetëm kënga: si yll drite nëpër shekuj ecën për të kënduar heroizmin e vëllait dhe dashurinë e motrës, madhështinë e shpirtit shqiptar. E kënga nuk vdes kurrë!

4. Fuqia e Mujit

Na ishte një herë në Klladushë, atje larg në Krajinë, afër Judbinës [këto vende ndodhen në Bosnjë e Kroaci, afër detit Adriatik – sqarim i autorit], një malësor që i kishte dy djem: Mujin e Halilin. E kishte edhe një vajzë, që e thirrnin Ajkuna. Malësori ishte i fortë dhe trim. Të tillë u bënë edhe të bijtë. Muji ishte jashtëzakonisht i madh krahasuar me moshën. Ishte i mençur, i pjekur e i durueshëm. I ngjashëm ishte edhe i vogli vëlla, Halili. Babai ishte i varfër, sa mezi e siguronte kafshatën e gojës. Prandaj, sapo u rrit Muji sa të mund të punonte, u bë punëtor me pagë te një zotëri. Ky ishte i pasur dhe e bëri Mujin bari, që t'i ruante lopët kur vinte koha për t'u ngjitur në male për kullosa.

Dhe këtë punë e bënte Muji: ngrihej para se yjet të përhumbnin, merrte kaçamakun, një copë bukë dhe pak djathë në një qese, merrte shkopin në dorë dhe i ngjiste lopët e zotëriut lart në male. Aty i kulloshte ato tërë ditën, hante bukën me krip, pinte ujë të ftohtë burimesh dhe çlodhej nën hije në vapën e mesditës. I ra të kalonte nëpër të gjitha dhiaret, një ditë këtu, një tjetër atje, e çonte kopenë në kullosa të mira dhe në mbrëmje i kthente ato në vathin e zotëriut. Ky i shihte kur lopët mjeleshin dhe befasohej: qumështi rridhte rrëke. Ena nuk mjaftonte për tërë atë qumësht. Muji merrte bukën e kripën, për të cilat kishte nevojë.

Gjithçka shkonte mirë ditë pas tjetrës, derisa një herë ndodhi që bagëtia u zhduk në kullosa. Muji i kërkoi gjithandej, në shpella rrëpirash, në të gjitha arat, e ku jo, derisa u err. Dhe nuk mundi t'i gjejë. Atë natë nuk u kthye në vathë. E si të kthehej pa lopët? Zotëriu do të tërbohej, kurse barinj të tjerë, shokët e tij, do ta qeshnin.

Ai u këput duke u endur nga dhiarja në dhiare, nga ara në arë dhe kur dielli perëndoi pas maleve, Muji u ul i lodhur e i dërrmuar skaj një shkëmbi. Aty e zuri nata. Një natë e errët, pa yje, pa hënë. Meqë s'kish ç'të bënte, vendosi të flinte e të priste derisa të dilte dita e pastaj të jepej sërish nëpër male për të kërkuar lopët.

Te shkëmbi ku kishte kërkuar shtrojerë, qenë dy djepa, secili me nga një foshnje. Foshnjët qanin e klithnin me sa zë kishin. Muji u afrua t'i shihte: ata ishin shumë të vegjël sa iu dhimbsën. I përkundi te djepat, secilin me nga një dorë, dhe u vuri në gjumë foshnjët.

Pas mesnatës, befas, në maje malesh u shfaqën drita të bardha e shkëlqyese. Jo, nuk ishin drita, ishin dy zana të veshura në kostume vezulluese. E panë Mujin ku qetë po

përkundte dy foshnjat dhe dëgjuan se si u fliste me butësi e miqësi. U befasuan dhe pyetën:

- Kush je ti? Ç'kërkon në këtë vend? Mos ke humbur gjësend e ke ardhur ta kërkosh?

- Jam bari lopësh, punëtor me mëditje për kafshatën e gojës, tha Muji. – Tërë ditën endem nëpër male duke kërkuar kullosa. Sot më ndodhi një kob i madh: lopët e zotëriut më humbën dhe nisa t'i lyp. Nata më gjeti në këtë vend dhe u ndala për t'u çlodhur pak e për të fjetur. Por nuk vura gjumë në sy, sepse këto dy bebe qanin. M'u dhimbsën e nisa t'i përkund, dhe më në fund i vura në gjumë... E ju, kush jeni? Prej nga e tërë kjo dritë, që u ndrinë nga fytyra dhe trupi?

Ato e njohën Mujin, të cilin e kishin parë shumë herë nga largësia, nëpër livadhet malore e në korije kur i kullosin lopët ose i lente të pushonin në hije. I thanë:

- Ne jemi zana, o Muj. Ne kemi marrë udhë, ashtu sikurse bëjmë çdo mbrëmje, të shohim nëpër botë e të ndihmojmë njerëzit e mirë e të drejtë. Ne i lamë këtu të vegjlit tanë. E ti Muj ke vepruar si një njeri i mirë, se i ke përkundur dhe ju ke nanuritur për t'i vënë në gjumë. Fat e mbarësi paç! Na thuaj tash, o Muj, ç'don të të japim ne për këtë të mirë që na e ke bërë? A don të keshë fuqi, o Muj? A don të luftosh? A don të kesh mall e pasuri? A don dituri? A don dhuntinë e oratorisë? Thuaj vetëm ç'don, dhe ne do të ta japim.

Muji u tha zanave:

- Zana të dashura, puna është kështu: barinjat tjerë më ngacmojnë dhe tallen me mua. A keni mundësi të më bëni të fuqishëm, ashtu që t'i mund ata?

- Vetëm këtë e don?

- Po.

Njëra zanë i tha tjetrës:

- Motër, a t'i japim Mujit qumësht zane e ta bëjmë të fuqishëm?

- Po, motër, t'i japim.

Zanat nga gjinjtë i dhanë Mujit qumësht dhe mjaftuan vetëm tre pika që ai të ngopej. Përnjëherësh Muji filloi ta ndjejë fuqinë, një fuqi të tillë sa do të mund ta shkulte me rrënjë një ah mali. Zanat i thanë:

- Të të shohim tash, o Muj, sa i fortë je bërë? Shkëmbin që e ke aty përskaaj, a mund ta ngritësh atë?

Zanat treguan një shkëmb që ishte i rëndë sa tre pendë demash. Muji u përkul, e kapi shkëmbin, e lëvizi nga vendi, e mbajti në duar dhe e ngriti deri te zogu i këmbës. Më lart nuk mundi ta ngriste. E lëshoi dhe u ul të çlodhej.

- Duhet t'i japim edhe ca qumësht Mujit, thanë zanat.

Ia dhanë gjirin edhe një herë. Fuqia e Mujit u rrit dhe ky e kapi shkëmbin, e mbajti në duar dhe e ngriti deri te beli. Më lart nuk mundi ta ngriste. Zanat e panë këtë dhe i thanë njëra-tjetrës:

- Edhe ca qumësht duhet t'i japim Mujit.

Muji piu edhe një herë qumësht zanash dhe u bë më i fuqishëm se një dragua. E kapi shkëmbin dhe e mbështeti në supe, e ngriti lart me duar dhe qëndronte drejt si një lis që s'lakohet. I pyeti zanat:

- Më thuani, zana të dashura, ku ta flakë këtë shkëmb! A ta gjuaj atje te livadhet e verdha apo tutje në fushat e Jutbinës?

Zanat e panë me buzëqeshje dhe i thanë njëra-tjetrës:

- Nuk bën më t'i japim gjë Mujit, se atëherë mund ta përmbys botën...

Pastaj filluan zanat ta pyesnin Mujin lidhur me babain dhe nënën, motrat e vëllezërit, mbi tërë Jutbinën dhe Krajinën. Gjatë tërë kohës hëna e verdhë rrinte sipër kokës së tyre dhe përcillte bisedën e tyre. Hija e shkëmbit të madh nisi të zgjatet e të mbulojë

edhe greminën. Në kullosat e maleve fryente një erë e freskët nate. Dëgjoheshin fëshfërimat e gjetheve të ahut, ku gurgullonte ujët e krojeve dhe ia shtonin zërin lumit që rridhte nga malet drejt fushave.

Pasi e kishin pyetur Mujin holl e gjatë, i thanë:

- O Muj, ne duam të vëllazërohemi me ty. Ç'thua?

- Në më doni si vëlla, mund të më keni, zana të dashura, tha Muji. – Kur të jem në zor do të ju thërras që të ma zgjasni dorën. Nëse ndokush do të ju fyej, më thirrni, ashtu që të vij e t'ua tregoj qejfin.

- Mirë fole, vëlla i dashur: nëse bie në hall, na thirr, e ne vijmë, dhe nëse ndokush ne na cenon, ne do të ankohe mi.

Kur agu filloi të ngjyrote qiellin e mëngjesit me të kuqe, zanat morën djepat, të mbuluara me pëlhurë të bardhë, dhe u zhdukën duke lënë shkëndijë drite. Muji i fërkoi sytë se deshë të shihte se ku shkuan ato, por e vetmja gjë që mundi të shihte qe shkëndija e dritës që shuhej sipër kullosave të maleve. Ai tha vetë më vete: “A mos isha ëndërr?” Shkoi dhe i lau sytë në burim. Ujët e ftohët e freskoi. Aty pa një shkëmb, të cilin as njëzet veta nuk do të mund ta lëviznin dot. U përkul, e kapi me të dyja duart dhe e vuri mbi supe. Qeshi e tha: “Jo, nuk paska qenë ëndërr” dhe e gjuajti tutje gurin, i cili ra nga shkëmbi në shkëmb derisa humbi në rrëpirë. Gjëmoi e tërë malësia...

Pastaj Muji vazhdoi t'i kërkonte qetë dhe i gjeti të ngopura dhe gjifryra; i mblodhi dhe i nisi për te i zoti. Kur mbërriti në fushën e Jutbinës dielli ishte ngritur lart në qiell. Aty ishin mbledhur të gjithë shokët e tij, të gjithë barinjët, dhe luanin e argëtoheshin. Kur e panë Mujin, nisën ta nganin me fjalë thumbuese:

- Më në fund, mbërrite, o frikacak?

Muji u zemërua, por nuk u përgjigj

- Si nuk të hëngri ujku me gjithë lopë!

Sërisht u zemërua, por prapë s'u përgjigj.

- A mos ke qejf të rrihem?

Muji qeshi e u përgjigj:

- Posi!

- A nuk ke frikë se do të hashë përsëri shqelma në prapanicë?

- Jo, nuk kam frikë.

Muji i përvoli krahët. Më i forti i barinjve iu afrua që ta godiste e ta rrëzonte përdhe, por më shpejt e kapi Muji, e çoi lart në ajër dhe e solli në shuplaka dy-tri herë, e pastaj e hodhi disa metra lart në ajër...

Barinjët e tjerë e panë Mujin të lemeritur dhe pyetën: “Ç'dreqin ka ngjarë me Mujin?” e pastaj ia mbathën.

- A ka dhe ndonjë tjetër që don të matet? – pyeti Muji.

Askush s'iu gjegj, se të gjithë kishin ikur të trishtuar.

Muji i mori lopët dhe i çoi te i zoti.

- Kujdesu për lopët dhe gjej një bari tjetër.

Muji u kthye në Klladushë të përshëndeste babain e nënën, motrën e vëllain. Ujqit lemeriteshin kur ia dëgjonin ecjen. Muji nisi të luftojë për vendin e vet. E tërë mbretëria kishte frikë kur Mujit i përmendej emri.

(...)

Kaq sa i përket legjendave shqiptare. Meqë kemi mbërritur deri këtu me përshkrimin, dua t'i shtroj lexuesit një pyetje: çka është heroizmi? Nëse heroizëm është që pa frikë t'i kundërvihesh një armiku shumë herë më të fuqishëm, atëherë është mjaft lehtë të nxirren në pah heronjtë shqiptarë. Po qe se, ndërkaq, me heroizëm mendohet gatishmëria për flijim, sakrifica e pafund në heshtje, aftësia që edhe duke qenë i

nënshtuar megjithatë të qëndrosh, atëherë do të jetë më e vështirë të definohet heroizmi. Se nuk është shprehi që të karakterizohen gratë e nënshtuara dhe vetëmohuese, të cilat flijojnë veten për jetën e të tjerëve, si heroina. Por, për mua, pikërisht gratë shqiptare janë ato që kanë bërë heroizmin më të mirë në vend. Me këtë konstatim, arrijmë natyrshëm te kapitulli pasues...

GRUAJA NË SHOQËRINË SHQIPTARE - NJË STUDIM ERRËSIRË

Një ditë pranvere të vitit 1977 Anders Vestinit i erdhi për vizitë e mbesa, Sara - të cilën nuk e kishte parë me vite dhe kishte kërshëri të dinte se cili ishte motivi i vizitës së saj. Andersi e kishte ruajtur mendimin e vet radikal të ditëve të rinisë, ndërsa djali i tij, Larsi, kishte ndjekur rrugë krejt të tjera. Pas studimeve ekonomike në Chalmers ai qe punësuar në një firmë të madhe elektronike amerikane dhe pas një kohe qe bërë shef i shitjes në Suedi. Larsi kurrë nuk kishte qenë i interesuar për çështjet ideologjike e politike; prandaj s'kishte kurrfarë problemi që të sillej sipas vlerave borgjeze që kërkonte puna e tij për firmën amerikane. Për Anders Vestinin ky orientim i djalit të tij ishte një zhgënjim i madh; kontaktet midis tyre ishin shumë sporadike dhe mjaft të tendosura. Larsi shpesh vinte në Stokholm për biznesin e tij, mirëpo nuk e vizitonte të atin. Për këtë nuk ishte aq i çuditshëm fakti se Andersi nuk dinte thuaja gjë për Sarën dhe jetën e saj në këto vitet e fundit.

Njëzetedyvjeçarja Sara i ra zilës, në portën e vilës së gjyshit në lagjen Engby. Ajo ndjente turp pse nuk kishte mbajtur kontakte me të, që nga shkolla e saj fillore. Në shtëpinë e babait kishte qenë rregull e pashkruar: të mos flitej fare për gjyshin; e kur edhe vetë Sara kishte rënë në konflikt me prindërit, ndër të tjera për shkaqe politike, dhe ishte shpërngulur nga shtëpia, ishin jo relacionet familjare, por krejt çështje të tjera ato që e kishin preokupuar atë. Ishte duke studiuar antropologji sociale dhe histori në universitetin e Stokholmit. Kishte qenë anëtare e PKS – Partisë Komuniste të Suedisë – por para disa muajve e kishte braktisur lëvizjen, pasi që kishte qenë gjithnjë më negative ndaj veprimtarisë së tyre. Gjatë periudhës kur ishte marksiste-leniniste, i kishte bërë tri vizita Shqipërisë, kishte qenë aktive në Shoqatën suedezo-shqiptare dhe kishte mësuar gjuhën shqipe nën drejtimin e një shoku të moshës – Bose Janson. Ky person, në rrethana krejt misterioze ishte zhdukur në Stokholm para një viti dhe askush s'dinte gjë për fatin e tij. Apo thënë më saktë: ai apo ata që dinin ndonjë gjë kishin arsye të heshtnin. Interesimi i Sarës për shqiptarët nuk ishte shuar nga zhgënjimet e saja politike, sepse e dinte fare mirë se ky popull e ky vend kishin mundësi për të dhënë më tepër nga vetja, pavarësisht nga raportet politike. E qysh në fëmijëri ajo kishte dëgjuar për simpatitë e gjyshit për shqiptarët. E tash kishte vendosur të bisedonte me të, për të mësuar më tepër lidhur me angazhimet e tij të më hershme.

Anders Vestini e hapi portën dhe përqafoi ngrohtësisht Sarën. Ajo u befasua këndshëm nga fakti se gjyshi dukej aq i fortë ani se i kishte 82 vjet. Dukej se fizikisht ishte aktiv. Kopshti tregonte se ai dhe gjyshja punonin me kujdes për t'i mbajtur kultivimet në gjendjen më të mirë. Në këtë pranverë të hershme kishin lulëzuar zymbylët, zambakët e verdhë dhe disa ferrëkuqe, të cilat më së tepërmi të binin në sy. Hapësira e kopshtit ishte e përgatitur dhe e gatshme për perimet dhe zhardhokët e sezonës së ardhshme.

Pas kafesë dhe një bisede të shkurtër me gjyshen, Sarës iu dha mundësia të hynte në temën që ishte shkak i vizitës, përveç thjesht kontaktit njerëzor me gjyshërit. Ajo kishte vendosur të studionte më afër shoqërinë shqiptare, pjesërisht në kuadër të studimeve socialantropologjike dhe historike, pjesërisht jashtë studimeve akademike. A kishte gjyshi ndonjë këshillë apo propozim?

Sara e hetoi menjëherë se kjo ishte një temë që e gjallëroi gjyshin, i cili u gëzua për faktin se e mbesa kishte filluar të ecte gjurmëve të tij. Një temë që i dukej se mund të ishte interesante: gjendja e gruas shqiptare. Andersi nuk ia kishte dalë ndonjëherë të mësonte aq shumë shqipen, por e dinte se një nga librat që kishte siguruar dikur, e shkruar nga Lumo Skëndo më 1924, pjesërisht kishte të bënte edhe me problemin e gruas. Poashtu mendonte se Sara do të duhej të siguronte ligjin e vjetër të dokeve,

Kanunin e Lekë Dukagjinit, që me siguri se duhej të ishte i botuar, ani se Andersi nuk e dinte ku dhe kur.

Nuk u desht shumë kohë që Sara të mund të fillonte të shfletonte tekstet që i siguroi: librin që gjyshi ia dhuroi, ligjin e dokeve – një ekzemplar i botimit të Kosovës ishte në bibliotekën e qytetit në Stokholm dhe disa fjalime të Enver Hoxhës lidhur me çështjen e gruas, që ishin botuar nga Shoqata suedeze-shqiptare. Sara do të merrej me këtë temë rreth njëzet vite, edhe pasi që kishte filluar të punonte si përkthyes nga shqipja në suedisht. Ajo, kësaj, pati mundësi t'i plotësonte studimet e veta duke i krahasuar me disa raste aktuale. Këtu më poshtë do të prezantohet një pjesë e shënimeve të Sarës, të cilat i ka quajtur “Gruaja shqiptare – një studim errësire”.

Sa i përket çështjes së gruas shqiptare, në pjesën më të madhe duhet të bredhim nëpër errësirë. Më tepër se kaq unë nuk dua të them – meqë ato që do të doja t'i thosha do të rrjedhin nga ato që do të thuheshin në vazhdim. Jam përcaktuar që të vë përballë njëri-tjetrit tekste të ndryshme, ashtu që lexuesi të mundet vetë të nxjerrë përfundimet. Janë rregullat e ashpra të ligjit të dokeve, apeli i Mid'hat Frashërit drejtuar asaj pakice të grave shqiptare që mund t'i lexonin tekstet e tij. Frashëri është njëmend shumë përparimtar për kohën e vet. Shumë interesante janë edhe fjalimet e armikut të tij më të egër, Enver Hoxhës, lidhur me çështjen e gruas në vitet e 1960-ta dhe diskutimet përkatëse, pavarësisht stilit propagandistik që i karakterizon ato. Pa fije dyshimi, Enver Hoxha ka treguar një angazhim të njëmendtë në çështjen e emancipimit të gruas dhe analiza e tij në këtë çështje edhe sot e kësaj dite është shumë e vlefshme, edhe pse ai kishte arsye të veçanta, si diktator i Shqipërisë dhe udhëheqës partie, të kujdesej që gratë të viheshin nën ndikimin ideologjik e politik e jo të jetonin ende në një ideologji tjetër. Ndërsa apeli i Frashërit ka kaluar mjaft pahetueshëm, fjalimet e Hoxhës kishin bërë ndryshime të mëdha për gruan shqiptare. Disa prej tyre ishin pozitive, porse, sikurse mësuam në vitet e 1990-ta, emancipimi kishte ngelur në gjysmë të rrugës: Gratë hynë në shoqëri, në administratë e në prodhim, porse në shtëpi nuk ndryshoi asgjë. Rezultati: Një ngarkesë e paarsyeshme pune nga rritja e numrit të detyrave. Prandaj pjesa dërrmuese e grave, sigurisht, edhe e kanë përjetuar “emancipimin” si humbje e jo si fitore.

Një kundërshtim duhet bërë këtu: Enver Hoxha e stërmadhon rolin e fesë sa i përket këndvështrimit tradicional shqiptar mbi gruan. Ligji i dokeve e ka pasur vlefshmërinë dhe shtrirjen e vet edhe te shqiptarët katolikë e edhe te shqiptarët muslimanë. Elemente religjioze ka gjithsesi në traditat, si rregull negative për gratë, por ato nuk janë aspak vendimtare. Në anën tjetër feja është referuar si mbështetje për botëkuptimet reaksionare, mirëpo zanafilla e traditave shpesh është joreligjioze. Është i habitshëm fakti se shumë vrojtues e kanë theksuar kujdesin fisnik për gruan në Shqipëri, kur në të njëjtën kohë ajo, në kontekste të tjera, konsiderohej thuaja si pajisje e kuzhinës.

Tekstin e Mid'hat Frashërit e kam prezantuar thuaja të tërin dhe pa shkurtime, kurse fjalimet e Enver Hoxhës jepen në përzgjedhje, ku u jam shmangur kapitujve mbi kontributet e partisë në këtë çështje, për shkak se nuk paraqesin ndonjë farë interesi për lexuesin e kohës sonë, dhe jam orientuar që të paraqes pjesërisht rezonimet e tij filozofike e pjesërisht materialin konkret që ai i referohet.

*1. Udhërrëfytyesi i parë në perandorinë e errësirës:
At Shtjefën Gjeçovi (1874-1929)*

Karakteristikë e ligjit të traditës është se ai bazohet në një kodeks gojor, një traditë që përcillet prej brezi në brez. Më vonë ato mund të shkruhen, sikurse është Ligji suedez i Vestgotas. E njëjta gjë vlen edhe për ligjet e traditës shqiptare, ndër të cilët më i njohuri është ai që quhet Kanuni i Lekë Dukagjinit. Përse, këto ligje tradicionale, quhen

sipas Lekës, që ishte aleat i Skënderbeut, nuk dihet. Mund të jetë se emërtimi ka ardhur nga kohë të mëvonshme.

Është meritë e priftit katolik, françeskanit Shtjefën Gjeçovi, që ky Kanun ekziston në formë të përmbledhur e të shkruar. Gjeçovi kishte një arsimim të mirëfilltë për kohën: I lindur në Kosovë, studioi në dy kolegje - në atë françeskan në Shkodër dhe në atë françeskan në Bosnjë, pas të cilave u shugurua prift. Fondi i njohurive të gjera që kishte përvetësuar do t'i jepte më vonë mundësi që në detaje të studionte dhe të botonte vepra në linguistikë, etnologji e arkeologji; vetëm se i njohur dhe i nderuar në rrethe të gjera do të bëhet para se gjithash për shkak të hartimit të Kanunit të Lekë Dukagjinit.

Por At Shtjefni ishte edhe atdhetar dhe aktiv në lëvizjen shqiptare. Ka jetuar dhe ka vepruar në pjesën më të madhe të trevave shqiptare. Pas Luftës së Parë Botërore u emërua famullitar në një kishë afër Prizrenit në Kosovë. Si atdhetar shqiptar dhe njeri i qëndresës, u bë i rrezikshëm për qarqet drejtuese në Beograd. Në vitin 1929, pas një grushtshteti antimbretëror, Mbretëria e sllavëve të jugut u shndërrua në diktaturë dhe e ndërroi emrin prej “Mbretëri e serbëve, kroatëve dhe sllovenëve” në “Mbretëri Jugosllave”.

Më 13 tetor 1929, dy xhandarë shkuan te Gjeçovi dhe e njoftuan se nënprefekti në Prizren donte të fliste sa më parë me të. E tëra ishte një bluf, dhe, megjithëse Gjeçovi kishte marrë masa sigurie, u vra pas shpine nga po ata dy xhandarë, atëherë kur e kaloi Drinin e Bardhë duke u kthyer për në fshatin e tij. Edhe pse diheshin autorët e krimit, askush nuk u dënua për mizorinë. Kjo vrasje ishte pjesë e një dallge të gjithmbarshme terrori kundër shqiptarëve në përgjithësi e në veçanti kundër atdhetarëve që eliminoheshin kudo në Jugosllavi. Rasti i Shtjefën Gjeçovit nuk ishte as i pari e as edhe i fundit. Dallgët e terrorit janë shfaqur herë pas here gjatë një shekulli të tërë.

Mirëpo, vepra e Gjeçovit jeton. Hartimi i Kanunit, me komentet dhe sqarimet, na jep një depërtim të paçmueshëm në një vepër rregullash të lashta, bisqet e të cilës edhe në ditët tona shpesh krijojnë rubrika.

2. Nga Kanuni i Lek Dukagjinit: Libri i tretë. Martesa.¹¹

NYE I TREMBDHETET

32. Detyrat e burrit ndaj gruen.

Burri a në detyrë:

- a) me u përkujdesë për veshë e mathë e për gjithshka të lypet për me mbajtë jeten;
- b) me ruejtë nderen e grues e mos me e lanë me u ankue për kurrnji nevoje.

33. Detyrat e grues ndaj burrit

Grueja a në detyrë:

- a) me i a ruejte nderen burrit;
- b) me i rrogue pa zhibla;
- c) me i ndejë nen sundim;
- d) m'u pergjegje detyrve të kunorës;
- e) me rritë e me mkambë fmin me nderë;
- f) me ndejë gadi me të veshmen e të mathmen (kah e qepmja);
- g) mos me i u perzie në fejesë të të bijve e të të bijave.

NYE I NJIZETET

¹¹ Marrë nga teksti origjinal.

Trashigimi i grues Shqyptare.

Grueja shqyptare farë trashigimit s'ka te prindja, as me plang, as në shpi – kanuja e xen gruen si një tepricë në shpi.

Prindja s'mendon për pajë as për kurrnjë send për vajzë të vet; aj, qi e xen do t'i bajë kujdesin.

Prindja e djalit, qi e xun vajzën do të mendojnë për gjith shka duhet për martesë të saj.

NYE I TRIDHETEKATERT

Nana - Grueja.

- a) Burri nuk ka tanger mbijetë të grues;
- b) Grueja farë tagrit s'ka as mbi bijt as në shpi;
- c) Me vra i biri t'amen, bjen në gjak me prindt e s'amës;
- d) Me rrahë, me plyrë a me vra gruen e burrit dora e huej, ndereni a kërkon burri, varren e gjakun prindja.

e) Me rrahë kunetija gruen e burrit, prindja e grues i a lypin nderen, në mos i raftë mbrapa i shoqi;

f) Me kenë nana gergase (qi perzien shpin), i biri e qet t'amen prej shpijet pa pjesë e pa gja, veç se vjetin e parë do t'i apë bukën e gojës (tri barrë drithë) e tjetër s'i ka.

3. Mid'hat Frashëri: Grave. Nga "Plagët tona" (traktat dhe ese 1924)¹²

Kam nderin të flas me juve, Zonja, dhe më vjen shumë keq të them duke nisur fjalën: kam të qahem. Mos u trembni: vërejtjet do t'i bëj me respektin më të madh dhe do t'ju kërkoj ndjesë që tani në ju thënsha gjësend që të mos ju pëlqejë. Besomëni se zemra, në këtë orë, do të më donte të kisha vetëm fjalë të këndshme për juve, falënderime dhe lëvdata. Pse ndodhem i shtrënguar që të përziejë kritika dhe observata në bisedimin tim?

E kini vënë re padyshim, se, teto Tuleja ka shumë qarje nga e mbesa; mos pandehni se pleqëria e bën grindare: jeni e sigurtë se në zemrën e saj ka më tepër mëshirë dhe dashuri për ju nga ç'rrëfejnë fjalët e saj...

Gjer më tani më patë se kam disa shkaqe që të qahem prej burrave. Është fort e kuptueshme se, një pjesë e atyre ankimeve do të bien mbi ju, ju mëmat, motrat, gratë e burrave. Po merrni një përgjegjësi të madhe nga fajet dhe të metat e botës, dhe kjo është gjëja më natyrale, kur jeni mesi më impotent i kësaj shoqërie, kur se të kishit dashur do të ishit të zonjat që të ndalonit një pjesë të atyre lathitjeve.

Ju kallëzoj pra, zonja, dhe ju kërkoj ndjesë një herë akoma, ju kallzoj si fajtores, si shokë të fajtorëve.

Nuk ju kritikoj, po e shihni, pse feminizmi s'ka përparuar ndër ne; ju nuk ju qortoq pse nuk dini të kërceni; pse nuk vini në *dancing*, ose pse nuk kini fituar të drejta politike. Jo. Përkundrazi; dëshiroj, unë për veten time, që këto shenja të përjashtme – dhe të rreme – të qytetërisë, të vijnë sa më vonë këtu, tek vendi ynë. Nuk ju kritikoj edhe pse nuk pasoni modën, pse mbani veshjet e vjetra, dhe pse disa prej motrave tuaja rrinë këmbëzbathur në baltë dhe mbështjellë si gogol menjë "xhybe". Jo. Është e lirë që ta mbajë këtë kostum qesharak, dhe aq më tepër akoma sa thonë që "xhybeja" ka një veprim moralizonjës, e bën burrin t'i vijë frikë nga gruaja, të mos ta shohë gruan veçse në formën më pak të bukur dhe aspak tërheqëse të saj.

¹² Marrë nga teksti origjinal

Ajo që ju akuzoj është pjesa e paktë që merrni për njerëzinë, interesin e dobët që rrëfeni në rrojtjen dhe në fatin e kësaj shoqërie; që rrini si të huaja, si të ftuara. Padyshim vendi juaj dhe detyra që keni janë fort të rënda brenda në shtëpi, dhe përpjekjet që bëni për të bërë të këndshme jetën e brendshme meritojnë që të ju jenë të gjithë mirënjohës. Mjerisht jashtë pragut të shtëpisë e shikoni veten tuaj sikur s'jeni nga kjo botë; dhe harroni se një detyrë nuk mbushet dot duke u neglizhuar gjysma e punës.

Të drejtat e gruas ja ka rrëmbyer burri; po faji është i të dy palëve: në qoftë se burri, i shoqi, e gjykon gruan si një krijesë më poshtë dhe jo të denjë sa të shikohet pari, shoqe dhe baraz, në qoftë se e quan fëmijë, kalama dhe i vjen turp t'i zërë ngojë emrin e saj, s'do harruarë se dhe gruaja, me edukatën që i jep së bijës kur është e vogël, duke e quajtur veten e saj "femër", e vë duke dashur në një shkallë poshtërore, abdikon fuqinë e saj. Në shumë vende barbare zakoni dhe ligji i jep të drejtë burrit, "mashkullit", të sillet me mënyrë brutale me gruan e tij, ta ndajë nga martesja, ose të marrë më tepër se një grua, duke e ulur gruan në shkallë të një plaçke, meqenëse në vende të paqytetëruara mbretëron edhe zakoni për të blerë gruan në Pazar!

Po s'e di në, rregulla që ndiqet prej malësorëve tanë, duke vluarë çupën në djep, duke e martuar pa dashjen e saj, duke e shikuar të mjerën "femër" si një teshë këmbimi, a si një mjet miqësimi, është më pak barbare?

Që kurdoherë njeriu ka pasur nevojë të gjejë një skllav për të punuar në vend të tij, që të mos lodhet vetë: ka stërvitur kafshët, kalin, kanë, qenë; po kjo s'i ka arritur; ka bërë luftëra dhe ka zënë njerëz të gjallë dhe i ka përdorur si kafshë. Ka marrë gruan, mëmën dhe motrën e tij, i ka përdorur si skllave, meqenëse e varfra "femër" i ka më të dobët grushtet dhe më të vegjël dhëmbët. Në arabisht, në ca libra të "shenjta", gruaja quhet "*mallyn mut' atyn*" domethënë një plaçkë, një teshë, që shitet dhe blihet. Egoizmi brutal i burrit, ëmbëlsia e butë e gruasë, dhe mbase fatalizmi i saj, e kanë pranuar këtë situatë çnjerëzore, pa një përndërkim.

Për të çrrënjësuar skllavërinë janë bërë me qindra luftra, në çdo komb, në çdo shekull të kohës së vjetër dhe të mesme; më e fundit e luftërave që ajo në mes jugut dhe veriut të Shteteve të Bashkuar, luftë e gjakshme dhe vëllavrasëse; mezi pastaj u pranua që të zezët, negrit, të mos jenë më skllavë. Kështu është shkruarë për njeriun e mjerë: pa ngrënë dru të mos i vijnë mendtë në krye.

Thamë se egoizmi e shtyn të mbajë gruan në një gjysmë robërie. Padyshim shqiptari s'është i vetmi në këtë hall të keq dhe të turpshëm, dhe, në qoftë se malësorët tanë e duan gruan që ta ngarkojnë me shkarpa dhe vetë të lozin kartërat ose të tunden me xhamadan të artë dhe të gjuajnë në shenjë – mos harrojmë se në kombe të tjerë, mbase jo fort larg nesh, pozita në popull nuk është më e mirë. Mjerisht, ajo që më bën të mendohem është se, ndër ne, në Shqipëri, edhe pozita e zonjës së klasave të larta s'është më e mirë se ajo e popullit, e llauzit. Shtytja e burrit është egoizmi. Po ky egoizëm prapë sot duhet të bëjë që të dalë gruaja shqiptare nga situata e sotme, të zërë vendin që duhet të meritojë.

Më vjen keq ta them prapë po, në të metat që ka shqiptari, përgjegjësia më e madhe i bie shqiptarkës. Në qoftë se njerëzit tanë nuk janë aq aktivë, aq patriotë, aq të mëshirshëm dhe të drejtë sa dëshirojmë që t'i shohim¹³, cila grua u dha gjirin e saj, cila motër, cila grua, cila mëmë i këshilloi? Në qoftë se vendi ka mbetur kështu në varfëri dhe populli vuan në moskamje e në sëmundje, në qoftë se foshnjat tona i korrin mortja e keqe, ç'bëri gruaja jonë për këtë Shqipëri, ç'kujdes mori për të shëruar plagët morale dhe fizike të saj?

¹³ Thonë se gjenden gra në Shqipëri që shtynë djemtë ose vëllezërit e tyre të vrasin dhe të marrin shpagë. Po unë s'dua ta besoj. Do të ishte gjë fatkeqe të kishim gra kaq të këqia. (Fusnotë e Mid'hat Frashërit)

Kur është pra çështja për lumturinë dhe interesin e përbashkët, a mund që gruaja jonë të rrijë akoma indiferente, si një e huaj e ftuar në shtëpi të huaj? A nuk duhet, për të mirën e përgjithshme, të bëhet një sforcim i përbashkët, në bashkëpunim dhe harmoni, duke mbledhur tokë fuqitë? Apo duhet që të dy palët të shikohen armiq, dhe pjesa më e rëndësishme e njerëzisë, mëma, motra dhe shoqja, të rrinë të larguara, duke parë mjerimin dhe plagën?

Burri, në verbërinë e tij mashkullore, i kërrusur nën barrën e kalbëzuar të fanatizmit dhe paragjykimet që e shtyjnë të shikojë si një faj, si një turp, jo vetëm bashkëpunimin e gruas, po sa edhe të zërë ngoje emrin e saj, burri them, mund që të dojë të bëjë një vetëvrasje, se s'i pëlqen të shkundet prej pluhurit dhe të shpëtojë nga çimkat e ideve të mykyra. Po a duhet që gruaja të rrijë indiferente përpara rrezikut, të mos bëjë asnjë hap, asnjë veprim, dhe të vejë drejt vdekjes?

E dashur këndonjëse. E di që je e mençme dhe patriote. Në qoftë se të qortoj, po të akuzoj pse nuk bën ndonjë shërbim, dhe jo pse ke ndonjë faj. Jam i sigurt që edhe ti e e kupton mirë se, ky popull i varfër kurrë s'ka për të përparuar në qoftë se ti nuk mbush plotësisht rolin e mëmës, të motrës dhe të shoqes, dhe nuk merr pjesë aktive në edukimin e fëmijës, në shërimin e plagëve që mbulojnë trupin dhe shpirtin e kombit. Roli yt sot është të vuash dhe të shohësh të tjerët të vuajnë, pa nxjerrë zë. Detyra jote duhet të jetë që të shpëtosh nga ky pasivitet, të marrësh një detyrë aktive, si më tepër e interesuar që duhet të jesh.

Them që burri duhet të punojë, të stërvitet, të marrë edukatë dhe arsim. Po harrojmë sa kohë vdjerrin kot, sa minuta të vlefshme e venë dëm grave të Shqipërisë! Them se duhet të punojmë me një kujdes të madh për qytetërimin dhe begatinë e këtij vendi, për shëndetësinë dhe mirëshkuarjen fizike të këtij populli, dhe harrojmë se gjysmën e njerëzisë sonë, gjysmën që mund ta quaj më e mira, e ndalojmë prej çdo shërbimi, ose nga egoizmi ynë brutal, ose nga injoranca jonë qesharake, ose nga që i pëlqen dhe gruas vetë që të jetë përtace dhe të mbetet si foshnjë.

A presim ne përparim dhe dritë, kur zonja e shtëpisë dhe squka e fëmijës të rrijë në shkallë të ulët? A presim ne një zgjim të vërtetë kur çupat tona, zonjat e nesërme të rriten vetëm si kukulla? Apo pandehim se një çupë, një grua e ka mbushur gjithë detyrën e saj kur të dijë të tërhollë petë për lakror dhe të bëjë qofte me thërrime?

Them se palët e thella të kombit duan nxjerrë nga errësira, duan shkukur nga balta. Po si mund të hyjnë pak rrëza të sotme, sa kohë që ne na pëlqen të mbajmë gruan në tym dhe në pluhur të shekujve të vdekur?

Duam që të shpëtojmë llauzin dhe vendin tonë prej lëngatave, të kemi një popull të shëndoshë, një shtet të fuqishëm, dhe harrojmë që rolin më të madh do ta lozë gruaja, se ajo do të interesohet për të vegjlit, për rrojtjen e të varfërve, për shpëtimin e atyre që vuajnë dhe lëngojnë. Duhet të kuptojmë bukur e mirë se shpëtimi dhe shëndoshja e kësaj njerëzie nuk bëhet gjë e mundur po që gruaja dhe çupa e shtëpisë nuk arrijnë një shkallë inteligjence dhe kulture, që të bëhen me të vërtetë zonja shtëpie dhe mbrojtëse të folesë.

Mendohem qysh të shpëtojë Shqipëria nga varfëria ekonomike që sjellë injoranca dhe përtimi; po s'duam të gjykojmë një herë se, shpëtimi nuk mund të vijë veçse nga puna, dhe puna nuk mund të na jetë e dukshme po që se gruaja s'merr pjesë në të, duke ditur qeverinë e shtëpisë, duke kuptuar rëndësinë e ekonomisë shtëpiake, ajo dituri e administratës së vatrës.

Gruaja në Shqipëri gëzon një respekt dhe një nderim që s'e gjen lehtë në vendet e tjerë. Liria e saj është e plotë në viset e vendit tonë ku s'ka hyrë pseudo-qytetërimi i Azisë. Gruaja shqiptare është inteligjente dhe s'i mungojnë cilësitë morale të larta. Është e vërtetë se të drejtat e saj i janë mohuar. Po edhe do kujtuar kurdoherë se, të

drejtat fitohen prej atyre që janë të denjë t'i marrin, prej atyre që dinë përdorimin e mënyrës për t'i fituar. Dhe më tepër akoma, mbi çdo konditë është ajo e të merituarit.

Duhet pra që gruaja shqipare të përpiket dhe të rrëfeket e denjë për të drejtat njerëzore. Lipset që të bëjë forcime për t'u lartësuar intelektualisht dhe shpirtërisht, duke njohur vendin e vërtetë që i ka hije të zërë.

Atëherë do të bindet gruaja shqiptare se, në ringjallje të këtij vendi duhet të marrë pjesë, të bashkëpunojë duke prurë aktivitetin dhe inteligjencën e saj për shërbimin e dheut mëmë, për lumturinë e përbashkët, që kështu, duke siguruar jetën dhe fatin e bardhë të djemve dhe të burrave, të kenë siguruar dhe rrojtjen fatmirë të tyre.

Atëherë, sikundër çdo shqiptar sado i pasur, i ditur dhe i lumtur të jetë, e ka për detyrë që të kujdeset për të mjerët, për ata që janë fatzes, dergjen në injorancë dhe vuajnë në moskamje, ashtue dhe çdo grua, sado zonjë e madhe që të të jetë, sado që t'i qeshë fati në bukuri dhe lumturi, duhet që të bëjë pak therori nga koha dhe dëfrimet e saj, të kujdeset për gratë e varfëra, për ato që lëndojnë dhe pësojnë.

Rolin më të madh që pres prej grave tona është përhapja e parimeve të higjienës dhe të mirërrrojtjes fizike. Burri s'vete dot në shtëpi ku një e varfër dergjet e sëmurë, ku një lehonë ka nevojë për ndihmë, ku një foshnje vuan për një filxhan qumësht. Gruaja me zërin dhe dorën e saj të njomë, mund të lehtësojë plagët fizike dhe morale, të shpjerë ngushëllimin, të ngrejë një fëmijëri afër fikjes, të shpëtojë një tjetër që mend rrezohet.

Ca më pak se nga burrat do të gjendet një grua që të rrëfeket indiferente në gjallërinë dhe dobësinë e këtij trupi që i themi shtet. Ca më mirë nga burrat, gratë do të dinë, se jeta dhe lumturia e tyre është varur te jeta dhe lumturia e Shqipërisë, që pa shëndoshur të gjitha palët dhe shkallët e kësaj popullsie, vetë s'mund të quhen jashtë rrezikut.

*4. Enver Hoxha: Mbi disa aspekte të problemit të gruas shqiptare
(Fjala e mbajtur në Plenumin e 2-të të KQ të PPSH, 15 qershor 1967)*

Shokë,

Si konkluzion të pikës së parë, dëshiroj të them edhe unë disa mendime mbi këtë problem.

Partia i ka vënë vazhdimisht rëndësi shumë të madhe çështjes së gruas, këtij problemi shoqëror, jashtëzakonisht të madh, me të cilën janë lidhur fatet e popullit, socializmi dhe komunizmi, e ardhmja e vendit tonë. Problemet e gruas nuk janë të veçanta, specifike në kuptimin e fjalës, të veçuara e të izoluara nga problemet e tjera të shoqërisë, ato nuk janë probleme që mund të trajtohen dhe të zgjidhen me lehtësi, ose, ca më keq, të injorohen. Problemi i gruas nuk është vetëm një problem sentimentesh dhe, pra, të trajtohet në mënyrë sentimentale dhe romantike. Ai është një problem i madh i jetës, i zhvillimit dialketik materialist të historisë së njerëzimit.

Për këtë arsye Marks, Engelsi, Lenini dhe Stalini dhe të gjithë nxënësit e tyre i kanë vënë një rëndësi të dorës së parë problemit të gruas, çlirimit të saj, emancipimit dhe formimit të personalitetit të saj në një shoqëri të lirë, pa shtypës e pa shfrytëzues.

(...)

Sistemi kapitalist i shenjtërisë së pronës private, i shfrytëzimit të njeriut nga njeriu, i skllavërimit ekonomik dhe shpirtëror të njeriut, ka rënduar mbi të gjithë, por veçanërisht dhe në mënyrën më barbare mbi gruan. Gruaja ka qenë e para skllave dhe më parë nga skllavi, në historinë e njerëzimit. Gjatë gjithë kësaj historie, pa kaluar në prehistori, qoftë në kohën e qytetërimit helenik, qoftë në epokën romake, ose në mesjetë, në epokën e rilindjes apo në kohën moderne, dhe gjoja në "qytetërimin e rafinuar" kontemporan borgjez, gruaja ka qenë dhe është krijesa njerëzore më e skllavëruar, më e

shtypur, më e shfrytëzuar, më e përbuzur nga çdo pikëpamje. Ligjet, zakonet, feja, seksi mashkullor atë e shtypnin, e mbanin nën thundër.

“Antagonizmi i parë i klasave në histori - thotë Engelsi – bie në një kohë me zhvillimin e antagonizmit midis burrit dhe gruas në monogami dhe shtypja e parë e klasës bie në një kohë me skllavërimin e seksit femëror nga seksi mashkullor”¹⁴.

“Gjeta gruan më të hidhur se vdekja”, thotë diku Ekleziasti, kurse Shën Jan Krizostomi ka një mendim tjetër mbi gruan. Ai thotë: “Në mes të kafshëve më të egra nuk mund të gjesh më të dëmshme se gruaja”.

Shën Thoma d’Akuini, teologu filozof, që ka qenë një nga filozofët dominues të obskurantizmit mesjetar, mendonte dhe profetizonte se “fati i gruas është të rrojë nën thundrën e burrit”; dhe, më në fund, për ta mbyllur me këto citate barbare, “natyra i ka bërë gratë skllavet tona”, ka thënë Napoleoni.

Të tilla ishin pikëpamjet e kishës dhe të borgjezisë mbi gruan. Të tilla vazhdojnë të jenë edhe tani për borgjezinë. Në Evropë dhe të gjithë botën ka filozofë e letrarë të panumërt që epërsinë e burrit mbi gruan e kanë bërë një mit. Për ata burri është i fortë, luftëtar, kurajoz dhe, pra, më i zgjuar, prandaj ai është i predestinuar të sundojë, të drejtojë. Kurse gruaja, nga ana e saj, është prej natyre e dobët, pa mbrojtje, pa kurajë, pra duhet të sundohet dhe të drejtohet. Teorecienë të borgjezisë, si Niçe dhe Frojd, mbrojnë gjithashtu teorinë se mashkulli është aktiv dhe femra pasive. Kjo teori reaksionare dhe antibiologjike të çon, siç çoi, në politikë – në nazizëm dhe në seksologji – në sadizëm.

Nënat, gjyshet dhe stërgjyshet tona e kanë vuajtur këtë skllavëri të rëndë, i kanë hequr në kurrizin e tyre plot plagë këto mizori trupore e shpirtërore. Tani, kur te ne ka triumfuar revolucioni, kur ndërtohet me sukses socializmi, Partia na vë si detyrë të madhe, në mes detyrave më të mëdha, çlirimin e plotë dhe përfundimtar të gruas nga çdo prangë e së kaluarës së hidhur, na vë për detyrë emancipimin e plotë të gruas shqiptare.

Marksizmi na mëson se pjesëmarrja në prodhim dhe çlirimi nga shfrytëzimi kapitalist janë dy fazat e emancipimit të gruas. Partia jonë, që ndjek e zbaton me besnikëri parimet marksiste-leniniste, e çliroi me luftë dhe me revolucion popullin, dhe veçanërisht gruan, nga shfrytëzimi kapitalist dhe e hodhi atë në prodhim.

Mund të themi, pra, se duke i plotësuar këto dy faza, duke e zhdukur plotësisht që nga rrënjët shfrytëzimin kapitalist dhe duke e zhvilluar me vrull më tej pjesëmarrjen në prodhim, ne kemi arritur suksese të mëdha në emancipimin e gruas, emancipim që duhet të zhvillohet e të thellohet më tej. Gruaja, që është një forcë kolosale, përparimtare, po merr pjesë, krahas me punën prodhuese shumë të frytshme, në revolucionin e madh arsimor, kulturor, po thyen çdo barrikadë, po kapërcen çdo pengesë e paragjykim, tregon në çdo lëmë forcën e saj krijuese, fizike dhe mendore, pastërtinë e saj shpirtërore dhe morale; ajo po merr dhe do të marrë çdo ditë e më shumë pjesë në qeverisjen e vendit, në drejtimin e industrisë, të bujqësisë, të arsimit e të kulturës. Direktiva e Leninit se “çdo kuzhinierë duhet të mësohet të drejtojë shtetin”, po zbatohet çdo ditë e me sukses nga Partia jonë.

Prandaj çështjen e pjesëmarrjes masive të grave në prodhim, në drejtimin e ekonomisë dhe të shtetit, në marrjen e arsimit dhe të kulturës, Partia duhet ta kuptojë thellë, jo vetëm si një faktor ekonomik përparimtar të rëndësishëm, por pse është i tillë ai ka njëkohësisht edhe rëndësi të madhe ideologjike, politike, kulturore dhe që, pa

¹⁴ K. Marks e F. Engels. Vepra të zgjedhura, vëll. II, f. 234. Tiranë, 1975.

zgjimin e gruas, pa pjesëmarrjen e saj aktive e të ndërgjegjshme, asgjë nuk mund të ecë drejt dhe si duhet.

(...)

... Një nga deduksionet e mëdha shkencore të marksizëm-leninizmit është ai që thotë se “skllavërimi i gruas është i lidhur me shfaqjen e pronës private”. Ky deduksion i madh teorik ndodhet në librin e famshëm të Engelsit “Origjina e familjes, e pronës private dhe e shtetit”. Që t’i kuptojmë si duhet nga ana teoriko-filozofike marksiste-leniniste këto probleme, që të kuptojmë si duhet zhvillimin dialektiko-materialist të shoqërisë sonë shqiptare në të kaluarën dhe në të tanishmen, që të kuptojmë dhe të interpretojmë drejt fenomenet e jetës që zhvillohen me vrull para nesh dhe të përcaktojmë në mënyrë korrekte marksiste-leniniste vijën që duhet të ndjekim për ndërtimin e jetës së re, çdo komunist duhet të bëjë përpjekje dhe ta studiojë këtë libër, ose pjesët e tij të zgjedhura, të cilat, edhe në qoftë se nuk ekzistojnë, ta përgatitim në mënyrë të përpunuar, që ta kuptojnë të gjithë.

Po të studiojmë me kujdes veprën e At Shtjefën Gjeçovit, “Kanuni i Lek Dukagjinit”, dhe veçanërisht kapitujt mbi pronën, mbi trashëgiminë, mbi familjen, mbi gruan dhe martesat, do të shohim në realitetin tonë vërtetësinë e madhe e gjeniale të Engelsit. Do të shohim se si prona private e mban në skllavëri të tmerrshme gruan, se si ajo, në fakt, është shndëruar në një pronë të thjeshtë, që mund të blihet, të shitet. Në të thuhet konkretisht:

“Burri ka të drejtë me e rrah gruen, me e lidh gruen kur ia përbuz fjalën dhe urdhnin... Kurse baba ka të drejtë me rrah, me lidh, me burgos e me vra të birin dhe të bijën... Grueja e ka për detyrë ndaj burrit me i ndej nën sundim... Gjaku i grues ban 1500 grosh” etj.

Natyrisht, jemi larg me shekuj nga zbatimi integral i “Kanunit të Lek Dukagjinit”. Jemi gjithashtu larg periudhës që At Gjeçovi bëri përmbledhjen e tij. Por kjo nuk do të thotë se nuk ekziston deri diku, natyrisht jo në mënyrë të mprehtë si përpara, fryma e tij dhe rutina në zbatimin e mjaft prej këtyre zakoneve që neve na dalin përpara, sidomos në jetën shoqërore të malësive.

(...)

Antagonizmi i sekseve, siç na mëson Engelsi, mund të konsiderohet si i pari manifestim i luftës së klasave në historinë e njerëzimit.

Revolucioni proletar, ashtu siç zhduk kapitalizmin, borgjezinë dhe ideologjinë e saj, ashtu siç zhduk shfrytëzimin e njeriut nga njeriu dhe e çon njerëzimin në një shoqëri pa klasa, ashtu zhduk edhe këtë antagonizëm në mes të sekseve. Këtë ai e bën duke e çliruar plotësisht gruan nga çdo gjë që pengon liritë dhe të drejtat e saj të barabarta me burrin.

Martesa është një moment me shumë rëndësi në jetën e njeriut, me të cilën janë lidhur shumë zakone prapanike, që aktualisht edhe në qoftë se nuk ekzistojnë më te ne në atë mënyrë të acaruar si më parë, ekzistojnë prapëseprapë disa tradita të rënda që ruhen.

Engelsi thotë se martesa e bazuar mbi dashurinë është morale dhe atje ku dashuria qëndron, vetëm atje është martesa.

Në shoqërinë tonë socialiste për këtë ngjarje të madhe të jetës së njeriut duhet të udhëhiqemi nga ky parim.

Duhet njohur se te ne ekzistojnë dhe shprehen mentalitete të gabuara e prapanike mbi dashurinë. Kjo konsiderohet si diçka e turpshme, e palejueshme, jonormale. Mjaft herë dashuria, në mos plotësisht, taksohet si një gjë amorale, “që gruan e çon në kurvëri dhe burrin në degjenerim”. Këto janë mentalitete jo të drejta. Në qoftë se ka diçka që s’ka të bëjë fare me kurvërinë, kjo është dashuria e vërtetë. Në kurvëri nuk ka dashuri.

Për fat të mirë vendi ynë nuk e ka të njohur këtë plagë të tmerrshme të kurvërisë, që ne duhet ta luftojmë deri në tendencën më të vogël të shfaqjeve të saj, tendencë që mund të ndodhë nga shthurja jo drejt, jo në rrugën marksiste-leniniste, të çështjes së dashurisë dhe të martesës, nga mosluftimi si duhet në praktikë dhe në teori të pikëpamjeve dhe të praktikave borgjeze e idealiste në këto çështje.

(...)

Te disa intelektualë ekziston koncepti për të mos u martuar me shoqe të mësuara, qofshin këto edhe me origjinë ose gjendje punëtore, të shtyrë nga pikëpamja mikroborgjeze, për të sunduar mbi gruan, për të qenë eprorë ndaj saj, për ta destinuar atë brenda katër mureve dhe për punët shtëpiake. Natyrisht, të tilla pikëpamje të huaja për shoqërinë tonë duhet luftuar.

Disa herë nuk ka harmoni në familje. Unë nuk do t’i analizoj të gjitha shkaqet, por në qoftë se s’gabohem, arsytet e vërteta duhet t’i gjejmë vetëm në interesin e pronës. Atje e kanë ato burimin, pavarësisht nën ç’petk shfaqen. Këtë burim populli e shpreh kështu: “fukarallëku sjell grindje”. Nga pikëpamja e filozofisë sonë kjo do të thotë se fukarenjtë nuk grinden me njëri-tjetrin, por ngrenë krye kundër atyre që kanë pushtetin ekonomik, por edhe atë politik, si të thuash.

Në familje ka mosmarrëveshje dhe disa herë grindje në mes të nuses së re dhe prindërve të burrit. Mund të themi se fajet i kanë të dy palët. Mundet, por nuk duhet harruar se (sidomos te brezat e prindërve tanë, bile edhe te ne vetë, sido që shumë më lehtë se te të parët) ekziston tendenca e prindërve që djali dhe nusja duhet t’u binden atyre në çdo gjë. Botkuptimet e tyre janë të papastruara dhe kjo është e kuptueshme. Ata, duke qenë të rritur në një shoqëri borgjeze patriarkale, është vështirë ta kuptojnë plotësisht se nusja nuk duhet të jetë e bindur ndaj tyre për çdo gjë. Çdo veprim të nuses, e ardhur e huaj në familje, ata e shohin me dyshim, se mos ajo e bën për vete djalin, “shtyllën e shtëpisë”, se mos e largojë djalin e tyre nga pushteti i prindërve dhe cenohet kështu interesi i tyre ekonomik personal. Kjo ngjet ca më shumë kur prindërit tanë pleq nuk kanë asnjë burim ekonomik, përveç të ardhurave të djalit të tyre. Ky e dashuron gruan e tij. Këtë lindin xhelozitë, fërkimet dhe, disa herë, mungesa e ndjenjave të mira në mes nuses dhe prindërve të burrit të saj.

Nga ana e saj, nusja, gjithashtu, ka tendenca të drejta të çlirohet, të fitojë pozitë në familje, jo vetëm ndaj prindërve të burrit, por edhe ndaj vetë burrit të saj. Këto tendenca të së resë i kupton fare mirë plaka, pasi në kohën e saj instinktivisht ka tentuar dhe, meqë ajo në kohën e saj ka dështuar në këto përpjekje të saj të ligjshme, nuk e gjen të drejtë që e reja e saj të fitojë. (...)

5. Nga Fjala e mbajtur në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH, më 18 tetor 1969.

Disa burra flasin për “lirinë” e gruas nga zori, por në brendinë e tyre nuk janë plotësisht dakord. Ata s’kanë ç’thënë kur gruaja, vajza apo motra e tyre bën mbledhje në fabrikë, vete në klub, këndon e kërcen atje pa asnjë të keqe me shokët e saj të punës, por me të dalë nga fabrika ai e shfaq humorin e tij prapanik, i thotë se “gratë duhet të vij në drejt në shtëpi”, e pyet: “Ç’ishte ai burrë që të shoqëronte në rrugë?” etj. Lëre pastaj sikur të bëjë shaka e të vejë ndonjë shok pune t’i bëjë vizitë miqësore në shtëpi.

Atëherë u bë skandali. Në shtëpi, sipas këtij prapaniku, nuk mund të vijnë veçse kushërinjtë e familjes dhe vetëm gra. Burra të huaj, shokë e miq të punës, pa qenë burri i shtëpisë në shtëpi, është diçka amorale, skandaloze për këta konservatorë që flasin me gojë të madhe për “lirinë e gruas”, por në fakt janë për “liri të kufizuar”, liri të kontrolluar nga burri si në kohën e gjyshit. Sipas tij, garanti i nderit të gruas është vetëm burri dhe jo vetë gruaja.

Vazhdohet të mendohet prej disa burrave (dhe këta nuk janë të paktë, por të kuptohemi, nuk janë njerëz të këqinj, ata kanë lakra në kokë që duhet t’ua qërojmë) se gruaja nuk mund të ketë miq e shokë, të cilët mund t’i venë për vizitë në shtëpi, ta përshëndetin, të shëtitin me të në rrugë, të ulen me të në park. Ç’gjë të keqe ka këtu? Gruaja në shoqërinë e vjetër natyrisht ishte e mbyllur në shtëpi, shumë herë nuk lejohej t’u dilte as kushërinjve të saj, pa le miqve të burrit. Tani ndërroi krejtësisht kjo situatë, në fakt duhet të ndërrojnë edhe mendimet e mykura.

Përse burri ka të drejtë të vejë të bëjë vizita ku të dojë dhe kujt të dojë, kurse gruaja jo? Përse burri mund të shëtit në bulevard me një shoqe pune dhe gruan ta dënojë opinionin pse shëtit me shokun e saj të punës? Pse dy qëndrime të burrit dhe të opinionit konservator ndaj gruas në fabrikë dhe në shoqëri, jashtë fabrikës? Arsyeja e vetme qëndron në atë se këta i mundon e vjetra. Ata flasin për demokracinë, për të drejtat dhe lirinë e gruas, por nuk i kanë kuptuar thellë dhe drejt këto probleme kaq të mëdha jetike, shoqërore. Disa për këto gjëra, duke mbrojtur të vjetrën, hiqen si moralistë të mëdhenj, si njerëz tepër të ndershëm, por nuk thellohen se janë në bazë të shumë fatkeqësive, të shumë dramave, të shumë padrejtësive.

(...)

Frika e madhe, sidomos e disa prindërve, se mos vajzës së tyre i del nami i keq, e dënon opinionin dhe kjo frikë, që e ka burimin në botëkuptimet e vjetra, bën që me fjalë asaj t’i jepet liri, por në fakt për vajzën nuk ka liri të njihet dhe të zgjedhë atë që do. Ky është një problem shumë serioz. Në të parë duket sikur gabon po të thuash se prindi nuk ka të drejtë të qederoset, pse në realitet ai ka të drejtë dhe duhet të ketë të drejtë të qederoset, por as në parim dhe as në praktikë prindi nuk ka të drejtë t’i zhdukë lirinë dhe të drejtat vajzës së tij. Vajzën ai duhet ta edukojë me frymën e re për të luftuar në jetë, për të kapërcyer rreziqet, t’i kuptojë dhe t’ja shpjegojë rreziqet që mund t’i turren në jetë, të jetë me të jo një prind patriarkal, por një prind revolucionar, jo një prind që të ketë frikë dhe turp mikroborgjez që t’i flasë ç’është dashuria proletare, bile edhe më parë se vajza e tij të ketë rënë në dashuri me ndonjë djalë që ka njohur. Prindi duhet ta ndihmojë vajzën në kapërcimin e vështirësive të jetës, pse jeta nuk është e shtruar kurdoherë me lule, ta ndihmojë në mënyrë që vajza të shoh te prindi njëkohësisht një shok dhe jo vetëm një qortues dhe një diktator të egër.

6. Ana e ndritur e medaljes: Përparimi i viteve të fundit

Do të ishte një padrejtësi e madhe të thuhet se problemet që u prekën më sipër dhe ato raste të cilat do t’i përshkruajmë në vazhdim janë tipike për gjendjen e shqiptarëve. Ka disa familje, kryesisht nëpër fshatra, që i ruajnë traditat e vjetra, me të cilat shtypen gratë. Në qytete pjesa më e madhe e grave bëjnë “një jetë normale evropiane”. Në ato familje të qyteteve të Kosovës që unë i njoh, gratë, që të gjitha, i kanë zgjedhur bashkëshortët vetë dhe vajzat merren, bie fjala, me muzikë pop, në kohë të lirë shkojnë në vallëzim, bëjnë patinazh dhe slalom - skijim me zbritje zigzage, arsimohen njëjloj si djemtë. Në Kosovë ka mjaft mjekte, avokate dhe mësuese.

Burrat i ndajnë punët shtëpiake me gratë në shumicën prej familjeve, po ashtu një lloj i ndarjes së disa punëve në baza gjinore është më i zakonshëm në Kosovë se sa në

Suedi. Shkurorëzimet nuk paraqesin më ndonjë lloj skandali në këtë shoqëri. Vetëm se nuk është lehtë të jesh nënë e vejë. Kërkesat morale janë më të mëdha ndaj grave se sa ndaj meshkujve. Por as në Suedi nuk kemi farë barazie totale lidhur me aspektin moral të burrit, respektivisht të gruas.

Një pjesë e mendimeve lidhur me rolin e gjinive dhe mbi pozitën e gruas ka një prapavi religjioze. Porse një rëndësi shumë më të madhe e luajnë traditat, që shumë veta gabimisht i marrin si të mbështetura në religjion. Sidomos te muslimanët ka një pjesë të mirë të traditave, të cilave u mungon mbështetja në Kuran, e megjithatë i mbajnë ato me bindjen se ato bazohen në moralin islamik. Aty ku patriarkalizmi dhe mentaliteti feudal ende jetojnë – nëpër fshatra, vendbanime periferike – janë rreziqet më të mëdha për diskriminim dhe shtypje ndaj grave. Dominimi i burrave justifikohet me një farë kujdesi ndaj moralit të grave – sepse ato konsiderohen të jenë “gjinia e dobët”.

Neve vetëm na duhet t’i shohim marrëdhëniet në Suedi, ashtu sikurse ato ishin para një qind vitesh, që t’i kuptojmë një sërë problemesh. Ka shumë gra suedeze që ende jetojnë, e të cilat i përkasin brezit të parë të grave me të drejtë votimi. Gjatë fëmijërisë sime në vitet e 1930-’40, pjesa dërrmuese e vendeve të punës ishin të mbyllura për gratë. Në këtë kohë, te ne, pati filluar të aplikohet kufizimi i lindjes së fëmijëve.

Nataliteti i lartë në Kosovë është pjesërisht çështje e klasave: shqiptarët e arsimuar zakonisht kanë 1-3 fëmijë, kurse ata vetëm me shkollë fillore zakonisht kanë më shumë se 4 fëmijë. Kështu ka qenë dikur edhe te ne, por nuk është më. Një faktor i rëndësishëm është ai se në Kosovë ka ekzistuar një konsideratë më pozitive ndaj numrit të fëmijëve, se sa te ne suedezeit. Mund të thuhet se shqiptarët, në përgjithësi, kanë treguar një interesim më të madh për fëmijët. Mirëpo emancipimi i gruas është thuaja i pamundshëm, po qe se numri i madh i fëmijëve ka për pasojë faktin që detyra e saj jetësore të jetë përkujdesja për fëmijët dhe shtëpinë.

*7. Një feministe shqiptare në Maqedoni:
Fatmire Lumani: Shtjellë poetike, Strugë 1997.*

Fatmire Lumani ka lindur në Ohër më 1960. Ka studiuar juridikun në universitetin e Prishtinës dhe ka përvojë nga mënyra e jetesës si në Maqedoni edhe në Kosovë. Që nga viti 1993 ka publikuar një varg romanesh, dramash dhe përmbledhje poetike në shqip, të cilat janë pëlqyer shumë, sidomos nga lexueset e saja. Fatmirja shpesh shkruan mbi problemet e gruas dhe nuk frikësohet që ta sfidojë opinionin konservator. Realisht dhe me mençuri ajo tregon në romanet e saja, se nuk është çështja vetëm e emancipimit të gruas nga dominimi patriarkal i burrit, por po aq është edhe mungesa e vetëdijes në botën e grave, për çka traditat kontribuojnë që shumë prej tyre edhe të justifikojnë mendimet e prapambetura dhe patriarkale mbi rolin e gruas në shtëpi dhe shoqëri. Duke u nisur nga tema që trajtohet këtu, unë kam zgjedhur të ju prezantojë një prej poezive më rebele të Fatmire Lumanit:

REVOLTË

Kur lind femra
qan dhe streha.

Me të një lot
një klithje
një mallkim
një barrë
shtohet në botë.

Turp!
Nëse dëshira na pushton.
E ndaluar!
Të dashurojmë.
Mëkat!
Nëse ëndërrojmë.
Ngritje zëri?
S'guxojmë!
Duan të jemi
figura,
veç emra
si femra.

Një sy, verbo
një vesh, shurdho
makina për shumëzim
robot për punë
kukulla për argëtim
kështu bota na do.
S'është lehtë të jesh e tillë femër
moj zemër.

Që në djep
na lidhën me dizgje
sytë na i mbuluan me shami,
rritën dhe jetën
na e dënuan
në robëri
deri në përjetësi.

JO – JO!!!
Mbajeni për vete
ju që predikoni
këtë “drejtësi!”

8. Fati i një vajze shqiptare në mirëqenien suedeze

Në një farë mënyre të çuditshme, para disa vitesh, kam mësuar për përjetimet tepër të rënda të një vajze shqiptare, që kur ajo dhe familja e saj kishin ardhur në Suedi dhe ishin vendosur në një kamp refugjatësh në jug të vendit. Megjithëse unë e kam mësuar tregimin e asaj vajze me ndërmjetësim – e se si nuk mund ta tregoj – jam krejt i sigurt se ai është i vërtetë. Përmes disa lidhjeve të tjera kam mundur t'i vërtetoj disa detaje.

Vajza dhe i dashuri i saj u njohën në kampin e refugjatëve dhe ranë në dashuri. Pasi biseduan rrënjësisht gjendjen e tyre, u pajtuan që të jetojnë bashkërisht, të martohen dhe të krijojnë familje. Mirëpo kur vajza u tregoi për këtë prindërve të vet, ata nuk deshën që kjo lidhje të vazhdojë. Sidomos i ati nuk pajtohej. I ati dhe ajo u grindën për këtë, me ç'rast i ati ia ndaloi ta takojë të dashurin. E kërcënoi të bijën se, po qe se ajo do të vazhdonte ta takonte atë, do ta përzinte nga shtëpia. Meqë kjo gjendje kishte të bënte me të ardhmen e saj, ajo nuk pa ndonjë shtegdalje tjetër përveç se të zhduket nga kjo shoqëri e vogël, aty ku familja e saj ishte vendosur pas qëndrimit në kampin e refugjatëve, dhe të provonte të gjente një vend ku ajo do të mund të vazhdonte të jetonte, një vend sa më larg prindërve të saj. Ajo kishte frikë për jetën dhe sigurinë e

vet; dhe ishte e bindur se i kërcënohej rreziku. Në këtë frikë ajo ndjente një shpresë në mundësinë për të jetuar në Suedi, meqë e kishte kuptuar se këtu kishte mundësi për çdo njëri që vetë të vendosë për fatin e vet, edhe për zgjedhjen e partnerit dhe çështjen e martesës.

Pra, u detyrua të braktiste familjen një ditë të vjeshtës së vonë, si kusht që të mund të realizonte shpresat dhe qëllimet e jetës së vet. Shkoi tek ai vendbanim ku dikur ndodhej kampi i refugjatëve, aty ku kishte banuar më parë dhe ku i dashuri i saj ndodhej ende; mirëpo aty nuk kishte ndonjë vend që të mund të banonin të dytë së toku, prandaj e lutën shefin e kampit të refugjatëve që t'i strehonte për dy-tri ditë, derisa të gjenin një banesë të tyre. Dhe ju lejua të rrinin aty disa ditë. Ata nuk guxonin t'i tregonin askujt për rastin e tyre, se kishin frikë se mos i ati do t'u binte në gjurmë dhe mund të ndodhte ndonjë gjë e tmerrshme.

Pas pak kohësh, në Suedinë e mesme gjetën një banesë përmes një shpalljeje në gazetë dhe e nënshkruan kontratën, ashtu që tash kishin se ku të banonin. U vendosën në qytetin ku e kishin banesën, shkuan te organet e shërbimit social për të kërkuar ndihmë, mirëpo atyre nuk ju dha asnjë ndihmë. Morën menjëherë kontakt me SFI, një shkollë për të mësuar suedishten për të huaj, mirëpo aty nuk kishte ndonjë vend të lirë dhe u detyruan të prisnin derisa të lirohej ndonjë vend në shkollë. Provuan me të gjitha kontaktet, aq sa ju lejonte gjendja në të cilën ndodheshin, por asgjë pozitive nuk rrodhi nga to. I dashuri i saj merrte pak para nga kampi i refugjatëve ku ishte i vendosur, një ndihmë prej 61 koronash në ditë, të cilat nuk mjaftonin për të siguruar as gjërat më elementare ditore, pasi që duhej paguar qiraja e banesës. Për t'ia dalë disi, u detyruan të huazonin para nga miqët, që kishin mundësi të kursenin ndonjë gjë, por shpejt u shtjerrën edhe këto mundësi huazimi, sepse huadhënësit filluan të dyshonin se atyre nuk do t'u kthehej borxhi.

Kështu, me kohën, çifti i ri u gjend në një situatë, kur ata nuk kishin as se çka të hanin. Vajza u sëmurë, për ç'gjë i dashuri duhej të kontaktonte spitalin që ajo të mund të merrte ndihmën e nevojshme mjekësore, por ata u përgjigjën se nuk kishin se çfarë t'i bënin një njeriu i cili ishte i sëmurë nga uria. Ju propozuan që çifti i ri të shkonte te organizatat humanitare e të kërkonin ndihma, por asnjëri nga këta të rinj nuk dinin se ku duhej të drejtoheshin. Më në fund kontaktuan me një suedez që banonte afër tyre, dhe ai i ndihmoi me 100 korona si dhe u dha një qese domate, fryte dhe tranguj, ashtu që të mos vdisnin urie. Vajza u detyrua edhe një herë t'i drejtohej shërbimit social për t'u treguar për gjendjen në të cilën ndodheshin. Atëherë ata u dhanë ndihmë 736 korona. Meqë nuk kishin asgjë në banesë, për një kohë të gjatë flinin në dysheme; dhe kur një fqinj suedez i pa se ku flinin, u dha disa dyshekë, që të paktën të mos flinin në dysheme.

Vajza dhe i dashuri kishin rënë në një gjendje ku po vdisnin urie mu në mirëqenien suedeze. Vajza u dobësua edhe më dhe kishte probleme të vazhdueshme me shëndetin për shkak të urisë dhe vështirësive nëpër të cilat kalonte.

Sa kushtet e rënda në arrati, ishte edhe frika se mos babai i vajzës do të mund t'i gjente dhe t'u hakmerrej. E përjetonte si tepër të dhembshme faktin që nuk kishte kurrfarë kontakti me prindërit, por nuk guxonte t'u telefononte. Se cili ka qenë fati i këtij çifti, unë nuk e di. Shpresa e tyre e vetme ishte mëshira e Zotit, drejtësia dhe kujdesi i vendit ku ata ndodheshin.

E vetmja gjë që di për familjen është se e ëma e vajzës është ndarë nga burri, me të cilin kishte jetuar një çerek shekulli. Edhe ajo shihte shpresën te Suedia si mundësi që të çlirohej nga një despot, që donte të kishte tërë pushtetin ndaj grave. Mund të besohet se ky njeri nuk kishte as idenë se çfarë plagë u kishte shkaktuar të afërmeve të vetë. Me siguri mendonte se vetë ishte i drejtë dhe se të tjerët, përmes intrigave, donin t'ia

shkatërronin jetën. Mbi të gjitha, ajo që i kishte ndodhur atij ishte gabimi i Suedisë dhe i suedezëve, ky vend e ky popull që nuk respektonte konceptin e tij të moralit...

9. Edhe një vajzë tjetër shqiptare tregon për vuajtjet e veta

Në lidhje me përpjekjet për të marrë lejeqëndrim në Suedi edhe një vajzë tjetër më ka dërguar privatisht dokumentacionin e saj që ta ndihmoja për të vënë kontakte dhe për të ndikuar për rastin e saj. Këtu po e paraqes rrëfimin e saj, me ndryshimet që janë të domosdoshme për ta fshehur identitetin e saj.

Vajza ka ardhur si 19-vjeçare në Suedi dhe, së pari, ka qëndruar te një i afërm i saj. Problemi i saj ishte shumë i vështirë për t'u zgjidhur. Rridhte nga një familje fshatare me qëndrim patriarkal, dhe pas shkollës fillore e gjimnazit, u ndodh para dilemës se si do ta formësonte ardhmërinë e vet. Në atë gjendje që mbretëronte në Kosovë në fillim të viteve të 1990-ta, ishte e paimagjinueshme që kjo vajzë të mund t'i vazhdonte studimet në universitet apo ndonjë arsimim tjetër të lartë.

Familja e zgjodhën si rrugëdalje fejesën e vajzës me një burrë me gjendje të mirë ekonomike, një njeri që ajo nuk e njihte e aq më pak ta donte. Daja i vajzës ishte mbles së bashku me njërin prej xhaxhallarëve. Pa kurrfarë dijenie të saj, familja e saj dhe e burrit kishin bërë marrëveshje dhe e kishin vërtetuar këtë me ritualin shqiptar të besës, që do të thoshte se ndonjë thyerje e marrëveshjes ishte e barabartë me humbjen e nderit.

Kur vajza mësoi për këtë marrëveshje, përjetoi një shok të rëndë. Mësoi se burri që ia kishin zgjedhur i përkiste një familje fetare, babain e kishte haxhi, që domethënë se kishte bërë udhëtim pelegrini në Mekë. Kjo familje i përmbahej traditave të vjetra dhe diskriminuese ndaj grave. Kishin shumë tokë dhe punët e bujqësisë kryheshin kryesisht nga gratë në forma skllavëruese.

Përpjekja për ta prishur fejesën dështoi; babai nuk mund ta thyente besën e dhënë, e as familja tjetër nuk do ta pranonte prishjen e fejesës. Vetë vajza s'kishte të drejtë fjale, se i tillë ishte mendimi patriarkal. Vajza i drejtohet motrës së vet në Suedi për këshillë dhe mbështetje. Edhe kjo kishte qenë viktimë e traditave armiqësore ndaj gruas meqë ajo pa pëlqimin e prindërve ishte martuar me burrin me të cilin ishte në bashkëshortësi; kësaj, si dënim, ia pati ndaluar babai vizitën në familjen prindore për pesë vjet.

E motra nga Suedia e këshilloi që të nxjerrë një pasaportë dhe ta braktiste vendin, me qëllim që t'i shmangej problemit. Administrata serbe, policia dhe gjykata, nuk ishin për ndonjë lloj ndihme, dhe po qe se ajo do t'u drejtohej atyre do të konsiderohej si tradhtarë.

Vajza e mori pasaportën dhe erdhi në Suedi. Para se të nisej, e kishte takuar burrin e saj të caktuar nga të tjerët, dhe ia kishte bërë të qartë se nuk donte të lidhte bashkëshortësi me të. Ai nuk kishte dashur të ndiente për kundërshtimin e saj. Gjatë qëndrimit në Suedi, ajo kishte mësuar se i ati nuk kishte ndryshuar aspak qëndrim; ajo e kishte "çnderuar" familjen me sjelljen e saj, ani se kjo nuk e kishte ndryshuar faktin se marrëveshja ende ishte në fuqi.

Ç'ka ndodhur më pas? Vajza që kishte menduar se gjendja do të ndryshonte gjatë kohës sa ishte në vizitë te e motra, e kishte kuptuar se ndodhej para rrezikut, prandaj kërkoi lejeqëndrim në Suedi. I "fejuari" i saj kishte telefonuar te e motra dhe ishte sjellë aq keq, sa kjo ishte detyruar ta ndryshonte numrin e telefonit. Kundër vajzës ishte i ati, burri i përcaktuar dhe ati i tij, që të gjithë ndiheshin të cenuar dhe kërkonin hakmarrje, dhe xhaxhai i cili kishte marrë 1000 DM nga familja e dhëndrit për mblesi.

Enti suedez për çështjet e imigracionit, me motivime të dobëta dhe jo të natyrshme, e kundërshtoi kërkesën e vajzës për lejeqëndrim; edhe për lejeqëndrim me baza humanitare. Enti në fjalë nuk i kishte vënë në dyshim të dhënat e vajzës për gjendjen e

saj, por konsideronte se problemi ishte i karakterit privat. Se çfarë ka ndodhur më pas unë nuk e di, por besoj dhe shpresoj që ajo të mos jetë kthyer në Kosovë, ku e priste një martesë e detyruar e cila bëhej edhe më e rëndë për shkak të “tradhtisë” së saj ndaj marrëveshjes. Një errësi mesjetare mbulonte edhe veprimet e burokratëve suedezë e edhe patriarkalët shqiptarë në trajtimin e këtij problemi njerëzor!

Njollat e këtilla duhet të nxirren në dritë. Duhet të jetë e qartë për çdo njëri në këtë botë që thirret në të drejtat njerëzore, se prindërit nuk mund ta caktojnë jetën e fëmijëve të tyre, se prindërit dhe të tjerët nuk mund të kenë pushtet vendimtar mbi çështje kaq personale, si fejesa dhe martesja. Askush nuk ka të drejtë të vendosë mbi jetën e të rriturve të tjerë, askush nuk ka të drejtë ta detyrojë askënd në një lloj jete të cilën ai apo ajo e urren. Kjo është një gjë elementare, që do të duhej të ishte e vetëkuptueshme. Dhe ne duhet t’i mbrojmë principet e këtilla demokratike. Kurse në Evropë, e cila mburret për mendime moderne, detyrë absolute e autoriteteve tona është që ta kapin demin për brirësh kur është fjala për të drejtat e njeriut – në rast të kundërt do të duhej që personi përkatës të përgjigjej para gjyqit për veprimet e veta. Në raste të tilla, t’ia hedhësh fajin “përplasjes së kulturave” dhe “kujdesit për traditat e huaja” është një tolerancë e keqorientuar, që domethënë se veprohet në mënyrë të pandërgjegjshme dhe johumane. Krimet kundër të drejtave të njeriut nuk mund të arsyetohen në asnjë mënyrë.

7 PARLAMENTI I KTHYER NË TEATËR KUKULLASH – FATI I NJË GODINE SHQIPTARE

Prej Sheshit Skënderbeu në qendër të Tiranës, aty ku shtatorja e heroit kombëtar ngrihet mbi luzmën e njerëzve, kërkohet të ikim nga vapa e korrikut në ndonjë hije. Është viti 1979. Befas, shohim një grup fëmijësh që dalin nga një portë dhe vazhdojnë të ecnin teposhtë rrugicës në rreshta. Ndërtesa është mjaft e thjeshtë, me ngjyrë të verdhë. Sipër hyrjes shkruan “Teatri i Kukullave”.

“Aha”, u them unë shoqëruesve të mi Lars Holstein dhe Sherstin Sandberj, “këtu është parlamenti, i kthyer në teatër kukullash”. Ata më shohin me habi, e unë nxitoj t’i sqaroj, se sapo kisha lexuar një përshkrim lidhur me këtë godinë, që ka pasur fate të ndryshme.

Të gjitha vendet e zëna

“Dikur, kur Mbreti Zog e sundonte këtë vend, kjo godinë në të vërtetë ishte parlament. A shkojmë brenda e shohim teatër kukullash?” u propozova.

E thënë, e bërë. U pritëm shumë miqësisht nga personeli i teatrit, por për të parë ndonjë shfaqje teatrore kukullash ishte e pamundur. Deri te shfaqja tjetër duhej pritur edhe disa orë, e përveç kësaj të gjitha biletat ishin të rezervuara. E pranuaam këtë me keqardhje, ani se ishim të vetëdijsëm se në Shqipëri nuk shkohet aty për aty për të blerë biletat. Vizita e të huajve nëpër institucione është një çështje serioze, që duhet të realizohet përmes kujdesit të autoriteteve. Në këtë vend të izoluar, të gjithë të huajt konsiderohen si agjentë të mundshëm të fuqive të huaja, dhe për këtë arsye kontaktet jashtë programit nuk stimulohen. Ne të tre jemi në vizitë si përfaqësues të Shoqatës suedeze-shqiptare, por liri të lëvizjes së plotë nuk kemi as ne, dhe si delegacion, ne, nuk duam t’i acarojmë relacionet dhe ta rrezikojmë misionin tonë miqësor.

Do të mjaftohemi me këtë diskutim të shkurtër lidhur me teatrin e kukullave në përgjithësi dhe në veçanti lidhur me historinë e çuditshme të kësaj godine.

Shqipëria komuniste nuk e pëlqente parlamentarizmin perëndimor. Lidhur me këtë kështu shprehet Enver Hoxha:

Parlamenti borgjez i hap portat e veta për ‘deputetët’, mirëpo diktatura e klasës borgjeze e bën të veten: atje bëhen diskutime të pafundme, aty vazhdohet votim pas votimi, dhe marrëveshjet vazhdojnë në pajtim me vullnetin e atyre që i vendosin ligjet – të pasurit, pronarët e trusteve, monopoleve dhe bankave – dhe ky pushtet manipulon me parlamentin dhe qeverinë, si një forcë tjetër shtetërore kapitaliste, duke lënë anash faktin se një manipulim i tillë nuk parashihet në kushtetutën në fuqi. (Nga Fjala në mbledhjen e përgjithshme vjetore të Frontit Demokratik, më 20 shtator 1978).

Po qe se ne, në mënyrë të njëjtë, në ditët tona do të provonim të përshkruanim se çka ishte karakteristike për Shqipërinë e Enver Hoxhës sa i përket ushtrimit të pushtetit dhe marrjes së vendimeve, përshkrimi ynë do të mund të ishte afërsisht kështu:

Kuvendi Popullor socialist në Tiranë i ka të hapura dyert për “deputetët”, mirëpo diktatura e Enver Hoxhës dhe e Byrosë Politike vazhdon: Të gjitha çështjet që shtrohen për diskutim janë paraprakisht të vendosura, dhe duke u nisur nga ato direktiva që Partia i ka dhënë mbetet që Kuvendi Popullor vetëm të marrë në mënyrë unike vendimin, ashtu sikurse pritet prej tyre. Askush nuk guxon ta kontestoj gjithëpushtetin e Enver Hoxhës dhe të Byrosë Politike në tërë jetën shoqërore. Ministrinë, organizatat si Fronti Demokratik dhe Bashkimi i Sindikatave e të tjera – janë vetëm sa për të funksionuar si një jehonë e atyre vendimeve që Enver Hoxha dhe mafia e tij i kanë marrë paraprakisht. Ky manipulim është krejt i vetëkuptueshëm dhe – megjithëse nuk shprehet drejtpërsëdrejti – është i sanksionuar në kushtetutën shqiptare të vitit 1976

dhe në atë që quhet “diktaturë e proletariatit”, me fjalë të tjera ajo çka diktatori, Enver Hoxha, ka vendosur për vazhdimin e jetës së vendit.

Kështu ne u bëmë edhe më të ligj se sa vetë Enver Hoxha, por jo edhe më gënjeshtar...

E shtëna në parlament

Se parlamentarizmi perëndimor nuk kishte po ashtu ndonjë mundësi të madhe për të funksionuar në një vend si Shqipëria është e kuptueshme, po që se i hedhim një sy historisë shqiptare. Për më shumë se 400 vite Shqipëria ishte sunduar nga Perandoria Osmane dhe vetëm më 1912 – e fundit nga popujt e Ballkanit – e shpall veten si komb i pavarur. Kjo pavarësi, që nga filli u vu në pikëpyetje prej Fuqive të Mëdha dhe vendeve fqinje të uritura për territore. Vetëm më 1920 u bë e mundur që në Shqipëri të krijohet një fuqi shtetërore, autoriteti i të cilës shtrihej në tërë vendin në kufijtë e tashëm. Shqipëria ishte një vend, i gjymtuar nga caktimi i padrejtë e kufijve, i shkretuar nga ushtritë e huaja dhe zënkat e brendshme, epidemitë dhe uria.

Ky parashtrim përmbledhës tregon se kushtet për demokraci – çkado që të fusim në këtë koncept – ishte mendimi më i keq në një vend të tillë. Faktorët e pushtetit në Shqipëri kanë qenë pjesërisht prijësit e klaneve dhe pronarët e mëdhenj të tokave, pjesërisht disa palë të huaja – dhe gjithnjë më tepër pushtetarët politikë dhe ekonomikë fashistë në Itali.

Një ngjarje dramatike në parlamentin shqiptar, në fillim të viteve të 1920-ta, përshkruhet në librin e memoareve të priftit Fan Noli, botuar në mërgim në SHBA më 1958. Noli ishte patriot shqiptar e njëherit edhe kozmopolit, një njeri jashtëzakonisht i gjithanshëm: shkrimtar, përkthyes, muzikolog, prijës fetar ortodoks, deputet dhe për një kohë të shkurtër edhe kryeministër në qeverinë liberale më 1924. Noli kishte simpati të madhe për Bashkimin Sovjetik, dhe kjo i shërbente si nxitje për të reformuar Shqipërinë. Përpyekjet e tij dështuan në konfliktin midis pronarëve të pasur tokash dhe fshatarëve të patokë. E tash, të njihemi me përshkrimin e tij të një episodi të dhunës në parlament:

Deputeti Beqir Valteri, me motive gjakmarrjeje, tenton t’ia shuajë jetën kundërshtarit të tij, Ministrit të Brendshëm Ahmet Zogu – i cili më pas u bë Mbreti Zog I-rë. Vetë Noli ishte i ulur pranë plakut Aqif Pasha nga Elbasani dhe e përcolli me shqetësim dhe i shtangur dramën që po luhej para tij.

Befas, në korridor, deputeti në fjalë shtie disa plumba në drejtim të Zogut. I plagosur lehtë, ky nxiton brenda në lokalën e parlamentit dhe aty gjen mbrojtje.

Disa deputetë u fshehën nën banka, të tjerë filluan të klithin në mënyrë hysterike - rrëfen Noli dhe vazhdon: Aqif Pasha mbante një kobure në dorën që i dridhej, dhe e drejtoi kundër armikut të tij të vjetër Shefqet Verlaci, i rrethuar nga truprojat. Njëri prej truprojave dukej jashtëzakonisht i neveritshëm: buzën e epërme e kishte të ngritur dhe të shformuar, sa që nuk mund t’i mbyllte buzët; me dhëmbin e dalë jashtë dukej si një *bulldog* hungëruar dhe i lemerishëm.

Më tej, Noli rrëfen se si Valteri futet në një tualet, ku ai vazhdon të shtijë me armën gjithandej, duke kënduar njëkohësisht këngë patriotike. Afër tualetit, një deputet i partisë konzervatore ishte gjysmë i vdekur nga tmerri dhe çirrej se nuk kishte asgjë me tentimatentatin; i gjori, nuk guxoi të dilte jashtë, para se atentatori ta dorëzonte armën.

“Plot me gaz helmues”

Kjo ngjarje nuk ka ndodhur në atë godinë që e vizituam në Tiranë. Ajo kishte filluar të ndërtohej në janar 1925, atëherë kur Noli tashmë e kishte braktisur skenën, i larguar nga kundërshtari i tij, i lartpërmenduri Ahmet Zogu, që e shpalli veten president dhe tre

vjet më pas “mbret të shqiptarëve”. Qeveria e Nolit, që zakonisht quhet “borgjeze demokratike” nuk ka pasur jetë më shumë se gjashtë muaj.

Një paradoks interesant është ai se Noli, gjatë kohës së mërgimit në SHBA, për shumë vite ka marrë ndihmë ekonomike nga mbreti Zog. Është fakt se më pas, Noli ka qëndruar larg politikës dhe i është përkushtuar vetëm veprimtarisë fetare dhe hulumtimit muzikor.

Gjatë kohës sa ishte shëf i qeverisë, Noli ka provuar me çdo kusht t’i siguronte Shqipërisë një hua nga Lidhja e Kombeve, mirëpo pa sukses. Gjatë qëndrimit në Gjenevë, ai ka mbajtur një fjalim para Këshillit të Përgjithshëm, me ç’rast ironia e tij vrastare dhe arti spiritual i të folurit korrën triumf – porse, sikurse e thamë, pa rezultat.

Në fjalën e tij ai thekson çështjen e parlamentit dhe funksionit të tij:

“Nofta sekretari i përgjithshëm kish në mend të thotë që nuk dëshëron të hyjë në marrëveshje për hua me një guvernë kryengritëse, pa një parlament, si atë që kryesohet prej të përunjurit prift. Po e dini ç’është parlamenti? Pa fjalë e dini. Po do të kuptohet më mirë kur t’ju thom ç’mendoj për të. Parlamenti është një sallë ku mblidhen politikanë pa shpirt që bëjnë prova operate në trupin e gjallë të racës së vet, një sallë plot me gaz të helmuar, gazi mbytës, gazi që sjell lot, qeshje, tangoje dhe gjithë gazet e tjerë me të cilët u lëftua luft’e fundit që t’u jipte fund tërë luftrave dhe të vendoste paqë, paqen për të cilën bëjmë fjalë.

Po meqë shkëlmi këmbë, jemi gati të bëjmë zgjedhje të ra, dhe t’a thresim atë plagë, atë fatkeqësi të madhe, atë supersticje të mallëkuar, parlamentin, pas dy ose tre vjetësh qeverimi atëror. Do të kini mirësinë atëherë zoti Sekretar’ i Përgjithshëm, pas tre vjetësh, të më jipni huan prej 400. 000. 000 frangash të cilën m’u zotuat disa minuta më parë? Thuani “Jo?”. Përse? E dinja.”

Til Ojlenhpigeli dhe Nastradin Hoxha

Prej fjalimit të Fan Nolit deri te ai i Enver Hoxhës kanë kaluar më shumë se 50 vjet. Qëndrimi ndaj parlamentarizmit është negativ në të dyja fjalimet, dhe fatkeqësisht duhet thënë se një shqiptar që sot gjykon të njëjtën gjë, duke u nisur nga rrethanat e viteve të fundit në Shqipërinë postkomuniste, do të arrijë në të njëjtin përfundim negativ. Noli kurrë nuk ishte ndierë këndshëm në parlament gjatë atyre katër viteve sa kishte vepruar në të, së pari si përfaqësues i kolonisë së madhe shqiptare në SHBA, e më pas si deputet nga qyteti i Korçës, përveçse në ndonjë rast kur ai vetë ose ndonjë ngjarje farse e ndërprisnin plogështinë pompoze.

Oponenti më i njohur i Nolit, sikurse e përmendëm, ishte Ahmet Zogu. Ky ishte një prijës klanor nga Mati, që shtrihet në veri të Tiranës; ai së pari qe Ministër i Punëve të Brendshme e pastaj kryeministër. Në një fjalim, Noli e ka krahasuar Zogun me Til Ojlenhpigel, “Nastradinin gjerman”. (Nastradin Hoxha është një princ i qerratave në rrëfeizat tradicionale në të gjitha vendet e ish Perandorisë Osmane. Historitë mbi të janë të panumërta thujse si historitë suedeze të Belmanit). Kritikën kundër Zogut, lidhur me përpjekjen për të fshehur faktin se programi qeveritar i ashtuquajtur progresiv nuk qe zbatuar, Noli e paraqet si një anekdotë.

Ojlenhpigeli ishte lidhur një herë se, për shumë të madhe parash, do ta stoliste me piktura pallatin e kontit. Rezultati ishte baraz me zero, megjithëse Ojlenhpigeli i kishte shpenzuar paratë, pa e prekur thujja fare brushën! Kur konti dhe shpura e tij shkojnë për t’i vlerësuar pikturat, Ojlenhpigeli sqaroi se pikturat qenë të bëra në mënyrë aq të përkryera, sa që vetëm ai që ka lindur në shtratin jashtëmartesor nuk mund t’i shohë ato. Ato vepra që faktikisht s’ekzistonin, i vlerësuan spektatorët si njëmend të përkryera, pasi që ata nuk dëshironin ta njollojnë nderin dhe emrin e vetë të mirë. Qe

vetëm një çupëz e thjeshtë, e cila tha: “E mëshiroftë Zoti nënën time të shkretë, që më paska lindur kopile, se unë nuk po shoh kurrë!”.

Me këtë paralele me përrallën e H. C. Andersenit mbi *Teshat e reja të perandorit*, Noli donte të tregonte se si përkrahësit e Zogut, që e çmojnë atë për retorikën e tij boshe, nuk janë gjë tjetër përveçse hipokritë të mjerë.

Këtu duhet përmendur edhe një krahasim tjetër. Në një artikull në gazetën *Svenska Dagbladet* (*E përditshmja suedeze*), Sven Aurén tregon për ish-mbretin e plakur Zog, të cilin ai e kishte parë duke shëtitur në Rivierën franceze. Auréni e krahason Zogun me komikun amerikan Buster Keaton, i cili kishte një pamje të ngjashme të ngrysur dhe njëkohësisht pompoze si të mbretit tashmë Zog të hequr nga fronin. Në çdo tragjedi ka diçka komike, e në çdo komedi ka një grimë tragjike. Një pjesë e mirë e elementeve në historinë shqiptare janë, ashtu sikurse pretendon ky kapitull të tregojë, tragjikomike. Por komike nuk janë vuajtjet e pamasa të njerëzve të thjeshtë përgjatë tërë historisë së këtij populli, e pra njerëzit mu në mjerim – pavarësisht se për cilin popull është fjala – janë të aftë që ta shfrytëzojnë humorin si një mjet që, përkundër të gjithave, të mbahen. Mbase për këtë, mu në prag të krizave dhe kaosit lulëzon humori.

I përshtatshëm për diktaturën

I lartpërmenduri Sven Aurén ka botuar më 1936 një udhëpërshkrim nga Shqipëria, ky orient i Evropës, aty ku ai pjesërisht e shpjegon simpatinë e vet për shqiptarët, e pjesërisht i trajton një pjesë të fenomeneve në Shqipërinë e mbretit Zog, trajtim që bëhet në një farë forme përtallëse e kozeriste:

“Godina i parlamentit është këtu afër: një ndërtesë njëkatëshe e lyer me të verdhë. Sipër hyrjes shkëlqenin fjalët “Parlamenti” me shkronja të mëdha. Duhet informacion shtesë si sqarim, se përndryshe i huaji do të mundet lehtë ta merrte këtë parlament për pavijon të stërvitjes me armë.

E njoha një amerikan që ishte për vizitë në Tiranë, i cili, kur e pa për herë të parë godinën e parlamentit, qeshi aq shumë sa gati u shtang, dhe pati nevojë të shkojë në hotel e të shtrihet.

E përse u dashka patjetër të tallesh me ato proporcione modeste? A nuk është krejt në rregull që parlamenti i një shteti diktatorial të ketë një pamje të jashtme të parëndësi? Shqipëria nuk është e vetme që bënte kështu. Shikojeni parlamentin në vendin e sundimtarëve të mëhershëm! Ankaraja është një qytet ultra-modern me pallate funksionale, parqe për mburrje dhe monumente prej hekuri. Por edhe parlamentit turk do t’i duhej një mbishkrim sipër portës, sepse ai duket si një hotel qytetesh në ndonjë nga qytezat provinciale.”

Mund të pyes sekush se mos ka qenë takimi me ndonjë person me pikëpamje të njëjtë si ajo e amerikanit të sipërpërmendur, që e bëri arkitektin e godinës së parlamentit, i cili pasi e përfundoi ndërtimin, ta braktiste Shqipërinë përgjithmonë. Me gjithë se iu nda një mirënjohje nga qeveria dhe iu premtua se do t’i jepej një post shefi në administratë, arkitekti Mustafë Tabaku udhëtoi për në Amerikën e Jugut dhe kurrë më s’u dëgjua për të gjallë.

Mos vallë vuante nga kompleksi i inferioritetit, apo kishte hamendur se vepra e tij e parë nuk do të kishte atë funksion që pritej? Se nuk do të ishte një forum për debate konstruktive dhe vendime për reformat e vërteta, që ishin parakusht për vetë të ardhmen e Shqipërisë si një shtet i pavarur, i njëjtë me pjesën tjetër të Evropës? Se në vend të kësaj do të bëhej një teatër për shfaqje tragjikomike, ku një prijës feudal që e quante veten mbret, i mbante fijet e marionetave që vetë i kishte zgjedhur, dhe se ajo që ngjau në këtë ndërtesë nuk kishte mundësi në asnjë mënyrë ta pengonte katastrofën: inkorporimin e Shqipërisë në perandorinë italiane të Musolinit.

Më 2 prill 1939 pushoi ndërtesa të jetë një herë e përgjithmonë parlament. Pesë ditë më pas zbritën këmishëzinjtë në limanet shqiptare. Mbreti Zog u arratis, së bashku me familjen, oborrin e tij dhe arkën e shtetit. Në Evropën e pa interesuar, që kishte qeshur me mbretin plaçkitës, mendohej se kjo ishte fundi i një operete. Ndërsa populli shqiptar e mbante të qeshurën, sepse ishin të parët që u goditën me atë fat i cili së shpejti do t'i godiste edhe Poloninë, Çekoslovakinë, Holandën, Danimarkën, Norvegjinë...

Ndërmjetakt: Krill Gipolitoviç Dardanellov

Për shtatëmbëdhjetë vjet ndërtesa ishte e pashfrytëzuar. Është mjaft e çuditshme se si kjo ka mundur të ngjajë në një vend ku mungesa e banesave ishte e madhe dhe nevojat për ndërtesa publike ishin edhe më të mëdha.

Vetëm në fillim të 1956-tes u mbush ndërtesa me jetë dhe gjallëri. Zejtarët shkonin e vinin, sepse kishin filluar riparimet dhe, pas punimesh prej një jave e gjysmë, u hap aty një klub sovjetik me kapitenin rezervë Krill Gipolitoviç Dardanellov si shef.

Shpejt do të shihej se zgjedhja e ndërtesës do t'i përgjigjej shumë mirë qëllimit të ri: salla e madhe, aty ku deputetët dikur ishin mbledhur në seancat parlamentare, kishte një formë të tillë, që i bënte të mundur të hynte në shërbim për shumë qëllime. Për katër vjet me radhë, sa do të përdoret ndërtesa si klub sovjetik, kjo sallë nuk do të përdoret vetëm për festa jubilarë dhe të ngjashme, të cilat i duan rusët, por edhe si sallë kinemaje dhe si restaurant me hapësirë vallëzimi. Në fakt, gjatë tërë vitit organizoheshin vallëzime në mënyrë të rregullt në këtë lokal. Me pak ndryshime, salla i kryente të gjitha funksionet, që i kërkonin aktivitetet e ndryshme.

Që më 1956, në lidhje me kongresin e njëzetë të Bashkimit Sovjetik, ka filluar të çahen relacionet shqiptaro-sovjetike. Stalini, me politikën e tij kundër Titos, për shqiptarët ishte njeriu që i kishte shpëtuar të mos gëlltiteshin nga Jugosllavia. E vëllezërit e tyre në Kosovë tashmë ishin të gëlltitur, por kjo ishte një histori tjetër. Stalini nuk ishte përzier në gjendjen e brendshme të Shqipërisë, kurse Nikita Krushqovi në një mënyrë cenuese për shqiptarët ishte sjellë me superioritet me rastin e vizitës që i kishte bërë vendit. Një shembull nga ditari politik i Enver Hoxhës:

E martë, 2 qershor 1959.

Shkuam te pjesa ku bëhet kultivimi i portokallëve në Sqar. Vizitua edhe Butrintin.

Gjersa po kënaqeshim me pamjet e Butrintit (sidomos me gjurmimet arkeologjike – shënim i Ulmar Kvikut) e thirri Krushqovi Malinovskin dhe unë e dëgjova se si ai i pëshpëriti: ‘Ç’vend fantastik! Këtu do të mund të ndërtohej një bazë ideale për nëndetëset tona... Nga ky vend do të mund të ndërhynim dhe të paralizonim gjithçka?’

U befasova se si ai mund të farkëtonte plane të tilla, para se të konsultohesh me të zotin e shtëpisë, sikurse ne e kemi zakon të themi...

Prishja me sovjetikët

Mbi parlamentin shqiptar dhe fatin e tij është i shkruar një ese në stilin surrealist, publikuar në revistën letrare shqiptare “Nëntori” më 1978. Ky ese është i shkruar nga Bashkim Shehu, djalë i kryeministrit të atëhershëm Mehmet Shehu. Bashkim Shehu më pas do të përfundonte në burg dhe në internim për rreth nëntë vjet, pas “vetëvrasjes” së atit të tij e i cili më pas qe akuzuar se ka shërbyer si agjent i kamufluar për shumë fuqi të huaja. Akuzat absurde të Enver Hoxhës kundër vëllait të vjetër të armëve u publikuan më vonë në librin “Titistët”.

Më 1978, Bashkim Shehu ishte nën rrezet e diellit dhe mund të shkruante më lirshëm se sa pjesa dërrmuese e shkrimtarëve shqiptarë. Në ese ai tregon mbi thyerjen midis Bashkimit Sovjetik dhe Shqipërisë, si dhe se si të gjithë nënshtetasit sovjetikë e braktisën vendin. Sikurse është e vetëkuptueshme edhe klubi sovjetik u mbyll. Bashkim Shehu, me

stilin e vet surrealist, e përshkruan një mbrëmje në klub pak para mbylljes: Haxhimehdi Bahramovi, atashe ushtarak i ambasadës, me origjinë nga një prej republikave kaukaze, mbajti një fjalim të gjatë dhe të çuditshëm. I ngulur në karrige, i rrethuar nga një masë e vogël, por e shqetësuar, dëgjuesish, filloi të fliste me frymëzim e në mënyrë ceremoniale lidhur me largimin e tyre nga Shqipëria.

Vazhdimi ishte i komplikuar dhe i pa kuptueshëm, një shfryrje dhune e urrejtje me një porcion sharjesh pa lidhje, një porcion me ankesa fyese për pabesi, një porcion sentencash nga popujt e republikave sovjetike dhe nga vende të tjera, dhe së fundi disa pasthirrma, që dukeshin si krokama sorrash. Gjatë tërë kohës dëgjuesit qëndruan si të mpirë, me përjashtim se herë pas here duartrokitnin si të ishin robotë. Ekstaza e tyre ishte e heshtur dhe e pahetueshme...

Me kohë fjalimi i Haxhimehdi Bahramovit filloi të marrë fizionomi, të bëhet kompakt dhe i kuptueshëm, së fundi ishte i pikëllueshëm dhe përplot me keqardhje. Si një pamje e largët aty ishte edhe orkestra, e cila pa pra lozte në sallën thuajse të zbrazët. Ky ishte fundi i koncertit evropaziatik, që kishte ngjarë me vite, muaj pas muaji...

Kështu paraqitja kaloi nga mërmëritjet e panumërta neandertale deri te ndarja në një lagunë të qetë të optimizmit dhe ngushëllimit se kjo tërheqje do të ishte vetëm e përkohshme, se, pa fiye dyshimi, ata të gjithë do të ktheheshin në këtë vend: të gjithë do të vinin – jo në aeroplanët Tupolev dhe Antonov – por në çilima fluturues. Pikërisht për këtë, kohëve të fundit; ata i ishin pajisur me çilima. Mandej tregoi një legjendë kaukaziane të shekullit të XVII, ku flitej për kthimin e armatës së carit pasi më parë kishin pësuar humbje nga sulmuesit turq dhe kurd.

Kjo legjendë e moçme ishte në vargje (Haxhimehdi Bahramovi citonte herë-herë dytri strofa) dhe tregonte për një ushtar sllav, që kishte mbetur i plagosur dhe kishte shkruar në një guri diçka thuajse biblike, si përmbajtja e mëposhtme: “Ne po largohemi nga ky vend duke lënë këtu hijet tona dhe fantazmat, por një ditë do të kthehemi ne e t’i mbushim ato me trupat tanë. Ajo ditë do të jetë Dita e Kiametit”.

Krejtësisht në fund, pasi Brahamovi kishte bërë një pauzë dhe kishte hedhur shikimin në drejtime të ndryshme, ndoshta për ta zgjuar interesimin e dëgjuesve, u shpreh me kënaqësi përzier me zemërim duke thënë: “Ju jeni në një hon të thellë, të thellë e të tmerrshëm, në të cilin turret rrjedha e ujëvarave të mia ...”

Teatri i Kukullave

Që më 1945 në Tiranë është themeluar Teatri i Kukullave. E më 1961 ai u bart në ish ndërtesën e parlamentit dhe të klubit sovjetik në rrugën Stres Balsha II.

Pasi që kjo ndërtesë kishte strehuar deputetët e Zogut e mëpastaj diplomatët dhe atashetë sovjetik, në fund ajo u pushtua nga Gishtoja, Til Ojlenhspigel, Borëbardha dhe shtatë shkurtabiqët, baroni Münchhausen, Maçoku me çizme, Harlekini dhe personat e “Rrobot e reja të perandorit”.

Para se të mund të shfaqej premiera e teatrit të kukullave në ndërtesën e vjetër të parlamentit, aty mbretëronte një gjendje e parregullt për shkak të riparimeve, rregullimit të kukullave, rekuizitave të tjera në ambientin e ri dhe shqetësime të tjera që lidheshin me transferimin. Nuk ishte për t’u çuditur që mjeshtri i vjetër i kukullave Simoni, i cili ishte me teatrin e kukullave që nga fillimi, dremitej i lodhur në një kënd. Ai, sipas Bashkim Shehut, atëherë pa këtë ëndërr:

Po shëtiste përsëri në ato rrugë të ngushta me qiparisa dhe mure kopshtesh në të dyja anët, por kësaj here në drejtim të kundërt. Ishte mesi i ditës, rrezet e diellit të forta dhe verbuese. Kaloi shpejt e shpejt në rrugën e zbrazët. Edhe rrugicat që kalonte ishin krejtësisht të zbrazëta.

Mbërriti te Teatri i Kukullave. Premiera do të fillonte. Në dukje, qe Simoni i fundit që mbërriti. Te porta e hyrjes priste portieri i vjetër i teatrit.

“Hyn” – tha ai. – Të gjithë janë këtu. Deputetët, princat, ambasadorët, admiralët dhe kardinalët”.

Simoni kujtoi kardinalin Mindsenti, pastaj ish-regjentin hungarez Horthy, admiral në një vend që nuk ka bregdet. Qeshi me zë. Vetëm se nuk i kujtohej se ku kishte dëgjuar për këtë... E pyeti portierin se mos po mendonte në ata dy.

“Hyn” – tha ai sërish. “Të gjitha uniformat i ke aty, të gjalla a të vdekura”

Si gjarpërinj

Simoni u ngjit nëpër një shkallë që e çoi te një stadion antik, një amfiteatër. Amfiteatri qe i ndërtuar në formë gjysmëharkore, krejt si një ndërtesë që ai e kishte parë diku, ndoshta në TV. Lart ishin ca statuja, që jepnin një përshtypje të zymtë me kablllo mikrofonash rrethqark trupave të tyre. Mikrofonat lëviznin dhe shkonin para e pas. Kur Simoni i shkoi me vëmendje, kabllot iu duken si gjarpërinj të zinj të lëbyer, por nuk kishte frikë. Kërkonte një ulëse.

Në të gjitha shkallët, në tërë gjatësinë e tyre, qenë vendosur garderoza prej hekuri. Në to qenë varur rresht pas rreshti uniforma të të gjitha llojeve dhe me çdo lloj rang civil e ushtarak. “Portieri i vjetër ka të drejtë”, mendoi mjeshtri i kukullave. Vërejti se në mes të uniformave vareshin edhe shumë kukulla, asosh që vetë i kishte bërë dhe të tilla që as i kishte parë më herët. Atje poshtë në arenë, larg sikur të shihte përmes një xhami që i zvogëlon pamjet, mezi dalloi disa grupe njerëzish që luftonin kundër njëritjetrit. Uniformat dhe kukullat tundeshin në varëset e tyre. Dukej sikur donin të thoshin: mos ashtu, mos ashtu. Simonit iu bë sikur rrodhi gjak nga krahët e palltove.

“Hohoho” u kakaris mjeshtri i kukullave. “Gjithçka është ngatërruar. Njerëzit zihen në skenë, kukullat dhe uniformat janë shndërruar në publik”.

Përskaj Simonit ishte një kamerë në stativ. Në një tabelë qe shkruar: “Dhuratë nga nënkoloneli A. F. Gavrilenko me rastin e Kongresit të XX të Partisë”. Përmes kamerës dukej se gjithçka qe kthyer për së mbrapshti, kurse përmes thjerrzave zvogëlohej arena deri në padukshmëri. Dikush shpërndante fotoalbume në publik. Tash pushuan dridhjet e kukullave gjithandej. Në kostumet e deputetëve, në kapotat e oficerëve, në mantelat e dukëve dhe në tunikat fisnike dukeshin fijet rreth copave, ku marionetat vareshin, si puçurra të plagëve të vjetra. Mjeshtri i kukullave me njërin sup u anua më përpara që më mirë të dallonte ndonjë nga fotografitë interesante. U lakua edhe më përpara: gjithçka u shndërrit, fotografitë shpërthyen në një dritë verbuese si të qe ndonjë eksplozim i bombës atomike. Arena, garderobat, shkallët e gurta, statujat – gjithçka u zhduk sa çel e mshel sytë... Mjeshtri i kukullave sërish u gjend në atë rrugë të ngushtë me qiparisa dhe mure kopshtesh në të dyja anët. Dielli i mesditës ndrinte fuqishëm dhe verbueshëm, ashtu sikurse kishte bërë milenium pas mileniumi.

Simbolika parodike – dhe tragjike

Pasi dolëm në rrugë pas vizitës në teatrin e kukullave ishte koha të ktheheshim te Hotel Dajti. Po mendoja për atë përshkrim që lexova në “Nëntori”, para se të udhëtoja për në Shqipëri. Ëndrra e mjeshtrit të vjetër të kukullave kishte kuptimin e një lidhjeje në mes të teatrit të kukullave dhe ushtrimit të pushtetit nga lloj-lloj ushtarakësh dhe civilësh në shoqëri të ndryshme nëpër kohë. A mund të jetë se shqiptarët që më 1956, atëherë kur ata e lejuan ndërtesën të funksiononte si klub sovjetik, ta kishin bërë këtë qëllimisht si provë e cila shprehte një simbolikë parodike? Pa fije dyshimi se kishte ngjashmëri në mes të kukullave dremitëse të mbretit Zog në parlament dhe ithtarëve në klubin sovjetik, të drejtuar me fijet prej Bashkimit Sovjetik.

Nëse jo më parë, atëherë simbolika do të ketë qenë aktuale më 1961, atëherë kur prishja me sovjetikët ishte një fakt dhe kukullat pushtuan ndërtesën! Porse, njëzet vjet pas vizitës, e shoh një simbolikë edhe më tragjike: në kohën e Enver Hoxhës shqiptarët e mësonin një aksiomë: Ne bëjmë gjithçka nën udhëheqjen e Partisë. Dhe kështu edhe ishte – çdo iniciativë individuale apo kolektive, që nuk e kishte miratimin e Partisë së gjithëpushtetshme, konsiderohej si veprim armiqësor. E kur sistemi i vjetër u rrënuar, doli se një pjesë të madhe të shqiptarëve u mungonte aftësia për veprime konstruktive, meqë ata nuk kishin mësuar ndonjë sjellje tjetër sociale përveçse përmes detyrimit të hekurt apo thjesht përmes dhunës. Kur gjithëpushtetshmëria u shemb, pushuan idealet, njerëzit u bënë asocijalë, pa aftësitë për të parë diçka tjetër përveç interesit personal, një pjesë e të cilëve përdornin të gjitha mjetet e mundshme për ta arritur atë. Shqipëria u bë një Perëndim i Egër.

Simbolika politike është një çështje, kurse funksioni primar i teatrit të kukullave është një çështje tjetër. Ky duhet t'i argëtojë fëmijët – dhe të rriturit që kanë ruajtur në shpirt fëmijërinë. Sot kanë marrë fund edhe regjimi i mbretit Zog, klubi sovjetik dhe sundimi i Enver Hoxhës, kurse teatër kukullash do të ketë gjithmonë dhe ai do ta ketë vendin e vet në jetë.

A MUND TË MËSOHET SHQIPJA?

Një pyetje që shpesh më shtrohet, kur zihet në gojë gjuha shqipe, është kjo: Cilat gjuhë të tjera i përkasin së njëjtës familje me shqipen? Zakonisht pyetësi befasohet kur unë përgjigjem, se gjuha shqipe nuk i takon ndonjë familjeje tjetër të gjuhëve. Sikurse suedishtja dhe gjuhët tjera evropiane – ndër të tjera përveç finlandishtes dhe hungarishtes – edhe gjuha shqipe i takon familjes së madhe të gjuhëve indoevropiane. E në kuadër të tyre, gjuha shqipe është një ndër më të lashtat dhe më origjinalet. Për këtë mund të lexosh një ese të linguistit Holger Pedersenit, ese të cilin e kam prezantuar këtu në kapitullin “Takimi me albanologë dhe disa të tjerë”.

Pyetjet lidhur me origjinën dhe lashtësinë e gjuhëve zakonisht janë të zorshme për t’u përgjigjur. Hulumtuesit detyrohen të kombinojnë pjesëza të mbetjeve të parëndësishme gjuhësore, ndonjëherë aq të shtrembëruara, sa që rreziku për gabime është thuaja i pashmangshëm. Tashmë ekziston bindja se shqipja rrjedhë nga ilirishtja, gjuhë kjo që është folur nga një numër i madh fisesh në një hapësirë të madhe në lindje të detit Adriatik para erës së re. Më pas, ilirët u mundën prej romakëve ekspandues, mirëpo gjuha e tyre do të jetojë edhe më tutje në viset e paarritshme malore, konkretisht në malet shqiptare.

Fjalët e huazuara

Bërthama e gjuhës shqipe, pra, është prej fjalëve me gjenezë ilire. Kur ndokush dëgjon ose lexon në gjuhën moderne shqipe lehtë mund të fitojë përshtypjen sikur shqipja ka lidhje familjare me gjuhë të tjera të Mesdheut; kjo përshtypje është pasojë, kryesisht, e përdorimit të shumë fjalëve të huazuara, të hasura më së shpeshti në literaturë profesionale dhe gazeta shqiptare. Bërthama e shqipes së pastër me origjinë indoevropiane ka rreth 2000 fjalë, të cilat përbëjnë bazën për fjalëformime të reja.

Gjuha shqipe ka huazuar fjalë prej greqishtes që nga kohët më të lashta, por sidomos në kohën bizantine, domethënë mesjetës së hershme.

Fjalët e huazuara latine janë të shumta dhe të rëndësishme, të cilat i gjejmë me bollëk në të gjitha fushat e veprimtarisë materiale dhe shpirtërore. Hulumtuesit mendojnë se në gjeografinë shqiptare, para së gjithash në trevat e Shqipërisë së tashme zyrtare dhe në Kosovë, është folur latinishtja nga popullata në luginat dhe fusha gjatë mesjetës së hershme, kurse ajo pjesë e thesarit të fjalëve që ka të bëjë me jetën në malësi ka karakter ilirik. Ai që e njeh latinishten klasike e ka mjaft të vështirë t’i identifikojë elementet latine në gjuhën moderne shqipe, pasi që këto vijnë nga gjuha e popullit, nga latinishtja vulgare, e cila është nënë e gjuhëve romane si italishtja dhe spanjishtja. Ja një krahasim i fjalës “kali” në këto gjuhë:

latinisht (klasike): equus
latinisht (vulgare): caballus
frëngjisht: cheval
italisht: cavallo
rumanisht: cal
shqip: kalë

E bija e gjuhës latine, italishtja, ka lënë gjurmët e veta në shqip qysh gjatë mesjetës, si dhe gjatë kohës së perandorisë osmane. Mirëpo, pjesa më e madhe e fjalëve të huazuara italiane kanë hyrë në shqip pas vitit 1912 dhe sidomos që nga pushtimi fashist më 1939. Praktikiht, i tërë fjalori teknik dhe i ndërtimtarisë është marrë nga italishtja,

e po aq shumë fjalë në kuadër të bujqësisë, pajisjeve, ekonomisë shtëpiake, modës dhe artit. Pas vitit 1944 është hequr një pjesë e italizmave nga shqipja si të panevojshme.

Gjatë shekullit XIX dhe XX, frëngjishtja si gjuhë e kulturës dhe e letërsisë kishte ndikimin më të madh në shqip. Këtu ka luajtur një rol të madh edhe fakti se shumë intelektualë shqiptarë, ndër të cilët edhe Enver Hoxha, kanë jetuar dhe studiuar në Francë, ku kanë përvetësuar njohuri të mira mbi kulturën dhe gjuhën franceze.

Edhe gjuhët sllave, para së gjithash, bullgarishtja, serbishtja dhe rusishtja, kanë ushtruar ndikim gjatë thuaja njëmijë vjetëve. Huazimet e fundit kanë të bëjnë me marrëdhëniet në shoqërinë socialiste, përfshirë këtu fjalë, nocione e madje edhe fraza të tëra, sidomos në terminologjinë sociale dhe politike: institut pedagogjik, organizatë partie e kështu me radhë.

Sa i përket Kosovës, këtu janë huazuar më tepër fjalë sllave në shqip se sa huazimet e bëra në shtetin shqiptar. Për më shumë se tetëdhjetë vjet Kosova ka qenë nën Serbi, gjë që ka ndikuar fuqishëm në gjuhën e folur e të shkruar në Kosovë, megjithëse që nga viti 1972 janë bërë përpjekje të organizuara për ta përshtatur gjuhën me shqipen kombëtare, të cilën shqiptarët e quajnë – gjuha e njësuar.

Së fundi, edhe diç për ndikimet e gjuhës turke në shqipen. Nga fundi i shekullit të XV dhe për më tepër se 400 vjet me radhë Shqipëria ishte e përfshirë në perandorinë osmane. Kjo sigurisht se do të godiste, para se gjithash, pjesët bregdetare dhe fushore, gjë që ka lënë gjurmë të pashlyera dhe të thella në gjuhën shqipe, e sidomos në dialektet shqiptare të veriut, duke llogaritur edhe dialektet e Kosovës.

Shumë fjalë turke janë zhdukur nga përdorimi i përditshëm, disa janë ruajtur ende në disa zhanre - si për shembull në përshkrimet historike dhe satira – e një pjesë tjetër jetojnë ende në shprehje, fjalë të urta popullore etj.

U ndala mjaft në detaje lidhur me fjalëhuazimet, me qëllim që të tregoj se ata që tashmë dinë pak frëngjisht, latinisht ose italisht kanë pakëz “ndihmë joshëse” për të mësuar shqipen. Elementet turke dhe sllave nuk e lehtësojnë mësimin e shqipes për shumicën e suedezëve.

Është me rëndësi për të theksuar se gjuha shqipe, si tërësi, ka një karakter krejt të veçantë. Kur ndokush sado pak familjarizohet me shqipen e përjeton identitetin e shqiptarëve, që është shumë tipik, në një mënyrë të ngjashme sikurse, ta zëmë, po ta takosh përjashta në rrugë një person të panjohur - me pak intuitë dhe përvojë menjëherë mund ta dallosh se personi i panjohur është shqiptar, madje para se ky njeri ta hap gojën për të folur.

Krejt në fund: Ka një ngjashmëri interesante ndërmjet sintaksës së gjuhës shqipe dhe asaj rumune. Bashkëngjitja e fjalëve, formimi i frazave dhe një sërë fenomenesh të tjera dëshmojnë për kontaktet e gjata me vllahët – një popull baritor rumun që ishte i përzier me ilirët dhe shqiptarët para dhe pas kohës bizantine. Nga ilirishtja, latinishtja dhe vllahishtja është formuar gjatë mesjetës gjuha e tashme shqipe.

Dialektet

Në disa enciklopedi të vjetra si dhe në tekste të tjera mund të hasen pohime se shqiptarët i flasin dy gjuhë të ndryshme, gegërishten në veri dhe toskërishten në jug. E vërteta është se ato janë dy dialekte kryesore brenda një gjuhe të vetme. Por duhet pranuar, se për një person që ka mësuar gjuhën kombëtare, e cila më tepër bazohet në elementet e shqipes së jugut, e ka mjaft vështirë për ta kuptuar një pjesë të dialekteve të gegërishtes.

Për njohësit e kësaj çështjeje duket pak e befasishme fakti se ndarja dialektore është më e madhe te shqiptarët se sa te ne suedezët. Shkaku është se izolimi i fshatrave, qyteteve dhe regjioneve ka qenë më i gjatë se sa këtu lart, në Evropën veriore, një izolim

i cili përforcohet me prapambetjen sociale që ka mbretëruar në Shqipëri deri në kohët moderne. Në aspektin topografik ka ngjashmëri me Norvegjinë – me male të larta dhe fusha të ulëta – dhe sikurse është e ditur, vëllezërit tanë në perëndim kanë një ndarje dialektore më të madhe se sa në Suedi.

Dallimi më i rëndësishëm ndërmjet gegërishtes dhe toskërishtes ka të bëjë me zgjedhimet e foljeve. (Kufiri midis këtyre dy dialekteve kryesore shtrihet te lumi Shkumbin, në mesin e shtetit të sotëm që quhet Shqipëri). Lidhur me të ekzistojnë koncepte krejt të ndryshme, gjë që mund të shihet edhe nga shembulli në vazhdim; fraza në suedisht: ‘Skulle du kunna gå och säga till honom att komma och besöka mig’ në Shqipërinë veriore do të thuhet: ‘Me kenë me shkue me i thanë me ardhë e me më pa’. Fjalë për fjalë, fraza e mësipërme suedeze, do të merrte këtë formë: ‘Att vara att gå att säga honom att komma och att mig se’ e që thuaja fare nuk tingëllon si porosi drejtuar një personi. Një shqiptar i jugut do të thoshte: ‘Të lutem të shkosh e t’i thuash, të vijë e të më shohë’, që fjalë për fjalë në suedisht do të tingëllonte: ‘Dig ber jag att du må gå och till honom må du säga att han må komma och mig se’ – e kjo është shumë më afër mënyrës suedeze për t’u shprehur, ani se edhe më e vështirë.

Më së miri është të them këtu se fraza e mësipërme është ndër shprehjet më të skajshme që unë kam mundur të gjej, si shembull për të ilustruar dallimet. Po qe se do të shihej vetëm leksiku, atëherë dallimet nuk janë aq të dukshme, sepse, në këtë rast, jo leksiku, por është zgjedhimi i foljeve dhe sintaksa që më së shumti ndryshojnë.

Gjuha e njësuar

Përpyekje energjike për të realizuar një gjuhë të njësuar shqiptare u bënë që në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX. Në atë kohë, shqipja kishte së pakut katërqind vjet që ishte përdorur si gjuhë e shkruar – por rrënimet nga luftërat kundër osmanëve në shekullin e XV kanë shkatërruar atë që ka mund të ishte më parë.

Shënimi i parë i shkruar në shqip është një formulë e pagëzimit nga viti 1462, e përfshirë në një qarkore të cilën kryepeshkopi i Durrësit Pal Ëngjëlli ua kishte përcjellë priftërinjve të vetë. Në mes të tekstit latinisht ndodhen fjalët të cilat prindërit shqiptarë mund t’i përdornin në pagëzimin e ngutshëm të fëmijëve të porsalindur – po qe se fëmija kishte rrezik të vdiste para se të mbërrinte prifti. Fjalët janë këto: “Un të pagëzonj pr’emënit Atit e t’birit e t’shpertit shenjt” e që nuk është shumë e ndryshme nga ajo në gjuhën e tashme të njësuar: “Unë të pagëzoj në emër të Atit, e të birit e të shpirtit të shenjt”.

Para botimit të këtij libri në suedisht, kanë arritur të dhëna se në arkivin e Vatikanit, si dhe në disa vende të tjera, pas analizave të shumta, janë gjetur tekste shqiptare më të vjetra se sa formula e sipërpërmendur e pagëzimit. Të dhënat janë aq të reja, sa që unë nuk kam mundur të siguroj informacione nëse ato janë të besueshme, domethënë nëse ato janë verifikuar nga shkencëtarët. Thënë në përgjithësi, nuk është aspak befasuese po qe se shqipja është përdorur edhe në formën e shkruar përpara shekullit të XV. Shkatërrimet në masë gjatë luftërave kundër osmanëve kanë zhdukur edhe shumë dokumente të mëhershme.

Vetëm disa shkrime në shqip – një përkthim i Biblës më 1555 (Bibla e Buzukut) dhe vepra të tjera më të vogla të karakterit fetar – janë botuar gjatë perandorisë osmane. E pra, tek në fillim të shekullit të XX, shqiptarët arritën të pajtohen për një alfabet të përbashkët, që u bë në Kongresin e Manastirit, në Maqedoninë e tashme, më 1908.

Në kohët e fundit të perandorisë osmane qe ndaluar botimi i letërsisë në shqip, mirëpo një numër i madh i shkrimeve u botuan në vendbanimet shqiptare jashtë vendit, të cilat pastaj u futën fshehurazi në Shqipëri. Ky është sqarimi se përse zhvillimet drejt gjuhës së njësuar ishin kaq të vonuara. Mirëpo çdo e keqe e ka një të mirë: Falë faktit se

shqiptarët e zgjodhën çështjen e alfabetit të tyre aq vonë, ata mundën të mësojnë nga përvojat dhe vështirësitë e popujve të tjerë, në mënyrë që të mund të përcaktoheshin për një alfabet i cili ishte më i përshtatshmi për qëllimin e tyre. Alfabeti i gjuhës shqipe është krejtësisht në pajtim me fonetikën, që domethënë se shqiptarët nuk kanë vështirësi të mëdha për ta shkruar gjuhën e vet në mënyrë të drejtë. Nxënësit suedezë – e madje edhe të rriturit – kanë probleme për të mësuar, bie fjala, shqiptimin e tingullit "tj" (shqip = ç) - me tj, k dhe kj dhe shqiptimet e ndryshme të tingullit j- me j, g, gj, dj, hj dhe lj. Këto vështirësi nuk i kanë nxënësit shqiptarë. Ajo çka paraqet vështirësi për botën është interpretimi se si duhet shqiptuar shkronjat e ndryshme shqipe dhe kombinimet e saja. Më poshtë do të prezantohet një sasi e rregullave të shqiptimit.

Në vitet e 1950-ta filloi seriozisht procesi i kristalizimit drejt gjuhës së njësuar. Në kundërshtim me proceset në vendet e tjera, për gjuhën e njësuar shqipe nuk ishte normë gjuha e kryeqytetit; në vend të kësaj dominimin e mori forma gjuhësore e jugut. Kjo shpjegohet me faktin se partizanët e më pas sidomos udhëheqësit politikë rekrutoheshin nga Shqipëria e jugut, prej nga ishte dhe Enver Hoxha. Pasardhësi i këtij të fundit, Ramiz Alia, ishte nga Shkodra e Shqipërisë së veriut.

Mund të thuhet se ishin faktorët politikë që e shkaktuan këtë dominim të formave gjuhësore të toskërishtes. Regjimi i mbretit Zog kishte propozuar dialektin e Elbasanit – një vijë kufitare e trevave ku flitet gegërishtja dhe toskërishtja – si pikënisje për gjuhën e kombit. Në të njëjtën kohë, klerikët katolikë të Shkodrës ishin shumë aktivë në fushën e kulturës dhe kishin një zgjerim të pasur të dialektit të tyre. Për regjimin komunist ishte me rëndësi që të shtypte kulturën katolike dhe të mbështesnin interesat e veta politike në të gjitha fushat – edhe në gjuhë.

Me gjithë këtë, kalimi nga njëri model te tjetri nuk ishte i menjëhershëm. Shtypi dhe radioja që në vitet e 1950-ta dhe 1960-ta ishte orientuar për t'i ngulitur format gjuhësore të shqiptarëve të jugut, ndërsa edhe më tej në literaturën profesionale dhe artistike paraqiteshin format kryesore të veriut dhe të jugut në gjuhën e shkruar deri në fillim të viteve të 1970-ta.

Më 1972 në Tiranë u mbajt Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, si rezultat i të cilit u botua fjalori normativ me rreth 32 000 fjalë. Kjo pati rëndësi të madhe, se edhe shqiptarët në Jugosllavi - në Kosovë, Mal të Zi dhe Maqedoni – e pranuan gjuhën e njësuar shqipe. Sot, për fat të mirë, është vetëm një numër i papërfillshëm i atyre që duan ta grisnin vendimin e atij Kongresi, ndërkohë që fare pak kritikë ka sa i përket formulimit të normave.

Sa më përket mua, unë mendoj se theksimi i formës toskërishte ka krijuar një gramatikë shqiptare edhe më të njësuar. Gegërishtja është më dinamike dhe për këtë më pak e rregullt, prandaj edhe më e vështirë të përdoret për normim. Deri këtu gjithçka është në rregull. Ajo që mua nuk më pëlqen fare ka të bëjë me faktin se gjuha e njësuar nuk e përdor infinitivin – paskajoren, po në vend të saj shprehet rregullisht me konjuktivin e së tashmes. Shprehja suedeze "han måste arbeta" do të formulohej në gjuhën e njësuar shqipe: "ai duhet të punojë", që tingëllon e çuditshme në përkthimin e fjalëpërfjalshëm "han måste han må arbeta". Këtu do të ishte më e natyrshme të përdorej gegërishtja: "Ai duhet me punue", që ka kuptimin e njëjtë si ajo në suedisht. Rreziku bëhet edhe më i madh kur shihet se gjuha e njësuar përdorë forma, të nxjerra nga infinitivi "joekzistues": "i punueshëm", që është i lakueshëm dhe mund të përpunohet e që është formë gegërishte; kurse "arbetare" (= punëtorët) quhen punonjës, që është një formë e cila i përket toskërishtes jugore. Nuk ka mundësi të bëhet një formë funksionale si surrogat për "i punueshëm", dhe me këtë ushtrohet dhunë ndaj logjikës. Mungesa e infinitivit ka krijuar një vakuim, ose për ta shprehur të tërën figurativisht: Kjo është si të pritët me sharrë trungru e të mbahen degët, ashtu varur në ajër!

Një problem tjetër është ajo që ka të bëjë me emrat e huaj. Lidhur me këtë është paraqitur një intelektual nga Shkodra me një propozim të shkëlqyeshëm: Emrat e gjuhëve të huaja do të jepen me ortografinë e asaj gjuhe brenda kllapave. Një shembull: Uinston Çerçil (Winston Churchill). Për fat të keq propozimi i tij nuk kaloi. Për një shqiptar që ka qenë gjithnjë i varur nga shkrimi i emrave të përveçëm sipas drejtshkrimit të shqipes bëhet i mundimshëm leximi i teksteve në gjuhë të huaja. Për njerëzit që s'kanë kontakte të rëndësishme me emra të huaj, modeli shqiptar ka një përparësi: ata e bëjnë shqiptimin shumë më mirë se sa po të përdorej drejtshkrimi i huaj pa sqarime.

Megjithatë, vërejtjet nuk janë aq serioze dhe rruga drejt një pasurimi të mëtejshëm të gjuhës së njësuar është e nevojshme dhe duhet të vazhdojë.

Kur sot dëgjojmë radioprage me në gjuhën shqipe nga anë të ndryshme të botës (në gjuhën shqipe ka emetime ndër të tjera prej Londrës, Uashingtonit, Bonit, Romës, Moskës, Athinës, Sofias, Pekingut, Vatikanit dhe Stokholmit) bëhet e qartë se gjuha e njësuar është ajo që përdoret si standard. Shmangiet nuk janë të shumta. Ende nuk është dëgjuar te shqiptarët parulla “Shqiptarët flasin gjuhën popullore”. Kjo, para se gjithash dhe me siguri, varet ngase nevoja e unitetit është aq e madhe në fushën e gjuhës shqipe, apo për t'u shprehur në një formë tjetër: populli shqiptar ka nevojë për unitet në të gjitha fushat. Pikërisht mungesa e unitetit pa detyrim ka qenë një problem tragjik i këtij populli, dobësi kjo që është shfrytëzuar nga armiqtë e shqiptarëve.

Ta shijojmë pak shqipen

Këtu prezantohet alfabeti i gjuhës shqipe dhe rregullat e shqiptimit. Theksi më së shpeshti bie në rrokjen e parafundit të fjalës, kurse drejtshqiptimi është krejt fonetik. Paraqitja me shkrim nuk mundet ta zëvendësojë përjetimin fonetik të gjuhës. Çdo njëri mund të dëgjojë emtimet në gjuhën shqipe përmes radios suedeze disa herë në javë (shih programet e radios në gazetë për orarin aktual!) të rrjetit P2, thuaja çdo ditë, me përjashtim të së mërkurës, prej orës 17.30 – 17.45.

Alfabeti i gjuhës shqipe ka 36 shkronja, domethënë 8 më shumë se sa suedishtja. Shkronjat kaq të shumta varen nga fakti se çdo tingull ka shkronjën e vet në gjuhën shqipe.

Shkronjat shqipe janë: a, b, c, ç, d, dh, e, ë, f, g, gj, h, i, j, k, l, ll, m, n, nj, o, p, q, r, rr, s, sh, t, th, u, v, x, xh, y, z, dhe zh.

Shqiptimi i shkronjave a, b, d, e, f, g, h, i, j, k, l, m, n, p, r, s, t, v dhe y nuk paraqet ndonjë vështirësi për suedezin. Kurse sa i përket shkronjave të tjera ka nevojë për komente.

“c” shqiptohet si “ts” në fjalët “tsar” ose “vits”. Psh: cigare (cigarrett).

“ç” tingëllon si zë në një teshtimë të lehtë (“attchi”, pra një t-tingull që menjëherë pasohet nga një tj-tingull. Psh: çaj (té).

“dh” shqiptohet si thuqërim në anglisht e fjalës “this” ose “there”. Psh: lidhje (förbindelse).

“ë” është diçka e natyrshme për suedezët që e kanë tingullin “ô” në dialektin e vet; për shembull, vermlandasit fjalën: “görgôtt, si dhe anglezët: “sir”. Është një tingull në mes të ô dhe a. Psh: zëri (rösten). Kur “ë” përdoret në fund të fjalës zakonisht është e pazëshme. Fjala shqipe “bukë” (bröd) shqiptohet saktësisht si fjala angleze “book”.

“gj” shqiptohet si shkronjat suedeze g dhe j së bashku, por secili tingull dëgjohet njëllë qartë. Psh: “gjak” (blod).

“ll” është një tingull “l” i trashë, që ne e gjejmë përsëri te vermlandasit dhe anglezët. Psh: “blå” e “blus” (në vermlandisht), “fall” e “full” (në anglisht). Psh: “lloj” (sort).

“nj” tingëllon si shkronjat suedeze “n” dhe “j” së bashku ose si fjala “new” e anglishtes. Psh: “një” (en).

“o” shqiptohet prorre si shkronja “å” e suedishtes. Psh: qyteti Shkodra.

“q” i ngjanë shumë “ç”, por është më e butë. Tingëllon afërsisht si një “k” shumë e shkurtë e pasuar nga një tingull “tj”. Afërsisht si te fjala suedeze “kokkär!” (shq. kuksher!; që dmth enë kuzhine) , por me një dëgjueshmëri më të dobët të “k”. Psh: i kuq (röd).

“rr” i përgjigjet një lapre të fuqishme me majë të gjuhës të shkronjës “r”. R e thjeshtë në shqip është më e butë se sa në suedisht dhe na e përkujton atë të anglishtes. Psh: “birrë” (öl), krahasoje me “bir” (son).

“sh” tingëllon si tingulli suedez “sj” në shqiptimin e suedishtes shtetërore, si te fjala “skinka” (shqiptohet: shinka; domethënë proshutë). Psh: Shqipëri (Albanien).

“th” i përgjigjet thuhërimit të pazëshëm të fjalës angleze “think”. Psh: “rreth” (omkring)

“u” shqiptohet si “o”-ja suedeze në fjalën “sol”. Psh: lugë (sked).

“x” shqiptohet si “d” plus tingëllima “s”, krahasoje me fjalën angleze “goods”. Psh: “xixë” (gnista).

“xh” i përgjigjet “d” plus tingëllimës “sj”. Psh: “xhami” (moské).

“z” është një “s” tingëllimë si në fjalën angleze “zoo”. Psh: “gëzuar!” (Skål!).

“zh” tingëllon si tingulli i zëshëm i frëngjishtes në fjalën “jour”. Psh: “plazh” (badstrand = spanjisht: playa).

Libra mësimi dhe fjalorë

Një fjalor suedisht-shqip me 17.000 fjalë u botua më 1994 nga Enti Shkollor i Suedisë, i cili është në përdorim. Botimi është bërë në kuadër të serisë LEXIN. ISBN 91-1-935192-5. Një botim me fjalë më të shumta është gati dhe do të botohet së shpejti¹⁵.

Ekzistojnë edhe disa fjalorë suedisht-shqip, mirëpo ata kanë vlera të kufizuara. Në përgjithësi duhet drejtuar te veprat e botuara jashtë vendit. Fjalori Shqip-Anglisht (Albanian-English Dictionary), botuar më 1998 me ISBN 99927-1-042-X dhe mund të sigurohet nga Shqipëria, shtëpia botuese “Toena”, Rr “Muhamet Gjolesha”, Fahu postal (box) 1420, Tiranë. Telefonat: 00355-42-40116, faksi 00355 – 42 – 27232.

Një kurs i gjuhës shqipe është i botuar në Shqipëri: Gjovalin Shkurtaç – Enver Hysa: “Gjuha shqipe për të huajt dhe shqiptarët jashtë atdheut”, botuar më 1996. Kursi përbëhet prej teksteve të leximit dhe gramatikës, një antologji të letërsisë dhe një fjalor me rreth 2500 fjalë në pesë gjuhë (shqip-anglisht-gjermanisht- frëngjisht-italisht). Edhe ky libër mund të porositet nga TOENA në Tiranë ose të huazohet në bibliotekat suedeze. Për të gjitha botimet shqip rekomandohet edhe më shumë të përdorni firmën BOTIMPEX nën drejtimin e dr.Estref Begës, adresë: Rr.”Naim Frashëri” P. 84 Sh. 2 Ap. 37 Tiranë, ose: P.O. Box 140. E-mail:botimpex@albaniaonline.net ose: botimpex@abcoma-al.com. Kjo firmë e furnizon rregullisht Shërbimin suedez të librave me botime në gjuhën shqipe.

I kthehemi edhe një herë pyetjes së shtruar në fillim të këtij kapitulli

A mundemi ne suedezyt të mësojmë shqipen? Kjo varet nga ambiciet. Të gjithë munden të mësojnë një pjesë të fjalëve të rëndësishme dhe të frazave. Por për ta zotëruar këtë gjuhë të zorshme, domethënë për ta përdorur në mënyrë korrekte në të folur e në të shkruar, para se gjithash kërkohen njohuri të mirëfillta të gramatikës në përgjithësi, por edhe të gramatikës suedeze. Kemi raport të përafërt si me

¹⁵ Fjalori është ribotuar në vitin 2005.

gjermanishten – gramatika e mërztishme është e domosdoshme. Kurse anglishten mund ta mësosh më tepër me instinkt, vetëm përmes ushtrimeve të zellshme.

*Erik Hans Tunman (1746 – 1778) – një hulumtues
mbi gjenezën e shqiptarëve*

Më 23 gusht 1746 në Toresund në veri të Mariefredit lindi një fëmijë i cili do të ishte i pari që seriozisht do të interesohej për çështjen e gjenezës së shqiptarëve. Erik Hansi ishte fëmijë i një prifti, i cili vdiq që më 1757 dhe pas vetës la 12 fëmijë – por pa kurrfarë pasurie ekonomike. Për Erikun e vockël, që u shqua herët për zgjuarsia dhe inteligjencë, u kujdes një i afërt i së ëmës, konzull suedez në Izmir të Turqisë. Po ky kujdes i të afërmit i bëri të mundshëm Erik Hansit të mësonte arabishten dhe pastaj të vazhdonte studimet në Suedi, ku së pari mësoi latinisht, greqisht dhe histori, e më pas teologjinë në Upsalë. Qe një student i varfër, që shpesh vuante nga uria – por literatura në përgjithësi e, para së gjithash, ajo historike, i jepnin ushqim shpirtëror në mungesë të atij material.

Pas kohës së studimeve në Upsala, Tunmani shkoi në Gjermani, ku së pari u punësua si informator në Pommern, që asokohe ende përfshihej në kuadër të shtetit suedez. Pastaj shkoi në Halle, ku kreu provimin e magjistraturës në moshën 23 vjeçare. Tre vjet më pas u emërua profesor në oratori dhe në filozofi në universitetin e Halles. Në Gjermani u bë i njohur me emrin Johann Tunmann.

Para se Tunmani të vdiste në moshë tepër të re, ishte vetëm 32 vjeçar, i sëmurë, i shkatërruar nga kraijatat e mëhershme dhe nga ngarkesa mbinjerëzore e punës – “ai e kishte harxhuar tërë dritën e tij në të dyja fundet” – arriti të botonte një sërë punimesh shkencore që shquhen nga një pjekuri e madhe, një qëndrim të gjerë e të thellë dhe vetëkritik. Më e njohura nga këto punime është “Hulumtime në lidhje me historinë e popujve evropindor” (1774), prej të cilave vetëm pjesa e parë është botuar. Në këtë vepër, tema “Mbi historinë dhe gjuhën e shqiptarëve dhe të vllahëve” përfshinë faqet 171-366.

Si ndodhi që suedezi Tunman të interesohet për çështjen mbi origjinën e shqiptarëve, që asokohe ishte mjaft e panjohur? Duhet përmendur gjithsesi faktin se universiteti në Halle, me bibliotekën e tij të pasur, ka joshur studentë dhe hulumtues nga e tërë Evropa. Në mesin e tyre ishte edhe shqiptari Konstandin Xhehani i cili vinte nga Voskopoja, qytet jugor i Shqipërisë, qytet ky që në shekullin XVIII ishte në lulëzim dhe ku kishte zënë fill një zhvillim i pazakonshëm për kohën dhe vendin. (Voskopoja është shkatërruar nga tre zjarre të mëdha, i fundit më 1916 dhe banorët u shpërngulën që andej). Xhehani e njohu Tunmanin me fjalorin shqip-vllahisht - greqisht të Teodor Kavaliotit, botuar më 1770 në Venedik. Kavalioti ishte mësimpldhënës në akademinë e Voskopojes, institucion edukimi ky ku shqiptarë e grekë studionin së bashku. Ai fjalor kishte 1170 fjalë dhe përbënte bazën për studimet vllahë - shqiptare të Tunmanit, i cili kishte një ndihmesë të madhe edhe nga njohuritë dhe përvoja e Xhehanit, që kishte studiuar në Leyden e Cambridge dhe luante rolin e këshilltarit për Tunmanin. Tunmani e ka përfshirë fjalorin e Kavaliotit në veprën e tij mbi shqiptarët e vllahët dhe e ka begatuar atë duke e përkthyer edhe në latinisht. Poashtu, ky ka bërë një analizë të fjalorit nga pikëpamja etimologjike dhe u interesua sidomos për fjalëhuazimet në shqip.

Si një çështje kardinale e konsideron problemin me ilirët dhe shqiptarët, dhe Tunmani vie në përfundimin se ilirët janë stërgjyshërit e shqiptarëve. Ai thekson se “në historinë e shqiptarëve nuk kam gjetur ndonjë gjurmë nga ndonjë emigrim i kohëve të vona: gjuha e tyre na ka dhënë asofarë dëshmish mbi fatin e popullit, sa që unë nuk mund të mos i pranoj ata si fqinjë të grekëve të vjetër dhe nënshtetas të Romës antike. Dhe në të dyja këto raste ata janë të njëjtë me ilirët”. Përmes studimeve historike dhe lingvistike, Tunmani mundi të vendoste gjuhën shqipe mes gjuhës ilire dhe asaj trake.

Ai arriti deri te përfundimi se fiset trake kanë jetuar në trevat ilire. Përmes studimeve të emrave të vendeve dhe të natyrës, nxjerrë përfundimin se shqiptarët rrjedhin nga ilirët, por me një element trak. Shkenca moderne e albanologjisë e pranon se teza e Tunmanit kryesisht qëndron mjaft mirë edhe sipas rezultateve të hulumtimeve të kohës më të re.

Për ne suedezët është kënaqësi që Tunmani, në përgjithësi, njihet si një ndër albanologët e parë të rëndësishëm. Me siguri se hulumtimet e tij do të kishin arritur rezultate edhe më të mirë, sikur të kishte jetuar më gjatë. Pas tij, për fat të keq, asnjë hulumtues i kualifikuar suedez nuk ka shfaqur farë interesimi për çështjet shqiptare.

A E NUHASIN SHQIPTARËT HUTIN NË KËNETË ¹⁶?

Shprehjet dhe fjalët e urta popullore shqiptare

Mund të përgjigjem drejtpërsëdrejti në pyetjen e titullit të mësipërm: Jo, ata nuk e shquajnë hutin në kënetë, që në suedisht ka kuptimin se njeriu dyshon se asgjë nuk është si duhet. Në shqip ka shprehje të tjera me hutin:

”Me t’ardhë unë si në gojë të hutit” (përkthimi në suedisht: ”När jag kommer som in i ugglans mun”), domethënë se njeriu është në rrezik ose se e vë vetëveten në rrezik.

”Doli në rrugë e u bë hut” (përkthimi në suedisht: ”Han gick ut på gatan och blev ugglan”) domethënë: Ai u zhduk pa fije gjurme, iku shumë shpejt.

”I ka kënduar huti” (përkthimi në suedisht: ”Ugglan har sjungit för honom”) domethënë: Gjithçka ka shkuar mirë për atë, ai ka pasur fat.

Shqiptarët hutin e konsiderojnë lolo dhe të keq, kurse te suedezët huti shpesh është simbol për mençuri dhe njohuri.

Një buf i vjetër themi ne suedezët për një plak tekanjor. Te shqiptarët bufi është njëlloj si huti përgjithësisht i keq, fodull. Dhe këtu faktikisht hasim kënetën!

”Buf kënete” (përkthimi në suedisht: ”Uv i mossen, kärret”), që domethënë: ”Budalla” dhe përdoret si fjalë fyese.

”Këtë e di edhe bufi” (përkthimi në suedisht: ”Det vet också uven”), që domethënë: këtë e kupton edhe një idiot; kjo është e vetëkuptueshme.

Ne mund të vazhdojmë edhe pak çaste në botën shqiptare të shpezëve.

”I kish mendtë zog” (përkthimi në suedisht: ”Han hade sinne som en fågel”), domethënë: Ai s’di të mendojë, është i papjekur.

”Njerëzit flinin si zogjtë” (përkthimi në suedisht: ”Människorna sov som fåglarna”), domethënë: Ata kishin gjumë të lehtë, ata ishin më shumë zgjuar se sa fjetur.

”Mos e lësho zogun prej dore!” (përkthimi në suedisht: ”Släpp inte fågeln ur handen!”), domethënë: Mos e lësho rastin të të ikën (nga dora). (Krahaso me fjalën e urtë suedeze: ”Bättre en fågel i handen än tio i skogen”, në shqip: ”Më mirë një zog në dorë se sa dhjetë në mal”)

”S’këndon zog për mue” (përkthimi në suedisht: ”Fågeln sjunger inte för mig”), domethënë: Mos më pyet se si kaloj, unë nuk jam mirë.

”Puna jote si zog në qiell” (përkthimi në suedisht: ”Ditt arbete är som fågel i himlen”), domethënë: Përpjekje e kotë, nuk ia vlen asgjë, nuk ia del.

”Me një gur vret dy zogj!” (përkthimi në suedisht: ”Med en sten dödar han två fåglar”), domethënë: Ai ia del me dy gjëra për një herë (krahasoje me fjalën e urtë suedeze: ”Han slår två flugor i en smäll”, shqip: Me një të goditur qëllon dy miza).

Gjithashtu ka edhe një pjesë të shprehjeve lidhur me sorrën.

”Ah, sorra që është!” (përkthimi në suedisht: ”Ack, en sådan kråka hon är!”) domethënë: Eh, sa e dobët dhe e sëmurë që është!

”E paguan si prifti sorrën!” (përkthimi në suedisht: ”De betalade det som prästen kråkan!”) domethënë: I kushton (dikujt) shtrenjtë (diçka).

¹⁶ Shprehja “ugglor i mossen” (hutat në kënetë) ka kuptimin e parandjenjës së mashtrimit, të nuhatjes së mashtrimit. Titulli do të mund të përkthehej edhe ”A e parandjejnë shqiptarët mashtrimin”, mirëpo unë iu përmbajta përkthimit bukval pasi që edhe fjalët e urta të këtij kapitulli lidhen me hutin.

"Ai ka hipur në bisht të sorrës!" (përkthimi në suedisht: "Han har hoppat upp på kråkans stjärt!") domethënë: Ai ka rënë në një gjendje të rrezikshme, mund t'i kushtojë shtrenjtë.

"Rrit sorrën që të të nxjerrë sytë!" (përkthimi në suedisht: "Du föder upp kråkan för att hon ska hacka ut dina ögon!") domethënë: Ti i ndihmon e kudesesh për ndokend që është mosmirënjohës, që gjitha të mirat t'i kthen me të këqia etj.

"Sorra sorrës s'ia nxjerrë sytë!" (përkthimi në suedisht: "Kråkan hackar inte ut ögonen på en annan kråka!") domethënë: Njerëzit e këqinj, ose ata që i takojnë të njëjtës grupë, e mbrojnë njëri-tjetrin.

Gjithsesi, ka shumë shprehje në lidhje me shpezët, por kaq mjafton sa për t'i shijuar pak ato.

Një numër shumë i madh shprehjesh dhe fjalësh të urta në shqip kanë të bëjnë me gjymtyrë të trupit, njëloj si edhe në suedisht. (Për shembull: "På tu man hand" = e ngjashme si "sy më sy", në kuptimin: në fshehtësi, me dyer të mbyllura; "Jag är idel öra" = e ka kuptimin: dëgjoj me vëmendje, të ndjek me ëndje gjersa flet; në shqip mund t'i korrespondojë shprehja: "Dëgjon gojëhapur"; "Hals över huvudet" = ka kuptimin e atij që nuk pret, që nxiton, në shqip mund t'i korrespondojë shprehja: "E ka shpirtin në fyt"; "På rak arm" = ka kuptimin: në çast, menjëherë, aty për aty, në shqip më bëhet se i korrespondon thënia: "Me blue në dorë"; "Står på god fot med någon" = e ka kuptimin: e ka mirë me dikend, kam raporte të mira me ndokend, në shqip mund t'i korrespondojë shpreja: "E kam me letra çelë me filanin")

"Ja hängri kokën!" (përkthimi në suedisht: "Han – eller detta – åt hans huvud!") domethënë: Ai – apo diçka- ishte shkaktar i vdekjes së tij.

"Për kokën e djalit" (përkthimi në suedisht: "Vid pojzens huvud!") domethënë: betohem në jetën e djalit tim (betim i nënës).

"Pata kokën në torbë!" (përkthimi në suedisht: "Jag hade huvudet i säcken!") domethënë: Isha në rrezik të madh (Krahasoje me shprehjen suedeze: "Jag hade huvudet i snaran", shqip: "E kisha lakun në fyt!").

"Ia prenë krahët!" (përkthimi në suedisht: "De högg av honom armarna!") domethënë: Nuk kishte kurrfarë mbrojtje, kurrfarë ndihme; mbeti pa ndihmë.

"Qenke ngritur në krahun e majtë, nga krahu i majtë!" (përkthimi në suedisht: "Du har stigit upp på vänster arm) domethënë: Je zgjuar në anë të gabuar (= ti je i qaravitur, gjithçka të shkon keq etj.).

"Ja mori dorën!" (përkthimi në suedisht: "Han tog handen från/av) që ka përdorime në kontekste të ndryshme:

"Ia mori dorën gjyshes!" (përkthimi në suedisht: "Han tog farmors/mormors hand") domethënë: Ia puthi gjyshës dorën.

"Ia mori dorën zanatit!" (përkthimi në suedisht: "Han tog yrkets hand!") domethënë: E mësoi zanatin e vet.

"Ia mori dorën zdruckthëtarit!" (përkthimi në suedisht: "Han tog snickarens hand!") domethënë: E mësoi zdruckthëtarinë.

"Dha me dorë të majtë!" (përkthimi në suedisht: "Han gav med vänster hand!") domethënë: Dha pak. (Krahasoje me fjalën e urtë suedeze: "Han gjorde det med vänster hand", shqip: i kushtoi pak rëndësi/kujdes çështjes, e kishte si punë të dorës së dytë).

"I jep dorën e të kërkon edhe krahun!" (përkthimi në suedisht: "Du ger honom handen och han vill ha även armen!") domethënë: Ti i jep diçka të vogël e ai të kërkon diçka të madhe. (Krahasoje me fjalën e urtë suedeze: "Du ger honom (fan) ett finger och han tar hela handen!", shqip: "Ia jep gishtin e ta merr dorën!").

"S'ka dorë!" (përkthimi në suedisht: **"Han har inte hand!"**) domethënë: S'ka vjedhur, nuk prek pasuritë e të tjerëve.

"Ai qet gurin e fsheh dorën!" (përkthimi në suedisht: **"Han kastar stenen och gömmer handen!"**) domethënë: Është dinak dhe gënjeshtar.

"Ai është njeri me dy faqe!" (përkthimi në suedisht: **"Han är en människa med två ansikten!"**) domethënë: Është shtiranjak/ hipokrit; është gënjeshtar.

"Sa për sy e faqe!" (përkthimi në suedisht: **"Så mycket för ögon och ansikte!"**) domethënë: Për shkak të formës, sa për dukje.

"Me faqe të bardhë!" (përkthimi në suedisht: **"Med vitt ansikte!"**) domethënë: Me nder, ndershmërisht; me sukses, me fat.

"Kjo punë ka marrë këmbë mirë!" (përkthimi në suedisht: **"Denna sak har fått ben bra!"**) domethënë: puna ka filluar mirë.

"Marr nëpër këmbë!" (përkthimi në suedisht: **"Jag tar honom över benen!"**) domethënë: Bëj ç'të dua me të, e keqpërdori.

Le të mjaftohemi me këta shembuj sa i përket pjesëve të trupit. Po e përfundoj këtë paraqitje me disa shprehje që përdoren shpesh:

"Ujku do mjegull!" (përkthimi në suedisht: **"Vargen tycker om dimma"**) – njeriu shpirtkeq gjithnjë dëshiron zënka dhe tollovi, të cilat mundet t'i shfrytëzojë për interesin e vet.

"Hyj në valle!" (përkthimi në suedisht: **"Jag går i dansen!"**) domethënë: Përzihem, futem në një punë.

"S'ka dasmë pa mish!" (përkthimi në suedisht: **"Det finns inget bröllop utan kött!"**) domethënë: Nuk ka asnjë gëzim pa një element të pikëllimit. Shprehja përdoret shpesh në domethënien: Askush nuk mund të fitojë pa shkaktuar luftëra, pa pësuar ndonjë humbje.

"Ujët fle, hasmi s'fle!" (përkthimi në suedisht: **"Vatten sover, fienden sover inte!"**) domethënë: Mos lejo veten të përgjumes. (Krahasoje me fjalën e urtë suedeze: **"I de lugnaste vattnen går de största fiskarna!"**, shqip: **"Në ujin më të qetë notojnë peshqit më të mëdhenjë!"**).

"Frika ruen vneshtin!" (në gjuhën letrare: **"Frika ruan vreshtin!"**) (përkthimi në suedisht: **"Fruktan vaktar vingården!"**). Kjo është shprehja që vlente për njerëzit nën pushtetin katërdhjetëvjeçar të Enver Hoxhës në Shqipëri. Ishte frika e njerëzve që e ruante vreshtin Shqipëri. Përmes frikës Enver Hoxha dhe partia e tij ia arriti t'i sundojë njerëzit duke e ruajtur pushtetin e vet mbi ta. Dhe mosbesimi ndaj vendeve të jashtme shprehet në shprehjen: **"I hueji kurrë s'bahet i yti!"** (përkthimi në suedisht: **"Utläningen blir aldrig din!"**), me fjalë të tjera: Mos beso në një të huaj!... Sepse ai nuk ishte nën kontrollin e partisë së gjithëfuqishme...

TUNGJATËJETA SHQIPTAR! – KUSH JE TI?

Sprovë për të skicuar mentalitetin dhe vetitë e shqiptarëve

Një mënyrë e sigurt për t'iu hapur gojën kritikëve - është që t'i trajtosh gjërat në mënyrë përgjithësuese, mu ashtu siç do të veprojmë unë në vijim të këtij kapitulli. Tema është joshëse, megjithëse e di se unë po e vëj vetë litarin rreth qafës time. Të shkruash diçka të tillë nuk është politikisht korrekte në Suedinë e sotme. Shembujt janë të tmerrshëm: Negrët janë si fëmijë e shpirtmirë, por gjithashtu gënjeshtarë dhe të pasigurtë (Ernest Karlson: Folkskolans geografi 1931).

Sot njeriu ndjehet i turpëruar para formulimeve të tilla; duket si ta kapësh profesor Karlsonin me pantollat të zhveshur nën gjunjë. Një herë e kam takuar një fizikan të fizikës bërthamore, i cili ishte zezak nga Nigeria dhe atëherë pata dëshirë ta zgjoja profesorin nga varri e të shihja reaksionin e tij nga takimi me një "negër" që ishte intelektual i lartë. Ne që pretendojmë se jemi më të ditur, jemi përcaktuar që të distancohemi nga gjykimet negative për popuj ose raca të tjera. Tashmë, vetëm në ambientet e prapambetura suedeze (domethënë të prapambetur mentalisht, ku një Peter Valenberj bashkohet me Lediga Lude dhe Viliga Vera) ende ka shenja të paragjyqimeve karlsoniane. Por edhe kjo duket paksa marroqe, në mënyrë të njëjtë si "pastruesja" që u bë "mirëmbajtëse e pastërtisë". Por fakti mbetet fakt, që domethënë se pastrimi megjithatë mbetet pastrim. Edhe paragjykimet e fshehta poashtu janë paragjyqime.

Kështu unë bëra pak mbrojtje për veten që në hyrje. E tash duhet t'ia filloj dhe shpejt të hidhem në temë. Një pjesë të vlerësimeve i konsideroj të verifikuara pasi që edhe shumë shqiptarë kanë mendime të njëjta për anët e mira e të këqija të bashkëvendasve të tyre...E si, në të vërtetë, duken shqiptarët? Një njeri që është i martuar me një shqiptare dhe ka farefis shqiptar, si dhe që është marrë me punët e këtij populli një jetë të tërë do të duhej ta dinte këtë? E po, çështja është se, çka njeriu mendon se e di dhe çka ai mendon për vetveten. Sidoqoftë...

Eqrem Çabej, një shkencëtar shumë i nderuar i gjuhës dhe letërsisë shqiptare, në një studim pohonte se "ajo që e përbënë bërthamën e shpirtit të shqiptarit - është rezervimi". Në këtë mënyrë shqiptarët dallohen prej popujve të tjerë të Evropës Perëndimore, dhe Çabej konsideronte se kjo varet nga natyra e egër e vendit dhe faktit historik se shqiptarët vazhdimisht janë dashur të jenë syçelë kundër armiqve. Shqiptarët, madje, edhe ndaj të afërmeve mund të jenë të kujdesshëm, të rezervuar, të mbyllur.

Këto mendime vlejné para se gjithash për shqiptarët e Kosovës. Ata shpesh janë tepër formal me miqtë. Po qe se do të mund të bëhet ndonjë krahasim me ndonjë popull tjetër evropian, atëherë ai është populli gjerman. Me saktësinë gjermane shqiptarët nuk mund të maten, por ata janë njëlloj seriozë si edhe gjermanët. Këtu mungon aftësia anglosaksone që në jetën shoqërore të mos jenë formalë e as tepër intim, po të lehtë dhe të këndshëm.

Në anën tjetër: ajo çka njeriut joshqiptar i bie në sy është mikëpritja e madhe dhe bujaria që ky popull e shpreh. Si suedez shpesh ka arsye për t'u ndierë i turpëruar nga mungesa personale e bujarisë. Në këtë aspekt, shpesh ndodh që shqiptarët të bëhen iracionalë, pasi që nderin e konsideron të varur nga sjellja e tij, veçanërisht në kuadër të mikëpritjes. Ndërsa një suedez mund të mendojë se është e pamend që një racion ushqimi për dy veta të ndahet me disa mysafirë që vijnë papritmas; pikëpamja suedeze "Bara den som är hungrig äter" (Vetëm ai që është i uritur duhet të hajë) konsiderohet rëndom si i patakt dhe jomiqësor nga një shqiptar. Suedezi beson shpesh se para së gjithash ai është praktik, ndërkaq shqiptari dëshiron t'i shmanget turpërimit për shkak të sjelljes së tij. Një problem i zakonshëm për suedezët, të cilët kanë udhëtuar

bashkarisht me një shqiptar që ka ngarë veturën, është se si ta bindin shqiptarin që të pranojë kompensim për shpenzimet e udhëtimit. Nëse udhëton me një suedez, problemi është i kundërt... Dueli mund të përfundojë me atë se shqiptari mbase pranon që t'i jepet ndonjë monedhë fëmijës...

Kufizimet formale me miqtë mund të jenë të rrepta, për të mos thënë të ngulfatshme, gjë që i bën shqiptarët shpesh të ndjehen më të lirë në shoqëri me njerëz që kanë origjinë tjetër. Shqiptarët më rigjidë të Kosovës një suedezi mund t'ia kujtojnë schartauanët (brenda kishës suedeze, grupë protestanësh me pikëpamje fundamentaliste fetare, me moral shumë të rreptë dhe shumica prej tyre janë peshkatarë) e bregdetit perëndimor, të cilët kanë një pikëpamje jashtëzakonisht të ngushtë mbi jetën dhe një mostër stereotipe të sjelljes. Pjesa dërrmuese e shqiptarëve kanë kujdes të veçantë sa i përket origjinës, nganjëherë në mënyrë krejt joreflektuese; gjë që duket sikur ata tërë kohën rrinë në kullën e tyre prej guri me gishtin në këmbëz të armës, të gatshëm për sulmin e armikut. Një popull që ndër shekuj u ka rezistuar asimilimeve prej turqve dhe serbëve, edhe në mërgim tregohet i kujdesshëm ndaj impulseve që, pjesëtarët e tij do të mund t'i vënin në kontakt me ato kultura që i takojnë aty. Sjellja e këtillë, sot, fund e krye, është në dëm të shqiptarëve. Në Kosovë fjala fleksibilitet mezi merr konotacion pozitiv... Na bie të dëgjojmë edhe vërejtjen, se është e habitshme se sa konservative ka vazhduar të mbetet jeta në fshatrat e Kosovës, edhe pse shqiptarët për katërdhjetë vite kanë punuar si punëtorë të përkohshëm në shumë vende të huaja, gjë që do të duhej të ishin ndikuar nga jeta, fjala vjen, në Gjermani, Austri e Zvicërr. E çuditshme: duket sikur këta shqiptarë "kokëfortë" kanë ecur si të verbër në ambientet e huaja! Mbase shqiptarët që kanë ardhur si azilkërkues, fjala vjen, në Suedi kanë pasur një qasje më ndryshe dhe shumica syresh, me siguri, kur të kthehen në Kosovë do të shërbejnë si ura lidhëse midis dy kulturave.

Është me rëndësi të kujtohet se një pjesë e mirë e qëndrimeve që i hasim te shqiptarët kanë qenë karakteristike edhe për sjelljet suedeze para 80-90 viteve, kur, për shembull, fëmijët nuk guxonin t'u drejtoheshin me "ti" prindërve të tyre! Asokohe shoqëria suedeze ishte më e vogël, ambientet më stabile, në shumë vende thuaja të gjithë njiheshin mesvete.

Në situatat kur pa ndonjë rrezik mund të jesh miqësor dhe i përzemërt, si në shoqërinë me fëmijë, shqiptarët kanë një ngrohtësi shumë të madhe. Përkujdesja që si rregull shqiptarët tregojnë ndaj të moshuarve mund ta bëjë suedezin, i cili "harron" t'i përshëndes të afërmit në pavionet e pensionistëve, të ndjejnë edhe admirim e edhe vrasje ndërgegjeje. Për shqiptarin është turp dhe e neveritshme që prindërit tashmë të plakur t'i vendosë në shtëpinë e pleqve; dhe ai që e bën këtë, ndjehet i turpëruar para shqiptarëve të tjerë. Qëndrimi i suedezëve ndaj pleqve mund të merret si veprim i vrazhdë, thjesht jonjerëzor. Por shqiptarët e pranojnë se përkujdesja e ka çmimin e vet: gjeneratat e reja duhet të kujdesen për pleqtë; por si do të funksiononte kjo po qe se ekonomia e familjes kërkon që të gjithë të rriturit të punojnë? Shumica e shqiptarëve besojnë se shoqëria shqiptare po ecën drejt investimeve të mëdha në kujdesin publik të pleqve – me fjalë të tjera, drejt një sistemi të ngjashëm me këtë suedez.

Një pjesë e vrojtuesve të huaj i konsiderojnë shqiptarët si individualistë. Unë mendoj se ky është një keqkuptim: shqiptarët nuk e kanë pikënisjen si ne – individin. Nëse ne e shohim një qëndrim negativ ose arbitrar te shqiptarët ndaj angazhimeve shoqërore, domethënë ndaj veprimtarisë së organizuar, kjo varet shpesh nga përvoja e tyre negative nga shoqëria. Për shqiptarët, si rregull, shoqëria ka qenë diçka e keqe, sepse ajo ishte një shoqëri e drejtuar nga sundimtarë mizorë shqiptarë ose të huaj. Prandaj, familja dhe farefisi për shqiptarin ka qenë e vetmja gjë e sigurt dhe ku mund të mbështetej, për çka ai gjithnjë është kujdesur që t'i ruajë. Megjithatë, shqiptarët

ëndërrojnë për ligj dhe rregull. Për këtë, shqiptarët e Kosovës dikur binin në ekstazë para pamjes së Shqipërisë së Enver Hoxhës, ku dominonte rregulli i ashpër sipas principit "Frika e ruan vreshtin". Tash shqiptarët nën protektoratin e NATO-s shpresojnë për ligj e rregull. Sipas këtij botëkuptimi, është detyrimi e jo liria ajo që sjellë rregull!?

Shqiptarët që kanë ardhur në Suedi, në asnjë mënyrë, nuk janë përjashtim prej shoqërisë shqiptare. Para se gjithash, rreth 90% e tyre janë shqiptarë të Kosovës e vetëm pak vijnë nga shteti i Shqipërisë. Ata shqiptarë që janë vendosur në një vendbanim kanë shumë pak gjëra të përbashkëta: dallimi midis fshatarëve dhe qytetarëve të Kosovës është shumë më i madh se sa në Suedi, gjë që i bën shqiptarët shpesh të ndjehen më të afërt me ata që vijnë nga vendbanime të ngjashme (domethënë fshatarët me fshatarë e qytetarët me qytetarë). Mbi të gjitha, duan të jenë bashkë me të afërmit e tyre, po qe se edhe ata kanë emigruar.

Shqiptarët, kur ka të bëjë me diskutimin politik, janë më së shumti të sofistikuar, ndonëse ata flasin më shumë për politikë se sa suedezët për sport. Shpesh kultivohen idetë mbi provokacione dhe konspiracione dinake. E tillë është jeta në Ballkan. Porse, jo rrallë gjykimet janë edhe të pjekura e edhe të mprehta.

"Në Ballkan gënjejnë të gjithët" thoshin fqinjët e mi më të afërt në Eskilstuna, serbë nga Tuzlla e Bosnës. E si është puna me gënjeshtat shqiptare? Përveç gënjeshtrave të domosdoshme për të mbrojtur fëmijët dhe pleqtë nga një realitet i pamëshirshëm ose për t'iu shmangur turpfit individual apo familjar, shqiptarët nuk janë të prirur për të përdorur gënjeshtat. E baroni Franz von Nopça bëri vërejtje një herë në fillim të shekullit (XX) se shqiptarët janë të singertë ndaj një të huaji të cilit i besojnë, por po qe se lind dyshimi se i huaji e përdor lojën e hajnit dhe të djallëzuarit, atëherë ai e gënjen atë në sy pa kurrfarë keqardhje. E përse të jesh i ndershem me një të pandershem? Ky mbase mund të thuhet se është një moral praktik.

Sa i përket të dhënave mbi veprimtarinë kriminale të shqiptarëve, që ka figuruar në mediat suedeze, duhet pasur kujdes në gjykime. Shumë nga ajo çka raportohet është e pamundur të kontrollohet. Disa fakte megjithatë duhet të paraqiten: Në mes të atyre që kanë braktisur vendin është edhe një grupë, e cila ose ishte kriminele që në atdhe ose degjenerohet shpejt në mërgim. Një shqiptar nga Kosova më ka thënë: - Kur kam ardhur në Suedi kam takuar një soj shqiptarësh, e nuk e kam ditur se ka të tillë... Shprehja përgjithësuese e Birgit Frigebos për prirjen e supozuar të shqiptarëve për hajni ishte një gafë, për çka ajo më vonë kërkoi falje, por paragjykimet e saj nuk ishin fenomen i rastit. Një pasqyrë të kundërt për shqiptarët e gjeta po atyre ditëve në një gazetë: Në një shpallje në gazetën lokale të qytetit tim një person falënderonte një shqiptar të Kosovës, i cili e kishte gjetur portofolin e tij dhe e kishte dorëzuar tek policia lokale... Të gjithë shqiptarët e ndershem në Suedi u lënduan dhe u pikëlluan nga akuza e mësipërme ministreshës. Menjëherë pas deklaratës së Frigebos, më vizitoi një shqiptare dhe kushëriri i saj me lot në sy: djali i saj, të cilin e kisha nxënë dhe e kam njohur si një fëmijë të dashur, ishte zënë në vjedhje në një shitore. Ç'është më e keqja, ai i kishte paratë për sheqerka dhe nuk kishte mundur ta sqarojë veprimin e vet. E ëma dhe kushëriri i saj kishin ardhur të bisedonin me mua lidhur me atë ngjarje dhe më pyetën se ç'duhej të bënin. Ajo që kishte ndodhur ishte e turpshme. Unë i qetësova duke u treguar se si një herë edhe unë, si fëmijë, kam vjedhur dhe duke u folur mbi fenomenin e vjedhjes tek fëmijët në përgjithësi. Të gjithë ishim të një mendjeje se shitoret suedeze thuajse nxisin vjedhjen, pasi që mallrat janë të ekspozuara ashtu që ato janë të arritshme në një mënyrë krejt tjetër nga ajo e vendeve prej nga kishin ardhur ata.

Lidhur me kriminalitetin e rëndë janë paraqitur veprimtari edhe në liga e edhe krime të rënda dhune, ndër të tjera edhe keqtrajtme të grave. Qenie të parrënja, që për shkak të luftës dhe shtypjes janë detyruar të braktisin atdheun dhe janë gjendur në një ambient totalisht të huaj, nuk ndjejnë asfarë përkatësie me këtë shoqëri – ata duan të shfrytëzojnë çdo shansë për përfitime pa kurrfarë ngurrimi moral. Ligat shqiptare, që janë marrë me kontrabandë dhe tregti narkotike e të armëve, janë të të njëjtit tip dhe ekuivalente me grupet mafioze si ato turke, serbe, italiane, suedeze e shumë të tjera. Ato, kryesisht, kanë qenë aktive në Gjermani e në Zvicër, të cilat i kanë bërë transportet nga Lindja e Largët në Evropën Qendrore. Këto të dhëna i kam marrë nga shtypi shqiptar, i cili më së shpeshti është i interesuar dhe shumë i mprehtë në çështjen e kriminalitetit shqiptar.

Dua ta përmbledh këtë: Kriminaliteti ndër shqiptarët në mërgim shfaqet si edhe te grupet tjera etnike. Mirëpo ndodhë që herë pas here akuzat lidhur me krimin kanë një prapavijë politike apo raciste. Në Ballkan ekziston një sindrom antishqiptar, që mund të ketë krahasim vetëm me temrrin rus, tmerrin kinez (i ashtuquajtur i "Rreziku i verdhë") dhe thënien për "qenin turk" në kohë të vjetra të Evropës. Është primitive, por u shërben qëllimeve të dyshimta politike, dhe, ç'është edhe më e dhimbshme, disa intelektualë në Ballkan, që këto punë do të duhej të dinin më mirë, janë krejtësisht primitivë në këtë çështje. Të reagosh në mënyrë primitive në Skandinavi është diçka krejt e papranueshme.

Ne që jemi pak më të moshuar mund t'i krahasojmë finlandezët dhe shqiptarët. Ne na kujtohen të gjitha përgojimet kundër finlandezëve që erdhën në Suedi para 40-50 viteve dhe do të kuptojmë se thëniet për shqiptarët si kriminelë kryesisht janë përfolje qëllimkëqia. Në vitet e '50-'60-ta jemi ushqyer nga gazetatat e djathta të tipit të *Nya Värmlands-Tidningen* (Gazeta e re e Vermlandit) me të dhëna mbi kriminalitetin e emigrantëve finlandezë. Populli i lexonte gazetatat, i shihte alkoholistët finlandezë që rrinin përpara Kompanisë për shitjen e alkoolit dhe brisnin "perkele" dhe pamja ishte e qartë: "Finlandezët janë një lloji i keq i njerëzve, dhe - ç'farë duan ata këtu?".

Ajo çka suedezët shpesh nuk e shihnin – ose nuk donin ta shihnin – ishte se 90-95% e finlandezëve që kishin ardhur te ne për të punuar, vuanin nga punët më të rënda në industrinë suedeze, ose punonin si pastrues në institucionet tona, duke e ndërtuar kështu mirëqenien suedeze. Ata i kryenin punët më të ndyera, me të cilat suedezët nuk donin të merreshin. Po këta finlandezë mund t'i shihje më pas në gjurmët e mocioneve dhe në pista skish, proporcionalisht më shumë sa se suedezët autoktonë. E njëjta gjë po përsëritet sot: Majoriteti i shqiptarëve në Suedi që e kalojnë kohën e tyre në industri, në komunikacion ose në kujdestari dhe të gjithë ata që vazhdojnë studimet e veta në shkollat tona nuk janë shumë të zëshëm. Shembujt negativë janë ata që, fatkeqësisht, bien më tepër në sy.

Në fund: Psikologjia popullore shqiptare shpesh ka një qëndrim shumë të mençur në çështjet jetësore. Me siguri është shumë e vlefshme që lehona menjëherë pas lindjes për disa ditë me radhë vizitohet nga e ëma, që kujdeset për të dhe e ndihmon atë. Kjo traditë me siguri mund t'i ndihmojë gratë e reja, të cilat përmes martesës bien në një ambient që pjesërisht është i huaj për to. – Dhe po qe se e sheh një karrige para derës së shtëpisë së një shqiptari kjo mund të shpreh faktin se në familje ka zi. Atëherë ti je i mirëseardhur për të shprehur ngushëllime, edhe po qe se kontakti yt me familjen ka qenë shumë sipërfaqësor. Merr me vete një kuti kafeje, si një dhuratë e vogël, për familjen që ka zi. Në trajtimin e pikëllimit shqiptarët janë shumë të shkathët, kurse ne suedezët zakonisht preferojmë t'i izolojmë njerëzit në pikëllim me thënien se "ata duhet të jenë të qetë në pikëllimin e tyre". Marrëzi, mendoj unë. Modeli i shqiptarëve është

shumë i përshtatshëm: njeriu mund të qajë me dikend që brengoset për të. Vetëm kohëve të fundit në shoqërinë suedeze është bërë aktual koncepti "grup i krizës".

Këtu po e vëmë pikën për këtë shqyrtim subjektiv dhe me paragjykime. Kjo mbase megjithatë i ka dhënë lexuesit diçka pozitive. Një gjë është e qartë: Kudo që të shkohet mund të shihet se njerëzit janë individë të ndryshëm. Mund të dallohen disa mostra brenda një popullate, e po qe se bëhen shumë përgjithësime atëherë njeriu mund të bie në pozita të gabuara! E, sidoqoftë, nevojat elementare të njerëzve janë të njëjta.

SHQIPËRIA DHE HEBRENJTË GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Në këto ditë, kur diametralisht ndahen mendimet mbi Izraelin dhe politikën e shtetit të hebrejve, mundet vetëm të konstatohet se pikëpamjet mbi hebrejët u takojnë atyre fushave ku mendimi tendencioz ka sjellë përfundime të gabuara më shumë se për çdo gjë tjetër. Dua që me pak fjalë të parashtoj botëkuptimin tim:

Gjatë historisë, si popull, hebrejët kanë vuajtur jashtëzakonisht shumë. Kontributi i hebrejve në kulturën botërore është i paçmueshëm. Shumë prej figurave të mëdha të muzikës, artit dhe literaturës gjatë shekujve kanë qenë hebrej. Dhe hebrejët kanë të drejtë të jetojnë në vendin e tyre.

Por: sionizmi është një ideologji që ka marrë një formë agresive. Izraeli është krijuar si shtet përmes një kombinimi të gabimit të bashkësisë ndërkombëtare dhe terrorizmit hebre. Për këtë, mjafton të përmendim grupin Stern (grup ekstremistësh hebrej) dhe vrasjen e kontit Folke Bernadote. Ndërkaq, sa i përket akuzave të sotme izraelite kundër palestinezëve për terrorizmin e këtyre të fundit - mund të thuhet vetëm kaq: Këta terroristë janë kundërpërgjigje ndaj asaj politike që tërë kohën e ka ushtruar Izraeli. Arabët i janë ekspozuar tradhëtisë dhe manipulimeve, e pastaj dëbimit. Unë nuk e mbroj politikën arabe kundër Izraelit, por dua të theksoj vetëm se ajo politikë i ka shkaqet e veta. Mbështetja e rezervave të botës perëndimore për Izraelin është një njollë turpi në historinë moderne, dhe pikërisht gjëra të këtilla e shtojnë fundamentalizmin arab dhe krijojnë terroristë, të cilët s'kanë se çka të humbin...

Tragjika është totale. Të gjithë pësojnë për shkak se fanatikët nga të dyja taborret kanë aq ndikim të madh. Unë e urrej antisemitizmin, por (pikërisht për atë!) më duhet të jem anti-sionist. Idetë mbi popujt e zgjedhur nga zoti ("Popujt që i përkasin Zotit") janë të tmerrshme pavarësisht se ku shfaqen ato! E tash do të kaloj te një kumt bëmirisie: Përpjekjet e shqiptarëve për t'i shpëtuar hebrejët gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Hebrejët në Shqipëri – disa fakte

Hebrejët e parë në Shqipëri kanë ardhur gjatë mesjetës. Në periudhën e paraluftës numri i tyre arrinte vetëm në 200 sish. Ata banonin kryesisht në qytetet bregdetare.

Në vitet 1941-1943 në Shqipëri erdhën si azilkërkues 597 hebrej. Të gjithë këta kanë shpëtuar. Pjesa dërrmuese e tyre e braktisën vendin me rastin e përfundimit të luftës. Numri i hebrejve që mbeten në Shqipëri pas luftës ishte gjithsej 200-220. Viteve të fundit edhe pjesa dërrmuese e tyre kanë emigruar në Izrael.

Shqiptarët e Kosovës i shpëtojnë hebrejët

Hebreja Julia Kantoz, rrëfen:

"Kur nazistët e sulmuan Jugosllavinë më 1941, shumë hebrej nga anë të ndryshme të vendit u mbledhën në kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë. Popullata, në pjesën më të madhe shqiptarë muslimanë, kishte vendosur që t'i shpëtonte refugjatët. Asokohe Kosova ishte e ndarë nga forcat okupatore italiane dhe gjermane. Përfaqësuesit shqiptarë iu drejtuan karabinjerëve italianë dhe ia dolën t'i bindin ata që pjesën më të madhe të hebrejve t'i transportojnë për në shtetin e Shqipërisë. Vetëm 50-60 sish ranë në duart e gjermanëve".

Dr Spiro Lito, asokohe mjek në Prishtinë, rrëfen:

"U njoftova nga një epror italian, i cili kishte ide socialiste si dhe nga shumë bashkëvendas, se gjermanët do t'i dërgonin hebrejët në kampet e përqendrimit. E

sajova një diagnozë false se gjoja hebrenjtë janë sëmure nga tifoja dhe se duhej të transferoheshin në Shqipëri. Prefekti Riza Drini e pranoi propozimin dhe hebrenjtë u shpëtuan në Shqipëri. Hebrenjtë e mbetur në Prishtinë shpëtuan me ndihmën e popullatës, e cila i strehonte ata. Gratë visheshin me kostume muslimane me fereuxe dhe mund të lëviznin të lira në qytet”.

Shqiptarët nuk u ndikuan nga antisemitizmi

Inxhinieri Samuel Mandil, refugjat hebre në Shqipëri, shkruan në një letërfalënderimi më 1945:

“Ne pamë me sytë tanë se populli shqiptar i çmonte njerëzit në bazë të vetive të tyre personale, ai tregoi mirëkuptim për të shtypurit dhe të përndjekurit, sepse edhe shqiptarët vetë shpesh kanë qenë në situata të tilla. Prandaj, ata nuk u ndikuan nga propaganda e qelbur antisemite nga ana e Gebelsit”.

Me kërkesën italiane e më pas edhe gjermane, organet shqiptare bashkëpunëtoreshë forcave okupatore, gjatë vitit 1942, nxorën urdhërin dhe dekretin sipas së cilës refugjatët hebrenj duhej të largoheshin nga vendi, si dhe t’u dorëzoheshin forcave okupatore gjermane. Të gjitha prefekturave, nënprefekturave, komunave e madje edhe kryeqendrave e fshatrave u tërhoqën vërejtja që të jepnin të dhënat mbi hebrenjtë dhe trevat ku ndodheshin ata. Këto urdhëresat u neglizhuan dhe u sabotuan nga të gjitha organet përkatëse lokale.

Komandanti italian në kampin e përqendrimit në Kavajë, kur Italia kapitulloi më 1943, i shkatërroi listat e hebrenjve në kamp dhe i nxiti ata të fshiheshin në anë të ndryshme të Shqipërisë.

Hebreu i fshehur në krevatin e gruas shqiptare

Mark Menachemi u fsheh në vende të ndryshme në Tiranë në vitet 1943-1944. Por ai përmend veçanërisht një grua nga jugu i Shqipërisë. Ajo është Dhorka Kovaçi e cila, kur gjermanët e bastisën në fillim të vitit 1944, e vendosi Markun në krevatin e vet dhe tha se ai ishte burri i saj, i cili ishte ”i sëmure”. Pastaj Marku shkoi te Vasil Nosi, pronar i një fabrike të alkoolit në Elbasan. Marku punonte dhe flente në fabrikë. Një ditë shkuan gjermanët dhe e arrestuan, por ai u shpëtua nga Vasili, i cili e kishte në dorë një epror të alkoolizuar gjerman e të cilin arriti ta detyrojë që ta shpëtojë Markun

Një hebreje që i jep gjë një fëmijë shqiptar

Në Berat, rreth 15 familje shqiptare, i morën në strehim refugjatët hebrenj. Ndër ta ishte Xhevat Gjergani i cili u kujdes për burrin dhe një vajzë të vogël të Sara Adizhes. Gruaja e Xhevatit, Afërdita, nuk kishte qumësht në gjë për fëmijën e saj. Prandaj Sara e muarr përsipër që t’i jepte gjë edhe vajzës së vet e edhe fëmijës shqiptar. Sipas traditave tona muslimane, thonë Xhevati dhe Afërdita, dy fëmijët u bënë vëlla e motër për njëritjetrin. Hebrenjtë janë njerëz si edhe ne, thonë ata, pavarësisht përkatësisë fetare dhe nacionale.

Shqiptari Refik Veseli merr medalje nga Izraeli

Bashkë me gruan dhe dy fëmijët Moshe Mandili nga Beogradi, ku kishte një fotostudio, shkoi në Shqipëri. Kur nazistët e pushtuan Jugosllavinë u transferua familja në kampin e përqendrimit në Kavajë të Shqipërisë. Sikurse u përmend më sipër, pas kapitullimit të Italisë u shpëtuan shumë familje hebreje falë mënyrës së veprimit të eprorit të lartpërmendur, dhe Moshe me familje u vendos së pari në Tiranë e më pas në

Krujë. Ata, te Refik Veseli, banuan deri në nëntor 1944, kur Beogradi u mor nga Armata e Kuqe dhe familja Mandili mundi të rikthehej atje. Djali i tyre, Gavri (Iki), me emër shqiptar, pati shkuar në shkollë në Krujë. Të gjithë fqinjët kishin dijeni për "mysafirët" e familjes Veseli dhe e alarmonin atë kur ishin duke ardhur gjermanët.

Në vitin 1990 Refik Veseli shkoi për vizitë te miqtë e tij të vjetër hebrenj, të cilët tashmë ishin vendosur në Izrael. Shkoi atje në një ditë të rëndësishme: ishte dita kur djali i Moshes po martohej. Gavri u tha të pranishmëve: jo veç ushqimi, por mbi të gjitha ishte mirësia dhe besimi i kësaj familje të thjeshtë shqiptare ajo që familjen Mandili e kishte mbajtur në jetë.

Një javë pas festës së dasmës Refikut iu nda medalja "Të drejtët" në ceremoni në Yat Vashem, ku drejtori i Institutit për studimet lidhur me holokaustin, me ç'rast ishin asgjësuar 6 milionë hebrenjë, në fjalimin e tij tha: Shqipëria ishte i vetmi vend ku asnjë hebre nuk ishte tradhëtuar, edhe pse mosdorëzimi i hebrenjve ishte me rrezik për shqiptarët.

(Materiali i këtij kapitulli, në pjesën më të madhe, është marrë nga një artikull në revistën "Studime historike" (Tiranë 1990). Revista është botuar me një vonesë shumë të madhe në një seri shkencore, dhe teksti është shkruar sipas gjitha gjasave pas vitit 1990.)

ZËRA SHQIPTARË PËR SUEDINË DHE SUEDEZËT

Suedia dhe Shqipëria nuk janë vende fqinje. Deri në kohën moderne, Shqipëria ishte vendi më i panjohur në Evropë për ne suedezët. Kjo, deri diku, ka ndryshuar nga ngjarjet dramatike të 1990-tës. Por përse të mos e kthejmë pyetjen në drejtim të kundërt: Çka kanë ditur shqiptarët për Suedinë?

Kur e vizitova Shqipërinë dhe Kosovën në vitin 1970 ndesha mendimin se Suedia, në aspektin teknik dhe social, ishte një prej vendeve më të zhvilluara në Evropë. Punëtorët në Shqipëri kishin njohuri lidhur me teknikën suedeze dhe njihnin emra si Atlas Copco e Volvo. Të interesuarit për futboll dinin shumë gjëra për futbollistët suedeze. Në Kosovë kishin parë disa filma suedeze ose kishin lexuar veprën e Ekstromit "Ajo vallëzoi në një verë", që ishte përkthyer në shqip në Kosovë dhe, me këtë, ishte përhapur – te shqiptarët si te shumë të tjerë - një imazh i dyshimtë për vajzën suedeze. Në Shqipëri kishte njerëz që i njihnin dhe i resepktonin emrat si Greta Garbo dhe Ingemar Bergman. Një pjesë e letërsisë suedeze është përkthyer në shqip, por është vështirë të përpilohet një listë e plotë.

Një student shqiptar në Upsala – athua vetëm trillim?

Në vazhdim do të trajtoj se si vendi ynë është përshkruar në letërsinë shqiptare. Dua të filloj me përshkrimin më interesant: Romanin e Faik Konicës "Dr. Gjëlpera zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit". Libri pa dritën si dorëshkrim më 1924 – e së pari u publikua më 1933 në serinë "Vepra". Libri nuk ka të bëjë gjithaq me dramën në Mamurras – vrasjen e disa studentëve amerikanë në një fshat në Shqipërinë e mesme; ai më tepër ka të bëjë me mendimet dhe zbulimet e një intelektualit shqiptar në botën e jashtme. Ky përshkrim, i cili në pjesën më të madhe është autobiografik, u shkrua nga një prej personaliteteve më të shquara të kulturës shqiptare prej ndërrimit të shekujve deri në ditët e Luftës së Dytë Botërore. Faik Konica (1875-1942) bashkonte në personalitetin e tij patriotin shqiptar, satirikun e gjallë që thoshte të vërtetat e hidhura për bashkëkombasit e tij, kozmopolitin dhe dendin. I vetmi që do të mund të krahasohej me Konicën në aspektin e mprehtësisë intelektuale dhe shumanshmërisë, është miku i tij personal, peshkopi Fan Noli. E tash le të kalojmë në paraqitjen e aventurës të para më shumë se 80 viteve, të këtij të riu shqiptar në Suedi:

"Gjëlpera kish dëgjuar që prej vjetësh për Upsalanë, si një qendër kulturore me famë, dhe emrin e Universitetit të Upsalasë të zihet në gojë me nderim. Nga të katër universitetet e Suedisë - në Upsala, Lund, Stokholm dhe Goteborg –zgjodhi Upsalanë; dhe që të mësonte sa më shpejt me rrethin e ri, shkoi që në nisje të vjeshtës te qyteti universitar. Erdhi më në fund koha akademike; dhe Gjëlpera tani vuri në kokë kësulën prej kadifeje të bardhë me një shirit të zi, që është shenja e studentëve të Upsalasë.

Në krye, gjuha e pengonte që të zhvillojë mirë mendimet e tija. Po sa vente dhe stërvitej; edhe me atë gjallësi që e karakterizonte, arrijti shpejt të bëhet plotësisht i zoti i gjuhës së re. Atëherë profesorët nishnë të kuptojnë e të çmojnë fuqinë mendore të tij; dhe bashkënxënësit gjetnë tek ai një njeri vërtetë të matur në të gjitha, po jo kundërshtar të gazit e të qeshjes. Kur kish nge, vente dhe ai në kabaretë e birraritë; mirrte pjesë në këngët e në vallet, si dhe në shakatë e padëmshme. Njohu nja dy çupa. Motin e dytë të tij në Upsala gjeti një mikeshë. Ia thoshin emrin Ingrid. Qe një leshverdhë e gjatë, nga pikëpamja e shtatit, më e bukur se Vera, po me fytyrën më të ftohtë, pa fuqinë misterioze të Verës (dashnorja e tij e studimeve në Petersburg – shënim i autorit.) ... Po Ingrida qe një çupë e dashur, me një shpirt të mbyllur dhe si pak të tërhequr, mikeshë ideale për një nxënës serioz, të kujdesur me kërkime diturie, i cili s'ka nge për zhvillime

romantike. Ingrida qe e sjellë, e urtë, e qetë, e rritur mirë. S'kërkonte një Romeo; desh një shok të pëlqyer. Dhe nxënësi ynë s'kishte dëshirë të jetë më tepër."

Ne mësojmë se Suedia ishte një ishull i qetë në kohën e luftës në Evropë dhe se kërkoheshin nëntë vite për t'u bërë mjek në Upsalë- tre vjet më tepër se sa në vendet e tjera. Gjëlpera- dhe Konica – e lavdërojnë këtë sistem suedez. Studenti shqiptar nuk kishte ndonjëfarë problemi ekonomik: babai i tij i mplakur i kishte vendosur 300 mijë korona në një bankxhiro suedeze, një shumë jashtëzakonisht e madhe në vitet e 1910-ta në Suedi. Mirëpo babai i vdes:

"Ingrida, porsa mësoi ngjarjen, i bëri vizitë dhe me takt pa dhënë ngushëllime të kota që s'ngushëllojnë po vetëm lëndojnë, foli mbi çështje të tjera, dhe i propozoi një shëtitje anës lumit Fyris"

Instituti i Karolinës dhe njohja me dramat e Strindbergut

"Në qershor 1920, pas nëntë vjet pune dhe kërkimesh, nëntë vjet aventurash të pasionuara në udhët e ngushta dhe të ashpra po të çuditshme të diturisë, Gjëlpera mori më në fund kësulën e doktorit të mjekësisë në universitetin e Upsalës. I ditur, i pasur, po i vetëm përpara një bote të trazuar e të përgjakur, Gjëlperës kish për të zgjidhur problemin e fushave të veprimtarisë së tij. Mund të rronte kudo; dhe meqë kërkimet e laboratorit i pëlqenin më tepër se sa puna e spitaleve, mund të vazhdonte së ndenjuri në Suedi. Me këto mendime u largua nga Upsala dhe u vendos në Stokholm, ku mori lehtë leje të punojë në laboratorët e një instituti me famë : Karolinska Mediko-Kirurgiska Institut. Stokholmi është nga Upsala një orë me udhë të hekurit, ose nja dy orë me anije të avullit nëpër lumin Fyris dhe një pjesë të liqenit Maelar. Dr Gjëlpera vente nga ndonjëherë në Upsala për t'u takuar me Ingridën; po më shpesh e ftonte Ingridën në Stokholm, që ta shpinte në teatër, veçan kur jepnin ndonjë vepër të Strindbergut, më të fuqishmit shkrimtar dramatik të kohëve tona, i cili në shumë lodra të gjata ka vetëm tri fytyra dhe është i zoti, me aq pak fytyra përpara shikonjësve, jo vetëm të shpëtojnë nga monotonia, po dhe ta mbajë disa orë publikun me vërejtje të palodhur e të gjallë: artist me të vërtetë i thellë, që arrin efekte të mëdha, me mjete të pakta. Ingrida e bënte udhëtimin në Stokholm me një gëzim që vazhdonte të përsëritej dhe prore rritej, dhe kthehej në Upsala me një mallëngjim për mikun e saj besnik, doktorin e huaj, i cili, tani burrë 29 vjetsh, sy zi, me ballë të gjerë, i gjatë e i hollë, kish një dukje fizike të pëlqyer; dhe veçan fytyra e tij prej mendonjësi kish një gjallëri që nga ndonjëherë turbullonte edhe shpirtin e qetë të Ingridës."

Përsëri në Shqipëri

Mirëpo, me kohë, dr Gjëlpera, do të braktisë Suedinë dhe do të udhëtojë për në jug. Së shpejti do të ndodhet sërish ai në vendin e vet, në Shqipëri. Një ditë ai pritet nga një ministër, Salemboza, dhe gjatë vizitës do të zihet në gojë edhe Suedia. Gjëlpera e përmend vizitën që një ditë princi Gustav Adolf i bëri universitetit në Upsala. Aty ndodhej profesori Holmkvist i cili, kur princi dhe shërbëtori i tij i tregojnë se që të dy ishin ftohur gjatë një gjuetie në Suedinë veriore, i urdhëron që të dytë të zhvishen për një kontroll mjekësor. Princi shpejt i bindet urdhërit. Kur ministri Salemboza e dëgjon këtë edhe ai nis të zhvishet për t'u kontrolluar nga Dr. Gjëlpera. Pasi që vishet sërish ministri, ulet dhe nis të kruajë kokën me gishtin e majtë tregues – meqë ai kishte dëgjuar se ashtu kishte bërë princi suedez. Ministrin i caktohet diagnoza: ai ka një skelet të brishtë për shkak të trupit të tij të rëndë. Mjeku i rekomandon atij të bëjë banjë dielli, në ajër të pastër dhe kurrë pas xhamit, si dhe të marrë vitamin A. Përveç kësaj, ministri duhet të pushojë me dietën e tij të njëjtë prej mishi me qëllim që t'i përmirësohet frymëmarrja si dhe në përgjithësi shëndeti. – Dr Gjëlpera e përfundon

vizitën duke i dhënë ministrit orën e tij të blerë në Suedi – sepse ai mund të blente një orë të re, kur ai të kthehej në Suedi.

Pyetja interesante është kjo: A ka qenë Faik Konica në Suedi? Në ato punime ku trajtohet jeta e tij nuk ka kurrfarë indikacioni se ka qenë; por nëse Konica nuk ka qenë në Suedi, atëherë ai do të ketë pasur një interesim tepër të madh për vendin tonë dhe ka marrë njohuri për të edhe përmes leximit e edhe përmes kontakteve me njerëz që kanë pasur përvojë personale nga Suedia. Të dhënat që ai lë në romanin e papërfunduar, për aq sa unë mund të gjykoj, janë korrekte dhe të besueshme.

Romani i Petro Markos “Hasta la vista”: Një vajzë suedeze si vullnetare në Spanjë

Në romanin e Petro Markos (1913-1991) “Hasta la vista”, ngjarja e të cilit zhvillohen gjatë luftës civile në Spanjë në vitet e ‘30-ta, personazhi kryesor është një vullnetar shqiptar, Gori Gjonleka. Romani u botua më 1959, e që nga atëherë është ribotuar disa herë.

E vërteta faktike është se një grup prej 40-të shqiptarësh mori pjesë në luftën civile në Spanjë në anën e qeverisë republikane. Në mesin e tyre ishte edhe shkrimtari Petro Marko. Disa nga shqiptarët edhe u vranë në luftime, ndër të cilët edhe Asim Vokshi nga Gjakova e Kosovës. Një tjetër pjesëmarrës ishte Mehmet Shehu, më vonë Ministër i Punëve të Brendshme dhe kryeministër në Shqipëri, “vetëvrasja” e të cilit më 1981 paraqet një prej ngjarjeve më të errëta në historinë shqiptare.

Në kapitullin e tretë të “Hasta la vista” paraqitet një vajzë suedeze:

“Infermierja suedeze, herë dremiste, herë i vinte dorën në ballë. E kish skalitur thellë fizionominë tërheqëse të Gorit. Ç’qepallat të zeza e të kthyer, aq sa kur çelëshin arrinin gjer tek vetullat e zeza! Ç’dhëmb të bardhë. Po t’ishite piktore do t’i bënte një portret, do ta mbante me vete e kur të kthehej atje larg në Suedi, do t’u thosh shoqeve: “Shikoni ç’fytyrë ka Mesdheu! Shikoni ç’fytyra kemi mjekuar...”

Kristina është e qetë dhe e heshtur, me shikim të ngrohët. Është e interesuar për Gorin, por ai s’bëri zë dhe është tepër i mbyllur. Kristina nuk ka guximin t’i thotë “Të dua”. Ajo ia hap zemrën Dritës, një vajzë nga Tirana, e cila e ngushëllon Kristinën:

“Kështu e kanë burrat! Qëllon të duan atë që s’e njohin dhe s’i do, dhe të mos shikojnë se cila i do. Po ti mos u dëshpro! Kështu e kanë shqiptarët! Nuk e tregojnë dashurinë! Janë shumë të mbyllur.”

Sa i përket Kristinës, gjithçka përfundoi në mënyrë tragjike - ajo u vra. U vra nga një sulm i armikut, atëherë kur nuk donte t’i braktiste pacientët. Gori kurrë nuk do ta harrojë atë.

*

Për deri sa filmat suedezë të viteve 1950-60 e krijonin një imazh jo të mirë ndaj femrave suedeze, shkrimtarët e sipërpërmendur shqiptarë kanë ofruar një pamje tejet pozitive mbi vajzat suedeze, si zemërmira dhe mjaftë simpatike.

Sterjo Spasse për vizitën në Stokholm më 1958

Sterjo Spasse ishte paksa i pazakonshëm, nga se si shkrimtar me përkatësi nacionale maqedonase, ka shkruar në shqip. Ka lindur më 1912 në një fshat të vogël buzë liqenit të Prespës, një liqe i bukur malor brigjet e të cilit ndahen nga Shqipëria, Maqedonia dhe Greqia. Në brigjet shqiptare ka disa fshatra të banuara me maqedonas, kurse në anën maqedonase ka mjaft fshatra me banorë shqiptarë.

Sterjo Spase u bë mësues, u diplomua në Shkollën Normale të Elbasanit që më 1932, dhe, disa vite më pas, botoi romanin e tij të parë “Pse?”. Romanet e tij mbi mësuesen e re Afërdita dhe luftën e saj për gruan dhe arsimimin e saj në Shqipëri në vitet e ’30-ta e të ’40-ta kanë qenë shumë të lexuara e të diskutuara. Por ndonjë shkrimtar i madh nuk ishte Sterjo Spasse, i cili vdiq më 1989. Merita e tij e madhe në Shqipërinë e Enver Hoxhës ka qenë bindja ndaj vijës së partisë, gjë që i dha atij një pozitë të sigurt dhe mundësi për të bërë udhëtime jashtë vendit. Kështu ai erdhi në qershor 1958 në Stokholm, si delegat për të marrë pjesë në Kongresin për çarmatim dhe bashkëpunim ndërkombëtar, që asokohe u mbajt në kryeqytetin suedez. Djali i tij, Ilinden Spasse, i përshkruan përshtypjet e udhëtimit të babait të tij në librin “Im atë, Sterjo!” që u botua në Tiranë më 1995:

“Simvjet Suedia po kremton një datë të shënuar të jetës së vet, një mrekulli - ëndërr për Evropën: Suedia feston 150-vjetorin e një jete paqësore. Gjatë këtyre 150 vjetëve nuk është zbratur pushka e topi. 150 vjet suedezët nuk kanë bërë luftë, nuk e dinë se ç’është lufta.

Stokholmi, është një qytet ku duket fati i një pune paqësore shekullore: Ka gati një milion banorë, megjithatë të krijohet përshtypja sikur këtu ka më shumë vetura se njerëz...

Qyteti shtrihet mbi bregdetin e Balltikut mbi ujdhesa dhe siujdhesa të lidhura me njëra tjetrën me ura të mëdha e shumë të mëdha. Thellësia e gjireve, që përbëjnë bregdetin e qytetit, duhet të jetë shumë më e thellë, se këto ditë këtu në gjirin përballë pallatit pamë të hidhen spirancat e tre vaporëve transoqeanikë. Në arkitekturë të bijen në sy dhomat me dritaret të mëdha për të hyrë drita e bollshme. Gati njëri mur është vetëm dritare. Këto dritare lidhen edhe me nevojën për diell që kanë këto vende: në më të shumtën e kohës gjatë vitit këtu mungon dielli. E tani në verë, që i kanë ditët kaq të gjata, duhet ta shfrytëzojnë atë për shëndetin. Ndërtesat janë shumë të mëdha, punuar me ornamente të ndryshme e sidomos ka pirgje drejt qiellit, me stile të ndryshme. Ka luks e pastërti kudo në hotelet dhe në restorantet.

Pastërtia dhe estetika janë bërë një gjë e zakonshme. Të gjithë janë veshur pastër dhe bukur. Edhe një lypës që na u paraqit me një kartelë invalidi, ishte veshur shumë mirë. Dyqanet janë plot me mall, mirëpo shohim pak blerës. Shërbimi kryhet me shpejtësi dhe çdo gjë është e ambalazhuar shumë bukur. Ushqimet i gjenë të konservuara. Duket se këtu industria ka nivel të lartë. Dhe pikërisht ky nivel ka ndikuar në jetën e njerëzve dhe ka krijuar traditë pune. Të gjithë punojnë me orar unik, e pasdreke të gjithë dyqanet janë të mbyllura, njerëzit janë të lirë dhe i gëzohen jetës familjare. Prandaj mbasdrekave kafenetë, restorantet, kinematë, vaporet e shëtitjeve, parqet, teleferikët që venë në zonat turistike dynden nga njerëzit.

Koha na duket si marsi a prilli i Tiranës: herë ftohtë, herë shi, herë pak ngrohët e diell.

Njerëzit në përgjithësi janë të gjatë: gratë më shumë leshverdha e sykaltërta, flokët e shumicës, u duken si lesh i bardhë deleje. Janë të holla, të gjata, shumë prej tyre të bukura nga fytyra, një pjesë e tyre kanë një bukuri të tillë, që nuk shkon pas midesë sonë. Burrat, zakonisht, janë jo aq të pashëm nga fytyra, kurse nga trupi janë të hedhur.

Në mes të kësaj morie njerëzish, nëpër parqe, ose nëpër kafenetë e parqeve shohim grumbuj të rinjsh: djemtë me mjekër dhe me flokë të gjata, ndërsa vajzat të veshura me pantollona të ngushta, si kilota, me një farë xhakete burri e me flokë të lëshuara, që pijnë duhan, që ecin zbathur a me nallane...

Në vitrinat e kinemave shohim reklama filamash amerikanë, që vrasin, presin ose mbysin gra. Në shumë librari shohim të ekspozuara revista, ku në faqen e parë, në kapak, ka gra krejtësisht lakurige. Fotot janë me ngjyra, që bien në sy për së largu.

Një anë shumë pozitive, veç industrisë së zhvilluar, ishte dhe pjesëmarrja e gruas në punë: gruan e gjen kudo krahpërakrah burrave, bile, nëpër dyqane, si shitëse, nëpër

restaurante, hotele, bile edhe si shofere. E këto gra, në punë e sipër, edhe shoferet, i gjen të veshura me bluza shumë të pastërta si të dala nga kutija.

Stokholm. 26.VII. 1958, ora 12.30”

Si Faik Konica e Petro Marko, edhe Sterjo Spasse jep një pamje pozitive për Suedinë. Spasse bën një përshkrim prej vëzhguesi. Vlerat që i përmend kanë të bëjnë me ato që Spasse i çmonte, kurse atë çka ai nuk e pëlqen: një pjesë e veshjeve dhe e mënyrës së paraqitjes së të rinjve, reklama e filmave me dhunë dhe revistat pornografike (ose ndoshta nudiste), paraqiten si fakte, pa i komentuar. Mandej, gjithherë mund të pyetet se a thua çka do të kishte shkruar Sterjo Spasse, sikur të kishte një liri të plotë të shprehjes? Me siguri, shumë gjëra do të paraqiteshin si rekomandime për Shqipërinë e varfër e të prapambetur. Por, për një shtet me sistem shoqëror kapitalist, politikisht nuk ishte e mundur të shprehje shumë entuziazëm në atë kohë në Shqipëri; një veprim i tillë do të kishte pasojë tepër të mëdha.

Një fat njeriu: Musine Kokalari

“... Njoha kulturën demokratike. Njoha tregjedinë e përmbysjeve të mëdha revolucionare dhe gjithë ndryshimet që pasuan nga ky tërmet i pandërprerë për të konsoliduar *diktaturën e proletariatit*... Njoha VETMINË E VETËKËRKUAR. Njeriu i vënë para të papriturave të hidhura, për të mos ardhur në kundërshtim me vetveten nuk ka rrugë tjetër, veç tërheqjes, “humbjes” në botën e vet të brendshme... Arrita kështu të njoh Shqipërinë e përmbysur. Po të mos kisha kaluar këtë rrugë sa tragjike aq edhe tronditëse, ndoshta s’do ta kisha njohur realitetin e vërtetë”.

Biografia e Musine Kokalarit është sa e begatë po aq edhe e vobekët. E begatë, po qe se hulumtohet puna e saj. E vobekët, po qe se shihen tiparet vendimtare të jetës së saj, tipare të cilat për më shumë se 36 vite mund të përmbledheshin vetëm me dy fjalë: burg, internim.

Kështu shprehet Eden Babani i cili, në gazetën Alternative SD, më 15 shtator 1991 shkruan disa fjalë përkujtimore me rastin e 8-vjetorit të vdekjes së Musine Kokalarit. Mbi vdekjen e saj tragjike ka shkruar një libër Eglantina Mandia, të quajtur “Sonata e Hënës” (Tiranë, 1995), prej nga është ridhënë këtu ajo pjesë e librit nga ditari i Musines, ku ajo shkruan mbi përshtypjet e veta lidhur me veprat e Selma Lagerlofit. – Por ne do të vazhdojmë me pikënisjen tonë prej artikullit të Babanit.

Musinja ka lindur më 19 shkurt 1917, më 1937 diplomoi në shkollën e vajzave “Nëna Mbretëreshë” në Tiranë. Në vitin 1941 iu dha titulli doktor i letërsisë në Universitetin e Romës për diseratacionin e saj “Letërisa shqiptare – Naim Frashëri”.

Musine Kokalari ka botuar veprat “Siç më thotë nënua plakë” (1939), “Sa u tund jeta” dhe “Rreth vatrës” (më 1944). Ka bashkëpunuar në mënyrë të rregullt me gazetën e kohës, duke shkruar me pseudonimin Muza. Është shkrimtarja e parë shqiptare.

Më 1943, bashkë me bashkëshortin Skënder Muço dhe një grup intelektualësh, formoi partinë socialdemokrate. Pas vrasjes së Skënder Muços, përveç me punën organizative brenda partisë, merrej edhe me botimin e gazetës socialdemokrate “Zëri i lirisë”. U përpoq të integronte lëvizjen e re socialdemokrate në Frontin Nacional-Çlirimtar, por pa sukses, sepse u pengua nga liderët komunistë që pretendonin se e drejtonin atë front, i cili formalisht ishte deklaruar pluralist, kurse praktikisht ishte shndërruar në një vegël të Partisë Komuniste të Shqipërisë, gjë që tashmë është e pranuar publikisht. Propozimi i saj që të përfshihej individualisht në Front u prit negativisht, meqë komunistët frikësoheshin ta pranonin në udhëheqje.

Pasi dy vëllezërit, Vesim e Muntas Kokalari, iu vranë në rrethana mizore gjatë luftimeve në Tiranë më 12 nëntor 1944, ditën tjetër u arrestua edhe Musineja, e cila pas

dy javësh do të lirohet me qëllim që të qetësohej opinioni, për shkak se vrasja e dy vëllezërve të saj e kishte prekur popullin.

Prej nëntorit të 1945, socialdemokratët shqiptarë futën në lëvizjen kundër diktaturës komuniste, lëvizje e cila quhej “Bashkimi Demokratik”. Bashkimi iu drejtua forcave aleate me një memorandum dhe kërkoi që zgjedhjet të caktoara për 2 dhjetor të shtyheshin, për shkak se ato nuk ishin përgatitur në mënyrë demokratike. Këtë çështje e kishte ngritur Musineja edhe në kontaktin me kolonelin Palmer, i cili në Shqipëri ishte me mision të qeverisë britaneze. Për fat të keq, forcat aleate nuk donin të merreshin me memorandumun e Bashkimit, gjë që u dha mundësi komunistëve ta paraqisnin “Bashkimin Demokratik” si një bllok që donte të shkatërronte pushtetin shtetëror.

Më 23 janar 1946 u arrestua Musineja. Afërsisht pas pesë muajve filloi gjykimi. Ajo tregoi vlera të larta gjatë gjykimit dhe kundërshtoi marrjen e avokatit mbrojtës.

Disa që ishin në sallën e gjykatës kujtojnë:

- Gjatë një seance sekush nisi të thërriste “Dënojeni me vdekje, me varje...”, e pas kësaj kryetari i gjykatës Frederik Nosi e pyeti Musinën:

- E pandehur, a e dëgjon se ç’thotë populli?

Me gjakftohtësi dhe mbase edhe duke ditur për fatin që një ditë pashmangshëm do ta priste diktaturën, ajo bëri profecinë:

- Këta, një ditë, do të thonë të njëjtën gjë edhe për ju!

Gjykata Supreme Ushtarake më 2 korrik 1946 e dënoi Musine Kokalari me 20 vjet burgim dhe konfiskim të pasurisë“ si sabotatore dhe armike e autoritetit pushtetor dhe e popullit”.

Këtu dua të lë përshkrimin e Babanit, se dua të parashtoj një mendim timin personal. Se komunistët ia arrinin të kundërvinin fëmijët ndaj prindërve tregon rasti i Frederik Nosit. Babi i tij, Lef Nosi, ishte ministër gjatë vitit të parë të Shqipërisë së pavarur e i cili, gjatë viteve të luftës, u tregua i pamundur sa pranoi një post nga qeverinë kuislinge e krijuar nga gjermanët. Ai u dënua me vdekje dhe u ekzekutua. Frederik Nosi ishte përkthyesi dhe shoqëruesi i Julian Amery, i cili ishte dërguar si agjent i qeverisë britaneze. Ky ka arritur t’i mbijetojë të gjitha ndryshimet politike, por se ç’ka ndodhur me atë pas rënies së qeverisë më 1991-92 është e panjohur për mua. Është e qartë se ai që ishte fëmijë i “një armiku të popullit” do të duhej, si të thuash, të ketë pështyrë në fytyrën e babait e të nënës së vet, si dhe do të ketë bërë shërbime të neveritshme si këlysh i diktaturës së Enver Hoxhës që të sigurojë jetën e vet. Frederik Nosi e zgjodhi poshtërimin dhe jetën...

Më 8 tetor 1961 u “lirua” Musine Kokalari nga burgu dhe u internua për tërë jetën në qytetin e vogël mirëditor Rrëshen.

Musineja u bë punëtore e shërbimeve komunale. Ne e kemi përjetuar atë se njerëzit me arsimim universitar nga vendet e pazhvilluara detyrohen të merren me larje enësh dhe pastrim në Suedi, meqë nuk mund të gjendet ndonjë vend pune sipas kompetencave që kanë. Fakti që Musineja u detyra të merrej me pastrim rrugësh dhe si ndihmëse muratori kishte shkaqe të tjera; qëllimi ishte që ajo të poshtërohej dhe me këtë t’u thuhej njerëzve: “Shihni se si e pësojnë armiqtë e popullit, se si ata i humbin vlerat njerëzore”. Musineja punonte në kushte të rënda: në mjerim e provokime të Sigurimit, ku ajo jetonte – sikurse vetë e ka thënë – në një vetmi të vetëkërkuar. Mbrëmjet i kalonte duke lexuar në bibliotekën në Rrëshen, ku rrinte në një kënd, e vizitorët e tjerë i rrinin larg si të kishte murtajën. Si pensioniste, Musineja jetonte vetëm nga pensioni prej më pak se 200 lekësh në muaj derisa vdiq më 14 gusht 1983.

Të afërmit e saj donin të mbanin zi për të, por nuk guxonin. Murtaja, me emrin e rrejshëm “luftë e klasave”, e izoloi Musinën. Shënimet e saj na tregojnë se ajo e pyeste veten se mos do të qe më mirë sikur të kishte vdekur në burg e t’i shpëtonte gjithë atij

mundimi fizik e psikik. Madje, edhe pasi ishte sëmurë nga kanceri, mizoria vazhdoi. Mjekju në Onkologji, në Tiranë, një “hero i kuq” nga rrethi i njerëzve të Byrosë Politike, Rita Marko, i cili ishte “syçelë” dhe e quante Musinën “sekretarëshë e Partisë Fashiste”, prandaj lidhur me këtë ka shkruar Musineja:

“Një gjë e kuptova. Jo vetëm që s’ua ndiente për rastin tim, por ata kënaqeshin duke më shkaktuar plagë. Kontrollimet mjekësore në të cilat kam qenë muajve të fundit ishin vetëm një teatër. Sipas rregullave do të duhej të isha operuar para gjashtë muajve.

Mjekë që vlerësonin pacientët sipas kriterëve politike. A mund të ketë një dënim më të madh moral për idetë “mbi njeriun e ri socialist”, për të cilat fliste aq bukur Enver Hoxha? Sepse kur aplikohet një moral i tillë ngulfatet humanizmi, mirësia njerëzore, dhe kultura. Por gënjeshtria e rrënon vetveten: Ideja për njeriun e ri socialist pëlciti si fluskë sapuni kur qeveria vajti në varr. Mbeti vetëm vakuumi.

Musine Kokalari mbi Selma Lagerlofin:

“DITARI”

18.II.1945. E shtunë.

Dita e vdekjes për 17 veta. Plagë të reja që hapen, lotë që po derdhen. Lotë mjerimi që s’kanë të pushuar, se plagë të reja të tjera do të hapen dhe s’lenë as të vjetrat të mbyllen. Hija e vdekjes mbulon qytetin. Drithma i shkojnë në trup çdo njeri. Ngjajmë me gjethet e pemëve që era i lëkund. Një e nga një po ikin e ikin. Një e nga një po na lënë. Kënga e vdekjes u përhap kudo dhe po hyn shtëpi më shtëpi. Ka më tepër se një mot që ka nisur me të madhe dhe nuk dihet se ku do të vejë dhe ku do të mbarojë. Pse heshtin njerëzia? Pse nxijnë rrugët e Tiranës? Mos vallë zemra ime e zezë, që kullon gjak i sheh kështu? Pse shtëpia më duket e ftohtë dhe çdo gjë pa shpirt? Fytyrave tona çdo ditë e më tepër u shtohet një rrudhë. Nuset çdo ditë më të zbehta dhe me flokë të thinjura. Plaga e shpirtit çdo ditë ftohet dhe kështu dhembja dëgjohet më shumë. Dhembja shungëllon në boshllëkun e shtëpisë sonë të ftohtë.

Ulur në këndin e odës dhe e mbyllur në veten time mendoja orët e ditës, librin që mbarova në darkë, pak më parë se të mbyllja librarinë “Novela suedeze” të Selma Lagerlof. Pas de Romiset, një tjetër grua shkrimtare më kënaq me novelat e saja, një ditë të tërë. Njëra më e bukur se tjetra. Penda e saj nuk shkruan, po i bie telave që tingëllojnë muzikën e ndjenjave të zemrës. Fjalët e saj i ngjajnë poezisë stolitur me mijëra zëra, ku natyra merr pjesë, sheh, këndon e qan me njeriun bashkë. Legjenda të kaluara gërshetuar dhe shkruajtur plot jetë. Ndjenja të holla të shpirtit, gëzim dhe ruajtja me një prozë poetike të pashoqe, ku dëgjohet gjithnjë një këngë e paprerë, që lidh zemrat e njerëzve të një populli të qetë, që do paqen, kënga e dashurisë. Një besim se e vërteta është mbi çdo gjë. Një ideal që ka hedhur rrënjë edhe në katundarin më të thjeshtë, në shtresat më të ulta, ndërgjegjia e pastër, shpirti i qetë.

Novelat e saj i ngjajnë melodive të zogjve. Legjenda të vendit, që natën rreth zjarrit kallëzohen prej babait dhe fëmijët kur të rriten ia lënë trashëgim atyre që vijnë pas. Pasqyra e gjallë e një populli të thjeshtë, të ndershëm, i lumtur dhe në varfëri, kur zemra është e kulluar si ujët e krojeve. Pasqyra e një populli me ndërgjegje, ku edhe fukaraja, që është keq për bukën e gojës, e ruan dhe e nderon mikun dhe shokun. Njerëz që i vlerësojnë të tjerët sipas veprave të tyre, sipas mënyrës së sjelljes me njëri-tjetrin, njerëz, që s’i harrojnë zakonet e të parëve. Njerëz që me vetminë e natyrës nuk rrojnë vetëm, se kanë një botë të brendshme të pasur, të cilët edhe në gjënë më të vogël të natyrës gjejnë bukurinë e pashoqe: shushurimën e krojeve, këngën e zogjve, fërshëllimën e erës, që tund degë dhe lëkund gjethe, bukurinë e luleve me erë të mirë

dhe dëborën në dimër, që vesh çdo gjë me petkun e saj të bardhë, si nusja atë ditë, që lë derën e babait për të vajtur tek shoku i jetës.

Selma Lagerlof, me zotësinë e saj artistike këto na i bie përpara syve. Këto ndjenja na ushqen. Kështu na dëfton vendin ku ajo ka lërë, është rritur dhe ka punuar për të.

Dashuria – burimi i jetës na prek dhe na bën të mendojmë si ajo, na bën të mendojmë që edhe ne, ta kemi një vend-Atdhe, si i saji, që na e përshkruan. Dhe në mos është ashtu si duket në shkrimet, ajo ka treguar se si vendi i saj duhet të gjejë rrugën më të drejtë për të qenë të lumtur. Të punojmë për të mbjellë farën e lirisë, ku respekti i çdonjeriu të jetë gjëja e parë. Dhe individualiteti i mbujtur mbi baza të shëndosha morali në çdo krijesë është ideal. Një ideal që nuk i largohet realitetit, po që i vjen në ndihmë duke rrojtur me nder dhe me djersën e ballit. Një ideal me virtytet më të larta dhe me ndjenja njerëzore!”

Përfytyrimet e mira e të ndritshme na ndihmojmë të mbijetojmë

Si vermlandas (krahinë në Suedi) që jam, më prekin fjalët e Musines. Eh, sikur ne të ishim vetëm përgjysmë aq të mirë sa ajo na përfytyronte! Natyrisht, duhet të kihet parasysh se letërsia patjetër i cytë njerëzit të mendojnë rreth asaj që e lexojnë, duke e interpretuar atë sipas nevojave dhe pikëpamjeve të veta. Situatën e tmerrshme që e përjetoi Musine Kokalari, kur gjakftohtësisht iu vranë vëllezërit, akt ky që tregonte se një diktaturë e egër ishte duke ardhur, edhe më i keq se okupacioni italian dhe ai gjerman, ajo kërkonte një antitezë të gjendjes tragjike të vendit të vet. Dhe këtë antitezë ajo e gjen te Selma Lagerlofi, në përshkrimin që kjo u bën banorëve të maleve të Vermlandit. Një shkrimtar tjetër, i cili po ashtu kishte një raport të veçantë me Selma Lagerlofin, ishte Joran Tunstrom, që këtyre ditëve vdiq. Në një intervistë televizive ai pat thënë: “Shumë prej nesh kemi përfytyrime të mira e të ndritshme, që na bëjnë të mbijetojmë luftërat e vështirësitë e tjera. Ato mund të jenë arti, mund të jetë muzika, apo çkadoqoftë tjetër.” Përfytyrimet e mira e të ndritshme të Vermlandit si duket i ndihmuan Musine Kokalari të mbijetojë realitetin tepër të vrazhdë të Shqipërisë.

ZËRA EMIGRANTËSH

Mërgimtarët shqiptarë në Suedi, përpara 1990-tës, ishin krejt të paktë. Një pjesë e refugjatëve politikë dhe punëtorët me punë të përkohshme erdhën nga Shqipëria, respektivisht nga Jugosllavia. Ata që vinin prej Jugosllavisë, shteti suedez filloi vetëm së voni t'i shkruante si shqiptarë – sepse këtu kishim shumë pak njohuri lidhur me relacionet ndëretnike dhe krejtësisht të paktë ishin ata suedezë që dinin për ekzistencën e Kosovës para trazirave të vitit 1981. E përfaqësuesit e Jugosllavisë në Suedi gjithnjë janë shtierë sikur shqiptarët nuk ekzistonin fare në federatën jugosllave.

Përpyekja e parë për të botuar diçka në shqip në Suedi, me sa di unë, u bë nga Ramadan Rexhepi-Osmani më 1975. Revista quhej "Dija" dhe ishte organ i shoqatës "Vllazërimi" në Malmo, shoqatë e themeluar më 1974. Këtë përpjekje e ndërpreu shpejt dhe me efektivitet konsullata jugosllave në Malmo, e cila përmes të infiltruarve të vet bëri që aktivistët shqiptarë të përçaheshin.

Një revistë tjetër, gjatë viteve 1982-1984, u botua nga Kosovë Rexha-Bala, i ardhur në Suedi në vitet e 1960-ta. "Stinët e jetës" kishte për qëllim që shqiptarët me botëkuptime dhe përkatësi të ndryshme t'i bashkonte kudo në botë në diskutimin lidhur me çështjen kulturore. Kjo përpjekje u prit me dyshime dhe kundërvënje nga regjimi shqiptar, i cili nuk dëshironte në asnjë mënyrë një diskutim të përbashkët midis komunistëve dhe jokomunistëve të interesuar për kulturën, prandaj kjo revistë u konsiderua si provokim. Tirana e kritikoi ashpër bashkëpunimin tim me këtë revistë dhe i ngriu relacionet me mua. Kurse për Kosovë Rexha-Balën kjo nuk kishte ndonjë domethënie – sepse ai ka herë e kishte përjetuar këtë gjendje.

Gjatë viteve 1985-1986 në Suedi u botua revista politike "Zëri i Kosovës", e drejtuar nga Xhafer Durmishi, Sabri Novosella dhe Milaim Zeka.

Bashkësia e Shoqatave Shqiptare në Suedi, gjatë viteve 1990-1996 botoi revistën "Qëndresa" me kryeredaktor Ramadan Rexhepi-Osmani, respektivisht Kosovë Rexha-Bala. Në të njëjtën kohë, gjatë viteve 1990-1993, u botua revista kulturore "Dëshira" nga Hajdin Abazi në Malmo. Në këto vite patën vërshuar refugjatët nga Kosova dhe këto revista patën tërhequr vëmendjen.

Gjatë viteve 1992-1995 u botua gazeta mërgimtare "Lajmëtari", e cila ishte vetëm një nga revistat javore për mërgimtarët e ndryshëm në Suedi, e cila botohej me subvencionim shtetëror. Ajo shpërndahej falas nëpër kampet e refugjatëve, prandaj dhe u lexua shumë nga mërgimtarët e sapoardhur. Redaktore ishte Karin Levander e në redaksi ishte edhe Milaim Zeka, më pas Shuqri Sejdiqaj, si dhe Ulmar Kvik. Gazeta i kushtonte shumë rëndësi lajmeve dhe informatave lidhur me shoqërinë suedeze.

Në vitet e 1990-ta LDK-ja e hapi Zyrën Informative të Kosovës në Stokholm, prej nga buletinet në shqip e anglisht shpërndahej në të katër anët. Shef i kësaj Zyre Informative ishte Dr. Shaqir Shaqiri. Mes bashkëpunëtorëve më aktivë duhet përmendur gjithsesi Shqiptar Oseku dhe Reshat Hoxha. Kjo Zyrë pushoi veprimtarinë atëherë kur Kosova u vu nën administrimin e UNMIK-ut.

Në vitin 1994 u përça bashkësia e vjetër shqiptare dhe u krijua Unioni i Shoqatave Shqiptare në Suedi. Gjatë viteve 1994-1998, si organ i Unionit u botua revista "Besa", kryeredaktor i së cilës ishte Ramadan Reshitaj. Si Bashkësia e Shoqatave Shqiptare, ashtu edhe Unioni i Shoqatave Shqiptare në Suedi u ballafaquan me konflikte të gjata të brendshme dhe me probleme ekonomike. Unioni ishte pasiv për disa vite, por ai u ringjall në vitet 2000-2001 dhe filloi sërish të botonte revistën "Besa", tash me Hajdin Abazin kryeredaktor.

Revista "Drita", organ i Shoqatës "Besa" në Treleborg, edhe pse me karakter lokal, kishte përhapje ndërkombëtare. Kjo revistë bashkonte në vetvete një botim të thjeshtë

nga aspekti teknik, me një nivel të lartë debati dhe me kontribut të madh kulturor; kryeredaktori i saj, Shefki Oseku, bëri përpjekje të lakmueshme për të prezentuar letërsinë suedeze për lexuesit shqiptarë dhe letërsinë shqiptare për suedezët. Me entuziazmin e vet gjithnjë të pashuar, Shefki Oseku gjente vazhdimisht bashkëpunëtorë – ndër të tjerët isha edhe unë – për të dhënë kontribute për çdo numër. Po ashtu, revista "Drita" është kujdesur për botimin e një varg veprash të rëndësishme në shqip e në suedisht.

Ndër shqiptarët në Suedi që kanë shkruar letërsi me motive nga Suedia, mund të përmenden Ramadan Rexhepi-Osmani (prozë), Kosovë Rexha-Bala (poezi), Selim Zeneli (poezi), Ramadan Tahiri (prozë), Riza Sheqiri (poezi e prozë) dhe Ymri Dermishaj (poezi). Nuk është fjala për përkthime voluminoze të ambientit; në fakt, motivet e këtyre shkrimtarëve janë me karakter shqiptar.

Së fundi duhet përmendur edhe Programi i Radios Suedeze në shqip "Ditari". Ky program filloi të emetohet në P2 (radioprogrami i dytë suedeze – përkth.) më 1994, prej të hënës deri të premten, me përjashtim të së mërkurës, me nga një çerek ore. Përmes internetit tash mundet ky program të dëgjohet kudo në botë. Producentë të "Ditarit" kanë qenë Milaim Zeka, Shuqri Sejdiqaj dhe Albana (Hyra) Birinxhikaj. Ky program jep lajme nga Suedia, bota dhe, natyrisht, para se gjithash, nga trevat shqiptare.

[Shënim: Programi "Ditari" sot transmetohet me emrin "Jehona" të hënën dhe të martën në orën 14.30-15.00 si dhe në Internet.]

SUNDIMTARI DHE NËNSHTETASIT

Shqiptarët fatkeq janë detyruar të përballen me shumë sprova. Sot është vetëm një numër krejt i vogël i atyre që e mbajnë mend Luftën e Ballkanit dhe dhjetëvjetëshin e parë të Shqipërisë së pavarur. Ajo që i karakterizonte vitet 1912-1925 është krejtësisht negative:

Shteti i ri shqiptar ishte një shtet i vogël i gjymtuar, pa parakushte për jetë të pavarur ekonomike. Më shumë se gjysma e popullit shqiptar kishte mbetur jashtë kufijve shtetëror të Shqipërisë. Një treg normal me baza nacionale ishte i pamundur për Shqipërinë – dhe e tillë vazhdon të jetë gjendja edhe sot. Banorët nga veriu e nga lindja tradicionalisht kanë bërë tregti me Prizrenin, Gjakovën, Tetovën, Gostivarin dhe Shkupin. Të gjitha këto qytete të tregtisë i qenë dhënë Jugosllavisë. Për një kohë të gjatë, kufiri mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë ka qenë krejtësisht i mbyllur; ata që kanë tentuar të kalojnë kufirin janë vrarë nga rojet kufitare ose kanë përfunduar në burg.

Në vitet pas 1912-tës, nëpër trevat shqiptare kanë kaluar armata të ndryshme të huajsh. Mbretëronte anarki e përgjithshme; uria dhe epidemitë shuan shumë jetëra njerëzish. Shqiptarët nuk ia dolën të vendosnin një rend shtetëror stabil, nga se ky shtet u krijua nga kompromisi mes interesave të Fuqive të Mëdha. Kësaj duhet shtuar edhe individualizmin primitiv, mentalitetin klanor në vend të bashkëpunimit nacional, aspiratën për pushtet dhe pronë. Në Shqipëri kishte elemente të mendimit bizantin-oriental, të gërshetuara me idetë perëndimore. Të gjitha këto e bënin shumë të vështirë mundësinë që vendi të funksiononte si një njësi unike dhe pa konflikte. Gjatë shekujve të sundimeve të huaja shqiptarët ishin mbyllur në rrethet familjare e farefisnore. Ligji dhe rendi ishin ligj dhe rend i forcave të huaja. Prandaj për to jo vetëm që nuk kanë ushqyer simpati, po përkundrazi – i kanë bërë shqiptarët që ligjin dhe rendin ta përjetojnë si diçka armiqësore.

Kthesat shoqërore që ndodhën në vitin 1925, kur Ahmet Zogu e mori pushtetin që tre vjet më pas ta shpallte veten Mbret të Shqipërisë, ato në vitin 1945 kur Partia Komuniste në krye me Enver Hoxhën, si një diktator i pacenuar, e mori pushtetin, si dhe ndryshimet e fundit të forcave në pushtet më 1992, kur Shqipëria formalisht pa dritën e demokracisë dhe të pluralizmit, të gjitha këto kanë një gjë të përbashkët. Kthesat kanë qenë në radhë të parë të drejtuara ndaj pushtetit qeveritar e në radhë të dytë ndaj rendit shoqëror që rridhte nga ndryshimi i forcave në pushtet. Ndërrimet e forcave në pushtet asnjëherë nuk janë bërë me mënyra paqësore, si rezultat i zgjedhjeve apo i referendumeve, pasi që demokracia si koncept kurrë nuk është jetësuar në jetën shoqërore shqiptare. Vërtet ndryshimet në vitin 1992 ishin jo të përgjakshme, por kriza e rëndë që kaloi Shqipëria më 1997 për shkak të lojërave piramidale, trazirat në Shqipërinë jugore dhe anarkia e përgjithshme, ishin të lidhura me përmbysjet e vitit 1992.

Për Shqipërinë ka qenë gjithëherë tipike se fuqia politike ka qenë më e madhe se sa pushteti shtetëror. Në epokën socialiste pushteti politik ishte zotërues, kurse pushteti shtetëror nuk kishte kurrfarë fuqie për drejtim. Pas vitit 1992 lufta për fuqi politike e ka shkatërruar shtetin dhe institucionet e saja. Proceset demokratike kanë mbetur në gjysmë të rrugës.

E përbashkëta e të gjithë pushtetmbajtësve në Shqipëri gjatë shekullit të njëzetë ka qenë se ata që e kanë marrë pushtetin nuk kanë pasur për qëllim të drejtojnë me vendin, por të sundojnë popullin. Kjo tregon se përse grupet politike dhe klasat në Shqipëri bëjnë një luftë kaq të ashpër kundër njëri-tjetrit për marrjen e pushtetit. Një gjendje të ngjashme e shohim sot edhe në Kosovë, gjendje në të cilën ndikon pjesërisht mentaliteti që është si pasojë e sundimit 80-vjeçar serb, e pjesërisht nga detyra tepër e rëndë e

ndërtimit të demokracisë së vërtetë, pa pasur bazë në ndërgjegjen e popullit dhe pa përvoja në proceset demokratike.

Shkrimtari dhe ekonomisti Fatos Arapi, në një analizë në tetor 1997, ka shkruar: Politikanët shqiptarë e kanë vetëm një yll orientimi: fuqinë politike. Dhe ky yll i verbon ata. Prandaj ata krijojnë klika dhe klane, me qëllim që ushtrimin e pacenueshëm të pushtetit ta personifikojnë me një Lider, me Njëshin, me Diktatorin. Pikërisht këtu e ka bazën politika e vrazhdë dhe e neveritshme e kultit në Shqipëri, domethënë në mungesën e një politike të ekuilibruar dhe të kultivuar demokratike. Një demokraci ekonomike, si kusht, kërkon një politikë demokratike dhe një pluralizëm politik, një sistem shumëpartiak dhe një parlament pluralist – përfundon ai.

Pa fije dyshimi, e rëndësishme është që bashkësia ndërkombëtare të interesohet për çështjen shqiptare, edhe për shkak se ardhmëria e Evropës varet nga relacionet në Ballkan. Relacionet e ardhme të Shqipërisë dhe Kosovës janë të varura, natyrisht, nga fakti se ç’status do të ketë Kosova në të ardhmen. Sikurse e kam thënë, Shqipëria si shtet nuk është në gjendje të plotësojë nevojat e popullatës me resurset e veta. *Një shtet shqiptar ku do të përfshihej edhe Kosova do të fitonte atë potencial ekonomik që kërkohet për të qenë një shtet i pavarur.* Prandaj, ndihmat e bashkësisë ndërkombëtare duhet të drejtohen sa në konsolidimin e shoqërisë dhe arsimimin e popullit, po aq edhe në ekonomi. Nga ana shqiptare, ka arsye për dyshim sa i përket vullnetit të vendeve të zhvilluara që në mënyrë altruiste të ndikojnë për një zhvillim të mirë të shoqërisë

Njëkohësisht, çështja shqiptare duhet të shihet në kontekstin e Ballkanit. Pjesa dërrmuese e shteteve ballkanike janë të vogla dhe në hapësirat e veta kanë një mozaik minoritetesh. Konfliktet tragjike në ato treva gjatë viteve të 1990-ta, që si gjenezë kanë pasur, në njërën anë, interesat e politikave të Fuqive të Mëdha dhe në anën tjetër nacionalizmin, në kuadër të shteteve ballkanase, si një mjet për qëllime politike dhe ekonomike. Është shumë e vështirë që të ushtrohet farë ndikimi te qarku i së keqes, siç ishin ngjarjet në Ballkan. Ndarja e kufijve nga Fuqitë e Mëdha dhe mungesa e interesimit për të ardhmen e popujve të Ballkanit kanë krijuar rrethana për një nacionalizëm të egër, pasojat e të cilit ne i kemi përjetuar edhe në dhjetvjetëshin e fundit. Dhe, për fat të keq, na duhet të konstatojmë se izolimi politik dhe ekzistencial nuk është e vetmja e keqe e shteteve ballkanase. Këto treva poashtu goditen nga tendenca e Fuqive të Mëdha për t’u kujdesur për interesat e veta tradicionale, si dhe nga përpjekja e tyre për përfitime egoiste.

E vetmja rrugë për të ardhmen e shoqërisë së gadishullit ballkanik është rritja e bashkëpunimit midis shteteve dhe një thyerje graduale e kufijve. Përvojat tona nordike tregojnë se shekujt e sundimit politik dhe të urrejtjes mund të zëvendësohen me mirëkuptim dhe bashkëpunim. Por problemi është jashtëzakonisht i madh, meqë një zgjidhje nënkupton një ndihmë të mirëfilltë prej Evropës për të nisur procesin e demokratizimit. Dhe ky demokratizim ka nevojë të zhvillohet edhe nga poshtë e edhe nga lart: lëvizjet popullore demokratike, jeta demokratike partiake, qeveri demokratike dhe si rezultat edhe zgjerim i bashkëpunimit ndërkufitar. Kjo nuk mund të arrihet as me improvizime, as me komandim. E meqë faktorët relevantë (shtetet, popujt, minoritetet) janë aq të shumtë, vazhdon problemi të jetë i komplikuar dhe i vështirë.

SOVRANI I ERRËSIRËS: ENVER HOXHA

Fati i intelektualëve gjatë sundimit të Enver Hoxhës

Mund të thuhet se Enver Hoxha, me rrethin e vet, lozte lojën “Dhjetë negër të vegjël” (lojë në të cilën, në çdo numërim, mbeten nga një negër më pak). I vetmi dallim ishte se numri i negrëve ishte më shumë se sa dhjetë. Por ata u zhdukën njëri pas tjetrit, ose ndonjëherë nga një grup i tërë njëherësh. Mënyra se si ai manipulonte me njerëzit, të sjellë ndërmend dramën e Shekspirit, në të cilat ndeshen pasionet dhe egërsitë njerëzore. Regjimi i Hoxhës të kujton festën e luanit: shumë gjurmë fërkemash të çojnë brenda e asnjë nuk të nxjerrë jashtë. E gjurmët e atij regjimi janë të tmerrshme...

Pa dyshim, gjëja më e rrezikshme ishte t’i takoje rrethit të tij. Të mbijetoje aty, politikisht e fizikisht, kërkoheshin shumë kualifikime speciale. Që t’ia dilje duhej të ishe servil, dinak dhe një kameleon brilant...

Për të parë se kjo që thashë më sipër nuk është një zmadhim, mjafton t’ia hedhim një sy listës së anëtarëve të Byrosë Politike të Partisë të viteve 1948-1982:

Mehmet Shehu – vetëvrasje (?)
Beqir Balluku – i ekzekutuar
Liri Balishova – e spastruar, por në jetë
Tuk Jakova – i spastruar
Bedri Spahiu – i spastruar
Koço Theodosi – i ekzekutuar
Rrapo Dervishi – i spastruar
Kadri Hazbiu – i ekzekutuar
Petrît Dume – i ekzekutuar
Abdyl Kallëziu – i ekzekutuar
Pirro Dodbiba – i spastruar
Xhafer Spahiu – i spastruar

Ata që u shpëtuan spastrimeve ishin vetë Enver Hoxha, pastaj Hysni Kapo dhe Gogo Nushi, që të dy vdiqën një vdekje natyrale, Spiro Koleka, Rita Marko, Manush Myftiu, Pilo Peristeri, Adil Çarçani, Ramiz Alia, Haki Toska, Pali Miska, Hekuran Isai, Llambi Gegprifti, Qirjako Mihali, Lenka Çuko dhe Simon Stefani. Nga 28 emra, 12 u zhdukën në rrethana pakashumë dramatike, prej spastrimeve, gjoja për shkak të mungesës së kompetencës, transferimeve në detyra më të ulëta e deri te akuzat për tradhëti që rezultuan me ekzekutim. 43 për qind të spastruar, në emër të luftës kundër imperializmit dhe fuqive të tjera të involvuara dhe të luftës së pamëshirë kundër këtyre fuqive, pa fije dyshim thotë shumë sa i përket jetës brenda partisë.

Enver Hoxha është misterioz. Shumë veta kanë dëshmuar për personalitetin e tij sharmant, se kishte një kulturë të shumanshme dhe aftësi politike. Vlerësime më pak pozitive gjenden në rrëfimet e të burgosurve politik. Mjeku Hamdi Oruçi, i cili jetoi në Nju Jork deri sa vdiq këtyre ditëve, në një letër më tregonte se ai e kishte pasur Enver Hoxhën mësues të frëngjishtes në gjimnazin e Tiranës, para se ky të shpërngulej në Liceun e Korçës. Oruçi e konsideronte Hoxhën si një pedagog të dobët me përsëritjet e bezdisshme të shprehjes ”n’est pas?” (apo jo?).

Në përgjithësi, të qenët e Enver Hoxhës për një kohë të gjatë në pushtet (1945-1985) ishte një tragjedi për popullin shqiptar. Mirëpo, sipas të gjitha gjasave, gjendja ishte e tillë në Shqipëri, sa që thujse të gjitha alternativat e tjera të mundshme të pushtetit do të kishin qenë po aq ose edhe më negative. Për shembull, një lloj protektorati nën ”mbrojtjen” e fuqive perëndimore. Ose, përpjekja me demokraci moderne

perëndimore, që do të dështonte për shkak të prapambetjes sociale dhe ekonomike të shoqërisë shqiptare dhe shumë shpejt do të zëvendësohej me një diktaturë ushtarake, me puçe të reja, e kështu me radhë. Thjesht, mundësitë ishin të pavolitshme pas Luftës së Dytë Botërore që shoqëria shqiptare të ishte fatlume.

Përveç kujdesit të vazhdueshëm për mbajtjen e pushtetit, Enver Hoxha kishte një ide pragmatike për ndërtimin e shoqërisë shqiptare nga themelet. Mbase ai do të ketë rezonuar kështu: ky trup i dobët e i sëmurë duhet mbështjellur me fasho. Fasho ai e quante ideologjinë marksiste-leniniste (në versionin e tij të veçantë shqiptar) dhe gjipsi që do ta mbante më këmbë trupin ishte partia, Partia Komuniste e Shqipërisë, e cila më 1948 u pagëzua me emrin Partia e Punës e Shqipërisë. Ky gjips do të duhej ta mbronte prej dëmtimeve që mund të vinin nga jashtë, mirëpo ai erdhi e u bë një koracë e padepërtueshme që individin e mbante të mbyllur.

Enver Hoxha e kishte për zemër ndërtimin e vendit. Shumë nga ajo që është bërë meriton çdo respekt. Përpjekjet për të zhdukur analfabetizmin, si dhe disa sëmundje të rënda të popullit si malaria e tuberkuloza, u kurorëzuan me sukses të madh. Angazhimi dhe vullneti deri në sakrificë i njerëzve u shfrytëzuan deri në kufijtë e skajshëm. Siguria themelore sociale dhe ekonomike u krijua dhe të gjithë të aftëve për punë iu siguroa vendi i punës. U hapën çerdhe, shkolla dhe më 1957 dhe Universiteti. Duke i pasur parasysh rrethanat konkrete të kohës, shqiptarët u arsimuan mjaft mirë.

Me mjete krejt të vogla u krijua një shoqëri, ku rregulli dhe rendi mbretëronin; porse kjo shoqëri kishte mungesa të mëdha. Ajo çka këtë krijesë e bënte një kolos me këmbë argjili ishte pikërisht relacioni i individit me partinë e gjithëfuqishme. Enver Hoxha ka punuar palodhshëm që njerëzit t'i frymëzonte me idetë e partisë si: vullnetin për sakrificë, solidaritetin dhe luftën kundër dukurive negative. Porse plotfuqishmëria e partisë ua kishte bërë të mundur atyre që e ushtronin pushtetin në nivele të ndryshme t'i tradhëtonin këto ideale të larta. Kështu ndodhi që njerëzit, në vend që të lehojeshin që, të frymëzuar nga ato ideale të larta, të pranonin pushtetin, ata, për fat të keq, u shtrënguan t'i nënshtroheshin pushtetit dhe, prandaj, me maje të gjuhës ta pranojnë rrugën e drejtë të partisë. Çdo iniciativë e ndërmarrë individualisht apo privatisht do të hidhej poshtë me ashpërsi, pasi që gjithçka duhej të bëhet "nën drejtimin e partisë". Pikërisht për këtë, është një fakt i lemerishëm ai se shumë nga sukseset ekonomike në epokën e Hoxhës u bënë nga puna e detyruar – ishin të burgosurit dhe të internuarit në llogore të shumta, që i dërrmuan trupat e tyre në të mirë të "ndërtimit socialist".

Dëshira e natyrshme e njerëzve që të kishin diçka të veten luftohej gjithkund në shoqëri. Një prej gabimeve më të mëdha të regjimit ishte ai që në fillim të viteve '80-ta kur i detyroi bujqit e kolektiveve të heqin dorë nga lopa e vetme, që kishin të drejtë ta kishin për përdorim privat. Gjithçka duhej të socializohej. Rezultati i kësaj ishte zemërimi i fshehur i njerëzve, therja në masë e bagëtive dhe pak a shumë një sabotim i maskuar ndaj politikës bujqësore të partisë. Këto akte veprimi, për banorët e qytetit, shkaktuan mungesë të mallrave ditore në një gjendje kur Shqipëria nuk kishte aleatë në botë dhe kriza ekonomike e sociale po trokiste në derë. Në vitet 1991-1992 ra kolosi – mori fund epoka e Partisë, Shqipëria e vobekët ekonomikisht, shoqërisht dhe moralisht ra në duart e një kapitalizmi të shfrenuar dhe të ideve të saj të "shokterapisë".

Mbase Enver Hoxha ka besuar se përmes masave të detyrueshme të kombinuara me bindje dhe ndikime do të mund të ndryshonte mentalitetin e njerëzve dhe të krijonte "njeriun e ri socialist". Në anën tjetër, një sërë veprimesh të tija tregojnë për një qëndrim mizor ndaj njerëzve, si besimi se duhet përdorur detyrimin dhe terrorin për të mposhtur kundërshtimin dhe për të siguruar mbajtjen e pushtetit. Ai ishte shumë i shkathët në përdorimin edhe të kulaqit edhe të kërbacit. Shumë gjëra tregojnë se Enver Hoxha ishte një cinik i vërtetë, i cili donte të drejtonte dhe t'i trajtonte shqiptarët sipas

qejfit të tij. Prandaj dhe personaliteti i tij, si e thashë më parë, është misterioz. Një tiran kujton se tirania e tij është mundësia e vetme për popullin, të cilin ai e shtypë pa mëshirë.

Shenja për mizori ka sa të duash në historinë shqiptare në kohën e Enver Hoxhës. Qysh në luftën partizane është manifestuar dhunë e tmerrshme, por për këtë nuk ishin fajtorë vetëm komunistët. Megjithatë, në pjesën më të madhe, ishin komunistët ata që provokonin ngjarje tragjike përmes sulmeve dhe reprezalieve, që kryesisht godisnin të pafajshmit.

Lufta kundër kishës katolike në Shqipëri mori shprehje të neveritshme. Tashmë është i dokumentuar martirizimi i klerikëve, dhe ka dëshmi për një brutalitet lemeritës të qeverisë. Klerikët katolikë u trajtuan me kaq egërsi të paparë sepse ishin e vetmja shtresë e arsimuar dhe si grup ishin të organizuar mirë, gjë që paraqisnin një rrezik për pushtetin komunist ose të paktën për kompromitimimin e tij.

Enver Hoxha ushtroi dhunë edhe ndaj dy grupeve të tjera: intelektualët në përgjithësi si kundërshtarët e vërtetë ose të trilluar dhe rivalët brenda partisë së tij. Ata që ishin në rethin e tij e kishin jetën në rrezik, sepse nuk ishte e mjaftueshme vetëm të qenët i bindur. Enver Hoxha kishte mësuar shumë nga Stalini, duke përfshirë edhe artin për të sunduar, përmes krijimit të atmosferës së frikës ku gjithçka ishte e mundur...

Për këto relacione do të flas në vazhdim të kapitullit, ku do të paraqes material konkret për atë se ç'ka ndodhur gjatë atyre viteve të rënda. Shumica e këtij materiali është publikuar pas rënies së regjimit, atëherë kur ata që kishin qenë të involvuar mundnin më në fund të flisnin lirshëm. Të kuptohemi, unë nuk do të jap një katalog të plotë mbi viktimat e terrorit, por vetëm do të zgjedhë disa prej rrëfimeve të veçanta që kam mundur t'i sigurojë e që flasin për disa fatkeqësi.

Është një paradoks tragjik fakti se sot shumë veta në Shqipëri kanë nostalgji për atë "rend dhe rregull" që mbretëronte në kohën e Enver Hoxhës. E njëjta gjë ngjanë edhe në ish-Bashkimin Sovjetik: njerëz të zhgënjyer kujtojnë "sigurinë" që kishin në kohën e Stalinit. Është e qartë se kush kishte një "biografi" të pastër, që nuk kishte qenë i rrezikuar e që kishte pasur një punë të mirë dhe që nuk ngarkohej nga një ndërgjegje e ndjeshme, mund të bënte një jetë të pabrengë në kohën e Enver Hoxhës - krahasuar me Shqipërinë e viteve të 1990-ta. Gjatë kësaj periudhe, kur banda të armatosura shkatërronin gjithçka, kur kidnapoheshin vajzat për prostitucion, kur njerëzit humbnin gjithë ç'kishin investuar në lojën piramidale, kur e tërë shoqëria ndodhej në një kaos total, nuk ishte aspak e çuditshme që nga shumë veta të përjetohej sistemi shoqëror i Enver Hoxhës si pozitiv. Se Shqipëria e re e kishte të vështirë të gjente rrugën e vet nuk është për t'u habitur. Do duhet kohë për të ndërtuar një shoqëri të re dhe për të arritur një moral të ri, që do të ruajë të arriturat më të mira të së kaluarës dhe t'i bashkojë këto me parimet e demokracisë. Për fat të keq, shoqëria moderne kapitaliste nuk është një terren i përshtatshëm për zhvillimin e një morali stabil shoqëror. Tregu, kjo fe e re botërore, nuk shquhet gjithaq për konsiderata morale. Pa fije dyshimi se ne do të përjetojmë reaksionin kundër vakuimit moral të kohës sonë. Edhe në Suedi e edhe në Shqipërinë e vogël. Por ajo do të jetë një histori tjetër...

Një dëshmitar shfaqet pas katërdhjetë vjetësh – Ymer Dishnica:

Në një intervistë në organin e Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, në revistën javore "Drita" më 30 qershor 1991, Ymer Dishnica tregon për intelektualët gjatë viteve të luftës dhe të viteve të para pas çlirimit, si dhe për relacionet me Enver Hoxhën dhe me vëllain e fatkeqësisë Sejfulla Malëshova.

Ymer Dishnica ishte moshatar i Shqipërisë së pavarur: ka lindur më 1912 në fshatin Dishnicë të Korçës, rrethi i Shqipërisë së jugut. Ka studiuar në liceun frëng në Korçë

gjatë viteve 1923-1932. I vazhdoi studimet në Lion të Francës në vitet 1933-1941 dhe u arsimua për mjek. Që në vitin 1932 u bë anëtar i grupit komunist të Korçës dhe vitin tjetër edhe anëtar i Partisë Komuniste të Francës. Si në Francë ashtu edhe pas kthimit në Shqipëri, ishte një publicist aktiv. Ymer Dishnica e ka mbrojtur mendimin për një Shqipëri etnike në marrëveshjen e Mukjes më 1943, marrëveshje që u bë midis komunistëve shqiptarë dhe organizatave nacionaliste "Balli Kombëtar" dhe "Legaliteti". Kur Enver Hoxha, në bashkëpunim me këshilltarët e tij jugosllavë e theu këtë marrëveshje, e akuzoi Ymer Dishnicën për tradhëti. Pas kësaj, jeta e Dishnicës u karakterizua nga kundërthëniet ndaj Enver Hoxhës, të cilat e çuan atë në internim dhe shumë vite vuajtje. – Në vazhdim po e japim një pjesë të intervistës me të, shoqëruar me disa sqarime plotësuese:

- Roli i intelektualëve tanë gjatë luftës thuhet se as që është përmendur gjëkund në debatin publik. Ç'keni për të thënë lidhur me këtë?

- Kur Italia fashiste sulmoi Shqipërinë, u prit me dhembje e zemërim nga shumica e intelektualëve shqiptarë, disa madje iu kundërvunë me armë në duar. I tërë populli ishte inatosur. Mujo Ulqinaku me shokë iu kundërvunë ushtarëve fashistë dhe shtatë herë i detyruan ata të ktheheshin në vapore. Shtypi demokratik në Francë shkroi mbi trimërinë e shqiptarëve, kurse një humorist u shpreh kështu: Shqiptarët ishin vetëm 2000 dhe në Durrës e detyruan armikun të tërhiqet në det shtatë herë. Po të kishin qenë 4000 do t'i kishin hedhur në det katërmbëdhjetë herë. Po të kishin qenë 8000, do t'ua kishin bërë këtë 28 herë. E me dhjetë mijë veta shqiptarët do ta kishin dërguar flotën italiane në Honolulu. – Në Paris studentët shqiptarë mbajtën një mbledhje në Quartier Latin, ku morën pjesë 44 studentë sa ishin gjithsej në Francë dhe të gjithë këta, me përjashtim të njërit, vendosën të kthehen në Shqipëri dhe t'i marrin armët.

Nga politikanët që ndodheshin në mërgim ishte vetëm një grup i vogël syresh që bënë kompromis me Italinë. Edhe në Shqipëri intelektualët ishin të gatshëm për rezistencë, një numër fare i vogël mërguan. Vetëm disa servilë i pranuan me kënaqësi të madhe pushtuesit. Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, që filloi më 1942, një numër i madh të rinjsh që studionin jashtë vendit u kthyen dhe me armë në duar morën pjesë në luftë. Pjesa dërrmuese e intelektualëve ishin për rezistencë të armatosur, qoftë përmes veprimit aktiv e qoftë përmes mbështetjes morale.

Rinia studentore ishte shumë aktive në lëvizjen guerile dhe në frontet e mëdha të luftimeve. Ndër më të njohurit në luftë ishin Qemal Stafa, Vojo Kushi, Perlat Rexhepi, Raqi Qirinxhi, Fuat Babani, Ali Demi. (Të gjithë këta kanë rënë në luftë kundër forcave okupuese – sqarim i autorit).

Afise, poezi, gazeta, këngë – të gjitha këto shkruheshin prej intelektualëve që i frymëzonin çlirimtarët në luftën për liri dhe i damkosnin pushtuesit e bashkëpunëtorët e tyre. Ndër vargjet që na kanë frymëzuar ishin edhe ato të shkruara nga poeti Lame Kodra (pseudonim i Sejfulla Malëshovës¹⁷ – sqarim i autorit). Këtë nuk po e them unë tash, e kanë thënë çlirimtarët vetë në atë kohë.

- Ç'mendoni për gjykimin kundër jush?

- Dënimin që e mora në Mukje ishte dënim politik, sot kjo është krejt e qartë. Por dënimi i vërtetë që mora, ishte dënim ndaj meje si intelektual, dhe për këtë dua të rrëfej.

¹⁷ Sqarim: Malëshova (1901-1971) ishte marksist, i arsimuar në Moskë dhe anëtar i Komiteti Qendror të PKSh. Poet me pseudonimin Lame Kodra, ministër i arsimit në qeverinë e parë pas çlirimit. Në verë të 1946 u eliminua politikisht nga Enver Hoxha. U internua në periudha të gjata, dhe sipas një të dhëne jetoi i izoluar nga njerëzit në qytetin Fier, ku askush nuk guxonte të fliste me të hapur. I vetmi kontakt me njerëzit ishte loja e futbollit me fëmijë. Nëse do t'i afrohej ndokush, ai e mbante gishtin para gojës (?) si shenjë për kushtet e mbijetesës së tij. Sejfulla Malëshova vdiq nga inflamacioni i zorrës qorre në vitin 1971. (Fusnotë e autorit)

Mbledhja e shkrimtarëve në gusht-shtator [1949] e tërboi udhëheqjen e agjitpropit të KQ të PKSh e sidomos Enver Hoxhën. Në mbledhjen plenare qenë prezentë më shumë se 30 anëtarë, shkrimtarë e publicistë. Gjatë mbledhjes, ku u kritikua ashpër Sejfulla Malëshova, u dëgjuan kundërshtime të fuqishme nga disidentët e kohës: Sejfullai, Skënder Luarasi dhe prej meje.

Malëshova i hodhi poshtë të gjitha akuzat dhe shpifjet të drejtuara kundër tij dhe i mbrojti shkrimtarët më të njohur si Gjergj Fishta, Fan Noli e Faik Konica. Ai tha se është e paimagjinueshme që këta emra të mëdhenj të letërsisë shqiptare të mos llogariten në të njëjtin nivel si Naim Frashëri e A. Z. Çajupi. Unë, në duet me Sejfullain, thashë fjalë të ngrohta për poezinë e tij dhe se nuk do ta hiqja as dhe një presje prej fjalës sime në parathënien e librit me poezi të tij që u botua disa vite më parë. Skënder Luarasi kritikoi rreptë fjalën e Shefqet Musarajt, si dhe qëndrimin e anëtarëve të kryesisë Dhimitër Shuteriqi e Mark Ndoja¹⁸.

Ia vlen të përmendet diçka nga dy diskutimet e shkurtëra që u mbajtën mes nesh: midis treshit Skënder Luarasi, Sejfullai dhe unë, si dhe midis meje, Sejfullait dhe Mark Ndojës.

Në rastin e parë, u ulëm në një tryezë thuajse të shkatërruar në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe po bisedonim. Skënderi ishte shumë i prekur dhe më tha: A e di ti, Ymer, se si është e mundur që Shefqeti [Musarajn] të përdorë një gjuhë të tillë ndaj Sajfullait? Ç'mjerim! – Sejfullai heshti, kurse unë iu përgjigja sakaq: Skënder, në fakt nuk është për t'u qarë një njeri i cili ka guxim të mjaftueshëm për ta thënë të vërtetën, për t'u qarë është një njeri i cili thotë diçka që as vetë nuk e beson.

Skënderi u përgjegj duke qeshur: Ke plotësisht të drejtë, po godet kokën e gozhdës. – Në fund të mbledhjes, u bëmë vetvetiu një treshe Sejfullai, Mark Ndoja dhe unë. Mark Ndoja e la mbledhjen e erdhi të bisedojë me ne si të donte të na bindte se nuk duhej të tregoheshim aq kryeneq në qëndrimet tona.

¹⁸ Gjergj Fishta (1871-1940), poeti më i njohur e më i çmuar në periudhën e paraluftës, që si nacionalist, prift dhe militant luftoi kundër ekspansionit sllav nuk mund të pranohej nga qarku i Enver Hoxhës. Ai definitivisht nuk ishte "politikisht korrekt".

Fan Noli (1882-1965), njeriu me angazhime të shumta, kryetar qeverie më 1924 dhe i njohur si poet, përkthyes, peshkop, muzikolog dhe shumë e shumë të tjera, por ky nuk u ekskomunikua. U respektua edhe nga komunistët shqiptarë; deri në vdekje jetoi në mërgim, në SHBA.

Faik Konica (1875 – 1942), stilist i shkëlqyer, publicist i radhëve të para, shkrimtar dhe debatues, qe po aq pak "politikisht korrekt" sa edhe Fishta. Gjersa Fishta ishte i rrënjosur fort në ambientet e Shqipërisë veriore, Konica ishte njëkohësisht patriot shqiptar dhe kozmopolit modern. Ai sulmoi skajshmërisht nacionalizmin dhe budallallëkun e përgjithshëm në jetën e shoqërisë shqiptare. Nuk trembej asnjëherë që të therte dema të shenjtë në kuadër të traditës dhe mentalitetit, e në të njëjtën kohë ishte shumë tolerant si publicist. Kontributi i tij më i madh në kulturën shqiptare qe revista "Albania", që pati rëndësi vendimtare për zhvillimin e gjuhës shqipe dhe për debat kulturor në përgjithësi.

Skënder Luarasi (1900-1982), vullnetar në Spanjë në luftën kundër fashizmit, intelektual i njohur e publicist, që mbeti në hije gjatë regjimit të Hoxhës.

Shefqet Musaraj (1914-1986) ishte shtyllë e regjimit. Në fillim, intelektual pesimist i viteve të '30-ta ("si një anije e mbytur në detin e trazuar"), Musaraj korri sukses me vargjet e tija politike "Epojeja e Ballit Kombëtar", ku në mënyrë polemizuese dhe me tendenciozitet të vrazhdë, por me humor të stërholluar, hidhte baltë mbi kundërshtarët kryesorë vendorë të komunistëve. Në përgjithësi, krijimtaria e tij letrare është me rëndësi të vogël.

Dhimitër Shuteriqi (1915-2003) ishte pjesëmarrës i luftës partizane dhe zhvilloi një talent për të eliminuar njerëzit në stilin e Enver Hoxhës. Si kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë në një periudhë të gjatë (1946-1973) i bëri një shërbim prej laroje pushtetit në luftën kundër intelektualëve. Shumë nga të lartpërmendurit kujtojnë me hidhërim kontributin e tij në anën e pushtetit. Anët pozitive të Shuteriqit tregohen në shumë studime të çmueshme historike dhe të historisë së letërsisë, edhe pse qëndrimi i tij ndaj të papërshtatshmeve politikë, e kushtëzuar nga pozicioni i tij, të shtrëngon në një vlerësim kritik të veprimtarisë së tij.

Mbi Mark Ndojën nga qyteti i Durrësit kam fare pak të dhëna. Në fillim ishte pozitiv ndaj regjimit, ra në sy të keq përmes kritikës së politikës së Enver Hoxhës ndaj katolikëve. (E tërë kjo fusnotë është e autorit)

Ai foli fuqishëm dhe mirë për Ndre Mjedën, por nuk pati guximin të thoshte as dhe një fjalë të vetme për patër Gjergj Fishtën, Fan Nolin e Faik Konicën. Ne të dy e dinim se ai kishte një mendim tjetër [nga ai i pushtetit] dhe ne nuk ia përmendëm se kjo ishte një mbledhje ku do të duhej të hapej dera për debat, në vend se të mbyllej ajo.

Pas kësaj, ne mbaruam si shkrimtarë. Penat tona u fishkën. Gjithçka tjetër mund të ketë një farë kuptimi, por përse të na ndalohej e drejta e krijimtarisë? Një intelektual jeton përmes fjalës së lirë.

- Ç'mendoni për fazat e zhvillimit të diktaturës staliniste në Shqipëri, në lidhje me intelektualët?

- Nga fillimi i luftës e deri te mbledhja e Mukjes, Ushtria Nacional-Çlirimtare kishte provuar në mënyrë të gjerë të vënte kontakte me intelektualët. Agjitorët tanë kishin lidhje me shumë intelektualë, edhe në kuadër të Ballit Kombëtar, veçanërisht midis intelektualëve të rinj. Agjitorët e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare mbanin takime ilegale në qytetet e mëdha si Tirana, Durrësi, Elbasani, Shkodra, Korça dhe Berati. Një pjesë e takimeve kishin edhe nga 50-60 pjesëmarrës. Në aso rastesh zhvillohej një debat i lirë. Ky stil i debateve vazhdoi deri te Konferenca e Labinotit në shtator 1943. Më pas, pasi nazistët kishin hyrë në vend dhe lufta ishte bërë edhe më e ashpër, u pakësuan takimet. Në pranverë 1944, bashkë me çlirimin e shumë trevave rritej edhe ndikimi ynë. Fronti Nacional-Çlirimtar filloi të lulëzonte në atë pranverë. Përgatitjet për Kongresin e Përmetit pasqyroheshin edhe ndër intelektualët. Fronti Nacional-Çlirimtar rritej përmes njerëzve të paparti, si dhe përmes të atyre që kishin studjuar në universitetet jashtë vendit: mjekë, mësimdhënës gjimnazi, inxhenerë dh veterinarë. Pas çlirimit, në vend të ngritjes, për intelektualët filloi një rënie duke arritur në fund: mungesa totale e shprehjes dhe e mendimeve të lira.

- A mund të pengohej ajo që ndodhi?

- Gjithë ç'ka ndodhur, ka mundur të mos ndodhë. Pse ndodhi ashtu, nuk domethënë se nuk ka pasur përpjekje të tjera e të cilat kanë dhënë ca rezultate. Marrëveshja e Mukjes ishte një përpjekje për të penguar atë që do të ndodhte më pas. Kjo (marrëveshja e Mukjes) ishte një vepër e intelektualëve shqiptarë, edhe të atyre që ishin aktivë në PKSh e edhe të atyre që ishin anëtarë të organizatës "Balli Kombëtar". Të dyja delegacionet, që përfaqësonin PKSh respektivisht Ballin Kombëtar, arritën mirëkuptim dhe nënshkruan "Marrëveshjen e Mukjes". Aty nuk fitoi as njëra e as pala tjetër, por fitoi Shqipëria. Pastaj erdhi ndërhyrja jugosllave, ndërhyrje në një mënyrë të tillë që vetëm ata dinë ta bëjnë, dhe gjithçka u zhduk – akt ky që kënaqi ekstremistët brenda Ballit dhe PKSh.

Një rast tjetër ku u bënë përpjekje për të penguar atë që ndodhi më pas, qe Konferenca e Beratit. Aty u kërkua një liberalizim brenda partisë dhe frontit nacional-çlirimtar, u dënuan metodat ekstremiste që u përdorën nga Partia dhe Fronti, ndryshime këto që u shprehën përmes faktit se Sejfulla Malëshova hyri në udhëheqje. Kjo kishte rëndësi për organizatat bazë të Partisë e të Frontit në atë kohë. Në Berat nuk u dënua vetëm Liri Gega, por edhe Enver Hoxha. Pas Beratit, Enver Hoxha vetëm de jure ishte anëtar i kryesisë së Partisë; de facto ajo drejtohej nga treshja Sejfulla Malëshova, Koçi Xoxe dhe Nako Spiro. Enver Hoxha nuk e pësoi fatin e Liri Gegës për shkakun e vetëm se qeveria e re e sapozgjedhur, pas një javë qëndrimi në Berat, nuk mund të hynte në Tiranë pa një lider. Ky fakt, që në fillim, u shfrytëzua me shumë shkathtësi nga Enver Hoxha për të shkuar në kundërsulm duke e përfituar Koçi Xoxen dhe pastaj duke sulmuar njëherë Sejfulla Malëshovën e mandej Nako Spiron. E tërë kjo u bë me ndihmën e Partisë Komuniste të Jugosllavisë.

Edhe grupin e deputetëve dhe veprimtarinë e tyre dua ta llogaris si përpjekje për të penguar atë që ndodhi më pas. Se si shkoi puna me këtë grup është gjë e njohur. [Pasi që

kishin apeluar për demokraci perëndimore, një numër deputetësh u nxorën para gjyqit dhe u dënuan me dënime të rënda.- sqarim i autorit].

- Ç'mendoni lidhur me aftësinë e ish-liderit për të qëndruar aq gjatë në pushtet?

- Te ai dominonte pasioni që me çdo kusht të jetë udhëheqës. E kishte kuptuar fare mirë se vetëm stalinizmi i jepte fuqi absolute Sekretarit të Parë të Partisë Komuniste për të drejtuar vendin. Ishte i paskrupull sa i përket goditjes, madje edhe ndaj atyre që sapo i kishte quajtur miq.

Tërë këtë e bëri duke u veshur me xhyben e Marksit, sikurse qe shprehur Sejfulla Malëshova. Për çdo manovër, të vogël a të madhe, i largonte një apo më tepër shokë. Në Labinot, ku u diskutua çështja e Mukjes, më flaku mua; në Berat në nëntor 1944, ku vetë shpëtoi përmes “mea culpa” dhe ndihmës që në mënyrë aq oportune mori nga Sejfulla Malëshova, e hodhi si pa të keq Liri Gegën dhe Ramadan Çitakun. Vetë shpëtoi, e në ndërkohë ushqeui një ndjenjë staliniste të hakmarrjes. Kur po përgatitej plenumi i 7-të i Partisë u erdhi radha atyre që jugosllavët i konsideronin si të pabindur. Në këtë kohë, u ngritën në udhëheqje të PKSh njerëz të tillë si Koçi Xoxe e Pandi Kristo me të tjerë. Enver Hoxha e ndoqi seriozisht “rrugën e vërtetë marksiste-leniniste e staliniste” me dashje a padashje. Si thotë fjala e urtë popullore: I keqi është me fat. Kur shpërtheu zënka me Bashkimin Sovjetik e Jugosllavinë, Enveri ynë i dashur e nxori shpatën dhe tregoi se çka mund të bëjë. Ka shumë për të thënë, se mjeshtria kurrë nuk humbet, dhe mjeshtri Enver tregoi se ishte një prej nxënësve më të zotë të Makiavelit.

- Si e vlerësoni veprimtarinë politike e intelektuale të Enver Hoxhës para luftës?

- Ai nuk është marrë me ndonjë veprimtari politike, e as me veprimtari intelektuale. Enver Hoxha nuk ishte as anëtar i Grupit Komunist të Korçës, madje as anëtar i Partisë Komuniste të Francës.

Për hir të së vërtetës, duhet thënë se ai i pati filluar studimet universitare në biologji në Francë, por nuk e mbaroi dot as vitin e parë të studimeve. Poashtu mund të themi se ai ishte anëtar i shoqatës së arsimtarëve që drejtohej nga disa komunistë të Grupit të Korçës. Nuk u përjashtua, por u udhëzua të jepte mësim vetëm në ciklin e ulët të liceut të Korçës.

- Ç'njohuri kishte ai nga filozofia asokohe?

- Nuk kishte kurrfarë njohurish për teoritë e Marksit e të Leninit.

- Kur u njohët me Sejfulla Malëshovën dhe a mund të thuash diçka më konkretisht për të?

- Sajfulla Malëshovën e kam njohur para se ta takoja. Dy nga miqtë e mi më të mirë, Esat Dishnica e Ali Kelmendi, më kanë folur shumë për të gjatë viteve 1930-1935. Esati e njihnte dhe ishin bërë shokë, qysh kur kishin qenë studentë në Romë bashkë me Avni Rrustemin. Ishte koha kur fashizmi erdhi në pushtet. Si shokë të ngushtë dhe ithtarë të flaktë të Fan Nolit, ata morën pjesë shpesh në përplasjet me fashistët, bashkë me antifashistët italianë. Nga të tretë shquhej Sejfullai për dituritë dhe kulturën e tij të lartë. U shqua edhe për interesimin e tij për letërsi. Kishte pasur kontakte me personalitete të shquara të letrave shqipe si me Fan Nolin dhe Konicën. I vlerësonte dhe i admironte shumë të dy këta si mjeshtrë të stilit, por e kishte më për zemër Fan Nolin, për të cilin kishte vetëm mendime të mira. Kur Sejfullai u emërua nga Fan Noli kryesekretar i zyrës së kryeminsitrit në Tiranë, atyre që e pyesnin të emën se ç'bënte Sejfullai, ajo e kishte për zakon t'u përgjigjej: - Një djalë e kisha, dhe atë ma mori Fan Noli; nuk prish punë, vetëm le të jetë mirë e shëndosh.

Në Tiranë Sejfullai u mor më tepër me krijimtari artistike se sa me punët e zyrës. Në atë punë ai nuk u shqua, por interesi vendos, sidomos kur ai është vërtet i fortë. Shkroi në gazetën “Xhoka” dhe “Arsimtari”.

(...)

Sejfullai parapëlqente fraza të thjeshta, që kuptoheshin lehtë, dhe ironizonte shpesh me ata që shkruanin në mënyrë të koklavitur. Kështu, fjala vjen, kur tallej me botuesin e gazetës “Arsimi” dhe me mënyrën e të shkruarit të tij, ia citonte prozën kaotike të botuesit.

(...)

Lidhur me tekstet dhe vargjet e tij kisha dëgjuar më parë përmes Ali Kelmendit, kur ky na i dha disa ekzemplarë të letërsisë së mirë, mund të lexoheshin poezitë e Nolit e të Sejfullait. Me vargje të tilla dhe me fjalë të ngrohta na i pushtonte zemrat Ali Kelmendi, dhe ai ishte një nga ata komunist dhe revolucionar i cili çlirim i Kosovës e kishte për zemër. E përmendte me simpati të madhe një demokrat kroat, deputet, i cili, kur qe diskutuar Kosova në parlamentin e Beogradit, kishte vënë mbi kokë plisin e bardhë shqiptar nga Kosova... E kur Asim Vokshi nga Kosova kishte rënë në Spanjë, Ali Kelmendi qau me lot gjaku.

*Familja Qiriazi – pioniere e arsimimit të popullit shqiptar
dhe fati i saj gjatë regjimit komunist*

Vëllezërit dhe motrat Qiriazi janë figura të spikatura në kulturën shqiptare dhe në historinë e arsimit, veçanërisht sa i përket hapjes së shkollave dhe botimit të librave. Vëllezërit Gjerasim (1858-1894) dhe Gjergj (1866-1912) botuan libra shkollorë dhe tekste për mësim, si dhe themeluan dhe udhëhoqën shkollën e parë të vajzave në Korçë, qytetin më të madh në juglindje të Shqipërisë. Motra e tyre Sevasti (1871-1949) dhe Parashqevi (1880-1970) ishin mësueset e para në shkollën e vajzave në Korçë që nga hapja më 1891, të cilat vazhdonin më pas me veprimtarinë e tyre për arsimimin e popullit duke organizuar kurse të mbrëmjes dhe “universitete popullore”. Më vonë, ato do të merren me veprimtari shkollore edhe në Tiranë.

Familja vinte nga Kolonja, nga pjesa më jugore e Shqipërisë, mirëpo babai Dhimitri qe shpërngulur në Manastir (Maqedoni) e ku merrej me tregtinë e prodhimeve prej druri. Savestia shkoi së pari në shkollën greke në Manastir (drejtori i të cilës ishte nga një fshat i banuar me shqiptarë afër Athinës) e më pas vazhdoi në një kolegji amerikan në Stamboll. Personaliteti i saj i jashtëzakonshëm pasqyrohet edhe në këtë ngjarje: Kur Sevastia e mori vesh se patrioti dhe mësuesi shqiptar Koto Haxhi ishte në burgun e Stambollit, ajo e shfrytëzoi miqësinë e saj me vajzën e drejtorit të burgut dhe studentja e re ia arriti që e veshur si burrë të futej brenda në burg dhe ta vizitonte Haxhin, i cili, natyrisht, sa u befusua po aq edhe u gëzua. (Ai ishte mik i familjes Qiriazi).

Sevasti dhe Parashqevi Qiriazi botuan së bashku revistën “Ylli i mëngjesit”. Sevastia shkroi edhe një gramatikë elementare për shkollën popullore dhe një libër leximi.

Parashqevia studjoi në Women’s college në Stamboll deri në vitin 1904; në të njëjtin vit u kthye në atdhe dhe filloi të punonte në shkollën e vajzave në Korçë. Ajo ishte edhe delegate në Kongresin e Manastirit më 1908, ku u vendos çështja e alfabetit të gjuhës shqipe, dhe më 1919 mori pjesë në Konferencën e Paqes në Paris.

Më pas familja Qiriazi hapi Institutin Qiriazi, një shkollë për vajza të moshave të ndryshme. Pas shtetëzimit të atyre objekteve, ato përbënin një pjesë të Universitetit të Bujqësisë.

Tash po e bëjmë një kërcim të madh përpara në histori dhe fjalën po ia japim Viktoria Ruli-Dakos, vajza e djalit të Sevasti Qiriazi-Dakos. Ajo ka rrëfyer për jetën e familjes në kujtimet e veta të titulluara “Familjet Qiriazi dhe Dako gjatë ditëve të regjimit komunist” në gazetën shqiptaro-amerikane “Illyria” më 27 nëntor 1999:

“Isha ende shumë e vogël, vetëm 5-6 vjeçe, kur fillova të kuptoj se familja jonë trajtohej më ndryshe se familjet e tjera. Ky trajtim niste që me qëndrimin e mësuesve

ndaj meje. Kisha shumë dëshirë të pikturoja dhe të shkruaja, por asnjëherë nuk më nxorën ndonjë shkrim a vizatim në “Gazetën e murit” të klasës, siç ndodhte me nxënësit e tjerë. Më vonë fillova të kuptoj arsyen e vërtetë, të ndërgjegjësohem për të dhe të diskutoj me nënën dhe teto Parashqevinë (Qiriaz), e cila jetoj me ne, deri në fund të jetës së saj, dhe së cilës i detyrohem për tërë edukimin tim moral dhe parimet e drejtësisë dhe të demokracisë së vërtetë. Gjithashtu, për sa kohë rrojti me ne, gjyshja Sevasti (ajo vdiq më 1949, kur unë isha 8 vjeç), na mblidhte rreth vatrës të katërt: mua, vëllanë, motrën dhe djalin e xhaxhait tonë dhe na lexonte e përkthente libra si “David Koperfildi”, “Oliver Tuisti”, na tregonte përralla etj. Ne e dëgjonim gojëhapur, sidomos, kur ajo tregonte ngjarje nga jeta e saj, kur fliste për punët e saj, për hapjen e shkollës, për ndjekjet e Hyqymetit Turk dhe të Mitropolisë Greke, udhëtimet për në Amerikë, etj.

Më 15 tetor 1943, gjithë familja jonë, Sevastia, Parashqevia, babai, xhaxhai me nënën dhe tezen time, kuzhinierja e shkollës, që kish vazhduar të jetojë me ne, unë, dy vjeç e gjysmë, u internuam në Banjicë, në afërsi të Beogradit, Jugosllavi, nga gjermanët. (Arsyen e këtij internimi, meqë ajo është shumë e gjatë për t’u shpjeguar këtu, do ta tregoj një herë tjetër). Aty qëndruam për 11 muaj. Në qershor të vitit 1944, aty lindi vëllau im, Roberti.

Mbas bombardimit të kampit nga ana e aleatëve, ne mundëm të kthehemi në Shqipëri, në Kamëz, në Institutin Qiriaz. Shtëpitë tona i gjetëm të grabitura, por më keq na erdhi për bibliotekën shumë të pasur, me rreth 300.000 vëllime, që ishte dëmtuar. Ndërkohë banuam aty deri kah mesi i vitit 1946, kur na dëbuan nga shtëpitë, duke sekuestruar çdo gjë që kishim, dhe pa na dhënë asnjë lloj strehimi. Sevastia dhe Parashqevia ndenjën nja dy muaj, duke sistemuar kotecin e pulave si dhomë. Po në këtë kohë prishën edhe kishën tonë familjare, ku ishte varrosur gjyshi, patrioti Kristo Dako, të cilin e nxorën nga varri dhe me kafkën e tij, të mbështjellë me lecka, luanin top. Kishte njerëz që këtë fakt e tregonin me mburrje. Edhe sot e kësaj dite, ne nuk e dimë ku prehen eshtrat e tij. Përfundimisht, ne u strehuam në shtëpinë e ish-kuzhinieres së Institutit Qiriaz, Rukie Tafait, në një shtëpi përdhese, pa dysheme e pa tavan, në Tiranë.

Në fund të vitit 1946, mbasi i kishin thirrur disa herë natën në hetuesi babanë e xhaxhanë, një ditë i mbajtën dhe na lajmëruan se ishin burgosur për arsye politike. Ishte koha kur kudo në Shqipëri, Sigurimi krijonte “grupe armiqësore”. U munduan t’i fusnin edhe babanë e xhaxhanë në grupe të tilla, mirëpo ata nuk i njihin kush, sepse kishin jetuar jashtë shtetit dhe, në vitet 1944-1946, kishin jetuar në Kamëz dhe nuk ishin marrë me politikë. Përpara se të burgosej babai im, Aleksandër Dako, i biri i Kristo Dakos dhe i Sevastisë, që caktuar, me urdhër të Mehmet Shehut, të punonte pranë UNRRA-s, për ndihmat që vinin, sepse dinte anglisht. Babai kishte bërë studimet në Robert College, Stamboll, dhe më vonë në Itali, për ekonomi e inxhinieri; ndërsa xhaxhai, Gjerjgi Dako, po ashtu, kishte studiuar në Robert College duke përfunduar studimet si mjek kirurg, në Itali.

Për tre vjet rresht, ne nuk morëm vesh asgjë për fatin e tyre. Nëna ime, Rozi, dhe motra e saj, Maria, të dyja italiane, që ishin martuar me dy vëllezërit Dako, kaluan në këtë periudhë vuajtje të tmerrshme. Nëna, që kishte mbaruar studimet për ekonomi financiare bankare, punoi në një zdrukthëtar, duke sharruar, ngarkuar e shkarkuar dërrasa, për një copë bukë, ndërsa tezja, shëndetligë, qepte në shtëpi për të siguruar triskat e bukës. Çdo dy javë na vinin në shtëpi dhe na thonin të bënim gati plaçkat, se do të na dëbonin nga Tirana.

Pas tre vjet torturash në burgun e Tiranës, xhaxhai im Gjergji Dako, i biri i Sevastisë, kirurgu duarartë vari veten në burg. Në fillim ne nuk e besuam këtë gjë dhe menduam se e kishin vrarë; por disa muaj më vonë, na erdhi në shtëpi, pasi ishte liruar nga burgu, dr. Isuf Hysenbegasi dhe na tregoi se si një natë e kishin zgjuar nga gjumi dhe i kishin

thënë se dikush kishte varur veten në birucë. “Kur e pashë Gjergjin – tha ai, (kishin qenë bashkë për studime në Itali dhe ishin shokë), - zemra më rrahu fort. E shtriva dhe fillova t’i bëj frymëmarrje artificiale. Për një moment, rrahjet e zemrës sime m’u dukën si të tijat, por çdo gjë që e kotë, mbasi ai kishte vdekur”. Lajmi i vdekjes së tij që një goditje shumë e rëndë për familjen tonë. Sevastia vajti në burg për të kërkuar trupin e tij, por nuk ia dhanë. Më vonë, sipas tregimeve të disa personave dashamirës, ajo me të shoqen e Gjergjit, duke gërmuar me thonj në buzë të lumit mundën të zbulojnë trupin e tij dhe, me qenë se po gdhinte, iu desh ta linin për mbrëmje, por për fat të keq gjatë ditës traktori kishte punuar tokën, kështu që nuk e gjetën dot trupin e tij.

Sevastia për muaj të tërë nuk gjeti qetësi dhe nuk pushoi së vajturi në dyert e zyrave të burgut e deri në Komitetin Qendror, që t’i jepnin trupin e të birit, por asnjë nuk i dha as edhe një shpresë, derisa ajo, pas tre muajsh vdiq e helmuar, e dëshpruar e zemërplatur që nuk e pa dhe nuk arriti ta varrosë me duart e saj djalin e dashur 34-vjeçar.

Varrimi i Sevastisë është i papërshkrueshëm me fjalë. Kjo grua heroinë që gjithë jetën punoi për Shqipërinë dhe që vinte Atdheun mbi familjen, u dërgua në varreza mbi një karrocë, e përcjellë nga motra e saj, Parashqevia, nga dy nusët e djemve, nga kuzhinierja besnike, Rukie Tafaj, dhe nga unë, atëherë 8 vjeçe.

Mbas disa muajve, në një mëngjes, pa prituri u shpërthye dera e oborrit dhe hynë forca policore me armë në duar dhe kontrolluan gjithë shtëpinë. Të gjithë u frikësuan. Në fund u larguan, duke shkukur nga muret fotografitë e babait. Kuptuam se diçka kishte ndodhur me të. Më vonë morëm vesh se ai ishte arratisur nga spitali, ku ishte shtruar dhe operuar, mbasi ishte paralizuar nga torturat. Kur iku nga spitali, kërkoi ndihmë tek një familje e njohur, ku i dhanë një palë nallane dhe një ferexhe. I veshur si grua, u mundua të largohej. E kërkuan tri ditë e tri netë, por nuk e gjetën. Së fundi, ai u dorëzua vetë, mbasi gjendja e tij shëndetësore ishte keqësuar shumë dhe nuk mund të ecte më.

Mbas kësaj ngjarjeje, babanë e nxorën në gjyq, mbas tre vjetëve regjim biruce dhe torturash të tmerrshme. Donin ta detyronin të firmoste që ishte spiun i angloamerikanëve, por ai i duroi të gjitha torturat dhe nuk e pranoi një gjë të tillë. Dhe kjo, ndoshta i shpëtoi jetën. Në gjyq, të dy dëshmitarët kërkuan falje dhe pohuan se i kishin detyruar të akuzonin babanë, të cilin ata nuk e njihnin fare. Atë ditë, gjyqi u pezullua dhe u hap pas tre ditëve me dëshmitarë të tjerë të rremë. Kështu babanë e dënuan me 7 vjet burg, si “armik i popullit” dhe spiun i UNRRA-s.

Nuk mund të mos përmend një ngjarje të kësaj kohe, kur babai ishte në spital dhe ne nuk e dinim. Një ditë, në orën 4 të mëngjesit ra dera. Doli teto Parashqevia për të pyetur se kush ishte. Një zë burri u përgjegj t’i hapnin derën se kishte për të treguar një gjë me rëndësi. Pas një ngurrimi, ajo e hapi derën. “Unë jam një polic burgu. Aleksandri është në spital dhe më vjen shumë keq, kur shoh të shoqen që sjell përditë në burg, ushqim e cigare, që përfundojnë në duar të policëve, sepse e di se me sa sakrifica i nxjerrë ajo; por, në asnjë mënyrë mos i ndërprisni menjëherë, por dalëngadalë. Ju lutem- vazhdoi ai – mos i thoni njeriut, se do të më merrni në qafë”.

Kështu, midis ujqërve, kishte edhe njerëz me karakter dhe me ndjenja njerëzore.

Ndërkohë, unë mbarova shkollën 7-vjeçare dhe konkurova në Liceun Artistik për pikturë, por megjithëse fitova, më thanë se unë nuk isha e denjë të përfaqësoja artin e realizmit socialist, mbasi do të sillja në artin shqiptar ndikimin e artit dekadent borgjez italian. Për të mos mbetur pa shkollë, u regjistrova në Politeknikumin 7 Nëntori, në degën elektrike.

Patëm një fat të madh kur mbaruam shkollën e mesme, unë e motra ime, Diana. Ministre e Arsimit, në atë kohë, ishte Qibrie Ciu, një nga ish-nxënëset e Institutit Qiriaz,

e cila vinte e vizitonte teto Parashqevinë vazhdimisht, me një respekt të veçantë. Ajo na ndihmoi shumë duke na dhënë të drejtën e studimit, mua për inxhinieri elektrike dhe motrës për gjuhën angleze. Dianën e sulmuan shumë herë në fakultet, duke i vënë fletërrufe, mbasi ajo e kishte babanë në burg nuk mund të ishte në atë fakultet, sepse fakulteti që i rezervuar vetëm për fëmijët e të mëdhenjve. Falë kurajos dhe ndihmës së madhe të prof. Skënder Luarasit, birit të Petro Nini Luarasit, motra ime mundi të mbarojë fakultetin dhe të punojë si mësuese e gjuhës angleze.

Mbas daljes nga burgu, babai punoi si inxhinier në uzinën “Dinamo”, të cilën ai kishte filluar ta ngrinte që nga themeli që kur ishte i burgosur. E mbajtën në punë sepse ishte shumë i aftë dhe iu nevojitej. Në vitin 1960, teto Parashqevi i bëri një letër Vito Kapos, duke i thënë se po jetonte në kushte banimi shumë të vështira dhe se ishte e sëmurë. Për çudi, dërguan një komision për verifikim dhe na dhanë një apartament, ku kushtet e banimit ishin më normale.

Në një nga këto ditë, na erdhi në shtëpi prof. Skënder Luarasi dhe na tha se ishte ngarkuar të shkruante për jetën dhe veprimtarinë e familjes Qiriazit dhe këto ditë do të vinte edhe piktori Maksi Velo, i cili, sipas tregimeve të Parashqevisë, do të pikturonte shtëpinë e Qiriazëve në Manastir, ku bëheshin mbledhjet e komisionit të alfabetit, mbasi mungonte një fotografi origjinale.

Kur teto Parashqevi e pyeti prof. Skënderin se si ishte e mundur një gjë e tillë, ai u përgjigj se me sa kishte kuptuar ai, Republika Jugosllave e Maqedonisë, në vijim të propagandës së saj se Shqipëria ishte shtet i krijuar vonë dhe nuk kishte tradita, histori, njerëz të ditur e të mëdhenj, etj., pretendonte se Qiriazët ishin maqedonas dhe prandaj i kishin vënë emrat e tyre rrugëve dhe shkollave. Kështu, në fakt, kjo nuk po bëhej për të nxjerrë në dukje me sinqeritet punën e madhe patriotike të kësaj familjeje në shërbim të kombit, por vetëm si nevojë imediate e situatës politike të krijuar.

Në festimin e 60-vjetorit të Kongresit të Manastirit, mua m’u dha rasti të shoqëroja teto Parashqevinë, që ishte e vetmja delegate e gjallë e këtij kongresi dhe kishte shkruar e komponuar Himnin e Alfabetit. Në të gjitha kumtesat që u mbajtën me këtë rast, nuk u përmendën fare emrat e Mid’hat Frashërit dhe të At Gjergj Fishtës. Edhe teto Parashqevinë e kishin porositur të mos i zinte me gojë. E vetmja gjë që më emocionoi dhe e elektrizoi sallën që kur teto Parashqevia, 88-vjeçare, këndoi Himnin e Alfabetit. E gjithë salla u ngrit në këmbë dhe, për çudinë time, pashë që përveç meje që më rridhnin lotët nga emocioni, pothuajse të gjithë i kishin mbushur sytë me lotë. Në ato momente ndjeva krenarinë legjitime që i përkisja një familjeje që i kishte sjellë aq e aq shërbime çështjes kombëtare.

(...)

Teto Parashqevia vdiq në vitin 1970 në moshën 93-vjeçare, me mendje të kthjellët deri në minutën e fundit. Të paktën, asaj iu bë një varrim i nderuar, ku morën pjesë ministrja e Arsimit, Vito Kapo, dhe shumë ish-nxënëse të Institutit Qiriaz. Në këtë kohë, gjithë familja Qiriaz që dekoruar me disa medalje e urdhra. Pas vdekjes, Sevastia dhe Parashqevia u nderuan me titullin “Mësuese të Popullit”.

Vitet kalonin dhe ne gjithnjë e më tepër e ndjenim peshën e asaj që quhej “familje borgjeze e intelektuale e deklasuar”. Në atë kohë filloi të ashpërsohej shumë lufta e klasave, një nga turpet më të mëdha të regjimit komunist. Në vitin 1965, u martova me mjekun radiolog, Viktor Ruli. Rrethi i tij familjar ishte komunist, por ai vetë kishte qenë e ishte gjithnjë një disident i vendosur. Në vitin 1966, Enver Hoxha mbajti një nga fjalimet e tij “historike” mbi nevojën e qarkullimit të kuadrit. Kjo ishte një nga metodat komuniste të terrorizimit të popullit dhe të mbajtjes së tij nën presion psikologjik. Im shoq, duke pirë kafe në barin e spitalit, pat treguar një batutë në të cilën, për fat të keq, krejt padashje, ishin përmendur dy mbiemrat Hoxha dhe Shehu, si më përfaqësuesit në

Shqipëri. Kjo mjaftoi që ta transferonin në Tepelenë, duke ia bërë të qartë se transferimi ishte rrjedhim i lidhjes që kishte bërë me familjen tonë të dekluar.

Ne jetuam në Tepelenë për 20 vjet në një terror psikologjik të papërshtatshëm, duke na vënë gjithnjë në dukje se kishim ardhur aty si të dënuar. Megjithatë, ne e ndjenim se njerëzit e thjeshtë na donin dhe na respektonin për punën tonë. U dëshpëruam shumë, kur vajzës sonë Juljana, (sot e martuar për Zef Mosin, nipin e Hilë Mosit), që e mbaroi gjimnazin me të gjitha dhjetat, nuk i dhanë as fletëlavdërimi e as bursa për vazhdimin e studimeve. I bëra një letër kryetarit të Komitetit Ekzekutiv, duke i shpjeguar prejardhjen e familjes, por ai ma preu shkurt: “Babai yt ka qenë në burg si armik i popullit; unë këtu kam 15 bursa që do t’ia kthej Ministrisë, por vajzës tënde nuk ia jap”. Për një vit të tërë luftova me letra e vajtje poshtë e lart në Tiranë, derisa pas një viti, si rrjedhim edhe i njëfarë “zbutjeje” të luftës së klasave, dhe si mbesa e Sevastisë munda që vajza ime të shkante në universitet.

Në vitin 1986, mbasi im shoq doli në pension, vendosëm të largohemi nga Tepelena. Teto Parashqevia më kishte lënë shtëpinë e saj, që ia kish dhuruar i nipi, Vangjel Qiriazi, që banonte prej vitesh në Amerikë. Veç kësaj, babai im plak, porsa ishte kthyer nga internimi dy-vjeçar në Lezhë, ku e kishin çuar, sepse dikush e kishte spiunuar, pasi kishte folë kundër regjimit dhe banonte vetëm.

Për 15 vjet, babai im bëri një punë të çmueshme, duke grumbulluar të gjitha dokumentet e familjes sonë nga Arkivi i Shtetit dhe duke i përkthyer nga origjinali. Ai vdiq në vitin 1994. Mbi varrin e tij vumë edhe emrat Kristo e Gjergji Dako. Vumë vetëm emrat, se eshtrat e tyre nuk dihet edhe sot se ku janë.

Për t’u shënuar këtu është se madje edhe sot e kësaj dite në Shqipëri, nuk ekziston asnjë shkollë, rrugë a shesh me emrat e tyre”.

Këtu po e ndërpres përshkrimin e Viktoria Ruli-Dakos. E marr me mend se edhe lexuesi është prekur thellë, ashtu sikurse edhe unë, kur e kupton se si u trajtuan njerëzit e përkushtuar, që kanë bërë aq shumë për kulturën e vendit të vet, vetëm pse me ndërgegjeje ishin distancuar nga komunizmi. Pa fije dyshimi se regjimi, i cili thuaja për gjysmë shekulli sundoi në Shqipëri, i kishte lënë hapësirë ligësisë. Njerëzit e ndershëm, që ishin në mesin e komunistëve, për fat të keq kishin mundësi tepër të vogla për të penguar mizorinë që bëhej në emër të luftës së klasave në një vend ku Partia dhe Sigurimi ishin të pacenueshëm dhe nuk guxohej të kritikoheshin – pavarësisht se ç’ndodhte. Mund të jetë që shtypje të ngjashme janë bërë edhe në kohën e Dhjatës së Vjetër dhe thuaja përgjatë tërë mesjetës, por që në shekullin e njëzetë, të pretendosh se qenke me botëkuptim progresiv e madje edhe humanist, dhe të bësh nëpërkëmbje të tilla brutale, - ky është kulmi i kalbjes dhe i gënjeshtërisë. Nuk mund të thuhet se kjo sjellje ishte e paparamenduar.

Dramaturgu që u la në harresë: Minush Jero në konflikt me Enver Hoxhën

Ishte viti 1969. Shqipëria po përjetonte pasojat e ndikimit të revolucionit kulturor kinez në shoqërinë shqiptare. Atë që kishte ngjarë në Kinë, regjimi shqiptar e kishte marrë si pretekst për t’i ndjekur edhe nga ”vrimat e fundit kundërshtarët” e mbetur në vendin që drejtohej nga Partia e plotfuqishme. Kishës i ishin dhënë goditjet e fundit shkatërruese, ishte bërë një ndryshim strukturor në shkollë dhe propagandohej për emancipimin e gruas dhe luftën kundër traditave të vjetra. Kjo ngjau, kryesisht, në vitet 1967-1968.

Në vitin 1969 dramaturgu Minush Jero (i lindur më 1932) arriti sukses të madh me dramën ”Njollat e murrme”. Vetë kryeministri Mehmet Shehu dhe sekretari i PPSH-së e më pas udhëheqës i partisë Ramiz Alia kanë marrë pjesë në një shfaqje dhe e kanë

shprehur pëlqimin e tyre. Por kjo nuk ndihmoi: Enver Hoxha, pasi e kishte parë shfaqjen, nuk e kishte miratuar. Katër vjet më pas u arrestua Minush Jero dhe u detyrua t'i kalonte pesë vjet në burg.

Si ndodhi kjo? Përse një trajtim i tillë? Problemi ishte se në subjektin e dramës Minush Jero i qe përmbajtur të vërtetës. Në një intervistë në revistën "Drita" në verën e vitit 1991 Jero tregon se kishte shumë domethënie se ai si mësues në vitet e '60-ta erdhi në kontakt me shoqërinë e re klasore shqiptare.

Gjatë praktikës në një shkollë në Tiranë, ku mësonin një pjesë e madhe e fëmijëve të udhëheqësve partiakë, Minush Jero vërejti se këta fëmijë të elitës, me ndonjë përjashtim, ishin arrogantë, me veshje ekstravagante dhe të pasjellshëm ndaj mësuesve. Ata kishin një status si të privilegjuarit ndër nxënësit e shkollës.

Vitin tjetër, Jero, tashmë me shkollë të kryer për mësues, përfundoi në qytetin e lindjes Vlorë. Aty nxënësit ishin të varfër dhe të veshur thjeshtë (për shembull, nuk kishin kapota dimrit), por ata ishin të sjellshëm, të dashur dhe të vëmendshëm ndaj mësuesve. Kurse mësuesit e shkollës ishin shumë të interesuar për problemet sociale dhe i diskutonin ato mes vete në mënyrë të gjallë. Kjo pati rëndësi të madhe për qëndrimin e Minush Jeros ndaj shoqërisë. Ai mësoi të shihte se çka fshihej mbrapa asaj që vetëm dukej se ishte, të shprehem me fjalë të E. G. Gejerit.

Kishte kundërthënie të mëdha në mes të parullave të udhëheqësve për vetëflijm dhe mënyrës asketike të jetesës nga njëra anë dhe stilit të tyre të jetesës, që ishte diçka në mes të princërve mesjetarë dhe evropërendimorëve. Shoqëria "socialiste" i kishte dy fytyra dhe ajo karakterizohej nga hipokrizia.

Suksesi i dramës "Njollat e murrme", e cila i trajtonte pikërisht anët negative të shoqërisë, ishte një fitore e Pirros. Edhe Jero e edhe regjisori Mihallaq Luarasi, disa vite më pas, do të bien që të dy në burg. Edhe pse me vonesë, Enveri u hakmuar.

Çështja është nëse dënimi i Jeros dhe e dramës së tij kishin për qëllim të ngulfatnin krijimtarinë artistike dhe artin jokonformist në përgjithësi. Lidhur me këtë Jero shprehet në intervistë:

- Së pari, drama kurrë s'mund të lulëzojë në një shtet totalitar. Një dramë e vërtetë kurrë s'mund të përputhet me shijen e diktatorit. Për shembull, shih Bashkimin Sovjetik: në kohën e Stalinit në asnjë skenë të vendit nuk është shfaqur asnjë dramë e Majakovskit. Po kjo gjë vlente edhe për Pirandellon në relacion ndaj Musolinit, e në Gjermaninë e Hitlerit u detyrua Brehti me të tjerë të mërgojnë. Prandaj është krejt e sigurt se Hoxha donte të merrte masa energjike ndaj teatrit në përgjithësi, e në të njëjtën kohë t'i tregonte me gisht Shehut, se vlerësimi i tij nuk kishte ndonjë peshë krahasuar me atë të udhëheqësit. E ajo që ndodhi katër vjet më pas ishte një inskenim, ku regjisori Enver Hoxha krijoi teatrin e tij me trillimin se udhëheqësit politikë si Todi Lubonja e Fadil Paçrami në njërin anë dhe njerëzit si Jero e Luarasi, në kulturë në anën tjetër ishin pjesë e një "komploti liberal" kundër tij. (Paçrami e kishte nga një këmbë në të dyja fushat: ai ishte edhe politikan edhe dramaturg). Disa vite më pas Hoxha do të "zbulonte" komplete edhe në ekonomi e në ushtri, me ç'rast i eliminoi një pjesë të madhe të udhëheqësve të të dyja fushave.

Në pyetjen e intervistuesit nëse veprat e kritikuara asokohe ishin shprehje e disidencës politike dhe nëse shkrimtarët donin ta rrënonin sistemin apo ta përmirësonin atë, Jero sqaron se në fillim shkrimtarët si rregull ishin solidarë me sistemin socialist; mirëpo më pas, kur kulturi i personit u bë gjithnjë e më i qartë – dhe atëherë u tregua se kritika kundër tij ishte e drejtë – u bë një ndarje edhe nga sistemi sovjetik edhe nga ai kinez. Fakti që Hoxha e kishte skicuar shoqërinë shqiptare sipas këtyre modeleve të jashtme i rriste gjithnjë e më shumë kundërthëniet mes udhëheqjes së partisë dhe inteligjencës e të popullit në përgjithësi. Po, mund të thuhet se ka pasur disidencë dhe

ajo që ndodhi më 1990 tregon se një disidencë e tillë pati filluar të zhvillohet që pas vitit 1945 dhe në mënyrë të heshtur kjo ishte prezente gjatë tërë kohës.

*

Në pyetjen lidhur me qëndrimin e vërtetë të Enver Hoxhës për kulturën, Jero thotë:

Enver Hoxha nuk ishte – sikur del edhe nga memoaret e tij dhe përshkrimi i tij nga të tjerët – ndonjë personalitet i kulturës, e kjo nuk domethënë se ai ishte aq i trashë sa të ishte i paaftë për ta kuptuar artin realist. Por me frymën e tij makiaveliste edhe ai, pikërisht si Stalini, Mao etj. donte t'i shtypte intelektualët në përgjithësi dhe artistët në veçanti. Aq sa që ai kishte fobi ndaj tyre. Kjo varej pjesërisht për shkak se Enver Hoxha kishte dështuar në studimet universitare (nuk e kishte kryer as semestrin e parë të studimeve megjithëse kishte provuar gjashtë vite). E donte poezinë por vetë kishte dështuar në shkruarjen e poezive. Më tej, e urrente artin e vërtetë, pasi që ai nuk i nënshtrohet disiplinës, ai nuk mund të ekzistojë në një ambient totalitar. "Të bindesh, të besosh dhe të luftosh" është trinia e totalitarizmit, kurse trinia e artit është "të vëzhgosh, të kritikosh dhe të flijosh veten për lirinë".

Minush Jero konstaton se kurrë s'ka qenë e mundur të jetohet mirë si artist në Shqipëri. E as komercializmi nuk do ta ndryshojë dukshëm këtë fakt. Humbja e tij më e madhe ishte se djali i tij, i cili ishte njëvjeçar kur drama e babait u stigmatizua dhe që prandaj nuk ishte aq "i mençur" sa të klithte si protestë kundër veprës së babait, më vonë për tre vjet do të humb të drejtën për të studiuar. Është e kuptueshme ndjenja e Minush Jeros ndaj diktaturës për atë që kjo bëri ndaj djalit të tij të pafajshëm!

Krejt në fund mund të shtohet se Minush Jero me profesion ishte epror ushtarak. Ai qe përjashtuar nga Partia e Punës e Shqipërisë për shkaqe politike më 1959-1960. U aftësua për mësues dhe u mor edhe me dramaturgji. Pas lirimimit nga burgu e deri te pensionimi i tij më 1987 Jero ka punuar punë të rëndë fizike në një fabrikë gome në Durrës. Ai, me gjithë përvojat e tij të hidhura, ka vazhduar të shkruajë drama.

*

Në librin "Shqipëria – zgjim i dhimbshëm" (Tiranë 1991) Atalanta Pasko, vajza e shkrimtarit dhe bankierit Dhimitër Pasko, i njohur si Mitrush Kuteli, shprehet:

"Dhuna që ushtroi diktatura e kuqe te ne ishte më e zezë sesa dhuna e çdo diktature tjetër, me çfarëdolloj ngjyre, gjatë shekullit tonë. Ndërprerja e lidhjeve me Perëndimin dhe euforia e të ndërtuarit "e një bote të re" që pompohej nga arti politikanesk, bëri që në fillim një pjesë e njerëzve të mos kuptonin se ç'po ndodhte. Kjo vdekje e gjithanshme u dukej si jetë. Zhgënjimin e tyre të thellë po e shohim sot. Ndërsa ata që kuptonin, ranë në një trishtim të thellë, të pashpresë. Është trishtimi i njeriut që sheh të keqen si i shtrinë krahët mbi të sotmen e të ardhmen dhe s'mund të bëjë asgjë për ta ndalur. Ky është dhe trishtimi i artistit që do t'i thotë diçka popullit të vet e nuk ia thotë dot.

Prandaj, Mitrush Kuteli shkruan:

Flenë fjalët e pathëna
Në savanin e harrimit
Sepse nëma dhe gjëma
Mbyti ninëzën e krijimit.

Janë këto fjalë të pathëna, edhe fjalë të tjera të thëna por të ndaluara që i kanë munguar shqiptarit në Shqipëri, ashtu si i kanë munguar edhe shumë sende të tjera të

lëmit material. Fjalët e pathëna dhe fjalët e ndaluara u zëvendësuan nga fjalët e gënjeshtërtë dhe kështu kobi që ra mbi kulturën shqiptare u bë më i madh. Gënjeshtër u ngrit në art, u bë kult, u bë institucion. Kush gënjen më shumë, ai është më i zoti, ai më do më shumë, ai meriton shpërblime më të mëdha – thoshte diktatura. Janë dëme që e shtrijnë rrezën e veprimit edhe përtej kufijve politik të Shqipërisë së sotme, edhe shumë përtej kohës së sotme.

Fjalët e ndaluara, fjalët e pathëna, jetët e pajetuara - janë akuza që e sotmja ia bën së kaluarës, liria – diktaturës, njeriu – antinjeriut”.

Ministrat e brendshëm kriminelë, apo ky ishte arti për ta bërë qeverinë shqiptare të bie në grackën e ngritur nga ajo vetë?

Në librin e tij “Nga një dhjetor në tjetrin” që trajton ngjarjet prej dhjetorit 1990 deri në dhjetorin e vitit 1991, Ismail Kadare rrëfen për takimin e tij me kryetarin e shtetit shqiptar Ramiz Alia në shkurt 1991.

“Të deklarosh se në Shqipëri nuk shkelen të drejtat e njeriut është absurde” i kishte thënë Kadare Aliajt. “Mjafton të shtrosh një pyetje të thjeshtë: ç’kanë bërë këta ministra të brendshëm të dënuar njëri pas tjetrit si kriminelë? Dihet se ministra të tillë, gjëja e parë që bëjnë është që qysh nga mëngjesi e gjer në darkë të shkelen të drejtat e njeriut.

Ai më dëgjoi dhe pak, pastaj tundi kokën i ngrysur.

- Ti ke të drejtë, tha. Në Shqipëri shkelen të drejtat e njeriut”.

Dhe Kadareja komenton: “Ishte hera e parë që dëgjoja një pohim të tillë, dhe nga kush, nga shefi i shtetit.”

Kadareja, si të thuash, kishte sulmuar duke u nisur nga vetë bazat e sistemit. Të gjithë ministrat e brendshëm shqiptarë gjatë kohës së Enver Hoxhës deri në vitin 1982, si Koçi Xoxe, Mehmet Shehu, Kadri Hazbiu dhe Feçor Shehu, nga vetë Hoxha ishin karakterizuar si kriminelë, agjentë të fuqive të huaja. Me siguri se të gjithë ishin kriminelë, dhe kjo duket nga ajo që ata kanë bërë në kohën e tyre sa kanë qenë ministra, dhe njëri nga ta vërtet kishte qenë agjent i interesave të huaja – Koçi Xoxe. Në Shqipëri ky u ekzekutua si tradhëtar, kurse në Kosovë disa rrugëve iu vu emri i tij – sepse ai kishte qenë shërbëtor besnik i Jugosllavisë në Tiranë.

Kadri Hazbiu kishte luajtur një rol të veçantë në eliminimin e kryeministrit Mehmet Shehu në fund të vitit 1981. Por, dy vjet më vonë Kadri Hazbiu u dënua me vdekje. I njëjti fat e gjeti edhe Feçor Shehun, i cili disa vite më parë e pat zëvendësuar Kadriun në postin e Ministrit të Punëve të Brendshme. Pra, të dytë u ekzekutuan më 9 shtator 1983, në të njëjtën ditë, duke u cilësuar si tradhëtarë dhe bashkëpunëtorë të Mehmet Shehut.

Sipas logjikës së Partisë, këta njerëz ishin shpirtlig dhe të këqinj – me çka ne pa fije dyshimi mund të pajtohemi – por ç’domethënie kishte kjo për Sigurimin? Kadareja, në fakt, nuk e kishte treguar gjoksin aq shumë sa mund të krijohet përshtypja.

Edhe një tregim tjetër nga ky libër ia vlen t’i tregohet lexuesve suedezë. Tregimi ka të bëjë me metodat e Sigurimit për rekrutim. Por rrallë është treguar se si ia dilte aparati brutal i spiunazhit të ballafaqohet me turpin. Pikërisht kjo ndodh në rastin që Kadare e relaton:

Miku i tij i afërt, poeti dhe kritiku Drago Siliqi, një njeri i mirë dhe i ngrohtë, i cili në moshën 33-vjeçare vdiq në një aksident gjatë një udhëtimi me aeroplan për në Kinë më 1963, ia kishte arritur në vitin 1961 t’u shpëtonte duarve të oktapodit të Sigurimit. Një njeri i Sigurimit e kishte kërkuar Dragon dhe i kishte kërkuar të bashkëpunojë “në emër të idealit komunist”. Drago Siliqi nuk kishte pranuar. Herën tjetër ishte përdorur një metodë klasike, por e pistë: ia kujtuan disa letra intime dërguar një gruaje, një punë

kjo shumë e ndjeshme. Drago kërkoi një kohë që të mendohej. Dhe pas pak kohe u mbajt një mbledhje lokale e partisë.

Drago, i cili ishte anëtar, e kërkoi fjalën te pika “Të ndryshme”. Për befasinë e pafshehur të të gjithëve, Drago Siliqi sqaroi:

- Para disa ditësh një shok nga Sigurimi më propozoi që të bëhem spiun i tyre. Para se t’ia japë përgjigjen, dua të di se çfarë mendojnë shokët në organizatën bazë!

Sekretari i partisë herë skuqej e herë zbehej për çdo gjë që thoshte ai. – Çfarë po thua, shoku Drago? Nuk fliten gjëra të tilla në mbledhje.

- Pse jo? – pyeti me padjallëzi Drago Siliqi. - Ne kemi mësuar që të mos fshehim asgjë për partinë, dhe tash unë jam para partisë apo jo?

Pas kësaj, Drago Siliqi nuk u ngacmua më nga Sigurimi.

”ARMIQTË E POPULLIT” – BURGJET – POSHTËRIMET

Shumë prej atyre që janë përndjekur dhe dënuar me internim ose burg, si dhe të gjithë ata të cilët janë ekzekutuar si ”armiqtë e popullit” ishin krejtësisht të pafajshëm lidhur me akuzat që u bëheshin atyre. Në këtë aspekt kishte shumë ngjashmëri midis Shqipërisë së Enver Hoxhës dhe Bashkimit Sovjetik të Jozef Stalinit. Megjithatë, me rëndësi është të theksohen dallimet: Është e vështirë të zhduket një njeri pa gjurmë në një vend si Shqipëria. Vendi nuk është më i madh se sa krahinat suedeze të quajtura Smoland ose Dalarna. Shqiptarët e mirënjohur dhe aktivë njiheshin nga të gjithë në vend.

Tash do të paraqes disa nga rrëfimet trishtuese të cilat i përshkruan Agim Musta në librin e tij ”Dosje të gjalla”, botuar më 1995. Në një libër tjetër, të quajtur ”Mandelët e Shqipërisë” botuar më 1992, rrëfen mbi disa shqiptarë, që kanë vuajtur shumë gjatë mbajtjes së dënimeve të gjata me burg në vitet 1960-1972.

Agim Musta ka qenë bashkëthemelues në fshehtësi i një grupi socialdemokrat në Tiranë, grup i cili më pas vendosi të bashkohej me grupin e Pjetër Arbënorit në Durrës. Por ata u zbuluan shpejt nga Sigurimi dhe grupet u ”bashkuan” vetëm përpara parrakëve të Gjykatës Ushtarake në Tiranë. Ja se si rrëfen Agim Musta:

Grupi hetues i Ministrisë së Brendshme më kishte rezervuar qelinë nr 6 në burgun e vjetër të Tiranës. Një gardian e hapi derën dhe e flaku me përçmim një batani të vjetër, përplot me njolla gjaku. Me dialektin e tij të vrazhdë jugor ai nisi të më flasë për rregullat e rendit në burg dhe pas çdo fraze, shtone ”E kupton?”. Më vonë mësova se ai ishte kapiten Velo, gardian burgu që nga viti 1945, i cili me gjuhën e tij dhe me pamjen e tij dukej më tepër komik se sa i tmerrshëm. Qelia ishte si një varr, ku nga një vrimëz hynte një dritë e dobët. Në dysheme dhe nëpër mure, me një shikim të kujdesshëm, mund të dalloheshin emra vendesh dhe njerëzish, të cilët nga kjo qeli kishin shkuar deri në vendet e ekzekutimit, deri në burgjet e errëta ose në kampet ku bënin punë të detyrueshme. Në qeli të mbyste kundërmimi i urinës: të arrestuarit kishin kryer nevojën e vogël në dysheme, sepse, sipas rendit shtëpiak të burgut, i burgosuri kishte të drejtë vetëm dy herë në ditë të shkonte në tualet dhe atë i shoqëruar nga gardiani. Me ato raporte presioni që i burgosuri i përjetonte, veshkët dhe mëshikëza e urinës bëheshin tejte të ndieshme, ndërkohë që shqisat e të dëgjuarit bëheshin më të mprehta. Çdo të katërtën orë, ditën e natën, kur bëhej ndërrimi i gardianëve, hapeshin dyert me zhurmë dhe të arrestuarit u nënshtroheshin një kontrolli të kujdesshëm, prej vrimës së zorrës së trashë e deri te rrënjët e flokut. Të dënuarit me vdekje mbaheshin në qeli, me duar e këmbë të lidhura në pranga nga pas. Gardianët i çonin të arrestuarit në lokalet e gjykatës hetuese, që ishin të ngjitura me ndërtesën e qelive, të lidhura në pranga dhe të shtrënguar fort për krahësh. Hetuesit nuk i përdornin emrat për të arrestuarit po numrat e qelive ku ata mbaheshin. Kapiteni, që rrinte përjashtë derës së gjykatësit hetues, merret urdhërin nga gjykatësi dhe thirrte në korridorin e qelive: ”Merreni 32-shin”. Tridhjetedyshi çohet në dhomën e hetuesisë dhe ulet në një karrige betoni (ishte ajo një karrige me këmbët e saj të ngjitura në beton). E para gjë që bënin gjyktësit hetues ishte të poshtërohej i arrestuari duke përdorur fyerjet më të rënda kundër tij e familjes së tij. Këto fyerje dhe sharje shoqëroheshin me goditje në fytyrë, kërcinj dhe në organet gjinitale, goditje me vizore në kokë, me shishat e ngjyrës së stylografëve në ballë, me të shkurtuara drunjsh në shpinë dhe me gjithë ç’kishte në tavolinën e punës dhe në vende të tjera në dhomë. Një ditë gjykatësi im hetues, majori Llambi Titani, ish shegert i një këpucari dhe që kishte kryer vetëm pesë vite arsimim, më çoi mua deri te lokali i torturave. Aty kishte gremça për t’i mbajtur njerëzit të varur, një dollap prej hekuri ku viktimat mund të mbahej disa ditë me radhë, krevate metalike ku i lidhnin fort

ata dhe i torturonin me hekur të skuqur dhe vaj të vluar, vaska me ujë të ftohët dhe akull ku të arrestuarit vendoseshin lakuriq, darë për ndukjen e thonjve, karrige elektrike për trajtim me shok-elektrik, ampula me vaj të lubrifikuar dhe medikamente të tjera për ta ndryshuar personalitetin e të akuzuarit. Thënë shkurt, në atë dhomë ishte një arsenal i tërë me pajisje torturimi, prej atyre më primitive deri te ato më moderne. Xhelati – gjykatësi hetues tha me një ton kërcënues dhe superior se në këtë dhomë torturimi shumë prej ”armiqëve të popullit” kanë lënë shpirtin dhe se i njëjti fat më priste edhe mua, po qe se nuk do të filloja të flisja. Një ditë më mori në pyetje gjykatësi më i lartë hetues i Republikës, gjenerali Nevzat Haznedari, njëri prej torturuesve më të njohur në diktaturën komuniste, mizoria e të cilit është e njohur mirë dhe e pallogaritshme. Ai shoqërohej nga një tufë çakallësh dhe lakenjsh, të cilët rrinin gatitu në fund të dhomës. Në një çast kur përgjigja ime nuk e kënaqi atë, më goditi me këndin e një vizoreje metalike. I larë në gjak, më ra të fikët. Shenjën e vizores e kam ende në ballë, megjithëse kanë kaluar që atëherë më se tridhjetë vjet. Gjatë hetimeve u janë dhënë të arrestuarve edhe droga, që i përziheshin në ushqim me qëllim që t’ia prishnin sistemin nervor. Në shumë vite kam ndierë pasojat e këtyre drogave të ndyra prej të cilave shumë të burgosur kanë pësuar lëndime të përhershme psikike.

Një mbrëmje korriku prokurori i përgjithshëm, udhëheqësi i inkuizicionit, Aranit Çela erdhi në një inspektim në burg. Të arrestuarit u ankuan lidhur me torturat që bëheshin nga gjykatësit e egër hetues. Unë protestova kundër torturës që na bëhej përmes mosdhënies së ujit gjatë vapës përcëlluese, por ai u përgjegj me vulgaritet çnjerëzor: ”Shih, armiqtë e Partisë dashkan ujë?! A mos doni edhe birra? A nuk e keni kuptuar se në Shqipëri mbretëron Diktatura e Proletariatit, që do t’ua nxjerrë palcën dhe do t’ua thyejë këmbët?!” Iu kthye gjykatësve hetues dhe gardianëve që rrinin pas tij dhe i nxiti ata që të mos bëjnë kurrfarë lëshimi ndaj të arrestuarve. Ja, kështu prokurori i përgjithshëm e mbronte ligjin!

Gjatë fundit të korrikut të vitit 1962 më dhanë aktakuzën, në të cilën unë akuzohesha sipas nenit 64 për ”tradhëti të lartë” dhe nenit 73 për agjitacion dhe propagandë grupore. Ndër të tjera theksohej se ne donim ta rrëzonim ”pushtetin popullor” përmes organizimit të grupit socialdemokratik. Vetëm zoti mund ta dinte se ç’mjete do të kishim përdorur për ta rrëzuar këtë regjim të urrejtur policor, sepse ne s’kishim tjetër përveçse shkumsave me të cilët shkruanim. Kulmi i cinizmit ishte kur gjykatësit hetues interesoheshin që ne të dilnim para gjykatës të veshur në kostume, ndërkohë që ne nuk kishim as pulla në pantallona dhe detyroheshim t’i mbanim ato me duar që të mos na zdisheshin. Gjykimi ishte i vendosur që më parë nga gjykata e hetuesisë dhe shpesh gjykatësit hetues krejt hapur na thoshin se gjykimi ishte formal dhe se gjithçka ata e kishin në duart e tyre. Dhe kjo ishte e vetmja gjë që ata e thoshin me sinqeritet. Ne këshilloheshim që të merrnin avokatë mbrojtës, ndërkohë që gjyktësit hetues i caktonin ata vetë dhe pa pëlqimin tonë. Më 7 gusht 1962, ne me duar të lidhura nga pas na futën në veturën e burgut dhe na çuan në Gjykatën në Tiranë të përcjellë me një xhip me njerëz të Sigurimit dhe me policë në të dyja anët. Do të dënoheshim nga Gjykata Ushtarake me kryetar kolonel Llazi Polena, ish pastiçer dhe që kishte mbaruar një shkollë për të rritur. Që kur regjimi komunist e ka marrë pushtetin, kolonel Llazi Polena kishte dhënë qindra dënime me vdekje, me ç’rast ai gjithëherë ia merrte sekujt një djalë, një bashkëshort, një vëlla ose një baba. Ky ishte një kompenzim i tij për “Nënë Parti” për postin që kjo ia kishte dhënë këtij horri të pashkolluar. Prokuror ishte major Sami Kapllani, nga po ai brum si edhe Polena. Tek dera e gjykatës priste nëna ime, që i bëri ballë të tërës pa i lëvizur as qerpiku. E kur grupi ynë po i afrohej hyrjes, ajo thirri: “Mos ke frikë! Mbajuni! Populli e di se s’keni bërë asgjë të keqe!”.

Oficerët e Sigurimit nxituan përpara dhe i bërtitën asaj: “Mbaje gojën, plakë e keqe! Se ne mund t’u hyjmë atyre dajak me shufura hekuri e t’i zhdukim nga faqja e dheut!”. Nëna ime i shikoi me përbuzje dhe ua ktheu shpinën me fjalët: “Duhet të keni turp!”.

Gjykimi u mbajt me dyer të mbyllura dhe në sallë kishte vetëm eprorë nga policia dhe funksionarë partiakë e shtetërorë. Te dera e hyrjes rrinin dy oficerë nga Ministria e Brendshme dhe dy oficer të Sigurimit. Ata nuk i lejuan as familjet tona të dëgjonin se si zhvillohej gjykimi. Aktakuza ishte e përpiluar me fraza standarde, që përdroreshin zakonisht në gjykimet e inskenuara kundër “Armiqve të popullit”. Formulimet ishin pak a shumë kështu: Kanë bërë propagandë kundër Partisë së Punës dhe pushtetit popullor. Kanë hedhur poshtë të arriturat e mëdha të Republikës Popullore të Shqipërisë në fushat politike, ekonomike dhe sociale. Kanë propaganduar për një mënyrë borgjeze të jetesës. Kanë derdhur vrer kundër realizmit socialist. Kanë shpifur kundër udhëheqjes së Partisë dhe të Pushtetit Popullor. Kanë dashur të formojnë një parti socialdemokratike. Kanë pasur për qëllim ta nxisin popullin në kryengritje për shembjen e pushtetit popullor. Kanë dashur... dhe fraza të ngjashme të trilluara, të marra nga propaganda e çmendur komuniste, e që të akuzuarit e paguanin me kokë ose me dënim shumëvjeçar burgu. Ne pranuan aq sa kishim bërë, por i refuzuam akuzat e tjera. Gjykimi zgjati katër ditë dhe më 11 gusht kolonel Llazi Polena e lexoi dënimin. Uran Kalakula dhe Pjetër Arbnori u dënuan me vdekje, kurse ne të tjerët u dënuam me burgim secili me më shumë se dhjetë vite. Pas një muaji, Presidenca e shfuqizoi dënimin me vdekje të Uranit e të Pjetrit duke i kthyer ato në dënime me nga 25 vjet burg.”

Kaq sa i përket rrëfimit të Agim Mustës për burgosjen dhe dënimin e tij. Ai do të paraqitet sërish në libër, bashkë me fatin e të burgosurve që i takon në burgun e Burrelit. Njëri nga ta ishte gjenerali Hulusi Spahiu, i cili ishte veteran nga Lufta e Spanjës dhe gjatë luftës partizane kishte qenë komandant i Brigadës së III-të. Agim Musta e përshkruan Spahiun si të matur, pa paragjykime dhe objektiv. Hulusi Spahiu mendonte se Enver Hoxha e kishte përgjegjësini e drejtpërdrejtë për të gjitha të këqiat që kishin ngjarë në Shqipëri pas krijimit të Partisë Komuniste të Shqipërisë. Mehmet Shehu nuk ishte asgjë tjetër përveçse një vegël në duart e kasapit Enver, një vegël të cilën ai me kohë do ta hidhte. Ky parashikim i Spahiut do të vërtetohej njëzet vjet më pas.

Një i burgosur tjetër i vjetër në Burrel ishte edhe dramaturgu i parë i Shqipërisë Ethem Haxhiademi, i cili më 1945 qe dënuar me burgim të përjetshëm. Mundimet e Haxhiademit gjatë njëzet vjetëve në ferrin e burgut të Burrelit e kishin mplakur atë para kohe. Ishte një arkiv i gjallë i historisë së administratës shtetërore të Shqipërisë gjatë periudhës 1912-1939 dhe punonte vazhdimisht në fletoret e zhubrosura të shënimeve, ku ai kishte shkruar kujtimet e veta konzice dhe të sakta. Haxhiademi kishte njohuri të gjera lidhur me botën kulturore të antikitetit dhe e adhuronte edhe kulturën gjermane. Në burg punonte si përkthyes nga gjuha gjermane dhe i përhapte njohuritë e tij. Asnjëherë s’i lexonte gazetat dhe kur bëhej leximi i detyrueshëm i “Zërit të Popullit” – organi kryesor komunist, i fuste veshët në lesh që të mos ndikohej prej saj. Thoshte shpesh se kishte vdekur në nëntor të vitit 1944 dhe se truri i tij kishte vënë embargo kundër ideologjisë komuniste. Shënimet e tij të shumëvlefshme, për fat të keq, përfunduan në duart e Sigurimit.

Në Burrel ishte edhe mësuesi i filozofisë, Gjergj Kokoshi. Ky ishte shumë i ditur në filozofi dhe politikë, gjithëherë miqësor dhe i hareshëm, megjithëse ishte i sëmurë rëndë nga tuberkulozi. Si socialdemokrat i ishte bashkuar Lëvizjes Nacional-Çlirimtare dhe ishte emëruar Ministër i Arsimit në fund të vitit 1945. Por më 1946 krijoi një grup opozitar në Kuvendin Popullor dhe së bashku me disa deputetë si Shefqet Beja, Selaudin Toto, Riza Dani me shumë të tjerë, u arrestua me urdhër të Enver Hoxhës dhe u dënuar

me 25 vjet burg. Gjergj Kokoshi ishte pronar i bibliotekës më të madhe private në Shqipëri, e cila pas burgosjes së tij pjesërisht u konfiskua e pjesërisht u përvetësua nga Biblioteka Kombëtare e Tiranës.

Kokoshi e shprehte dëshprimin e tij të thellë që Lëvizja Nacional-Çlirimtare ishte përdorur nga komunistët për marrjen e pushtetit dhe vendosjen e diktaturës. Ishte i bindur se populli në përgjithësi, rinia, intelektualët e madje edhe anëtarët e thjeshtë të Partisë Komuniste nuk dinin gjë për planet djallëzore të Enver Hoxhës dhe bashkëpunëtorëve të tij më të ngushtë. Gjergj Kokoshi gjatë shumë viteve në Burrel kishte punuar me veprat e Marksit, Engelsit e të Leninit dhe kishte ardhur deri te përfundimi se komunizmi do të rrëzohej edhe si praktikë edhe si ideologji. I sëmurë rëndë nga tuberkulozi, pa trajtim mjekësor dhe pa ndihmë nga familja (ai qe beqar). Kokoshi vdiq në burg dhe shkrimet e tij të shumëvlefshme u zhdukën.

Për pak çaste do të ndërprej përshkrimet e Agim Mustës. Gjatë kontakteve të mia me ambasadën e Shqipërisë në Stokholm unë e pata kuptuar se njëri apo disa nga diplomatët e kishin për detyrë të raportonin në Sigurim për njerëzit me të cilët ambasada kontaktonte. Pas rënies së regjimit komunist, mësova se në arkivin e Sigurimit ishte shënuar se unë mund të isha “agjent anglez”! Sado të dukej një pohim qesharak, unë e kuptova se prej çka varej kjo. Në vitin 1984 kam biseduar lidhur me një udhëtim të mundshëm për në Shqipëri, dhe kur më pas i tregova sekretarit të ambasadës Ivzi Çipuri se unë nuk shkova në Shqipëri po në Angli (së bashku me një pjesë të kolegëve të mi nga shkolla), ai u çudit. Ç’do të bëja unë në Londër, përveç se të merrja instruksione për spiunim ndaj Shqipërisë? Kjo ndodhi në kohën kur isha “komprometuar” përmes bashkëpunimit me një revistë shqiptare në mërgim. Më nuk konsiderohesha si “mik i Shqipërisë”, ashtu sikurse më kishte karakterizuar Enver Hoxha në letrën e tij më 1978.

Agim Musta e konfirmon veprimtarinë e ambasave në “Dosjen e gjallë” përmes të dhënave që kishte marrë nga Zija Dibra, i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe në vitet 1950-ta ambasador në ambasadën shqiptare në Pragë. Zija Dibra njoftonte se Ministria e Punëve të Jashtme i nënshtrohej Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të punësuarit në ambasada ishin, si rregull, personel i Sigurimit. Ai tregon për një raport nga Behar Shtylla, i cili kishte shkuar në SHBA me detyrë. Ky raport e kishte prekur thellë Zijanë, pasi nuk ishte një raport i zakonshëm diplomatik, por një njoftim nga një oficer i Shërbimit të Sigurimit. Raporti bënte me dije se Behar Shtylla e kishte për detyrë të rekrutonte agjentë të Sigurimit në koloninë shqiptare në SHBA, përmes presioneve dhe kërcënimeve të ndryshme, deri te mundësia e internimit dhe burgosjes së të afërmeve që ishin në Shqipëri. Zijai ia kishte dhënë raportin e deshifruar Manush Myftiut, i cili asokohe ishte Zëvendësministër i Punëve të Jashtme. Zijai pohonte se ata që vendosnin në ambasada ishin të punësuarit e Sigurimit dhe jo ambasadorët. Njeriu i Sigurimit raportonte direkt te Ministria e Brendshme për gjithçka që kishte të bënte me të punësuarit në ambasadë dhe prej andej merrte direktiva. Zijai tregon se ai qe shkarkuar nga posti i ambasadorit në Pragë, për shkak se, pa e informuar njeriun e Sigurimit në ambasadë, ishte takuar me Pajetan, sekretar i Partisë Komuniste të Italisë. Pajeta kishte protestuar ndaj faktit se në Shqipëri mbaheshin shumë specialistë italianë si pengje, edhe pse lufta kishte gjashtë vjet që kishte përfunduar. Ky qëndrim jonjerëzor i qeverisë shqiptare paraqiste vështirësi për Partinë Komuniste të Italisë, si dhe Shqipërisë i jepte një imazh të keq. Kjo, në fakt, nuk e shqetësonte regjimin e Enver Hoxhës. Ambasadat shqiptare merreshin me veprimtari të pastër kriminale. Zija Dibra pohon se ata përmes një bashkëpunimi të afërt me shërbimin sekret sovjetik dhe njerëz të tjerë të sigurimeve nga vende të tjera të lindjes kryen vrasjen e Mid’hat Frashërit në Nju Jork më 1949, atentatin kundër Sadik Premtes në Paris, vrasjen e Ahmet Kukës në

SHBA, zhdukjen mistike të Izet Vrazhdos dhe shumë krime të tjera të tmerrshme. Shërbimi Shqiptar i Sigurimit, përmes agjentëve të vet, kishte shkatërruar grupet shqiptare në mërgim dhe kishte paralizuar aksionet e tyre kundër regjimit të Enver Hoxhës.

Ndonjëherë ngjante që tragjikja të përzihej me komikën, si në rastin e 75-vjeçarit xha Karafili, një plak i sjellshëm dhe i mirë, i cili me festën e vet të kuqe të kohës së Turqisë dhe gjithëherë me tespihet në duar e kishte çuar veten e tij në kamp. Ai rrëfente se një ditë kishte shkuar në shtallën e kolektivit, ku ishin demat, për të parë demin e tij, i cili qe bërë asht e lëkurë dhe me vrragë në qafë. E kishte përqafuar dhe e kishte puthur kafshën, si të ishte fëmijë i tij. Pastaj kishte shfaqur pakënaqësinë për gjendjen e demit të tij kështu: “Si qafa jote e keqtrajtuar, o i dashur Kazi, është edhe zemra ime për shkak të komunistëve të mjerë, të cilët as kanë mend e as besim!” Xha Karafili ishte kthyer nga shtalla me lotë në sy dhe atë ditë as një fjalë të vetme s’ua kishte thënë djemve e as grave të tyre, të cilët e donin dhe e respektonin. S’kish gjë që atë ditë mund ta bënte atë të çelte gojën. Një javë më pas, një xhip nga Sigurimi erdhi dhe e mori plakun dhe e kishin përplasur në një qeli. Pas dy ditësh, u mor në hetuesi nga Thanas Caku, udhëheqësi i hetuesisë në Elbasan, së bashku me eprorin e rrethit që ndodhej në shërbim. “Ulu këtu!” i thanë ata dhe i treguan me gisht karrigen e betonit. “Trego, kujt i ke folur keq për Partinë, përndryshe do ta pësosh keq” i bërtiti eprori. Tespihet i ranë nga dora xha Karafilin dhe me zë të mbytur tha: “E ç’paskam bërë tash, çuna?”.

- Ti e di fare mirë dhe ne duam që atë të na e thuash vetë, tha udhëheqësi i hetuesisë Caku.

- Për allahun, unë s’di gjë.

- E si ishte puna me demin, ç’i ke thënë para një jave në shtallën e kooperativës? – donte të dinte eprori.

Xha Karafili u turbullua fare dhe pa menduar fare tha:

- Çfarë, edhe demin e paski bërë spiun, a?!

- Ne e dimë se si është puna, kishte thënë Caku me një buzëqeshje. – Por ne duam që ti ta pranosh këtu, para nesh, çfarë ke folur me demin dhe po qe se e thua të vërtetën, Partia do të mundohet në mënyrën më të mirë të mendoj edhe për ty!

Dhe xha Karafili, në atë gjendje të turbulluar siç qe, kishte treguar gjithë ç’i kishte thënë demit “spiun”, pa hequr e pa shtuar as edhe një fjalë të vetme. Udhëheqësi i hetuesisë shkroi protokollin dhe e vuri atë përpara Karafilin që ta nënshkruante.

- Po djema, unë nuk di as të shkruaj e as të lexoj!

- S’prish punë! Vër gishtin aty, e urdhëroi eprori.

Ata ia lyen me ngjyrë të zezë gishtin e Karafilin dhe e vulosën pjesën e poshtme të protokollit aty ku shkruante: nënshkrimi i të akuzuarit.

- Tash mbaruam së bashku! – i thanë xha Karafilin dhe e thirrën policinë për ta çuar 75-vjeçarin në qelinë e tij. Xha Karafili i gJORë mendoj tërë natën se kush ka mundur ta spiunonte, sepse kur e kishte përkëdhelur demin dhe kur i kishte shqiptuar ato fjalë fatale nuk kishte asfarë gjurme të ndonjë qenie tjetër të gjallë në shtallë. E kafshët flasin vetëm në përralla. E kush kishte mundur ta denonconte? Si kishin mundur eprorët ta merrnin veshë se ç’i kishte thënë Kazit? Dy muaj me radhë e kishte vrarë mendjen xha Karafili, por nuk kishte arritur të zbërthente enigmën. Vetëm gjatë procesit gjyqësor iu bë e qartë e vërteta. Atëherë, përgjegjësi i shtallës u paraqit si dëshmitar dhe pa fije turpi tregoi para gjykatës se atë ditë, kur xha Karafili e kishte përqafuar demin dhe ia kishte thënë ato farë fjalët, ai ndodhej në shtallë, i shtrirë pas një duaji sane; dhe sapo xha Karafili ishte larguar nga shtalla, ky “mik i rendit” kishte dalë ngadalë nga sana dhe kishte shkuar te eprori kujdestar i Sigurimit për të raportuar atë ç’kishte thënë xha Karafili.

Kur të burgosurit e tjerë dëgjuan këtë ngjarje tragjekomike nga goja e plakut të gjorë, shpërthyen në të qeshura; e pastaj kur flisnin për të, ishin të një mendjeje se drama të këtilla mund të ndodhnin vetëm në skenën shqiptare. Në asnjë vend tjetër regjimi nuk do të mund të binte në një nivel kaq të ulët. Pas disa muajsh xha Karafili u dërgua në burgun e Burrelit, pasi që do të ishte vetëm “lak në këmbë” në kampin e punës. Plaku vdiq një vit më vonë, i thyer nga vuajtjet dhe moshën. Unë nuk do ta harroj kurrë xha Karafilin, shkruan Agim Musta dhe shton se nuk do të befasohej sikur gjeneratat e ardhshme të besonin se tregimi i xha Karafilin ishte vetëm një prodhim i një mendjeje me fantazi të zhvilluar. Por për fat të keq, ajo ishte një ngjarje e vërtetë në historinë e diktaturës komuniste shqiptare.

Mendimi im është ky: Fashizmi ishte i urryer, por në të kishte diçka të pajtueshme me teorinë dhe praktikën mizore. Komunizimi kishte ideale të bukura, por realsocializmi tregoi po atë përbuzje mizore për jetën e njerëzve si edhe fashizmi. Unë e përjetoj me një ndjenjë përbuzjeje një regjim i cili mund ta poshtëronte veten deri në atë masë sa një plak ta dënonte me burg vetëm për fjalët që ia kishte thënë një demi, një regjim i cili i kishte shkatërruar intelektualët më të shquar të vendit dhe shërbimi morbid i Sigurimit i cili përmes fabrikimit të akuzave perverse i kursente mjete shtetit, si dhe i asgjësonte nga burgu shënimet e bëra me mundim nga të burgosurit! Para se gjithash, vetë Enver Hoxha e meriton përbuzjen tonë: ky aktor i lig ka mundur të na mashtroj ndoshta me lojën e tij dikur, por pasi t’i lexojmë “veprat” e tij, gjenden, në mes të tërë atyre fjalimeve vetëlavdëruese dhe gënjeshtrove, shembuj për qëndrimin e tij mizor dhe urrejtjen e tij të egër kundër gjithçkaje dhe gjithkujt që mund ta rrezikonte pushtetin e tij. Regjimi i tij krijoi njerëz të tipit të përgjegjësit të shtallës, njerëz që kishin humbur çdo ndjenjë ndershmërie dhe që shiteshin te pushteti për asgjë.

Por në kulm të mizorisë ka edhe heroizëm. E pra, ky është heroizmi i të burgosurve dhe i të përndjekurve. Dhe ky ndoshta është heroizmi më i madh shqiptar, krahas vetëmohimit të grave. I kërkojmë falje heroit kombëtar Skënderbeu. Mizoria më e madhe në botën shqiptare nuk ka qenë sundimi osman dhe lakmitë e shteteve fqinje. Ka qenë armiku që ishte mu në mesin e tyre. Dhe më e keqja ka qenë se ky popull me buzëqeshje dhe brohoritje detyrohej shtypjen ta thirrte liri... Prova më e rëndë që barbarisht e kishte rënduar vendin ishte ajo se njerëzit duhej çdo ditë të bënin luftën e klasave dhe t’i ngulfatnin ndjenjat e tyre njerëzore. Çdo ditë të vërtetohet se Partia është më e shtrenjtë se sa dashuria për nënën dhe babain. (Nëna dhe babai mund të ishin tradhëtarë, që duhej zbuluar dhe denoncuar, por kurrë Partia!). Çdo ditë të shohësh zi dhe të detyrohesh të betohesh se atë që sheh është e bardhë... Ky është poshtërimi më i madh që mund t’i bëhet një populli.

Së voni, shkrimtari shqiptar Sokol Jakova ka publikuar një libër interesant, me titull “Dëshmitarë në tragjedi”. Libri ka material autobiografik dhe është një përshkrim i gjallë i jetës studentore në Tiranë në vitet e 1960-ta. Përshkrimi i ambientit dhe i personave është i shkëlqyeshëm. Tragjedia që shpreh titulli ka të bëjë me Viola Jakën, vajzës më të bukur të Tiranës, një vajzë e sjellshme, inteligjente dhe me optimizëm për jetë. Por ajo bën një “krim” të rëndë: u lind në një familje, ku kryefamiljari qe klasifikuar si armik dhe tradhëtar. Gjeneral Tuk Jakova ishte anëtar i Byrosë Politike të Partisë Komuniste të Shqipërisë, por në fillim të viteve të 1950-ta ra në sy të keq, u dënua me burg të rëndë e të gjatë dhe vdiq duke vuajtur dënimin.

Fati i Violës u përcaktua nga “krimi” i saj, nga “mëkati i trashëguar”, në një shoqëri e cila bënte gjithçka për t’i shtypur e ndonjëherë edhe për t’i shkatërruar në mënyrën më të ligë të gjithë ata, të cilët konsideroheshin se ishin kundër aparatit të pushtetit, kundër Partisë së plotfuqishme. Viola, emri i vërtetë i të cilës ishte Vjosa Jakova, bëri gabimin se u dashurua në një të ri, që i takonte një prej familjeve udhëheqëse. Ky u

detyra të flijojë dashurinë e vet, për shkak se familja dhe të afërmit e anatemuan vajzën e një “tradhëtar”. Më vonë, Viola iu nënshtua edhe poshtëtimeve të tjera dhe e mbetur pa kurrfarë kontakti me rrethin, u shkatërrua tërësisht dhe përfundoi në spitalin mental. Diktatura barbare e shkatërroi vajzën më të bukur dhe më të hijshme të Tiranës.

Le t’i kthehemi sërish përshkrimit të Agim Mustës. Në kampin e Rrepës ai u njoh me Eqremin, një i ri me fytyrë të zbehur dhe qëndrim melankolik, që rrallë fliste me të burgosurit e tjerë. Vinte nga një fshat i Peshkopisë, në zonën kufitare midis Shqipërisë dhe Maqedonisë, dhe kishte punuar mësues në fillim të viteve të 1960-ta. Akuzohej për lidhje kundërligjore me një vajzë të ciklit të lartë të nëntëvjeçares dhe arratiset në Jugosllavi, ku u akuzua se ishte dërguar si agjent i Sigurimit të Shqipërisë dhe, për t’i shpëtuar torturimit, ai e pranoi akuzën. Eqremi u dënua me pesë vjet burgim nga një gjykatë ushtarake në Shkup. U dërgua në burgun e Mitrovicës së Sremit, ku kishte dhe shumë të burgosur të tjerë shqiptarë të arratisur nga Shqipëria e të dënua nga gjykatat jugosllave. Njëri nga ta ishte edhe kunati im Hyseni, i cili i konfirmon detajet kryesore të këtyre përshkrimeve. Tortura dhe puna e detyruar e shkatërrojnë Eqremin, i cili merr tuberkulozin dhe pas lirit, përmes intervenimit të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, vendoset për trajtim në një senatorium në Suedi. Nga këtu vë kontakt me të afërmit e tij në Shqipëri dhe përmes letërkëmbimeve u tregon se ç’kishte përjetuar dhe për gjendjen e tij shëndetësore. Vëllezërit dhe nëna plakë trokasin në dyert e udhëheqësve të qeverisë, derisa arrijnë të marrin një premtim prej Haxhi Lleshit, kryetarit të Kuvendit Popullor të Shqipërisë dhe i cili vinte nga i njëjti rreth prej nga ishte dhe Eqremi, se ai do të mund të kthehej në atdhe pa pasur ndonjë privim. Letra e nënës, ku ajo i shkruante se donte ta shihte patjetër të birin para se të vdiste, e bën Eqremin ta merrte vendimin fatal për t’u kthyer në Shqipëri. Me tren shkon në Romë, rrugës takon një prift protestan gjerman i cili e këshillon ta ndërrojë vendimin, për shkak se komunistët kurrë nuk e mbajnë fjalën dhe se do t’i japin atij një dënim të rëndë po qe se do të kthehej, duke i thënë se Zoti do t’ia falte po qe se do ta thente besën që ia kishte dhënë nënës së sëmurë. Fjalët e priftit e bëjnë Eqremin të luhartet, por nuk mundi t’ia ndryshonte vendimin. Nga Roma merr aeroplanin për në Shqipëri, dhe kur zbret nga aeroplani në Rinas, i vihen prangat dhe i konfiskohen dhuratat që i kishte marrë për familjen përmes Kryqit të Kuq Suedez.

Kur e ëma merr vesh se ç’i kishte ndodhur të birit, vdes. Vëllezërit, që ishin të mashtruar, provojnë ta bëjnë Haxhi Lleshin që ta mbajë fjalën e dhënë. Në Repë i shfaqet Eqremit tuberkuloza sërish për shkak të ftohtit, punës së rëndë dhe ushqimit të keq; kësaj radhe një verem shkatërrues. Eqremi kollitej me gjak çdo ditë dhe lëngon gjithnjë më shumë. Me vonesë tepër të madhe e shtrijnë në spitalin e burgut në Tiranë dhe ne, bashkëteburgosurit e tij, nuk e dimë se ç’i ndodhi atij.

Kjo histori e llahtarshme e librit të Agim Mustës më bën të kujtoj “Alfonsin”, sikurse ai e quante veten. Refugjat nga Durrësi, i cili, si shumë i ri, ishte arratisur nga Shqipëria kryesisht për arsye aventureske. “Alfonsi” më 1964 erdhi në Suedi, ku njohu një suedeze, me të cilën u martua më 1967. Në vitin 1978 ndodhi katastrofa: gruaja iu operua pas një infarkti, por nuk shpëtoi. Një bashkëshortësi e lumtur përjetoi një fund tragjik. Bota e “Alfonsit” u shkatërrua, dhe pas kësaj ai mendonte se s’kishte më asgjë që e lidhte me Suedinë. Meqë banonte në Stokholm, kishte mundësi të vizitonte lokalet e Shoqatës Suedeze-Shqiptare dhe aty të lexonte gazetën nga atdheu. “Alfonsin” e takova në verë të vitit 1979, kur tashmë kishte vendosur të kthehej në atdhe. Nuk donte të prezentohej me emrin e tij të vërtetë, pasi që kishte rënë në konflikt me disa bashkatdhetarë dhe kishte frikë prej tyre.

Me rastin e ftesës për vizitë në Shqipëri, unë e mora përsipër të merrja me vete një pemë, të cilën si pemë të miqësisë do ta mbillja në Shqipëri, në fshatin Rrëmbec të Korçës, një fshat i cili qe bërë i njohur përmes librit “Albanska ansikten” (Fytyrat shqiptare) të Lars Oke Augustsonit. Pa e menduar mirë e kisha zgjedhur një mështekën të lartë 2.5 m, e cila, së pari, ishte e vështirë për t’u bartur dhe, gjithashtu, kërkonte mirëmbajtje përpara mbjelljes në tokën shqiptare. Në një pjesë të transportit, atë deri në Arlanda, më ndihmoi “Alfonsi”. Ajo çfarë ndodhi, që kur mështenka humbi nga shikimi im dhe u vendos në një hotel në Korçë, ishte se askush nuk qe kujdesur për të. Ajo që, më në fund, u mboll në Shqipëri, s’ishte vetëm se një pemë e fishkur dhe e vdekur. E sot megjithatë jam i lumtur që shkoi ashtu sikurse shkoi, pasi që ajo “miqësi”, mbi të cilën mbështetej shoqata jonë, ishte e rreme. Ne nuk ishim asgjë tjetër pos gur shahu në lojën politike të Enver Hoxhës dhe të regjimit të tij; dhe kjo pasqyrohet edhe në fatin e “Alfonsit”.

Ai e realizoi planin e tij për kthim, edhe pse, në kundërshtim me Eqremin, e dinte se ç’ë priste. Mbase do të ketë pritur ndonjë dënim më të lehtë, meqenëse kurrë nuk kishte qenë kundërshtar i regjimit. Por jo: kur “Alfonsi”, emri i vërtetë i të cilit ishte Dilaver Hasa, mbërriti në Shqipëri, u arrestua menjëherë dhe u dënua me 25 vjet burg dhe punë të detyruar. Një pasuri prej thujse gjysmë milioni (korona suedeze), që e kishte trashëguar prej gruas së tij dhe që i kishte marrë me vete, iu konfiskuan. Një ish i burgosur, tashmë i liruar, që kishte ndejtur me “Alfonsin”, tregonte se ai punonte në burgun afër minierës së Spaçit. Kur gazetari i *Expresit* Arne Wirén tentoi të hulumtonte fatin e “Alfonsit”, përmes bisedës me Ivzi Çipurin, në ambasadën e Shqipërisë, iu servuan gënjshtira dhe bishtërimë. Ishte po ai punëtor ambassade i cili më 1984 kishte trilluar se unë do të mund të isha “agjent britanik”. Dhe ky Ivzi Çipuri në vitet e 1990-ta mori një post të mirë në administratën e Shqipërisë “demokratike” të Sali Berishës! Mbase ai mund të thotë se vetëm e kishte kryer detyrën e tij në epokën e komunizmit; detyrën e tij për të gënjyer, mashtruar dhe fabrikuar shpifje, për t’i shërbyer “diktaturës së proletariatit”...

Ka të dhëna se “Alfonsi” është kthyer në Suedi dhe se banon diku në Skone. Unë, në kohën kur po shkruaja këtë libër, nuk kam mundur ta kontaktojë. Mbase dëshiron ta harrojë të kaluarën e vet kaq tragjike.

KAMPI I SPAÇIT

Lart në malet e Mirditës, në Shqipërinë e mesme, është një vend i cili do të mbetet përgjithmonë në mendjen e shqiptarëve, ashtu sikurse Aushvici, Belseni, Dudinka dhe emra të tjerë të tmerrshëm nga arsenali i Hitlerit dhe i Stalinit për rrënimin e njerëzve. Ai është Spaçi, një vend ku dielli midis maleve ndrinë vetëm tre orë në ditë. Burgu ishte në një rreth ku gërmohej bakri dhe sulfur squfuri.

Këtu po bëj një përshkrim të Spaçit, sipas librit "Shqipëria – zgjim i dhembshëm" (Tiranë, 1991), shkruar nga Agim Hamiti, i lindur në Dukat afër Vlorës më 1947. Agimi bashkë me familjen u dënua me internim dhe u privua nga e drejta për studime universitare, sepse babai i tij, një avokat i njohur, qe arratisur nga Shqipëria atëherë kur Agimi ishte dy vjeç. Më 1978 u arrestua Agim Hamiti dhe u dënua për "agjitacion dhe propagandë kundër shtetit". U lirua në vitin 1988, pasi kaloi vite të rënda në burgun e Spaçit dhe të Qafë Barit. Kështu Agim Hamiti e përshkruan Gulagun shqiptar:

Secili vizitor që do të vinte për herë të parë në Spaç, do të pushtohej nga një ndjenjë e përgjithshme apatie, ashtu sikur kur je dëshmitar i padëshiruar i situatave jetësore me dhembje e ankth vdekjeje. Edhe nëse vizitori nuk do të ishte i vetëm, kur ai të mbërrijë te kjo gropë e madhe që natyra ka krijuar në këtë vend, do të ndjejë një nevojë për meditim dhe të ketë vëmendjen tek ato ndjenja të befta që ngjallen në një ambient të tillë.

Vendi, nga të gjitha anët, rrethohet nga kodra e male. Kur ato shikohen nga hija e Spaçit, përmes relievit tepër të thyer, krijojnë përshtypjen e dy vargmaleve që në formë gjysmërrathësh janë vendosur përballë njëri-tjetrit. Në të dy anët, atë juglindore dhe veriperëndimore, ku ato në mënyrë simetrike takohen natyra i hap dy dritare - secilën në formë të përroit të rrëpirët përposhtë këtij bazeni të madh.

Shkurret, që mbulojnë një pjesë të kreshtave të maleve rretheqark, bëjnë një luftë të pabarabartë për mbijetesë në atë tokë të pafrytshme që i nënshtrohet erozionit. Rrënjët e tyre, që thuaia tërësisht janë jashtë, provojnë të ngulen diku mes gurëve të djegur nga dielli ose në plasaritjet e shtresave të shkëmbinjve. Vetëm për një kohë të shkurtër gjethet e tyre mund të shihen të hapura drejt diellit, sepse kur bënë vapë ato mblidhen për të ruajtur atë njomje të paktë, të cilën me shumë mund e kanë fituar.

Sipërfaqja e tokës, në përgjithësi, është e murrme dhe përbëhet nga shtresa të ndryshme të shistit argjilor. Mundet që acidi sulfurik, i cili aty ndodhet me shumicë në të gjitha përrrenjtë, kontribuon që sipërfaqja e tokës t'i ekspozohet erozionit dhe erës së keqe.

Shumë rrallë të zë syri ndonjë tufë bari, e kur kjo të ndodhë, atëherë bari mund të shihet vetëm në vende të tilla ku ka mbetur toka e paprekur dhe nuk i është nënshtruar fuqive shkatërruese të acideve. Poashtu brazdat e thella të përrrenjve me këndet e veta të thyera, që thujse tërësisht thahet gjatë verërave, janë lyer me ngjyrë nga mbeturinat e kripërave të acideve.

Kjo strukturë e ndryshueshme e sipërfaqës tokësore bëhet edhe më e dukshme për shkak të faqeve të rrëpirta të vargmaleve rrethuese.

Pasi të ketë menduar një çast lidhur me këtë ambient të pazakonshëm, që i nënshtrohet reaksioneve kimike dhe marrëdhënieve atmosferike, vizitori i cili do të jetë për herë të parë këtu në një farë mënyre do të zgjidhë lëmshin e ndjenjave kontradiktore, që ta shprehë çudinë e tij në mënyrën e vet, që zakonisht varet nga profesioni që ka.

Një bari do të murmuriste vetë më vete: "As delja që kënaqet me pak nuk do të kish mundur të gjejë një fije bari për ta ngrënë, e aq më pak një lopë."

E po të ishte murator, vizitori do t'i merrte dy gurë e t'i godiste me njëri-tjetrin dhe do të shihte se si ato thërmohen e i bien para këmbëve, dhe do të mblidhte fytyrën e do të thërriste: “Gur të këtille nuk mund të përdoren për ndërtimtari. Madje as gëlqere s'mund të përfitohet prej tyre.”

Kurse një gjeolog do të shprehej në mënyrë entuziaste: “Sa më e zyrtë të duket suprina, aq më e begatë do të jetë nëntoka.” Ai do të aludonte te bakri, i cili poashtu përmban një pjesë ari.

Një specialist për çështje policore që në shikim të parë të kësaj grope, që duket sikur është hapur nga një ekskavator gjigant, do të kishte një vlerësim të qartë: “Një burg i krijuar nga natyra.”

Duket sikur disa specialistë të dy kategorive të fundit bashkërisht kanë nxjerrë përfundimet e tyre e të cilat më pas kanë dhënë shkak për vendimin fatal të qeverisë që në këtë vend, në verë të vitit 1968, të fillojë ngritja e një kampi për punën e rëndë të detyruar, e dedikuar për të burgosurit politikë.

Përderisa më parë sipërfaqja tokësore e atdheut ujitej me djersë e me gjak prej një ushtrie me koka të rruara – viktima të regjimit komunist, erdhi koha që nëntoka tash të kërkonte hakmarrje. Numrit të kampeve të përfolura për punë të detyruar dhe shtëpive ndëshkuese iu shtuan edhe shumë të tjera. Përveç emrave si Maliq, Tërbuf, Beden, Zadrime, Gjrokastër, Burrel, Rinas, Kuçovë, Fier, Fushë-Krujë, Laç, Tiranë, Elbasan, Skroftinë, Vlorë e të tjera, u shtua edhe zgafella e tmerrshme e Spaçit, që më vonë u bë edhe kamp i të njëjtit lloj.

Të gjitha këto vende të papërshtatshme për jetë u furnizuan me kontingjente të kundërshtarëve politik të regjimit komunist në Tiranë.

Me Spaçin fillon një epokë e re e shfrytëzimit nëntokësor të të burgosurve politikë, jetët e të cilëve Kryesia e kampeve dhe e burgjeve në kuadër të Ministrisë së Brendshme i llogariste sipas numrit të karrocave të ngarkuara me mineral.

Çdo fillim është i vështirë, kurse puna e detyruar në një zgafellë, duke pasur parsysh kushtet në të cilat jetonin të burgosurit politik, kishte kuptimin e një sistemi të tërë të problemeve të reja, sistem që krijonte një sërë vështirësish.

Në vazhdimësi do të detyroheshin të punonin me mungesë të plotë të dritës së diellit, e cila do të ndikonte në aspektin shëndetësor në organizëm. Do të thithnin ajrin nga kompresorët, ajër që ishte një përzierje si një koktel i vërtetë gasrash, tymrash, avujsh dhe kundërmimesh të rënda të minjve të ngordhur, ndyrësirave dhe mbeturinave në zgafellë.

Gjatë 24 orëve, pa pushim, detonoheshin mijëra ton dinamit poshtë në zgafella në tri ndërrimet. Tymi prej llambave karabite, edhe pse me modesti, ndikonte në papastërtinë e përgjithshme të ajrit, që thithej në vendet e punës. Pellgjet e shumta me ujë e palëvizshëm e të ndotur, që nuk kishin asfarë lidhje me kanalet, ndikonte me avujt e vet në papastërtinë e ajrit. Kundërmimi i fuqishëm shkaktonte sëmundje dhe vjellje tek ata që për herë të parë vinin këtu në zgafellë, e cila kishte një gjendje mesjetare. Mushkëritë e të burgosurve, herët a vonë, do të binin viktimë për mykozë, pasi që kishin thithur ajër të këtille në luftën e ashpër për një ekzistencë të mundimshme, ekzistencë e cila mund të ruhej vetëm duke iu falënderuar shpresës.

Në ato vende pune ku gërmohej piriti, temperatura gjatë tërë kohës ishte ndërmjet 35°C dhe 40°C, nga lumenjtë nëntokësor vazhdimisht pikonte ujë me përmbajtje sulfurike dhe binte në trupat gjysmë të zhveshur të të burgosurve. Acidi digjte lëkuren dhe shkaktonte plagë të reja, e kjo e bënte veshjen dhe zhveshjen e rrobave një torturë për të burgosurit si në vendin e punës ashtu edhe në birucat e fjetjes.

Kushtet e punës në përgjithësi në zgafellë ishin të nivelit të mesjetës. Norma e punës, që realizohej ditën e natën (varësisht nga ndërrimet) me të rëna dhe rrahje nga policët,

bënte që mjetet e mbrojtjes teknike në vend të punës të mbeteshin vetëm në letër, në shënimet që personeli i mbante sa për formalitet. Të burgosurve nuk u lejohej kurrë të punonin sipas rregullave të mbrojtjes në vendin e punës, madje as atëherë kur s'kalonte më shumë se ndonjë orë pas ndonjë rasti vdekjeje në punë. Pajisjet që do të duheshin për kushtet normale të punës (binarë, vinç-ura etj.) leleshin në sektorë të tjerë, ku punëtorët e lirë punonin, kurse mungesat e mëdha që ishin në Spaç për shkak të mungesës materiale "kompletoheshin" me policët. Në këtë ambient makabër i burgosuri ishte ai që e kishte vlerën më të vogël dhe ai duhej të paguante për të gjitha dëmet, si pala përherë më e vuajtur në luftën e ashpër midis dhunës dhe drejtësisë.

Policët ishin përzgjedhur sipas drejtimeve speciale. Të gjithë këta njerëz në uniformë personifikonin padijen primitive dhe varfërinë kronike, që e karakterizonte këtë rrethinë të egër e të prapambetur. Uniforma u jepte këtyre njerëzve një mundësi, iknin nga varfëria ekstreme e fshatarëve kooperativistë, u jepte atyre ushqim dhe furnizim vjetor me veshmbathje, një pagë që kurrë nuk do të mund ta imagjinonin, privilegjin për të marrë banesë familjare në vendbanimin më të afërm e, krahas kësaj, edhe një punësim të përshtatshëm për gratë. Fëmijët e tyre shpejt do të përfitonin bursa shtetërore studentësh, për shkak se baballarët ishin të punësuar në kuadër të sektorit të Ministrisë së Brendshme. Të vetëkënaqur tej mase ata jetonin, sidomos në fillim, si në një ëndërr, meqë u kishin ikur racioneve me bukën prej misri dhe ushqim tjetër të varfër. E kur u thoshin atyre se ata njerëz me koka të rruara e të veshur me të murme ishin armiq të regjimit në fuqi, ata këtë e interpretonin sipas interesit të tyre personal: "Ata duan të na i marrin të gjitha ato të mira që na i ka dhënë pushteti!". Këto mendime i bënë aq agresivë sa që ndonjëherë nevojitej ndërhyrja e ndonjë eprori të komandës për t'i vënë fre shpërthimit vullkanik të "patriotizmit" të tyre. Joshjen që paraqiste përfitimi material e kishin marrë ata si frymëzim prej punës së verbër shtypëse të makinerisë shtetërore.

Revolta në Spaç në maj 1973

Duke pasur parasysh këtë shtypje të tmerrshme dhe mbikqyrjen ekstreme që shoqëria e Enver Hoxhës ushtronte ndaj të gjithë nënshtetasve, del se është një kurajë e jashtëzakonshme ajo që të burgosurit në Spaç ia arritën ta trondisin regjimin përmes një revolte, e cila sigurisht që u shua, por që megjithatë do të mbetet e paharruar si një ndër ngjarjet më të mëdha në historinë e Shqipërisë. Për autorin e këtij shkrimi, revolta e Spaçit me konsekuencat veta të ashpra mund të krahasohet me kryengritjen e Skënderbeut kundër sulltanit më 1443 ose Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë në Vlorë më 1912. Të tri këto ngjarje kanë të përbashkët faktin se mundësitë për sukses ishin shumë të vogla, por vendosmëria i mposhti të gjitha hezitimet. Në paraqitjen e mëposhtme do të hasim në një heroizëm të vërtetë.

Për këtë revoltë ka një sasi jo të paktë materialesh të publikuara. Unë kam pasur në dispozicion tre përshkrime nga ish të burgosur: Mehet Isai, i cili citohet nga Agim Musta në veprën e tij të sipërpërmendur, Agim Hamiti, përshkrimi i të cilit gjendet në një fragment të librit "Shqipëria – Zgjim i dhembshëm" (Tirana 1991) dhe së fundi Bedri Myftari në gazetën "Kosova", 1 shtator 1991. Këto përshkrime kanë shumëçka të përbashkët, por ai i Agim Hamitit është më i miri. Ai u transferua në Spaç në vitin 1978, që domethënë se nuk ishte dëshmitar okular i revoltës sikurse dy të tjerët. Jam përcaktuar që të përmbledhë të tria këto përshkrime në një të vetëm.

Në kohën e revoltës numri i të burgosurve në këtë ferr të vërtetë ishte mbi 1000. Dy muaj para shpërthimit të revoltës më 21 maj 1973, të burgosurit e hartuan një plan. Së pari u realizua aksioni i sabotimit të punës, përmes së cilës nuk u përmbush plani i mihjes së bakrit dhe piritit. Si pasojë, u mbushën birucat e izolimit me të internuar.

Bënte të ftohët sa që temperatura gjatë netëve në mars zbriste ndonjëherë edhe nën - 20°C. Revolta filloi atëherë kur 450 punëtorët e ndërrimit të parë duhej të shkonin në punë. Zef Pali ishte mbajtur një muaj në birucën e izolimit për refuzim të punës. Kur gardiani nuk e liroi Zefin, ai provoi të arratisesh, por u kap. Eprori dhe polici kujdestar i Sigurimit filluan ta maltertojnë atë. Qeni i burgut, i dresuar nga i burgosuri Fiqiri Muhaj, iu sul njeriut të Sigurimit. Të burgosurit u turrën dhe përleshjet filluan. Njëkohësisht, i burgosuri trim e guximtar Hulësi Pashollari me një çelës anglez ia arriti t'i hapte dyert e 12 birucave të izolimit dhe t'i lirojë shokët e vet. Gardianët dhe policët u rrahën mirë dhe u nxorën jashtë kampit. Komandanti i kampit shtihej sikur donte të bashkëpunonte dhe tentonte të ndalte revoltën përmes bisedës dhe kompromisit, por të burgosurit nuk u mashtruan dhe e nxorën jashtë. Të burgosurit mbetën zotër të burgut.

Një flamur u sajua; në të u vizatua shqipja dykrenare, por pa yllin sipër saj. E kuqja rrethëqark shqiponjës ishte lyer me gjakun e të burgosurve. Në ndërtesën kryesore të burgut u ngrit flamuri nga një ballkon tre kat sipër tokës. Për kryengritësit ky ishte një çast i madh dhe i prekshëm. Ata thirrnin: Poshtë diktatura! Poshtë Enver Hoxha!

Për tri ditë me radhë vazhdoi revolta. Gjatë netëve, armiku ngriti reflektorë të mëdhenj dhe ushtarët që e kishin rrethuar kampin nisën të shtinin me armë automatike dhe me mitraloz. Të burgosurit u apelonin ushtarëve:

- Ushtarë! Mos na gjuani! Ne jemi vëllezërit tuaj! Armët drejtojini kundër regjimit në Tiranë!

Përforcimet me armatim të rëndë erdhën nga regjimenti i Burrelit.

Ditën e dytë filloi beteja vendimtare. Nga helikopterët u lëshuan snajperistë në kamp, rreth tetëqind sosh. Udhëheqja e burgut e kishte ndërprerë furnizimin e kampit me ujë, energji elektrike dhe ushqim. Donin që t'i mposhtinin me anë të urisë. Më në fund, në ditën e tretë, u mposht revolta nga fuqia e pushtetit. Katër kryengritës u dënuan me vdekje dhe u ekzekutuan: Hajri Pashaj, Dervish Bejko, Pal Zefi dhe Skënder Daja. Jo më pak se 86 të burgosurve të tjerë ju është zgjatur dënimi me gjithsej 1400 vjet! Edhe qeni i burgut u dënua me vdekje dhe u var! Por qeni, para se të ngordhte, edhe një herë e tregoi përkatësinë e vet klasore, sepse e kafshoi specialistin për qen, kapitenin Ndue, thotë Agim Hamiti, me humorin e tij të zi, i cili kthehet në një frymëzim për jetën në çaste të vështira... Ekzekutimi i qenit, më duket mua se i jep një "shkëlqim" unikat diktaturës së proletarietit dhe do të duhej, me të drejtë, t'i kushtohej një kapitull në kujtimet e Enverit dhe historisë së Partisë, me një titull adekuat: "Si pushteti popullor pa asnjë hamendje asgjëson armiqtë e popullit".

SHQIPËRIA PREJ KOMUNIZMIT DERI TE POSTKOMUNIZMI

Evropë – ç'mundësi u ke ofruar shqiptarëve?

Ato paraqitje të shkurtëra që bëmë lidhur me fatkeqësitë që i goditën njerëzit të shenjuar si "armiq të popullit" në Shqipërinë e Enver Hoxhës, dëshmojnë për një regjim të fortë, i cili e mbante vazhdimisht të mbërthyer me totalitarizëm tërë shoqërinë. Një faktor vendimtar ka qenë dobësia e vendit dhe ndjeshmëria në të gjitha fushat, një gjendje që e kishte gjenezën te paaftësia e Fuqive të Mëdha dhe mungesa e interesimit për të krijuar mundësi ekzistenciale për një Shqipëri demokratike. Rivaliteti dhe pazarllëqet e Fuqive të Mëdha krijuan në fillim të shekullit të XX një Shqipëri, të cilës i mungonin parakushtet më të rëndësishme për zhvillim ekonomik e social. Nga fakti se treva të mëdha të banuara me shqiptarë mbetën nën Jugosllavi dhe Greqi u krijua një traumë nacionale, pasojat e të cilës, edhe në këtë çast shkrimi, na e kujtojnë problemin ende të pazgjidhur të Kosovës. Ato treva të banuara nga shqiptarët, të cilat kishin mundësitë më të mira për bujqësi dhe për nxjerrjen e mineraleve, u krasitën nga trangu i atdheut dhe përfunduan nën Serbi, pra në Jugosllavi. Problemi me shqiptarët në veriun e Greqisë "u zgjidh" në përfundim të luftës më 1945 përmes dëbimit të shumicës së tyre për në Shqipëri me motivimin se ata kishin përkrahur armiqtë e Greqisë gjatë luftës. Ata që mbetën u penguan me metoda të egra të kultivonin etnicitetin e tyre. Sipas muzikologes Birthe Trærup, e cila më ka treguar se më 1959, kur ajo kishte bërë inçizimin e këngëve dhe vallëzimeve të shqiptarët në Greqi, atyre u qe ndaluar t'i këndonin këngët e tyre në shqip. Frika e organeve greke për lëvizje etnike të shqiptarët, turqit dhe maqedonët, që jetonin në Greqi, është çështje e njohur (për ata që janë të interesuar për këtë). Është interesante se opinioni botëror ka treguar interesim më të madh për qëndrimet e Turqisë kundër kurdëve dhe sirianëve, megjithëse Greqia është mëkatari më i madh sa i përket shtypjes së minoriteteve. Dhe në emër të sinqeritetit duhet pranuar se shqiptarët në ish Jugosllavi, përkundër gjithë vuajtjeve që ajo u ka shkaktuar, kanë pasur megjithatë më tepër hapësirë etnike se sa vëllezërit e tyre fatkeq në Greqi!

Shqipëria si shtet me problemet e veta enorme sociale, ekonomike e kulturore definitivisht ishte lënë në rrugicat e Evropës. Nuk ishte thuajse aspak e papritur kur Italia në pranverën e vitit 1939 vendosi të aneksonte Shqipërinë, e që u bë pa mund të madh, pasi që mungonin parakushtet për rezistencë.

Kur komunistët shqiptarë filluan të bëjnë planet për të marrë pushtetin në vend me armë në duar, ishin vetëm një grusht njerëzish që dinin diçka për ideologjinë dhe aplikimin e saj praktik në Bashkimin Sovjetik. Krejt çka ata shihnin ishte një zgjidhje radikale për të krijuar një shoqëri krejt tjetër nga ajo pararendëse, pasi që demokracia perëndimore gjithnjë i kishte lënë në baltë. Por ashtu të dobët sikurse ishin ata duhej të mbështeteshin te fuqitë e jashtme, para se gjithash te komunistët jugosllavë dhe në radhë të dytë te Bashkimi Sovjetik. Lufta e komunistëve shqiptarë u fuqizua bashkë me rrjedhën e ngjarjeve në Luftën e Dytë Botërore; gjatë vitit 1943 dukej krejt qartë se Fuqitë e Boshtit do të humbnin luftën. Por ata që në lëvizjen partizane ishin më të vetëdijshëm lidhur me pushtetin, para se gjithash Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu, e dinin se për ndërtimin e shoqërisë socialiste nuk mund t'u besonin aleatëve perëndimorë. Anglia dhe SHBA e mbronin kapitalizmin dhe demokracinë. Komunistët shqiptarë gjykuan se nuk kishte rrethana për demokraci borgjeze në Shqipëri dhe ajo nuk u shkante as edhe planeve të tyre – as sa i përket kthesës së ardhshme radikale shoqërore e as për qëndrimin e tyre ndaj pushtetit. Jo, komunizmi duhej të ishte sistemi shoqëror në Shqipëri. Mirëpo kjo, sikurse e kam thënë në këtë libër, qe krevat i Prokrustit për popullin shqiptar. Shoqëria u ndërtua pas vitit 1944 sipas shembëlltyrës

sovjetike, e cila në kontekstin shqiptar funksiononte afërsisht si një vidë druri në një pjesë metalike.

Ndërtimi i një shoqërie – dhe dilema mbi detyrimin apo lirinë

Nevoja për ndërtimin e një shoqërie duke u nisur nga mundësitë ekzistonte, por nuk ishte vendimtare. Më e rëndësishmja ishte siguria e aparatit shtetëror dhe inkorporimi i qytetarëve në një sistem, me një udhëheqje të vetme, me një drejtim, pra monizmi. Shqipëria e vjetër ishte një shoqëri feudale me një mozaik fshatrash dhe qytetesh, me dallime të mëdha në strukturë dhe në jetën shoqërore midis pjesëve të ndryshme të vendit, por me prapambetje ekonomike dhe sociale dhe me një ndërtim familjar patriarkal si një karakteristikë e përbashkët. Ndryshimi i kësaj strukture nënkuptonte një punë të gjatë dhe durimplotë me ndikime, trysni dhe sipas nevojës edhe me përdorim të dhunës. Kolektivizimi i bujqësisë u krye hap pas hapi dhe me flijime të mëdha. Duhet theksuar se ky proces u krye thjesht përmes detyrimit dhe kurrë nuk ka qenë i pëlqyer nga ata që janë prekur nga ajo direkt – fshatarët. Dhe sikurse e kemi përmendur edhe më parë, përpjekja në fillim të viteve të 80-ta për ta kolektivizuar fshatarësinë me dhunë shkaktoi një zemërim të paparë të fshatarëve të kolektivizuar. Përgjigja e tyre ishte kasaphanja masive e bagëtive, gjë që çoi në një mungesë të gjatë të mishit e të qumështit në vend.

Përveç krimeve personale të Enver Hoxhës me asgjësimin e kundërshtarëve realë apo fiktivë dhe karakteristikës së tij eventuale psikopatike, me një ushtrim personal të pushtetit që e deformoi shoqërinë dhe e nxiti një kult grotesk personal, ka shumë shkaqe të tjera të cilat bënë që punët të shkojnë ashtu sikurse shkuan. Hoxha kishte nevojë për armiq dhe kurbanë për të përforcuar pushtetin e vet. Ai shkaktoi një psikozë që bazohej në atë se vendi ishte i rrethuar vetëm nga armiq, se miqtë e dikurshëm ishin shndërruar në armiq dhe se vetëm uniteti rreth vijës së partisë (domethënë politikës së tij) mund të shpëtonte Shqipërinë. Është vështirë për ta ditur nëse ai vetë i besonte mundësisë së krijimit të një bashkimi të popullit dhe të një ardhmërie të mirë. Mirëpo duket qartë se ai me të gjitha mjetet e mundshme kujdesej për ruajtjen e pushtetit të tij. Por me sa duket Enver Hoxha udhëhoq edhe nga ideali (apo vetëmashtrimi?) dhe, sikurse e kam përmendur edhe më parë, ai është një njeri kompleks dhe i zorshëm për t'u vlerësuar. Zhvillimin e Shqipërisë ai e keqkuptoi esencialisht në një pikë: Frika e ruan vreshtën, por vetëm për aq kohë sa njeriu e di se, po ta fusë dorën në vreshtë, shkopi mund t'ia zbusë shpinën! E tërë jeta e vendit ishte ngritur mbi themelet e frikës (Shërbimi i Sigurimit, informatorët, dogmat politiko-ideologjike, kontrolli, dënimi në formë internimi apo burgosja e madje edhe në formë ekzekutimi), dhe të urrejtjes (lufta e klasave, persekutimi ndaj armiqve të supozuar). Se në fillim shoqëria nuk do të kishte funksionuar me metoda ekskluzive demokratike, poashtu është e qartë. Mirëpo, nuk mund të ndërtohet një shoqëri pozitive me njerëz të vetëdijshëm të ngritur mbi një themel të vetëm, ku dyshimi është baza e shoqërisë. Falsiteti ishte i dukshëm ngase, në një rënë anë, shoqëria donte të ndërtonte bujarinë dhe një frymë kolektive e, në anën tjetër, njëkohësisht aplikonte aq dënime të rënda dhe metoda rigoroze të kontrollit.

Gazetari polak Ryshard Kapushcinski ka lënë një të dhënë mahnitëse në librin e tij "Ebony"/"Zezakët", që për bazë ka vitet e tija të shumëta të udhëtimit dhe veprimtarisë gazetareske në Afrikë. Gjatë regjimit gjakpirës të Mengistus në Etiopi shumë akademikë dhe studentë në Adis Abeba ishin ose maoistë ose enveristë. Kur u bë prishja mes Shqipërisë dhe Kinës në verën e vitit 1978 filluan enveristët t'i ndiqnin maoistët nëpër rrugë dhe gjaku u derdh rrëke!

Pikërisht në këtë kohë unë isha në Shqipëri dhe mund t'ju sigurojë se te shqiptarët gjithçka ishte e qetë. Sigurisht që kishte një shqetësim, mbaheshin mbledhje në vende

pune për të shtuar veprimtarinë. Frika ishte se mos imperialistët dhe socialimperialistët (d.m.th. amerikanët dhe rusët) do të kujdeseshin për ta shfrytëzuar situatën. Natyrisht, kjo ishte edhe një rrugë e partisë (dhe e Enver Hoxhës) në përpjekjet e vazhdueshme për të ngulur dhe përforcuar qëndrimin e tyre në shoqëri; dhe kjo përpjekje ishte çuar deri në fund. Porse ndonjë grup apo individ prokinez thuajse nuk kishte fare ndër shqiptarët. Vetëm në Etiopinë e largët kjo ngjarje politike do të kishte për pasojë gjakderdhjen.

Sado groteske kjo të duket, edhe më interesante është fakti se kishte aq shumë evropërimorë që i "hëngrën" mësimet e Enver Hoxhës. Ithtarët e tillë, mund të thuhet, përbënin një bërthamë të fortë njerëzish që e donin politikën e Stalinit dhe që mendonin se një diktaturë e fortë ishte e vetmja mundësi për t'i qëruar hesapet me shtypjen imperialiste dhe kapitaliste. Mendime të ngjashme ka edhe sot në mesin e elementëve destruktivë në luftën kundër globalizimit, ata që thyen dritare dhe gjuajtën gurë mbi policët në Goteburg dhe Genua. Lejohet që qëllimi – çlirimi i popullit – të shenjtërojë mjetin. Unë mendoj se është shqetësuese me njerëzit të cilët besojnë se lumturia arrihet në fundin e një rruge, e cila kufizohet nga ndërtesa të rrënuara dhe me gërmadha kufomash. A nuk janë këta individë, së paku, të ngjashëm, por edhe mendjengushtë, si cinikët e liberalizmit tregtar?

E, megjithatë, na duhet të kujtojmë se shumë nga ne që kemi mbështetur Shqipërinë socialiste e kemi bërë këtë si një lloj proteste kundër bllokut të Fuqive të Mëdha. Ne kemi parë gabime dhe mungesa në shoqërinë shqiptare – raportet më të pakëndshme të disa mediave ne i besonim se ishin propagandë antikomuniste; por ne gëzoheshim se kishte një shtet në Evropë, i cili kishte guximin të ecte në një rrugë tjetër, të ndërtonte një shoqëri të veten pa marrë urdhëra nga ndokush tjetër. Me siguri ka shumë që edhe sot duan një shoqëri të tillë, vetëm se të ngritur mbi bindjen demokratike në vend të detyrimit monolit. Por armiku është i fortë, apo jo shokë, dhe cili shtet sot guxon t'i kundërvihet "tregut"? Të gjithë hedhin vallen, përveç diktaturave obskurantiste, si ajo e Sadam Huseinit në Irak apo ajo në Korenë Veriore; mirëpo këto shtete, si shembuj të pavarësisë e të aspiratës për liri nuk hyjnë asgjë në punë...

Shumë nga gabimet dhe krimet që janë bërë në Shqipëri mund të kuptohen nga fakti se ndodheshin situata të papërshtatshme dhe ekstreme. Sociologja Marion Kloep lidhur me këtë, në një raport nga Shqipëria më 1991, shkruan: "Cili kapiten, anija e të cilit ndodhet në furtunë, do të organizonte votim se ç'kurs duhet të ndiqet?". E kur gjërat nisnin të rrokullisen, është krejt e lehtë të merren masa detyrimi "për shkaqe sigurie" edhe atëherë kur do të mund të përdroreshin metoda demokratike; kështu ndodhi izolimi nga populli që më në fund – dhe kjo duket të ketë qenë rasti me Enver Hoxhën – të mbetesh i rrethuar nga lajkatarë injorantë, mendon Marion Kloep. Dhe në vlerësimin e saj ka një pjesë të mirë të së vërtetës.

Marion Kloep mendon se sistemi dhe partia e kanë minuar ardhmërinë përmes një fryme patriarkale duke përndjekur familjeve të tëra, jeta e të cilave shpesh shkatërrohej, dhe në zemrat e të cilave është mbëltuar një zemërim i papajtueshëm kundër udhëheqjes dhe sistemit. Nuk lejohej kurrfarë veprimtarie e pavarur rinore, kurrfarë pune konstruktive kulturore, por vetëm fraza dhe parulla.

Gjithnjë ka njerëz të cilët e kuptojnë se si mund të shfrytëzohet një situatë, e kjo vlen po aq shumë për burokratët në Shqipëri sa për shitblerës aksionesh në Suedi. Shumë funksionarë partie e shfrytëzuan mungesën e debatit të hapur në shoqëri për të pasuruar vetveten, në të shumtën e herave përmes vjedhjes së pastër të pasurisë së përgjithshme, duke rregulluar kushte të mira për të afërmit e tyre. Ata kishin zhvilluar edhe një sistem të mbrojtjes: ua bënin të qartë çdo njërit, që mund të mendohej se kishte gjasa t'i sulmonte, se kjo do t'i dilte më së keqi atij vetë.

Në raportin e saj Marion Kloep përmend shumë vendime të pamenda, dhe përveç politikës katastrofale të bujqësisë të cekur më sipër, ajo kritikon projektin enorm për të mbuluar vendin me mijëra bunkerë pakashumë të pavlerë, në kohën kur këto para duheshin për të plotësuar mungesën e madhe të banesave. Ajo që Marion Kloep, me këndvështrimin e saj të majtë e nga jashtë, mbase nuk donte ta shihte mirëfilli, ishin pasojat që ka lënë shoqëria moniste përmes mbërthimit totalitar në trurin e njerëzve. Në një farë mënyre njerëzit janë privuar nga shpirti i tyre, dhe ata që kanë mundur t'i japin shprehje se çka kjo donte të thoshte – një pjesë shumë e vogël e vetëdijshme e shqiptarëve – kanë dëshmuar për vakuumin moral në të cilin ata kanë jetuar, gjendje kjo e cila vetëm sa ishte përkeqësuar pas rënies së regjimit komunist.

Për njerëzit pa pretendime intelektuale, ata që vetëm donin të vegjetonin ose t'i shfrytëzonin ato mundësi që ofroheshin, regjimi i Enver Hoxhës do të ketë pasur shumë të mira për ta, me gjithë varfërinë dhe kërcënimin se ata edhe pa fajin e tyre mund të binin në fatkeqësi politike. E po qe se do të heshtnin dhe të kujdeseshin, u sigurohej punë, arsimim i mirë për fëmijët, shërbim mjekësor primitiv por funksional, si dhe një sërë privilegjesh të tjera shoqërore. Kjo, në krahasim me shoqërinë e vjetër, paraqiste një përparim të madh. Kërkesa për demokraci nuk mund të jetë tepër e fuqishme prej atyre që kurrë nuk e kanë përjetuar atë dhe kurrë nuk e kanë humbur atë.

E megjithatë ka arsye të shtrohet pyetja: Çfarë alternative u dha shqiptarëve Evropa dhe bota? Po të kishin fituar shqiptarët një parlamentarizëm perëndimor më 1945, por me të njëjtit kufinj si më parë, rrugëdalja do të ishte e qartë: tensionet ekonomike midis pronarëve të tokës dhe fshatarëve do të ishin rritur, papunësia do të kishte shkaktuar emigracion dhe varfërim regjional, do të ishte rritur vartësia nga jashtë dhe kur kundërthëniet të kishin arritur nivele të rrezikshme do të kishte ardhur deri te një puç ushtarak në stil të ngjashëm me atë që rëndom ka ndodhur me "republikat-banane" në Amerikën Latine. Një diktaturë vendore dhe një numër i vogël kompanish amerikane dhe evropiane do të kishin diktuar zhvillimin në një Shqipëri të tillë. E po, ç'bëre ti Evropë për shqiptarët? Ç'bëre më 1913, 1915, 1920 dhe më 1939 dhe në planifikimin e Evropës së re në Jaltë e më pas? S'ua vare fare shqiptarëve, Evropë! Vendi i shqiptarëve ishte aq i vogël, aq piktoresk me orientalizmin e tyre, sa që meritonte të përqueshej! Dhe kur e qeshura mori fund, ju ua kthyet sërish shpinën shqiptarëve. Që më qafë u ra Enver Hoxha ishte gabim i prapambeturisë së tyre....

A ishte gabimi i shqiptarëve që Italia fashiste dhe Gjermania naziste krijuan një Shqipëri kryesisht në kufijtë e saj etnikë gjatë luftës? Për shkak se kishin qenë fuqi të gabuara që kishin vepruar në të mirë të shqiptarëve, duhej që këto të "mira" (kufijtë etnikë) të ndërpriteshin pas luftës. E këtu ishte logjika komuniste – dhe kjo u gëlltit nga fuqitë perëndimore! Më 1999 NATO-ja sulmoi ish-Jugosllavinë. Asokohe në vetëdijen e qarqeve të ndryshme perëndimore nuk ekzistonin vrasjet dhe shkatërrimet serbe, por kishte vetëm indinjatë se përse NATO-ja kishte sulmuar një shtet sovran dhe kishte kundërshtuar të pranonte të drejtën e këtij shteti që papengueshëm t'i mundonte e t'i dëbonte nënshtetasit e vet... Ky qëndrim absurd perëndimor ndaj Rusisë dhe përpjekjes pansllaviste i ngjanë dashurisë së një gruaje e cila e dashuron djallin për shkak të syve të tij të bukur...

SHEMBET DIKTATURA: SHQIPËRIA 1990-1991

Në pjesën e vonë të viteve të 1980-ta, u shfaqën shenjat e amullisë dhe rënia futet në skenën e shoqërisë shqiptare. Industria dhe minierat kishin ngelur me makineri dhe pajisje të tjera të vjetra e të konsumuara. Pjesa dërrmuese e kësaj teknike ishte e kohës kur Bashkimi Sovjetik dhe Kina ndihmuan në ndërtimin industrial të Shqipërisë, dhe mundësia për t'u pajisur me pjesë rezervë ishte e kufizuar – megjithëse një pjesë e prodhimit të tyre bëhej në vend. Mundësitë për ta përtërirë dhe zgjeruar industrinë ishin shumë të vogla; kapitali i domosdoshëm mungonte e kreditë e jashtme nga bota perëndimore ishin pamundësuar për shkaqe ideologjiko-politike. Edhe pse një lloj zgjerimi i tregut me vendet e Evropës Lindore u bë gjatë kësaj kohe, prapëseprapë gjendja ekonomike në Shqipëri ishte gjithnjë e më shqetësuese; e shtoji kësaj edhe thatësinë disavjeçare që e kaploi vendin e që shkaktoi probleme të furnizimit me gjëra ushqimore.

Sidoqoftë, vendimtare për fatin e sistemit të shoqërisë shqiptare do të jenë faktorët e jashtëm. Shqiptarët ishin mësuar të jetonin në kufinj urie, nevojat e tyre ishin të vogla, pasi që kurrë nuk kishin përjetuar një standard normal të jetesës evropiane. Barrë tepër të rënda u bënë rënia dhe kthimi pas, të cilat nuk mund të fshiheshin dot as nga parullat e zjarra politike. Por i tërë zhvillimi në Evropën Lindore, e në këtë kuadër në radhë të parë në Bashkimin Sovjetik, ku problemet ekonomike ishin në rrugë të një zhvillimi katastrofal, tregonin se ekonomisë së planifikuar socialiste po i afrohej fundit të saj në të gjitha shtetet e Evropës që për 50 vjet kishin jetuar në këto kushte. Shqipëria kishte ndjekur rrugën e vet specifike – për shkaqe ideologjike dhe realpolitike, mirëpo kur sistemi shoqëror u rrënuar në ato shtete prej të cilave tregu i Shqipërisë ishte i varur, atëherë nuk kishte më resurse të vazhdohej si më parë.

Udhëheqësit shqiptarë ishin të pushtuar nga doktrina e Enver Hoxhës dhe ata kishin ngelur në ato aksioma, të cilat nuk mund t'i thyenin. E njëherit u tregua se ajo doktrinë ku do të duhej t'i kishte bazat kryesore – doktrina mbi kapitalin njerëzor – ishte aq pak në harmoni sa me realitetin ekzistues - po aq me parimet tjera të ngurta. "Njeriu socialist" që sistemi shqiptar e kishte krijuar, ishte një njeri i cili jetonte edhe me detyrimin për të jetësuar dekretet e shoqërisë, por edhe me vullnetin e tij personal të shtypur për një jetë më të mirë. Rënia, korrupsioni, frazat shoqërore dhe gënjeshttrat e ngulfatnin tërë ndërgjegjshmërinë, bujarinë, vullnetin për flijim dhe unitetin që do të duhej për të ardhmen në një shoqëri tjetër nga ajo kapitaliste, që e dominonte botën. Shqiptarët u tjetërsuan gjithnjë më shumë, me një urrejtje të paqartë por në rritje ndaj sistemit, në të cilin detyroheshin të jetonin e që i kishte privuar nga e drejta për jetë personale. Ata ishin detyruar të bëheshin hipokritë, të pranonin vetëm me gjysmë goje sistemin shoqëror, por në realitet gjithnjë më të vetëdijsëm se ata kishin mbetur të vetmuar në botë.

Udhëheqësit shqiptarë u detyruan të shohin shenjat që tregonin se një ndryshim rrënjësor pritej në Evropën Lindore, ndryshim të cilit ata i frikësoheshin më së shumti, sepse rrezikonte sistemin që kishin ngritur dhe me këtë edhe pozicionin e tyre. Perestrojka e Mihajl Gorbaçovit, emigrimi masiv nga Gjermania Lindore nëpërmjet Hungarisë që çoi deri te rënia e murit të Berlinit në nëntor 1989, si dhe ngjarjet e përgjakshme në Rumani një muaj më pas, likuidimi i Çaushekut dhe i regjimit të tij, tregonte se nuk kishte ndonjë rrugë të kthimit pas – rrjedha e ndërrimeve nuk mund të ndalej.

Ajo që, në të njëjtën kohë, kishte ngjarë në Jugosllavi paraqiste rrezik të drejtpërdrejtë për Shqipërinë si shtet. Gjendja në Kosovë ishte eksplozive dhe Jugosllavia ndodhej para rrënimit të vet, por serbët që e kishin zakon të silleshin si të

ishin popull i zgjedhur, me çelësat e politikës dhe të fuqisë mbrojtëse në duart e tyre, nuk do ta lëshonin rastin pa e gllabëruar provincën shqiptare e cila për ta ishte "Zemra e Serbisë". Një luftë civile në Jugosllavi e cila do ta detyronte Shqipërinë të involvohej, ishte një mundësi të cilën të gjithë e llogarisnin.

E dhëna se trazirat në botë, edhe në fillim të viteve të 1990-ta, ende nuk kishin shprehur ndikimet e veta në shoqërinë shqiptare, duhet t'i atribuohet faktit se partia komuniste, Partia e Punës e Shqipërisë, kishte një dominancë shumë të fuqishme mbi funksionet e shoqërisë. Nuk kishte kurrfarë force të pavarur politike dhe sociale përveç Partisë. Enver Hoxha kishte krijuar një aparat, që sa i përket mbikqyrjes dhe kontrollit të jetës shoqërore ishte thujse total. Organi më i rëndësishëm i Partisë për të ruajtur pozicionin e vet pushtetar – shërbimi sekret Sigurimi – i kishte sytë e vet gjithkrah dhe vepronte shpesh me brutalitet të pamëshirshëm. Ai e bënte punën e ndyrë, me të cilën nuk donte të merrej politika zyrtare, ndërkohë që njerëzit e Sigurimit kishin një hapësirë të dukshme të veten për manovrim.

"Ne bëjmë gjithçka nën udhëheqjen e Partisë" nuk ishte vetëm parullë, po ishte një realitet tragjik. Bashkimet profesionale dhe organizata e masave Fronti Demokratik, të cilat kishin zyra në çdo lagje të qyteteve, nuk ishin asgjë tjetër përveçse krahë të zgjatur të Partisë. Veprimtaria e intelektualëve ishte tërësisht e rregulluar dhe e kufizuar nga diktati, që e kishte vënë në jetë Partia dhe që ishte një mendje sine qua non. Në art dhe letërsi realizmi socialist duhej të mbretëronte, ajo dhe absolutisht asgjë tjetër. Disidentët që u shfaqën, për shembull, në Çekoslovaki, Poloni e Bashkimin Sovjetik as që mund të imagjinoheshin në Shqipëri, siç jam munduar ta ilustroj në kapitujt e mëparshëm. Nga ato tekste mund të bindemi se ç'fatkeqësi i kishte katandisur ata që kishin provuar të ecnin në një rrugë të tillë.

Shumica e popullsisë shqiptare, fshatarët në kolektivat bujqësore dhe punëtorët industrialë, jetonin tërësisht të izoluar nga ngjarjet në botë. Ata që rrinin deri vonë zgjuar nëpër fshatra mundnin përmes radios e televizionit të merrnin tinëza një pjesë të informacionit nga jashtë, por një gjysmë shekulli përvojë tregonte se ishte rrezik jete të diskutoje gjëra të tilla me të tjerët. Kushtet e mjerueshme të jetës ishin realitet që i bënin njerëzit në heshtje të mallkonin fatin e tyre.

Prijsi i vendit – Ramiz Alia

Enver Hoxha ishte prindi i ashpër i shqiptarëve për më tepër se 40 vjet, deri në vdekjen e tij në vitin 1985. Që kur ishte themeluar Partia Komuniste e Shqipërisë në nëntor 1941 dhe tërë kohën, pa ndërprerje, kishte qenë udhëheqës. E drejtonte qeverinë shqiptare, e cila erdhi në pushtet pasi që gjermanët ishin dëbuar nga vendi në nëntor 1944, dhe kishte mbijetuar të gjitha ndryshimet dhe ndërrimet politike. Si rregull, ishte vetë ai i cili i kishte inskenuar dhe dirigjuar ato. Seriozisht i rrezikuar kishte qenë vetëm në dy raste: më 1947-1948 kur jugosllavët donin ta eliminonin atë dhe më 1956 kur ai thujse ishte larguar nga skena si pasojë e procesit të destalinizimit të nisur nga Krushqovi. Por me shkathtësi djallëzore dhe duke mos respektuar asgjë, ai qëndroi në shalë për aq kohë sa jetoi. Prandaj një shikëputje nga politika e tij nuk mund të pritej; e veja e tij, Nexhmije Hoxha, kishte një pozitë të fortë dhe ishte e lidhur me gardën konservatore në Byronë Politike dhe Komitetin Qendror.

Ramiz Alia e kishte marrë rolin e "princit trashëgimtar" të Enverit, pasi që Hysni Kapo kishte pësuar një vdekje të natyrshme më 1979 dhe "pretendenti tjetër i trashëgimisë" Mehmet Shehu më 1981 ishte ekzekutuar politikisht dhe kishte bërë vetëvrasje ose ishte mbytur (gjë që ende është e paqartë).

Dy ditë pas vdekjes së Enver Hoxhës u zgjodh Ramiz Alia sekretar i parë i Partisë së Punës së Shqipërisë, që domethënë se mori funksionet e diktatorit. Por asgjë më nuk do

të ishte si më parë, dhe mund të ironizohet lidhur me parullën më të njohur, të cilën besnikët e partisë e lakonin në të gjitha kontekstet e mundshme e të pamundshme: "Parti-Enver, jemi gati kurdoherë!". Së shpejti do të tregohej se një parullë tjetër për Ramiz Alinë do të mund të motivohej mirë, ashtu sikurse unë vetë e kam menduar gjatë ngjarjeve të atëhershme në Shqipëri, sikur të kthehej: "Parti-Ramiz, jemi gati në çdo krizë!". Se fati i takoi Ramiz Alisë që të zgjedhte midis alternativave, shumica prej të cilave dukeshin të pamundshme.

E kush ishte ky njeri i vogël, me pamjen e tij të butë dhe me sjellje pajtuese? Secili mund ta shihte se ai në shumë aspekte dallohej nga Enver Hoxha. Hoxha ishte i madh, sharmant, karizmatik, një tip aktori, i kujdesshëm në veshmbathje, por me një vulgaritet pas lustrës. Ramiz Alia linte përshtypje pedanti, pak i thinjur dhe pa karizmën e parardhësit, por modest dhe i arsyeshëm. Ndonjëherë do të vërehej ndonjë shenjë ashpërsie, që ai nuk kishte prirje ta tregonte. Ajo çka ai donte të tregonte ishte pamja e një personi të matur e të arsyeshëm, që gjithmonë e vinte logjikën në rend të parë. Por padyshim se sistemi që për gjysmë shekulli e kishte ngritur Enver Hoxha do të formësonte edhe këtë njeri, e ai sistem zor se mund të karakterizohet me fjalët "i matur e i arsyeshëm".

Ramiz Alia kishte një origjinë krejt tjetërfare krahasuar me gjithë udhëheqjen tjetër politike shqiptare. Ishte i lindur në Shkodër, në veri të Shqipërisë, më 1925, ndërkohë që pjesa dërrmuese e udhëheqësve komunistë vinte nga jugu i Shqipërisë. Një rrethanë tjetër interesante ishte se familja e Alisë kishte ardhur në Shkodër nga Kosova. Ramiz Alia iu bashkua Partisë Komuniste më 1943 dhe mori pjesë në luftën partizane, por jo në ndonjë pozitë udhëheqëse; kur lufta ishte në përfundim ai ishte në fakt ende i mitur. Veprimtaria e tij partiake ka qenë më së shumti e drejtuar në punën e të rinjve. Me rastin e Kongresit të parë të Partisë Komuniste të Shqipërisë më 1948 – atëherë kur Partia e ndërroi emrin në Partia e Punës e Shqipërisë – ai u zgjodh anëtar i Komitetit Qendror të Partisë. Pas studimeve universitare në Bashkimin Sovjetik u bë kandidat për Byronë Politike dhe më 1961 u caktua anëtar i barabartë i Byrosë Politike dhe njëkohësisht sekretar në Komitetin Qendror.

Maturia e Ramiz Alisë bëri të mundur mbijetimin e tij politik; ai ka mbajtur gjithmonë një profil të ulët në çështjet kontraverse, ndërkohë që ishte lojal e i dëgjueshëm i Enver Hoxhës. Tre vitet e fundit ai mori gjithnjë e më shumë funksione të tij në parti e në shoqëri. Kishte poashtu marrëdhënie të mira me gruan e Enverit, Nexhmijen, gjykimi i së cilës edhe publikisht e edhe në prapaskenë kishte rëndësi të madhe. Ai ishte teknokrat, porse kishte shprehur interesim për shumë aspekte të jetës shoqërore, duke përfshirë edhe kulturën, ku më 1972 kishte treguar një qëndrim të dukshëm liberal, qëndrim i cili nuk arriti të pengonte dimrin shpirtëror që kishte filluar më 1973 me të ashtuquajturën "fushatë kundër ndikimeve të huaja dhe qëndrimeve liberale".

Trashëgimia që Ramiz Alia mori nga Enver Hoxha qe: një vend në falimentim. Sikurse u përshkrua më sipër, karakteristika e përgjithshme ishte stagnimi dhe rënia. S'kishte vullnet për reforma në Byronë Politike dhe Komitetin Qendror, ku fjalën kryesore e kishte bërthama e fortë e ithtarëve të mbetur politik të Enver Hoxhës. Ishte një rreth i keq: po qe se reforma të mirëfillta do të aplikoheshin kjo donte të thoshte relacione dhe varësi nga bota e jashtme, çka do të rrezikonte sistemin e izoluar totalitar. E kryesorja për udhëheqjen politike ishte ruajtja e këtij sistemi, prandaj nuk kishte hapësirë për reforma. Në kujtimet e tij, Ramiz Alia ka përmendur problemin me elementët konservatorë brenda Byrosë Politike, por në realitet ai vetë ishte shumë më konservator se sa shtirej. Është thënë nga shumë vlerësues shqiptarë se pamja e një udhëheqësi dashamirës të reformave është e rreme – Ramiz Alia u hapi rrugë reformave

vetëm kur e kuptoi se ato ishin të pashmangshme. E tërë politika e tij tregon për përpjekjen që sa më gjatë ta ruajë pozicionin monopolist në shoqëri të Partisë së Punës së Shqipërisë. Me gjithë disa vrazhdësi të shëmtuara në biografinë e Alisë – ndër të tjera vrasjen e njerëzve që kalonin kufirin madje edhe në vitin 1990, për çka ai e kishte përgjegjësinë kryesore – duhet të pranohet se politika e Ramiz Alisë në tërësi bëri që gjakderdhja e panevojshme të shmanget. Një vijë e fortë do të kishte mundur të shkaktojë luftë të brendshme midis përkrahësve të Partisë dhe kundërshtarëve, e kjo do të sillte vuajtje të jashtëzakonshme për një popull edhe ashtu të goditur rëndë.

Bëhen të dukshme të çarat në sipërfaqen monolite

Viti 1990 filloi në mënyrë dramatike: në Shkodër kadetët ushtarakë qëlluan më 11 janar kundër turmës së demonstruesve, e cila kishte provuar ta rrëzonte përdhe statujën e Stalinit. Demonstrata kishte të bënte para se gjithash me mungesën e artikujve ushqimorë dhe nevojën për reforma. Edhe në pjesë të tjera të vendit u shfaqën pakënaqësi.

Gjendja në ekonomi ishte aq serioze, sa kontrolli i Partisë në jetën shoqërore nuk mund të vazhdonte më tutje. Brenda Frontit Demokratik u kërkua që të pushonte kontrolli i Partisë mbi gazetën e Frontit "Bashkimi". Studentët e Universitetit të Tiranës u angazhuan në diskutime të mëdha lidhur me ardhmërinë dhe një pjesë e shkencëtarëve, si historiani Arben Puto, morën pjesë në debat. Grupe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut filluan të krijohen. Shqipëria u zgjua nga letargjia e vet, dhe njerëzit i provonin kufijtë e hapësirës së tyre për manovrim në situatën e re, të ndikuar nga ngjarjet në botë.

Verën e vitit 1990 në Tiranë, kur studentët e liruar nga shkolla dhe të rinj të papunë bredhnin rrugëve, pra ishte ajo kohë kur të çarat e para të sipërfaqes monolite u bënë të dukshme. Ende mbretëronte një pasiguri e madhe se si Sigurimi, policët dhe armata do të sillshin, po qe se pakënaqësia popullore do të çonte deri në demonstrata serioze dhe trazira. Ajo që ndodhi, erdhi krejt papritmas: më 2 korrik rreth 400 veta, kryesisht të rinj të papunë, mësynë lagjen ku ndodheshin selitë diplomatike në Tiranë, që më parë ishte krejt e mbyllur për botën e jashtme, dhe pushtuan disa ndërtesa që u takonin ambasadave perëndimore. Numri i pushtuesve u rrit shpejt në 4500 veta. Fillet e kësaj ndodhie kurrë nuk janë qartësuar: a ishte ajo që ngjau një zhvillim spontan apo i planifikuar, por ajo që ndodhi tërhoqi vëmendjen e mediave në tërë botën. Përmbysjet në Evropën Lindore, pa asnjë dyshim, tashmë kishin arritur edhe Shqipërinë.

Në të njëjtën kohë, masa njerëzish të dëshpëruar nga provincat mësynë në drejtim të portit të Durrësit në detin Adriatik. Qëllimi i tyre ishte të hipnin në ndonjë anije dhe të dilnin në Itali.

Partia nuk e pranoi menjëherë humbjen e betejës. Një ditë pas pushtimit të ambasadave njerëzit u mobilizuan detyrimisht në një demonstratë masive me 100 000 pjesëmarrës në Sheshin Skënderbe në Tiranë; mirëpo kjo nuk ndryshoi asgjë.

Ismail Kadare në librin e tij "Nga një dhjetor në tjetrin" (Paris, 1991) tregon mbi ditën e dytë të Partisë dhe të shërbimit sekret. Qyteti i vogël Kavaja, që shtrihet afër detit Adriatik, me 30 000 banorë, u bë një çerdhe e kundërshtarëve të regjimit. Sigurimi bëri planin që ta thyejë frymën kryengritëse në Kavajë:

Dy kamioneta me sampistë, trupa speciale, dalin si të tërbuar nga një fshat i Durrësit. Ndalesën e parë e bëjnë në plazh të Golemit, që shtrihet midis Durrësit e Kavajës, ku zakonisht vijnë të bëjnë plazh kavajasit. Sulen si të marrë në plazh dhe godasin pushimtarët, iu shqyejnë grave rrobat e banjës, shajnë dhe fyejnë. Ndërsa viktimat janë ende të trullorur, sampistët hypin në kamione dhe sulen drejt Kavajës. Shpërthejnë nëpër rrugë duke thirrur: "Jemi bijtë e Enver Hoxhës!"; hyjnë nëpër kafe, godasin dhe

fyejnë klientët: ah, ju qenkeni kavajasit trima? Ha, ha, ha! Në prag të një shtëpie, vrasin një djalë të ri...

Ishte skenar klasik i një provokacioni, pas të cilit duhej të vinte masakra.

Por nuk shkoi ashtu sikurse që planifikuar, shkruan Kadareja: Kavaja e pranoi sfidën. Të tërbuar njerëzit iu sulën sampistëve të urryer, i goditën, i shqyen, i bënë të zhduken nga faqja dheut. Por tërbimi i qytetarëve (ashtu siç që llogaritur nga projektuesit e masakrës) nuk u ndal. Ata iu sulen ndërtesës së Sigurimit e të Policisë, Komitetit të Partisë, vitrinave të dyqaneve.

Kjo do të mjaftonte si "dëshmi për kundërrevolucion", për të urdhëruar ndërhyrjen e tanksave dhe për të fabrikuar një "komplot" me kontakte me armiqtë e brendshëm, agjentura të huaja, me CIA dhe NATO dhe gjithë tabloja...

Por gjithçka shkoi keq për Sigurimin. Pse? Sepse, i gjithë qyteti që ngritur më këmbë dhe si një njeri i vetëm – me komunistë, disidentë, nëpunës të gradave të ndryshme – u ngrit populli për Kavajën e vet. Thjesht, nuk kishte mundësi të viheshe kundër një qyteti të bashkuar!

Sigurisht se Alia, në një plenum të jashtëzakonshëm të Partisë më 6 korrik, do të akuzonte fuqitë e huaja kundërrevolucionare sikur ato qëndronin prapa ngjarjeve të kohëve të fundit. Kurrfarë faktesh nuk janë paraqitur as atëherë e as më pas si mbështetje për këtë akuzë. Pa dyshim se kishte një lloj interesi në Washington, Londër e Bon për të larguar qeverinë komuniste në Shqipëri, por është krejt i pabesueshëm ndonjë komplot apo planifikim nga jashtë. Në të vërtetë, perëndimi kishte frikë nga zhvillimet tepër të shpejta në Shqipëri, pasi e tërë gjendja në Ballkan ishte shumë e ndjeshme, veçanërisht për shkak të krizës në rritje në Kosovë. Fjalët e Alisë duhet të kuptohen më parë si justifikim në mungesë të ndonjë argumenti më të mirë. Madje edhe për një regjim si ai shqiptar do të ishte paksa absurd të thuhej se CIA e ka marrë pushtetin mbi shpirtat e tërë Kavajës!

Për Partinë, kjo që ndodhi, kishte domethënien e një krize të rëndë. Më 7 korrik, disa nga ata të vijës së fortë u detyruan të braktisnin Byronë Politike: Ministri i Punëve të Brendshme dhe Shefi i Sigurimit Simon Stefani, pastaj Manush Myftiu, Prokop Murra, Rita Marko dhe e veja e Hysni Kapos – Vito Kapo. Disa nuk pëlqeheshin nga populli. E kjo vlente në një shkallë edhe më të lartë për Lenka Çukon, e cila u detyrua të braktiste postin e vet si sekretare e Komitetit Qendror, një grua që kishte ecur rrugës së gjatë dhe që ishte e urryer në lidhje me qëndrimin e saj të pashpirtë përkitazi me "reformat" me anën e të cilave ishin goditur punëtorët e agrokulturës. Dhe ata që ishin përgjegjës të drejtpërdrejtë për provokimin në Kavajë, e paguan. Atje turpi ishte bërë nga eksceset sampiste. Muho Asllani, shefi i urryer i Komitetit të Partisë për rrethin e Durrësit, ku bënte pjesë Kavaja, u përjashtua. Së fundi u përjashtua edhe shefi i neveritshëm i Sigurimit Z. Ramizi. Edhe drejtori i përgjithshëm për organin policor D. Bengasi. I vetmi që mbeti ishte njeriu vërtet i errët, prokurori i përgjithshëm Arianit Çela. (Se me sa brutalitet ky ishte sjellë ndaj të burgosurve që ankoheshin e kemi treguar më parë.)

Por këto masa ishin tepër të vona që të mund të shpëtonin Partinë dhe Ramiz Alinë nga gjykimi i popullit. Ramiz Alia, përmes manovrimeve dhe zvarritjes së veprimit e kishte humbur shansin të hynte në histori. Por duhet theksuar se pozita e tij nuk ishte e lehtë.

Ngjarjet, të cilat do të vazhdonin, nxorën në shesh se të çarat ishin shtuar. Paaftësia për reforma të njëmendta u bë e dukshme. U bënë disa ndryshime në legjislacion për të zvogëluar krimet më flagrante kundër të drejtave njerëzore, si për shembull e drejta për demonstrata. Por në muajt që pasuan dy tendenca do të shkaktonin tendosje: në kohën kur fuqia e aparatit të dhunës po zvogëlohej, rriteshin tendencat për shpërthime të

dhunës anarkike. Dhe ky problem e ka karakterizuar zhvillimin në Shqipëri deri më tash: fuqia e rendit publik e ka humbur autoritetin, në të njëjtën kohë që njerëzit i zgjidhnin problemet që shfaqeshin duke e vënë veten në vendin e fuqisë së rendit. Në vend të dhunës së organizuar dhe të sanksionuar nga lart, erdhi dhuna spontane, e paparashikueshme dhe e pakontrolluar nga "poshtë". Pa fije dyshimi se një gjendje e tillë ishte edhe më e tmerrshme për popullatën se sa rrënimet e Shërbimit të egër të Sigurimit...

Preokupimi i Ramiz Alisë për mbajtjen e Partisë në pushtet do ta bëjë atë ta neglizhojë gjendjen ekonomike katastrofale në vend. Problemi i furnizimit me artikuj ushqimorë nëpër qytete u bë gjithnjë e më shqetësues, kurse fshatarët vidhnin bagëtinë nga kopetë kolektive ose për të krijuar kope private të tyre ose për t'i prerë ato për nevojat e veta për mish. Gjersa aparati shoqëror po rrënohej, shumë shqiptarë e shfrytëzuan rastin për të përvetësuar pronën e përbashkët për shfrytëzim privat, në kohën kur poashtu shumë raste vandalizmi filluan të shpreheshin, në shumë raste shpërthime të pakuptimta të hakmarrjes kundër asaj shoqërie të urryer: rrënimi i shkollave dhe spitaleve, që natyrisht ishte krejtësisht destruktive, kurse mund të kuptohet më lehtë vandalizmi që goditi institucionet partiake dhe të pushtetit shtetëror.

Më 10 nëntor 1990, Adil Çarçani, kryetar i Këshillit të Minsitrave të Shqipërisë, në një intervistë televizive deklaroi, ndër të tjera, se thatësira dhe rrethanat e tjera e kishin detyruar Shqipërinë të importonte artikuj ushqimor dhe energji elektrike. E ku mbeti bilanci tregtar? – pyesja veten në fletoren e shënimeve të mia.

Më 17 nëntor u njoftua se lutja e parë fetare e hapur pas 23 vitesh mbahej në Shqipëri, një meshë katolike me 5000 pjesëmarrës nga Shkodra. Më vonë kam mësuar se mesha ishte mbajtur nga padër Simon Jubani, i cili qe mbajtur në internim 26 vjet. Dënimi i qe rritur tetë herë për shkak se kishte pagëzuar fëmijë dhe kishte bërë veprime të tjera religjioze në kamp. Pas meshës, Jubani e disa të tjerë u arrestuan nga policia dhe u morën në pyetje, por ishin lëshuar pasi populli kishte protestuar. Përmes *Voice of America*, nga një inçizim manjetofonik, kam dëgjuar një pjesë të meshës. Në të, Jubani kishte folur për bashkëjetesë paqësore midis katolikëve dhe muslimanëve dhe për zgjidhje paqësore të konfliktit me përfaqësuesit e regjimit.

Më 5 dhjetor nëna Tereze e vizitoi Shqipërinë për herë të dytë. Ajo u pranua me ngrohtësi nga Ramiz Alia, i cili e quajti atë "Nëna Tereze e Shqipërisë". Ajo, ndër të tjera, vizitoi një çerdhe fëmijësh në Tiranë, të cilës i ishte vënë emri i saj.

Nis të thyhet monoliteti

Më 9 dhjetor agjencia e lajmeve suedeze TT lajmëroi se, sipas të dhënave diplomatike në Tiranë, ka pasur përleshje midis studentëve demonstrues dhe policëve në kryeqytetin shqiptar. Këto demonstrata shpejt u zhvilluan në një lëvizje të vetëdijshme për pluralizëm dhe studentët filluan të pushtonin universitetin, e në të njëjtën kohë një peticion me kërkesë për ndryshime të sistemit shoqëroro-politik u nënshkrua nga 5000 studentë dhe 8000 punëtorë e nëpunës. Në kohën kur studentët demonstرونin dhe sulmoheshin nga policët, Ramiz Alia mbajti një takim me një numër të caktuar intelektualësh të njohur për të shqyrtuar mundësitë e aplikimit të pluralizmit ideologjik. Në mesin e pjesëmarrësve në takimin me 50 intelektualët ishte edhe Ismail Kadare, Arben Puto, Gramoz Pashko dhe mjeku e anëtari i Partisë Sali Berisha, i cili qe dërguar si negociator nga Alia për të kontaktuar studentët. PPSH mbajti një mbledhje të Komitetit Qendror ku u muar vendimi për të aplikuar pluralizmin në shoqërinë shqiptare. Vija e studentëve, pra, triumfoi. Njëkohësisht u shkarkuan pesë anëtarë të Byrosë Politike.

Intelektualët që kishin marrë pjesë në kontaktet me studentët vendosën më 12 dhjetor të themelojnë Partinë Demokratike. Përveç Putos, Pashkos dhe Berishës, që u përmenden më sipër, anëtarë të grupit drejtues të partisë së re u bënë edhe Arben Imami, Eduard Selami dhe zëdhënësi i studentëve Azem Hajdari. Më 18 dhjetor kjo parti e re u pranua zyrtarisht nga parlamenti, që atëherë e kishte miratuar ligjin për sistem shumëpartiak. Në të njëjtën kohë, i vetmi shkrimtar i njohur i Shqipërisë, Ismail Kadare emigroi. Zyrtarisht ka theksuar se kishte konstatuar se të gjitha përpjekjet e tij si intelektual për të ndryshuar shoqërinë në drejtimin demokratik kishin qenë jofrutdhënëse. Kadareja thekson përpjekjet e tij për të ndikuar te Ramiz Alia përmes bisedash dhe letërkëmbimit. U vendos në Paris.

Vlerësimi im personal është se Ismail Kadare kishte shqetësime serioze në lidhje me gjendjen e tij dhe të familjes në një Shqipëri të ardhme, sidomos për arsye të kërcënimeve të vazhdueshme, ndërsa me krijimtarinë e vet artistike dhe me pozitën e vet si i vetmi përfaqësues i letërsisë shqiptare i njohur ndërkombëtarisht ai mund të llogariste në një ekzistencë të sigurt në Francë. Atje ishte shtëpia botuese Fayard, e cila më së shumti kishte kontribuar që Kadare të bëhej i njohur në botë.

Dimri 1990-1991 ishte një kohë trazirash; pjesërisht mbretëronte një mungesë e artikujve ushqimor dhe e energjisë elektrike, pjesërisht shkaktuan shqetësime "forcat e errëta", të cilat në disa anë të vendit thuhej se ishin provokatorë në shërbim të fuqive konservatore, në anë të tjera ishin njerëz që nuk kishin fije ideali dhe as më të voglën ndjenjë për atdheun.

Më 21 dhjetor, përmes BBC-së, mund të dëgjohej korrespondenti i Daily Telegraphit në Tiranë, i cili përmes duartrokitjeve që dëgjoheshin, raportonte se si vetë ishte dëshmitar kur u demontua statuja e Stalinit, që pastaj u largua me një kamionetë. Ky demontim natën ishte si hyrje në 111-vjetorin e lindjes së Stalinit, diçka që mediat nuk e kishin vënë re, por që unë i kisha rënë në fije.

Qyteti Stalin e rimori emrin e vet të vjetër Kuçovë saktësisht pas 40 vitesh dhe emri i Stalinit u fshi poashtu nga një varg vendesh të tjera: nga stacioni i energjisë në Bistricë afër Sarandës, nga kombinati i tekstit në Tiranë dhe nga një sërë rrugësh.

Më 31 dhjetor, dëgjoj të përmbillet emisioni i vitit të ri në Radio-Tiranë për të huajt me marshin e Radetzkyt "Für Elise" dhe "Lambada", ndërsa për shumë vite emitimet ishin mbyllur me Internacionalen...

Shqipëria pluraliste bën hapat e parë të pasigurtë – me uri dhe emigrim

Viti 1991 filloi me kalimin e shqiptarëve të uritur nëpër malet me dëborë për në Greqi. Këta ishin njerëz që i takonin edhe minoritetit grek e edhe shqiptarëve etnikë. Organet greke e akuzuan Shqipërinë se po i detyronte për në ekzod nënshtetasit greqishtfolës, gjë që u kundërshtua nga ana shqiptare. Disa ditë më pas, Greqia kërkoi ndihmë nga Kombet e Bashkuara për t'ia dalë mbanë problemit me mijëra njerëz që kalonin kufirin. Njerëzit në Shqipëri vuanin urie në atë dimër. Dhe që më 29 janar në Shqipëri i kishin kthyer rreth 5000 azilkërkues. Është një film i mirë grek, që rrëfen se sa keq u trajtuan emigrantët grekë nga bashkëkombasit e tyre dhe u quajtën "shqiptarë të mallkuar". Përfundimi i filmit: grekët e Shqipërisë arritën në përfundimin se më mirë ishte të vuanin urie në Shqipëri se sa të poshtëroheshin nga "vëllezërit" e tyre në Greqi...

Më 5 janar u botua numri i parë i gazetës "Rilindja Demokratike" organi i Partisë Demokratike. Ajo u botua vetëm në 6000 ekzemplarë dhe dy herë në javë, se sa pak ishte kjo mund të shihet po qe se krahasohet me organin qendror të PPSH "Zëri i Popullit" i cili botohej me një tirazh prej 100 000 ekzemplarësh dhe gjashtë ditë në javë.

Më 6 janar, Kuvendi Popullor i Shqipërisë vendosi të amnestojë 202 të burgosur politikë dhe ata që mbetnin pritej që së shpejti të liroheshin. Profesor Arben Puto, i cili punonte me çështjen e të drejtave të njeriut, deklaroi se numri i përgjithshëm i të burgosurve politikë ishte 500 dhe se rreth 400 syresh ishin liruar gjatë vitit 1990.

Në skenë dolën edhe disa parti të tjera: Partia Ekologjike dhe Partia Republikane. Lideri i kësaj të fundit, Sabri Godo - është një njeri me arsimim të lartë dhe me përvojë, porse politika shqiptare që nga viti 1991 është dominuar totalisht nga lufta midis dy partive më të mëdha – Partisë Socialiste (pasardhëse e PPSH) dhe Partisë Demokratike.

Shqetësimet sociale ishin të mëdha në këtë dimër me incidente serioze në Durrës, Shkodër dhe në pjesë të tjera të vendit. Punëtorët e minierave në Valias nisën një grevë urie për rritjen e pagave.

Më 21 janar Radio Tirana, me Svjetllana Mihalini në mikrofon, emtoi programin e fundit në suedisht. Nuk kishte më ndonjë motiv që, në këtë gjendje të vështirë ekonomike, të vazhdohej me emetimin e programeve drejtuar një vendi tjetër të vogël në fundin tjetër të Evropës. Muaji shkurt ishte një muaj i jashtëzakonshëm. Studentët e universitetit të Tiranës kishin nisur një fushatë demokratizimi. Kërkuan të ndërpriteshin ushtrimet e detyruara ushtarake dhe studimet në teorinë marksiste-leniniste. Donin që universiteti të mos mbartte më emrin e Enver Hoxhës. Ekonomisti i ri Gramoz Pashko, prindërit e të cilit kishin pasur poste të rëndësishme në kohën e Hoxhës, do të bëhej hallka bashkuese midis Partisë Demokratike dhe studentëve. Por studentët shpejt shkuan më tej: Ata kërkuan që Ministri i Punëve të Brendshme, ai i Jashtëm dhe ai i Drejtësisë të shkarkoheshin. Ramiz Alia u kundërpërgjigj me mbajtjen e një mbledhjeje në Vlorë, e cila ishte çerdhe e komunistëve, ku rekomandoi disiplinë dhe unitet dhe ndërprerjen e "papërgjegjësisë, huliganizmit dhe rrugaçërisë". Por kjo nuk ndihmoi shumë.

Javën pasuese u rritën tensionet në Tiranë dhe kulmuan më 20 shkurt. Një masë popullore prej rreth 100 000 vetash – sipas vlerësimit të korrespondentit të AP i cili ndodhej në vend – u mbledhën në Sheshin Skënderbe, pasi që studentët kishin marshuar nga universiteti deri aty. Përveç të rinjve të papunë që tashmë ishin element i zakonshëm pjesëmarrësish, kjo masë tash përbëhej edhe nga punëtorë dhe banorë të "thjeshtë" të Tiranës e kjo tregonte se ç'përmasa kishin marrë protestat. Një pjesë e demonstruesve, edhe pse policia qëlloi me rreptësi dhe rreth 20 sish edhe u plagosën, ia arritën ta rrëzonin statujën dhjetëmetërshe të Enver Hoxhës. E pra pranohet se pjesa dërrmuese e policëve ishin në anën e demonstruesve – erërat definitivisht kishin marrë të mbarën.

Mund të jetë interesante të lexohen disa nga reagimet ndaj kësaj që kishte ndodhur. Nuk ishte e papritur që Ramiz Alia i kishte karakterizuar akterët si "masa e tërbuar", "barbarë" dhe "vandalë". Mehmet Kraja, shqiptar nga Mali i Zi dhe veprimtar në Kosovë, shkruan në librin e tij "Vitet e humbura" mbi ngjarjet në Tiranë:

Në këtë kohë Kosova përjetoi një befasi të pamasë për ato që ndodhën në Tiranë, në lidhje me rrëzimin e statujës së Enver Hoxhës në qendër të Tiranës. Më duhet ta them me sinqeritet se shumë të paktë ishin njerëzit në Kosovë që e mirëpritën këtë ngjarje dhe edhe më të paktë ata që përkrahnin atë që kishte ndodhur dhe që e konsideronin këtë të domosdoshme. Ata nuk e dinin se statuja e bronzit në mes të Tiranës tërë kohën e kishte frenuar procesin e demokratizimit në Shqipëri, pasi që miti për diktatorin vazhdonte të jetonte përmes pushtetit të ikonografisë dhe ai ishte aq shumë i pranishëm thuase ishte i gjallë. Ky mit, i cili shfrytëzohej nga klani drejtues, vazhdonte të ushtronte shtypje dhe t'i terrorizonte njerëzit jo vetëm psikikisht. Ajo statujë bronzi në qendër të Tiranës ishte pikëmbështetja më e fuqishme dhe më stabile e pushtetit. Nën hijen e asaj statue nuk mund të kishte as liri politike e as mendim të lirë, as demokraci e as mirëqenie

nacionale. Edhe ata që donin ta kuptonin këtë, nuk e pranonin atë që kishte ngjarë, pasi që ata mendonin se veprimi i tillë ishte një vandalizëm ekstrem. Ata, domethënë kosovarët, nuk e dinin se statuja e Enver Hoxhës ishte një nga ato të pakta "vlera" që ende kishin mbetur të parrënuara në Shqipëri. Vlerat e tjera, me domethënie shumë të madhe ekonomike, kulturore dhe historike, ishin reduktuar në mbeturina të pavlera.

Edhe një zë, kësaj here nga burgu në Burrel, aty ku i burgosuri politik Fatos Todi Lubonja po vuante vitin e 17-të të dënimit me burgim, dënim i motivuar vetëm me shmangie nga vija e partisë në çështje kulturore. Lubonja i kishte të gjitha arsyet për ta urreyer Enver Hoxhën, i cili e bartte përgjegjësinë kryesore për vuajtjen e tij të pamerituar. Ai, më 20 shkurt 1991, në ditar shkruan:

"Ngjarje historike për popullin shqiptar! E pabesueshme, fantastike: kollosi i Rodit u rrëzua! Populli i Tiranës pas një beteje gurësh e tullash me policët dhe sampistët, i vuri litarin në qafë dhe e rrëzoi. Kjo është dita më e bukur e jetës sime si i burgosur, dita më e lumtur, të cilën s'ma kish marr mendja kurrë se do ta përjetoja duke qenë në burg. Sa herë kam menduar se vajtja në Tiranë do të ishte për mua gjithherë e mbarsur me ankth dhe revoltë për shkak të atij qeni, që do të më dukej se e sundon dhe njëherësh e poshtëron qytetin që nga lartësia atij monumenti".

Prapëseprapë, ajo që kishte ngjarë nuk kishte çuar deri te një gjakderdhje masive, së cilës iu kishin frikësuar shumë. Ramiz Alia mori rolin e balancuesit, i vetëdijshëm se kishte shumë më tepër për të humbur se sa për të fituar për regjimin në fuqi. E mori edhe detyrën e presidentit të Republikës, gjë që e bënte drejtpërdrejt dhe personalisht përgjegjës për çdo vendim me rëndësi të qeverisë. Ia arriti përkohësisht të qetësonte opinionin përmes kontakteve me Partinë Demokratike dhe Partinë Republikane, takime në të cilat testohej se deri në ç'shkallë mund të hapej aparati shtetëror dhe njëkohësisht shprehej një mungesë vullneti për të rënë në konflikt direkt nëpër rrugë me aparatën shtetëror. Prandaj ishte një platformë e vogël e përbashkët për mirëkuptim, dhe ajo u shfrytëzua. Në kuadër të Partisë Demokratike, Sali Berisha u bë gradualisht dominues; në radhën e studentëve kishte disa elementë ekstrem si Azem Hajdari, të cilin Berisha më pas do ta shfrytëzojë për lojëra radikale; poashtu, ai vetë nuk donte të shihte rrezikun që i sillnin sulmet e tija agresive, me të cilat i kishte krijuar vetes shumë armiq. Hajdari, diku në fund të viteve të '90-ta, së pari u plagos rëndë në një atentat e më vonë edhe u vra.

Në mars shpërthyen sërish trazirat. Mijëra të rinj të dëshpëruar u mblodhën në portet e Durrësit, të Vlorës dhe Shëngjinit, ku i pushtuan anijet dhe shkuan në Itali. Tash policia kishte filluar që me ashpërsi t'i ndalonte turbullirat. U shkaktuan përleshje të dhunshme dhe u vendos gjendja e jashtëzakonshme në portin e Durrësit. Policët morën instruksione që të pengonin grumbullimin e masave kudo në vend. Poashtu nga ana italiane bëheshin përpjekje me çdo kusht që të pengoheshin të zbarkonin anijet tjera me azilkërkues në vend.

Në këtë kohë një njeri i ri filloi të paraqitej në udhëheqjen e Partisë së Punës tashmë shkëlqimhumbur dhe të reduktuar dukshëm: Fatos Nano. Ai, si edhe Gramoz Pashko në anën e PD, ishte ekonomist dhe konsiderohej si reformator. Dhe si Pashko, ai vinte poashtu nga pjesa më jugore e vendit.

Zgjedhjet më 31 mars 1991- një fitore e papritur e PPSH

Në prag të zgjedhjeve shqiptare, të cilat për shkak të gjendjes qenë shtyer për më 31 mars, mbretëronte një tendosje e madhe. Gramoz Pashko vizitoi SHBA-të dhe u kthye me një çek të madh të mbushur me premtime për ndihmë për Partinë Demokratike, po që se kjo do t'i fitonte zgjedhjet. Së shpejti Shqipëria do të pranohej në Fondin Monetar, OSBE, Bankën Botërore dhe në Bankën e Zhvillimit Evropian, të gjitha vendet do të

përgatiteshin për t'i marrë shqiptarët si punëtorë të përkohshëm dhe kapitali i jashtëm do të pompohej në vend – kështu besohej. Evropa dhe SHBA do t'u jepnin shqiptarëve një ardhmëri të lumtur – ky qe mesazhi. Në realitet, vetëm një pjesë tepër e vogël e atyre premtimeve u realizuan gjatë viteve të 1990-ta. Shkaqet për këtë mund të kërkohen si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

Me gjithë trazirat para zgjedhjeve, vetë zgjedhjet qenë një ngjarje paqësore. Ishte hera e parë që nga vitet e '30-ta që mbaheshin zgjedhje me sistem shumëpartiak në Shqipëri. Pjesëmarrja në zgjedhje ishte masive, thuajse si në kohën e Enver Hoxhës, dhe pa presion për votim: 97% prej 1.9 milionë njerëzve me të drejtë votimi morën pjesë në votime, gjë që ishte përqindja më e madhe e pjesëmarrjes në ndonjë zgjedhje të Evropës Lindore pas instalimit të sistemit shumëpartiak. Në rundin e parë të votimeve PPSH fitoi 162 mandate nga 250 në Kuvendin Popullor; PD fitoi 65 mandate, ndër ta 17 mandate nga 19 në rrethin e Tiranës. Edhe dy runde votimesh u zhvilluan, më 7 dhe 14 prill, në ato vendvotime ku asnjë kandidat nuk kishte fituar majoritetin absolut në rundin e parë. Rezulteti ishte ky: 10 mandate për PD dhe 7 mandate për PPSH, ndërsa partia e minoritetit grek Omonia fitoi 2 mandate. Rezultati përfundimtar ishte se Partia e Punës e Shqipërisë fitoi 169 nga 250 mandate të Kuvendit Popullor, që donte të thoshte një shumicë prej dy të tretash. PD fitoi 75 mandate, kurse Omonia 5.

Në Shkodër, ku urrejtja ndaj komunizmit ishte më e madhe se në pjesët e tjera të vendit (nga se në Shkodër trajtimi i priftërinjve katolikë dhe kundërshtarëve të tjerë politikë kishte thyer të gjitha rekordet e mizorisë), u bë një reagim i drejtpërdrejtë ndaj fitores së komunistëve. Më 2 prill, qindra të rinj shpërthyen në trazira për shkak se flitej se shifrat e zgjedhjeve ishin rezultat i manipulimeve dhe i taktikës së frikësimit, mirëpo kjo në të vërtetë ishte gabim. Kësaj here organet qeveritare reagueshan shpejt dhe pamëshirshëm për të shuar trazirat. Trupat e Sigurimit vranë katër veta dhe dëmtuan shumë të tjerë. Ministri i brendshëm Gramoz Ruci i quajti demonstruesit "terroristë".

Kuvendi i ri Popullor u mbledh më 10 prill, mirëpo opozita kundërshtoi pjesëmarrjen – por, një javë më pas, ata u pajtuan. U arrit marrëveshja për miratimin e një kushtetute të përkohshme derisa të kryhet përpunimi i një kushtetute tjetër më të plotë. Emri i vendit u ndryshua nga Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë në Republika e Shqipërisë. Kushtetuta e re provizore nuk përmendte asgjëkundi ideologjinë marksiste-leniniste apo një rol udhëheqës për PPSH. U sanksionua e drejta për pronë private, e drejta për greva, e drejta për organizimin e demonstratave dhe e drejta për të emigruar. Në vend të presidiumit të Kuvendit Popullor u vendos një president ekzekutiv i Republikës, i cili do të zgjidhej me një shumicë prej dy të tretash në Kuvendin Popullor. Ramiz Alia u zgjodh në këtë post me një shumicë dërrmuese, mirëpo pa votat e opozitës. Me gjithë mungesat, kushtetuta e re shprehte një përparim të dukshëm. Një nga pikat më të rëndësishme ishte neni 7 ku sanksionohej se "shteti respekton të drejtën për besim fetar dhe krijon kushtet për ushtrimin e saj". Me gjithë fitoren e dukshme në zgjedhje, komunistët ishin në rënie, kurse Partia Demokratike, e cila s'kish vetëm tre muaj të ekzistencës, kishte një ardhmëri përpara saj.

Një pranverë e trazuar. Partia e Punës e Shqipërisë e ndërron emrin

Pranvera qe e trazuar. Elementët destruktivë, të cilët kishin humbur gjithë besimin te shteti dhe te rendi publik, shkatërronin lirisht, vagonët e trenave demolohehin, të gjitha pajisjet nëpër shkolla që mund të barteshin jashtë plaçkiteshin, autobusët në Tiranë dukeshin si skelete pa ulëse e pa dritare. Një student u shpreh: "Shteti ka vjedhur prej nesh për 50 vite. Tash është radha jonë, që ne të vjedhim prej shtetit". Zemërimi është i kuptueshëm, mirëpo veprimi i mungon logjika!

Pas zgjedhjeve Ramiz Alia e la postin e sekretarit të parë të PPSH. Kjo u bë në pajtim me kushtetutën e re, me normat e saj lidhur me pozitën e presidentit. Ai poashtu duhej të linte edhe Byronë Politike edhe Komitetin Qendror. Në fillim të majit Fatos Nano u bë kryeministër. Ai u përpoq të zbatonte reformat, i vetëdijshëm për gjendjen katastrofale në ekonomi, mirëpo shpejt filloi një grevë e përgjithshme në të cilën u përfshinë 300 000 punëtorë nga të gjithë sektorët shoqëror. Pas katër javë greve i tërë vendi ishte i paralizuar dhe shkonte drejt kolapsit. Qeveria ndodhej para asaj që ishte e pashmangshme – më 4 qershor, vetëm pas një muaji, ra qeveria Nano. Dukej qartë se asaj i mungonte mbështetja nga populli. Partia e Punës e Shqipërisë u plandos – nga punëtorët! Ky edhe ishte fundi i qeverisjes komuniste 47 vjeçare në Shqipëri.

Komunizmi shqiptar ishte krijuar në rrethana të çuditshme; gjatë tërë kohës ishte ushqyer nga Stalini, deri diku nga Lenini e edhe nga Mao, por shumë pak nga Marksi dhe Engelsi; iu kishte kundërvënë ashpër Krushovit dhe Brezhnjev, në të dyja rastet për shkak se Bashkimi Sovjetik ishte larguar nga politika dhe metodat e Stalinit, si dhe për shkak se Shqipëria e kishte vështirë që si shtet i vogël të ruajë pavarësinë e vet brenda bllokut të Lindjes. Politika e Enver Hoxhës, që dukej aq rigjide, në realitet ishte e përshtatur sipas nevojave të Partisë dhe pushtetit të tij.

YLLI BUFI DHE QEVERIA E SHPËTIMIT KOMBËTAR

Ramiz Alia e kishte shumë të vështirë të gjente një shef të ri të qeverisë. Komunistët e vjetër e kishin kuptuar tashmë se kah po fryenin erërat; askush nga ta nuk dëshironte të vihej në krye të një qeverie. Ylli Bufi, i cili kishte qenë ministër i mirëmbajtjes në qeverinë jetëshkurtër të Nanos, e mori përsipër detyrën që si kryetar i Këshillit të Ministrave të drejtonte një "Qeveri të Shpëtimit Kombëtar". Dymbëdhjetë ministrat e rinj ishin jokomunistë. PPSH, gjithashtu, kishte dymbëdhjetë vende, ndërsa 7 i takuan PD dhe pesë të tjerat u ndanë nga Partia Republikane, Partia Socialdemokrate dhe Agrarët.

Qeveria mbështetej në ndihmën nga jashtë, duke kuptuar se luftimet midis të rinjve e të vjetërve, qytetit e fshatit dhe komunistëve e opozitës duhet të shuheshin si kusht që të mbijetonte kombi. Bufi ia arriti të bindte sindikatat të ndërprisnin grevën deri te zgjedhjet e reja në vitin që do të vinte.

Mu në këtë kohë u mblodhën anëtarët e PPSH në Kongresin e tyre të 10-të. Partia tash ishte një hije e vetes së vet të dikurshme dhe prandaj ishte e domosdoshme një rishqyrtim i themeleve të saja. Partia e ndërroi emrin në Partia Socialiste Shqiptare (që ne në vazhdim do ta shënojmë me shkurtesën PSSh) dhe Fatos Nanon e zgjodhi sekretar të parë të Partisë. Me këtë, sipas kushtetutës së re të përkohshme, ai nuk mund të hynte në qeveri.

Partia donte të hiqte vulën e vet komuniste; nëntë nga anëtarët e deriatëhershëm të Byrosë Politike u spastruan dhe partia e pranoi socializmin demokratik. Garda e vjetër protestoi – pa rezultat – duke qëndruar në grup dhe duke brohoritur "Parti – Enver, jemi gati kurdoherë!". Ishte Nexhmije Hoxha, e veja e Enverit, ajo e cila paraqiste figurën dominante të konservatorëve. Mirëpo, pasi që komunistët e vjetër ishin në minoritet, ata nuk mund të bënin shumë, madje nuk mundën të pengojnë as zgjedhjen në presidiumin e partisë të shkrimtarit Dritëro Agolli, i cili kishte bërë një sulm verbal kundër Enver Hoxhës dhe epokës së tij.

Tash ishin zhdukur edhe fotografitë e fundit nga muret e shtëpive dhe veprat e Enver Hoxhës, si dhe shkrimet e tjera politike të tij ishin djegur ose përdorshin si letër higjenike. Realiteti shqiptar rrallë është i matur: nga adhurimi me besnikëri deri te flakja totale nuk është rrugë e gjatë...

Qeveria e Ylli Bufit nuk ia arriti të shpëtonte Shqipërinë nga një krizë që po bëhej gjithnjë më e thellë.

Bujqësia kooperativiste u shua dhe bujqit filluan të ziheshin për parcelat e tokës, sado që Qeveria i kishte caktuar drejtimitet e reformës agrare. Disa ndihma ekonomike erdhën nga Italia përmes të ashtuquajturit "Operacioni Pelikan". Dimri ishte i rëndë, por jo i mbushur me dhunë si më parë. Lisat preheshin për të plotësuar nevojat për nxemje gjatë dimrit dhe u shkaktuan trazira urie. Gjendja në Shqipëri ishte e mjerë dhe të folurit për një rend të ri botëror nuk mund të kuptoheshin ndryshe përveçse si ironi, për një popull i cili kishte filluar të humbte të gjitha shpresat.

Më 4 dhjetor 1991 ra edhe Qeveria Bufi. Një qeveri teknike, e drejtuar nga Vilson Ahmeti, mori përsipër të kujdesej për çështjet e vendit deri te zgjedhjet e reja, të cilat u caktuan për më 22 mars. Një popull i uritur dhe i mërdhirë nga të ftohtët vuajti edhe një dimër të acartë.

Zgjedhjet ishin një fitore e madhe për Partinë Demokratike. Pjesëmarrja në zgjedhje sërish ishte e madhe: 90.35%. PD fitoi 62% të votave kundër 25% të PSSh. Partia e re komuniste fitoi vetëm 2%. Partia Demokratike mori 92 mandate, socialistët 38, socialdemokratët 7, republikanët 1 dhe Unioni për të drejtat e njeriut 2 mandate. Partia e fundit ishte një bashkim i partisë minoritare greke Omonia, e cila qe ndaluar, dhe

Partia e vogël maqedonase Prespa. Sipas ligjit për zgjedhje, partitë e ndërtuara mbi baza etnike nuk kishin të drejtë të merrnin pjesë në zgjedhje. Pas zgjedhjeve, u largua Ramiz Alia nga posti i presidentit.

SALI BERISHA DHE PARTIA DEMOKRATIKE 1992-1994

Më në fund, Partia Demokratike, përmes zgjedhjeve të 22 marsit 1992, erdhi në pushtet. Me 92 nga 140 mandate në Kuvendin Popullor ata kishin thajse 2/3 e majoritetit. Për socialistët ishte një lehtësim të mos e kishin pushtetin qeveritar. Ata mund të merreshin me konsolidimin e vet, të reformonin partinë dhe të prisnin situatat kur do të merrnin municion për një kundërsulm të mirëfilltë kundër PD.

Sali Berisha u zgjodh president i vendit pas Alisë. Befas u emërua për shef të qeverisë së re Aleksandër Meksi, një inxhinier 53 vjeçar i cili ishte ekspert për arkitekturë bizantine. Ai më parë nuk kishte përvojë politike, por ishte i respektuar dhe i duhej PD. Ndërkaq, socialistët nuk kishin asnjë vend në qeveri.

Sali Berisha ka lindur më 1944 në Tropojë, një qytet i vogël në këndin e veriut të Shqipërisë, afër kufirit me Kosovën. Kishte punuar si kirurg i zemrës në Tiranë. Si anëtar partie në PPSH dhe specialist mjekësor, ai kishte pasur mundësi të studionte jashtë vendit, në Paris dhe Kopenhagë, gjatë kohës së regjimit të vjetër. Personalisht kam pasur dyshime të mëdha kundrejt Berishës që nga fillimi – ky ishte një demagog i kalibrit të njëjtë si Enver Hoxha, mendoja unë. Në xhirologarinë e tij të vockël pozitive mund të evidentohet se nuk kishte pasur përfitime materiale, se kishte vazhduar të banonte në po atë banesë të vogël në Tiranë, të cilën e kishte pasur nga regjimi i vjetër.

Miranda Vickers, në librin e saj "Shqipëria: prej anarkisë deri te identiteti ballkanik" (1997), në mënyrë të qëlluar shkruan se Sali Berisha në paraqitjet e tij publike tregon ngjashmëri të madhe me Radovan Karagjiqin, lider i serbëve të Bosnës. Krahasimi nuk është aspak i favorshëm për Berishën, por ishte i saktë. Berisha ka sjellje ekstravagante, është shumë i vetëdijshëm për rolin e mediave, i mprehtë por jo i besueshëm, me prirje për vlerësime të pakontrolluara ekstreme për kundërshtarët e tij. Ai është rritur në një shoqëri me shije të mprehtë për komplete të vërteta e të trilluara dhe për konspiracione. Sali Berisha është një person me prirje të padisiplinuara komuniste në një syprinë të tejdukshme të patosit demokratik. Paaftësia e tij për të bashkëpunuar me kushte të njëjta, për të deleguar pushtetin dhe detyrat e punës është thajse patologjike. Ai është marrosur duke e shijuar pushtetin, më tha një mik në Tiranë, i cili e njihnte Berishën personalisht; më parë, kur punonte si mjek, ai ishte normal, e tash është tepër jonormal, tha miku im.

Sa i përket bashkëpunimit me botën, zgjedhësit prisnin që Berisha të përmbushte premtimet lidhur me hapjen e dyerve kundrejt Evropës. Por as vendet e BE-së e as shtetet e tjera nuk tregonin ndonjë ndryshim në qëndrimet e tyre ndaj Shqipërisë pas zgjedhjes së Berishës. Përrjashtim bënte Italia, një përjashtim negativ. Qeveria Kraksi kishte pasur lidhje intime me socialistët në Tiranë, e tash këto lidhje qenë ndërprerë. Sa i përket SHBA, në Washington mbretëronte një interesim për të pasur një mbështetje militare në Shqipëri, kjo për shkak të pozitës strategjike të vendit, por nuk vërehej ndonjë rritje e ndihmës ekonomike. Ato pak investime që u bënë, për ironi, erdhën nga ndërmarrje private të shteteve fqinje tradicionalisht armike si Italia dhe Greqia.

Mjeshtri i intrigave Berisha, i cili erdhi në pushtet përmes sabotimit të shumtë ndaj qeverisë së shpëtimit kombëtar, vazhdoi shpejt me intriga, kësaj radhe brenda partisë së tij. Në gusht 1992, ai bëri një spastrim, me ç'rast u goditën shumë nga ata që kishin planifikuar dhe themeluar PD. Ata që lanë partinë ishin Gramoz Pashko, Ministri i Mbrojtjes Perikli Teta, Ministri i Kulturës Preç Zogaj, Neritan Ceka dhe Arben Imami. Këta, më pas, themeluan partinë opozitare të quajtur Aleanca Demokratike (AD).

Një faktor negativ ishte ambasadori i SHBA-ve Vilam Ryerson, i cili kishte ndikim të madh te Berisha. Ryersoni ishte antikomunist i tërbuar, i cili i nxiste dhe i toleronte tendecat totalitare të Berishës kur ky jepte goditje kundër "komunistëve të rrezikshëm"

të supozuar. Duket se do të ketë qenë Ryesoni, i cili ishte përgjegjës direkt për luftën kundër elementëve pajtimtar dhe progresiv në PD dhe se ai ishte përgjegjësi për mbështetjen që SHBA i dhanë Berishës personalisht, mbështetje e cila vazhdonte të ishte e fortë edhe disa vite derisa aventurat e Berishës u bënë të rrezikshme, madje edhe për Washingtonin.

Tendencat autoritare në shoqëri, nën drejtimin e Berishës, bëheshin gjithnjë e më të dukshme. Organi i PD “Rilindja Demokratike” heshtte lidhur me shprehjen e pakënaqësive, ndërkohë që i kushtonte shumë hapësirë bëmave dhe thënieve të Berishës. Kushdo që shprehte pakënaqësi me politikën e partisë në pushtet etiketohej si “komunist”. Radioja dhe TV poashtu ishin megafona të Berishës. Në gusht 1992 shtatë gazetarë e braktisën “Rilindjen Demokratike” për shkak të kufizimeve të ashpra të cilave ata duhej t’u nënshtroheshin, me kërkesën që gjithherë të shkruanin sipas vijës së partisë. Ata protestuan kundër shfaqjeve të tilla, prej të cilit ishin vuajtur gjatë regjimit të vjetër. Kur prokurori shtetëror Maksim Haxhia refuzoi t’u ngriste padi gazetarëve opozitarë, ai u shkarkua nga Berisha.

Pasardhësi i shërbimit shtetëror Sigurimi, SHIK-u – Shërbimi i Informimit Kombëtar, merrej me fabrikimin e kompleteve, që më pas për to t’ua hedhnin fajin komunistëve të vjetër. Raste të trazirave sociale, përleshjeve në portet e qyteteve dhe disa atentate me bomba, thuhej se ishin përpjekje për revansh nga ana komuniste. Duhet të konstatohet se shumica e ngjarjeve që ndodhnin kishin ngjashmëri me taktikën e regjimit të vjetër: të eliminohen rivalët e mundshëm për pushtet duke i akuzuar ata për veprimtari tradhtarë ndaj vendit. Ujku qimen e ndërron, por jo zanatin...

Neritan Ceka, njëri nga liderët e Aleancës Demokratike, në maj të vitit 1994 ka lënë një karakteristikë të Sali Berishës: Në kohën e komunizmit nuk lejohej kurrfarë opozite. Studentët dhe intelektualët filluan të flisnin për opozitën së pari si një ide dhe ajo pastaj u bë një realitet në rrugë si dhe në universitet. Asokohe Berisha nuk ishte me ta. Ai u dërgua nga Ramiz Alia, si i qëlluar, për të marrë kontrollin mbi lëvizjen studentore. Ai jo vetëm që ishte komunist, por ishte prej komunistëve të ashpër madje. Kur debatonte me Kadarenë, ky thoshte se ai (Berisha) nuk ishte përkrahës i pluralizmit politik, por vetëm i pluralizmit të ideve – përfundon Ceka.

Ky është problemi me Berishën dhe shpjegon se çfarë ngjau vitin e shkuar dhe më 1992. E vetmja perspektivë prej të cilës ai e sheh politikën është që ajo të diskutohet brenda partisë, e pastaj partia duhet ta zbatojë atë që është vendosur, pa opozitën. Në këtë mënyrë, ai e ka bërë PD të ngjashme me PPSH që ishte dikur. Dhe ai ka sens për të kontrolluar mediat – atë e ka mësuar nga Alia dhe nevoja për të vepruar përmes njerëzve të tjerë, të cilët vetë nuk kanë fare rëndësi-përfundon Ceka.

Me rëndësi të përmendet është edhe fakti se Berisha vjen nga pjesa e veriut të Shqipërisë, Tropoja, ku tradita klanore është e fortë dhe ku nxitet fuqia, trimëria dhe qëndrueshmëria, por ku ana tjetër e medaljes është intoleranca, stili autoritar dhe mosbesimi në parimet themelore të demokracisë.

Është poashtu me peshë të përmendet se ishin shumë më tepër se sa komunistët e vjetër dhe intelektualët progresivë, ata të cilët u distancuan nga politika e Berishës. Ai ra në konflikt edhe me ish të burgosurit politikë, të cilët u trajtuan padrejtësisht dhe të cilët me të drejtë kritikonin se Berisha ushqente një grup gjarpërinjsh, njerëz që ishin lojal ndaj tij por që kishin qenë puthadorë të regjimit të vjetër. Pronarët e vjetër të tokave, që banonin jashtë vendit, dhe pasardhësit e tyre donin kompensim për tokën, e cila u qe ndarë fshatarëve pas shkatërrimit të kolektivizimit të bujqësisë. Kështu, shkalla e pakënaqësisë ishte mjaft e gjerë.

Partia Demokratike dhe Berisha erdhi në pushtet kryesisht për shkak se njerëzit besonin në premtimet për ndihmën nga jashtë dhe se ata ishin të vetëdijshëm se

Socialistët nuk kishin mundësi të mëdha për të marrë ndihma të tilla. Këto shpresa u humbën gjithnjë e më shumë dhe më 1994 erdhi koha e krizës së parë të madhe për PD-në.

Këtu po e ndërprej paraqitjen historike për një kapitull të ndërmjetëm I: Përjetimet personale të autorit në Shqipëri dhe në Maqedoni më 1994.

Drejt ikjes nga e kaluara - e pastaj?

Smajl Ymeri në Rotebro dhe në Tiranë

Pas tre vjet pune të paprerë me problemet e azilkërkuesve të Kosovës, kryesisht në formë përkthimesh por poashtu edhe me kontakte të përditshme me kosovarët dhe me diskutime për problemin e tyre dhe përjetimet e të gjitha llojeve, mendova se më duhej një pushim. Gjatë kësaj kohe, pas ndarjes me gruan, kam jetuar i vetëm, prandaj kisha nevojë ta ndryshoja ambientin. Dhe kishin shkuar 15 vjet qyshkur kisha qenë në Shqipëri. E mu në këtë kohë fitova një bursë nga Instituti Suedez, bursë udhëtimi për në Shqipëri, gjë që ndodhi në kohë të duhur. Udhëtimet brenda vendit dhe ndalesat do të duhej t'i mbuloja vetë. E caktova dhe datën e udhëtimi: 27 mars 1994.

Natën para nisjes e kalova te një shqiptar i Kosovës në rrethin e Stokholmit, që quhet Smajl Ymeri. Ky më përcolli deri te autobusi, me të cilin do të shkoja deri në Arlandë. Kisha marrë përsipër të kryeja disa punë, ndër të tjera edhe t'u çoja para njerëzve në Tiranë, sepse rrugët normale të Evropës për bartjen e parave ende nuk funksiononin në Shqipëri.

Udhëtimi me aeroplan në relacionin Arlandë-Vjenë-Tiranë zgjati rrafsh 5 orë. Aeroporti i Rinasit ishte po ai, vetëm më i prishur se më parë. Një mik shqiptar me emrin Piro, bashkëshortja e të cilit Svjetllana ishte zëri suedez i Radio Tiranës gjatë disa viteve, më priti me veturë për të bërë rrugën 20 km. deri te qendra e Tiranës.

Përshtypja e parë ishte se Shqipëria nga një vend i varfër me bujqësi kolektive dhe me shumë njësi industriale ishte kthyer në një vend edhe më të varfër me bujqësi private por pa industri fare. Automobilat njëmend ishin më të shumtë se në vitet e '70-ta, por edhe qerret ishin shtuar. Fshatarët që ecnin përpara kafshëve të tyre dhe të tjerë mbanin në kokë qeleshet e bardha e të rrumbullakëta tradicionale, për të cilat thuhet se të kujtojnë përkrenaren e Skënderbeut, heroit kombëtar. Kalojmë përkaj shumë fabrikave të mbyllura, kurse arat shfrytëzohen në pjesën më të madhe. Vendi është jashtëzakonisht i rrëgjuar dhe vetëm disa projekte ndërtimesh duken tej rrugëve. Gjithandej shoh dyqane private dhe duket se ka me bollëk artikuj ushqimorë – mirë për ata që kanë mundësi të blejnë. Leku shqiptar është shumë i dobët: 100 lekë = 1 dollar.

Piroja e Svjetllana më kishin vizituar në Eskilstuna para disa vitesh dhe unë mendoja që kohën time të parë në Tiranë ta kaloja te ta. Kjo nuk u tregua praktike – Svjetllana duhej të merrte pjesë në një kurs gjuhe në Gjermani e Piroja punonte si inxhinier në ndërtime të ndryshme jashtë Tiranës. Prandaj u vendosa te e ëma e Svjetllanës, Eleni. Aty banonin edhe vëllezërit e saj të pamartuar Alberti dhe Ylli.

Dollarët e suedezës Ana-Karin për burrin e saj Xhevdetin më digjnin në xhep dhe doja që, sa më parë të ishte e mundur, t'i dorëzoja. Piroja më kuptoi dhe prandaj menjëherë u nisëm për te Rruga e Barrikadave 99 që t'ia dorëzoja Xhevdetit 700 dollarët që i duheshin për ushqim. Ai banonte te një familje tiranase, e cila na pranoi me përzemërsi dhe ne bëmë një bisedë të mirë gjersa po prisnim Xhevdetin. Fjodor Damani jetonte në një shtëpi të vjetër 200 vjeçare, një ndërtesë e vjetër e rrethuar prej një muri kah rruga. Emri i të zotit të shtëpisë më bëri të kujtoj se shumë emra të ngjashëm me ata rusë janë nga koha e miqësisë sovjetiko-shqiptare. Mikesha ime Svjetllana ishte quajtur sipas emrit të vajzës së Stalinit, kurse i zoti i shtëpisë ku unë ndodhesha tani ishte pagëzuar sipas shkrimtarit të madh (Fjodor Dostojevski – shën. i përkth.). Disa vite më pas, humoristi shqiptar Qamil Buxheli botoi një libër me titull: "Ne nuk kemi ndonjë Dostojevski, por kemi sa të duash idiotë". Por kjo mbase është një histori tjetër...

Pasi erdhi Xhevdeti, i cili me një kënaqësi të papërmbajtur i mori paratë, pimë kafe dhe shikuam fotoalbume. Atëherë ngjau diçka që shpesh më ka ndodhur në jetë: ajo që duket e pabesueshme – papritmas ngjanë. Në album shoh një fotografi të Smajl Ymerit, i ulur po në këtë kanape ku unë isha i ulur tash.”E pamundur”, thirra unë, ”njeriu i fundit me të cilin jam ndarë në Suedi para 12 orëve ishte Smajl Ymeri, e tash e shoh atë në albumin tuaj. A ka qenë ai gjithkund në Tiranë?” – pyes unë dhe konstatoj se bota është shumë më e vogël se sa njeriu e beson.

Lypësit dhe Enver Hoxha - tashmë i hequr nga fronti

Ditën tjetër isha i ftohur dhe me shkuarje të mëdha hundësh. Ftohje në kohë shumë të paqëlluar. E megjithatë, vetëm nisem e dal në qytet. Gjithkrah ngrihen gërmadha mbeturinash, që askush nuk i heq. Në Shqipërinë komuniste ishte pastër dhe bukur gjithkrah. Në atë kohë urdhëroheshin njerëzit që çdo javë ”vullnetarisht” të pastronin lagjen. Por tash të gjithë refuzojnë të bëjnë diçka vullnetarisht!

Lypës ka shumë, më së shumti fëmijë të vegjël, por edhe të rritur - invalidë e të tjerë. Ndërkohë që unë po shikoja disa libra te një shitës në rrugë vjen një njeri dhe më flet. Pasi më tregon se quhet Nezir Ndreu, unë i drejtohem me pyetjen e qëlluar mirë: A mos je nga Dibra? Me këtë dua t’i tregoj se kam njohuri më tepër se ato të rëndomtave, dhe Neziri fillon të rrëfejë. Kishte qenë i burgosur dhe i internuar për shumë vite. Dibranët, të cilët jetojnë në kufi me Maqedoninë, janë të njohur për ndjenjën e tyre lirishtese; disa kanë luftuar me nacionalistët, disa me partizanët. E pyes Nezirin se mos është i afërt me Isa Ndreun, një industrialist në Itali, dhe Dali Ndreun, një komunist që u mbyt nga Sigurimi bashkë me gruan e tij shtatzënë Liri Gega gjersa po iknin nga Enver Hoxha. Po si, që të dy i kishte të afërm. Ky edhe ishte anëtar në partinë e Isait – Bashkimi Demokratik Shqiptar; me Isain kisha të bëja shumë gjatë viteve të 1970-ta. Neziri ka punuar në Greqi, por është kthyer. Do të shkojë në SHBA, por nuk mundet pa i çuar ndokush garancion.

Në një shëtitje tjetër, në të njëjtën ditë, bredha përgjatë lumit Lana, që, për fat të keq, nuk është tjetër përveçse një batac i madh që rrjedhë përmes qendrës së Tiranës. Gjatë kësaj shëtitje bisedoj me disa njerëz të varfër, që ruajnë lopë dhe dele – një përjetim i çuditshëm në një kryeqytet evropian! Në një farë mënyre Tirana është kthyer pas në vitet e tridhjeta. Një plak që punon si bari, tregon se është endacak. Ky është shumë kritik ndaj qeverisë ”demokratike”: më parë kishte të ardhura vërtet të vogla, por të sigurta. Një kategori tjetër që nuk e pëlqen politikën e qeverisë është ajo shtresë e ish-nëpunësve, të cilët për shkaqe politike ishin katandisur në ”asistencë”. Këta janë tash të papunë me një ndihmë të turpshme. Njerëzit e thjeshtë e të paarsimuar në përgjithësi janë në gjendje edhe më të keqe se sa në shoqërinë e vjetër. Në këtë kohë është duke u bërë privatizimi. Mungesa e banesave është shumë e madhe – duhet pritur me vite e vite për një banesë.

Fëmijët e vegjël, ciganë, thuajse m’i grisin këmbët dhe nuk më lëshojnë pa u dhënë lekë. Por unë nuk kam të imëta, dhe krejt padëshirë detyrohem të ”çlirohem” prej tyre.

Përskaj lumit Lana më bijnë në sy dy ndërtesa. Nga njëra zhurmon popmuzika amerikane, tjetra është një qendër ndërkombëtare kulturore, që më parë kishte qenë muzeu i Enver Hoxhës. Futem brenda dhe filloj të bisedoj me rojën, që tregohet shumë i sjellshëm.

Muzeu është i ndërtuar si një piramidë me një luks që tingëllon keq për shkak të kushteve të varfëra të Shqipërisë. Vallë, sa do të ketë kushtuar i tërë mermeri nga Carrare¹⁹?

¹⁹ Qytet në Itali.

Të gjitha objektet e kultit janë hequr nga muzeu. Salla e madhe është e mbushur tash me karrige. Objekti mbahet me paratë amerikane, më thonë.

Po kjo, ç'është tash? Nga një dhomë atje lart nën kulm dëgjohej një këngë e bukur kori. "Ave Maria" e mbush kupolën. Është një kor që ushtron në prag të një koncerti për nderë të Nënë Terezës.

Një ndjenjë e një jorealiteti të lehtë më shfaqet. Ai që veten e bëri zot, i asistuar nga vartësit servilë, ia ka lënë vendin zotit të krishterë. Deviza "*Sic transit gloria mundi*" – Kështu humbet lavdia e botës – më kujtohet. Më kaplon një ndjenjë e madhe kënaqësie për shkak se ai, i cili e ka lavdëruar veten dhe ka shkelur aq shumë mbi të tjerë, është hequr nga fronti dhe predikuesi i dashurisë midis njerëzve i ka marrë domenet e mëhershme të tij. E ndjenjat në Shqipërinë e re janë të përziera. Një lloj shtypjeje është zhdukur, mirëpo njerëzit e vegjël pak se e kanë më mirë. Ka shumë gjëra që tregojnë se vetëm është kthyer ana tjetër e gëzofit, në vend të përpjekjes për të ndërtuar një shoqëri të drejtësisë.

Në pjesën e pasme të piramidës së madhe është një antenë. Mësoj se është emetuesi i Voice of America. Përveç VOA edhe BBC, e cila poashtu e ka një emetues lokal, edhe TV shqiptare ka filluar me reklamë. Gjërat më elementare nga bota moderne mungojnë, porse me pop dhe Coca-Cola, ky vend i varfër, është i furnizuar. Më bien ndërmend disa ngjashmëri me republikat-banane të Amerikës qendrore. Vallë, ky realitet ishte ajo për të cilën gjë njerëzit kishin luftuar?

Rinia shqiptare dhe vizitat nëpër shtëpia

Ditën tjetër, pas një takimi me shkrimtaren Diana Çuli, një e njohur përmes Ula Torpe (intelektuale dhe politikane lokale në Stokholm, politikane komunale, personalitet kulture), dhe me Nezir Ndreun e vajzën e tij, fillova të shëtitesha nëpër qendër të Tiranës për të bërë fotografi. Shkova nëpër rrugën e paradave "Dëshmorët e Kombit" deri poshtë te Universiteti, ku takova katër studente. Vendosa të bisedoja paksa me to për të parë se ç'mendonin për jetën dhe gjendjen në vend. Fillimisht provuam të uleshim në murin e Pallatit të Presidencës aty afër, por u detyruam të largohemi për shkak të një roje temperamentë.

M'u kujtua se unë, duke shëtitur i vetmuar në të njëjtën rrugë më 1979, më kishte ngjarë t'i afrohesha Komitetit Qendror të Partisë. Befas u tranda nga kujtimet e mija prej një "klik-klik". Ishte rojtari që e kishte hequr siguresën nga arma e tij automatike. Ai nënqeshi me dashamirësi, ndërkohë që bënte lëvizje të tilla me armën për të më treguar se unë duhej të rrija larg ndërtesës. Kjo ngjarje nuk më kishte zemëruar; por ky qen-roje "demokratik", i bezdisshëm e me dy këmbë, që u shfaq përsëri kur unë doja ta fotografoja pallatin e Sali Berishës, më bëri po atë përshtypje të pakëndshme, sikurse një person i cili pak më parë ka fituar një pasuri dhe, kështu, sillet sikur ta zotëronte të tërë qytetin... Shqipëria e ka fituar një qeveri "të re të pasur", ku krijohet përshtypja se respekti fitohet duke futur hundët gjithkund.

Vajzat ishin shumë të këndshme, pimë Seven Up dhe shikuam disa materiale që i kisha marrë nga Suedia. Stili serioz i tyre më dha shpresa të mira për të ardhmen e rinisë shqiptare. Problemi më i madh, mendonin ato, ishte gjendja e pasigurt dhe vështirësia për të gjetur punë pas studimeve.

Në mbrëmje kisha planifikuar të takohesha me tregtarin e librarave Estref Bega bashkë me një shqiptar të ri nga Kosova, Gjon Hoshi. Ky kombinim e kishte historinë e vetë të veçantë. Gjoni ishte azilkërkues në Suedi dhe kishte marrë një urdhër për të shkuar në armatën popullore jugosllave. Ai ishte pak i disponuar për të kryer shërbimin ushtarak në një vend ku rekrutët shqiptarë ktheheshin në shtëpi në arkivole të plombuara, duke ua mvëshur vetëvrasjen. Policia suedeze nuk kishte parë ndonjë

pengesë për Gjonin që të shkonte në Shqipëri, por ku do të mund të banonte se? Në këtë gjendje ndërldhemi unë dhe Estref Bega. Meqenëse ishte përngutë, unë nuk kisha mundur të bëja diçka më tepër se sa të shkruaja disa letra rekomandimi për llogari të Gjonit dhe ia pata dhënë atij dy adresa në Tiranë. Kështu, ai një natë kishte trokitur në derën e Estrefit, i cili kishte thënë se “miqtë e Ulmarit janë dhe miqtë e mi” dhe e kishte lejuar atë të futej brenda. Gjoni paguante për dhomën dhe ishte ndjerë mirë te Estrefi. Tash kishin ardhur ata të dy së bashku për të më takuar. Dhe shkuam në një bar përballë Hotel Dajtit, ku rastësisht u takuam me kompozitorin Limoz Dizdari. Ky na tregoi se si një herë në Goteborg kishte rastisur të futej në një zonë ku policia ishte duke bastisur në kërkim të një dhunuesi, edhe pse kjo ishte ndodhi dramatike, ai kishte përfunduar mirë. Në mbrëmje vazhdoi ndeja në shtëpi te Estrefi ku u shtrua darkë me raki dhe verë. Poashtu lexova disa tekste letrare të Eridës, vajzës së Estrefit. Kalova shkëlqyeshëm.

Të nesërmen në mëngjes duhej të abonohesha në revistën shqiptare katolike “Hylli i Dritës” dhe i shoqëruar nga Gjoni, shkova deri te rruga Ali Pashë Gucija, ku katolikët në Tiranë e kishin qendrën e vet. Aty afër ishte një kioskë, pronari i të cilës, Nysret Radoni, ishte shqiptar nga Kosova. Nysreti na ftoi për kafe dhe tregonte për jetën e tij: në vitet e '60-ta ishte shpërngulur nga Peja për në Shqipëri, për shkak të botëkuptimeve të tija komuniste-nacionaliste dhe pas studimeve në Universitetin e Tiranës kishte punuar mësues në Fushë-Krujë.

Një problem më vete në Tiranë është trafiku i egër dhe i padisiplinuar. Kur dëshiron të kalosh rrugën ose duhet të jesh i durueshëm e të presësh ose të shpejtosh si shigjetë. Cilësia e benzinës nuk është aq e mirë – ajo kundërmon mjaft keq. Shumë shqiptarë ngasin vetura të vjedhura nga Greqia dhe Italia, dhe shumë prej tyre nuk kanë patent-shoferi.

Këtë mbrëmje e kalova te miqtë e mi të parë shqiptarë, Mira Mamaqi-Meçule me familje. Kontaktet me familjen Mamaqi i kam bërë që kur isha 15 vjeçar, më 1949. Asokohe letërkëmbëhesha me babain e Miras, Lumon i cili vdiq më 1956. E tash, pas shumë vitesh ndërprerjeje, unë mund t'i vizitoja ata sërish në shtëpi. Aty ishte bashkëshorti Fatmiri, vajzat Aurela dhe Blerina dhe kunati Gavroshi. Një darkë e shkëlqyeshme me ushqim dhe pije, e si dhuratë unë mora një pikturë të Nënë Terezës. Gjersa Fatmiri është anëtar i një bashkësie islame, vajzat janë anëtare të shoqatës katolike të të rinjve. Kjo është tipike për tolerancën fetare te shqiptarët. Te Eleni, pronarja e banesës ku unë isha vendosur, në mur i ishte varur një pikturë e shën Marisë, kurse në dhomën e djalit një endje që tregonte Jezuin duke qetësuar shtrengatën.

Më 31 mars u përgatita për udhëtimin për në Maqedoni, që duhej të nisesha të nesërmen. Në shtëpi te Eleni erdhi vajza tjetër, Tatjana me të bijën Hermona, që kishte bërë një vizitë në Linshoping përmes formës së këmbimit të nxënësve para disa vitesh – e nxënësja suedeze, që asokohe kishte qenë në Shqipëri, quhej Ana Shindberj (tash mësuese në Udevala). Ajo ka ruajtur një simpati të madhe për Shqipërinë dhe shqiptarët. Babai i Hermonas ka qenë i punësuar në Sigurim e Shtetit dhe ekonomia e familjes tani është e keqe. Nga dhoma ime në banesën e Elenit dëgjoheshin thirrjet e lutjeve muslimane dhe herët në mëngjes zgjohesha nga kënga e këndesit; mbase një pamje nga kthimi i së vjetrës. Gavroshi tha dje se me rëndësi për Shqipërinë ishte ndërtimi i ekonomisë, ku bujqësia të kombinohej me industrinë që u përgjigjet kushteve të vendit. Më parë rreth 90% e industrisë kishte për qëllim vetëm të angazhonte popullin, kurse funksionet tjera ishin të panevojshme.

Mbrëmjen e fundit në Tiranë e kalova me 17-vjeçaren Erida, të cilës i ndihmova me detyrat shtëpiake në letërsinë angleze dhe shqiptare. Erida kishte një qëndrim dukshëm

të orientuar kah lufta e klasave kur ajo analizoi poezinë e Migjenit “Kënga e Mjerimit” (një poezi kritike ndaj shoqërisë së viteve të 1930-ta). Ishte interesante të diskutoje letërsi me Eridën, e cila është inteligjente dhe intelektuale tipike. Por kur është fjala për çështjet praktike ajo është mjaft e hutuar.

Bronkiti m’u pezmatua, prandaj në barnatore mora dy lloje barnash para udhëtimit. Zëri më është shtjerrë paksa, por në përgjithësi ndjehem mirë.

Prill-trill – në pritje për të udhëtuar

Edhe në Shqipëri bëhet mashtrimi në muajin prill, për çka dha prova programi i mëngjesit në radio. Dëgjuesit u lutën që të telefonojnë dhe të japin shembuj lidhur me shprehjen “Rrena i ka këmbët e shkurtëra”. Por edhe mua thuajse më mashtruan, sepse shoferi i cili duhej të më çonte në Maqedoni kishte pasur disa defekte në veturën e tij dhe nuk erdhi. Në ndërkohë, unë e shfrytëzova rastin për të marrë të dhëna lidhur me të hyrat dhe çmimet përmes bisedimeve me miqtë e mi:

Pensionistët e “niveleve më të ulëta” merrnin 138 korona suedeze për muaj si pension, të punësuarit shtetëror 336 korona, pensioni i mësuesve duke përfshirë edhe shtesën e moshës me të tjera arrinte në 576 korona për muaj. Një student mund të marrë bursë deri në 800 korona për muaj; po kaq ndoshta fitonin edhe të punësuarit në bizneset private.

Rryma elektrike është rritur nga 0.80 lekë të reja për kWh në 45 lekë të reja, vaji është shtrenjtuar nga 1.20 lekë në 20, buka nga 5 në 50 lekë, benzina nga 1 lek në 70 lekë dhe çmimi bazë i telefonit nga 10 lekë në 200 lekë në muaj. 100 lekë kanë vlerë sa një dollarë ose rreth 12 korona suedeze.

Nuk është çudi se përse populli brengoset nga përkeqësime të tilla. Qeveria e Berishës është treguar jokompetente dhe kur besimi kundrejt partisë dhe liderit konsiderohet shpëtim i vetëm nuk është çudi që interesi i popullit lihet anash. Privilegjet e drejtuesve “demokratikë” kanë shkuar, për fat të keq, edhe më larg se shfrytëzimi i paturp që u ushtrua nga pushtetmbajtësit e vjetër.

Shqiptarët e Kosovës nuk çmohen në Tiranë. Unë brengosem dhe befasohem me disa qëndrime ekstreme nga ana e disave. Rekord i u thye nga një tiranas i cili shprehet: “Mirë ua bëjnë serbët që i qethin ata drejt shqiptarë të Kosovës. Ata kështu e kanë lypur”. I shokuar nga fjalë të tilla, nuk arrij dot të bëjë ndonjë koment. Do të duhej ta kisha pyetur nëse ai do të donte t’i amputohej ndonjëri nga krahët e tij, për shkak se mund të mos i dukej mjaft i mirë! Sepse shqiptarët janë pjesë të të njëjtit trup, kudo që jetojnë ata.

Historia e antipatisë ndaj kosovarëve është se disa prej tyre në një mënyrë të pamëshirshme e kishin shfrytëzuar gjendjen në lidhje me rënien e komunizmit në Shqipëri. Kishin shkuar atje dhe kishin blerë tokë, kishin nisur kontrabandë me drogë dhe prostitucion. Njerëz që kërkojnë të pasurohen me çdo kusht ka gjithkrah, por në këtë rast shumë njerëz në Shqipëri e kishin përjetuar rëndë faktin se ata që duhej të ishin vëllezër të tyre, silleshin si horra. Dhe si zakonisht, të gjithë njerëzit e mirë duhet ta pësojnë kur një klikë fare e vogël ua prish të tjerëve imazhin.

Drejt Maqedonisë

Alberti e gjen një shofer tjetër, Arben Canin. Ky ka një veturë të mirë, që me siguri do t’ia dalë rrugës për në Maqedoni. Por ai ka punuar në Gjermani dhe është mësuar të fitojë para, e poashtu ai ka punuar edhe si shofer për ekspertë të jashtëm në Shqipëri, prandaj e di se nuk do të më dalë aq lirë.

Me lehtësi kaluam nëpër grykën e Krrabës në rrugën mes Tiranës dhe Elbasanit, të cilën e kisha provuar që më 1970. Është një rrugë me tatëpjeta malore, ku më shumë se

gjatë një udhëtimit me aeroplan njeriu ndjehet i lënë në mëshirë të zotit. Kësaj here kaluam mirë dhe qetë e me një mot të mirë. Afër Prrenjasit filluan të dominojnë shpatet e maleve me dheun e kuq dhe afër liqenit të Ohrit dukeshin gjithnjë më shumë pemë kajsish dhe vishnjesh. Para fshatit të vogël peshkatar Lin hapet fusha, dhe pamja është jashtëzakonisht e bukur me liqenin ngjyrë të kaltërt, të thellë, i cili kurorëzohej nga malet e mbuluara me dëborë.

Ne mbushëm rezervuarin në Pogradec, aty ku shoferi im kishte kryer shërbimin ushtarak dhe kishte të njohur. Afër kufirit u ndalëm në një pushimore; pronari i restorantit ia ngriti zërin në maksimum muzikës kur thashë se unë, si suedez, ndihesha i nderuar që ai dëgjonte ABBA... Në afërsi ishin vilat e Enver Hoxhës dhe të korifejve të partisë, vila të cilat ishin në një ambient shumë të mirë.

Në kufirin me Maqedoninë të Shën Naumi u bë e qartë se shoferi duhej të kishte vizë dhe e tërë procedura në kufi kushtoi 190 DM (marka gjermane). I tërë ky udhëtim u bë tepër i shtrenjtë: bileta e aroplanit më kushtoi shumë më tepër se sa duhej dhe tash edhe 2000 korona të udhëtimit me veturë. Por, ky ishte 1 prilli... dhe edhe një budallallëk tjetër: unë propozova një rrugë malore dhe shoferi, për fat të keq, u dakordua. Pas 7 km u detyruam të ktheheshim. Jo vetëm që vetura duhej të kalonte nëpër gurë që ishin rrokullisur nga lart, por në fund nuk mundëm të shkonim më tutje për shkak të pengesës nga bora!

Së shpejti u lëshua errësira, por ne vazhduam. Në Maqedoni rrugët ishin të mira dhe ne, përmes Ohrit dhe Resnjes, shkuaam drejt cakut: fshati Asamat buzë liqenit të Prespës. Aty do të kaloja një javë me miqtë e mi të vjetër nga Eskilstuna, familjen Shabani, vajzës së të cilës, Editës 16-vjeçare, i kisha dhënë mësim në shqip. Familja kishte jetuar disa vite në Beograd dhe Edita nuk kishte mundur atje të mësonte shqip – pastaj kishin kërkuar lejeqëndrim në Suedi, ku morën refuzim. Ishin kthyer në vendlindjen e tyre në Maqedoni dhe ndodheshin tash në këtë fshat të vogël. Një kushëri i nënës së Editës, rastësisht, ndodhi të shfaqej me veturën e tij dhe na priu rrugës.

Më në fund arritëm – miqtë e mi tashmë e kishin pas humbur shpresën se do të mbërrija. Edita kishte qarë paksa, por tash atyre iu kthye gëzimi në këtë mbrëmje. Përqafimet e saja dhe puthjet në faqe më bënë të kthjellesha pas gjithë asaj rruge të gjatë me veturë. U shpërndava dhuratat – ndër të tjera një byzlyk filigranti që kisha blerë për Editën; pastaj ngritëm dollin dhe hëngrëm supën e mbrëmjes. Më erdhi keq për shoferin Arben, i cili duhej të kthehej natën që të ishte i gatshëm për turrën tjetër nesër në mëngjes, natyrisht i paguar mirë për mundin, por megjithatë ishte e rëndë.

Shtëpia ku isha tash dhe e cila u qe huazuar familjes Shabani nga një i afërt kishte standard të mirë dhe ishte e madhe, krahasuar me banesat në Tiranë. Por nuk kishte WC – nevojtorja ishte qilar primitiv afër hyrjes. I ati Nexhati nuk kishte ndonjë punë. Si do të mund t'ia dilte familja për një kohë të gjatë? Maqedonia nuk kujdeset për mirëqenien e qytetarëve shqiptarë.

*Raport nga një fshat i Maqedonisë - miqtë shqiptarë
të gatshëm të vdesin për Suedinë*

Ky qenka një vend të cilin ia vlen ta vizitojnë turistët. Ne ndodhemi në anën lindore të liqenit të Prespës. Liqeni nuk është dhe aq i madh, por ai përbën me të vërtetë një pikë kryqëzimi. Vetëm disa kilometra tutje në jug fillon Greqia. Nëse udhëton në jug nga ana tjetër, shpejt arrihet te kufiri shqiptar. Liqeni i Prespës, pra, është i ndarë midis tre vendeve. Këtu, mbi të gjitha, ka maqedonas përgjatë bregut të liqenit – në fshatrat e të tria vendeve, por disa fshatra ose janë tërësisht shqiptare ose janë të ndara midis popullatës shqiptare dhe asaj maqedone.

Në shëtitjen e parë, gjatë ditës së dytë në Maqedoni, shoh rrethinën me tërë bukurinë e saj, ndonëse banorët e kësaj ane thonë se kam ardhur shumë herët për ta parë këtë anë, dmth. se kam ardhur paksa para kohe. Fshati Asamat rrethohet nga male të mëdha e të mbuluara tërësisht me dëborë, ku maja më e lartë, Peristeri, shtrihet në Greqi. Rrethina e ka një specifikë: kultivimin e mollëve dhe kumbullave. Sidomos mollët janë të njohura për cilësinë e tyre, gjë që i bën blerësit të vijnë nga vise shumë të largëta në kohën e të vjelave. Fshati ka rreth 50 shtëpi, gati gjysma të banuara me shqiptarë. Shumë banorë të fshatit kanë mërguar në SHBA, Gjermani, Danimarkë, Suedi dhe Australi.

Ne shkojmë te shtëpia e kumatës së Nexhatit. Rrugës shohim një çerdhe lejleku në një shtyllë telefoni dhe lejlekët janë aty. Kunati Jusuf, i cili është pronar i kafenesë dhe njëherit dyqanit të fshatit, na qeras me raki; më pas, djali i shtëpisë Vasviu, me veturën e tij na çon në treg në qytetin Resnje, që ndodhet aty afër. Aty tregtia është në kulm. Mua më jepet rasti të bisedoj gjermanisht me një shitës rruge, i cili është maqedon dhe ka kaluar 15 vjet në Gjermani, kurse anglisht flas me një çun shqiptar, i cili kishte ardhur nga Kanadaja para gjashtë vjetësh. Vizitojmë edhe sallonin e frizeres, ku Edita punon gjatë ditëve.

Pasi u kthjem në fshat, flasim për gjendjen e familjes. Nexhati ka të thatë në lukth dhe ka nevojë për barna. Pas kthimit në Suedi, unë bashkë me një mjek simpatik ia bëjmë një kombinim me Losec dhe penicilin, dhe për kënaqësinë tonë ky kombinim barërash tregohet efektiv. Disa muaj më pas Nexhati na njoftoi se ai nuk kishte më vështirësi me lukthin.

Moti bën i keq dhe ne rrimë brenda në shtëpi. Edita bisedonte me tre djem bashkëmohatarë, të cilët erdhën për vizitë. Ne huazuam një video dhe shikonim një videokasetë, të cilën e kam marrë me vete nga Suedia, ku shihet se si shqiptarët dhe miqtë suedezë e kremtojnë 28 Nëntorin më 1992. Edita dhe familja e saj nuk ishin të pranishme në atë rast, por ajo i njehe shumë nga pjesëmarrësit. Ish gruaja ime Helena dhe vajza jonë Juhana erdhën poshtu në festë, gjë që ishte e jashtëzakonshme sepse, për shkak të shkurorëzimit, ditën e nesërme unë do të largohesha nga shtëpia. Shqiptarët në tubim ishin të mallëngjyer nga fakti se edhe në gjendje shkurorëzimi, Helena po shprehte miqësinë ndaj atij populli, të cilit burri i saj ia kishte kushtuar tërë jetën.

Nëna e Editës, Nadirja, babai Nexhati, tezja Maide dhe xhaxhai Jusufi flasin me admirim për Suedinë. Sidomos Jusufi, pronari i dyqan – kafenesë, është ai i cili bënë muhabet më shumë. Ai me familje kishin kërkuar azil në Suedi dhe kishin marrë refuzim, por ia kishin dalë të kursenin pak para gjatë kohës së pritjes së përgjigjes. Me këto kursime arriti të niste biznesin e të blente veturën. Shtëpinë e kishte bërë me paratë që i kishte fituar gjatë tre vjetëve në Australi. Maqedonia nuk i ka dhënë kurrfarë përkrahje, përkundrazi. Komunistët maqedonas e rrënuan dyqanin e Jusufit në një fushatë antishqiptare. Policët ndërhyjnë vetëm sa për të ndërprerë gjakderdhjen, jo për të ndarë drejtësinë.

Miqtë e mi shqiptarë më tregojnë se do të ishin në gjendje të vdisnin për Suedinë në rast nevojë. Suedia nuk kishte arsye direkte që t'i ndihmonte, megjithatë i kishte trajtuar në mënyrë humanitare. Nëse Suedia do të sulmohej nga armiq, ne mund të llogarisim në një kompani shqiptare ose pse jo edhe në një batalion të tërë vullnetarësh! Ndihem shumë i mallëngjyer. Kurse ne, për çudi, mendojmë se Suedia nuk e kryen si duhet detyrën e solidaritetit ndërkombëtar!

Është krejt e qartë se këta fshatarë kanë nevojë për ndihmë e investime, që të mund të orientohen për një veprimtari të veçantë biznesi, që do të mund ta zhvillonin. Nadirja

ka një vëlla, Alajdinin, i cili fiton 8000 korona në vit dhe i cili duhet të kujdeset për një vëlla tjetër të tij epileptik. Shteti nuk jep as dhe një cent për shërbime sociale.

Një gjë më bie në sy: fëmijët mbledhin kërmijë nëpër vreshta dhe ata i shesin te shteti! Dy fëmijë të vegjël, për shkak të shiut, hyjnë brenda në ora 22 dhe tregojnë se sa kërmij kanë zënë.

Intermexo etnike dhe një shëtitje e këndshme nëpër male

Ditën tjetër, vëllai i vogël i Editës, Agroni, është i zemëruar dhe i mërzhitur. Një fëmijë tjetër pak më i vogël nga një familje maqedone në fshat e ka ngacmuar Agronin, duke i thënë se e tërë familja Shabani do të duhej të ikte nga fshati dhe të kthehej në Beograd. Agroni ia kishte pallangjesh atij fëmijë të vogël një flakaresh dhe ai ishte rrëzuar dhe e kishte lënduar dorën. Prindërit e të dyja familjeve ishin të prekur - fëmija duhej të shkonte në spital për kontroll. Nadirja herë pas here bëhet tepër nervoze – dhe mendon se ajo familja tjetër po e stërmadhon ngjarjen për shkaqe antishqiptare; ajo, poashtu, është e zemëruar në djalin e saj, pse e ka qëlluar një fëmijë më të vogël.

Në mbrëmje mësojmë edhe për një intermexo tjetër. Një kusheri i Nadires dhe gruaja e tij erdhën në vizitë, dhe këta treguan se Vasviu, i cili formalisht është pronari i dyqanit të vogël të prindit të tij, Jusufit, është arrestuar nga policia me 100 kg peshk në portbagazh. Sipas vendimit, tërë atë që ai e ka peshkuar duhet të çohet në qendër të qytetit, por Vasviu nuk ia ka varë këtij vendimi. Arrestimi konsiderohet edhe si një shembull i ngacmimit të organeve maqedonase ndaj shqiptarëve dhe si përpjekje për t'i goditur të gjithë shqiptarët për çdo gjë. Në mbrëmje temat rreth shqetësimeve etnike në këtë shtëpi janë shumë të pranishme.

Përndryshe, për mua kjo ishte një ditë e bukur. Në mëngjes shkuam poshtë te liqeni i Prespës dhe shikuam veprimtarinë e peshkatarëve, e dikur më vonë na mori Vasviu me vete në një shëtitje me veturë lart në male midis Ohrit dhe Liqenit të Prespës, pikërisht në atë rrugë të cilën unë ia pata propozuar shoferit atë natë kur ne erdhëm në Maqedoni. Tash ne shkuam nga ana tjetër ku kishte pamje vërtet të bukura, e sidomos ishte e mrekullueshme kur arritëm në një lartësi mbi 1000 metra mbi nivelin e detit. Këtu malet ishin me ahishtë për gjatë rrugës dhe unë mblodha e shtypa disa lule pranverore, ndër të tjera edhe agulçe. Duke u ngjitur lart drejt majës hasëm në një kamionetë maqedonase, që kishte mbetur në borë! Shoferi ishte ulur e po priste ndihmën.

Përshkrimin e një bime mjekësore e kam lënë në Tiranë te Ylli, që studionte biologji në Universitetin e Tiranës. Përshkrim në fjalë që bërë nga një grua prej Kosovës, Mihane Kabashi-Qiraxhiu, e cila asokohe banonte në Eskilstunë. Bima besohej të ishte e mirë veçanërisht kundër bronkitit. Në universitet bima që identifikuar si *Asarum europaeum*, dhe është shumë e rrallë këtu. Bima ka cilësi këlbaztretëse dhe përdoret kundër bronkitit dhe astmës. I tregova një fotografi të bimës Nexhatit, i cili tha se e njihnte. Duke u kthyer nga lartësia befas Nexhati briti “Ndal” dhe nxitoi jashtë veturës drejt një trangu të rrëzuar ahu. Ai u kthye me një bimë duke e mbajtur në duar. Flora me bimë mjekësore ishte aty: pa fije dyshimi, kjo ishte bima që e kërkonim. Nëse do të më keqësohen më shumë organet e frymëmarrjes do të porosis një ekzemplar të bimës nga Maqedonia. Nexhati tregoi një symprehtësi dhe përkushtim, e kjo është disi në kontrast me paraqitjen e tij apatike. Përndryshe ai ishte njeriu i cili, siç thuhet, jetonte në këndin e jetës, jetonte nga bëmirësia, dhe pa perspektivë për të ardhmen. Depresioni e kishte mbërthyer atë njeri.

Kusheriri i cili erdhi për vizitë në mbrëmje punonte roje. Për këtë punë ai merrte 300 DM në muaj. Shpenzimet ishin të larta: energjia elektrike 50 DM, parapagimi për

telefonin 10 DM dhe TV 10 DM. Më pak se 100 DM mbeteshin për gjërat e domosdoshme.

Çështja lidhur me ndihmën suedeze në Maqedoni u shtrua sërish në bisedë dhe ne na preokuponte përgjigja se si marrësit e këtyre ndihmave i ndanin ato. Miqtë e mi në Asamat besonin se drejtuesit i fusnin paratë në xhepat e tyre.

Dikur vonë në mbrëmje u bë me qejf Jusufi dhe nisi të tregonte histori, e që duhej të ishin të vërteta: Disa murgësja e kishin fshehur një thesar në një gropë në pyll. Jusufi bënte gjueti dhe po ndiqte një lepur të bardhë, kur ai rrëshqiti në gropë, në të cilën kishte një thesar të lidhur me një litar pesëmetërsish të gjatë i cili, po qe se ndokush do t'i afrohej, ai shndërrohej në gjarpër! Jusufi mezi kishte arritur t'i shpëtonte gjarpërit... Ai njeri që mund t'i gjejë dy fjalë magjike do të hapet toka dhe kështu thesari do të gjendet.

Unë tregova një histori të ngjashme nga Vermland:

Në Glumseryd të Veses një palë shërbëtorë kishin dalë jashtë në mes të natës duke lypur thesar. Ata shkuan te një muranë, ku dihej se një thesar i njohur fshihej aty e i cili dukej vetëm në mesnatën e së enjtes. Shërbëtorët nisin të rrëmihin në heshtje, sepse po qe se do të flitej, mundi do të shkonte huq. Në mesnatë ata e panë shumë qartë thesarin që shkëlqente në gropën që e kishin rrëmihur. Por pikërisht në atë çast shfaqet një pulë e çalë duke tërhequr një karrocë të ngarkuar me sanë. Kjo dukej aq qesharake, sa që shërbëtorët shpërthejnë në të qeshura. Sakaq, qe zhdukur thesari dhe gurët kishin rënë sërish në gropën e rrëmihur.

Jusufi m'u kundërvua i "indinjuar" duke thënë se kjo me siguri do të ketë qenë vetëm trillim, kurse historitë e tija ishin të vërteta të kulluara!

Qumështi i dhisë, shëtitjet dhe një shi që s'ndalej

Nexhati kishte dalë dhe kishte marrë ca vezë të pulave të shtëpisë, për të më qerasë me to, si dhe me qumësh të nxehtë dhie, që kishte shije të shkëlqyeshme. Por ngjarjet e djeshme lidhur me zënkën e Agronit dhe intervenimi i policisë kundër Vasviut e kanë shkakatuar një atmosferë të trishtueshme. Malli i familjes për Suedinë sërish aktualizohet.

Nexhati dhe unë bëjmë një shëtitje të gjatë deri lart te pjesa veriore e Liqenit të Prespës, ku takojmë e bisedojmë me një bari të moshuar shqiptar që ruan tri lopë dhe dy viça. Bëjmë vizita edhe te disa të njohur. Vëllai i Nadires, Alajdini, i cili e prezenton vetëveten si "ai me llambën" jeton në kushte primitive e ngusht me gruan dhe një fëmijë. Është një ambient i cili të sjellë ndërmend mjerimin e fshatrave në Shqipëri, por që njerëzit të detyrohen të jetojnë kështu në Maqedoni – kjo me siguri është një produkt i diskriminimit etnik. Unë e shoh qartë se si rregull, maqedonët i kanë kushtet e jetesës shumë më të mira se sa shqiptarët. Pjesa dërrmuese e maqedonëve kanë dhe punë.

Në mbrëmje vijnë në vizitë disa burra nga fshati Kranje, i cili ndodhet në malin tutje disa kilometra në jug. Njëri nga burrat, Behxhet Asllani, është aktivist në kuadër të PPD – Partia e Prosperitetit Demokratik. Ai është bujk, por duket se është mirë i informuar në çështje të ndryshme dhe e flet një shqipe shumë të pastër. Ne bisedojmë lidhur me mundësitë për të zhvilluar turizmin; e ai më premtonte të hulumtojë mundësinë e udhëtimit tim të sërishëm për në Tiranë. Unë e shtroj idenë se mund të aranzhohet një program për turistë të huaj me temën "Tre vende – një popull". Kjo nënkuptonte se grupi i turistëve duhej të vizitonte ambientet shqiptare në Mal të Zi (p. sh. qytetin bregdetar Ulqinin), Shqipërinë (Shkodër-Krujë-Tiranë-Durrës-Pogradec me kombinime vizitash interesante dhe bërje plazhi) si dhe Maqedoninë (Strugë-Ohër-Prespë me kombinim të njëjtë). Në Asamat ka një sërë pushimoresh boshe, që s'janë përdorur pas shkatërrimit të Jugosllavisë, që mund të meremetoheshin dhe të përdroreshin. Puna është

vetëm të gjendet njeriu që është i interesuar dhe mund ta realizojë këtë ide. Porse për sa kohë që gjendja të jetë e pasigurtë është e vështirë që të realizohet kjo ide.

Të nesërmen, kur u zgjova, binte një shi i madh. Edita e Agroni tashmë kishin shkuar. Udhëtojnë me autobus deri në shkollë, respektivisht te salloni i frizeres. Agroni shkon në klasën e gjashtë në shkollën e fshatit më të afërt. Për shkak të motit të keq ne rrijmë të trishtuar në kuzhinë dhe dëgjojmë Radio Tiranën. Më bie në sy një gjë pozitive në programet e kohëve të fundit: diskutohen probleme të vërteta, p. sh. çështje të ambientit dhe përgjegjësia e popullit në gjendjen e tashme, aferat e dashurisë me të huajt dhe se ç' domethënie kanë ato. Një person tregon për problemin e tij, pastaj ftohen dëgjuesit të telefonojnë në radio dhe të paraqesin mendimet e tyre. Diçka e këtillë ishte totalisht e paimagjinueshme në shoqërinë totalitare.

Edita erdhi në shtëpi me shokë, kureshtarë të më takonin mua. Unë ndihem sikur të isha ndonjë majmun në kopshtin zoologjik, ku njerëzit shkojnë për ta parë. Nuk është dhe aq e pakëndshme, pasi që të gjithë janë të sjellshëm dhe miqësorë, por më duket disi komike. Në botën shqiptare i huaji duhet të mësohet me këtë. Kur unë pata shkuar në Shqipëri për të parën herë më 1970, u bëra sensacion për shkak të njohurive të mia të gjuhës shqipe. Shpejt u bëra një orator popullor në plazh – megjithëse e tërë biseda ishte më tepër një lloj monologu, meqë njerëzit kishin guxim vetëm të dëgjonin, por jo edhe të flisnin në atë gjendje. E njëjta gjë përsëritej herë pas here. E në këtë fshat, të Maqedonisë së largët, kurrë nuk ishte parë ndonjë i huaj që të fliste shqip.

Vizitorët kësaj here janë – një i ri 20 vjeçar dhe dy vajza, njëra 17 e tjetra 15 vjeçare, të cilat banojnë në anën veriore, në rajonin e Resnjës. Vajzat janë të turpshme, sa mezi flasin, kurse djemtë janë më fjalamanë. Ai tregon se e ka kryer shërbimin ushtarak në armatën maqedonase për nëntë muaj dhe asokohe, në rajonin e Strugës, atij i kishte ndodhur të kapte shqiptarë, që kishin dashur të kalonin kufirin nga Shqipëria. Ai i kishte trajtuar mirë, por i kishte kthyer në anën tjetër. Ishin shfaqur disa probleme me vjedhje në shtëpitë e pushimores. Këta të rinj nuk kanë mësuar shqip në shkollë. E shqipja e tyre, megjithatë, është më e mirë se sa e folmja e pjesës dërrmuese të të rinjve shqiptarë në Kosovë. Ne ndodhemi 40 km në brendi të Maqedonisë, por këtu jeton gjuha shqipe dhe dialekti është i këndshëm e i lehtë për t'u kuptuar. Patriotizmi i fortë që është në Kosovë, këtu nuk bie në sy. Relacionet me maqedonët me siguri se janë të çrregulluara, por absolutisht jo aq të nxehta sa midis shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë. Duket se konfliktet në pjesën veriore të Maqedonisë janë më të forta.

Kah ora 23 Nexhati, në radion e tij të vjetër, arrin të gjejë Radio Suedinë. Ishte një ndjenjë e bukur me atë përshëndetje nga atdheu dhe zemërimi nga shiu në Maqedoni m'u zbut nga e dhëna për rënie shiu të përzier me dëborë dhe + 2 gradë celsius në Stokholm.

Një shëtitje deri në Ohër dhe Strugë

Vizita ime në Maqedoni fillon t'i afrohet fundit. Ende po bie shi, por miqtë e mi mendojnë se unë patjetër duhet të shoh edhe disa vende turistike në afërsi, Ohrin dhe Strugën, vendbabime të cilat poashtu kanë edhe një pjesë të madhe banorësh shqiptarë. Jam shumë i mërziur nga shiu, ndërkohë që shqiptarët mendojnë se vizita ime ka sjellë mbarësi, sepse këta kanë nevojë për shi. Unë jam ai që u kam siguruar të vjela të mira, thonë ata me bestytini të vërteta apo të shtira. Ata përmendin faktin se Liqenit të Prespës i është zvogëluar sasia e ujit në mënyrë shumë shqetësuese viteve të fundit, dhe më tregojnë se ku më parë ishte vija e plazhit dhe unë e kuptoj shqetësimin e tyre.

Vasviu, si zakonisht, tregohet i gatshëm si shofer me ne është edhe Edita që ka marrë leje nga puna për të na shoqëruar. Ne dridhemi nga të ftohtët kur e vizitojmë portin e

Ohrit dhe më pas shkojmë te rrënojat e kalasë që ende kanë mbetur që nga koha osmane. Ka pasur edhe kisha me vlera të mëdha – ky vend ka qenë një strumbullar i hershëm për kishën greko-ortodokse – dhe xhami të ndryshme. Hotelet e bukura dëshmonin se kjo trevë njëmend është një vend i pëlqyer turistik, edhe pse turizmi me siguri ka humbur me çoptimin e Jugosllavisë. Nga lartësia e kalasë unë shikoj tutje kah malet, ku vitin e kaluar ndodhi një katastrofë me një aeroplan, katastrofë e cila mori shumë jetë.

Në Strugë, një qytet i njohur për festivalin ndërkombëtar të poezisë që mbahet çdo vit, e vizituam vëllain e Jusufit, Ashim Iljazin, i cili 15 vjet ka jetuar në Australi, ku ka fituar aq shumë para sa ai nuk kishte më nevojë të punonte. Ai më premtoi se do të më çonte në Tiranë, pas katër ditëve.

Kishte shumë shqiptarë nëpër rrugët e Strugës, por në Ohër pak më pak. Diskriminimi duket shumë qartë edhe për vetë faktin se asnjë nga pllakat e emrave të rrugëve, apo afishet, nuk janë lejuar të shkruhen në gjuhën shqipe nëpër rrugë. Nuk ka madje as gazeta në gjuhën shqipe në kiosqe. Duket krejt qartë se fryma pansllaviste sundon në Maqedoninë e sotme: Ky është një vend i sllavëve dhe shqiptarët, turqit si dhe të tjerët duhet t'u nënshtrohen atyre. Unë fitova përshtypjen se represioni maqedonas ka përmasa ndoshta më të mëdha sa edhe diskriminimi në Kosovë. Dhe në prapaskenë qëndron Moska, që si një vëlla i madh, por i lig, e nxit frymën pansllaviste. Mbase është paksa e padrejtë të demonizohen sllavët. Si është gjendja në botën perëndimore? Cilat janë mundësitë që ne seriozisht ta sfidojmë kulturën Coca-Cola, sundimin e NATO-s dhe nënshttrimin pakashumë të plotë të ekonomive kapitaliste ndaj asaj amerikane? Mbase lëvizja pansllaviste, si ajo fundamentaliste në kuadër të islamit, është një përgjigje josimpatike por e kuptueshme ndaj dominancës militare dhe ekonomike amerikane? Të gjitha këto forca me të drejtë mund të akuzohen për intolerancën e tyre, idiotizmin kokëfortë, i cili sipas nevojës mund të zhvillohet në brutalitet, por në një botë të çmendur aktorët lehtë mund të bëhen edhe më të çmendur. Po të mund ta ndalnim botën, jo sa për të ikur nga ajo, por për të bërë një plan veprimi të cilin do ta pranonin të gjithë (përveç shfrytëzuesve, të cilët me gjithë qejf do të dëshironin t'i flaknim në ferr) mbase do të bëhej e mundur që të krijohet një rend i ri botëror. Por bota sillet pandalshëm dhe shumë besojnë sot se tashmë është bërë vonë për diçka të tillë...

Pleq, plaka dhe murgësja të vogla e të zymta

Dikur u kthyem te ngrohtësia e shtëpisë. Edita e pranon një grua maqedonase dhe ia rregullon flokët në shtëpi. Televizioni maqedonas ka një program të shkurtër në shqip për çdo ditë. Kësaj here shfaqet një gjepurë e mjeruar e që duhet të paraqesë një zbavitje shqiptare, por ajo as është zbavitje e as shqiptare...

Burri i gruas maqedonase futet brenda. Di të flas bukur mirë shqip dhe mua më jepet rasti të flas me të. Këtu në fshat, faktikisht, është një pjesë bukur e mirë e maqedonasve që dinë shqip, por Jusufi djallëzisht thotë se një pjesë e maqedonasve kurrë nuk kanë treguar se dinë të flasin shqip përpara se të vinin për vizita blerësit e frutave nga Shqipëria dhe atëherë, këta maqedonasë, mundën “papritmas” të bënin tregti duke folur shqip!

Ky njeri, në rininë e tij, kishte qenë tetë vjetë me radhë anëtar i gardës mbrojtëse të Titos. Është interesant për të konstatuar se shqiptarët në përgjithësi janë pozitivë kundrejt diktatorit të vdekur. Ai, kur kishte shkuar në vizitë në Kosovë, që pritur me duartrokkitje. E çuditshme, sepse masat e tij nuk kanë qenë gjithherë në të mirë të shqiptarëve. Por ata sigurisht se kanë rezonuar kështu: Titoja kishte bërë më të mirën e mundshme në situatat e komplikuara.

Çdo mëngjes, Nadirja e ndez stufën e kuzhinës, gjë të cilën e bëri edhe sot më 7 prill 1994. Ngrohja nevojitet për të larguar tkurrjen nga të ftohtit e mëngjesit. E sot faktikisht është një mot i thatë. Si zakonisht, unë ulem e rri në kuzhinë, kjo epiqendër për aktivitetet e shtëpisë, si në të gjitha familjet e thjeshta në këtë botë: te prindërit e mi, në banesën time si i rritur, e edhe këtu. Një plakë vjen në vizitë. Ajo banon në një fshat 5 km larg dhe në këtë rrethinë ka jetuar tërë jetën e vet. Një herë ka bërë një vizitë tre javëshe në Malmo në Suedi, si dhe në Danimarkë, për t'i vizituar të afërmit. Ajo është e veshur me veshjet tipike të plakave: një shami të kuqe, një bluzë të kaltër me një xhakëtë bojëkafe sipër, fustan të zi, dhe çorapa të njëjta. Hetoj se shqipja e kësaj plake është e përzier me turqizma dhe më pas, nga Nadirja, mësoj se nëna e saj ka qenë një turke etnike. Nadirja më jep kompliment për veshin tim të mirë për gjuhën shqipe.

E nisa me Nadiren një bisedë lidhur me traditat, një temë e cila gjithsesi shfaqet sa herë të kesh kontakte me një kulturë të huaj. Për Nadiren, e cila e ka përjetuar jetën në Beograd dhe Eskilstunë, është më e lehtë të dallojë midis traditave specifike dhe atyre tipike se sa për një person që tërë kohën ka jetuar vetëm në një vend. Ajo tregon se vajzat e reja shqiptare këtu kanë një liri sociale, mund të lozin dhe mund të shoqërohen mjaft lirë derisa të bëhen 15-16 vjeçare dhe pas kësaj kohe, ato tërhiqen nga shoqërimet; sepse atëherë priten të drejtohen kah detyra e tyre e ardhshme si gra dhe të jenë larg çdo dyshimi për një jetë të shthurur. Fjalët e Faik Konicës, të thëna afërsisht para njëqind vitesh, mbi “murgësia të vogla e të zymta të cilat presin fatin e tyre” vlejnë edhe sot. Njerëzit, sidoqoftë, kanë mirëkuptim pse Edita, e cila është rritur në Beograd, është disi më ndryshe se sa vajzat e fshatit. Por ky është një dallim, që mund të kushtojë.

Mëllënja këndon në lartësitë e Peristerit

Nadirja na qeras me piten e saj të mirë – një ushqim që është diçka në mes të petullës dhe pudingut, me mbushje si spenaq ose hithëra. Ajo di të gatujë mirë, sepse jo më kot ka punuar në një restorant në qytetin e madh Beograd. Zakonisht nuk jam shumë optimist sa i përket ushqimit shqiptar (që në pjesën më të madhe bazohet në prototipin turk), ai nuk është më i keq se sa ai anglez, gjerman apo norvegjez, por nuk mund të krahasohet me ushqimin francez apo italian. Sidoqoftë, Nadirja mburret me artin e saj të gatimit dhe unë asaj gjithnjë i thur lëvdata. Dhe lavdërimi, në këtë ambient të zymtë, prore është një nxitje për të.

Bashkë me Nexhatin shëtisim kah jugu deri në fshatin Pretor. Bënë ftohët, por shkëlqimi i diellit i jep gjallëri shëtitjes sonë. Pas kthimit merrem me fotografim intenziv. Nadirja me piten e saj, Edita si frizere me vajzën e çiftit që dje ishin këtu, Nadirja dhe nëna e saj, Agroni duke u hedhur ushqim pulave dhe të tjera pamje nga idili i jetës së fshatit.

Në mbrëmje, me Nexhatin shkuam te pijetorja e fshatit, që e gjetëm të mbushur përplot, me shqiptarë e me maqedonas të të gjitha moshave. Ata pinin birra dhe flisnin mu ashtu sikurse flasin në të gjitha pijetoret e fshatrave, kudo në botë. Një shqiptar ka qenë në Australi dhe flet mirë anglisht, një tjetër më i moshuar është shumë i dhënë pas historisë, për çka ai respektohet nga të tjerët.

Më vonë, shkova te Gëzimi, djali i Maidës e i Jusufit, i cili më tregoi vizatimet e tija. Gëzimin e ndihmova lidhur me detyrat; ai është nëntëvjeçar dhe shkon në klasën e tretë. Nëna dëgjonte me kujdes se çfarë mendoja unë dhe krenohet kur i them se djali i tyre është i zoti në detyrat shkollore. Gëzimi e ka një fanellë me mëngë të shkurtëra me tekstin “Mjolk är livet” (“Qumështi është jeta”), një kujtim nga Suedia. Ai më tregon se ka dëshirë për t’u kthyer në Suedi; e ka gjyshën dhe farefisnin këtu në fshat, por megjithatë... Bota është e mbushur përplot me të rinjë, të cilët mbartin në vetëvete një kujtim të mirë për Suedinë.

Suedinë e arrijmë sërish përmes radios në orën 23 dhe mësoj se ekonomia shënon ngritje dhe se Karl Bildi (ish kryeministër i Suedisë) ka premtuar vazhdimin e ndihmës për Vietnamin.

Më herët gjatë ditës një bujk shqiptar e ndaloi traktorin dhe më tregoi një barcoletë ekuivoke: një vajzë nga Shqipëria kishte emigruar në Itali dhe i kishte shkruar së ëmës. E kësaj do t'i jenë prerë këmbët dhe do të jetë ulur e traumatizuar tërësisht, kur djali ia kishte lexuar letrën. “Jam shumë e kënaqur me Pescara” shkruante vajza. Mirëpo fjala “Pescara” në shqip merr kuptimin e numrit pesë plus organin gjenital të burrit! E gjora nënë, ajo e kishte menduar më të keqen – orgji në një vend të huaj. Ky ishte humori shqiptar fshataresk. Gjyshi im Heningu, i cili poashtu ishte fshatar, kur isha i ri më kishte treguar një paturpësi të ngjashme, domethënë diçka që bazohet në keqinterpretim të fjalëve. Fshatari kishte shkruar në qytet, dhe atje i dhanë leje për t'u marrë me tregti, prandaj ai e dërgon një telegram në shtëpi: “Sänd pigan med stora låren. Jag har fått stånd!” (Shpjegim i përkthyesit: Fjalët që mund të keqinterpretohen për shkak të dykuptimisë janë “låren” (=loren) që domethënë edhe “arkë” e edhe “kofshë”, si dhe “stånd” (=stond) që domethënë edhe “leje me banak” e edhe “erekcion”. Kuptimi i menduar i fjalisë është “Dërgoma vajzën me arkën e madhe, se e kam marrë lejen!”, kurse keqinterpretimi është ky: “Dërgoma vajzën me kofshët e mëdha, se e arrita erekcionin!). Kur më pas e kam ritreguar historinë nga Asamati në një bisedë gojore me dy doktorë filozofie në Tiranë, komenti i tyre ishte: “Është fantastike që një fshatar shqiptar në Maqedoni tregon histori me kaq finesë!”.

Ditën tjetër, kur u detyrova të shkoja te nevojtorja primitive, këndonte mëllenja nga një majë lisi, ndërkaq prapa qëndronin malet e Peristerit. Këto male që përbëjnë prapaskenën me majet e veta të mbuluara me dëborë nuk janë tmerruese sikurse alpet e veriut të Shqipërisë ose masivi në perëndim të rrafshnaltës së Dukagjinit në Kosovë, por këto nuk e kanë as madhësinë olimpike të Tomorrit në Shqipërinë e mesme. Madhësinë e Tomorrit e kam përjetuar një ditë të nxehtë në verën e vitit 1970, atëherë kur bashkë me një grup danezësh u munduam fort përpjetë kodrës deri te kështjella e Beratit; në anën tjetër fusha me pamjen e freskët nga dëbora shihte drejt malit të lartë 1418 m.

Fshatrat e kullave prej gurit

Sot na premtohet një shëtitje interesante. Do t'i vizitoj fshatrat binjake Kranjë dhe Arvat, që shtrihen 6 km në jug të Asamatit. Në automobilin e Vasviut udhëtojmë: Nexhati, Jusufi, Maidja dhe unë. Fatkeqësisht, moti u prish dhe filloi të bie shi, sa dëm! pasi që fshatrat nuk janë të zakonshme. Askund nuk kam parë diçka të ngjashme, ndoshta mund të cilësohet si një Gjirokastër në miniaturë. Lexuesi që nuk ka shëtitur në viset shqiptare, mund ta gjejë në bibliotekë romanin e shkëlqyeshëm “Kronikë në gurë” të Ismail Kadaresë, ku pasqyrohet ambienti i Gjirokastrës në mënyrë shumë të qëlluar: gjithçka është prej guri, shtëpitë janë si të vendosura njëra mbi tjetrën. Këtu në Arvat e shoh një ambient të ngjashëm arkaik. Shtëpitë janë ndërtuar me siguri për t'u mbrojtur nga sulmet, me mure të trasha prej guri dhe me frëngji. Ne shkonim rreth e rrotull dhe shikonim gurët dhe rrugicat ndërmjet tyre. Pastaj ishte koha të shkonim te Sadberi, vajza e Jusufit dhe e Maidës. Ajo ndjehet paksa e izoluar në këtë ambient. Burri i saj Ditari zakonisht është përjashtë, duke u kujdesur për arat ose shkon në gjueti. Vazhdojmë deri te shtëpia e Muhamer Zerveskit, ku bëjmë shumë biseda dhe dhe pimë shumë raki. Babai i Muhamerit, Kaderi, na ftoi në shtëpi dhe aty erdhi një politikan lokal – Sabri Sulejmani, i cili, më vonë, në të njëjtën ditë, erdhi në vizitë te Nexhati. Si pasojë, ne u vonuam shumë, e kjo është problematike, pasi që pijetorja duhet të hapet për myshterinjtë, të cilët me siguri rrinë aty e presin të zemëruar. Muhameri e ka një vëlla në Heleforsh, të cilin e kam kontaktuar kur u ktheva në Suedi.

E shpreha mendimin se do të duhej që të investohej në turizëm, edhe se Partia e Prosperitetit Demokratik do të duhej të vinte kontakte me Suedinë për të zgjuar interesimin lidhur me diskriminimin e shqiptarëve në këto anë. Një pjesë e gjërave do të duhej të merreshin në konsideratë nga Gjykata Evropiane. Por shqiptarët nuk kanë avoketë të mirë në botë.

M'u shfaqet një problem: zëri thuajse m'u shtjerrë fare si pasojë e bisedave të shumta dhe e gjithë asaj raku me të cilën u qerasa. Kjo më ngjau në kohën kur vërtet doja të flisja. Sabriu, politikani lokal, vjen në vizitë. Ai lë një përshtypje pozitive, është i qetë e i matur, ka studiuar në universitetin e Prishtinës dhe flet shqip pa gabime.

Sabriu më fut në rrjedhën e ngjarjeve. PPD është përçarë në dy fraksione. Njëra është e gatshme të bashkëpunojë me organet maqedonase, kurse tjetra e ka të kthyer shikimin kah atdheu, Shqipëria. Në Resnje e kishin të vështirë të përcaktoheshin, mirëpo kur u pa se shumica prej 17 njësive lokale i përkrahnin "këta të rinjtë" – edhe këta vendosën që t'u jepnin përkrahje. Vendimtare ishte qëndrimi i Shqipërisë.

Në fillim të viteve të '90-ta, kur Maqedonia ishte bërë shtet i pavarur, shqiptarët kishin qenë të angazhuar për autonomi politike. Kurse tash ata kanë kaluar te kërkesa për proporcionalitet në pushtet e parlament, në jetën shoqërore dhe kulturë.

Unë replikoj duke thënë se e kuptoj se Sabriu e karakterizon atë linjen e parë si naive, të mbështetur në papërvojën politike të shqiptarëve. Por autonomi do të thoshte ose që ato pak komuna të cilat kanë majoritet shqiptar do të bëheshin rrethina autonome (që do të ndaheshin si rripi i Gazës respektivisht Bregu Perëndimor në Palestinë) ose do të duhej prekur kosheren e grerëzave duke kërkuar që të gjitha rrethinat me minoritet shqiptar do të duhej të futeshin në një territor autonom. E si do të reagonin atëherë maqedonët?

Lamtumirë Asamat!

Është një mëngjes melankolik: unë duhet ta lë familjen Shabani, të udhëtoj deri në Strugë për të vazhduar më tutje për në Shqipëri. Nadirja, Edita dhe Agroni i fshijnë lotët nga sytë – shqiptarët vërtet dinë ta shprehin ndjenjën e mikpritjes dhe të pikëllimit gjatë ndarjeve nga musafirët.

Në shtëpi të Ashimit në Strugë shikoj një inçizim të vjetër nga TV-Tirana me këngëtarin Ibrahim Tukiqi, me të cilin jam takuar në Vermland, kur ai ishte azilkërkuar në Suedi. Asokohe, në minibusin e dhëndërrit dhe të vajzës sime, ai këndonte arie aq sa xhamat dridheshin... Filmi tregon se shqiptarët në banesat e tyre ende jetojnë si në kohën e kalorësisë, mënyrë jetese të cilën ne suedezët e kemi braktisur para 500 vitesh. Shqiptarët janë kalorësit e fundit feudalë, dhe në mungesë të bukës e të lirisë shqiptarët ushqehen me legendat e tyre të moçme. Sigurisht se njeriu mund edhe të vdes, vetëm të mos koritet sepse "Shqiptari vdes por nuk koritet"...

Dita e nesërme fillon heret. Ashimi dhe unë zgjohemi pa zhurmë, për të mos e shqetësuar bashkëshorten e tij Magbulen; nisemi që në ora 04.30. Por Ashimi ka bërë një llogari gabim: Stacioni te kufiri është i mbyllur dhe neve na duhet të presim një orë aty. Rrugës brenda në Shqipëri shoh njerëzit më të varfër që ndonjëherë i kam parë në jetën time. Një plakë ecën e ngarkuar me një turrë të madhe drunjsh në shpinë, njerëz me fytyra të mërzitura presin autobusin. Këta janë njerëz që e dinë se ç'domethënë uria. Afër Tiranës e marrim në veturë Luljetën, një mësuese nga një fshat në malësi. Ajo tregon se ka një shoqe, që është martuar me një shqiptar të Maqedonisë, nga Gostivari, atje lart në veri. Ajo qanë gjatë tërë kohës, tregon Luljeta, se nga burri i saj fanatik është e mbyllur si në burg. Kurse unë e siguroj se shqiptarët nga Maqedonia jugore nuk janë aq primitivë, dhe gratë e kanë një pozitë shumë më të mirë.

Ashimi nuk do kurrfarë kompenzimi për atë që më solli me veturë – mezi arrita t'ia japë veç dikund rreth 120 korona suedeze si pagesë për benzinën. Kthimi ishte, pra, rreth njëzet herë më i lirë se sa shkuarje në Asamat! Kuptova se Ashimi ka një qëllim të dyfishtë me udhëtimin. Ai flet aq shumë për vajzat në Tiranë dhe më pyet se mos doja edhe unë të gjeja ndonjë lidhje, dhe disa orë më pas erdhi te Estrefi bashkë me një grua, të cilën e prezantoi si një të afërme, por unë dyshoj në këtë. Fillova, sakaq, të mendoja për *Vajzën në Havanë...*

Ditët e fundit në Tiranë

Tash jam kthyer te kujdesi besnik i Estrefit, dhe ne hamë një drekë të këndshme në shtëpi të tij. Estrefi është një person i stresuar, por kuzhinier i zoti, një shembull i mirë i burrave të emancipuar shqiptarë, të cilët nuk rrinë duarkryq kur gruaja nuk është në shtëpi. E unë mendoj në antipodin e tij, që një ilustrator shakaxhi e ka skicuar në revistën “Hosteni” diku në vitet e '60-ta: Një burrë kokëgjel, i ulur në një kolltuk të madh, me fëmijën e vogël, edhe ai kokëgjel, në një kolltuk më të vogël krahas tij, dhe në derë gruaja-nëna me një tabaka në duar...

Në drekë vjen edhe Xhafer Dobrush. Takimi me të, pas 30 vitesh nga takimi ynë i parë, është diçka fantastike! Në vitet e '60-ta Xhaferi ishte shef i Radio-Kukësit, një qytet i vogël ky në këndin verilindor të Shqipërisë, i cili u bë i njohur në botë atëherë kur ai u vërshua nga të dëbuarit prej Kosovës. Më thanë në Shqipëri se ishte diçka surrealiste që Radio-Kukësi të dëgjohej në Suedi kur mezi dëgjohej në Tiranë! Mirëpo valët e shkurtëra dhe jonosfera e kanë atë veti të çuditshme, pasi që radiovalët mund të arrijnë deri në një gjendje reflektuese dhe prandaj ato mund të dëgjohej me mijëra kilometra larg – por jo në zona të ndërmjetme. Asokohe Xhaferi më ishte përgjigjur në letrat që i kisha dërguar – natyrisht pasi që i ishte dhënë leja nga Komiteti Ekzekutiv i Partisë – dhe më kishte dërguar edhe një telegram për një program të dëshiruar me muzikë. Që atëherë Xhaferi ka studiuar drejtësinë dhe ka qenë ligjërues i filozofisë marksiste në universitet. Kjo nuk është ndonjëfarë merite në Shqipërinë e sotme, por Xhaferi pati marrë detyrën e përfaqësuesit në Sindikatën e mësimdhënësve. Xhaferi, si edhe Estrefi, është një njeri i këndshëm, një shembull i mirë, gjë që tregon se nuk ishin vetëm horrat ata që e kishin bartur mbi vete shoqërinë komuniste. Shumica e tyre nuk mund të cilësohen si horra në krahasim me idhtarët e Sali Berishës, i cili tash i mbanë frenat e pushtetit!

Një shëtitje në qytet – aty ku kafja dhe konjaku për tre veta kushton 48 korona suedeze, por që miqtë e mi mendojnë se është shtrenjtë. Pastaj bisedojmë me një shitës rruge shumë të pakënaqur; ai shet frute për shkak se nuk ka punë dhe mendon se është turp që njerëzit të detyrohen të jetojnë në kufi të urisë në Shqipëri. Një njeri tjetër e ka një dyqan, të cilin e drejton bashkë me gruan – që të dy kanë të mbaruara studime universitare dhe me siguri se nuk kanë llogaritur në një jetë të këtillë. Të këqiat vetëm shtohen: Estrefi mërzhitet që një i ri që vlarë me armë automatike në rrugë të hapur në qendër të Tiranës afër Bankës Shtetërore. Disa ditë më parë policia, pas një ndjekjeje të egër dhe gjuajtjesh të ndërsjella me armë, i kishte ndalur disa të rinj, që kishin shumë armë në automobil.

Në shoqërinë totalitare ishte pushteti ai që vriste, e tash janë anarkia dhe mungesa e ligjit ato që shkaktojnë dhunë. Tirana nuk është si Çikago në vitet e '30-ta, por shenjat janë shqetësuese. Përveç kësaj, Estrefi më tregon se metoda e vjetër për mbikqyrje ka filluar të shfaqet sërish. Po që se dikush e viziton një ambasadë të huaj mund të vihet nën “mbikqyrje” rrugës për në shtëpi. Pse? Çka frikohet pushteti shtetëror? Në bashkëbisedim me Estrefin dhe Xhaferin, këta shprehin mendimin se disa pamje të vrazhda të Shqipërisë së sotme nuk duhet as të përfshihen në përshkrim, sepse

përshkrimi duhet të jetë realist dhe pikërisht nga kjo mungesë vuan shumë filma të viteve të '90-ta, të cilët karakterizohen nga një qëndrim negativ e i njëanshëm.

E diskutojmë problemin e grumbujve të mbeturinave që janë krijuar në çdo oborr pas shtëpive e të cilat vetëm shkonin duke u rritur. Më parë detyroheshin njerëzit që me punë “vullnetare” të punonin për të pastruar ambientin e afërt, e tash nuk jepet as kontributi i banorëve e sa i përket kompanisë për marrjen e mbeturinave – as që e meritonte të quhet ashtu. Këtu mbase do të duhej një “diktaturë e edukatës”. Për shembull, policia do të duhej të merrte masa të rrepta ndaj një fqiu të Estrefit, i cili i hedhë mbeturinat direkt prej ballkonit të katit të tretë. Mund të merret me mend se çfarë ndjen fqiu i katit nën të, kur një pjesë e mbeturinave bien në ballkonin e tij.

Ne jemi të një mendjeje se grumbujt me plehra dhe lypësit nëpër rrugë nuk i shërbejnë si mbështetje vullnetit të të huajve për investime si dhe turizmit në Shqipëri.

Më 11 prill artisti Pleurat Sulo më ftoi të shihja fotot e tija. Ato ai i ka vendosur në një dhomë të Muzeut Historik Kombëtar. Fotografitë kryesisht janë me ngjyra, 70x50 cm dhe të një klase të lartë. Ai ka zgjedhur pjesën më të mirë të kulaqit shqiptar: qytetet muzeale, vendet dhe gjësendet arkeologjike, kostume popullore, pamje alpine, kisha të vjetra me ikonografi si dhe xhami. Përveç kësaj ka edhe portrete, kryesisht bardhezi.

Ishte kënaqësi që ky koleksion arriti të prezentohej në Suedi në vitin pasues, ndër të tjera edhe në Shtëpinë e Kulturës në Stokholm.

Pleurat Sulo nuk e ka pasur lehtë gjithmonë. Nga Estrefi mësoj se ai për disa vite e ka marrë një studente në studion e tij dhe e ka fotografuar atë lakuriqe. Sekush e zbuloi se ç'po bënte dhe dha alarmin. Sigurimi kishte mijëra sy gjithkund. U dënua me disa vite burgim për krim seksual. Anders Zorni dhe fotografi i vajzave Kary Lasch, po të jetonin në Shqipëri, do të kishin pasur pasoja shumë të rënda.

Vizita tjetër e kësaj dite i dedikohet Xhafer Dobrushit në zyrën e Lidhjes së Mësuesve. Ambienti është deprimues, është jashtëzakonisht ftohët në lokale dhe disa ventilatorë të vegjël nuk mund të bënin shumë për të ngrohur. Vend i papërshtatshëm për shëndet dhe Xhaferi duket se nuk ndihet mirë në atë vend pune.

Dikur më vonë ha drekë me Xhaferin dhe gruan e tij, zonjën Zyra, në shtëpinë e tyre. Vajza e tyre, që quhet Erida, si edhe vajza e Estrefit, hanë me ne poashtu. Ne shikuaam fotografitë e vjetra nga Kukësi, veçanërisht nga puna në radio. Zyra poashtu kishte punuar si folëse në atë grup të vogël prej katër vetash. Tash më duket si diçka joreale, pas më shumë se tridhjet vjetësh kur unë kisha dëgjuar këtë stacion të vogël atje lart në mal.

Në mbrëmje Edi më çon te një familje cigane muzikantësh. Babai, Ethem Qerimaj, është një violinist i njohur, “Artist i merituar” dhe djali, Fatosi, ligjëron në Akademinë e Artit. U dha për një orë një koncert shumë i mirë, por ata nuk pranuan ndonjë kompensim ekonomik nga unë. Unë jam mik i Shqipërisë dhe, prandaj, ata ndiheshin të lumtur që kishin lozur në instrumente për mua. Unë turpërohem, nga shprehia për të gjykuar romët si popull që në çdo situatë duan të marrin para. Do të duhej të gjykoja më mirë. E si është puna me paragjykimet e mia?

Ditën tjetër udhëtoj për në atdhe. Me vete kam shumë shënime lidhur me projekte të ndryshme të mundshme, që unë llogaris se do të mund t'i realizoj në Suedi. Kanë të bëjnë me persona të ndryshëm dhe grupe të ndryshme, që kanë diçka me vlerë të na ofrojnë neve skandinaveve, programe të ndryshme në kuadër të fushës kulturore. Kur arrita në shtëpi ia dërgova të gjitha materialet Institutit Suedez. Tronditem kur mësoj nga ata se asnjë nga projektet e propozuara nuk mund të realizohet. Nuk ka mjete të dedikuara për gjëra të tilla. Për fat, unë nuk kam premtuar asgjë, megjithëse kisha shpresa të mëdha – por ato u shembën përdhe. Ndihem tmerrësisht i frustruar – sa shumë doja të bëja diçka për ata njerëz të mrekullueshëm dhe të vuajtur!

Por dy ditë pas kthimit tim në shtëpi ndodhë diçka që më lehtëson shumë: Qeveria merr vendim që të gjitha familjet me fëmijë nga Kosova që kanë ardhur në Suedi para 1 janarit 1993 do të marrin lejeqëndrim në Suedi. Shumë nga miqtë e mi që prisja të refuzoheshin do të mund të vazhdonin jetën e tyre në Suedi.

E me këtë po kthehem te prezantimi i Shqipërisë në vitet e '90-ta.

NGA KRIZA KUSHTETUESE MË 1994 DERI TE SHEMBJA MË 1997

Ka shumë shembuj nga vitet 1994-1996 për zvogëlimin e besimit ndaj Partisë Demokratike. Brenda partisë që rritur korrupsioni në shkallë të lartë dhe Berisha i që kushtuar një lloj nepotizmi të gjerë: shumë nëpunës u spasturan dhe u zëvendësuan ku më shumë e ku më pak me persona jokompetentë nga rajoni i Berishës. Por më seriozja që bashkëpunimi me mafian që doli në sipërfaqe në lidhje me një vrasje politike në Shkodër në janar 1994. Ishte anëtari i AD Gjovalin Cekini i cili u vra nga Selami Çela pas një mbledhjeje; dorasi ishte vëlla i ish shefit të policisë në Shkodër. Vrasjes i parapriu një provokim i anëtarëve të PD, që kishin ardhur për ta prishur mbledhjen. E tëra kishte të bënte me bandën mafioze dhe mosmarrëveshjet midis tyre. Lideri i AD Neritan Ceka shkruan: "Gjendja më shqetësuese tash është lidhja midis qeverisë dhe mafias, veçanërisht rretheqark Shkodrës, ku shkelen sanksionet e OKB kundër Jugosllavisë. Ne besojmë se vrasja e një anëtari të AD më 14 janar është e lidhur me këtë. Sipas të dhënave që ne i kemi, PD në Shkodër kishte vendosur që 25 anëtarë të tyre të merrnin pjesë në mbledhjen tonë. Ne besojmë se vrasësi ishte po në këtë grup. E nuk është arrestuar askush dhe qeveria ka refuzuar shumë kërkesa në takimet me anëtarët të AD".

Më vonë, në të njëjtin vit, ndodhi kriza më e madhe deriatëherë në PD. Nga marsi i vitit 1991, sikurse e kemi thënë, ishte në fuqi një kushtetutë e përkohshme, dhe puna për një kushtetutë të plotë filloi menjëherë pas fitores së PD-së në zgjedhjet e vitit 1992. Punët shkonin jashtëzakonisht ngadalë, dhe vetëm kur u tha se për një anëtarësim të mundshëm të Shqipërisë në Bashkimin Evropian kërkohej kushtetuta – u përshpjetuan punët. Datë e fundit u caktua 30 nëntori 1994.

Berisha kërkoi ndihmën amerikane për të qëndisur një kushtetutë sipas nevojave të tij. Dhe tradita amerikane me një pushtet qendror të presidentit ishte si e bërë për Berishën. Por kushtetuta nuk u pëlqye nga Kuvendi Popullor dhe madje nuk e kaloi as referendumin që e kishte imponuar Berisha: 55% votuan kundër e veç rreth 40% votuan për. Berisha u trondit dhe u detyrua ta pranojë këtë fakt. Pozita e tij ishte dobësuar dukshëm.

Shqipëria e viteve 1994-1995 megjithatë ishte diçka më mirë se disa vite më parë. Njerëzit ishin më mirë të veshur, herë-herë shfaqeshin mungesa në ushqime por megjithatë gjatë pjesës më të madhe të vitit kishte ushqim të mjaftueshëm. Veç dallimet ishin të dukshme midis kryeqytetit të Tiranës dhe regjioneve të tjera. Vendbanimet e shpopulluara, të cilat më parë qenë mbështetur në një lloj industrie, karakterizoheshin nga rënia dhe apatia. Në Tiranë trafiku ishte i tmerrshëm, ani se vetëm 5% e familjeve të kryeqytetit kishin vetura. Ndërtohej shumë, por në mënyrë të paorganizuar. Qendra e Tiranës ishte farmakosur nga kiosqet, zakonisht të vendosura në parqet e bukura të dikurshme. Me kohë, përmes ligjit, i kishin hequr ato më të këqijat, porse qetësia e vjetër e Tiranës ishte poashtu e humbur. Aktual ishte problemi me energji elektrike dhe ujë. Duhej kujdesur për të ruajtur kohën kur ujët vinte dhe atëherë të përdroreshin pajisjet elektrike.

Kriza e PD vazhdonte. Berisha ia ktheu shpinën kryetarit të PD Eduard Selami, një filozof i qetë dhe i kultivuar nga elita e vjetër e Tiranës. Selami duhej të largohej. Po kjo ndodhi edhe me kryetarin e Gjykatës Supreme Zef Brozi, të cilit iu imponua largimi pasi ky kishte kritikuar Ministrinë e Brendshme në lidhje me të drejtat e njeriut. Brozi kërkoi dhe mori azil politik në SHBA, ku kishin filluar të kuptonin se ç'po bënte Berisha. (Përderisa SHBA-të po ia ngrehnin veshët vetvetes, ishin shumë pak politikanë në Evropën Perëndimore që kuptonin se ç'po ngjante në Shqipëri.).

Pasi kishte bërë një propagandë frikëmbjellëse dhe kishte ushtruar presion për të siguruar fitoren në zgjedhje, PD dhe Berisha e konsideronin veten të përgatitur për zgjedhje, që ishin caktuar për 26 maj 1996. PS kishte një problem të madh: lideri i saj Fatos Nano, pa fakte të qëndrueshme, ishte dënuar me burg për përvetësim të mjeteve shtetërore. Edhe Ramiz Alia ishte burgosur, dhe dënuar se kishte keqpërdorur pozitën e tij. Nano ishte lidhur me evrosocialistët, por ai kishte një kundërshtim të fortë konservator brenda partisë.

Atmosfera në vend ishte përplot shqetësim në prag të zgjedhjeve. Ankesa të vazhdueshme vinin nga Socialistët dhe partia e vogël socialdemokratike. Dhe zgjedhjet njëmend ishin skandaloze, me manipulime, fletëvotime false dhe presion kundër votuesve. Në mbrëmje raportet lidhur me mashtrimet në zgjedhje ishin aq alarmante sa që PS, socialdemokratët dhe Aleanca Demokratike lajmëruan se do të tërhiqeshin dhe deklaruan bojkotimin e zgjedhjeve. Megjithatë, rezultati i zgjedhjeve u pranua: PD fitoi 95 nga 115 mandate sa i përket rëndësimit të parë të zgjedhjeve, Socialistët fituan 5.

Observatorët e OSBE-së, që kishin kontrolluar rreth 300 vendvotime, raportonin për “parregullsi serioze” dhe u paraqitën disa shembuj. Pas rrethit të dytë të votimeve PD kishte 122 nga 140 vende në parlament. Rrethanat bënë që opozita të bojkotojë punën e parlamentit.

Kësaj here, për të parën herë, SHBA-të reaguesh shumë seriozisht kundër Berishës. Edhe Këshilli Evropian bëri po këtë. Përderisa Evropa u mjaftua me vërejtje, SHBA-të shkuan më tej dhe kërkuan përsëritjen e zgjedhjeve. Ambasadori i SHBA-ve nuk mori pjesë në hapjen ceremoniale të parlamentit, kurse pjesa dërrmuese e emisarëve evropianë morën pjesë sikur gjithçka të kishte shkuar në mënyrë normale.

Më e keqja ishte se pikërisht për shkak të mbështetjes nga Perëndimi u bë e mundur që Berisha të mposhte tërë opozitën dhe ta drejtonte vendin në një rrugë që e largonte atë nga demokracia e vërtetë. Gabimi më i madh i Perëndimit ishte investimi në Berishën si “njeri i fortë” në vend që të ndërtoheshin institucionet që ishin të domosdoshme në shoqërinë shqiptare. Këshilltarët nga Perëndimi rekomanduan shokterapi për jetën ekonomike shqiptare, dhe kjo mbase edhe do të kishte sukses sikur gjendja të mos ishte aq e mjerë. Sikurse thuhet, gjersa të rritet bari-cofë gomari. Kapitalizmi i egër i detyronte njerëzit të zgjedhnin midis urisë ose emigrimit.

Shqipërisë deri më tash i kanë munguar plotësisht lëvizje popullore të tipit të tillë që e nxorën popullin suedez prej mjerimit moral e social që mbretëronte në mesin e shekullit të XIX. Lëvizja kundër alkooholit, lëvizja për liri fetare dhe lëvizja punëtore kishin një rëndësi të jashtëzakonshme për përparimin social dhe emancipimin që e karakterizonte kohën në prag të ndërrimit të shekullit dhe më pas. Mund të shohim se druri dhe hekuri kanë luajtur një rol të madh kurse emigrimi në SHBA kishte zbutur trysinë shoqërore në shumë pjesë të vendit. Por pa çlirimin politik dhe emancipimin në nuk do të mund të ndërtonim themelet për sistemin social të mirëqenies, për të cilin në Suedi ishim krenarë; ky sistem kohëve të fundit po shkon duke u keqësuar gjithnjë e më shumë.

Shqiptarët u mashtruan gjatë vitit 1996 për të investuar kursimet e veta të dobëta në fondet e investimit. Pa përvojë lidhur me fuqitë e tregut dhe përmbajtjen e njëmendtë të kapitalizmit, shqiptarët e mjerë ranë në krahët e mashtruesve, të cilët kishin startuar lojën piramidale në vend. Baza ishte mafia, që ishte rritur në Shqipëri nën regjimin e Berishës, një mafi që e kishte shfrytëzuar luftën në Bosnjë për kontrabandim të derivateve, armëve dhe narkotikës. Këto banda kriminale zhvilloheshin fuqishëm për shkak të embargos kundër Serbisë dhe armë e derivate çoheshin përmes kufirit në Mal të Zi dhe Serbi. Por me Marrëveshjen e Dajtonit u ndërpre kontrabandimi. Kontrabandistët e armëve duhej të paguanin borxhet e tyre për armët e pashitura, të cilat i mbanin në depo. Nevojat për shuma të mëdha parash shpejt u rritën, dhe u gjet

zgjdhja - investimet në lojërat piramidale. Në këto lojëra mund të spastroheshin paratë e kontrabandës; pastaj populli u mashtrua me përqindje të lartë interesi për të krijuar besimin se edhe të vegjëlit tash mund të merrnin hisen e tortës së tyre. Llogaritet se shqiptarët kanë investuar midis 1.5 dhe 2.5 miliardë dollarë në këto fonde - shumë veta shitën shtëpitë që të mund të merrnin pjesë në festë....

E tëra mori fund në janar 1997. Resurset e Fondeve Xhaferi dhe Populli u konfiskuan nga qeveria. Por ishte vonë – paratë në pjesën më të madhe kishin ikur nga vendi.

Reagimi në vend ishte i egër. Në fund të shkurtit filloi një revoltë e armatosur në qytetin e Vlorës. Ky qytet luante rolin e dyshimtë të të qenit bastion i mafias, me të gjitha llojet e mundshme të trafikimit klandestin për në Itali, e pikërisht në këtë qytet pjesa dërrmuese e fondeve kishin përqëndruar veprimtarinë e tyre. Vlora u bë një skëterrë e të shtënave me armë dhe e dhunës. Dhe revolta u përhap në tërë vendin. Shoku Kallashnikov e kishte marrë komandën në duar!

SHQIPËRIA NË VORBULLIN E CIKLONIT

Në vend të përshkrimit të hollësishëm të gjendjes kaotike dhe anarkisë që mbretëronte në Shqipëri më 1997, unë po ia lë fjalën shkrimtarit shqiptar Fatos Arapi, me banim në Tiranë, por me origjinë nga Vlora, i cili në revistën "Drita", organ i Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptarë, më 19 shkurt 1997 bëri një analizë interesante të ngjarjeve në Shqipërinë e atij viti. Fatos Arapi është ekonomist dhe ka njohuri të mira në gjuhët sllave. Analiza e tij jepet këtu në formë të një rezymeje e jo me citate të sakta.

Kriza shqiptare

Brenda gjashtë muajsh u përmbys gjithçka në Shqipëri: ligji dhe rendi, administrata shtetërore, mbrojtja. Shteti u shemb. Populli u armatos, u shfaqën revolta, një kryengritje e armatosur. Vendi u katandis në një gjendje kaosi dhe dhune, ku krimi i organizuar dukej të ishte i vetmi faktor realisht i fuqishëm shoqëror.

Edhe po të mos kishte fare simpati për shqiptarët, bota nuk mund të shikonte të ndodhte kjo pa një ndjenjë shqetësimi. Një Bosnjën e shkatërruar nga lufta, një vend i trazuar si Qiproja, konflikti i hapur midis izraelitëve dhe palestinezëve ishin të tepërta. Një konflikt i katërt shkatërrues në Shqipëri mund të ishte vërtet i rrezikshëm për Ballkanin dhe për tërë Mesdheun.

Tash duhej marrë masa për të kufizuar ndikimet e trazirave në Shqipëri, ashtu që ato të mos përhapeshin në Kosovë dhe Maqedoni, si dhe të pamundësohej një emigrim i madh nga Shqipëria drejt Evropës perëndimore.

Që moti Shqipëria kërcënohej nga fqinjët shovenistë. Por asnjëri nga to nuk mund të shfrytëzonte gjendjen e trazirave për ndonjë përfitim direkt të tyre. Italia, e më pas Greqia, shpejtuan me masa të shpëtimit, treguan "solidaritetin" e tyre, pasi që siguria e tyre ishte kërcënuar. Tërësisht e qartë: Shqipëria është një shtet sovran, anëtare e KB. Kufijtë e vendit janë të përcaktuara qartë dhe të pacenueshme.

Bota sot: epoka e shndërrimeve të mëdha

Bota sot karakterizohet nga shndërrime të përmasave të mëdha. Grupime shtetesh krijojnë një treg, p.sh. Amerika, Japonia, Franca dhe Gjermania. Pastaj tregu i përbashkët evropian, tregu i Azisë lindore e kështu me radhë. Tregu përbëhet nga partnerë financiarë, që manovrojnë në nivel global. Por kahja e integritimeve në kuadër të një ekonomie botërore është vetëm një fenomen, e njëkohësisht ne shohim një kahje kah autonomia në shumë pjesë të ndryshme, krejt në kundërshtim me direktivat e tregut.

Edhe politika amerikane e edhe ajo e Evropës perëndimore synojnë që gjendjen e ekuilibruar që ishte arritur më parë midis shteteve të mund ta përshtasin paqësisht në rrethanat e reja, pa konflikte, për të evituar luftërat civile ose luftëra regjionale. Bëhen përpjekje për të siguruar që kufijtë të mbeten të pacenueshëm.

E në të njëjtën kohë, zhvillimi i pandërprerë ekonomik kërkon që vendet të zbatojnë ekonominë e tregut, të bazuar në pronën private, të sundojë pluralizmi në këto vende, të respektohen të drejtat e njeriut dhe ato etnike.

Pasojat e privatizimit në Shqipëri

Që nga fillimi i viteve të 1990-ta në Shqipëri janë zbatuar reforma të shpejta dhe radikale ekonomike: "privatizimi i shpejtë masiv" dhe "shokterapia". Por për të realizuar një privatizim të shpejtë e në shkallë të gjerë kërkohet një pushtet i fuqishëm, një administratë e fuqishme. Në një gjendje të tillë ka rreziqe të dukshme që "politika e

dorës së fortë” të shquhet me një prirje kah diktatura. Fenomene të këtilla janë shprehur në Shqipëri, në Rusi, në Bjellorusi dhe në vende të tjera.

Privatizimi i shpejtë dhe i përgjithshëm kërkon një sistem bankar. Kjo mungonte në Shqipëri, atje nuk kishte ndonjë rutinë apo disiplinë financiare. Pa parakushte të tilla privatizimi shndërrohet në vjedhje, korrupsion, në një mënyrë për pasurim të pushtetarëve dhe kastës politike. Privatizimi i këtillë kishte si pasojë varfërimin e masave të gjera popullore.

Rezultati? Pakënaqësi e përgjithshme popullore, dyshime, urrejtje që çoi në kryengritje me pasoja katastrofale.

Ekonomia centraliste socialiste kishte “një treg të natyrshëm” nëse mund të thuhet kështu. “Ekonomisë së planit” i përgjigjej një “prodhim i planifikuar” për të plotësuar nevojat minimale të popullsisë sa për të mbijetuar. Prandaj edhe ajo ishte një ekonomi dhe treg i mbyllur.

Gjatë periudhës kalimtare gjithçka u lejua të ishte e lirë: kufijtë e shtetit, doganat, kapitali, konkurrenca. Sa çel e mshel sytë Shqipëria u shndërrua në një “pazar” për tregtarët grekë, maqedonas, italianë, turkë, malazezë e të tjerë. Të gjithë përpiqeshin të shfrytëzonin gjendjen që të përfitonin sa të ishte e mundur më shumë në kurriz të konsumatorëve të pambrojtur shqiptarë. Prodhimi i vendit pushoi, u ngulfat.

Si kusht për zhvillimin e ekonomisë shqiptare kërkohet domosdoshmërisht një treg vendor, i cili plotëson nevojat normale të popullit e të shtetit. Vetëm me një treg të këtillë ekonomia e vendit mund të integrohet në jetën ekonomike regjionale dhe ndërkombëtare.

Shqipëria e gjymtuar dhe e izoluar

As me përpjekje mbinjerëzore Shqipëria nuk mund të krijojë një treg normal me bazë shtetërore. Shiko realitetin: tradicionalisht njerëzit nga Shqipëria veriore dhe lindore kanë qenë të orientuar të zhvillojnë tregtinë në drejtim të Prizrenit, Gjakovës, Tetovës, Gostivarit dhe Shkupit. Sot kufijtë me këto zona janë pak a shumë të mbyllura. Kur njerëzit nga Shqipëria synojnë të arrijnë në këto vende, ata vriten nga rojet kufitare të Serbisë ose Maqedonisë. I vetmi shteg mbetet kah jugu, në Greqi. Dhe atje kanë vajtur me dhjetëra mijëra shqiptarë për të kërkuar punë, në shumicën e rasteve ilegalisht. Një mundësi tjetër ishte dalja përtej detit Adriatik, në Itali, e që shumë veta tashmë andej ia kishin mësyre që nga vitet e 1990-të, por edhe atje konsideroheshin një emigracion i padëshiruar, sepse ky nuk ishte një këmbim ekonomik mbi baza të barabarta.

Shqipëria, e cila për pesëdhjetë vite kishte qenë e izoluar përmes politikës moniste, vazhdon të jetë sërish vend i izoluar tash përmes vlerave politike të botës së jashtme.

Kriza dhe çështja shqiptare

Rreth 60% e popullatës shqiptare jetojnë në fshatra. Për ekonominë moderne kapitaliste vlen një fakt: ajo nuk mund të funksionojë nëse më tepër se gjysma e popullsisë merret me bujqësi. Në botën e sotme nuk mundet kurrfarë bujqësie të ekzistojë vetëm sa për të plotësuar nevojat lokale të ushqimit.

Pa marrë parasysh se çfarë regjimesh do të vijë në pushtet në Shqipëri, të cilat do t'i mbrojnë apo jo interesat e kombit, ato nuk do të mundin vetëm për vetëm të ndryshojnë diçka nga themeli. Për aq kohë sa çështja shqiptare të mos zgjidhet, në mënyrë të drejtë dhe përfundimtare, shtatë milionë shqiptarët që jetojnë në territore të lidhura mesvete në Gadishullin Ballkanik gjithnjë do të kontribuojnë për një krizë kronike dhe destabilizim të regjionit.

Kriza e sotme shqiptare është një krizë totale: politike, sociale, morale. Por para së gjithash ajo është një krizë ekonomike. Dhe kur kufijtë shqiptarë u hapën mafia nxitoi të instalohej aty. Mafia greke, italiane, turke, bullgare dhe ruse kontribuan që tregu i drogës, kontrabandimi i njerëzve, prostitucioni, si dhe kontrabandimi i derivateve dhe i armëve të marrë përmasa shumë të mëdha. Regjimi shqiptar fillimisht u tregua symbullur e pastaj u involvua edhe vetë, sipas logjikës që bartë me vete ajo gjendje. Tashmë nuk është ndonjëfarë sekretit se Vlora, një qytet me pozitë strategjike në jug të Shqipërisë, është bërë qendër e mafias dhe e tregut të drogës. Një pjesë e të rinjve shqiptarë ra në rrjetin e botës mafioze – dhe kjo nuk është për t’u çuditur, meqë ata nuk kishin kurrfarë mundësie për të gjetur një punë të ndershme dhe, ajo që është më e keqja, këta ishin të privuar nga perspektiva e së ardhmes.

Loja piramidale është veç një aspekt i krizës shqiptare, ajo që u bë shkëndija ndezëse. Porse çështja kryesore ka të bëjë me kundërthëniet midis shpresës për demokraci që mbretëron në Shqipëri dhe gjendjes faktike sa i përket perspektivës politike, respektivisht demokracisë ekonomike. Ngjarjet e vitit 1992 nuk sollën një pluralizëm të mirëfilltë demokratik. Sërish në pushtet erdhi një parti që identifikohet me shtetin, sërish u zhvillua kulti i partisë dhe i personalitetit, monizmi, pra një diktaturë, por me një parti tjetër në udhëheqje. E një demokraci e zhvilluar politike nënkupton para së gjithash një demokraci ekonomike. As kjo nuk u zhvillua në Shqipërinë e viteve të 1990-ta.

Ngjarjet e përgjakshme të vitit 1997 janë pasojë e luftës së brendshme për dhe kundër një demokracie politike dhe ekonomike. Nëse nuk kuptohet kjo, atëherë nuk mund të kuptohet as logjika e historisë shqiptare.

Mirëpo kriza e vitit 1997 e ngriti çështjen shqiptare në kulmin e saj: bota filloi të kuptojë se kjo çështje duhet të trajtohet më ndryshe nga ç’ishte trajtuar deri tash, ajo poashtu kuptoi se një Shqipëri demokratike është e pabesueshme pa zgjidhjen e çështjes nacionale shqiptare. Me vitin 1997 kriza hyri në një fazë të re.

Të sundosh, apo të udhëheqësh vendin?

Për fat të keq, pjesa dërrmuese e regjimeve gjatë viteve të 1990-ta, domethënë grupimi apo grupimet politike që merrnin pushtetin, nuk kanë pasur për qëllim të drejtojnë vendin, por ta marrin pushtetin për të sunduar mbi popullin. Dhe ata vërtet sunduan, me fjalë të tjera, ata përdorën pushtetin politik që në një mënyrë apo në tjetër të krijojnë privilegje, të vjedhin dhe të pushtojnë shtetin e shoqërinë. Për ta pasuruar veten dhe për ta varfëruar popullin.

Pasi që ata sundojnë dhe nuk drejtojnë vendin, grupet politike dhe klasat në Shqipëri bëjnë një luftë të ashpër kundër njëri-tjetrit për marrjen e pushtetit politik. Kështu ishte më 1924, 1945, 1992 dhe së fundi më 1997. Politikanët shqiptarë e kanë veç një yll orientues: të fitojnë pushtetin politik! Ai yll i verbon ata. Prandaj krijojnë klika dhe klane dhe e personifikojnë ushtrimin e pacenueshëm të pushtetit te një Lider, te Njëshi, te një Diktator. Kjo është kultura e tyre politike. Kulti i vrazhdë dhe i neveritshëm në Shqipëri e ka gjenezën e vet pikërisht te mungesa e një politike demokratike të kultivuar dhe të qetë.

Një demokraci ekonomike nënkupton një politikë demokratike dhe një pluralizëm politik, një sistem shumëpartiak dhe një parlament pluralist. Ngjarjet e vitit 1997 në Shqipëri tregojnë se po qe se nuk përfillen këto kërkesa të demokracisë pasojat mund të jenë shkatërrimtare. Dhe regjimet që shqiptarët i kanë pasur, nuk kanë punuar fare për të mirën e demokracisë ose për çështjen shqiptare. Këto klika dhe klane kryesisht janë antikombëtare, që i sakrifikojnë vlerat kombëtare për të ushtruar pushtetin e tyre dhe sundimin mbi popullin. Gjithçka tjetër është vetëm demagogji dhe kamuflazhë.

Por kriza e 1997 tregon edhe një gjë tjetër se: shqiptarët nuk janë të gatshëm të pranojnë më vazhdimin dallaverave të tilla nga ana e "sundimtarëve". Udhëheqja politike në Shqipëri në të ardhmen do të gjendet në "vorbullin e ciklonit" dhe do t'u nënshtrohet kontestimeve dhe kritikave. Mirëpo, në fund të fundit, vendimtare do të jetë gatishmëria e vendeve fqinje dhe e komunitetit ndërkombëtar për të pranuar dhe për të ndikuar në zgjidhjen e drejtë të çështjes nacionale shqiptare. Shqiptarët kanë punuar shumë dhe tashmë një kohë të gjatë për zgjidhje paqësore, ata kanë besuar në mënyrë të sigurtë në integrimet evropiane dhe solidaritetin ndërkombëtar.

Çështja shqiptare përbën një sfidë për Evropën dhe botën. Po qe se shqiptarët do t'i humbin shpresat e tyre ka rrezik që zjarri të përhapet në Kosovë dhe Maqedoni. Pyetja se a ka mësuar gjë Evropa dhe bota do të marrë së shpejti një përgjigje. Dhe kjo përgjigje do të jetë e rëndësishme për ardhmërinë e tërë Evropës.

SHQIPËRIA PREJ 1998 - DERI MË 2001

Pas ngjarjeve të dhunshme më 1997, kur vendi ndodhej buzë luftës qytetare dhe Shqipëria u bë një vend i pa kontroll të ligjit, popullata u gjend në gjendje shoku. Sali Berisha e humbi pushtetin qeveritar, me gjithë përpjekjet maksimale për ta mbajtur atë. Ky politikan e kishte humbur tërë besueshmërinë te vlerësuesit ndërkombëtar, dhe Komiteti Britanik i Helsinkit ishte i pamëshirshëm në vlerësimin lidhur me Berishën: mashtrim në zgjedhje, shfrytëzim demagogjik i mediave, një pushtet policor dhe një Shërbim Sigurimi në duart e Partisë Demokratike për ta mposhtur opozitën. Amnestia Internacionale thekson gjykimet politike në Shqipërinë e Berishës si një karakteristikë tjetër të politikës së Berishës.

Prandaj, shpresa për ndryshime ishin të mëdha kur Partia Socialiste erdhi në pushtet. Por gjendja ishte edhe më tutje e nderë. Njerëzit jetonin nën presionin e asaj çka kishte ndodhur, një gjendje e frikës konstante dhe mosbesim ndaj shtetit. Dhe është shumë e vështirë t'ia dalësh me krimin për aq kohë sa vendi është jashtëzakonisht i varfër dhe të rinjtë nuk shohin ndonjë perspektivë për të ardhmen e tyre, përveç emigrimit.

Përmbysjet politike në fillim të viteve të 1990-ta krijuan së pari një eufori, një besim naiv se bota tash ishte e hapur për shqiptarët. E në të njëjtën kohë u krijua një vakuum në çështjen e funksioneve të individit e të shoqërisë në vazhdimin e këtyre zhvillimeve. Shqiptarët e hutuar e kishin të vështirë të gjenin rrugën e tyre të drejtë. Dhe ajo që ndodhi më 1997 ishte një traumë e vërtetë, sepse kur terrori i kallashnikovit bënte ligjin në rrugë shumë shqiptarë i humbën edhe atë pak besim që u kishin mbetur ndaj shoqërisë së tyre.

Megjithëse duket paradoksale, ndodhi që ngjarjet dramatike në Kosovë përmirësuan klimën shpirtërore në Shqipëri. Në pranverën dhe verën e vitit 1999, njerëzit e varfëruar në Shqipëri pranuan bashkëkombasit e tyre, të cilët me qindra mijëra detyroheshin nga ushtria dhe policia serbe të kalonin kufirin nga Kosova ose nëpërmes Maqedonisë. Përnjeherësh u shpreh solidariteti dhe humaniteti, që përforcoi besimin e shqiptarëve në vetvete dhe që poashtu u kuptua pozitivisht nga bota. Pas gjithë atyre vuajtjeve me përpjekjet për të emigruar në Itali me anije, korrupsionit, kontrabandës së narkotikës, me armë e me njerëz dhe me lojërat fatëkëqia piramidale erdhi një periudhë e cila ua ktheu njerëzve vlerat e tyre të humbura.

I treguan vetvetes, njëri-tjetrit dhe botës se ata, me gjithë mjerimin dhe varfërinë e tyre, ishin të gatshëm për sakrificë për bashkëkombasit e tyre që iknin për të shpëtuar jetën. Tradita shqiptare e mikpritjes dhe e vetëflijimit megjithatë nuk ishte shuar!

Sa i përket jetës politike në Shqipërinë e sotme nuk ka shumë gjëra interesante për të treguar. Polarizimi jokonstruktiv dhe mungesa e disiplinës që e ka karakterizuar debatin politik në Shqipëri që nga fillimet e viteve të 1990-ta ka vazhduar. Pa fije dyshimi, Sali Berisha është ai i cili mbanë përgjegjësinë më të madhe për nivelin shumë të ulët të jetës politike në Shqipëri. Kundërshtari i tij, lideri i Partisë Socialiste Fatos Nano, për dallim nga Berisha, ka një shkollim të mirëfilltë politik nga e shkuara, por edhe ai është kompromentuar përmes disa "afërave". Dobësia e tij e madhe për të dëgjuar zërat e sirenave greke – dhe fakti se greqishtja e Nanos është më e mirë se sa shqipja e tij! – është kritikuar nga shumë vlerësues. Pasi që socialisti Pandeli Majko u bë shef i qeverisë dhe fitoi vlerësime të larta për ndershmëri dhe qëllime të mira, u detyrua të largohet nga pushteti nga që humbi luftën kundër Fatos Nanos lidhur me postin e kryetarit të Partisë Socialiste. Si pasardhës i Majkos erdhi Ilir Meta, por faktori më i fuqishëm brenda partisë socialiste ishte pa fije dyshimi Fatos Nano. Shpresat për ndryshime të vërteta në Shqipëri nuk janë përmbushur: rrëmujat lidhur me lojën

piramidale nuk janë sqaruar ende, korrupsioni dhe kontrabanda vazhdojnë, dhe asnjë lloj kapitali i huaj nuk dëshiron të investojë në një vend kaq jostabil si Shqipëria. Pamja është fare pak e ndritshme: ngecja ekonomike dhe sociale, kundërthëniet dhe grindjet politike, që pengojnë zhvillimet pozitive – janë karakteristikat dominuese.

Zgjedhjet e 24 qershorit 2001, që do të pasohen nga një rund i dytë në vjeshtë, u realizuan me një vlerësim pozitiv nga ana e observatorëve të huaj, por Sali Berisha dhe pasuesit e tij, si zakonisht, nuk pushonin së çjerruri për gjoja mashtrim në zgjedhje dhe ndërhyrje policore – të njëjtat akuza të cilat me të drejtë mund t'i bëheshin atij në zgjedhjet e mëhershme. Komenti i Fatos Nanos: Mënyra e këtillë e shprehjes është bërë, për fat të keq, një sindrom i pashërueshëm nga i cili vuan Sali Berisha... Rezultati i zgjedhjeve nuk ishte i qartë: një lloj dominimi i socialistëve, por rundi i dytë do të duhej të ishte vendimtar.

Një përshkrim përmbledhës i zhvillimeve të fundit do të ishte mjaft i bezdisshëm për lexuesin. Ajo çka u tha më sipër mjafton si një pamje e përgjithshme mbi gjendjen në Shqipëri. Më duket më mirë që të parashtroj përshtypjet nga vizita ime e dytë në Shqipëri më 1995.

SHËNIME NGA UDHËTIMI I VITIT 1995

Pas udhëtimit tim më 1994 në Shqipëri, krejt papritmas më erdhi një ftesë nga Muzeu Historik në Shkodër që në verën e vitit të ardhshëm të merrja pjesë në një seminar ndërkombëtar me titull "Shkodra ndër shekuj". Ishte shefi i muzeut Mentor Quku që më shkruante dhe donte kontributin tim. Unë pranova dhe premtova të merrja pjesë me kumtesën "Shkodra në publikimet suedeze gjatë njëqind viteve". Unë gjithherë kam qenë i interesuar për qytetin e Shkodrës, që dikur ishte qendra më e njohur kulturore e Shqipërisë, ndaj intelektualëve të të cilit qytet qenë bërë përndjekjet më të tmerrshme në kohën e Enver Hoxhës. Një prej shkaqeve ishte se Shkodra ka një pjesë të madhe të popullësisë katolike, si dhe fakti se priftërinjtë katolikë përbënin elitën intelektuale në Shqipërinë e paraluftës. Intelektualët e Shkodrës, para se gjithash priftërinjtë, paraqisnin pengesën më të madhe për Enver Hoxhën dhe partinë në përpjekjet e tyre për të marrë gjithë pushtetin në Shqipëri. Me një politikë totalisht të pamëshirshme, Hoxha ia arriti të asgjësonte ose ta heshtte zërin e asaj opozite, që e kishte qendrën e vet në Shkodër.

Më 19 qershor 1995 nisa udhëtimin me aeroplan për në Vjenë, ku kalova natën. Ditën e nesërme arrita në aeroportin e Rinasit. Estrefi më priti dhe më njoftoi për gjendjen. Jeta e tij është përplot me probleme, por ai, si zakonisht, është i gëzuar dhe miqësor. Te ai do ta kaloj këtë natë.

Dhe mbrëmjen e kalova bashkarisht me komunistët e vjetër: Xhaferi e ka punën e tij me sindikatën e arsimitarëve, kurse Xhemali i cili kishte qenë profesor i filozofisë marksiste tash ka ngelur pa punë. Ditën tjetër vjen Xhemali, një ish-shef i policisë në regjimin e vjetër, i cili tash punon taksist e që do të më çojë deri në Shkodër. Ai duket një njeri i qetë dhe miqësor, i interesuar për letërsi, dhe është e vështirë për të besuar se dikur ka ushtruar tmerrret e xhelatit në veprimtarinë e tij të mëparshme. Por këtë mund ta vendosin vetëm ata që asokohe kanë pasur të bëjnë me policët, dhe dëshmitarë të tillë nuk janë të pranishëm.

Kur arrij në Shkodër fitoj përshtypjen se qyteti, në këto rrethana të rënda, ende nuk e ka gjetur formën e mirëfilltë, pas shndërrimeve një shoqëri të re. Hotel Rozafa, ku do të vendosem, është një përjetim zhgënjyes, i shkatërruar dhe në rënie. Këtu kam banuar edhe më 1979, por gjendja asokohe ishte shumë më e mirë. Kisha llogaritur me një akomodim privat dhe pata pak vështirësi derisa u vendosa. Drejtuesit e seminarit kishin ambicie për të kryer vetë gjithçka, porse u haste sharra në gozhdë. Hëngra drekë me Estrefin dhe shofer Xhemalin – dhe paratë për të paguar faturën erdhën me një korrier.

Një xhami e madhe, vezulluese dhe madhështore, të vriste sytë në atë zonë të varfër. Ajo është bërë me mjete të Arabisë Saudite dhe Estrefi mendon se ka pasur projekte më të rëndësishme për të investuar. Estrefi bisedon për korrupsionin dhe duket qartë se rruga deri te demokracia shqiptare do të jetë me lakadredha dhe e gjatë. Ka ikur tashmë ajo kohë kur gazetarët mund të shkruanin për fëmijët e vegjël, të cilët me mospërfillje shkelnin nëpër karamelat që ua jepnin turistët e huaj; ata nuk donin asokohe të merrnin diçka nga dajët dhe tezet imperialiste. E tash, të vegjëlit janë bërë lypsarë rrugëve.

Unë shkova deri te Muzeu Historik dhe atje takova një të njohur të hershëm, që quhet Paulin Perja, me të cilin kam pasur letërkëmbime në vitet e 1970-ta, dhe njihem edhe me shumë të tjerë.

Bashkë me hulumtuesin e shpellave dhe jetës popullore Gëzimin dikur vonë shkojmë në shtëpi te profesor Jup Kastratit, të cilin më parë e kam takuar dhe kam pasur letërkëmbim në vitet e 1970-ta.

Fillon seminari në Shkodër

Një mëngjes në hotel, i përjetoj disa pakënaqësira. E hëngra mëngjesin në një sallë të ngrënies, me mbulesa të ndyera tavolinash. M'u dasht të rruhesha në një dhomë tjetër, sepse në dhomën time nuk kishte rrymë. Nuk kishte ujë të nxehtë dhe doreza e dushit ishte e këputur. Duke iu falënderuar ndihmës së një vajze që quhej Ajshe e zgjidha problemin atë pasdite. Personeli nuk e dinte se ç'do të ndodhë me ta. Një grua që si unë ishte mysafire e hotelit e kishte këtë vlerësim: këta kamarierë dhe pastruese ishin spiunë të regjimit të vjetër. Ata bënë mbikëqyerjen në hotel. Se ata kanë tash telashe është diçka që e kanë merituar.

Po e shikoja atë zonjën e pamëshirshme me dy gusha të krupshme dhe po mendoja se ashtu sikurse është regjimi ashtu bëhen edhe njerëzit, për të mirë e për të keq. Por sigurisht spiunazhi që ngritur në virtytin më të lartë. Më kujtohet kur unë, një mëngjes të vitit 1979, në Hotel Adriatik të Durrësit isha duke pritur fotoreporterin, Piro Naçe. Në ndërkohë po e kaloja kohën me një shqiptare, e cila në ditët e veta të rinisë gjatë Luftës së Dytë Botërore e kishte bashkuar fatin e vet me një italian dhe që atëherë kishte jetuar në Itali. Ajo kishte ardhur në një vizitë të afërmit e saj në atdhe. Ne argëtoheshim duke krahasuar paratë suedeze dhe italiane në letër dhe monedhë. Kjo zgjoi një interesim të madh të personali i mirëmbajtjes. Një pastruese nisi një balet joshës me fshesë para syve të mi në korridor dhe më shpoi me shikime të zjarra. Kjo ishte me siguri si pretekst për të larguar vëmendjen time nga një pastruese tjetër, e cila disa metra tutje nga unë rrinte e kërrusur, që në dukje lustronte mermerin, kurse në të vërtetë ajo përgjonte bisedën tonë. Kur unë e hetova pastruesen e dytë, ajo më dha një buzëqeshje të ëmbël. E tëra ishte si të qeraseshe me çokollatë që përmbante helm... ani se spiunazhi e kishte një tundim sensual...

E tash, diku në mes të viteve të 1990-ta, hetohet njëfarë shtresimi në shoqëri. Ata që më parë kishin pasur punë të mira – ata që politikisht ishin të pranueshëm - janë negativë dhe të brengosur për ardhmërinë, kurse ata që më parë kishin qenë të goditur tash e kishin më mirë, megjithëse jo aq shumë, të paktën në aspektin material, dhe klasa e re që po krijohet përmbanë një numër të madh elementesh të dyshimta.

Ndërtimtaria, krahasuar me vitin paraprak, ka zënë fill dhe ka fillim të mbarë, mirëpo korrupsioni është përgjithësisht i pranishëm. Një pjesë e mirë e parave vjen me sa duket nga veprimtari të dyshimta që kryhen nga shqiptarët jashtë vendit: tregu i narkotikës, prostitucioni, eksporti i armëve. Disa janë pasuruar duke bërë kontrabandë, falë embargos gjatë luftës së Bosnjës. Kjo ndodhi sipas parimit "vdekja e njërit, ushqim për tjetrin". Kurse në nivelet më të larta tregtia e armëve kryhej nga zotërinj "të ndershëm" me mansheta të bardha në shtetet më demokratike – por në parim gjendja është njëlloj e keqe për viktimën. Nuk është një botë e bukur, por e tillë qenka ajo, ashtu sikurse këndonte dikur trubaduri suedez, Ola Magnel.

Biseda me personelin e hotelit vuri në dukje një lloj konflikti midis katolikëve dhe muslimanëve. Një pastruese thoshte se katolikët gjithnjë kanë vuajtur nga masat e regjimit komunist, kurse muslimanët si rregull kanë kaluar mirë me çdo regjim që ka ardhur në fuqi.

Shkova herët në ceremoninë e hapjes së seminarit në Teatrin "Migjeni". Po atë ndjenjë të pabesueshmërisë, që e kisha përjetuar vitin e kaluar kur e pashë ish muzeun e Enver Hoxhës, e ndjeva sërish. Këtu, në radhën e parë, unë dhe një nga liderët e Ballit Kombëtar ishim ulur përkaj njëri-tetrit; ai ishte një plak i vjetër dhe i thyer. Një prelat katolik i veshur solemnisht hyri brenda dhe u ul në të njëjtën radhë. Ishin dy shembuj të gjallë të mposhtjes totale të Enver Hoxhës. Ata ishin përfaqësues të dy fuqive që ai kishte bërë çmos për t'i çrrënjësuar...

Organizatori i seminarit Mentor Quku mbajti një fjalim, të mbushur përplot me parulla antikomuniste. Secili regjim i ka sloganet e veta dhe ajo që kërkohet është vetëm që në kohën e duhur të përdorën parullat politikisht korrekte.

Dita vazhdoi me ligjërata dhe një drekë, dhe në orën 17.00 ishte koha kur unë do të duhej të mbaja ligjëraten time. Natyrisht, nuk munda t'i shmangem aspektit patetik dhe fitova duartrokitjet më të fuqishme (të paktën kështu më dukej mua) kur po tregoja se si unë kisha dëgjuar çdo ditë Radio-Shkodrën në fund të viteve të 1940-ta duke filluar dhe mbaruar emetimet e mëngjesit dhe të mbasditës me melodinë nacionaliste britaneze, "Land of hope and glory" - Vendi i shpresës dhe i madhështisë - të Edgar Elgarit. Merreni me mend sikur Enver Hoxha të kishte mësuar për këtë "infiltrim muzikal të imperializmit", ai që disa dhjetëvjetësha më pas do të dënonte të gjitha koncertet me valset vjeneze...

Një mbrëmje e mrekullueshme me muzikë dhe kujtime

Surrealizmi ishte përzier me realitetet në ligjëraten time, e mbrëmja që edhe një shembull për mua se gjithçka mund të ngjajë në jetën e një njeriu, ajo që më së pakut pritet mund të ngjajë, ashtu sikurse ajo që më së shumti dëshirohet mund të kthehet në një dëshpërim të hidhur. Në ditët e mia të rinisë kam ndejtur thuajse me kokën brenda në altroparant për të kuptuar atë zë të dobët dhe muzikën nga Radio-Shkodra. Tash po shkoja te Kështjella e Rozafës, e cila funksionon si një muze. Një gazetar i Radio-Shkodrës më intervistoi, ai poashtu e kishte inçizuar edhe ligjëraten time. Pastaj në mbrëmje ndejta me shkodranët dhe dëgjoja një koncert me një muzikë të mrekullueshme, që isha mësuar ta doja që në moshë të re dhe nga një vend shumë i largët. Rrugës për te Rozafa bisedoja me një grua – e ajo ishte Odette M. nga Franca, të cilën e kam pasur kolegë të studimeve në Prishtinë para 18 vjetësh! Asokohe ajo ishte murgeshë, por me sa duket e kishte braktisur këtë angazhim. Kjo nuk më befasonte, pasi ajo tregohej aq ithtare ndaj Shqipërisë së Enver Hoxhës, diçka që dukej e çuditshme për shkak të politikës ndaj religjionit nga ana e diktatorit. Tash po përjetoja diçka që më dukej si një ëndërr, diçka që ishte bërë realitet. Oh, ç'kënaqësi të mund të këndoja ato këngë të dashura së bashku me njerëzit nga Shkodra! Ndihesha aq i ri, i lehtë, thua se isha një shpend që po fluturoja sipër maleve shqiptare!

Kjo ndoshta mund të duket qesharake, por për një njeri i cili ka "jetuar" në një kulturë nga distanca, siç është rasti im në raport me kulturën shqiptare, një përjetim i këtillë, si ky në kështjellën e Shkodrës, është thuajse i njëjtë me atë njeriun, që më në fund, pas shumë vitesh përpejkjeje, arrinë te vendi i premtuar. E di se të gjithë shqiptarët më kuptojnë për këtë ndjenjë, pasi ata kanë një ndjenjë aq të fuqishme për patetizëm, si një aspekt romantik i jetës, që shumë nga pjesa jonë e botës e shohin me nënçmim si diçka të vjetëruar. Në ambientin suedez këto ndjenja të mia mund të merren si çmenduri e pazakontë... Por duke pasur parasysh historinë shqiptare, vuajtjet e tyre ndër shekuj, do të duhej që kjo të kompensohet duke iu dhënë përparësi së bukurës, ngrohtësisë, optimizmit dhe vitalitetit të jetës, ashtu sikurse ndodhë në muzikë. Ata që kanë pasur rastin të dëgjojnë muzikën hebreje ndiejnë të njëjtën dinamikë të optimizmit për jetën, me siguri për shkak se hebrenjtë kanë vuajtur shumë më tepër se sa popujt e tjerë. Por në kohën kur po e shkruaj këtë, detyrohem të shtoj: Mos ndodhtë që shqiptarët një ditë të ecin rrugës së njëjtë, rrugës që nga viktima të kthehen në kryes krimesh, ashtu sikurse ka ndodhur me Izraelin në relacion me arabët e Palestinës! Dhe është e vërtetë, ashtu sikurse thotë edhe Solzhenicini, se njeriu nuk fisnikërohet nga vuajtjet që i shkaktojnë të tjerët, madje ndodhë e kundërta – bartet ndyrësia nga kryesit e krimeve te viktima. Por i njëjti Solzhenicini thotë poashtu se kufiri midis së keqes dhe së mirës depërton drejtpërdrejt nëpër çdo zemër të njeriut, dhe se ka gjithherë mundësi

që të ndryshohet ky kufi në secilin drejtim. Se a është kjo e vërtetë apo jo mund të diskutohet, por ia vlenë të jetohet sikur kjo të ishte e vërtetë.

Kjo mbrëmje në kështjellën e Shkodrës, sidoqoftë, ishte përjetimi im më i fuqishëm gjatë të gjitha viteve sa unë kam pasur kontakt me vendin e Shqiponjave.

Mbrëmja në prag të festës së Shën Gjonit me peshk dhe verë

Tash ishin angazhuar disa forca që të më largonin nga ky hotel i trishtë. Profesori Jup më ofroi të banoja te ai, por radhën e zuri para tij një mik i vjetër, Paulin Perja.

Në rrugë e takova një të ri, që në mënyrë shumë të kulturuar e parashtrori dilemën e rinisë shqiptare: problemet e rënda ekonomike, shprishjen shpirtërore në një periudhë të rëndë kalimtare, mungesa e besimit në të ardhmen, pra dilema ekzistenciale që me siguri përjetohen si shumë akute nga të rinjtë e ndërgjegjshëm shqiptarë se sa kjo ndodhë ndër të rinjtë në vendet nordike. Ky i ri donte të dëgjonte një fjalë nga unë, ashtu në ecje gjatë rrugës, dhe unë provova t'i tregoja se bota kapitaliste i ka mizoritë e veta, një tjetër lloj mizorie nga ajo e shoqërisë totalitare, shumë më i fshehtë dhe më i zorshëm për t'u kuptuar, dhe se kërkohet kohë për të gjetur rrugën e mirëfilltë, për t'u zhvilluar dhe për të mësuar se si të mbrohet integriteti personal në botën moderne.

Filloi dita e fundit e seminarit, por para se të fillonin ligjëratat, më intervistoi TV-Tirana, gjë që qe shumë e bezdisshme sepse një nga teknikët me këmbëngulje donte të mbante reflektorin të drejtuar në fytyrën time, ashtu që unë detyroheshja tërë kohën t'i rrihja qerpikët. Kur intervista u emetua në TV e Tiranës unë veç isha në shtëpi, dhe miku im Fahredin Berisha, shqiptar i Kosovës në Norrshoping, e kishte inçizuar me kujdes programin dhe pastaj ma dha videokasetën.

Edhe "Voice of America" më kishte intervistuar për programin e vet në gjuhën shqipe. Si honorar mora 3000 lekë për kontributin tim!

Pas drekës te familja Kastrati u gjenda te Paulin Perja, i cili punonte në Muzeun Historik. Gruaja e tij Antoneta punon me fëmijët psikikisht të hendikapuar dhe tregonte një angazhim të madh për nxënësit e saj. Është interesant se Paulini është ortodoks e gruaja katolike. Në Shkodër ekziston një kishë e vogël ortodokse. Është afërsia e Malit të Zi ortodoks që ka ndikuar në këtë.

Ky qift i këndshëm nuk e ka dhe aq keq. Paulini fiton 50 dollarë në muaj, Antoneta 70 dollarë. E kanë shtruar një darkë të mirë për mua si mysafir. Ka peshk – krap. Paulini që i njeh finesat e gjuhës popullore e hedhë verën dhe thotë: "O' më ha me venë, o' m'ço ku kam këne". Në këtë shprehje është peshku ai që thotë: "Ose do të më hani mua së bashku me verën, ose do të më ktheni atje prej nga vij unë". Dhe Paulini vazhdon: "Në Shkodër zihet krap, vritet cjapi", që dmth. se në Shkodër ka edhe ujë dhe male të larta.

Kthimi në Tiranë

Ditën tjetër me taksi kthehem në Tiranë. Në Zadrime, disa kilometra në jug të Shkodrës, e shoh vendbanimin më primitiv në Evropë. Ka mundësi që vetëm fëmijët të cilët jetojnë kanaleve në Bukuresht ta kenë më keq! Këtu faktikisht banojnë njerëzit në shpella që kanë gërmuar në rrëpirë të malit.

Nuk mund ta studjoj gjendjen më nga afër, por më shpjegojnë se me shembjen e bujqësisë kolektive njerëzit mundnin të merrnin nga një ngastër private të tokës. Kjo u bë me spontanitet dhe nuk qe e sanksionuar nga pushteti shtetëror. Për këtë, pronarët e rinj privatë të tokës bujqësore kërcënoheshin me mundësinë që të tjerët të mund të pretendonin tokën e "tyre". Që të evitohej ky rrezik kërkohesh që ata të banonin sa më afër që të ishte e mundur me pronat e tyre, dhe njerëzit ishin përcaktuar që të groponin vendbanime në faqet e maleve. Nevoja nuk njihte ndonjë ligj.

Sërish jam në Tiranë dhe shëtis me Estrefin deri te parku i madh i universitetit. Ai është një pasqyrë e frymës së Perëndimit të Egër në shoqërinë e re. Një hotel i madh është ndërtuar mu në mes të ndërtesave administrative dhe nuk është i përshtatshëm, parku është në shkatërrim dhe sektori i botanikës, aty ku më parë kishte ekzemplarë të një numri të madh të bimëve, ndër të tjera lloje të ndryshme dhe forma të ndryshme të luleve, tashmë është e shkretëruar dhe në vend të saj janë ndërtuar banesa private. Aty, përkaj liqenit artificial, ka megjithëkëtë një restorant të këndshëm me shërbim edhe jashtë, e ku u ndalëm dhe pimë birra e hëngrëm ushqim.

Sivjet unë ndiehem faktikisht mjaft i zhgënjyer. Udhëtimi nuk më ka dhënë atë kënaqësi që shpresoja. Është para se gjithash të kuptuarit e gjendjes së shqiptarëve që më shkakton këtë ndjenjë. Shtresat më të varfëra janë në gjendje të mjerueshme. A mund të ketë ndonjë varfëri më të madhe ndokund në Evropë? A nuk janë vallë të ngjashme si ato ambiente të cilat i përshkroi Migjeni në vitet e 1930-ta, dhe jo aq larg nga ajo kohë? Dallimet klasore po rriten, e poashtu edhe korrupsioni. Arbitrariteti harliset në një shtet të cilit i mungon një udhëheqje e mirëfilltë. E megjithatë ekziston edhe ana e gëzueshme: shqiptarët mbahen bashkë në familjet e tyre. Shqiptarët janë një popull i zgjuar dhe inteligjent. Po t'u krijoheshin pak kushte më të mira, ata mund të punonin në mënyrë kreative.

Vapa me lagështi më mundon. Bronkiti pezmatohet, bëhem i flashkët dhe irritohem. Kisha menduar ta bëja një udhëtim të tërthortë për në Maqedoni, mirëpo nuk mund t'i përballoj udhëtimin të gjatë në vapë. Më me qejf do të pushoja disa ditë në bregdetin e Durrësit.

Vallë, kujt mund t'i besohet kur është në pyetje Shqipëria? Gjatë tre vizitave të mia në vitet e 1970-ta kishin mundësi që gjithë opozitarët e mundshëm të zhvillonin ndonjë bisedë me mua. Shpesh dilja në errësirën e natës (herët errësohet në jug) dhe ai që donte mund të shmangej me mua dhe të lehtësonte zemrën. Por asnjë fjalë kritike ndaj regjimit nuk më ishte thënë. Aq i fuqishëm ishte represioni sa askush nuk guxonte të më kontaktonte. Kurse në Kosovë, në vitin 1977, u deshën vetëm disa ditë që studentët opozitarë të fillonin të bisedonin me mua dhe me albanologët amerikanë me të cilët unë shoqërohesha. Ne, madje, ndiheshim të shqetësuar nga pakujdesia e tyre. Kurse për gjashtë javë të plota në Shqipëri në atë kohë, mësoja veç këtë se të gjithë ishin të kënaqur, problemet ishin të rendit sekondar dhe të gjithë ishin në shërbim të vijës së Partisë...

Tash i dëgjoj të zhgënjyerit duke e nxirë gjendjen aktuale, kurse njerëzit e karrierës e idealizojnë atë. Estrefi, i cili ishte sekretar i Lidhjes së Rinisë dikur, thotë se shumica e të dënuarve politikë e meritonin dënimin e tyre dhe se përshkrimet lidhur me terrorin, si për shembull në Shkodër, janë të tepruara. Një intelektual në Shkodër, Fritz Radovani, më jep shkrimet e tija, ku faqet janë të mbushura me dhunë dhe vrasje priftërinjsh katolikë. Ai e urren komunizmin, sepse ia ka shkatërruar tërë familjen.

Paulin Perja ka qenë poashtu i përndjekur, por ky kaloi lehtë - vetëm me shpërngulje. Shoku i tij i klasës Vehid Boriçi, të cilin e njoh mirë pas disa viteve të tija në ambasadën e Shqipërisë në Stokholm, pas kësaj nuk donte ta shihte më Paulinin. Sot Vehidi, që ka shkuar në rrugën prej udhëheqësit në Albaturist deri te shërbimi në ambasadë, ka një post të lart në administratën e Sali Berishës. Tipat servilë ia dalin në të gjitha ndryshimet e regjimeve...

Në vitin 1985 Estref Bega u akuzua për titizëm, por shpëtoi. Sot ai flet mirë për Enver Hoxhën, ani se distancohet nga sistemi monist. Të hequrit nga fronti presin kohën e tyre - fitoren e Partisë Socialiste që sipas të gjitha parametrave do të ndodhë. Berisha dhe partia e tij e qeverisën vendin tepër keq.

Konsiderohet se SHBA ka interesa strategjike në Shqipëri. Por kur NATO-ja u shfaq në Durrës për manovra të përbashkëta me shqiptarët, ushtarët amerikanë u sollën shumë keq në qytet, i ngacmonin gratë dhe silleshin si sundimtarë. Një burrë, të cilit ia bezdisi nusen një amerikan në një festë private, e nxori revolen dhe e qëlloi amerikanin. Ky mbijetoi, por ishte shumë i dëmtuar. Mëse 20 000 njerëz kërkuan që shqiptari i ri të lirohej; ai megjithatë u dënua me një vit burgim.

Unë nuk dalloj ndonjë logjikë sa i përket trajtimit të njerëzve në lidhje me punësimet. Komunistët kanë përdorur metoda të pamëshirshme, kurse demokratët duket se nuk kanë kurrfarë kriteri. Si munden vallë njerëzit si Vahid Boriçi dhe Ivzi Çipuri të vendosen në poste të larta të vendit, kurse shkencëtari Jup Kastrati të mbetet jashtë? Ky është poashtu një qëndrim i dyshimtë se po kthehen prapa te vitet e 1930-ta lidhur me kthimin e pronës së konfiskuar. E çuditshme, por komunistët me ndërgegjeje i kishin regjistruar të gjitha konfiskimet e pronave personale në shërbim të shtetit. Në rrethin ku jetonte Estrefi, zyrja e Frontit Demokratik u ka kaluar në pronë fëmijëve të ish-pronarit. Në qytete problemet nuk janë të mëdha, kurse atje, lart në malet e veriut, janë shkaktuar grindje të farefisit në lidhje me ndarjen e tokave bujqësore të kolektivit.

Në Shqipëri takimet janë të shumta dhe vetmia tepër e rrallë

Më 27 qershor u takova me kryetarin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, Bardhyl Londo. Ai erdhi me një varg propozimesh, por ato ishin të tilla që nuk mund të bëhej diçka e qëndrueshme me to. Poezia e tij është e mirë, por unë kam dyshime te ky njeri. Nga aty shkova te ndërtesa e RTSh, ku më kishin propozuar një intervistë për shqiptarët jashtë vendit. U pritë nga dy zonja të reja, Alda dhe Eda, të cilat i pata takuar edhe ditën e mëparshme. Aty ndodhej edhe mikësja ime e vjetër, Svjetllana, e cila më ka vizituar në Suedi disa herë. Intervista që e gjatë, dhe gjithçka shkoi mirë.

Në një mur pashë të vizituar një yll partizan me shkronjat VFLP – Vdekje Fashizmit – Liri Popullit; në vende të tjera tekste si LIRI FATOS NANOS (lideri i burgosur socialist), RROFTË BALLI KOMBËTAR (dmth. kundërshtari kryesor i partizanëve gjatë luftës), POSHTË DIKTATORI SALI BERISHA, dhe së fundi FUCK IT, parullë kjo që nuk ka nevojë për ndonjë shpjegim.

Mbrëmja kaloi në shoqëri të këndshme me familjen Meçuli-Mamaqi. Në përshtypjet nga udhëtimi i vitit 1994 kam rrëfyer për kontaktet e mia shumëvjeçare me këtë familje, e cila me kënaqësi donte të më ndihmonte për të gjetur një grua shqiptare, që të mos jetoja në këtë vetmi relative sikurse kisha jetuar në këto tre vjetët e fundit. Ky problem do të tregohet se është i mundur për t'u zgjidhur, gjë që edhe do të ndodhë tre muaj më vonë atëherë kur në Norrshoping takova Samkën, e cila u bë gruaja ime. Dhe është Samka, ajo që faktikisht më ka nxitur papra për ta shkruar këtë libër...

Një përpjekje për “t'u kujdesur për mua”, ashtu drejtpërdrejt, që bëre edhe dy vite më parë. Edvini, djali i Estrefit, dhe unë patëm udhëtuar për në Durrës një mëngjes. Gjatë rrugës munda të shoh se Shqipëria ishte “lumturuar” me Fabrikën e Coca-Colës, por aty ishte edhe një kompleks i bukur restoranti, si dhe vila të reja e të hijshme rrugës midis Tiranës dhe Durrësit. Edi dhe unë, pas një udhëtimi me vapë e djersë, u zhytëm në det. Pasi u freskuam paksa, bëmë një vizitë nostalgjike në Hotelin e vjetër Durrësi, ku kisha banuar më 1970. Aty Lindita, një vajzë 24-vjeçare, provoi të më binte që ta merrja në Suedi, por, pasi Edi bisedoi seriozisht me të, ajo u tërhoq.

Ditën tjetër takova një person shumë simpatik – Ramadan Vozgën, i cili ishte përgjegjës për kontakte me jashtë pranë Bibliotekës Kombëtare. Ai më parë kishte qenë shef i Estrefit. Biseda mori kahjen e relacioneve midis atyre tashmë të rrëzuar nga fronti dhe të ish të dënuarve politikë. Ai ishte i bindur se të dënuarit politik si rregull ishin të

matur dhe modestë, kurse elementët më të këqinj përbëhen nga ish-komunistë, që politikisht kishin shkuar kah e djathta. Këta e teprojnë në agresivitetin e tyre për të dëshmuar se vërtetë janë në krahun e djathtë. Unë shtova se edhe nëpunësit servilë të cilët përulen para pushtetit në çdo situatë, si për shembull disa nga diplomatët, edhe këta duhet të futen në atë kallëp. Dhe z. Ramadani u pajtua me këtë mendim.

Në vend të udhëtimeve të gjata, kisha vendosur të vizitoja një krahinë për të cilën isha shumë kureshtar: Mirditën. Kjo krahinë shtrihet në Shqipërinë e mesme, në veri të Tiranës. Mirdita është një rreth i vogël malor me popullatë katolike, të izoluar nga zonat tjera katolike. Në aspektin historik Mirdita u bë e njohur përmes fisit të Markagjonit, që aty e kishte pushtetin për një kohë të gjatë.

Më 2 korrik u nisëm për Mirëditë, por paraprakisht u kthyem deri në Durrës për t'u larë. Si shoqërues e kisha Xhemalin, taksistin, dhe Estrefin. Ata nuk e kuptonin dot dëshirën time për të vizituar Mirditën. Mendonin se nuk kishte ndonjë gjë interesante për të parë atje. Shumë mund për pak gjë, mendohejshin të më bindnin ata, por unë isha i vendosur në timen.

Rruga për në Mirditë fillimisht ndjek lumin Mat, pastaj degën e tij që quhet Fan. Është një urë e madhe e ndërtuar nga italianët në kohën e mbretit Zog. Në Rubik një kishë shndëriste lart në një shkëmb; prodhimi i bakrit është ndërprerë dhe e njëjta gjë vlen edhe për industrinë në qytetin e Rrëshenit (6000 banorë). Kur arrijmë atje, kërkojmë Muzeun Historik, i cili, siç kuptojmë, ishte i mbyllur. Kisha shpresuar ta takoja kujdestarin e muzeut Nikollë Tomën, të cilin e kisha takuar gjatë seminarit në Shkodër.

Afër muzeut e takuam një njeri, i cili tregon gatishmëri të na shoqërojë e të na e tregojë vendin. Ai është artist dhe quhet Lin. Na çon te kisha katolike, ku në murin e jashtëm vetë ka realizuar një mozaik të bukur me piktura të grave të Mirditës. E tëra kishte ngjarë kështu: para se të shembej regjimi komunist ishte ndërtuar këtu një hotel, i cili më pas qe blerë shumë lirë nga kisha katolike. Në këtë kohë aty po mbahej një seminar për të rinjtë. Lini nuk ishte impresionuar nga regjimi i tashëm. Enver Hoxha, sipas mendimit të tij, 50% ishte gabim e 50% e kishte drejt; kurse Ramiz Alia, sipas tij, ishte në përgjithësi një njeri i përparimit. Mirdita kishte dhënë 2000 intelektualë, të cilët tash kishin mbetur të papunë. Sa për italianët, ata vijnë në Mirditë për të na i marrë vajzat e bukura.

Një gjë që tregon për fuqinë e zakoneve fetare është ajo se, përderisa në vendbanimet muslimane nuk shihet asnjë derr, ata luzmojnë në krahinat e Lezhës, Shkodrës e të Mirditës.

Në orën 17 u kthyem në Tiranë. Në hyrje të kryeqytetit kalojmë përska një lagje të madhe me ndërtime të paplanifikuara. Ajo është krijuar përmes shpërnguljes së njerëzve si p.sh. nga Kukësi në veri, të nxitur nga regjimi. E kur kjo popullatë tashmë i kishte ndërtuar shtëpitë, policët provuan t'i largonin. Ata u përgjigjen me gjuajtje gurësh dhe duke e bllokuar rrugën kryesore me blloqe gurësh. Pastaj kishte shkuar një ministër aty për të zgjidhur problemin. Vetura e tij u bë e papërdorshme e ai vetë u mor peng. Ky problem ende nuk është zgjidhur.

Dita e parafundit në Shqipëri

Nuk mund të them se kësaj here jam i pikëlluar pse kthehem në shtëpi. Vapa është e padurueshme dhe me gjithë se jam përshtatur paksa, më ka marrë malli për Suedinë e freskët dhe të ftohtë. E në Shqipëri ka shumëçka që është tronditëse, e keqe dhe tragjike, edhe materialisht e edhe shpirtërisht. Më e keqja, sa më duket mua, është paaftësia sociale, jashtë rrethit të familjes dhe të miqve. "Secili popull e ka atë regjim të cilin e meriton" është një gjykim i vrazhdë. Por ka diçka të vërtetë në këtë thënie, se ai popull i

cili nuk ka aftësi t'i japë fund traditës negative dhe një pikëpamjeje shoqërore që shkatërron mundësitë zhvillimore të atij populli, është i dënuar me destabilitet të vazhduar dhe kundërthënie të llahtarshme.

Këtë mbrëmje të fundit jam i brengosur dhe i irrituar nga klima e nxehtë (40 gradë) dhe dua vetëm të shtrihem dhe të rri si përtac. Por drej o punë, Pleurat Sulo dhe gruaja e tij më ftojnë për darkë. Aq keq ndiehesha nga vapa, sa me dëshirë do t'u thoja "shkoni në drej të mallkuar", por aftësia bindëse e Estrefit dhe uni im më i mirë triumfuan. Te Pleurati shkova bashkë me Estrefin. Pleurati është vërtet njeri i dobishëm në shtëpi, kurse jashtë në qytet duket mjaft i rëndë dhe i tendosur. Shpejt fillova të turpërohem për neverinë time të më hershme. Është i këndshëm, i singjertë dhe shpotitës ky qift bashkëshortor. Estrefi tallet: "Ulmari e ka një traditë që nuk e tradhëton. Ai gjithnjë merr diarrë kur e viziton Shqipërinë. E kjo është mbrëmja e fundit, mundësia e fundit ta ndihmojmë atë që të mbajë traditën e tij, nga se barku i tij ka qenë i freskët deri më tash. O burrani, bëni si të dini më mirë!" u thotë ai nikoqirëve, të cilët shkulen së qeshuri bashkë me mua. E tërë koha ishte argëtim, dhe më në fund unë s'munda të përmbahem pa u treguar Pleuratit dhe gruas së tij se me sa pavullnet erdha dhe sa i kënaqur isha tash. Mendoja se si një darkë si kjo do të mund të zhvillohej sikur kjo të kishte ngjarë në kohën e regjimit të vjetër. Krejt ndryshe, thotë Estrefi: ne vetëm do të rrinim duke folur gjëra të pakuptimta dhe duke ngritur dolli për miqësinë e pavdekshme midis popullit suedez dhe popullit shqiptar, si dhe për Partinë e Punës së Shqipërisë me shokun Enver Hoxha në krye. Diçka tjetër do të ishte e pabesueshme.

Lamtumirë, Vendi i Shqiponjave!

Mëngjesi im i fundit në Shqipëri kësaj here fillon me ndaljen e rrymës. Pastaj e bëj një shtëtitje të padobishme deri te Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Bardhyl Londo, i cili më kishte thënë të vija këtu për të marrë disa vepra, që i zënë me një grua bukuroshe dhe tregoi një mospërfillje të hapur ndaj meje. Materialet do t'i dërgonte me postë, më tha. Dhe nuk është për t'u çuditur që edhe pas kaq vjetësh ai material ende nuk më ka ardhur.

Është më e këndshme të rrih e të bisedosh me Eridën. Ajo është e vogël, e sjellshme dhe miope, prandaj afrohet shumë që të mund të shih qartë. Më qeras me kafe e sanduiç, dhe ne bisedojmë për jetën familjare dhe për bashkëjetesën në përgjithësi. Është çupëza e vockël e mbrojtur në familjen e shkapërderdhur, si dhe është inteligjente dhe mua ma do zemra që kjo inteligjencë t'i ndihmojë asaj të ketë sukses në jetë.

Kësaj here nuk kam parë shumë turistë apo të huaj në Shqipëri. Me sa duket vendi nuk paraqet ndonjë atraksion. Është si një shaka e çunave për gratë e moshuara: Të gjithë e dinë se ç'kanë ato, por askush nuk dëshiron t'iu afrohet!

Erida më ka ftuar për drekë dhe më ka përgatitur edhe ushqim për udhëtim. Ajo ka përgatitur mëlçi, dhe unë e bëj atë të qeshë kur e quaj "Cuca e Mëlçisë", që është një parodi e veprës së njohur "Cuca e Malësisë". Ndër gjërat më qesharake që di është ajo që të gjejë shprehje komike në shqip dhe t'i bëj shqiptarët të shkrihen... Unë jam i frymëzuar nga Helena, ish-gruaja ime, e cila ka aftësi të gjejë shprehje qesharake në suedisht duke u nisur nga prejardhja e saj finlandeze.

Te aeroporti në Rinas shoh një grup grash nga malet e veriut, të veshura me kostumet më të bukura popullore. Nxitoj tek to dhe ato më lejojnë t'i fotografoj. Atyre grave dhe burrave të tyre ua shpreh dashurinë time për kulturën popullore shqiptare. Grupi që vinte nga fshati Dajç afër Shkodrës, magjepset nga komplimentet e mia. Mjerisht, më së shumti janë plakat ato që veshen kështu dhe e ruajnë traditën e bukur.

Ndarja nga Estrefi e Xhemali bëhet me lot në sy. Në kontrollen e pasaportave gruaja i shqyen sytë – dhe kjo bëri "klik" në kujtesën time, ndaj thirra: - "Shqipe!" Ishte

shoqëruesja e sjellshme Shqipja e punësuar nga Albturizmi gjatë vizitës sime të mëparshme në vitin 1979, ajo që pati qarë kur ne u kthyem për në shtëpi, veçmas për shkak të Sanës dhe Matiasit, fëmijët e miqve të mi Sherstina dhe Lars Holshtejn.

SHQIPËRIA E DYTË: KOSOVA

Popullsia: Kosova është po aq e madhe sa krahina suedeze Skone.

Sipas regjistrimit të vitit 1981 numri i banorëve ishte 1 584 000.

Prej këtyre 1 226 736 shqiptarë – 77%.

Serbët përbënin 209 792 – 13%.

Minoritetet e tjera: 26 000 malazezë dhe 58 000 muslimanë etnikë.

Në vitin 1990 llogaritej numri i shqiptarëve në Kosovë të jetë rritur afro 90%.

Rritja e popullatës deri në fillimet e viteve të 1990-ta ishte shumë e lartë, sidomos te popullata shqiptare.

Ekonomia: Kosova ka hapësira të mëdha me tokë pjellore. Kushtet për bujqësi janë të shkëlqyeshme, mirëpo mungesa e kapitalit ka bërë që të përdorën metoda mjaft primitive të shfrytëzimit me shkallë të ulët të mekanizimit dhe si rrjedhojë edhe rendimenti ishte mjaft i ulët.

Kosova poashtu është shumë e pasur me minerale. Në minierat e Trepçës te Mitrovica janë burimet më të mëdha të Evropës në plumb, zink dhe nikel. Burimet e ujit poashtu janë të mira; dhe kjo pasuri është kryesisht e pashfrytëzuar.

Kultura: Kultura shqiptare në Kosovë karakterizohet nga shumë elemente, që janë shkrirë në një gjatë rrjedhës së historisë. Trashëgimia ilire qëndron si themel, por ka ndikime të kulturës greke dhe romake-latine që prej antikës, më pas elementet serbe dhe turke që janë përfshirë në kulturë. Ajo çka i karakterizon shqiptarët e sotit në Kosovë - është një kulturë e veçantë, por që ka shumëçka të përbashkët me kulturën e Shqipërisë.

Arsimi i përgjithshëm popullor, i cili u zhvillua me hov, veçmas nga vitet 1960, ka bërë që gjuha e njëzuar shqipe të përdoret zakonisht si gjuhë e kulturës. Megjithatë, këtu jetojnë dialektet shumë më fuqishëm se p. sh. në Evropën veriore.

Në mënyrë përmbledhëse mund të thuhet se kultura në Kosovë është e orientuar kah vendet perëndimore, kurse në kulturën popullore jetojnë edhe sot e gjithë ditën elementë patriarkalë dhe orientalë. Universiteti i Prishtinës, që nga fillimet e viteve të 1970-ta, ka luajtur një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në arsimin dhe në jetën kulturore. Duke qenë se shumë të rinj nga provinca studjojnë në Universitet, dallimet qytet-fshat u pakësuan dukshëm.

Religjioni: 450 vitet e sundimit të Perandorisë Osmane në Kosovë bënë që majoriteti i popullatës të kalojë në islam. Shpesh nuk bëhej fjalë për konvertim të detyruar; vendimtare ishte se muslimanët kishin përfitime ekonomike. Pastaj, kisha katolike që në shekullin e XVI ishte në rënie dhe e humbi forcën e vet bashkuese.

Sot nga shqiptarët e Kosovës 90% janë muslimanë, kurse rreth 10% janë katolikë.

Serbët në Kosovë janë ortodoksë. Shqiptarët janë shumë tolerantë në çështjet religjioze: fundamentalizmi nuk ka rrënjë tek ta.

KOSOVA – VIKTIMË E POLITIKËS BOTËRORE

Sikurse e kam thënë edhe më parë, nuk ka hapësirë në suaza të kopertinave të këtij libri që më për së afërmi t'i parashtroj zhvillimet jashtë shtetit shqiptar, për ato treva ku ndodhet një numër i madh i popullatës shqiptare. Gjendja në Kosovë është paraqitur tashmë në 4-5 publikime, në të cilat publikime ai që është i interesuar mund të gjejë përgjigjet në pyetjet lidhur me historinë dhe jetën shoqërore të kësaj treve.

Unë do të përqëndrohem që të shtroj problemin më të vështirë: Se si erdhi deri te kjo gjendje në Kosovë dhe cilët faktorë kanë qenë vendimtarë, që këtë trevë e bënë një prej problemeve më akute etnike në Evropë.

Gjatë sundimit Osman, që në Ballkan zgjati thuhet 500 vjet, çështjet etnike u paraqiten në plan të parë për të parën herë në shekullin XIX. Asokohe fuqi të ndryshme u konfrontuan me njëra-tjetrën: Përpjekjet nacionaliste të popujt e Ballkanit dhe në qarqet drejtuese që këto çështje i çonin përpara, interesat e Fuqive të Mëdha në këto treva, relacionet e këtyre me fuqitë nacionaliste në Ballkan dhe rivalitetet e tyre të brendshme dhe qëndrimet e Fuqive të Mëdha kundrejt tyre.

Në Kongresin e Berlinit më 1878 u zhvillua një luftë midis partnerëve të ndryshëm, ku kombet e Ballkanit, të përkrahur ose të kundërshtuar nga Fuqitë e Mëdha të Evropës, përpiqeshin të gjenin përkrahje në kërkesat e tyre.

Lëvizja shqiptare për një shtet shqiptar ka filluar më vonë se te popujt e tjerë të Ballkanit. Ajo e kishte shumë të vështirë të fitonte simpati për kërkesën për pavarësi të atyre trevave që kishin popullatë shqiptare. Burrshetasi gjerman Bismark madje pati deklaruar: "Nuk ka ndonjë komb shqiptar". Pikëpamja e tij në këtë çështje do të dominojë edhe në politikën evropiane lidhur me shqiptarët për shumë dekada. Nuk ndihmoi gjë fakti që intelektualët shqiptarë dhe liderët e tjerë shqiptarë menjëherë pas Kongresit u mbledhën në Prizren të Kosovës dhe themeluan një bashkim për mbrojtjen e atdheut, Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (për më konkretisht shih nënkapitllin e këtij libri "Pavarësia shqiptare"). Shpërthimi i aktivitetit politik e kulturor i shqiptarëve që pasoi nuk e ndryshoi indiferencën evropiane.

Kudo në Evropë shqiptarët trajtoheshin si një numër fisesh, e jo si një popull. Ky botëkuptim i tyre bazohej në faktin se shqiptarët i kishin tri fe. Nuk ndihmoi aspak e dhëna se shqiptarët vazhdimisht e kishin parë fenë e tyre të nënshtruar ndaj interesave të kombit.

Sidomos vendet fqinje si Serbia, Mali i Zi dhe Greqia tregonin një mungesë totale të mirëkuptimit lidhur me kërkesat e shqiptarëve, të cilat ishin në kundërshtim me synimet e tyre ekspansioniste. Greqia donte të nënshtronte Shqipërinë jugore dhe për këtë mbështetej në faktin se atje kishte një minoritet grek. Serbia synonte të dilte në detin Adriatik dhe po qe se shqiptarët do t'i kundërviheshin këtyre synimeve, këta ose do të nënshtroheshin ose do të asgjësoheshin, mendonin në Beograd.

"E sëmura e Evropës", Perandoria Osmane, ishte duke dhënë shpirt dhe në këtë kohë erdhi Lufta Ballkanike, që të sëmurit i dha goditjen vdekjeprurëse. Mu në mes të kësaj lufte, patriotët shqiptarë e shpallën pavarësinë e Shqipërisë më 28 nëntor 1912. Konferenca e Londrës, e thirrur për shkak të Luftës së Parë Ballkanike, nuk i përfilli kërkesat etnike të shqiptarëve. Pretendimet shqiptare u mbështeten nga Austro-Hungaria, mirëpo Serbia gëzoi mbështetjen e Francës dhe të Rusisë. Serbia përfitoi treva të mëdha, ku majoriteti i banorëve ishin shqiptarë, dhe u vendos ky kufi që vlenë edhe sot. Serbët sulmues gjatë tërë kohës përmes masakrave ndaj shqiptarëve kishin bërë gjithçka për të ndryshuar strukturën e popullsisë në dobi të tyre. Populli shqiptar u nda mes për mes nga ky kufi.

Peter Dalhof-Nilsen shprehet në "Örnarnas land" në një mënyrë shumë të qëlluar se si Ministri i Jashtëm britanez e përshkruan atë që ndodhi në Konferencën e Ambasadorëve në Londër dimrin dhe pranverën e vitit 1913. Rusët donin t'ia lenin Kosovën Serbisë, kurse Austria Shqipërisë. Kështu, herët një mëngjes, në kohën e rrëshajave, ambasadori austriak Mensdorf shkoi te Grej dhe ia përcjellë porosinë e "gëzueshme" se qeveria e tij u ka lëshuar pe rusëve dhe ka vendosur që Kosovën t'ia lërë Serbisë. "Nyja e Gordit që zgjidhur, por vetëm në dukje" shkruan Dalhof-Nilsen, "një konflikt u shmang dhe kështu u siguroa paqja në Evropë".

Me këto fjalë nga memoaret e Grejit hidhet dritë e qartë mbi lojën e shahut të Fuqive të Mëdha në lidhje me çështjen e përkatësisë së popullit shqiptar dhe përmes përshkrimit të rrjedhës së ngjarjeve shemben si shtëpi kartoni të gjitha argumentet mbi "të drejtën" e Serbisë ndaj Kosovës.

Shqiptarët në Kosovë dhe Maqedoni "kështu" ranë nën një regjim, i cili i shihte këta si një të keqe të tepërt, si një trup i huaj në shtetin e serbëve, kroatëve dhe sllovenëve (kështu quhej në fillim Jugosllavia).

Serbia në fillim kishte synuar ta nënshtonte tërë Shqipërinë, por kishte dështuar. Shtetit të amputuar shqiptar që u krijua i mungonin kushtet ekonomike dhe qytetare për një mirëqenie të ardhme. Trevat më të rëndësishme bujqësore dhe pasuritë minerale ndodheshin në anën tjetër të kufirit, në Kosovë. Pesëqind vjetët e sundimit osman kishin shkaktuar prapambetje dhe e kishin lënë një strukturë feudale. Gjakmarrja, uria, shtypja e grave, malariet dhe tuberkulozi ishin karakteristikat e shtetit të ri shqiptar. Nuk ndihmonte shumë fakti që vizitorët dashamirës të huaj e çmonin lart mikpritjen, bujarinë dhe nderin e shqiptarëve të varfër. Gjendja sociale dhe ekonomike ishte e mjerë. Shqipëria mbeti vendi më i varfër dhe më i pazhvilluar në Evropë për shumë vite.

Në anën tjetër të kufirit, në mbretërinë e Jugosllavisë, shqiptarëve u mohojë ekzistenca si popull. Mundoheshin t'i etiketonin ata si "turq", një dallim që bazohej në fenë e tyre muslimane. "Të drejtën" e vet për Kosovën serbët e bazonin në faktet historike nga shekujt XIII-XIV, kurse shqiptarët mund të replikonin se ata kishin qenë në këtë vend shumë kohë para se serbët të arrinin në Ballkan në shekullin VII-VIII. Shumë shqiptarë i detyruan të emigronin në Turqi. Lidhja e Kombeve në Gjenevë më 1930 mori një dokument dëshpërues, një memorandum të hartuar nga tre priftërinj katolikë shqiptarë, në lidhje me gjendjen e shqiptarëve në Jugosllavi. Mu në zjarrin e luftës më 1999, Karl Bildi (ish kryeministri i Suedisë) e vizitoi Gjenevën dhe atëherë ai u informua për këto dokumente të vjetra. A ishte e përshtatshme politikisht dhe e mundshme për t'i përkujtuar ato? Sigurisht, tha Bildi, ato duhet pa fije dyshimi të hapen dhe të bëhen publike. (Nga një program në TV suedez).

Shqiptarët në Jugosllavi u zhgënjyen sërish në fund të Luftës së Dytë Botërore. Ata nuk kishin avoketë mbrojtës në botë, dhe me gjithë se ata kishin dashur të bashkoheshin me shtetin e Shqipërisë, siç qe vendosur në Konferencën e Bujanit më 31 Dhjetor 1943 dhe 01, 02 Janar 1944. Kjo ëndërr e lashtë e shqiptarëve të Kosovës megjithatë nuk u realizua. Konsiderohej se forcat serbomëdha ishin tepër të fuqishme, ndaj, kryetari Tito deklaroi se nuk ia kishte dalë ta frenonte nacionalizmin serb në lidhje me atë se cilit shtet duhej t'i përkisnin shqiptarët.

Mirëpo, shqiptarët e Kosovës asnjëherë nuk u pajtuan me robërinë e imponuar. Kështu, në mars të vitit 1964, nga anëtarët e Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve (LRBSH), së cilës i printe patrioti dhe shkrimtari Adem Demaçi, në mbarë Kosovën u shpërndanë flamujt kombëtarë shqiptarë. Pas pak, e pikërisht më 08.06.1964, nga policia sekrete jugosllave UDB-a, u arrestuan me qindëra njerëz të cilët i përkisnin LRBSH-së. Të gjithë këta u dënuan me burgime shumëvjeçare, ndërkaq Adem Demaçi,

u dënua me 15 vjet burg. Pas liritimit nga burgu, sërish Adem Demaçi u dënua me 15 vite burg. Kështu ky patriot dhe shkrimtar shqiptar qëndroi 28 vjet nëpër burgjet e ndryshme jugosllave.

Këtë radhë Lëvizja në fjalë nuk ia arriti t'i realizojë qëllimet e veta çlirimtare, por flakadanin lirishtesë të saj e mbajtën gjallë të gjithë brezat e Kosovës. Këtë ideal të shenjtë lirie më vonë e sendërtuan me gjak luftëtarët e UÇK-së të cilët me heroizëm të pashoq luftuan për t'ia sjellë lirinë Kosovës.

Për hirë të objektivitetit, është me rëndësi të ceket se në periudhën prej vitit 1966, atëherë kur Ministri i Brendshëm serb Aleksandër Rankoviç u shkarkua, e deri te viti 1981 shqiptarët në Kosovë kishin një vetëqverisje të konsiderueshme. Më pas, të drejtat e tyre u suprimuan në mënyrë sistematike nga regjimi serb në Beograd. Pas vdekjes së Titos, shqiptarët e Kosovës filluan me shqetësim të shihnin shenja ogurzeza dhe sipas parimit se "preventiva është më e mirë se sa kurimi", studentët e Prishtinës kërkuan që Kosova të fitojë statusin e republikës. Është me rëndësi të kujtojmë se në pjesën më të madhe ishin grupet marksiste-leniniste, të frymëzuar nga Shqipëria e Enver Hoxhës, që i parashtronin kërkesat shqiptare. Demonstratat dhe protestat u shtypën me dhunë të egër. Pastaj serbët filluan për t'i zhvidhosur vidhat e autonomisë një nga një, dhe kur Milosheviçi erdhi në pushtet vendosi t'i qëronte hesapet me "nacionalizmin, irridentizmin dhe separatizmin shqiptar" një herë e përgjithmonë, me mbështetje të fortë të nacionalizmit serb. Në vitet 1989-1990 u anulua statusi i veçantë i autonomisë së Kosovës dhe nga shqiptarët u kërkua lojalitet ndaj Serbisë, të cilën praktikisht të gjithë refuzonin ta pranonin. Në një periudhë prej dhjetë vitesh shqiptarët mbetën jashtë shoqërisë zyrtare dhe u krijua një shoqëri më vete, e cila vazhdimisht kërcënohej e krasitej nga pushteti shtetëror serb, që kishte pushtetin e përgjithshëm në duar të veta përmes policisë, ushtrisë dhe kontrollit kufitar. Ishte një formë e veçantë e okupimit, ku "Republika e Kosovës" kërkonte të drejtën e vet për ekzistencë përmes politikës joviolente.

Udhëheqja e Republikës me akademik Ibrahim Rugovën në krye megjithatë nuk ia arriti të fitonte mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare për kërkesat e veta për pavarësinë e Kosovës. Interpretimi i çuditshëm i së drejtë së popujve që mbretëronin në botë, i dha Serbisë mandatin që ta trajtojë Kosovën me atë brutalitet që ajo e gjente më të përshtatshëm. Rugova kishte besuar se do të mund ta bënte Serbinë të lëshonte pe përmes politikës së molisjes. Por edhe Serbia e kishte vlerësuar gabimisht se do të mund ta mbante kontrollin në të ardhmen.

Për shqiptarët e Kosovës ishte e qartë se një ndarje totale dhe përfundimtare nga Serbia ishte e domosdoshme. Asnjë regjim jugosllav nuk do të mund t'i garantonte të drejtat e tyre etnike, politike, sociale dhe kulturore. Në vitet 1966-1981 sigurisht që ishte shënuar një përparim në këtë drejtim, porse tash kushtet ishin ndryshuar krejtësisht. Shumë shqiptarë konsideronin se pritja për instalimin e një qeverie demokratike në Beograd, pas së cilës gjë edhe bashkësia ndërkombëtare do t'i mbështeste kërkesat e tyre për të drejta etnike, mund të çonte deri aty sa lidërshipi serb, në ndërkohë, të ndërmernte një aksion të drejtpërdrejtë dhe të bënte serbizimin total të Kosovës. Kush do të guxonte të priste kaq gjatë në rrethana të këtilla fare të pasigurta?

Në një ligjëratë në Stokholm në pranverën e vitit 2000 Sherstin Gredbek, veprimtare e organizatës "Gruaja për gruan" e cila disa herë e kishte vizituar Kosovën, përmendi se ajo kishte kuptuar që nga viti 1994, me rastin e bisedave me studentët e Prishtinës, se zhgënjimi kishte arritur pikën më të lartë dhe ata nuk mund të përballonin më situatën, me atë mungesë të veprimeve të frytshme, të cilat do t'u siguronin të drejtat e shqiptarëve. Ibrahim Rugova, për fat të keq, për një kohë të gjatë e kishte mashtruar opinionin publik me shprehjet e tij mbi mbështetjen për Kosovën nga politikanë dhe

personalitete në krye të shteteve të ndryshme të botës, gjë që ata që ishin mendjekthjellët e cilësonin si (vetë) iluzion ose vetëm dëshirë. Ishte, pra, një çështje kohe kur durimi shqiptar do të mbaronte përfundimisht dhe atëherë kur përpjekjet pacifiste nuk do të mund të pengonin durimhumburit dhe forcat vepruese të kalonin në veprime. Dhe si zakonisht, kur armët filluan të flasim vetëm atëherë superfuqitë treguan një interesim "të vërtetë". Në politikën e superfuqive më së shpeshti ndodh të mos ftohen zjarrfikësit para se shtëpia të jetë djegur thujse krejtësisht. Para se gjithash, Evropa po tregonte cinizëm, ndrojtje dhe indiferencë irracionale, megjithëse shembulli i Bosnjës tashmë kishte dëshmuar se çfarë skenari pritej. Ajo Evropë që e kishte tradhëtuar Ballkanin më 1879, 1913 dhe më 1945 ishte e gatshme ta tradhtonte përsëri. Mirëpo kësaj here shqiptarëve befas u dolën në ndihmë mediat, duke i bërë ata tepër të dukshëm dhe në këtë mënyrë u pamundësua mospërfillja...

Kështu, ndodhi ai eksplodimi që filloi me aksionet e fshehta të guerilës UÇK dhe me manipulimet politike të regjimit të Milosheviçit si dhe me sulmet policore nëpër fshatrat e Kosovës. Shqiptarët në mërgim ndienin një shqetësim dhe ankth të jashtëzakonshëm për atë që do të ndodhte: A ishte, vallë, lufta për vdekje e atdheut dhe e popullit të tyre ajo që këta po e shihnin nga larg? Përveç kontributit ekonomik për Kosovën nga emigracioni shqiptar, qenë shumë që braktisën sigurinë e tyre në Suedi dhe në shumë vende të tjera evropërendimore – dhe që brenda UÇK-së, me armë në duar, do të luftonin për ekzistencën dhe lirinë e atdheut të tyre. Kjo mund të krahasohet me vullnetin për fljirim që u tregua në luftën civile të Spanjës, ku shumë vullnetarë vërshuan për të luftuar kundër Frankos dhe fashistëve. E kundërshtare në Kosovë ishte një nga ushtritë më të mëdhaja të Evropës - ushtria serbe.

Dyshimi, se ata mund të mbeteshin kërkues të lumturisë ekonomike këtu në Suedi, me siguri ka ndikuar që këta të rinj të gjakonin për të rifituar krenarinë dhe vetëbesimin, përmes paraqitjes vullnetare për luftë. Kjo natyrisht e ka çmimin e vet – askush nuk mbetet i paprekur nga tmerret dhe mundimet e luftës.

Ajo çka ndodhi më pas i takon historisë aktuale dhe është e njohur mirë për çdo njërin. Kur ky libër ishte duke u shkruar, dukej qartë se Evropa ende nuk ka guximin që hapur të mbështesë kërkesat shqiptare për ndarje totale të Kosovës nga Serbia. Në vend të kësaj bëhet një shtyerje e çështjes lidhur me ardhmërinë e statusit të kësaj treve, dhe rezultat mund të jetë fakti që mundësitë për ndërtimin e pavarësisë në Kosovë të frenohen. Kush guxon të investojë në një gjendje të tillë pasigurie, si mund të ndërtohet një shoqëri stabile, kur e ardhmja është e paqartë? Me 70% papunësi dhe me një ekonomi ku paratë nga farefisi në vendet perëndimore dhe nga veprimtaria e mafias përbën bazën, Kosova është shumë larg nga zhvillimet drejt lirisë, demokracisë dhe mirëqenies, për të cilat gjëra kaq shumë veta kanë flijuar jetën...

NË VEND TË EPILOGUT

Një pjesë e madhe e suedezëve, që gjykojnë me nxitim, mendojnë se e kanë të qartë pasqyrën e shqiptarëve: Ata janë primitivë, të pabesueshëm dhe gjaknxehtë, të cilët nuk ngurrojnë t'i rrokin armët kur është fjala për t'i zgjidhur konfliktet. Ata merren me kontrabandë narkotike, me veprimtari të tjera të errëta dhe në përgjithësi janë hajna. Disi kështu pati thënë ministresha suedeze – megjithëse ajo që e detyruar më pas t'i tërhiqte fjalët e veta!

Unë shpresoj që ky libër do të paraqes një kundërpeshë ndaj këtyre paragjytimeve. Unë vetë nuk jam i njohur si primitiv, i pabesë, gjaknxehtë, i dhënë pas armëve dhe nuk merrem me hajni – e pra unë e dua këtë popull dhe atë të mirë që ata mund të na japin. Unë e di se pak rëndësi kanë theksimet e mësipërme raciste... Pa zbulime, pa fshehur anët negative, jam munduar të jap imazhin e një populli, i cili e meriton një fat më të mirë se sa të përfundojë në fatkeqësi.

Por sa faktorë negativë, vallë, mund të gjenden, po që se do të kërkohej një sqarim për këtë gjendje të mjerueshme, që populli shqiptar ka kaluar ndër shekuj? Sikurse të provonim ne të krijojmë një "toplistë" të fatkeqësive, do të ishte tepër e vështirë të bënim një rangim të drejtë, sidoqoftë më poshtë po i paraqes dhjetë faktorët më negativë që unë kam mundur t'i gjejë; faktorët në fjalë nuk janë të ranguar sipas peshës së tyre, por sipas një kronologjie:

Kolonizimi romak

Shkatërrimet e dyndjeve të popujve

Sundimi i Perandorisë Osmane për gati 450 vjet

Faktorët gjeografikë (topografia, klima e ashpër në male, moçalet)

Zgjidhja e vonuar i vetëdijes kombëtare dhe kulturore, struktura feudale

Prapambetja, traditat negative, gjakmarrja

Ndarja e padrejtë e kufijve nga Fuqitë e Mëdha

Politika e shteteve fqinje kundër Shqipërisë

Okupimi fashist

Ushtrimi i pushtetit nga Partia Komuniste, stalinizmi, Enver Hoxha, terrori.

Për ta përgatitur "top - 10" me këta faktorët e fatkeqësisë – nuk që edhe aq vështirë. S'është kaq e lehtë të gjejmë faktorë pozitivë. Pasi që gjendja e vendit ka qenë dhe sot është e rëndë e jostabile, ndaj duket më e përshtatshme që, për të krijuar një pasqyrë të plotë, të kemi parasysh pjesët negative.

Unë jam përcaktuar për të përshkruar kryesisht historinë e Shqipërisë së pavarur, duke filluar nga viti 1912 deri te fundi i viteve të 1990-ta. Historia e vjetër, para 1912, mund të gjendet mjaft mirë e përshkruar, madje edhe në suedisht, ku nuk ka dallime të mëdha në mes të rrëfimeve. E mbi çështjen e Kosovës tashmë kam shkruar disa broshura, të botuara më 1981, 1990 dhe 1999, broshura që për fat të keq nuk janë shpërndarë shumë.

E po që se dëshiron të tregosh për zhvillimet e popullit shqiptar pas 1912, do të hasësh në vështirësi. Deri më 1920 është fjala për një histori të kaosit dhe anarkisë, pushtues të huaj dhe luftime të brendshme, uri dhe epimedi. I vetmi faktor pozitiv është përpjekja austriake për të përmirësuar kushtet dhe për të modernizuar atë trevë ku ata ishin vendosur në veri të Shqipërisë. Sikur të mos ishin shkatërrimet serbe, malazeze, bullgare e greke, shkatërrimet e komandantëve vendorë ushtarakë (si Esat Pasha, Haxhi Qamili etj.) si dhe mungesa e një strukture shoqërore – do të ishte i mundur krijimi i një shteti stabil.

Gjatë viteve 1920-1939 u bë një lloj stabilizimi me një periudhë më paqësore. Ahmet Zogu e mori pushtetin më 1925. Ai ishte një sundimtar feudal, por me një lloj ambicie për të përmirësuar gjendjen në vendin e tij. Por politikisht e ekonomikisht ra në duart e Italisë, e cila më 7 prill 1939 e aneksoi tërësisht Shqipërinë. Vendet tjera të Evropës e panë këtë, por nuk ndërhyjnë. Shqiptarët nuk konsideroheshin një popull për të cilin ia vlen të flijohesh.

Pasi Bashkimi Sovjetik u sulmua nga Gjermania verën e vitit 1941, komunistët filluan të organizohen gjithandej nëpër Ballkan. Më të fuqishmit janë ata në Serbi; dhe janë emisarët jugosllavë ata që i përcaktojnë tiparet kur Partia Komuniste e Shqipërisë krijohet në nëntor të të njëjtit vit. Idetë për frontin popullor, në shembëlltërinë e perfiditetit të stalinizmit, shfaqen edhe në Shqipëri: front popullor domethënë në atë rast një lëvizje ku komunistët e kanë pushtetin në prapaskenë, ku masat manipulohen, ku liberalët shërbejnë vetëm si garniturë ose eliminohen dhe ku nacionalistët e konservatorët luftohen dhe shkatërrohen në luftë civile. Vitet 1942-1945 për Shqipërinë ishin vitet kur Fronti Nacional-Çlirimtar përkushtohet për të goditur italianët dhe gjermanët, kur raportet e forcave e lejonin këtë, por mbi të gjitha për të goditur kundërshtarët e tyre në frontin e brendshëm. Në kuadër të udhëheqjes, Enver Hoxha manovroi për të fituar dominancën. Kundër tij kishte, para se gjithash, Koçi Xoxen, laron e jugosllavëve, dhe në fillim edhe Sejfullah Malëshoven, që angazhohej për një bashkëpunim me aleancën perëndimore dhe për një politikë liberale kulturore. Malëshova spastrohet që në vitin 1946, kurse prishja e Bashkimit Sovjetik me Jugosllavinë e Titos i jep Hoxhës një mundësi për të likuiduar kundërshtarët e mbetur në udhëheqje, si Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo, gjatë vitit 1948.

Gjendja e izolimit e Shqipërisë pas prishjes me Jugosllavinë shoqërohet me përpjekjen e SHBA-ve që nën hijen e luftës së ftohët të rrezojnë regjimin e Tiranës përmes agjentëve që lëshohen me parashuta, por që dështuan krejtësisht, ndër të tjera, për shkak të raportimit të agjentit Kim Filbi lidhur me planet amerikane.

Politika e vërtetë e Hoxhës duket se kurrë nuk do të ndriçohet tërësisht, e as roli që ka luajtur Shërbimi i Sigurimit Shqiptar. Pyetje interesante: Në Jugosllavi kishte një bërthamë të fortë të serbomëdhenjve, që i pëlqenin metodat e Stalinit dhe s'i besonin politikës fleksibile të Titos dhe balansit midis politikës së brendshme dhe të jashtme. A është e mundur që Hoxha dhe Sigurimi të kenë pasur lidhje me këta konservatorë stalinistë në Jugosllavi?

Në udhëheqjen shqiptare të partisë kishte një numër të madh joproporcional të grekëve dhe vllahëve nga popullata e këtyre minoriteteve. Për disa vite Shqipëria ishte bazë e partizanëve grekë të gjeneral Markos, gjë që paraqiste një moment të vazhdueshëm pezmatimi të regjimit grek. A mos, vallë, Athina ushtroi ndikim përmes agjentëve të vetë në Shqipëri?

Nacionalistët shqiptarë në vitet e 1990-ta janë përgjigjur me "po" në të dyja pyetjet. Por do të ishte interesante sikur kjo që ka ngjarë të mund të ndriçohet përmes ndonjë burimi më të paanshëm.

Edhe Greqia e edhe Jugosllavia ndër vite kanë ndjekur një politikë perfide kundrejt Shqipërisë. Këtë karakteristike që unë e paraqes këtu nuk ka të bëjë aspak me vlerësimin e regjimit të Enver Hoxhës. Gjatë kohës së diktaturës në politikën e shteteve fqinje nuk ushqehet ndonjë simpati apo humanizëm ndaj Shqipërisë. Përkundrazi: gjendja e mjerë e Shqipërisë i kishte dhënë rast Beogradit dhe Athinës të shfrytëzonin dobësinë shqiptare, ashtu sikurse kishin bërë edhe prore.

Mbërthimi i vendit nga Enver Hoxha bëhet gjithnjë e më i fortë. Pas prishjes me Bashkimin Sovjetik gjithçka bëhet edhe më keq. Nga viti 1967 izolimi krijon hapësirë për të shkatërruar kulturën shqiptare. Kishat dhe xhamitë shkatërrohen ose

shndërrohen në ndërtesa profane, traditat dhe ritet shkatërrohen ose shndërrohen në "frymë socialiste", legjislati e institucionalizon mungesën e të drejtës së individit. Atë që nuk kishin mundur ta shkatërronin vandalët, hunët, kalorësit e kryqëzatave, hordhitë osmane dhe grupet banditeske serbe, po ia jepte goditjen vdekjeprurëse politika komuniste, që ushtrohej nën hijen e revolucionit kulturor kinez. Një shabllon steril kulturor kishte mbetur dhe do të dominonte për gati tridhjetë vjet, me përjashtim të një kohe të shkurtër të lulëzimit kulturor në vitet 1971-1972. Dhe pikërisht në këtë kohë goditi përsëri grushti shkatërrimtar: Enver Hoxha e mprehi shpatën dhe me të preu herë pas here, më 1973 dhe në vitet pasuese. Kur vdiq më 1985, kishte arritur që, në pjesën më të madhe, të shkatërronte çdo përpjekje për mendim të pavarur dhe kulturë të gjallë.

Por atëherë edhe ditët e regjimit ishin thujtë të numëruara. Pesë vite pasi kishte ikur Hoxha nga skena filloi gjithçka të shembet. Binin statujat e Leninit e të Stalinit, si dhe statuja e madhe e Hoxhës. Muzeu i tij piramidial u zbraz dhe aty në të ardhmen do të dëgjoheshin edhe himne të krishtera. Një gjeneratë e tërë shqiptarësh ishin stërkequr shpirtërisht përmes terrorit. Kjo vuajtje e popullit është jashtëzakonisht e madhe. Se të shuash shpirtin në një trup me jetë është një krim edhe më i keq se vrasja. E kjo është një mizori që kurrë nuk mund të falet. Vakuumi shpirtëror, që u krijua në Shqipëri pas rënies së diktaturës, është një dëshmi tragjike për vuajtjen shpirtërore të këtij populli. E çka fituan ata? Shokterapinë e kapitalizmit botëror pas kolektivizimit të detyruar; ideologjinë e individualizmit karrierist në vend të solidaritetit të detyruar e të mirëfilltë! E kjo definitivisht nuk ishte ajo për çka populli shqiptar kishte nevojë.

Natyrisht, ndonjë herë kishte edhe solidaritet të mirëfilltë. Ajo çka unë kam përjetuar në fshatrat e Shqipërisë veriore gjatë vizitës sime më 1979 pas tërmetit të madh që pati goditur Shqipërinë dhe Malin e Zi, ishte punë rindërtuese e bazuar në një organizim të mirë, solidaritet dhe bashkëpunim. Këto janë kujtimet e mia më të ndritshme nga epoka e Hoxhës. Të rinjtë që punonin në rindërtim ishin të frymëzuar me solidaritet. Ishte fatkeqësi që ky vullnet natyror për t'u dalë në ndihmë të tjerëve, u shfrytëzua dhe u kompromitua aq shumë sa që të rinjtë shqiptarë në vitet e 1990-ta drejtpërdrejt reagonin negativisht të shprehja "punë vullnetare". Ata e kishin kuptuar me lehtësi se "puna vullnetare" shënonte përpjekjen e regjimit për t'i shfrytëzuar njerëzit për qëllime materiale dhe propagandistike. Prandaj bazat e solidariteti ishin kalbur...

Dora e rëndë e partisë kishte rënduar mbi Shqipërinë. "Ne bëjmë gjithçka nën udhëheqjen e partisë" ishte parulla. Shpresa se mbërthimi do të zëvendësohej me një angazhim të rritur të popullit, të bazuar në vetëdijen politike dhe sociale, kishte dështuar me turp. Mekanizmat mbrojtës të partisë, sipas modelit leninist të partisë, ishin treguar si fuqia më e madhe e shoqërisë dhe kjo fuqi nuk lejonte kurrfarë konkurrence. Kështu kjo epokë tragjike u shndërrua në një kohë kur jeta normale kishte pushuar në vend, e që në fakt ishte një kohë kur më së shumti kishte nevojë për tërë spontanitetin dhe fuqinë krijuese të mirëfilltë. Dhe konsekuenca ishte një varfëri më e keqe se sa vështirësitë ekonomike.

E sa i përket Kosovës më duket e drejtë të theksoj se ajo që ka ndodhur atje është një lloj çlirimi i vonuar nga shtypësit kolonialistë. Suedia nuk gëzonte të drejtën për ta zotëruar Finlandën, për shkak të parimit të kohës sonë se secili popull ka të drejtë në vetëvendosje, dhe sipas të njëjtës pikëpamje as turqit osmanë e as serbët nuk kishin të drejtë për ta zotëruar Kosovën. Ky vend i përket popullit të tij, por me siguri kjo e drejtë e tyre do të kontestohet sërish, para se të krijohen kushtet reale për paqe të qëndrueshme në Ballkan. Ne duhet të shpresojmë se nacionalizmi do të pushojë së qeni një armë për të shtypur të tjerët. Ai duhet të ruhet tashmë si një mbrojtje paqësore e kulturës autoktone dhe e gjuhës, në të njëjtën kohë që ajo afirmon dhe mbështet

kulturat e tjera në baza të barabarta. Dhe në atë kontekst më mirë është të flasim për patriotizëm se sa për nacionalizëm.

Ky problem me një zhvillim në proces e sipër është në kundërshtim me një çështje së paku po kaq të rëndësishme: Në këtë fazë të zhvillimit në të cilën populli shqiptar ka hyrë do të bëhet gjithnjë më e evidente nevoja për vetërimëkëmbje. Sikurse ne këtu në Suedi që para 150 vjetësh krijuam lëvizje të ndryshme popullore të cilat kontribuan në zhvillim, si për të dalë nga shtypja sociale, alkoholizmi, padituria dhe prapambetja ashtu edhe për të krijuar demokracinë moderne suedeze, njëloj edhe shqiptarët duhet që përmes lëvizjeve të veta popullore të gjejnë rrugën e zhvillimit demokratik, larg nga sundimi i mafias dhe mungesës së solidaritet shoqëror. Kjo nevojë e unitetit si kusht për ndërtimin e një shoqërie moderne shqiptare, që ishte aspiruar që në Rilindjen Shqiptare para më se 120 vitesh, duket të jetë një nevojë aktuale edhe sot e gjithë ditën. E tash janë vetë shqiptarët ata që duhet të marrin përsipër ndërtimin e shoqërisë së tyre, natyrisht me ndihmën dhe orientimin nga jashtë, por para se gjithash me fuqitë e veta. Në disa aspekte ora shqiptare është ndalur që nga pushtimi osman në shekullin e XV – dhe ajo ende nuk ka nisur të punojë me atë ritmin e vet të rregulltë. Këtu do të kërkohet të bëhet një spastrim i madh nga mentaliteti kokëfortë dhe mungesa e vetëdijes shoqërore, që ende gjallojnë ndër shqiptarët. Pa një zhvillim pozitiv drejt demokracisë, shqiptarët nuk kanë ndonjë ardhmëri në Evropë. Është e tmerrshme të mendosh se sa shumë shqiptarë i kanë shkatërruar jetët e tyre dhe me gjithë heroizmin, ata jetuan kot. Po mendoj për ata heronj të cilët për idealet e tyre dhe për shkak të çiltërsisë së tyre u kalbën nëpër burgjet shqiptare. Ky vend ka dhënë një Enver Hoxhë, por edhe një Nënë Terezë. Dhe unë jam i bindur se do të jetë Tereza, Agnes Gonxhe Bojaxhiu sikurse ajo quhej në të vërtetë, që bota do ta kujtojë – edhe pse shumë nuk e dinë se ajo ishte shqiptare.

Shtrohet pyetja se çka do të ndodhë? por kjo do të jetë një histori tjetër. Për fat të keq ka një rrezik, që fati i shqiptarëve të ketë farë ngjashmërie me legjendën e një mëlyshi në një liqe suedez. Një gjeraqinë zhytet në thellësi dhe ia vë kthetrat mëlyshit, por ky kishte qenë shumë i madh dhe i fuqishëm sa e tërheq në thellësi shpendin grabitçar. Gjeraqina ngordh dhe me kohë shndërrohet në skelet. Meqenëse kthetrat e gjeraqinës ishin ngulur aq thellë në trupin e mëlyshit, ky detyrohej të notonte me skeletin si një lanet mbi shpinë, një kujtim i përjetshëm i asaj që kishte ndodhur.

Kurrë mos ndodhtë që historia tragjike dhe e tmerrshme t'u jap shqiptarëve një fat të ngjashëm! Për ta shmangur këtë, kërkohet një përkrahje bujare dhe bashkëpunim ndërkombëtar të cilat do të çonin në një gjendje, ku shqiptarët vetë të përballojnë ardhmërinë e tyre sipas kushteve vetjake. E kjo kërkon që edhe çështja e ardhmërisë së Kosovës të gjejë një zgjidhje të qëndrueshme. Mendimi im është që përpjekjet duhet të drejtohen kah një rritje e bashkëpunimit midis popujve të Gadishullit Ballkanik. Me drejtësi, me një zhvillim ekonomik dhe me një mentalitet demokratik kudo në Ballkan domethënia e kufijve do të mund të zvogëlohej dhe mbase të mund të realizohej një Federatë e çiltër dhe e vërtetë e Ballkanit (ndoshta një farë modeli i ngjashëm si tek shtetet skandinave). Pjekuria politike mungon gjithkund në Ballkan dhe nacionalizmi i verbët çon në mizori, hakmarrje dhe kështu me radhë në qarkun e së keqes. Do të duhej të ishte një preokupim serioz për Evropën se si ky qark i së keqes, në të cilën edhe ajo ka dorë, do të mund të ndërpritej por, sipas gjasave, kjo do të ndodhë vetëm pasi që konfliktet e hapura të imponojnë angazhimin e saj. E ne nuk duhet të harrojmë se Evropa është ajo e cila e ka një pjesë të madhe të përgjegjësisë për atë që ka ngjarë në Ballkan në 130 vitet e fundit. Mirëpo sot nuk flitet shumë për këtë përgjegjësi dhe pikërisht kjo mungesë e vetëdijes është një nga shkaqet që më ka nxitur të shkruaj këtë libër.

LISTA E EMRAVE SUEDEZË

NË SHQIP

Ulmar Kvik
Peter Dalhof-Nilsen
Soren Someliusit
Orjan Stureshë
Sebastian Shejman
Bengt Fyledal
Gyn Kesle
Erik Gustaf Gejer
Anders Vestin
Sodermanland
Sodra Latin
Lungren
Karl Vilhelm Ludvig
Jelmarit
Zhan q. P
Sormlandi
A. fon Shveiger-Lershenfeld
Rajhposten
Jalmar Branting
Sherstin Sandberj
Ivan T. Aminof
Nils Lago – Lengkvist
J. L. Sakson
Per Albin Hanson
Set “Seta” Högglund
Gustav Majer
Baroni Franz Nopça
Maksimilian Lamperc
Shën Goran
Elvur
Grac
fshati Eng
Bose Janson
Vestgota
Til Ojlenhpigel
Krill Gipolitoviç Dardanellov
Haxhimehdi Bahramov
Minwenti
Ernest Karlson
Peter Valenberj
Upsala
Lumi Fyris
Strindberg
Holmkvist

NË SUEDISHT

Ullmar Qvick
Peter Dalhoff-Nielsen
Sören Sommeliusit
Örjan Sturesjö
Sebastian Scheiman
Bengt Fyledahl
Gun Kessle
Erik Gustaf Geijer
Anders Westin
Södermanland
Södra Latin
Lundgren
Carl Wilhelm Ludvigun
Hjälmarit
Jean q. P
Sörmland
A. von Schweiger-Lerchenfeld
Reichposten
Hjalmar Branting
Kerstin Sandberg
Iwan T. Aminoff
Nils Lago – Lengquist
J. L.Saxon
Per Albin Hansson
Zeth “Zäta” Höglund
Gustav Meyer
Baroni Franz Nopcsa
Maximilian Lambertz
Sankt Göran
Älvor
Graz
Ängby
Bosse Jansson
Västgöta
Till Eulenspiegel
Krill Gipolitovitj Dardanellov
Hadjimehdi Bachramov
Mindscenty
Ernest Carlsson
Peter Wallenberg
Uppsala
Fyrisån
Strindberg
Holmquist

**Selma Lagerlof
Joran Tunstrom
Larsh Oke Augustson
Ana Shindberj
Juhana
Glumseryd
Vese
Karl Bildi
Heleforsh
Sana
Matias
Sherstina
Lars Holshtein**

**Selma Lagerlöf
Göran Tunström
Lars Åke Augustsson
Anna Kindberg
Johanna
Glumserud
Väse
Carl Bildti
Hällerfors
Sanna
Mattias
Kerstina
Lars Holtein**

SHTESË: BIBLIOGRAFI

Disa publikime mbi Shqipërinë dhe shqiptarët - në gjuhët tjera dhe në gjuhën shqipe:

1. Jokl, Norbert: Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen. 1923.
2. "Flamuri" – The Flag. Organ of the Albanien Agrarian-Democratik Party "Balli Kombëtar" 1948 ff.
3. Amery, Julian: Sons of the Eagle. London Macmillan & Co. 1948.
(Egna minnen från partisankriget's dagar)
4. Davies, 'Trotsky': Illyrian venture London Bodley Head 1952. (Si e mëparshmja).
5. Skendi, Stavro: Albania. New York Praeger 1958.
6. Hamm, Harry: Albania, China's Beachhead in Europe. New York Praeger 1963.
7. Demaçi, Adem : Gjarpërinjt e gjakut, 1958 dhe: Vetëmohimi 1994, -Prishtinë.
8. Qosja, Rexhep: Vdekja më vjen prej syve të tillë 1974,
dhe: Fjalori demokratik 1997 -Prishtinë.
9. Arapi, Fatos: Drejt qindra shekujsh shkojmë, 1977; Fatet, 1979; Këngët e moçme shqiptare, 1986; Ne, pikëllim i dritave, 1993; Më vjen keq për Jagon, 1994-Tiranë.
10. Podrimja, Ali: Thirrje, 1961; Kosova është gjaku im që nuk falet, 1971;
Lum, lumi, 1982; Take të larta, 2000; Sfinga 2000, Prishtinë.
11. Elsie, Robert: An elusive eagle soars. Antologji e poezisë moderne shqipe përkthyer nga Robert Elsie, UNESCO 1993.
12. Hamiti, Sabri: Njëqind vjet vetmi, 1990; Studime letrare 2003, Prishtinë.
13. Gegaj, Athanas - Krasniqi, Rexhep: Albania. New York 1964.
14. Frashëri, Kristo: The History of Albania (a brief survey). Tirana 1964.
15. Liess, Otto Rudolf: Albanien zwischen Ost und West. Hannover 1968.
16. "Dija" Organ i SHKA "Vëllazërimi", Malmo 1975 (Revistë)
17. "Stinët e Jetës" 1982-1984, Goteborg (Revistë)
18. Smiley, David: Albanian Assignment. Chatto and Windus 1984.
(Tregim rreth luftës).

19. Buda, Aleks dhe të tjerët : Fjalori Enciklopedik Shqiptar. Tiranë 1985.
20. "Zëri i Kosovës" 1985 -1986, Stokholm (Revistë)
21. Robyns, Gwen: Geraldine of the Albanians. Muller, Blond & White Ltd.
22. London 1987 (Biografi över drottning Geraldine, Kung Zogs gemål).
(Biografi e mbretëreshës Gjeraldina, gruas së Mbretit Zog).
23. "Qëndresa" Organ i Bashkësisë së Shoqatave Shqiptare në Suedi
- Malmo 1990 – 1996.
24. "Dëshira" - Malmo 1990-1993 (Revistë kulturore)
25. "Lajmëtari" invandratidningen på albanska. Stockholm 1992-1995
26. "Besa" Organ i Bashkimit të Shoqatave Shqiptare të Suedisë,
Malmo 1994-1998, 2000-2001
27. "Elsie, Robert: History of Albanien Literature. Columbia University Press,
New York 1995. (Varianti shqip: Dukagjini, Peja-Tirana 1997)
28. Elsie, Robert: Kosovo in the heart of the powder keg. 1997 (Dokumenti themeltar
mbi statusin e Kosovës dhe mbi ngjarjet e rëndësishme historike).
29. "Drita" Revistë kulturore-informative e Shoqatës "Besa" në Treleborg, viti 1996-
2000 (nr. 22 / 1998 - materiali i huazuar ka të bëj me socialistin Dhimitër Trajanin).
30. Malcolm, Noel: Kosovo, a short history. London, Macmillan 1998.
31. Abazi, Hajdin: Të paepur 1992 Suedi; Trimoshat, 1993, Suedi; Në asgjëkund të fatit-
Folle destino (shqip – italisht), Romë, 1995; Shprishja e territ, 1997 -Prishtinë.
32. Oseku, Shefki: Një lloj drite tjetër, poezi 1997, Suedi, Hetimet, roman
autobiografik, 2000, Suedi.
33. Hoxha, Nexhmije: Jeta ime me Enverin. Tiranë 2002.

LITERATURA E SHKRUAR NË SUEDISHT DHE AJO E PËRKTHYER NË SUEDISHT QË TRAJTOJNË: SHQIPËRINË DHE SHQIPTARËT

Lista është përpiluar nga Ulmar Kvik në maj të 2002-tës dhe është rradhitur sipas vitit të botimit të veprave.

1. [Anonym = S. Zanovic'] Den store Castriotto af Albanien kallad Scanderbeg. Historia. Anders Zetterberg, Stockholm 1788. (Përkthim në suedisht u bë prej origjinalit në gjermanisht dhe frëngjisht).
2. Övfer land och haf. Illustrerade reseskildringar. Stockholm C. E. Gernandts Boktryckeri 1879. [Në f 105-116 flitet për udhëtimin nëpër Maqedoni, Kosovë dhe Shqipëri nga M. Guillaume Lejean.]
3. Jensen, Alfred: Slavia. Kulturbilder. Albert Bonniers förlag, Stockholm. 1897. 355 f. [Përmban përshkrime të shkurtëra lidhur me Shqipërinë dhe Kosovën.]
4. Langlet, Waldemar – Aminoff, Iwan T.: Kriget om Balkan. Göterbog 1912-13. [Material dokumetar shumë i vlefshëm, ndër të tjera, për masakrën serbe.]
5. Von Jessen, Franz: Strövtåg på Balkanhalvön. C. W. K. Gleerups förlag, Lund. 1913. [Në mënyrë të veçantë e trajton gjendjen në Maqedoni, por edhe në Mal të Zi.]
6. Lago-Lengquist, Nils: Under Kejsarörnar och halvmåne. En krigskorrespondents minnen och anteckningar. Åhlen & Åkerlunds förlag. Stockholm 1916. 292 f. [Në f 218-225 flitet për heroin shqiptar të lirisë – Isa Boletinit.]
7. Wigert-Lundström, Hakon: Balkanresa i krigstid. P. A. Norstedt & Soners förlag. Stockholm 1917. 130 f. [Në f 112-130 bëhet një përshkrim i Shqipërisë veriore.]
8. Mörne, Håkan: Vackra, vilda Balkan! Stockholm 1935. [Në f 143-160 si dhe 197-258 flitet për tema shqiptare.]
9. Auren, Svén: Europeisk orient. Natur och Kultur. Stockholm 1936. 223 f.
10. Falck, Gunnar: Balkan i brännpunkten. Dagens böcker, Malmö. Lund 1941. 180 f. [Trajton, ndër të tjera, relacionet Itali-Shqipëri dhe Shqipëri-Greqi.]
11. Unander, W: På farofyllda uppdrag i österled. Globförlaget Malmö 1947. 258 f. [Përmban, mes tjerash, kujtimet e autorit si epror në shërbimin turk në Maqedoni dhe Shqipëri në fillim të shekullit të XX.]
12. Fyledahl, Bengt: Albanien. Semesterserien: Resehandbok. GLT Stockholm 1970. 140 f.
13. Albanien. Ordfront, Eneryda 1970. 89 f.
14. Kessle, Gun & Myrdal, Jan: Albansk utmaning. Bokförlaget PAN/ Nordstedts. Stockholm 1970. 215 f.

15. Hoxha, Enver: Studera marxismens-leninismens teori [Studjojeni teorinë marksiste-leniniste] KFML (r) Rëda Stjërnan, Helsingborg 1971. 28 f.
16. Hoxha, Enver: Talet i Moska den 16 nov. 1960. [Fjalimi në Moskë më 16 nëntor 1960.] Svensk-Albansk föreningens skriftserie nr. 3. Parathënia dhe përkthimi nga Ulmar Kvik. Södra Tryckeriet, Eneryda 1973. 40 f.
17. Hoxha Enver Två tal om kvinnan Svensk-Albansk föreningens skriftserie nr. 3. Förord och övers. av Ullmar Qvick. Södra tryckeriet Eneryda 1973. 40.s
18. Kadare, Ismail: Den döda armens general. [Gjenerali i ushtrisë së vdekur.] roman. Përkthyer prej frëngjishtes nga Britt Arenander. Bonniers 1973. 240 f.
19. Hoxha, Enver: Centralkommitténs verksamhetsberättelse på Albanska arbetets partis 6:e Kongress. [Raport i Komitetit Qendror në Kongresin e 6-të të PPSH.] Oktoberförlaget. Trycklund uppsala 1973. 135 f.
20. Qvick, Ullmar: Fem albanska noveller. [Pesë novela shqiptare.] Svensk-albansk förenings skriftserie nr. 4. Ordfront, Stockholm 1974. 55 f.
21. Kota, Filip: Proletärer i alla länder... Albanskt arbete om den fackliga världs rörelsen. [Proletarë të të gjitha vendeve... punim shqiptar mbi lëvizjen botërore të sindikatave.] Përkthim nga botimi francez. Oktoberförlaget. Ordfront, Stockholm 1975. 163 f.
22. Kadare, Ismail: Krönika i sten. [Kronikë në gur.] Roman. Sipas botimit francez përkthimin në suedisht e bëri Britt Arnenander. Bonniers 1975. 225 f.
23. Svensk-albansk föreningen: Albanien – en handbok för Albanienvänner, vetgiriga och turister. Ordfront, Stockholm 1976. 248 f.
24. Kadare, Ismail: Bröllopet. [Dasma.] Roman. Prej anglishtes e përktheu në suedisht Lars Åke Augutsson. Oktoberförlaget. Ordfront, Stockholm 1976. 148 f.
25. Hoxha, Enver: Albanien i kamp mot Chrusjtjovrevisionismen. [Shqipëria në luftë kundër revizionizmit hrushqovian.] Përkthim sipas botimit anglisht nga Erik Göthe. Oktoberförlaget. Ordfront, Stockholm 1976. 336 f.
26. Augustsson, Lars Åke: Albanska ansikten. Ordfront, Stockholm 1977. 156 f.
27. Hoxha, Enver: Rapport till Albanska Arbetets Partis sjunde kongress 1 november 1976. [Raport në Kongresin e 7-të të PPSH më 1 nëntor 1976.] Nga anlishtja përktheu në suedisht Lars-Olof Andersson. Ordfront, Stockholm 1977. 189 f.
28. Gun Kessle: Vi vill överleva. En bok om Albanien. Gidlunds. Tryckt hos Weilin & Göös Esbo, Finland 1977. 64 f.

29. Hoxha, Enver: Tre tal om kvinnan. [Tre fjalime mbi gruan.] Svensk-albansk föreningens skriftserie nr. 3. 2:a upplagan. Ordfront, Stockholm 1977. 52 f. [Botimi i parë kishte vetëm dy fjalime.]
30. Shuteriqi, Dhimitër S: Herre och tjänare. [Zotëri dhe shërbëtor.] Një novel mbi reformën agrare. Nga anglishtja e përktheu në suedisht Lars Åke Augustsson dhe B-L Jansson. – Åven Bergen ska blomma. [Edhe malet do të lulëzojnë.] Mbi bujqësinë shqiptare nga Peter Sylwan dhe Caroline Trapp. Të botuara në një vëllim të përbashkët nga Svensk-albanska föreningen (Shoqata suedezo-shqiptare.) Ordfront, Stockholm 1977. 33+30 f.
31. Löfstedt, Jan-Ingvar: Socialistisk utbildning i Albanien. Institutionen för internationella pedagogik. 27, Stockholms universitet december 1977. 70 f A4.
32. Kinas brytning med Albanien. Med inledning av Lasse Lindström. Oktoberförlaget 1978. 127 f.
33. Agolli, Dritëro: Kommissarie Memo. Nga botimi në anglisht e përktheu në suedisht Sven Collberg. Oktoberförlaget Lund 1978. 287 f.
34. Brev från Albanska Arbetetes Partis Centralkommitté och den albanska regeringen till Kinas Kommunistiska Partis Centralkommitté och den kinesiska regeringen. [Letra nga KQ i PPSH dhe qeveria shqiptare drejtuar KQ të PKK dhe qeverisë kineze.] Svensk-albanska föreningen. Umeå 1978. 30 f.
35. Qvick, Ullmar: Örnarna och bergen, [Shqiponjat dhe malet.] Albansk poesi. Förlaget Rallarros 1979. 224 f.
36. Hoxha, Enver: Imperialismen och revolutionen. [Imperializmi dhe revolucioni.] Svensk-albanska föreningen. Përkthim sipas botimit anglisht e frëngjisht. Minab, Surte 1979. 248 f.
37. Nydahl, Thomas: ”Men tystnaden var lögn”. Dikter om Albanien. Team Offset, Malmö 1979. 29 f.
38. Kadare, Ismail: Den hårda vintern. [Dimri i madh.] Roman. Sipas botimit në frëngjisht përkthyer në suedisht nga Mariann Eyre. Bonniers 1980. 447 f.
39. Agolli, Dritëro: Mor Albanien. [Nënë Shqipëri.] Përkthimi dhe interpretimi nga shqipja në suedisht prej Ulmar Kvikut. Svensk-albanska föreningens skriftserie nr. 6. 1980. 56 f.
40. Nydahl, Thomas: Frihetens ombudsman i dikten. Om den albanske författaren Ismail Kadare. Poesisällskapet occident. Team Offset Malmö 1980. 40 f.
41. Ekdahl, Ronny - Karnstedt, Torgny: Albanien – inte bara berg. Fotobok, format A4. Prisma, Helsingborg 1981. U.S.
42. [Anonym = Ullmar Qvick]: Kosova: en histori(s)k-politisk översikt. Svensk-albanska föreningens skriftserie nr. 7. 36 f. Kv Studieförlaget Uppsala 1981.

43. Hoxha, Enver: Eurokomunismen är anti-kommunism. [Eurokuminizmi është antikomunizëm.] Kommunistiska Arbetarförlaget Stockholm 1981. 170 f.
44. Hoxha, Enver: Rapport till Albanska Arbetets Partis åttande kongress. [Raport për Kongresin e 9-të të PPSH.] Kommunistiska Arbetarförlaget Stockholm 1982. 120 f.
45. Bidrag till Öststatsforskningen nr. 4, 1982. Uppsala 1983. 113 f. [Përmban kontribute të një seminari kushtuar Shqipërisë në Örebro nga Haluk Soydan: Statsmaktens legitimitet i Albanien och Bert Danemark: Några data om urbaniseringsprocessen, befolknings-utvecklingen, stadsplaneringen och den socio-ekonomiska relationen mellan stad och land.]
46. Kadare, Ismail: Stäppgudarnas skymning. Sipas botimit në frëngjisht përktheu në suedisht Lellemor Gustavsson. Bonniers Stockholm 1983. 193 f.
47. Kadare, Ismail: Nischen i muren. Roman. Sipas botimit në frëngjisht përktheu në suedisht Marianne Eyre. Bonniers 1986. 211 f.
48. Rugova, Ismail: Svensk-albansk ordlista. Svensk-albanska föreningens skriftserie nr. 9. Stockholm 1986. 60 f. [Botimi i katërt i zgjeruar më 1993.]
49. Albansk folkkultur. Svensk-albanska föreningens skriftserie nr. 10. KPS Stockholm 1987. 35 f.
50. Myrdal, Jan: Den albanska utmaningen 1968-1986. Nordstedts Stockholm 1987. 194 f.
51. Stipendiater om Albanien. Svensk-albanska föreningens skriftserie nr. 11. Stockholm 1987.
52. Kadare, Ismail: Vem förde hem Doruntine? [Kush e solli Doruntinën?] Nga frëngjishtja e përktheu në suedisht Marianne Eyre. Bonniers Stockholm 1988. 152 f.
53. Röhm, Hans Joachim: Resmål Albanien. Svensk-albanska föreningens skriftserie nr. 13. 1989. 140 f.
54. Sturesjö, Örjan: Kosovo – ett jugoslaviskt dilemma. Utrikes-politiska institutet: Världspolitiken Dagsfrågor 4: 1990. 34 f.
55. Qvick, Ullmar: Kosova. En politiskt-historisk översikt. Svensk-albanska föreningens skriftserie nr. 14. Botimi i dytë më 1990. 35 f.
56. Kadare, Ismail: Bergens Homeros. [Homeri i maleve.] Nga frëngjishtja e përktheu në suedisht Agneta Westerdahl. Bonniers Kristianstad 1990.
57. Kadare, Ismail: Drömmarnas palats. [Pallati i ëndrrave.] Nga frëngjishtja e përktheu në suedisht Agneta Westerdahl. Bonniers Borås 1992. 208 f.
58. Svensk-albansk ordbok. Utgiven av Dardania AB. ED 1993. 296 f.

59. Sommelius, Sören: Kosova utan stjärna. Carlssons. Stockholm 1993. 234 f.
60. Kadare, Ismail: Monstret. [Përbindshi.] Nga frëngjishtja e përktheu në suedisht Agneta Westerdahl. Bonniers, Falun 1994. 186 f.
61. Svensk-albanskt lexikon. Lexin-serien. Red. Sadulla Zendeli (Daja). Skolverket. Nordstedts tryckeri. 1994. 802 f. + 64 faqe me fotografi.
62. Dalhoff-Nielsen, Peter: Örnarnas land. Nga danishtja u përktheu në suedisht. Studiekamraten förlag. Eslöv 1996. 242 f.
63. Heimerson, Staffan: Sarajevo och tusen platser till. W&W. 1995.
64. Pashku, Anton: Glöd. Dramë. Përktheu në suedisht Ulmar Kvik. Studiekamratens förlag 1996. 89 f.
65. Nilsson, stefan: Hemmaplan Albanien. Grafisk support, Göteborg 1996. 148 f.
66. Sturesjö, Örjan – Scheiman, Sebastian: Den albanska frågan. Utrikespolitiska institutet. Världspolitikens dagsfrågor 8-9/1997. Kalmar 1997. 64 f.
67. Röster om Kosova. En reserapport med rekommandationer. (Karl-Erik Tysk, Bengt Orr. Truggve Emstedt, Michael Williams.) Kyrkvägens förlag. Skara 1997. 86 f.
68. Östra Europa. Illustrerad vetenskap, Köpenhamn. Serien Världen i dag. 1997. [Për Shqipërinë flitet në f. 35 dhe 65.]
69. Mårtensson, Solveig: Europas länder. [Libër për të rinj.] Almqvist&Wiksell 1998. 88 f. F A4. [Në f 4-5 flitet për Shqipërinë.]
70. Stålnacke, Anna Lena: Europas länder. [Libër për të rinj.] Natur och Kultur/ Almqvist&Wiksell. Uppsala 1998. 160 f. [Në f 8 – 10 flitet për Shqipërinë.]
71. Wingborg, Mats: Fakta om facket i Central- och Östeuropa. Stockholm 1998. 116 f. [Ka një kapitull për Shqipërinë.]
72. Toçi, Fatmir: Skanderbeg. Me përkthim në suedisht dhe sqarimf jalësh të Sadulla Zendeli – Daja. Ilust. Vehap Kokolari. Toena,. Tiranë 1998.
73. Winderberg, Siv – Ukiqi, Rukie: Så många tårar. Libër për të rinj. Raben & Sjögren. 1999. 143 f. [Një vajzë e re tregon për përjtimitet e saja nga arratisja prej Kosovës deri në Suedi.]
74. Blickpunkt: Kosova. Utgiven av Svensk-albanska föreningen. Red. Ulmar Kvik. Norrköping 1999. 62 f.
75. Beqiri, Ardita: Mitt hjärtas dagbok/ Ditari i zemrës sime [botim në shqip dhe suedisht.] Përkthimi në suedisht nga Ulmar Kvik. Podium. Stockholm 2000. 135 f.

76. Oseku, Shqiptar: Nutida albansk poesi på svenska / svensk poesi – på albanska. Një antologji dygjuhëshe: shqip-suedisht. Disa ribotime. Botimi i parë më 2000. Revista Drita. Treleborg. Rreth 350 f.

77. Sheqiri, Riza: Utan hem – var ska man bo? Ilust. Sejdi Zeka, përktheu në suedisht Ulmar Kvikku dhe autori. Copugraf, Bräkne-Hoby 2002. 50 f.

78. Fonseca, Isabel: Begrav mig stående. Ordfront 1998. Ribotim më 2002. 421 f. [Në f 29 – 115 flitet për familjen Duka, romë në Tiranë.]

79. Davidsen, Leif: De goda systrarna. (Nga danishtja në suedisht e përktheu Mona Eriksen.) Prisma 2002. Roman.

80. Nydahl, Thomas: Politisk geografi. Occident 2002.

P Ë R M B A J T J A

Dy fjalë nga përkthyesi.....

HYRJE.....

FISËT SHQIPTARE

Duka i Sodermanlandit – princ i Shqipërisë?.....

Anders Vestini vazhdon leximin.....

Të çrrënjoret e tërë fara shqiptare!.....

Lëvizja për pavarësi të shqiptarët.....

Jalmar Branting dhe fiset shqiptare

Një libër shumë i çmuar.....

VUAJTJET E SHQIPTARËVE.....

Lufta e ashpër dhe fundi i ashpër: Isa Boletini.....

Fjalët e thëna në varrin e Isa Boletinit.....

Dashuria e pamundshme: Lule Pal Marku.....

Lulja takon Aloisin.....

Mbeçë, more shokë, mbeçë!.....

Kënga e Rexhës.....

MID'HAT FRASHËRI - ALIAS LUMO SKENDO.....

Të dhëna: Kush është Mid'hat Frashëri?

Robert Elsie: History of Albanian Literature. New York 1995.....

Fjalori Enciklopedik Shqiptar. Tiranë 1985. Botim i Akademisë së

Shkencave të Shqipërisë. Kryeredaktor: Prof. Aleks Buda.....

Halim Zeqiraj: Mid'hat Frashëri si njeri dhe patriot.

Nga gazeta Flamuri, organ i Ballit Kombëtar, më 28 Nëntor 1978.....

FORMIMI I NJË SHQIPËRIE TË LIRË E DEMOKRATIKE MBI

BAZAT MODERNE E NJË SHOQËRIE MODERNE

Episode nga jeta e Mid'hat Frashërit - Një ditë në librarinë e Lumo Skendos:

1. Halim Zeqiraj rrëfen në gazetën Flamuri më 28 Nëntor 1978.....

2. Ma shkatërruan murin - Në mënyrë të lirë sipas udhëpërshkrimit

“Europeisk Orient” -Orienti evropian- 1936, të Sven Aurénit.....

3. Pas shkollës shkova te libraria e Lumo Skendos:

-Nexhmije Hoxha rrëfen në librin e saj

“Jeta ime me Enverin”, Tiranë 1998.....

Nga proza e Mid'hat Frashërit

“Lotët” nga Hi e Shpuzë, 1915.....

TAKIME ME ALBANOLOGË DHE DISA TË TJERË.....

“Me thuaj se me kë rri, të të them se cili je!”.....

Futja e Andersit në vorbullën politike.....
 Andersi e takon një shqiptar.....
 Një bursë udhëtimi dhe pasojat e saj.....
 Mbi gjuhën shqipe.....
 Baroni Franc Nopça dhe disa albanologë të tjerë.....

MË SHUMË HEROIZMA SE SA GRURË.....

Kristë Maloki: Shpirti i Shqiptarit

(marrë nga gazeta Bota Shqiptare 1943).....

“Rrëfejza nga “ Tregime të moçme shqiptare” të Mitrush Kutelit

1. Rozafati
2. Besa e Konstandinit.....
3. Gjergj Elez Alija.....
4. Fuqia e Mujit.....

GRUAJA NË SHOQËRINË SHQIPTARE - NJË STUDIM NË ERRËSIRË.....

1.Udhërrëfyese i parë në perandorinë e errësirës:

At Shtjefën Gjeçovi (1874-1929).....

2. Nga Kanuni i Lekë Dukagjinit: Libri i tretë. Martesa.....
3. Mid’hat Frashëri: Grave. Nga “Plagët tona” (traktat dhe ese 1924).....
4. Enver Hoxha: Mbi disa aspekte të problemit të gruas shqiptare
(Fjala e mbajtur në plenumin e 2-të të KQ të PPSH, 15 qershor 1967)....
5. Nga fjala e mbajtur në mbledhjen e Sekretariatit të
KQ të PPSH me 18 tetor 1969.....
6. Ana e ndritur e medaljes: Përparimi i viteve të fundit.....
7. Një feministe shqiptare në Maqedoni: Fatmire Lumani:
Shtjellë poetike, Strugë 1997.....
8. Fati i një vajze shqiptare në mirëqenien suedeze.....
9. Edhe një vajzë tjetër shqiptare tregon për vuajtjet e veta.....

PARLAMENTI I KTHYER NË TEATËR KUKULLASH

- **FATI I NJË GODINE SHQIPTARE**.....

Të gjitha vendet e zëna.....
 E shtëna në parlament.....
 Plot me gaz helmues.....
 Til Oljenshpigeli dhe Nastradin Hoxha.....
 I përshtatshëm për diktaturën.....
 Ndërmjetakt: Kiril Gïpolitoviç Dardanellov.....
 Prishja me sovjetikët.....
 Teatri i Kukullave.....
 Si gjarpërinj.....
 Simbolika parodike - dhe tragjike.....

A MUND TË MËSOHET SHQIPJA?.....

Fjalët e huazuara.....
 Dialektet.....
 Gjuha e njësuar.....

Ta shijojmë pak shqipen.....
Libra mësimi dhe fjalorë.....
I kthehemi edhe një herë pyetjes së shtruar në fillim të këtij kapitulli.....
Erik Hans Tunman (1746-1778) – një hulumtues
mbi gjenezën e shqiptarëve.....

A E NUHASIN SHQIPTARËT HUTIN NË KËNETË?
Shprehjet dhe fjalët e urta popullore.....

TUNGJATËJETA SHQIPTAR! - KUSH JE TI?
Sprovë për të skicuar mentalitetin dhe vetitë e shqiptarëve.....

SHQIPËRIA DHE HEBRENJTË GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE.....
Hebrenjtë në Shqipëri - disa fakte.....
Shqiptarët e Kosovës i shpëtojnë hebrenjtë
Hebreja Julia Kantozi, rrëfen:.....

Dr. Spiro Lito, aso kohe mjek në Prishtinë, rrëfen:
Shqiptarët nuk u ndikuan nga antisemitizmi.....
Hebreu i fshehur në krevatin e gruas shqiptare.....
Një hebreje që i jep gji një fëmije shqiptar.....
Shqiptari Refik Veseli merr medalje nga Izraeli.....

ZËRA SHQIPTARË PËR SUE DINË DHE SUEDEZËT
Një student shqiptar në Upsala – vetëm trillim?.....
Instituti i Karolinës dhe njohja me dramën e Strindbergut.....
Përsëri në Shqipëri.....
Romani i Petro Markos "Hasta la vista":
Një vajzë suedeze si vullnetare në Spanjë.....
Sterjo Spasse për vizitë në Stokholm më 1958.....
Një fat njeriu: Musine Kokallari.....
Musine Kokallari mbi Selma Lagerlofin.....
Përfytyrimet e mira e të ndritshme na ndihmojnë të mbijetojmë.....

ZËRA EMIGRANTËSH.....

SUNDIMTARI DHE NËNSHTETASIT.....

SOVRANI I ERRËSIRËS: ENVER HOXHA
Fati i intelektualëve gjatë sundimit të Enver Hoxhës.....
Një dëshmitar shfaqet pas katërdhjetë vjetësh – Ymer Dishnica:.....
Familja Qiriazit – pioniere e arsimit të popullit shqiptar
dhe fati i saj gjatë regjimit komunist.....
Dramaturgu që u la në harresë: Minush Jero në konflikt me Enver Hoxhën.....
Në pyetjen lidhur me qëndrimin e vërtetë të Enver Hoxhës
për kulturën, Jero thotë:.....

Në librin "Shqipëria – zgjim i dhimbshëm" (Tiranë 1991) Atalanta Pasko,
vajza e shkrimtarit dhe bankierit Dhimitër Pasko,

i njohur si Mitrush Kuteli, shprehet:.....
Ministrat e brendshëm kriminelë, apo ky ishte arti për ta bërë qeverinë
shqiptare të bie në grackën e ngritur nga ajo vetë?.....

“ARMIQTË E POPULLIT” - BURGJET – POSHTËRIMET.....

KAMPI I SPAÇIT.....
Revolta në Spaç në maj 1973.....

SHQIPËRIA PREJ KOMUNIZMIT DERI TE POSTKOMUNIZMI
Evropë – ç’mundësi u ke ofruar shqiptarëve?.....
Ndërtimi i një shoqërie - dhe dilema mbi detyrimin apo lirinë.....

SHEMBET DIKTATURA: SHQIPËRIA 1990-1991.....
Prijsi i vendit – Ramiz Alia.....
Bëhen të dukshme të çarat në sipërfaqen monolite.....
Nis të thyhet monoliteti.....
Shqipëria pluraliste bënë hapat e parë të pasigurtë – me uri dhe emigrim.....
Zgjedhjet me 31 mars 1991- një fitore e papritur e PPSH.....
Një pranverë e trazuar: Partia e Punës së Shqipërisë e ndërron emrin.....

YLLI BUFI DHE QEVERIA E SHPËTIMIT KOMBËTAR.....

SALI BERISHA DHE PARTIA DEMOKRATIKE 1992-1994.....

UDHËPËRSHKRIM, 1994

Drejt ikjes nga e kaluara - e pastaj? Smajl Ymeri në Rotebro dhe në Tiranë.....
Lypsit dhe Enver Hoxha - tashmë i hequr nga froni.....
Rinia shqiptare dhe vizitat nëpër shtëpia.....
Prill-trill – në pritje për të udhëtuar.....
Drejt Maqedonisë.....
Raport nga një fshat i Maqedonisë -
miqtë shqiptarë të gatshëm të vdesin për Suedinë.....
Intermexo etnike dhe një shëtitje e këndshme nëpër male.....
Qumshti i dhisë, shëtitjet dhe një shi që s’ndalej.....
Një shëtitje deri në Ohër dhe Strugë.....
Pleq, plaka dhe murgesha të vogla e të zymta.....
Mëllenja këndon në lartësitë e Peristerit.....
Fashtrat e kullave prej gurit.....
Lamtumirë Asamat!.....
Ditët e fundit në Tiranë.....

NGA KRIZA KUSHTETUESE MË 1994 DERI TE SHEMBJA MË 1997.....

SHQIPËRIA NË VORBULLIN E CIKLONIT.....
Kriza shqiptare.....
Bota sot: epoka e shndërrimeve të mëdha.....
Pasojat e privatizimit në Shqipëri.....
Shqipëria e gjymtuar dhe e izoluar.....
Kriza dhe çështja shqiptare.....
Të sundosh apo të udhëheqësh vendin?.....

SHQIPËRIA PREJ 1998 DERI MË 2001.....

SHËNIME NGA UDHËTIMI I VITIT 1995.....
Filloi seminari në Shkodër.....
Një mbrëmje e mrekullueshme me muzikë dhe kujtime.....
Mbrëmja në prag të festës së shën Gjorit me peshk dhe verë.....
Kthimi në Tiranë.....
Në Shqipëri takimet janë të shumta dhe vetmia tepër e rrallë.....
Dita e parafundit në Shqipëri.....
Lamtumirë, Vend i Shqiponjave!.....

SHQIPËRIA E DYTË: KOSOVA.....

KOSOVA VIKTIMË E POLITIKËS BOTËRORE.....

NË VEND TË EPILOGUT.....

LISTA E EMRAVE SUEDEZË NË SHQIP DHE NË SUEDISHT.....

SHTESË: BIBLIOGRAFIA.....

**LITERATURA E SHKRUAR NË SUEDISHT DHE AJO E PËRKTHYER
NË SUEDISHT QË TRAJTOJNË: SHQIPËRINË DHE SHQIPTARËT.....**

U L M A R K V I K U

MË SHUMË HEROIZMA SE SA GRURË

Një përshkrim dokumentar i historisë dhe jetës
shoqërore të shqiptarëve gjatë shekullit të XX

[U përkthye në shqip prej origjinalit në gjuhën suedeze: "Mera hjältemod än vete"
(Revista "Drita" në Treleborg, Suedi, viti 2004, 399 faqe. ISBN-91-631-5616-4)
por me disa shtesa dhe ndryshime të vogëla]

Përktheu: Hajdin Abazi

Korrektorë:
Shefki Oseku, Ulmar Kvik

Përpunimi kompjuterik: Frashër Oseku

Libri u financua nga ABF-i në Treleborg-Suedi

**I jam shumë mirënjohës kryeredaktorit të "Dritës", Shefki Oseku, pa ndihmën e
të cilit ky libër nuk do ta shihte dritën.**

Autori

U dorëzua në shtyp në qershor të vitit 2006

Tirazhi 1.000 kopje

BOTIM I REVISTËS "DRITA" NË TRELEBORG-SUEDI

BIOGRAFIA E ULMAR KVIKUT



Ulmar Kvikut u lind më 13 qershor 1934, d.m.th. para 72 vitesh, si fëmija i parë në një familje të varfër. Babai i tij ishte punëtor por me interesa intelektuale për artet, politikën, dhe natyrën. Nëna ishte shtylla e familjes. Me sakrificat e familjes Ulmari i ri i vazhdoi studimet në gjimnaz dhe në shkollën pedagogjike. Ai u interesua për çështjet ndërkombëtare, për gjuhë të huaja, dhe ky interesim u forcua përmes dëgjimit të radiostacioneve të botës. Në këtë mënyrë ai mori kontakt me Radio Tiranën, Radio Shkodrën dhe Radio Kukësin. Në vitin 1969 fillon intesivisht të mësoj gjuhën shqipe, përmes literaturës së bollshme që i vinte nga Shqipëria. Ndërkaq në vitet '70, '78, '79, '94, e vizitoi Shqipërinë, kurse në vitin '95 mori pjesë në Seminarin Ndërkombëtar "Shkodra ndër shekuj". Poashtu në vitet

1970 dhe 2004 merr pjesë në Seminarin për albanologët e huaj që organizohet në Prishtinë. Gjatë viteve të '70-ta Ulmari ka pasur kontakte të dendura me arbëreshët e Italisë. Ndërkaq më 1994 e ka vizituar edhe Maqedoninë Perëndimore. Edhe sot i ruan librat dhe fotografitë si dëshmi për këto kontakte. Pra, mëse një gjysmë shekulli kontakte me botën shqiptare nga Suedia!

Vlen të ceket se në Suedi, Ulmari prore ka qenë zëdhënës jozyrtar i Shqipërisë dhe i mbarë kombit shqiptar. Ishte bashkëpunëtor e më vonë edhe kryetar i Shoqatës Suedeze-Shqiptare, që u themelua në vitin 1970 e ku për 10 vjet u botua Buletini - një tribunë për shqiptarët dhe letërsinë shqipe. Që nga viti 1981 bashkëpunon me gazetën e re "Albanien och vi" (Shqipëria dhe ne). Më 2002 Shoqata Suedeze-Shqiptare u shndërrua në Komitetin Shqiptaro-Suedeze, ku Ulmari parreshtur e jep kontributin e tij.

Pothuajse të gjitha përkthimet letrare nga shqipja në suedisht kanë kaluar nëpër duart e Ulmar Kvikut. Ka botuar në suedisht një seri veprash të autorëve shqiptarë, të cilat i ka përkthyer me përkushtim. Ka bashkëpunuar në përpilimin e disa veprave tjera gjuhësore: tre fjalorë suedisht-shqip dhe një gramatikë të suedishtes në shqip. Në vitin 2004 nga Revista "Drita" në Treleborg iu botua libri i tij dokumentar në gjuhën suedeze "Mera hjältemed än vete" (Më shumë heroizma se sa grurë), ku flitet për shqiptarët gjatë shekullit XX, e të cilin tashmë lexuesi e ka në dorë, përkthyer në shqip nga shkrimtari dhe veprimtari i mirënjohur, Hajdin Abazi. Ulmar Kvikut në bashkëpunim me mikun e tij, Lars-Erik Morinin, janë duke e përgatitur fjalorin shqip-suedisht, të parin fjalor të këtij lloji. Ai ndihet krenar për emërtimin "Shqiptar Nderi", dhe për dekoratat e marra nga Zyra e Kosovës, në Suedi, si dhe nga Shoqata bëmirëse "Nëna Tereze", dega në Suedi. Ulmari është anëtar shumëvjeçar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Suedisë.

Është babai i katër fëmijëve. Tre prej tyre të lindur në martesat e mëparshme, ndërsa Arlinda, 9 vjeçare, është një vajzë e talentuar suedeze-shqiptare, e cila u lind pas martesës së Ulmarit me Samkën, gocën pejane.

Kënaqësia të cilën ai e përjeton nga frytet e punës së vet - është shumë më e madhe se sa mundi që bën. Dhe kjo kënaqësi lumturohet veçmas nga jeta e tij familjare suedeze-shqiptare....

Kryeredaktori i "Dritës" Shefki Oseku,
më 20/ 02/ 2006, Treleborg-Suedi